

Shqipja dhe Sanskritishtja

PJESA E DYTË

PETRO ZHEJI







Petro Zheji

Shqipja dhe Sanskritishtja

PJESA E DYTË



TIRANË 2006

Mars 2006 © *Copyright by* Petro Zheji.
Të gjitha të drejtat e ribotimit, të riprodhimit, të riprodhimeve të pjesëshme apo citimeve, janë e drejtë e Autorit. Ligji dënon çdo shpërdorim të së drejtës së Autorit.

Shtëpia botuese **Tertiumdatur**

Kompjuterizimi i këtij botimi, duke përfshirë këtu edhe simbolet, grafikat, riprodhimin e fotove, kopertinën dhe pregatitjen për shtyp, janë kryer nga Albert Thoma.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Zheji, Petro
Shqipja dhe Sanskritishtja / Petro Zheji. –
Bot. i I-rë – Tiranë:
Tertiumdatur, 2006.
Pj. 2, 564 f. : me il. ; 230cm
Bibliogr.
ISBN 99943-805-1-6

811.18 `362 :811.211
811.211 `362 :811.18
811.18 `373.6

Dy fjalë lexuesit...

Mendojmë se kjo Pjesë e Dytë nuk ka nevojë për parathënie, pasi ajo e Pjesës së Parë i vishet llogjikisht, e më tej e më tepër, edhe Pjesës së Dytë. Por sidoqoftë mendojmë që para se të hidhemi *in media res*, prapë diç i duhet thënë lexuesit për t'ia bërë atij më të lehtë perceptimin e Mesazhit që Studimi përçon.

Pjesa e dytë e këtij studimi është ndarë më dysh, në **Hyrjen** dhe **Gllosarin**.

Në Hyrje jepet një minimum i bagazhit teorik dhe "teknik" që do të zbatohet në Gllosar për motivimin e fjalëve sanskritishte nëpërmjet Shqipes që, si një "*psikopomp*" i lashtë e hyjnor, i përcjell ato tek Simboli që ato përshkruajnë në mënyrë të pavetëdijshme (në sistemin gjuhësor ku bëjnë pjesë) dhe ku etimollogjizimi i tyre merr fund e kur ato pra *prehen* më në fund të qeta...

Shëmbulla të tilla janë dhënë jo pak edhe në Pjesën e parë të këtij Studimi, por veç atje nuk është folur me hollësi dhe as me një rigorozitet shkencor të mjaftueshëm mbi metodollogjinë tonë të veçantë të motivimit. Kjo është bërë në Pjesën e dytë, e ndoshta edhe më tepër e më thellë nga ç'duhej. Është fjala këtu, ndër të tjera, për minimumin e një arsenali të tërë njohurish që jo vetëm përfshijnë arritjet e fundit të Gjuhësisë, të Fillosofisë e të Llogjikës por që shtrihet, me një frymë Sinteze, edhe në zhvillimet më të fundit në fushat e ndryshme të Dijes siç janë Fizika Moderne, Psikollogjia e Inkoshientit etj.

Lexuesi që nuk ka mundur të lexojë Pjesën e parë nuk do ta ndjejë veten si të përhumbur e të hutuar në këtë pjesë të dytë, falë përsëritjeve si dhe shënimeve të shumta, ndonëse të shkurtra, mbi momentet më themelore të parashtrimeve teorike të Pjesës së parë.

Më tepër nuk po zgjatemi sepse një diallog qoftë edhe i përciptë, me lexuesin, do të qe i mundur dhe i frytshëm vetëm pasi ai të ketë përshkuar i përqëndruar tërë rrjedhën e parashtrimeve tona në këtë Studim...

Në Pjesën e parë të këtij studimi ne vumë në dukje një afinitet të theksuar mes Shqipes dhe Sanskritishtes.

Ky afinitet shfaqej në radhë të parë në një listë të gjatë gllosash me të njëjtin kuptim (a kuptim të afërt) dhe me të njëjtën formë (a forma tepër të përngjashme) në të dy gjuhët, si p. sh.:

sanskr.	shq.
bhāra	**barra**
trapa	**turp**
paka	**pjek**
khyā	**quaj**
vāsū	**vashë**
...	...

Ai shfaqej, së dyti, në faktin se në një numër të madh fjalësh të përbëra të Sanskritishtes, pjesët përbërëse mund të identifikoheshin me rrënjë të pastra (*operatorë të lirë*) të Shqipes, gjë që edhe i **motivonte** ato, këto fjalë sanskrite, që do të thotë: *shpjegonte përse ato kanë atë kuptim që ato në fakt kanë.*

Shëmbulla të tilla qënë ndër të tjera:

prekṣya - *i* **dukshëm**

që vlen të shikohet. Fjalë që zbërthehet (e pra dhe motivohet) me *ndërmjetësinë e Shqipes* si **bër ka sy**.

bhrāmarin - *epileptik* (që vuan nga *morbus* **caducus**)

Fjalë që zbërthehet (e pra dhe motivohet!) si:

bh ram arin

dhe me shqipen:

bâ rām arjun

E kështu me radhë...

Në të gjitha këto raste sanskritishtja nuk është në gjëndje, për mungesë operatorësh të lirë, të automotivohet, gjë që na jep të drejtë të shkruajmë:

$$\textbf{gll.}\ (x')_{\text{sanskr.}} < \textbf{gll.}\ (x)_{\text{shq.}}$$

e pra një raport i mundshëm **derivacioni** i gllosës sanskrite (***x'***) nga gllosa korrisponduese e Shqipes (***x***).

Kjo do të thotë se *fuqia motivuese e fjalës shfrytëzohet si një kriter lashtësie*, në kuptimin që në se një gllosë e sistemit ***X*** është në gjëndje të motivojë një gllosë të sistemit ***X'*** dhe e anasjellta nuk është e vërtetë, që këndej mund të deduktohet me plot të drejtë se:

$$x' \supset X' \quad < \quad x \supset X$$

ku simboli $\supset$ tregon *përfshirje në ...*, ndërsa simboli $<$ *derivacion.*

Në qoftë se pastaj kjo është e vërtetë për një numër shumë të madh gllosash të sistemit ***X'***, ne mund të shkruajmë simbolikisht:

$$\begin{array}{ccc} S' & < & S \\ x' \supset X' & & x \supset X \end{array}$$

Dhe që këndej rrjedh se: a) sistemi ***X*** është thjesht më i lashtë, më "zanafillor" se sistemi ***X'***, ose që; b) sistemi ***S'*** *rrjedh* nga sistemi ***S***, është një *derivat* i tij.

Kështu për shëmbull italishtja, frëngjishtja, spanjishtja... (gjuhët e ashtu-quajtura "romane") *rrjedhin* nga latinishtja sepse është e mundur të tregohet se

si të gjitha mund të bëhen të rrjedhin në leksikun e tyre, nëpërmjet disa transformacioneve fonetike standard, nga latinishtja.

Por shëmbulli i latinishtes dhe i gjuhëve romane nuk mund të zbatohet *talis qualis* në rastin e Shqipes dhe të Sanskritishtes. Edhe kjo sepse këtu është fjala për *motivim*, që do të thotë, në shumicën e rasteve, siç shihet në këtë studim, në *shpënien e fjalës për të motivuar* (këtu sanskritishte) tek *simboli që ajo "pa ditur" përshkruan, dhe që përbën limanin e fundëm ku fjala plotësisht e motivuar prehet më në fund e qetë**...

Ndaj pra dhe në rastin e Sanskritishtes ne do të optojmë për rastin (a), me fjalë të tjera ne do përpiqemi të arrijmë në përfundimin se Shqipja është më e lashtë se Sanskritishtja dhe kaq.

Një gjë e tillë nuk është bërë në një mënyrë e në një sasi të mjaftueshme në *Pjesën e parë* të këtij studimi, sepse duhej dhënë një numër më i madh shëmbullash motivimi me anë të shqipes të gllosave sanskritisht.

Pikërisht me këtë dhe mirret kjo pjesë e dytë e studimit. Po në të jepet edhe një vështrim i thelluar mbi Gjuhën në përgjithësi, mbi disa karakteristika a specifika të saj të pavëna në dukje gjer më sot. Një gjë e tillë bëhet edhe në pjesën e parë, por në një mënyrë disi mjaft koncize dhe jo aq të kapshme nga lexuesi i thjeshtë të cilit ky studim dhe i drejtohet në radhë të parë, shqiptarit të mirë dhe babaxhan që do të dijë më tepër për gjuhën e tij dhe nëpërmjet saj për historinë dhe identitetin e popullit të tij. Kjo problematikë me karakter të përgjithshëm, që përbën objektin e një studimi tjetër ende të pabotuar me titull "Fillosofia e Llogjika e Gjuhës" që nga edhe janë huajtur mjaft zhvillime dhe rezultate, rimerret këtu më shtruar.

Në këtë pikë lexuesi mund të pyesë: Po përse është i nevojshëm një vështrim i tillë i përgjithshëm mbi Gjuhën gjersa synimi i këtij studimi është kryesisht, në mos po vetëm e vetëm, nxjerrja në pah e lidhjeve të Shqipes me Sanskritishten dhe të provuarit mundësisht të një lashtësie më të hershme të Shqipes ndaj Sanskritishtes?

Një gjë e tillë është e nevojshme kryesisht për *përligjërimin shkencor të procedurave* që ne përdorim për t'ia arritur qëllimit tonë.

---

* "Prehja" pra *jo tek një koncept* sado primar e themelor qoftë ai (etimollogjia klasike) *por tek një simbol* (etimollogjia e rè).

Kështu, bie fjala, tërë procedura jonë motivuese ngrihet mbi hipotezën se *gjuha referon gjithnjë tek Qëndra, e rrjedhimisht tek simboli.*

Le ta ilustrojmë këtë me ndonjë shëmbull. Le të shqyrtojmë fjalën gjermanisht *sterben = me vdekë.*

Motivimi i kësaj fjale gjermanisht jep:



Kështu fjala gjermanisht *sterben* "pushon" tek simboli ● që ajo përshkruan dhe që është siç dimë ai i *errësirës*, i *vdekjes* ...

Pasi arrijmë në këtë pikë, ne duhet të vërtetojmë, qoftë me një numër të stërmadh shëmbullash a qoftë, edhe më mirë, teorikisht, se është gjithnjë kështu, se motivimi i fjalës përfundon gjithnjë tek një simbol, se, e thënë ndryshe, *fjalët përshkruajnë e shprehin në instancë të fundit simbole e jo koncepte.*

Së dyti, duhet provuar se reduktimi tek simboli është njëkohësisht edhe reduktimi tek Qëndra. Ja pra që lind llogjikisht nevoja për zgjerimin e thellimin e bisedës rreth tërë kësaj problematike.

Për një strukturizim më të qartë të kësaj *Hyrje*, do të jetë mirë të hartojmë një listë të çështjeve (*a zgjerimeve të çështjeve*) që nuk janë prekur ose nuk janë prekur sa duhet në *Pjesën e parë* të këtij studimi për të përligjëruar saktësinë e motivimeve tona të gllosave sanskritisht.

Një listë e tillë do të përfshinte kryesisht këto pika:

— *Artikullimi llogjik i Mendimit mitik nëpërmjet Algoritmit Simbolik:*

b. Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik
c. Ndërtimi i Algoritmit Simbolik duke u nisur nga Hiçi
d. Një ballafaqim i drejtë për drejtë i Algoritmit Simbolik me Mendimin mitik
e. Algoritmi Simbolik si HOLOGRAMË

— *Prania e Algoritmit Simbolik (e pra edhe e Mendimit mitik) në gjuhë të ndryshme.*

— *Se si fjalët i referohen gjithmonë, kur në një mënyrë, kur në një tjetër Qëndrës.*

— *Si emërton Gjuha?*

— *Se si fjalët me plurisemantizmin e tyre shtrojnë ekuacione simbolike e pra mite kozmogonike.*

— *Gjuha dhe Inkoshienti.*

— *Shkenca e rè e zgjeruar e Etimollogjisë*

— *Urtësia e Gjuhës*

Para se të fillojmë zbërthimin e këtyre pikave, duhet të themi se ato nuk janë krejt të ndara nga njëra tjetra. Përkundrazi ato depërtojnë kur në një mënyrë kur në një tjetër tek njëra tjetra, "mbivendosen" pjesërisht (angl. *they overlap*), përsërisin pjesërisht njëra tjetrën etj., etj. kështu që për vetë natyrën polivalente të simbolit rreth të cilit ato vërtiten është e pamundur të hiqet një kufi i prerë mes një çështjeje dhe një tjetre. Kështu pra që *edhe përsëritjet, kur në një masë e kur në një tjetër, janë të pashmangshme.*

Le të fillojmë pra atëhere me: *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik*, ndërtimi i të cilit, do të na japë mundësi ta zbatojmë krejt automatikisht Mendimin Mistik në Gjuhë e kudo.

Artikullimi llogjik i Mendimit Mitik nëpërmjet Algoritmit Simbolik

a. Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik

Ç'është Mendimi Mitik?

Mendimi mitik është mendimi i fillosofirave dhe feve të lashta, kryesisht të Lindjes. Ai lidhet me një vizion tjetër, jo "shkencor", si ky yni sot, mbi Botën. Ai ka qënë i njëjtë për të gjithë Botën e lashtë dhe të stërlashtë, ashtu sikundër mendimi shkencor është sot i njëjti për të gjithë popujt e Botës, a të paktën për shumicën e tyre dërmuese.

Qëndrimi përbuzës i shkencës klasike ndaj mendimit mitik

Gjer para pak kohësh mendimi mitik vështrohej si qesharak, absurd dhe i rremë. Por aty nga fillimi i gjysmës së dytë të këtij shekulli e veçanërisht gjatë këtyre dekadave të fundit, në mos po edhe më herët, opinioni për të ndryshon, dhe një punë e madhe bëhet sot në tërë botën për një kuptim më të thellë të këtij mendimi si edhe për një rivlerësim të tij.

Rivlerësimi i mendimit mitik nga shkenca moderne

Rezultatet e arritura janë mahnitëse. Mbrrihet, ndër të tjera, në përfundimin

se pa ndihmën e tij është e pamundur të shpjegohen në një mënyrë llogjike, të kënaqshme dhe konsekuente, zbulimet e fundit të shkencës, ndër të tjera ato të Fizikës moderne*. Pra dhe ne asistojmë sot në vërshimin përmbysës dhe triumfues të mendimit mitik (mistik) kaq të përbuzur dhe të vënë në lojë dikur.

Gjendja e fragmentuar e mendimit mitik (mistik)

Por mjerisht ky Mendim na paraqitet si i "pa organizuar", si "fragmentar", si "rapsodik", si i "pastrukturuar". Jo se ai duhet të jetë në vetvete i tillë, por duke qënë fjala për një strukturizim të hollë dhe të panjohur si dhe në kundërshtim të plotë me mentalitetin tonë dhe me shprehitë tona mendore, ai i është dukur studiuesve krejt i pakapshëm. E pra kështu ai mbetet për dijetarët ende sot i pastrukturuar, i pa artikulluar në një "sistem", siç nuk ka ndodhur përkundrazi me mendimin shkencor, me Llogjikën Mathematike (a simbolike), me ato suksese e me ato zbatime të frytshme dhe të gjithanshme që të gjithë tashmë i dimë.

Mundësia e artikullimit llogjik të mendimit mitik

Por autori i këtij studimi mendon se ka mundur ta mbushë këtë boshllëk me ndërtimin e një Algoritmi Simbolik që s'është tjetër veçse pikërisht artikullimi llogjik i mendimit mitik (mistik).

Ai e parashtron zbulimin e tij, si dhe pasojat dhe zbatimet e shumta që ai gjen kudo në të gjitha fushat e Dijes, në studime të veçanta ende të pa botuara. Prej tyre ne dhe kemi marrë e paraqitur këtu, duke i integruar në një parashtrim të shkurtër, të thjeshtë e të kuptueshëm për një shtresë të gjërë lexonjësish, ato elemente që janë të domosdoshëm për të kuptuar dhe legjitimuar metodollogjinë e rè të autorit në analizën llogjike-fillosofike të "fakteve" shkencore në përgjithësi dhe të Gjuhës në veçanti.

---

* Shih për këtë edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi, fq. 111.

*Përcaktimi i mendimit mitik sipas Cassirer**

Për ndërtimin e Algoritmit Simbolik, si një strukturizim të mendimit mistik, duhet nisur nga një përcaktim i këtij mendimi, por nga një përcaktim i tillë me të cilin të mund të "operohet". Le të zgjedhim, për këtë qëllim, atë të Cassirer (shih edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi, fq. 106), sipas të cilit karakteristika më themelore e mendimit mitik dhe ajo që e bën atë krejt të ndryshëm nga mendimi shkencor është *akauzaliteti*, gjë që do të thotë se shpjegimi i ngjarjeve nuk bëhet sipas këtij mendimi përmes parimit të *shkakësisë* dhe as, për pasojë, siç do të shohim, me ndihmën e *Arsyes*.

Akauzaliteti i mendimit mitik dhe Fizika moderne

Mund të shkruajmë:

$$\textit{Mendimi mitik}\ (\text{Cassirer}) = \textit{mendim akauzal} = -\leftrightarrow$$

ku $\leftrightarrow$ është në llogjikën mathematike simboli (shenja) e përdorur për të treguar propozicionin llogjik të *kauzalitetit* (*shkakësisë*).

Vëmë rè, shkarazi, se parimi i shkakësisë nuk shpjegon dot më asgjë në Fizikën moderne (kuantike), siç detyrohet ta pranojë këtë edhe vetë Einstein-i, kundërshtar i betuar i parimeve mbi të cilat ngrihet kjo Fizikë dhe i Frymës nga e cila ajo udhëhiqet (shih edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi, fq. 110).

Triumfi i mendimit mitik në shkencën moderne

Duke qënë kështu, vihet rè "a priori" një pikë e rëndësishme kontakti mes mendimit mitik (mistik) dhe shkencës moderne që ndiqet, siç do të shohim më

---

* Ernst Cassirer, fillosof gjerman i shekullit 20-t. Vepra e tij kryesore *Fillosofia e formave simbolike* përbën një kontribut themelor në fillosofinë e kulturës.

tej në këtë studim, edhe nga shumë pika të tjera përbashkësie, të cilat shpjegojnë fundja më në fund edhe "përsenë" e triumfit sa të stuhishëm, aq edhe të papritur dhe të çuditshëm të mendimit mitik në të gjitha fushat e Dijes së Kohës sonë*.

Mendimi mitik dhe Qëndra

Një tjetër karakteristikë themelore e mendimit mitik është "pozimi i Qëndrës" që përcaktohet si *Coincidentia oppositorum* (përputhja e të kundërtave) dhe që identifikohet në instancë të fundit me ZOTIN.

Duke treguar me x dhe $-x$ të kundërtat (që mund të jenë çfarëdo) mund të shkruajmë:

Qëndra = *Coincidentia oppositorum* = $(x = -x)$

Pozimi i akauzalitetit = Pozimi i Qëndrës

Le të vërtetojmë tani se këto dy karakteristika themelore të mendimit mitik, pozimi i Qëndrës dhe akauzaliteti janë ekuivalente. Ndërtojmë për këtë qëllim tabelën e vërtetësisë të kauzalitetit të vështruar si një propozicion llogjik si edhe atë të ekuacionit $(x = -x)$, i vështruar edhe ky si një propozicion llogjik.

Ndërtimi i tabelave të vërtetësisë **

Ndërtimi i tabelës të vërtetësisë të propozicionit llogjik të shkakësisë (kauzalitetit):

Në një mënyrë disi të thjeshtuar mund të themi se një ngjarje p vështrohet si **shkaku** i një ngjarje q, që e ndjek dhe që quhet **pasojë** a **efekt**, kur sa herë ndodh p, ndodh pas saj edhe q. Në qoftë se një gjë e tillë nuk vihet rè, mes

---

* Shih edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi, fq. 159.

** Tabelat e vërtetësisë (angl. *Truth Table*) përbëjnë një farë kriteri mathematik për të përcaktuar nëse një pohim është i vërtetë apo i rremë.

p dhe q nuk ekziston ndonjë raport *shkak-efekt*.

Duke treguar me "**I**" *ekzistencën* e raportit në fjalë dhe me "–" *mungesën* e tij, ne mund të shkruajmë:

p	q	$p \leftrightarrow q$
I	I	I
I	–	–
–	I	–
–	–	I

ku me "**I**" është treguar *ekzistenca e raportit* (*Vërtetësia* e relacionit, e propozicionit), kurse me "–" *mos ekzistenca e raportit* (*Fallsiteti* i relacionit, i propozicionit).

Ndërtimi i tabelës të vërtetësisë të "Coincidentia oppositorum" të vështruar si një propozicion llogjik:

x	x	$x = -x$
I	I	–
I	–	I
–	I	I
–	–	–

Llogjika mathematike (simbolike) na mëson se:

Kur tabelat e vërtetësisë të dy propozicioneve llogjike
janë të barabarta, dy propozicionet llogjike në fjalë janë ekuivalente

si edhe:

Kur tabelat e vërtetësisë të dy propozicioneve llogjike janë të kundërta,
dy propozicionet llogjike në fjalë janë edhe ato të kundërta

Duke qënë kështu mund të shkruajmë:

$$Qëndra = (x = -x) = - \leftrightarrow \text{(akauzaliteti)}$$

Kështu pra:

Të pozosh Qëndrën a të pozosh akauzalitetin është e njëjta gjë.

Llogjika Formale
(Llogjika e të Tretit të Përjashtuar - Tertium Non Datur)

Dihet se llogjika formale apo Aristoteliane që është edhe llogjika a "logosi" me të cilin punon **Arsyeja** njerëzore, ngrihet e tëra si mbi themelin e saj të patundur, mbi Parimin e Identitetit që shkruhet zakonisht si $A = A$, por që ne mund ta shkruajmë sigurisht edhe si $(x = x)$ gjersa "A" mund të jetë çfarëdo, e pra një variabël (x).

E vështrojmë këtë ekuacion si një propozicion llogjik dhe ndërtojmë tabelën e tij të vërtetësisë.

Do kemi:

x	x	$x = x$
I	I	I
I	–	–
–	I	–
–	–	I

Vëmë re se:

$$T_{(x=x)} = T_{(\leftrightarrow)}$$

pra atëhere edhe:

$$(x = x) = \leftrightarrow$$

Po ashtu, me qënë se:

$$T_{(x=x)} = -T_{(x=-x)}$$

do të kemi edhe:

$$(x = x) = -(x = -x)$$

(Këtu T rri për *tabela e vërtetësisë*)

Llogjika Esenciale
(Llogjika e të Tretit të Përshirë - Tertium Datur)

Shpesh herë llogjika e përcaktuar nga $(x = x)$ (llogjika formale) quhet edhe *Llogjika e të Tretit të Përjashtuar* (*Tertium non Datur*), ndërsa llogjika e përcaktuar nga $(x = -x)$ quhet edhe *Llogjika e të Tretit të Përfshirë* (*Tertium Datur*).

Me qënë, se siç pamë:

$$(x = x) = -(x = -x)$$

pra atëhere edhe:

$$(x = -x) = -(x = x) = -\textit{llogjika formale}$$

shihet qartë se llogjika e dytë mund të vështrohet (nga pikëpamja e llogjikës së parë) si një **antillogjikë**.

Kodet

Do t'i quajmë këto dy llogjika **kode** dhe do të shkruajmë:

$$\textit{Kodi formal} = F = (x = x)$$
$$\textit{Kodi esencial} = E = (x = -x)$$

Disa marrëdhënie mes kodeve

Një marrëdhënie e parë është, duke marrë parasysh ato sa vërtetuam më sipër:

$$\boxed{E = -F} \quad \text{si dhe} \quad \boxed{F = -E}$$

Një tjetër relacion do të përftohej në këtë mënyrë:

$$E^2 = (x = -x)^2 = [(x^2 = (-x)^2] = (x^2 = x^2)$$

Dhe duke pozuar:

$$x^2 = X$$

do të kemi:

$$E^2 = (X = X) = F$$

që nga dhe:

$$\boxed{E = \sqrt{F}}$$

Vazhdojmë më tej. Shkruajmë:

$$E = (X = -X)$$

Me qënë se X mund të jetë çfarëdo, mund të marrim:

$$X = (x = -x) = E$$
$$-X = -(x = -x) = (x = x) = F$$

Do të kemi atëhere:

$$\boxed{E = (E = F)}$$

Si edhe, siç mund të shihet lehtë:

$$\boxed{F \neq (F = E)}$$

Pra, duke qënë kështu, ne mund të themi se F **përfshihet** nga E, porse E **nuk përfshihet** nga F. Mathematikisht pra kemi:

$$E > F \quad \text{dhe sigurisht} \quad F < E$$

ku ">" lexohet **më i madh**, ndërsa "<" **më i vogël**.

Pra, duke përmbledhur:

F **del nga** E $(E^2 = F)$ **dhe përfshihet në** E $(E > F)$

Kjo na jep të drejtë ta vështrojmë llogjikën e të **Tretit të Përfshirë** si një **llogjikë të zgjeruar**.

Llogjika si pasqyrim i Antillogjikës

Mund të shkruajmë:

$E =$

I I	=	–
I –	=	I
– I	=	I
– –	=	–

$F =$

I I	=	I
I –	=	–
– I	=	–
– –	=	I

Me qënë se shenjat "**I**" dhe "–", mund të vështrohen si konvencionale, ne mund të pozojmë: **I** = S dhe – = ƨ.

Duke zëvendësuar në tabelat përkatëse të vërtetësisë (*grupe transformacionesh*), do të kemi:

$E =$

SS	=	ƨ
Sƨ	=	S
ƨS	=	S
ƨƨ	=	ƨ

Le ta shikojmë tani ***E*** -në në pasqyrë.


Do kemi:

Refl . $E =$

ƨƨ	=	S
ƨS	=	ƨ
Sƨ	=	ƨ
SS	=	S

Dhe duke u kthyer tek *shënjat* e para, duke ripozuar me fjalë të tjera:

S = I
ƨ = –



Do të kemi siç shihet lehtë:

$$\text{Refl } .E = F$$

Dhe ky është një relacion tjetër i rëndësishëm mes E dhe F.

Qëndra si qëndër e rrethit (sferës)[*]

Ne e përcaktuam Qëndrën, sikundër bëhet edhe në librat e simboleve, si *coincidentia oppositorum* e pra pozuam:

$$\textbf{Qëndra} = (x = -x)$$

Por ne mund ta përkufizojmë Qëndrën edhe si qëndrën e një rrethi (sfere), me fjalë të tjera ne mund të shkruajmë:

$$\textbf{Qëndra} = (x^2 + y^2 = 0)$$

Le të vërtetojmë se këto dy përcaktime të Qëndrës janë të njëvlershme.[**]

Le të nisemi nga ekuacioni i parë për të arritur tek i dyti kemi:

$$(x = -x)$$

Duke shumëzuar të dy anët me i [***] do të kemi:

$$ix = -ix$$

e pra: $$y = -y$$

e pra atëhere edhe:

$$y = ix \quad \text{që nga} \quad (y - ix = 0) \quad \ldots(\mathbf{a})$$

$$-y = ix \quad \text{që nga dhe} \quad (y + ix = 0) \quad \ldots(\mathbf{b})$$

---

[*] Qëndra e rrethit ($x^2 + y^2 = r^2$) mund të vështrohet edhe si qëndra e sferës ($x^3 + y^3 + z^3 = r^3$) që sajohet nga vërtitja e rrethit rreth një prej diametrave të tij.

[**] Ne jemi marrë me këtë çështje edhe në *Pjesën e parë* të këtij studimi (fq 122).

[***] Kështu tregohet në Mathematikë *njësia imagjinere* që përcaktohet si $i = \sqrt{-1}$.

Duke shumëzuar mes tyre (**a**) dhe (**b**) do të kemi:

Qëndra: $(x^2 + y^2 = 0)$

Nisemi tani nga ekuacioni i dytë për të mbrrijtur tek i pari. Mund të shkruajmë:

$$(x^2 + y^2 = 0) \;=\; (y + ix)\,(y - ix) \;=\; 0$$

E pra edhe:

$$(y + ix = 0) \qquad \text{ose} \qquad (y - ix = 0)$$

Si edhe:

$$y = -ix \qquad \text{dhe} \qquad y = ix$$

e pra atëhere edhe:

$$-ix = y$$
$$ix = y$$

Që nga:

$$ix = -ix$$

E pra përfundimisht, duke pjesëtuar të dy anët me i :

$$x = -x$$

F : kodi i cektësisë
E : kodi i thellësisë


Mund të shkruajmë:

$$F = -E = -(x^2 + y^2 = 0) = (x^2 + y^2 = r^2)$$

E atëhere pra:

E = *Qëndra e rrethit* (*sferës*)

F = *Periferia e rrethit* (*sipërfaqja e sferës*)



Dhe ky është një relacion tjetër mes dy kodeve.

Kodi ***E*** është pra kështu kodi i **mbrëndësisë**, i **thellësisë** (ndaj pra edhe emri **esencial**) ndërsa kodi ***F*** është kodi i **jashtësisë**, i **periferisë**, i **sipërfaqes**, e pra si i tillë, një kod *sipërfaqësor*, i *përciptë*, **formal**.

Kodi F
si vërtitje e kodit E

Një relacion i rëndësishëm mes dy kodeve do të përftohej duke vërtitur "grupin e transformacioneve" në ***E*** (shih më lartë) me një kënd prej 90°.

Do të kishim në këtë rast:

$$\mathbf{E}\overset{90^\circ}{\curvearrowright} = \mathbf{I}\curvearrowright\ \mathbf{I}\curvearrowright = -\curvearrowright$$

$$= - - = \mathbf{I} = \boldsymbol{F}$$

E kështu edhe për të gjitha rreshtat e tjera të tabelës të vërtetësisë të kodit ***E***.

Pra mund të shkruajmë:

$$\mathbf{Rot}\ \boldsymbol{E} = \boldsymbol{F}$$

Ku **Rot** qëndron për *rotor* (rrotullim).

Tabula Smaragdina dhe
Goethe[*]

Me qënë se:

$$\mathbf{Qëndra} = \textit{Coincidentia oppositorum} = (\boldsymbol{x} = -\boldsymbol{x})$$

dhe me qënë se këtu ***x*** mund të jetë çfarëdo, ne mund të marrim:

---

[*] Shih lidhur me këtë çështje edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi (fq. 158-159)

$$x = lartë = \uparrow$$

Do të jetë atëhere:

$$-x = -lartë = poshtë = \downarrow$$

Kjo atëhere do të thotë se në:

$$Qëndër = (lartë = poshtë) =$$

$$\boxed{(\uparrow = \downarrow)} \qquad \ldots(\mathbf{E})$$

Marrim: $x = brënda$, do të jetë atëhere $-x = jashtë$.
Pra atëhere në *Qëndër* do të kemi gjithashtu:

$$\boxed{(jashtë = brënda)} \qquad \ldots(\mathbf{E})$$

që mund të shkruhet simbolikisht si:

$$\boxed{(x = \boxtimes)} \qquad \ldots(\mathbf{E})$$

Vërejmë me këtë rast se ne rigjejmë kështu me mjete thjesht llogjike dhe mathematike ato sa thuhen në Tabula Smaragdina që përbën një "Codex sui generis" për tërë Mendimin simbolik.

Qëndra dhe Uniteti i të kundërtave

Le të marrim tani: $x = \mathsf{S}$
Do të jetë atëhere: $-x = -\mathsf{S} = \mathsf{Ƨ}$
Në Qëndër do të kemi kështu:

$$E = (x = -x) = (\mathsf{S} = -\mathsf{S}) = (\mathsf{S} = \mathsf{Ƨ})$$

Ne shohim pra se në Qëndër "palët kundërshtare pajtohen", se konflikti *shuhet*, *zgjidhet*, a ndryshe, se në Qëndër s'ka konflikt, s'ka luftë, ka *paqe*.

Do ta shprehim këtë si:

$$E = -\S\mathcal{2}$$

Dhe për një sërë arsyesh që lidhen me mendimin mitik* si:

$$\boxed{E = -\S\mathcal{2}}$$

Periferia dhe Lufta e të kundërtave

Me qënë se $F = -E$, është e qartë se do të kemi:

$$\boxed{F = \S\mathcal{2}}$$

Kjo do të thotë se në *periferi*, në *sipërfaqe*, në "formë" konflikti *mbahet*, *qëndron*, *ushqehet*... Kjo është edhe **lufta e të kundërtave** e Dialektikës, (***Antiteza***, momenti i dytë i triadës hegeliane) që siç shikojmë është një parim **formal**, *sipërfaqësor*, i *përciptë*, i *jashtëm*, etj. etj.

Pika dhe Qëndra

I rikthehemi Qëndrës.
Mund të shkruajmë:

$$Qëndra = E = (x = -x) = (x^2 + y^2 = 0)$$

Zgjidhja e **vetme** e këtij ekuacioni është, siç shihet qartë, *zero*, e pra simb. 0.

Nga ana tjetër ekuacioni $(x^2 + y^2 = 0)$ mund të vështrohet si ekuacioni i **pikës**. Dhe është fjala këtu për *pikën gjeometrike* e cila s'ka dimensione

---

* Me qënë se *kundërvënia* (konflikti) i *parë*, par excellence, paradigmatik, është ai ndërmjet *Qiellit* (3) dhe *Tokës* (2). Kemi:

$$\mathcal{2} = 3 = \textbf{\textit{Qielli}},\ \S = 2 = \textbf{\textit{Toka}}.$$

(a ndryshe: ka dimensionin **zero**), e cila lidhet me *imagjinerin* (s'ka realitet, s'ka materialitet) e cila është *bosh*, e cila është një *vrimë*... Gjithnjë tek libri i simboleve të Cirlot na jepet një informacion i rëndësishëm për *pikën* si edhe për *polin*, informacion që lidhet ngushtë me sa po parashtrojmë*. Referojmë pra tek këto ekstrakte nga Cirlot.

Disa vetira të Qëndrës

Nga sa u tha më sipër, ne shohim se Qëndra është **bosh** (angl. *void*), gjersa lidhet me pikën gjeometrike dhe pasi kjo e fundit përfaqëson simbolikisht një **vrimë** (angl. *hole*).

Ne shohim se Qëndra është **zero** (0) gjersa zero është zgjidhja e ekuacionit të Qëndrës, d.m.th. e ekuacionit ($x = -x$).

Ne mund të shohim se Qëndra nuk është reale, se ajo është **imagjinere** (shih edhe fq. 37 ku tregohet se *Qëndra* = $E = i$).

Ne shohim se Qëndra **nuk lëviz**, porse prapë vë në lëvizje gjithshka, siç lexuam në citatet e mësipërme.

Ne shohim se Qëndra përfaqëson të **Tërën** (*të Gjithën*, angl. the *All*), me qënë se, siç thuhet prapë tek Cirlot (fq. 260), Qëndra (*pika*) "...përfaqëson shumën **tërësore** të të gjithë aspekteve të realitetit ..."

Ne shohim se Qëndra është **përtej çdo dualiteti** (angl. *far beyond all*

---

* **Pika**: Ka kuptimin e *unitetit*, të *origjinës* dhe të *Qëndrës*.

Ajo paraqet gjithashtu parimin e manifestimit, ndaj pra në disa mandala Qëndra nuk tregohet por duhet të **imagjinohet** nga vetë i iniciuari.

...Shkalla e parë e gjithshkaje është krejt e **fshehtë**, jo e shfaqur, dhe nuk mund kurrë të arrihet... Kështu shpjegohet përse **Qëndra, identike me pikën mistike**, paraqitet zakonisht si një **vrimë**. (Cirlot: fq. 260)

Poli: *Qëndra* mistike, ose *mesi i pandryshueshëm* është *pika fikse* që njihet në traditën simbolike me emrin *pol* me qënë se Toka vërtitet rreth tij. Poli identifikohet gjithashtu edhe me zenithin. Në Kinën e lashtë ai paraqitej nga një ***vrimë** në qëndër të një disku prej nefriti e quajtur* **P i** .

"Mesi i pandryshueshëm" vështrohej si shkaku i çdo ndryshimi. "Libri i Ndryshimeve", në Kinë, na thotë se metamorfozat e pandërprera të materies lindin nga poli i madh - **një Njënjësi** (angl. *Oneness*) - *e vendosur larg e përtej çdo dualiteti, larg e përtej çdo ngjarjeje* dhe *që identifikohet me "lëvizjevënësin" e palëvizur të Aristotelit.* (Nënvizimet e citateve janë tonat. Kemi nënvizuar ato momente që do të na duhen në punën tonë). (Cirlot: fq. 260)

duality...), se ajo lidhet ngushtë me **njëshin**, **unitetin** dhe **unicitetin** (angl. *oneness*).

Ne shohim se Qëndra është e **fshehur** (angl. *occult*).

Ne shohim se Qëndra, ndonëse vetë *nuk ndryshon*, është prapë *shkaku i çdo ndryshimi*, i *çdo formë-lindjeje* dhe *formë-ndryshimi* (metamorfozë).

E kështu me radhë.

Le të përpiqemi të tregojmë tani se si të gjitha këto vetira të Qëndrës mund të bëhen të rrjedhin llogjikisht, mathematikisht.

Vërtetimi mathematik i vetive të Qëndrës[*]

1. Le të provojmë se *Qëndra* është e *Tëra* (e Gjitha).

Dimë se:

$$Qëndra = coincidentia\ oppositorum = (x = -x) = llogjika\ e\ të\ Tretit\ të\ Përfshirë$$

Sipas kësaj llogjike (e të Tretit të Përfshirë), një *quid* (një çfarëdo *send*) p mund të jetë njëkohësisht edhe i barabartë (identik) me p (me veten e tij) edhe me **jo** p, e pra edhe me **gjithshka** që *nuk është* p. Ai mund të jetë pra kështu gjithshka, ai mund të jetë pra e **Gjitha**, e **Tëra**.[**]

Pra përfundimisht mund të shkruajmë:

$$\textbf{Qëndra} = (x = -x) = \bigcirc = \text{e } \textbf{Tëra}$$

2. Le të vërtetojmë tani se *Qëndra* lidhet me *imagjinerin* dhe me *infinitin*.

---

[*] Shih lidhur me tërë këtë tematikë edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi.

[**] Rikujtojmë këtu se tek Cirlot (fq. 123) lexojmë:


$$\bigcirc = Infinity,\ the\ Universe,\ the\ All$$

Nga ana tjetër dimë se:

$$\bigcirc = (x = -x) = \textbf{Qëndra}$$

Shkruajmë:

Qëndra = $(x = -x)$
= $(x^2 + y^2 = 0)$
= $(y = ix)(y = -ix)$
= *drejtëzat imagjinere*
(a *izotrope*)



Le të marrim njërën prej tyre, p.sh. $(y = ix)$.
Mund të shkruajmë: $y = ix$, $y / x = i$, e pra edhe $tg\psi = i$.

Pra edhe:

$$Qëndra = (tg\psi = i) = i \qquad \ldots(\mathbf{E})$$

Çfarë dhe duhej vërtetuar.
Me qënë se *Qëndra* $= (x = -x) = E$, mund të shkruajmë edhe:

$$\boxed{E = i}$$

Le të vëmë rè shkarazi këtu edhe se, duke u nisur nga ekuacioni $(tg\psi = i)$, ne mund të rigjejmë përsëri ekuacionin e Qëndrës. Dhe vërtetë:

$$(tg\psi = i)^2 = (tg^2\psi = i^2) = \left(\frac{y^2}{x^2} = -1\right) = (y^2 = -x^2)$$

Dhe përfundimisht:

$$(x^2 + y^2 = 0) = Qëndra$$

3. Le të vërtetojmë tani se <u>*Qëndra* lidhet me *infinitin*</u>:

a) Duke u mbështetur në sa më sipër, mund të shkruajmë:

$$tg\psi = \frac{\sin\psi}{\cos\psi} = i$$

që nga dhe:

$$\sin\psi = i\cos\psi$$

Ose dhe:

$$-i\cos\psi + \sin\psi = 0$$

Dimë që:


$$i^2 = \left(\sqrt{-1}\right)^2 = -1$$

Që nga edhe: $ii = -1$, e pra edhe $i = -\frac{1}{i}$ ose edhe $-i = \frac{1}{i}$

Zëvendësojmë tek ekuacioni i mësipërm.

Do të kemi:

$$\frac{1}{i}\cdot\cos\psi + \sin\psi = 0$$



$-\infty$

Dhe pra përfundimisht:

$$\cos\psi + i\sin\psi = 0$$

Në bazë të formulës së Eulerit do të kemi:

$$e^{i\psi} = \cos\psi + i\sin\psi$$

E pra atëhere edhe, në rastin tonë:

$$e^{i\psi} = 0$$

Një ekuacion ky që kënaqet vetëm për $\psi = -\infty$.

Dhe vërtetë, në këtë rast do të kemi:

$$e^{i\psi} = e^{i\cdot(-\infty)} = \frac{1}{e^{i\infty}} = \frac{1}{\infty} = 0$$

Kemi $tg\psi = i$, e pra atëhere përfundimisht:

$$\boxed{Arctg\ i = -\infty}$$

Dhe kjo është lidhja që kërkonim dhe donim të provonim mes *Qëndrës* dhe *Infinitit*.

Ne gjejmë kështu në të njëjtën kohë edhe një lidhje të rëndësishme mes *imagjinerit* dhe *infinitit*.

b) Një mënyrë tjetër për të treguar se *Qëndra* lidhet me *Infinitin*, është edhe kjo:

Shkruajmë:

$$Qëndra \;=\; coincidentia\ oppositorum \;=\; (x = -x)$$

Ky ekuacion kënaqet nga **zero** (0), por ai kënaqet me një afërsi shumë të madhe edhe nga $0+\varepsilon$, ku ε, është një madhësi pafundësisht e vogël (e vogël, siç thuhet në Mathematikë, sipas dëshirës). Mund të shkruajmë atëhere:

$$(0+\varepsilon) = -(0+\varepsilon)$$

e pra atëhere edhe:

$$\frac{1}{(0+\varepsilon)} = -\frac{1}{(0+\varepsilon)}$$

Për $\varepsilon \to 0$, do të kemi:

$$\boxed{\infty = -\infty}$$

Pra ekuacioni i *Qëndrës* kënaqet edhe nga *Infiniti**.

c) Ka edhe një mënyrë tjetër për të provuar se ***Qëndra** lidhet me **infinitin***.

Nisemi nga ekuacioni i rrethit:

$$(x^2 + y^2 = r^2)$$

E rishkruajmë këtë ekuacion në koordinata *homogjene*.

Për këtë pozojmë:

$$x = \frac{X}{Z}, \qquad y = \frac{Y}{Z}$$

---

* Vërejmë këtu se mathematika (Gjeometria Analitike) na mëson se ka vetëm një infinit, ndonëse mund të mendohet se ekzistojnë dy (*pozitiv* dhe *negativ*).

Duke bërë zëvendësimet do të kemi:

$$\left(\frac{X}{Z}\right)^2+\left(\frac{Y}{Z}\right)^2 = r^2$$

ose edhe:

$$\frac{X^2}{Z^2}+\frac{Y^2}{Z^2} = r^2$$

Dhe duke thjeshtuar emëruesit:

$$X^2+Y^2 = Z^2\cdot r^2$$

Për $x \to \infty$, $y \to \infty$, do të kemi $Z \to 0$, dhe atëhere: $X^2+Y^2=0$.

Mund të shkruajmë pra:

$$\lim_{r\to\infty}(x^2+y^2=r^2) \;=\; (X^2+Y^2=0)$$

Ekuacioni i fundit është ai i një rrethi me *rreze infinite*. Ne shohim se si ai ka të njëjtën formë me atë të ekuacionit të rrethit me *rreze zero* (*Qëndrës*).

Që këndej pra lidhja e *Qëndrës si zero*, me *Qëndrën si infinit*. E pra atëhere ne mund të themi se:

Në Qëndër zerua dhe infiniti korrespondojnë

ose e thënë edhe ndryshe:

pambarimisht e vogla dhe pambarimisht e madhja përputhen

Le të vërtetojmë tani se Qëndra nuk lëviz:

Mund të shkruajmë:

$$\textit{Qendra} = (x = -x) = (x^2 + y^2 = 0) = \ldots \quad (y = \pm ix)$$

Marrim njërën prej drejtëzave çfarëdo imagjinere, për shëmbull: $y = ix$.

Mbi të marrim dy pika (x_1, y_1) dhe (x_2, y_2).

Kryejmë një çvendosje që do ta tregojmë me d nga njëra pikë në tjetrën mbi drejtëzën imagjinere. Do të kemi, sipas rregullave të Gjeometrisë Analitike:

$$d^2 = (x_2 - x_1)^2 + (y_2 - y_1)^2$$

Dhe për:

$$\begin{cases} y_1 = i x_1 \\ y_2 = i x_2 \end{cases}$$

duke zëvendësuar më sipër, do të kemi:

$$d^2 = (x_2 - x_1)^2 + (ix_2 - ix_1)^2$$

ose edhe:

$$d^2 = (x_2 - x_1)^2 + i^2 (x_2 - x_1)^2$$

Ose edhe, përfundimisht:

$$\boxed{d^2 = (x_2 - x_1)^2 - (x_2 - x_1)^2 = 0}$$

Pra kjo ç'vendosje është $d = 0$.

Kjo do të thotë se *drejtëza izotrope* (imagjinere) *nuk mund të shkasë mbi veten e vet*, (ose *shket pa shkarë*) a ndryshe se *Qëndra* (këtu e rrethit, por në përgjithësi *Qëndra*, në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, pavarësisht se si ajo përcaktohet) *nuk ç'vendoset*.

Le të vërtetojmë tani se ajo as nuk vërtitet.

Me qënë se Qëndra reduktohet tek drejtëzat imagjinere, le të marrim parasysh si më lartë drejtëzën imagjinere: $y = ix$.

Le të supozojmë se ajo bën me boshtin xx' një kënd ω.

Do të kemi kështu:

$$tg\omega = i$$

Le të supozojmë tani *per absurdum* se drejtëza imagjinere vërtitet me një kënd $\Delta\omega$. Do të kishim kështu një drejtëz që do të formonte me boshtin xx' këndin $(\omega + \Delta\omega)$.


Le të njehsojmë tangjenten e këtij këndi (që do të shprehte koeficientin këndësor të drejtëzës së "rë" imagjinere që do të përfitohej në këtë mënyrë...).

Do të kemi:

$$tg(\omega+\Delta\omega) = \frac{tg\omega+tg\Delta\omega}{1-tg\omega\cdot tg\Delta\omega} =$$

$$= \frac{i+tg\Delta\omega}{1-i\cdot tg\Delta\omega} = \frac{i+tg\Delta\omega}{1+\frac{1}{i}tg\Delta\omega} =$$

$$= \frac{i+tg\Delta\omega}{i+tg\Delta\omega}\cdot i = i$$



Kështu pra përfundimisht:

$$\boxed{tg(\omega+\Delta\omega) = i = tg\omega}$$

Kjo do të thotë atëhere se pas "vërtitjes" ne arrijmë përsëri tek drejtëza imagjinere nga e cila u nisëm. Kështu pra:

Asnjë lëvizje vërtitëse **me, mbi** *drejtëzën imagjinere*

A e thënë ndryshe, e në një mënyrë paradoksale:

Drejtëza imagjinere vërtitet pa u vërtitur

Ne mund t'i përmbledhim përfundimet e arritura skematikisht edhe kështu:

$$E = -(\underset{A}{\ } \rightarrow \underset{B}{\ })$$

(jo lëvizje çvendosëse, translacioni)

$$E = -\circlearrowleft$$

(jo lëvizje vërtitëse)

Dhe duke treguar *arketipikisht* lëvizjen me $\sim$ mund të shkruajmë atëhere:

$$\boxed{E = -\sim}$$

Me qënë se:

$$F = -E$$

do të kemi:

$$F = -(-\sim) = \sim$$

pra:

$$\boxed{F = \sim}$$

dhe me qënë se, $E = \sqrt{F}$ do të kemi edhe:

$$\boxed{E = \sqrt{\sim}}$$

Me fjalë të tjera: E *(Qëndra) ndonëse vetë nuk lëviz* $(E = -\sim)$ *është* prapë *rrënja e çdo lëvizjeje* $(E = \sqrt{\sim})$

Kështu pra ajo ndonëse *vetë nuk lëviz, vë në lëvizje gjithshka* (*immobilis mobilis*, sipas shprehjes të Aristotelit).

Le të vërtetojmë tani se Qëndra është e fshehur (angl. *occult*)*

Dimë se: $E = (x = \boxed{x})$**.

Dhe me qënë se nga ana tjetër $F = -E$ do të jetë atëhere edhe:

---

* Fjala angl. *occult* lidhet me fjalën shqipe *me kall.*

** Shih edhe fq. 33.

$$F = -(x = \boxed{x})$$

e pra:

$$\boxed{F = (-x = \boxed{x})}$$

Me qënë se mund të shkruajmë edhe $F = -E = -\bigcirc$. Duke interpretuar këtu $\bigcirc$ si *bosh* (*vakuum*), $-\bigcirc$ do të interpretohet atëhere si *plot*, *i,e mbushur*, gjë që mund të paraqitet arketipikisht me simbolin ●.

Ky simbol ●, siç kuptohet lehtë, duke qënë se $\bigcirc$ është simboli ndër të tjera i *boshit*, i *vakuumit*, mund të vështrohet edhe si ai i *materies*, e pra edhe ai i *Botës materiale*. Pra mund të shkruajmë:

● = *materie, Botë materiale*

Me qënë se tek formula e mësipërme x mund të jetë çfarëdo, le të marrim:

$$x = \bigcirc$$


Do të jetë atëhere:

$$-x = -\bigcirc = \bullet = \textit{materie, Botë materiale}$$

Do të kemi atëhere:

$$F = (-x = \boxed{x}) = (-\bigcirc = \boxed{\bigcirc})$$

E pra përfundimisht:



E pra *Qëndra* është vërtetë e *fshehur*, e *kallur* (angl. *occult*), siç duhej provuar.

Le të provojmë tani se Qëndra është përtej çdo dualiteti.

Për këtë duhet të tregojmë se:

$$E = -2$$

Marrim ekuacionin e Qëndrës: $(x = -x)$.

Siç pamë edhe më sipër ai ka vetëm **një** (1) zgjidhje dhe kjo do të thotë pikërisht se Qëndra është përtej çdo **dualiteti** (-2).

Mund të merrnim edhe ekuacionin tjetër të *Qëndrës* $(x^2 + y^2 = 0)$. Edhe në këtë rast do të shihnim të njëjtën gjë, me qënë se rrethi ka vetëm *një* (1) *qëndër.*

Ne pamë gjithashtu se:

$$\text{Qëndra} = E = -\Omega$$

gjë që tregon se në *Qëndër nuk ka konflikt*, e pra *as dualitet* (-2).

Nuk mund të thuhet e njëjta gjë për F, dhe kjo sepse:

a) $F = (x = x)$, dhe ky ekuacion ka *më tepër se një* zgjidhje.

b) $F = (x^2 + y^2 = r^2)$, dhe ky ekuacion kënaqet nga të gjitha pikat e periferisë së rrethit që janë *më tepër se një.*

c) $F = -E = -(-\Omega) = \Omega$ = *konflikt, dualitet*

Ne vërtetuam kështu një sërë vetish të Qëndrës që përmbaheshin në citaten nga libri i Cirlot. Por ne mund të demonstrojmë gjithmonë llogjikisht, mathematikisht edhe veti të tjera të Qëndrës, veti këto që përfshihen tek përcaktimi i Qëndrës, po tek Cirlot, nga i cili dhe kemi cituar më poshtë*.

---

* Në faqen 40 lexojmë:

Centre. To leave the circumference for the centre is equivalent to moving from the exterior to the interior, from form to contemplation, from multiplicity to unity, from space to spacelessness, from time to timelessness. In all symbols expressive of the mystic Centre, the intention is to reveal to Man the meaning of the primordial "paradisal state" and to teach him to identify himself with the supreme principle of the universe. This centre is in effect Aristotle's "unmoved mover" and Dante's "L'Amore che muove il sole e le altre stelle". Similarly, Hindu doctrine declares that God resides in the centre, at the point where the radii of the wheel meet at its axis. In diagrams of the cosmos, the central place is always reserved for the Creator, ... surrounded by concentric circles spreading outwards, ... Among the Chinese, the infinite being is frequently symbolized as a point

of light with concentric circles spreading outwards from it... In some Hindu mandalas, such as the Shri-Yantra, the centre itself is not actually portrayed, but has to be supplied mentally by the contemplator... A great many ritual acts have the sole purpose to finding out the spiritual "Centre" of a locality ... There are many legends which tell of pilgrimages to places with characteristics which relate them to Paradise. This Chinese tale, for example, retold by the orientalist Wilhelm in his work on Lao-Tse: "King Huangti had a dream. He crossed into the kingdom of the Hua Hsü. The kingdom of the Hua Hsü is west of the far West and north of the far North. It is not known how many hundreds of thousands of leagues it is from the Ch'i state. It can be reached neither by boat nor by carriage, nor on foot. It can be reached only by the spirit in flight. This country has no sovereign; everyone acts according to his own dictates... They enter the water and are not drowned, walk through fire and are not scorched... They rise up into the air as others walk on the face of the earth... They rest in space as other sleep in beds; cloud and mist do not veil their gaze... They walk only in the spirit. This concept of the Centre coincides, of course, with that of the "Land of the Dead" in which the theme of the COINCIDENTIA OPPOSITORUM of the mystic tradition come to signify not so much "opposition" as neutralization, in the characteristically oriental sense. The Centre is located at the point of intersection of the two arms of the superficial (or two-dimensional) cross, or of three arms of the essential, three-dimensional cross. In this position it expresses the dimension of the "infinite depth" of space, that is, the seed of the eternal cycle of the flux and flow of forms and beings, as well as the dimensions of the space itself. In some liturgical crosses, as for example that of Cong in Ireland, the centre is marked by a precious stone. (Cirlot)

(*Qëndra*. Të largohesh nga periferia e rrethit me drejtim për nga qëndra, është njëlloj si të lëvizësh nga jashtë brënda, nga forma tek esenca, nga shumësia tek njësia, nga hapësira tek pahapësira, nga koha tek pakohësia. Të gjitha simbolet shprehëse të Qëndrës mistike priren t'i zbulojnë Njeriut kuptimin e "gjendjes parajsore" primordiale si edhe t'i mësojnë atij se si të bëhet një me parimin suprem të Universit. Qëndra është në fakt "lëvizjevënësi i palëvizur" i Aristotelit dhe "l'Amore che muove il sole e le altre stelle" i Dantes. Edhe doktrinat hindiane pohojnë se Zoti rri në qëndër tek pika e takimit të rrezeve të rrotës me boshtin e saj. Në diagramat e Kozmosit, vendi qëndror i përket gjithmonë Krijuesit... ku ai është i qarkuar nga rrathë koncentrikë në përhapje... Ndër kinezët, qënia infinite simbolizohet shpesh si një pikë drite e rrethuar nga rrathë koncentrikë që hapen dora dorës që largohen prej Tij. ... Në disa mandala hindiane, si bie fjala në Shri-Yantra, vetë qëndra nuk paraqitet konkretisht, por soditësi duhet, sipas mendjes së tij, ta vërë atë në vendin e duhur... Një numër i madh aktesh rituale kanë për qëllim gjetjen e "Qëndrës" spirituale të një lokaliteti... Ekziston një numër i madh legjendash që flasin për pelegrinazhe në vende me karakteristika të përngjashme me ato të Parajsës, si bie fjala kjo rrëfenjë kineze e ritreguar nga orientalisti Wilhelm në veprën e tij mbi Lao-Tse: "Mbreti Huangti pa në ëndërr sikur po udhëtonte mes për mes mbretërisë të Hua Hsü. Mbretëria e Hua Hsü është në perëndim të Perëndimit të Largët (Far West) dhe në veri të Veriut të Largët (Far North). Nuk dihet sa qindra mijëra lega ajo ndodhet nga shteti Ch'i. Atje nuk mund të arrish as me barkë, as me karrocë dhe as me këmbë. Atje mund të mbërrish vetëm mbi krahët e Frymës në fluturim. Kjo mbretëri nuk ka mbret: sikush bën si di vetë. Nuk ka ligje, sikush ndjek lirisht dëshirat e tij... Ata futen në ujë dhe nuk mbyten, ecin mbi zjarr dhe nuk digjen... Ata ngrihen lartë në ajër sikundër dikush tjetër do të ecte mbi dhé, ata pushojnë në ajër, sikundër dikush tjetër do të flinte në shtratin e tij... Ata udhëtojnë mbi krahët e Frymës... Ky përfytyrim i Qëndrës përputhet, padyshim, me atë të "Vendit

I referohemi prapë kësaj citate duke "piketuar" pasazhet më të rëndësishme.

"To leave the circumference for the centre is equivalent to moving from exterior to interior, from form to contemplation, from multiplicity to unity, from space to spacelessness, from time to timelessness".

Pamë se Qëndra është e fshehur (angl. *occult*) (fq. 36) dhe kjo atëhere do të thotë se ajo është *brënda* e *jo jashtë*, pra *interior*. Ne mund të shkruajmë kështu:

$$Qëndra = \boldsymbol{E} = brënda = interior_{\text{angl.}}$$

$$Periferia \text{ (çdo gjë tjetër posë qëndrës)} = jashtë = exterior_{\text{angl.}}$$

Dimë gjithashtu se:

$$periferia\ (circumference)_{\text{angl.}} = (x^2 + y^2 = r^2) = \boldsymbol{F} = kodi\ i\ Formës = Forma\ (format)$$

Dhe pra atëhere:

$$Qëndra = \boldsymbol{E} = kodi\ i\ Esencës = Esenca\ (contemplation)_{\text{angl.}}$$

Dimë se ka vetëm *një qëndër*, pra mund të shkruajmë:

$$Qëndër = \boldsymbol{E} = \boldsymbol{1} = unity_{\text{angl.}}$$

---

të të Vdekurit" (angl. *Land of the Dead*) ku motivi i "coincidentia oppositorum" i traditave mistike ka shumë më tepër kuptimin e "neutralizimit" (komplementarizimit) në stilin karakteristik oriental, se sa atë të "kundërvënies".

Qëndra është vendosur në pikën e ndërprerjes të të dy krahëve të kryqit sipërfaqësor (ose dy-dimensional), ose tre krahëve të kryqit esencial apo tri-dimensional. Në këtë pozicion ajo shpreh dimensionin e "thellësisë infinite" të hapësirës, me fjalë të tjera, farën e ciklit të amshueshëm të ndryshimeve të pareshtura të formave dhe të qënieve si edhe gjithashtu edhe vetë dimensionet e hapësirës. Në disa kryqe liturgjikale, si për shëmbull në atë të Cong në Irlandë, qëndra shënohet me një gur të çmueshëm.)

Dhe nga ana tjetër dimë se:

$$\boldsymbol{F} = -\boldsymbol{E} = -1 = \neq \boldsymbol{1} \text{ (ose } \not{1}\text{)} = \textit{jo një, shumë} = \textit{multiplicity}_{\text{angl.}}$$

Le të vërtetojmë tani "the spacelessness" dhe "the timelessness" të Qëndrës (Qëndra është jashtë Kohës dhe Hapësirës).

Ne pamë se:

$$\textit{Qëndra} = \textit{pika} = \textit{dimensioni zero}, \quad \text{e pra} \quad \textit{hapësirë} = 0$$

gjë që do ta shkruajmë si ($\boldsymbol{s} = 0$).

Nga ana tjetër ne pamë gjithashtu se *Qëndra nuk lëviz*. Por kush thotë *kohë* nënkupton *ciklicitet, lëvizje*. Prandaj pra dhe në Qëndër koha është zero, gjë që e shkruajmë si ($\boldsymbol{t} = 0$).

Do të kemi gjithashtu:

$$\boldsymbol{F} = \textit{periferia e rrethit} \text{ (sipërfaqja e sferës)} = -\textit{Qëndra}$$
$$= -\textit{spacelessness}, \quad -\textit{timelessness}$$

e pra "space" and "time", gjë që do ta shkruajmë si ($s \neq 0, t \neq 0$).

Pra, duke përmbledhur mund të shkruajmë:

$\boldsymbol{E} : (\boldsymbol{s} = 0, \boldsymbol{t} = 0)$	(Jashtë Kohës dhe Hapësirës)
$\boldsymbol{F} : (\boldsymbol{s} \neq 0, \boldsymbol{t} \neq 0)$	(Mbrënda Kohës dhe Hapësirës)

Lexojmë më tej në citaten mbi simbolizmin e Qëndrës nga Cirlot:

"This Centre is in effect Aristotele's "*unmoved mover*" and Dante's: "*L'Amore che muove il sole e le altre stelle...*"

Që Qëndra është "the unmoved mover" këtë tashmë e kemi vërtetuar.

Le të vërtetojmë tani se ***E*** = *Amore (Dashuri)*.

Pamë se:

$$E = -\Omega = \textit{jo konflikt, jo luftë, ...} = \textit{jo urrejtje}$$
$$= \textit{dashuri (Amore)}$$

Kështu pra:

Qëndra = Zoti = Dashuri

Ky përfundim gjen një rikonfermë të njëzëshme në të gjitha Shkrimet e Shenjta, sipas të *cilave Zoti është Dashuri*, një *dashuri pa kushte* e *me çdo kusht*.


Dhe më tej:

"Hindu doctrine declares that God resides in the centre, at that point where the radii of a wheel meet at its axis..."

Pamë se:

$$F = (x^2 + y^2 = r^2) = \sim$$
$$E = (x^2 + y^2 = 0) = -\sim$$

Grafikisht:



Më tej:

"Among the Chinese, the infinite Being is frequently symbolized as a *point of light* with concentric circles spreading outwards from it..."

Le të vërtetojmë se:

Qëndra = Dritë

Në teorinë e Relativitetit pozohet:

$$tg\varphi = i\frac{v}{c}$$

ku: v shpejtësia e një trupi
i njësia imagjinere
c shpejtësia e Dritës

Për $v = c$, do të kemi: $tg\psi = i$

Pra atëhere mund të shkruajmë *korrespondencën*:

$$(tg\psi = i) = (c)$$

Por kemi parë se $E = i$ (fq. 36). Pra atëhere mund të shkruajmë akoma:

$$\textbf{Drita} = [c] = i = E = (x = -x) = (x^2 + y^2 = 0) = \textbf{Qëndra}$$


Nga ana tjetër me qënë se:

$$F = (x^2 + y^2 = r^2)$$

dhe me qënë se r mund të jetë çfarëdo, mund të marrim suksesivisht:

$$r_n > r_{n-1} \ldots > r_1$$

E pra:



Kështu pra ne treguam se si Qëndra është burimi i Dritës, si edhe përhapjen e Dritës duke u nisur prej saj.

Ne tekstin mbi Qëndrën nga Cirlot, na thuhet akoma, ndër të tjera, edhe se:

> "(The Centre) can be reached only by the **spirit in flight**...".

Kjo do të thotë se edhe vetë *Qëndra* është spirituale dhe jo pra materiale.
Por kjo rrjedh thjesht nga fakti se, siç kemi parë:

$$Qëndra = \boldsymbol{E} = \bigcirc = -\bullet = jo\ materialitet = spiritualitet$$

Në tekst na thuhet gjithashtu:

> "This country has no sovereign: everyone acts according to his own dictates; the people have no lawmakers; everyone acts according to his own dictates".

Ne mund ta tregojmë *ligjin* (siç do të shihet edhe më mirë më poshtë) me simbolin arketipal ∞, dhe kjo për arsye se *ligji* shpreh një *lidhje* (në it. *legge* = *ligj* dhe në të njëjtën kohë *legare* = *lidh*) që mendohet *e qëndrueshme*, *e pandryshueshme*, mes dy ngjarjeve, mes dy fenomeneve.

Me qënë se ky simbol është ai i *lidhjes* e pra atëhere edhe ai i *skllavërisë*, është e qartë se Qëndra, duke qënë e *lirë* (*Qëndra* = *Zoti*) do të shtrojë ekuacionin:

$$Qëndra = -\infty$$

Dhe, duke treguar Qëndrën me ○ (rikujtojmë se ○ si *zero*, është zgjidhja e vetme e ekuacionit të *Qëndrës* ($\boldsymbol{x} = -\boldsymbol{x}$)) ne mund të shkruajmë ekuacionin simbolik:

$$\bigcirc = -\infty \qquad \text{...(E)}$$

Dhe me kaq i japim fund këtij demonstrimi të disa vetirave themelore të

Qëndrës, e cila nuk është vështirë të kuptohet, se është kategoria më e lartë e tërë Mendimit Mistik, nga e cila edhe tërë ky mendim, në parimet e tij themelore (si ato që përmblidhen në Algoritmin tonë Simbolik) mund të bëhet të rrjedhë.

Vërejtje: *Një pjesë e mirë e informacionit që jepet këtu mbi Qëndrën dhe vetitë e saj, gjendet i shpërndarë andej këndej edhe ne pjesë të tjera të këtij studimi dhe në mënyrë të veçantë tek Hyrja (Një ballafaqim i drejt për drejt të Algoritmit Simbolik me Mendimin Mitik).*

Simboli ⋈

Mbasi mbrrijtëm në këtë pikë, le të introduktojmë edhe një simbol tjetër, të cilin e përmendëm shkarazi pak më lartë, simbolin ⋈.

Po citojmë këtu më poshtë pasazhe të ndryshme nga simbolizma e tij:

"**Knot**. A complex symbol embracing several important meanings all of which are related to the central idea of a *tightly closed link*..."*

(**Nyja**. Është një simbol kompleks që përfshin shumë kuptime të rëndësishme, të cilat referojnë që të gjitha tek ideja e një lidhjeje të ngushtë, të shtrënguar...)

Duke qënë kështu, simboli ynë i mësipërm (⋈), mund të interpretohet (një interpretim) fare mirë si ai i *nyjes* gjersa flet për një *lidhje*, për një *bashkim*, për një *conjunctio* etj., etj.

Le të tregojmë, si punë e parë se ky simbol bën pjesë në kodin ***F***.

Për këtë le të marrim parasysh faktin se në llogjikën mathematike (formale) ekziston një propozicion i quajtur pikërisht *conjunctio* dhe që paraqet lidhjen a bashkëqenien e njëkohshme të dy entiteteve (a koncepteve) ***p*** dhe ***q***. Ai

---

Shih *Pjesën e parë* të këtij studimi, fq. 99; *Pjesa e dytë* në kapitullin *Një ballafaqim i drejtë për drejtë i Algoritmit Simbolik me Mendimin Mitik*, fq. 93, (Cirlot, fq. 172)

tregohet zakonisht me simbolin jo arketipal **&**. Por është e qartë se ne mund ta tregojmë atë edhe me simbolin tonë arketipal ☒.

Ndërtojmë tabelën e tij të vërtetësisë.

Do të kemi:

p	*q*	*p & q*
I	I	I
I	–	–
–	I	–
–	–	–

Kjo tabelë vërtetësie është identike (me përjashtim të rreshtit të fundit, gjë që ne mund, me të drejtë këtu, të mos e përfillim*) me atë të $(x = x)$.

Mund të shkruajmë atëhere:

$$F = (x = x) = \& = \boxtimes$$

Dhe ja vërtetuam kështu përfshirjen e këtij simboli në kodin F:

$$F = \boxtimes$$

Me qënë se $E = -F$, do të jetë atëhere edhe:

$$E = -\boxtimes$$

Le të citojmë në këtë pikë përsëri nga Cirlot (fq. 173):

---

* Mund të sillet si arsye a jusifikim për këtë ndryshim të rreshtit të fundit të tabelës së vërtetësisë të këtij propozicioni se *disjunctio* (V) (shih fq. 67) siç e tregon vetë fjala, duhet të jetë e kundërt në çdo pikë me *conjunctio* (☒), gjë që kërkon ndryshimin pra të rreshtit të fundit të tabelës të vërtetësisë të kësaj të fundit nga:

–	–	–

në:

–	–	I

"To undo the knot was equivalent to finding the "Centre" which forms such an important part of all mystic thought..."

(Të zgjidhësh nyjen është njëlloj si të gjesh "Qëndrën" që përbën një pjesë tepër të rëndësishme të mendimit mistik...)

Mirëpo ne dimë se:

$$E = (x = -x) = Qëndër$$

Dhe me qënë se nga ana tjetër mund ta tregojmë *Qëndrën* me simb. ○, ne mund të shkruajmë ekuacionin e rëndësishëm për të cilin u fol shkarazi më lartë:

$$\boxed{○ = -\infty^{*}} \qquad ...(E)$$

Me qënë se:

$$F = -E = -○ = ● = -(-\infty) = \infty$$

ne shohim se mund të shkruajmë edhe:

$$\boxed{● = \infty} \qquad ...(F)$$

Edhe ky është një ekuacion simbolik i rëndësishëm me zbatime të shumta në fusha të ndryshme të Dijes.

Me qënë se simboli ● është ndër të tjera, siç kemi vënë në dukje edhe më lartë, ai i *materies*, i *Botës materiale*, i *Errësirës*, i *të Keqes* ... kuptohet atëhere përse *nyja* është vështruar nga të lashtët si diçka e *keqe*, si një *mëkat*, si një *faj*[**], si diçka *djallëzore* dhe *jo aspak hyjnore*. Kështu shpjegohen llogjikisht ato sa lexojmë mbi simbolizmën e *nyjes* tek Cirlot (fq. 173).

"... it expresses the concept of binding and fettering ... This is why the

---

* Shih fq. 51

** Me fjalë të tjera *kombi* (nyja) është vështruar si një *kob*. Mos harrojmë gjithashtu se në shqip *nyje* (∞) dhe *nyj* (●). (Shih edhe *Hyrjen*)

"Flamen Dialis" of the ancient Romans could not wear knots in his habits; and this is also true of the Moslems on their pilgrimages to Mecca..."


(...shpreh konceptin e *lidhjes* dhe *pran*gosjes ... Kjo është edhe arsyeja që "Flamen Dialis" i romakëve të lashtë *nuk mund të mbante rroba me nyje, po ashtu sikundër as myslimanët gjatë pelegrinazhit të tyre në Mekë.*)

Koncepti dhe simboli

Në parashtrimet e mësipërme jemi ndeshur me dy entitete llogjike, me *konceptin* dhe *simbolin*. Le të flasim tani shkurtimisht mbi të dy si edhe mbi marrëdhëniet mes tyre.

Siç dihet, koncepti presupozon një *abstraksion* që do të thotë fjalë për fjalë *zbritje, heqje, nxjerrje*.

Në qoftë se të *Tërën* e tregojmë arketipisht me $\bigcirc^*$ është e natyrshme (dhe arketipike) që *ndarja, pjesa* (që hiqet nga e *tëra* gjatë abstraksionit) të tregohet simbolikisht me $\oplus$.



Me qënë se mund të shkruajmë, siç kuptohet lehtë:

$$\underset{\textit{pjesa}}{\oplus} = \underset{\textit{jo e tëra}}{-\bigcirc}$$

Do të kemi atëhere:

$$\oplus = -\bigcirc = -(x = -x) = (x = x) = F$$

Kodi F dhe koncepti


Shihet pra kështu se si **koncepti** është një kategori llogjike që i përket kodit

---

* Cirlot fq. 223: $\bigcirc$ = *Infinity, the Universe*, the All

F *(llogjika formale, Arsyeja njerëzore, llogjika e të Tretit të Përjashtuar...).*

Vëmë rè me këtë rast se, me qënë se simboli ⦶ mund të interpretohet fare mirë edhe si *për-***cak**-*tim* (*përcaktimi* presupozon vendosjen e një ***caku***, e një *kufiri*...) shihet atëhere se mund të shkruajmë:



Që këndej pra edhe *përcaktueshmëria* e konceptit, mundësia, me fjalë të tjera, *për ta përcaktuar* atë.

Por atëhere do të kemi edhe:

$$E = (x = -x) = -(x = x) = -F = -⦶ =$$
$$jo\ për\text{-}cak\text{-}tueshmëri = jo\ koncept$$

Kjo do të thotë atëhere se një **"kuid"** (shq. një "diç") **që i përket kodit** ***E*** (a më saktë, që i përmbahet "rregullave" të kodit ***E***) **nuk është i përcaktueshëm e pra nuk është as i konceptueshëm.**

Kodi E dhe simboli

Kjo do të thotë atëhere se kodi ***E*** duhet të përdorë, për "punën" e tij një tjetër instrument, një tjetër entitet a kategori "llogjike", *të ndryshme nga koncepti* dhe e tillë që të mos mundet të jetë në vetvehte në mënyrë univoke e përcaktueshme.

Një kategori e tillë nuk mund të jetë tjetër veçse **simboli**.

Disa vetira të simbolit

1) Simboli lidhet me *llogjikën e Tertium Datur* (e pra me kodin ***E***).

2) Simboli lidhet me *imagjinerin* (dhe me llogjikën e tij (dhe ne kemi parë

se kishim: $(E = i)$)).

3) I njëjti simbol mund të ketë kuptime të ndryshme (plurivociteti, pluri-interpretimi i simbolit e pra mos konceptualizimi i tij).

4) Interpretime te ndryshme të të njëjtit simbol mund t'u referohen planeve a fushave të ndryshme të Realitetit, degëve të ndryshme të Dijes Njerëzore. Kjo do të thotë përsëri, ndër të tjera, se *korrispondenca simbol-koncept nuk është univoke por plurivoke*, gjë për të cilën u fol dhe më sipër.*

E dhe llogjika simbolike

Duke qënë kështu, **simboli e *heq* ndarjen mes sferave të ndryshme të Realitetit dhe të Dijes**, gjë që mund ta paraqitim skematikisht si:

simboli = $-\textcircled{D}$

Lidhur me simbolin dhe vetitë e tij mund të konsultohet me përfitim të madh edhe, ndër të tjera, libri i Jean Chevalier *Dictionnaire des symboles* (Robert Laffont Editeur) dhe veçanërisht Hyrja e gjatë në këtë libër (Introduction), ku përveç shumë gjërave të thella mbi simbolet dhe mekanizmat e mendimit simbolik, lexojmë edhe këto:

"Lacan-i flet për ekzistencën e një rendi simbolik, strukturizues të Realitetit ndërnjerëzor.

C. Levi-Straus kishte arritur në një përfundim anallog nga studimi antropollogjik i fakteve kulturore "Çdo kulturë, shkruan ai, mund të vështrohet si një **bashkësi sistemesh simbolike** ku vëndin e parë e zënë *Gjuha*, rregullat martesore, marrëdhëniet ekonomike, arti, shkenca, feja ..."

"Simboli, si një kategori transhendente e përtej-tokësores, e pafundësisë, i zbulohet njeriut në tërësinë e tij, si mëndjes ashtu dhe shpirtit të tij. *Simbolizmi është një e dhënë e drejtpërdrejt dhe e menjëhershme e vetëdijës në tërësinë e saj*, thotë Mircea Eliade..."

"Simbolet janë gjithmonë *pluridimensional*..."

"Dituria e simboleve nuk ngrihet mbi parimin e të Tretit të Përjashtuar siç bën llogjika konceptuale. Ajo presupozon, përkundrazi, parimin e të Tretit të Përfshirë a, e thënë ndryshe, një komplementaritet të mundur ndërmjet qënieve, një solidaritet universal..."

"Simboli pluridimensional mund të ketë një numër të pafund dimensionesh."

"Të zbulosh një raport simbolik është pak a shumë njëlloj si të ndodhesh *në Qëndër të Universit*."

"... (simbolet) kapërcejnë vëndet dhe kohërat, situatat individuale dhe rrethanat e rastësishme... Ato solidarizojnë disa realitete në dukje krejt heterogjene, duke i referuar tek i njëjti realitet që, duke qënë më i thelli, është në të njëjtën kohë edhe arsyeja e fundme e të qënurit të tyre..."

"Lidhjet mes simboleve nuk shpjegohen aspak me një llogjikë konceptuale..."

Por kemi, siç dihet:

$$-\textcircled{1} = \bigcirc = E$$

dhe ky ekuacion i fundit na thotë përsëri se simboli është një entitet që i përket ekskluzivisht kodit ***E*** (a më saktë, se ai "sillet" sipas "rregullave" të ***E***-së) duke përbërë atë kategori llogjike me të cilën ***E*** "punon" (vepron, operon) a, e shprehur akoma ndryshe, **simboli është gjuha me të cilën *E*** (*Qëndra, Zoti...*) **shprehet**.


Shohim pra kështu se si ***E*** *është bash llogjika e simbolit, kodi sipas të cilit simboli sillet, po në atë mënyrë sikundër* ***F*** *do të qe llogjika e konceptit, kodi sipas të cilit koncepti sillet* (operon).

Spektri semantik i një simboli

Le të trajtojmë tani një subjekt tjetër, atë të "spektrit semantik" të një simboli.

Siç kemi thënë edhe më parë, i njëjti simbol pranon më se një intepretim, gjë që është njëlloj si të thuash se i njëjti simbol mund të ketë kuptime të ndryshme të shprehura me një larmi konceptesh.

E pamë këtë me rastin e simbolit ○ që duke simbolizuar *Qëndrën* (○ = ($x = -x$)) mund të shprehte në të njëjtën kohë edhe *Boshin*, *Hiçin*, *të Tërën*, *Infinitin*, *Frymën*, *Zotin* ... gjë që grafikisht mund të paraqitej si:




Dhe ky do të ishte, sigurisht, vetëm një *segment* i spektrit semantik (kuptimor, konceptual, interpretativ) i simbolit ○.

Le të shqyrtojmë tani një segment të spektrit semantik të ndonjë simboli tjetër.

Marrim për shëmbull simbolin ⦶.

Një segment i spektrit të tij semantik do të jetë:



Le t'i tregojmë *rrezet semantike* (interpretuese, konceptuale) të një simboli X në këtë mënyrë:

$$X\ (x_1,\ x_2,\ \ldots,\ x_p,\ \ldots,\ x_m)$$

Me qënë se ato i referohen të gjitha të njëjtit simbol, do të themi se ato janë "esencialisht" identike*.

Kështu që pra do të kemi:

$$X\ (x_1,\ x_2,\ \ldots,\ x_p,\ \ldots,\ x_m) \rightarrow (x_1 = x_2 = \ldots,\ x_p = \ldots,\ = x_m)$$

Në rastin e simbolit ⦶ për shëmbull do të kemi:

---


* Kjo për arsye se simboli, siç pamë, lidhet me kodin ***E***, i cili është kodi i *Esencës* (ndërsa ***F*** është ai i *Formës*).

(*damje = gjysëm = pjesë = kufi = cak = limit = fund = përcaktim = përkufizim = përcaktueshmëri = mungesë = defekt = e metë = matje = ...*)

Le të marrim tani simbolin ●.*
Ky simbol mund të interpretohet (arketipikisht!) si:

e zezë (si *ngjyrë* dhe si *fatkeqësi*), *errësirë*, *padije*, *vdekje*, e *keqe*, *mëkat* ... *materie*, *Botë materiale*, e *mbushur*, *gabim*, ... *hije*, *natë*, *mënxyrë*, ... *djall*...**

Një segment i spektrit të tij do të jetë pra:



* Shih edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi, f. 100.

** Vërejmë këtu se simboli ● duke qënë *ai i të keqes* është njëkohësisht edhe ai *i materies* dhe i *Botës materiale*. Që nga dhe **Bota materiale = e keqe**. Kjo nuk duhet të na habisë, sepse ideja e ligësisë së Botës materiale është diçka arketipike dhe që është trashëguar nga fetë e mëdha e fillozofitë e lashta e të thella të Lindjes e, në mënyrë të veçante, të Hindisë, si edhe, në kohëra më të reja, nga vizioni neoplatonik dhe i krishterë i Botës.

Le ta tregojmë këtë simbol të dytë me ***Y***. Do të kemi:

$$Y\ (y_1,\ y_2,\ ...,\ y_q,\ ...,\ y_n) \rightarrow (y_1 = y_2 = ...\ y_q = ... = y_n)$$

E pra atëhere edhe:

E zezë = Errësirë = Padije = Vdekje = E keqe = Mëkat = Materie = Botë materiale = E mbushur = Gabim = Hije = Natë = Mënxyrë = Djall = ...

Mund të shkruajmë:

a) ● = −○ ...(**F**)

(gjersa ○ mund të interpretohet si *dritë* dhe ● si *errësirë;* ose derisa ○ mund të interpretohet si *Frymë* dhe ● si *materie;* ose, gjersa ○ mund të interpretohet si *bosh* dhe ● si *m-bush-je*; etj.). Mund të shkruajmë gjithashtu:

b) ⊕ = −○ ...(**F**)

(gjersa ○ mund të interpretohet si e *Tëra* dhe ⊕ si *pjesa*; ose gjersa ○ mund të interpretohet si *e plotë, e përsosur* ndërsa ⊕ mund të interpretohet si *e metë,* si *e mangët,* si *mospërsosje*; e kështu me radhë).

Nga (a) dhe (b) nxirret **ekuacioni simbolik**:

⊕ = ● ...(**F**)

Do të kemi pra:

$$X = Y$$

Po atëhere do të jetë gjithashtu, duke u mbështetur në sa janë thënë më sipër si edhe siç kuptohet lehtë:

$$(x_1,\ x_2,\ ...,\ x_p,\ ...,\ x_m) \rightarrow (y_1,\ y_2,\ ...,\ y_q,\ ...,\ y_n)$$

Që mund të shkruhet edhe kështu:

$$\begin{array}{ccc} X & = & Y \\ & \downarrow & \\ x_p & = & y_q \end{array}$$

Ku shënja $\downarrow$ rri për *implikon* dhe ku p dhe q mund të përshkojnë të gjitha *vlerat* (rrezet e spektrit konceptual a interpretativ) të simboleve përkatës ekuivalent mes tyre (në rastin tonë ⦶ dhe ●).

Përkthimi nga Gjuha Simbolike në Gjuhën Konceptuale

Formula e fundit na lejon të kalojmë nga një *gjuhë simbolike* në një *gjuhë konceptuale.*

Një relacion simbolik përkthehet kështu automatikisht në një relacion konceptual e pra në një gjykim.

Le ta ilustrojmë këtë me ndonjë shëmbull.

Interpretimi si burim i një informacioni universal

Le të interpretojmë ⦶ si *matje* dhe ● si *masë materiale* a thjesht si *send material*, si *Materie.*

Mund të formulojmë atëhere këtë gjykim:

"*Materia** (●) *është* (=) *e matshme* (⦶)"

Dhe anasjelltas:

"*Çdo entitet i matshëm* (⦶) *është* (=) *material* (●)"

Dhe kjo i përgjigjet të vërtetës e madje një të vërtete jo aspak triviale po të thellë e të rëndësishme.

---

* Kupto: *çdo send material, gjithshka lidhet në një mënyrë a në një tjetër me materien...*

Dhe vërtetë, nga:

$$\text{⦶} = \bullet \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

ne mund të nxjerrim, duke shumëzuar me (-1) ekuivalencën (ekuacionin) tjetër simbolik:

$$-\text{⦶} = -\bullet \qquad \ldots(\mathbf{E})$$

që mund të interpretohet, ndër të tjera, edhe si:

"*Një entitet jo material* $(-\bullet)$ *nuk mund të matet* $(-\text{⦶})$"

Dhe ky është një pohim të cilin Fizika moderne (Mekanika Kuantike) e rikonfermon.

Dhe vërtetë kemi:

$-\text{⦶}$ = $-$cak = *–përcaktueshmëri* = *papërcaktueshmëri*

= *Parimi i Papërcaktueshmërisë* në Fizikën Kuantike

= *Fizika Kuantike* = $-\bullet$ = ○ = *vakuum, fusha e vakuumit*

Dhe dihet fare mirë se *Fizika Kuantike* $(-\text{⦶})$ arrin në përfundimin se *në nivelin e thellë subatomik* (siç është rasti i "fushës së vakuumit" $(-\bullet = \bigcirc)$, *çdo matje e saktë* (⦶) *është e pamundur* $(-\text{⦶})^*$).

Le të interpretojmë tani ⦶ si *fund, i fundëm* (it. *finito*) dhe ● si *Botë materiale.*

Mund të formulojmë atëhere këtë gjykim:

"*Bota materiale* (●) *është* (=) *e fundme* (⦶)"

Kjo do të thotë, me fjalë të tjera, se:

"*Bota ka një kufi* (⦶) *në Kohë dhe në Hapësirë*"

---

* Shih edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi (fq. 150, 151, 152, 153, 159).

Dhe ne rigjejmë kështu përmes një rruge të thjeshtë e krejt llogjike, një nga zbulimet më të fundit të Kozmollogjisë moderne, atë mbi *Big Bang*-un (fillimi i Botës) dhe *Big Crunch*-in (fundi i Botës), pra faktin që *Bota materiale ka një kufi në kohë*; si edhe teorinë e vrimave të zeza, sipas të cilës *Bota ka një kufi edhe në hapësirë*[*].

Algoritmi Simbolik që ne po ndërtojmë na lejon ta rifuqizojmë këtë pohim a tezë themelore të Kozmollogjisë moderne, duke dhënë një demonstrim llogjik të saj. Ekuacioni:

$$\text{⦶} = \bullet \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

mund të interpretohet edhe në shumë mënyra të tjera duke u dhënë simboleve që figurojnë në të të tjera "vlera" kuptimore.

Kështu duke interpretuar ⦶ si *ndarje* dhe ● si *Botë materiale*, një send çfarëdo material, rigjejmë të thënën e famshme të Paracelsus: *Die Separatio ist aller Geburt Anfang* (Ndarja është fillimi i çdo lindjeje)[**].

Interpretojmë përsëri simbolin ⦶ si **matje** dhe ● si **materie**, *grimcë materiale, realitet material, Botë materiale.*

Atëhere mund të themi bashkë me arritjet e fundit të Fizikës Moderne, se:

Realiteti material (●) *në nivelin e subatomikut të thellë krijohet gjatë procesit të matjes* (⦶)[***]

Zhvillimet e mëtejshme, të fundit fillozofike të kësaj teze shkojnë gjer atje sa të miratojnë të thënën e famshme të fillosofit idealist anglez Berkley sipas të cilit "**Esse est percepi**" (Sendet ekzistojnë për sa mund të perceptohen)[****], që do të thotë *që jemi ne me koshiencën tonë, me mendjen tonë, që e krijojmë realitetin i*

---

[*] Shih edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi (fq. 107).

Në zhargonin e fizikantëve kjo gjë shprehet herë herë edhe duke thënë se "*Bota nuk është tërë bota*" që aludon ndër të tjera edhe për ekzistencën e një realiteti tjetër jo "botësor" përtej këtij Realiteti tonë të dukshëm, të prekshëm material.

[**] Shih edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi (fq. 124).

[***] Shih edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi (fq. 151).

[****] Shih edhe *Pjesën e dytë* të këtij studimi, *Shkenca e rè e zgjeruar e Etimollogjisë* (fq. 171).

cili, ndryshe, do të mos qe. Në këtë përfundim kishin arritur edhe fillosofët e lashtë të mëdhenj hindianë sipas të cilëve Bota materiale s'ishte veçse një dukje e rreme e krijuar nga mashtrimi magjik i Maya-s a, ç'ishte njëlloj për ta, i Maras, d.m.th. i Djallit.

Kështu pra mund të themi, duke përsëritur, se gjykimet që formulohen në këtë mënyrë (si më lartë) nuk janë aspak triviale por, sikundër u tha, janë të thella dhe themelore e të tilla që prekin të gjitha fushat e Dijes. Ato janë, mbi këtë, "apodiktikisht" të vërteta, sepse të "deduktuara" nëpërmjet një rruge "llogjike", gjë që *mund të përbëjë një provë të rreptë* (në llojin e vet...) *dhe të pranueshme* ("demonstrim" llogjik) *të propozicioneve, parimeve e fakteve themelore të kësaj apo asaj shkence* dhe në veçanti, si në rastet që shqyrtuam këtu, të zbulimeve themelore të Fizikës dhe Kozmollogjisë moderne.

Përsëri mbi simbolin ∞

Le të rishqyrtojmë tani simbolin ∞ për të cilin u fol shkurtimisht edhe më lartë (fq. 51).

Ai është kryesisht simboli arketipik i *nyjes*[*], por ai mund të vështrohet fare mirë edhe si një paraqitje simbolike e *ligjit* që vendos një lidhje, një mvarësi të ndërsjellë mes dy a më shumë madhësive a entiteteve, lidhje që vështrohet si e *qëndrueshme*[**]. Po ky simbol mund të shprehi fare mirë edhe *relativen, relativitetin* dhe kjo, ndër të tjera, sepse fjala *relativ* rrjedh nga latinishtja *relatio* që do të thotë në kuptimin e saj të parë, themelor, *lidhje,mvarësi* dhe nga ana tjetër, të thuash se një *gjë* a *cilësi* a një *ngjarje* etj., etj. është relative, kjo do të thotë që ajo **mvaret** nga një tjetër.

Por ky simbol mund të paraqesë fare mirë edhe *seksin*, si një *bashkim*, si një *ndërthurrje* mes dy entitetesh që vështrohen si të kundërta. Ai mund të shprehë edhe *përbërjen*, të *përzierën*, *jo të thjeshtën, kompleksen* e pra, për pasojë, edhe të *vështirën*, të *ngatërruarën* e kështu me radhë.

Me qënë se, siç pamë:

---

[*] Shih edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi (fq. 99).

[**] Shih edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi (fq. 100).


$$\aleph = \&^{*}$$

ne vëmë rè se ky simbol lidhet me propozicionin llogjik të *Conjunctio* dhe me qënë se:

$$\& = (x = x) = F$$

ne shikojmë se simboli $\aleph$ i përket pra kodit F.

Le të ndërtojmë një segment të spektrit të tij semantik**:



---

* Shih edhe *Pjesën e dytë* të këtij studimi (fq. 53).

** Shih edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi (fq. 100).

*** Le të shpjegojmë përse simboli $\aleph$ është i përshtatshëm edhe për shprehjen e *për-***pleksi***-tetit*, të *pavendosmërisë*.

Vëmë rè së pari se fjala lat. *perplexus* lidhet me shqipen *pleks*, *pleksje* dhe si e tillë kjo fjalë mund të paraqitet fare mirë me $\aleph$ që mund të shprehi kështu në një mënyrë krejt të përshtatshme dhe arketipale *pleksjen* (m-*pleksjen*)...

Conjunctio

... Vëmë rè se kemi, siç pamë:

$$\aleph = \& = conjunctio$$

Por *conjunctio* do të thotë *par definition* (si propozicion llogjik) *edhe ... edhe* (edhe ***p***, edhe ***q***) e pra **moszgjedhjen** e një mundësie të vetme, e një *rrugëdalje* të vetme, e një *objekti* të vetëm e kështu me radhë. Pra atëhere ky simbol do të thotë edhe *pavendosmëri* (*përpleksitet*), çfarë dhe duhej vërtetuar.

Disjunctio

Në llogjikën simbolike (mathematike) ekziston edhe një propozicion i quajtur *disjunctio* a ndryshe *ose ... ose* (lat. *aut ... aut*) që tregohet zakonisht me simbolin $\underline{\vee}$. Kemi këtë propozicion llogjik kur nga dy *entitete* (objekte, fakte, ngjarje, mundësira, etj., etj.) **zgjedhim** vetëm **një, ose *p* ose *q***.*

Tabela e tij e vërtetësisë do të ishte:

p	***q***	***p*** $\underline{\vee}$ ***q***
I	**I**	–
I	–	**I**
–	**I**	**I**
–	–	–

Kemi atëhere:

$$T_{\underline{\vee}} = -T_{\&}$$ **

E pra atëhere edhe:

$$\underline{\vee} = -\&$$

---

* Në llogjikën mathematike ekzistojnë dy lloje *Conjunctio-sh:*

a) **inkluzive** (*përfshirëse*) a *jo e rreptë* që tregohet me **V** dhe sipas të cilës mes dy objekteve (mundësive) mund të mirret *ose njëri* (*p*), *ose tjetri* (*q*), *ose* **që të dy**.

b) **ekskluzive** (*përjashtuese*) a *e rreptë* që tregohet me $\underline{\vee}$ dhe sipas të cilës nga dy objekte (mundësira) mund të mirret **vetëm** *ose njëri* (*p*), *ose tjetri* (*q*).

** Shih edhe fq. 53.

dhe me qënë se, siç pamë, **&** = $\aleph$ do të kemi edhe:

$$\underline{\mathbf{V}} = -\aleph \qquad \ldots(\mathbf{E})$$

Vëmë rè se ky është një ekuacion simbolik në ***E*** sepse, siç mund të shihet:

$$T_{\underline{\mathbf{V}}} = T_{(x=-x)}^{*}$$

e pra atëhere edhe:

$$\underline{\mathbf{V}} = (x = -x) = E$$

Simboli $-\aleph$ shpreh, siç shihet qartë, *zgjidhjen, shlirimin* e, duke qënë i barazvlefshëm me $\underline{\mathbf{V}}$, edhe *zgjedhjen*, marrjen e një vendimi.

Kjo është dhe arsyeja që në latinisht (edhe në italisht) de**liberare** do të thotë *të marrësh një vendim* ($\underline{\mathbf{V}}$), dhe në të njëjtën kohë në lat. (it.) **liberare** = *shliroj, bëj të lirë* ($-\aleph$).

Kjo është gjithashtu edhe arsyeja që në shqip *zgjedhje* (it. *scelta*) e pra (zgjedhja e njërës prej dy mundësive, etj., e pra *marrja e një vendimi*) ($\underline{\mathbf{V}}$) dhe në të njëjtën kohë *zgjidhje* (it. *scioglimento* nga folja *sciogliere* që nga dhe *sciolto*, i *zgjidhur*) e pra simb. $-\aleph$.

Shohim pra kështu se mund të shkruajmë:

$\underline{\mathbf{V}}$	=	$-\aleph$	...(**E**)
zgjedh		*zgjidh*	
(*de**liberare***		***liberare***	
scegliere		*sci**o**gliere*)$_{\text{it.}}$	

Me fjalë të tjera, ne mund të shohim se ekuacioni i mësipërm, i rëndësishëm simbolik, pozohet në një mënyrë origjinale si nga shqipja ashtu edhe nga italishtja. Kjo rikonfermon edhe një herë, linguistikisht, vërtetësinë e tij.

Vëmë në dukje me këtë rast se:

Shih edhe fq. 26.

Gjuha (*gllosari i çdo gjuhe pa përjashtim*) **rikonfermon, kur në një mënyrë e kur në një tjetër, të gjitha ekuacionet simbolike të Algoritmit Simbolik.**

Kjo çështje është trajtuar mjaft gjërësisht në *Hyrjen* e këtij studimi, atje ku flitet mbi *Praninë e Algoritmit Simbolik në Gjuhë.*

Ekuacione simbolike me ⊗ *dhe disa interpretime të tyre*

Le të tregojmë tani me $z_1, z_2, \ldots z_r, \ldots z_s$ rrezet e ndryshme semantike të simbolit ⊗.

Mund të shkruajmë atëhere siç bëmë edhe me simbolet e tjera:

$$Z(z_1, z_2, \ldots z_r, \ldots z_s)$$

si edhe:

$$z_1 = z_2 = \ldots z_r = \ldots z_s$$

Me fjalë të tjera:

nyje = relativitet = mvarësi = lidhje = skllavëri = relacion, marrëdhënie = bashkim = seks = thurrje = ngatërresë = përzierje = kompleksitet = bashkëveprim = përpleksitet, pavendosmëri = **ligj** *= conjunctio* **(&)** *= ...*

gjë që na lejon të formulojmë një sërë gjykimesh apodiktikisht të vërteta, si bie fjala:

"*Çdo ligj* (⊗) *është relativ* (⊗)"
"*Teoria e Relativitetit* (⊗) *nuk është e thjeshtë* (⊗)"
"*Kush thotë seks* (⊗) *thotë mvarësi* (⊗), *thotë skllavëri* (⊗)"
...

Nga ana tjetër, me qënë se kemi:

$$\text{⚮} = \& = (x = x) = F = \bullet$$

do të kemi edhe:

$$\text{⚮} = \bullet \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

Interpretojmë:

⚮ = *masa materiale e një trupi*
● = *relativitet*

Mund të formulojmë atëhere këtë gjykim apodiktik:

"*Masa e një trupi* (●) *është* (=) *relative* (⚮)"

Rigjejmë kështu nëpër një rruge thjesht e krejt llogjike *relativitetin e masës* sipas teorisë së Relativitetit.*

Interpretojmë:

● = *mëkat*
⚮ = *skllavëri*

Mund të formulojmë atëhere këtë gjykim:

"*Kush mëkaton* (●) *bëhet* (=) *skllav* (⚮) *i mëkatit.*" **

Dhe rigjejmë kështu të thënën e Jisu Krishtit në Ungjill (Gjoni 8:33).

Interpretojmë:

● = *masa materiale e një trupi* pra dhe *inercia e tij*
⚮ = *bashkëveprim*

---

* Shih edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi (fq. 107).

** Shih edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi (fq. 108)

Rigjejmë atëhere hipotezën e Machut* në fizikë:

"Inercia e një trupi (●) *shpjegohet* (=) *me shumën e bashkëveprimeve të tij* (⋔) *me të gjithë trupat e tjerë të Universit."*

Vërejmë këtu se duke e treguar *shumën* me simbolin $\sum$, hipoteza e Machut mund të shkruhet më saktë si:

$$\bullet = \sum_{1}^{\infty} \pitchfork_i$$

ku termi i dytë vlen për *shumën e të gjithë bashkëveprimeve.*

Algoritmi Simbolik na thotë pra se hipoteza e Machut ka një *bazë llogjike* dhe mund të jetë pra kështu e vërtetë.

Interpretojmë:

● = *Bota materiale*
⋔ = *conjunctio* (martesë, seks)

Rigjejmë kështu mitin kozmogonik të krijimit të Botës përmes *Hieros Gamos* (Martesës së Shenjtë) ndërmjet Qiellit dhe Tokës**.

Takimet

Vëmë rè me këtë rast se si Algoritmi Simbolik na lejon të realizojmë një sërë "takimesh", si ai këtu mes Jisu Krishtit, Einsteinit, Machut dhe një miti kozmogonik.

Ne shohim, nga ana tjetër, se si Krishti, si Einsteini, si Machu, si miti kozmogonik që përmendëm më sipër i *Hieros Gamos*, na thonë në **esencë** të njëjtën gjë. Ata që të gjithë shtrojnë të njëjtin ekuacion simbolik:

---

* Ernst Mach, (1838-1916), fizikant dhe fillosof i shquar austriak me origjinë çeke. Ka dhënë një kontribut me vlerë në fillosofinë e në shkencat e ndryshme të kohës së tij. Einsteini mori shumë prej tij dhe e cilësoi atë si "pararendës" të Teorisë të Relativitetit.

** Shih edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi, fq. 166.

$$\bullet = \infty$$

ndonëse e interpretojnë atë në mënyra të ndryshme.

Do të themi atëhere se *Krishti, Einshteini, Machu, Kozmogonia...* ***takohen*** *në formulën e mësipërme në* ***F***.

Algoritmi Simbolik lejon realizimin e një numri thuajse të pafund takimesh të tilla, duke kapërcyer Kohën dhe Hapësirën (*ashtu sikundër bën edhe simboli*), **duke shëmbur muret e ndarjeve, duke mos çarë kokë për kufij dhe barriera të çfarëdo natyre** (*pikërisht ashtu sikundër, prapë, edhe simboli*).

Shumëzimi me (–1)
dhe ndërrimi i kodeve

Kemi parë se si kur na është dhënë një ekuacion simbolik, duke shumëzuar të dy anët me (– 1) përftohet një tjetër ekuacion simbolik i barazvlefshëm me të parin.*

Por veç do pasur parasysh se duke qënë:

$$E = -F \quad \text{si edhe} \quad F = -E$$

shumëzimi me (– *1*) ndryshon përkatësinë e ekuacionit simbolik tek ky apo ai kod.

Le të marrim për shembull ekuacionin:

$$\infty = \bullet \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

Le të shumëzojmë të dy anët me (– *1*).

Do të kemi:

$$-\infty = -\bullet \qquad \ldots(\mathbf{E})$$

---

* Shih p.sh. faqen 63.

Dhe rigjejmë kështu të thënën e Shën Palit (Letër Romakëve, 7:8):

"*Pa ligjin* (– ☓) *mëkati* (●) *është* (=) *i vdekur* (– ●)"

Duke pasur parasysh se:

– ● = ○ ...(E)

duke zëvendësuar në ekuacionin e mësipërm, do të kemi:

– ☓ = ○ ...(E)

Duke interpretuar ☓ si *nyje* dhe ○ si *Qëndër*, rigjejmë këtë gjykim të përfshirë në Mendimin Mistik:

> "To undo the knot (☓) was equivalent (=) to finding the "Centre" (○)."*
> (Të zgjidhësh nyjen (☓) është njëlloj (=) si të gjesh Qëndrën (○).)

Duke interpretuar ○ si e *vërteta* dhe – ☓ si *liri*, rigjejmë të thënën e Krishtit (Gjoni 8:32)**:

"*Do të njihni të vërtetën* (○) *dhe e vërteta do t'ju bëjë juve të lirë* (– ☓)"

Roli Unifikues i Algoritmit Simbolik

Duke përfunduar me këtë pikë, themi prapë e prapë se:

Falë Algoritmit Simbolik (artikullim llogjik i Mendimit Mistik) **muret që ndajnë aspektet e ndryshme të Realitetit, pikëpamjet e ndryshme sipas të cilave shihet dhe gjykohet ky Realitet dhe që nuk janë tjetër veçse shkencat, fillosofitë, fetë e artet e ndryshme... *bien*, duke na treguar e**

---

* Shih Cirlot, fq. 17.

** Shih lidhur me të gjitha këto interpretime edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi.

bërë fare të qartë se të gjitha degët e ndryshme të Dijes, qoftë edhe në kohëra e vende të ndryshme, thonë, në fund të fundit, *në esencë*, të njëjtën gjë.

Algoritmi Simbolik lot në këtë mënyrë rolin e një faktori të fuqishëm **unifikimi**.

Antillogjika dhe Anallogjia*

Kemi parë se kishim:

$$E = (x = -x) = -(x = x) = -F = -\,llogjika\ formale$$

Pra E mund të vështrohet, nga ky pikëvështrim, si një **Antillogjikë**.

Le të analizojmë tani fjalën me zanafillë greke: **analogjia** (*αναλογία*).

ana- është në greqisht një parashtesë (prefiks) me kuptim *mohues*, e pra simbolikisht:

$$\textbf{ana-} = -1$$

Pjesa tjetër e fjalës **-logjia** lidhet me greqishten *logos* (*λογος*) që nga dhe *logjikó* (*λογίκό*) = *arsye, gjykim... llogjikë*.

Duke qënë kështu, mund të shkruajmë:

$$E = \textit{Anti}llogjikë = \textit{Ana}llogjì$$

Kështu pra kodi E duke qënë kodi i *Antillogjikës*, është në të njëjtën kohë edhe ai i *Anallogjisë*.

Kjo shpjegon atëhere edhe nga një tjetër pikëvështrim përse:

$$E = -\leftrightarrow$$

(jo kauzalitet, jo shkakësi)

---

* Shih edhe *Pjesa e parë* e këtij studimi, fq. 97.

Mund të themi, duke qënë kështu, se në ***E*** nuk kemi të bëjmë me **konseguenca**, por me **korrispondenca**.

Ky përfundim pritej po të kihet parasysh se, siç kemi parë:

$$(E) = (simbolizëm)$$

Që *Anallogjia* lidhet ngushtësisht, esencialisht me simbolin, këtë e provojnë edhe të gjitha ato sa lexohen, lidhur me këtë çështje, ndër të tjera, tek Cirlot:

"Anallogjia është ndoshta guri i themelit i tërë ndërtesës simbolike..." *

"Ngjashmëritë materiale ose formale përbëjnë vetëm një nga anallogjitë e mundshme, sepse anallogjia mund të lidhet edhe me funksionin..." **

"Anallogjia si një proces unifikues dhe rregullues shfaqet vazhdimisht në art, në mitet dhe në poezì.

Prania e saj dëshmon për një forcë ***mistike*** *në veprim, nevojën për të ribërë* ***një*** *atë që është copëtuar, shpërndarë e përhumbur..."* ***

Ritheksohet pra në këtë mënyrë rëndësia themelore e Anallogjisë për teorinë e Simbolizmit, a, ndryshe, për Mendimin Mistik (mitik).

Nga ana tjetër kemi parë se si simboli pozonte llogjikën e Tertium Datur, me fjalë të tjera ***E***.

Pra dhe do të kemi:

Simbol = Anallogji
*Simbol = **E** = Antillogjikë*

Dhe vërtetë atëhere:

Anallogji = Antillogjikë

---

* Cirlot, fq. xl.

** Cirlot, fq. xxxix.

*** Cirlot, fq. xl.

Për dy objekte që i përgjigjen anallogjikisht njëri tjetrit thuhet se *korrispondojnë. Dhe ja pra kështu kuptohet përse Teoria e Simbolizmit* është ndërtuar e tëra me *korrispondenca* (dhe jo me *konseguenca*, të cilat nënkuptojnë ligjin e shkakësisë).

Po përfundojmë duke riprodhuar këtu disa vargje nga vjersha me titull "Correspondances" të poetit të njohur frëng të shekullit XIX, Charles Baudelaire, që lidhet ngushtë me temën e bisedës sonë:

Correspondances*

La Nature est un temple où de vivants piliers
Laissent parfois sortir de confuses paroles;
L'homme y passe à travers des forêts de symboles
Qui l'observent avec des regards familiers.

Comme de longs échos qui de loin se confondent
Dans une ténébreuse et profonde unité,
Vaste comme la nuit et comme la clarté,
Les parfums, les couleurs et les sons se répondent.
.....

Rishtrimi i pyetjes: "Çfarë është Algoritmi Simbolik?"

Përgjigja pas gjithë atyre që pamë gjer këtu, mund të jetë edhe kjo:

Algoritmi Simbolik është tërësia e figurave simbolike në të dy kodet (*E* dhe *F*) bashkë me të gjitha rrezet e spektrave të tyre semantikë si edhe me të gjitha ekuacionet simbolike të mundshme dhe interpretimet e mundshme të tyre.

---

* **Korrispodenca**

Natyra është si një tempull ku ca kolona të gjalla / Murmuritin herë herë ca fjalë të ngatërruara / Njeriu kalon nëpër pyje me simbole / Që e ndjekin me sy të dashur e familjar.

Si jehona të gjata që shkrihen diku larg / Në një unitet terrzi dhe të thellë / Gjoksgjërë porsi nata dhe si drit'e diellit / Parfumet e ngjyrat e tingujt i gjegjen njëri tjetrit.

Si një pjesë përbërëse e tij duhet vështruar edhe mënyra e përkthimit nga gjuha simbolike në gjuhën konceptuale dhe anasjelltas etj., etj.

Algoritmi Simbolik sajon kështu një **sistem**, ndonëse krejt të veçantë dhe *sui generis*.

Le të riprodhojmë tani tërësinë e figurave simbolike në E dhe në F.

$$E = (x = -x) = -(x \neq -x) = -(x = x) = \bigcirc = \oplus =$$
$$-\ominus = -\bullet = -\varphi = -\S = -\leftrightarrow = -(-1) = 1 = -(\chi) =$$
$$\infty = i = (x = \boxed{x}) = (\uparrow = \downarrow) = (E = F) = -F =$$
$$\sqrt{F} = -\aleph = \underline{V} = -\sim = (x^2 + y^2 = 0) = (\leftarrow = \rightarrow)$$
$$= -\tfrac{1}{2} = -2 = -5 = (s = 0, t = 0) = -\odot =$$
$$-\overset{\circ}{\frown} = \ldots$$

$$F = (x = x) = (x \neq -x) = -(x = -x) = -\bigcirc = -\oplus =$$
$$\ominus = \boxed{\circ} = \bullet = \varphi = \S = \leftrightarrow = -1 = \boxed{1} = \chi =$$
$$-[\infty] = -[i] = (-x = \boxed{x}) = (F \neq E) = \aleph = -\underline{V}$$
$$= E^2 = -E = \boxed{E} = \text{Refl } E = \text{Rot } E = \sim =$$
$$(x^2 + y^2 = r^2) = \not\sim = (s \neq 0, t \neq 0) = \odot = (\uparrow \neq \downarrow)$$
$$= (\leftarrow \neq \rightarrow) = \& = \tfrac{1}{2} = 2 = 5 = \overset{\circ}{\frown} = \ldots$$

Le të japim ndonjë sqarim dhe le të bëjmë ndonjë vërejtje:

1) Simboli φ qëndron për *rënie, gravitet, peshë, dekadencë, degradim*, etj., etj. Ai përbëhet, siç shihet, nga simboli $\circ$ që është ai i *Qëndrës*, i *Frymës*, i *Zotit*... dhe nga $\downarrow$, një shigjetë me kokë poshtë në kuptimin e **rënies** (angl. *fall*).

Me qënë se çdo figurë simbolike (dhe çdo rreze e spektrit të saj semantik a interpretativ) lidhet, siç do të shohim, me një *mit kozmogonik*. Miti kozmogonik që mund të shprehet me simbolin që po shqyrtojmë është ai i *rënies*, për të cilin është folur edhe në vënde të tjera të këtij studimi.

2) Simbolet $-[\infty]$ dhe $-[i]$ rrinë për *jo infinit* dhe *jo imagjiner* e pra respektivisht *i fundëm* dhe *real.*

3) Simboli $\not X$ rri për *jo një, shumë, të ndryshme ...*

4) Simboli $(\leftarrow = \rightarrow)$ rri për *përpara = mbrapa* ose *e djathta = e majta,* ose *e ardhmja = e kaluara.*

5) Simboli $\overset{\circ}{\frown}$ që paraqet një hark rrethi dhe qëndrën e rrethit (o) rri për *përkulje, krrusje.*[*]

Rikujtojmë se ekuivalenca $\bullet = \overset{\circ}{\frown}$ del nga:

$$\bullet = (x = x) = (x^2 + y^2 = r^2) = \textit{rreth}$$

e pra *hark rrethi* $(\overset{\circ}{\frown})$.

6) Figura simbolike $F = \boxed{E}$ del duke u nisur nga: **a)** $F = -E$ dhe nga **b)** formula në F: $-x = \boxed{x}$. Në këtë formulë mund të marrim, me qënë se x mund të jetë çfarëdo, $x = E$. Dhe atëhere do të kemi: $-E = \boxed{E}$ e pra atëhere edhe $F = \boxed{E}$.

7) Lidhur me këtë simbol (+) shih edhe faqe 316.

Vërejmë me këtë rast sa vijon:

a) Të gjitha figurat simbolike në E dalin duke mohuar ato të F-së (sikundër edhe ato të F-së dalin duke mohuar ato të E-së).

---

[*] Vërejmë shkarazi këtu se duke intepretuar simbolin $\bullet$ si *masë materiale* dhe $\overset{\circ}{\frown}$ si *përkulje, krrusje* të kontinuumit Kohë + Hapësirë, ne rigjejmë përmes Algoritmit tonë Simbolik, d.m.th. nëpër një **rruge thjesht e krejt llogjike** *krrusjen* e kontinuumit Kohë + Hapësirë, në pranì të *masave materiale,* **në Teorinë e Relativitetit të Zgjeruar**.

Ekuivalenca simbolike:

$$\varphi = \overset{\circ}{\frown} \qquad \ldots(F)$$

do të jepte shpjegimin origjinal "gjeometrik" të gravitetit nga Einsteini nëpërmjet *krrusjes të kontinuumit.*

b) Të gjitha figurat simbolike në ***E*** (bashkë me të gjithë spektrat e tyre semantikë) ndodhen, sa kohë që ne jemi e mbetemi në ***F*** (e pra në këtë Botën tonë reale, *materiale*, me qënë se ***F*** = ●) *të fshehura,* të *okultuara* (të kallura), të *groposura*, të *represuara,* të *penguara,* të *ndaluara,* të *padukshme*, siç del qartë nga formula e mësipërme (***F*** = [E]). Kështu kodi ***E*** përbën brendinë, thelbin, Esencën e *pashfaqur*, të *pamanifestuar*, të *përmbajtur* (e pra atëhere edhe **përmbajtjen** !) të kodit ***F***. A, e shprehur ndryshe dhe në një gjuhë disi theollogjike, "*Mbretëria e Qiellore është* ***mbrënda*** *Mbretërisë Tokësore*"*.

Kjo do të kuptohet edhe më qartë po të jetë se në formulën e mësipërme do të zëvendësojmë ***F*** me ● (*Bota materiale*, "Mbretëria Tokësore") dhe ***E*** me ○ (*Bota spirituale*, "Mbretëria Qiellore").

Në këtë rast do të kishim:



Dhe na rikujtohet atëhere prapë e prapë këtu e thëna e Teilhard de Chardin:

"*Dans le coeur* (□) *de la Matière* (●) *il y a l'Esprit* (○)"

8) Në kodin ***F*** kemi ***2*** dhe ***−1***.

Pra mund të shkruajmë:

$$2 = -1 \qquad \text{...(F)}$$

Ky është një barazim i *mathematikës mistike* për të cilin kemi folur edhe gjetiu**. Po, duke zgjeruar bisedën, le të themi edhe këtu diçka.

Në mathematikën mistike pozohet:

---

* Krishti në Ungjill: "Mbretëria e Qiejve është brënda jush", (Ungjilli sipas Llukës, 17:20-21).

** Shih p.sh. *Hyrjen* (fq. 149).

$$9 = 0$$

që nga dhe:

$$3 + 3 + 3 = 0$$

E pra atëhere edhe:

$$3 = 0$$

ose edhe:

$$2 + 1 = 0$$

dhe përfundimisht:

$$\boxed{2 = -1} \qquad \text{...(F)}$$

Duke u mbështetur tek barazimi i fundit mund të shkruajmë, duke pjesëtuar të dy anët me **2**, edhe:

$$1 = -\frac{1}{2}$$

ose edhe atëhere:

$$-1 = \frac{1}{2}$$

Kemi gjithashtu:

$$\frac{1}{2} = \mathbf{0{,}5} \text{ e pra mistikisht}^{*} \quad 0 + 5 = 5$$

Pra mund të shkruajmë:

$$2 = -1 = \frac{1}{2} = 5 \qquad \text{...(F)}$$

9) Me qënë se $E = \bigcirc$ dhe $F = \bullet$, duke interpretuar $\bigcirc$ si *Frymë* dhe $\bullet$ si *Materie*, ne mund të themi se kalimi nga kodi E në kodin F realizon kalimin nga *Fryma* (lat. *Spiritus*) tek *Materia*, nga *Bota Spirituale* tek *Bota Materiale*.

Por ne mund të interpretojmë $\bigcirc$ edhe si **hiçi**, e pra atëhere kalimi nga E

---

* Tek Cirlot fq. 236, tregohet se për të gjetur vlerën simbolike (cilësore) të një numri me shumë shifra mblidhen këto shifra duke marrë 9 = 0. Kështu *vlera simbolike* e numrit p.sh. 4586 do të jetë:

$$4 + 5 + 8 + 6 = 9 + 14 = 9 + 9 + 5 = 0 + 0 + 5 = 5$$

në ***F*** mund të vështrohet edhe si *Krijimi i Botës materiale nga Hiçi*[*]. Ky krijim është një **rënie** (angl. *fall*) sepse kemi në ***F***: ● = ♀.

Duke qënë kështu ne mund të shkruajmë atëhere se:

$$\textbf{Krijimi i Botës}^{**} = \begin{cases} E & (\bigcirc) \\ \downarrow & \\ F & (\bullet) \end{cases}$$

10) Çdo figurë simbolike në ***F*** është ekuivalente me -1, gjë që mund të interpretohet si *fillimi ka nisur me një mohim.* Nga ana tjetër, Bota, sipas Mendimit Mistik (e jo vetëm) ka filluar me një mohim dhe kjo sepse:

a) *Bota ka filluar me një flijim* (të një Qënie Hyjnore).

b) Sipas Cirlot (fq. li, 25, 32, 33 ...) "*Bota ka filluar me një Involucion*";

c) Kemi parë se: ● = ♀ = -1, pra *fillimi i Botës Materiale:* ● = -1.

ç) Sipas Hegelit Bota fillon, si alienim i Frymës Absolute, me Antitezën, dhe me qënë se *Teza* është ***1***, *Antiteza* do të jetë -1.

Me qënë se nga ana tjetër ● (që bën pjesë në ***F***) mund të interpretohet si *Botë materiale,* del se:

Çdo figurë simbolike në ***F*** (*çdo interpretim i saj, i çdo rreze të spektrit të saj semantik*) **mund të vështrohet si një mit kozmogonik**.

Kështu për shëmbull mund të shkruajmë:

$$\underset{\textit{ndarja}}{\bigcirc} = \underset{\textit{fillimi}}{-1} = \underset{\textit{Bota materiale}}{\bullet} \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

---

[*] Shih edhe *Ndërtimi i Algoritmit Simbolik duke u nisur nga Hiçi.*

[**] Shih lidhur me këtë çështje edhe gjetiu, veçanërisht tek *Hyrja*, fq. 157

E pra atëhere mund të themi:

"Bota filloi me një ndarje"

dhe rigjejmë kështu "mitin kozmogonik" të përmbyllur në të thënën e Paracelsit, të përmendur disa herë në këtë studim *"Die Separatio ist aller Geburt Anfang"*.

Duke interpretuar simbolin ⌀ si *çgjymtyrim* (angl. *dismemberment*) rigjejmë mitin kozmogonik të fillimit të Botës me një çgjymtyrim (Cirlot, fq. 62 dhe 63).

Marrim simbolin ⚸. Ai mund të interpretohet ndër të tjera si *Hieros Gamos* (Martesa e Shënjtë), dhe mund të shkruajmë:

⚸	=	-1	=	●	...(F)
Martesa e Shënjtë		*fillimi, lindja*		*Bota materiale*	

Pra përftohet kështu miti kozmogonik i krijimit të Botës përmes Martesës së Shënjtë (Cirlot, 168, 189 ...).

Marrim ♀, simbol që mund të interpretohet si *rënie* (angl. *fall*), *rënia e Frymës*. Mund të shkruajmë:

♀	=	-1	=	●	...(F)
rënia e Frymës		*fillimi, lindja*		*materia*	
				Bota materiale	

Rigjejmë kështu mitin kozmogonik të *rënies* (Cirlot, fq. 173, 227, 249, 383), të rënies së Frymës në materie.

Marrim simbolin -1. Interpretojmë -1 si *mohim*. Ne mund të themi atëhere se:

Bota materiale (●) *filloi* (-1) *me një mohim* (-1)

Del pyetja: *me një mohim të kujt, të çfarë*? Të *njëshit* (*1*) dhe me qënë se sipas Algoritmit Simbolik:

$$1 = \bigcirc = Zoti = Qëndra \qquad \ldots(\mathbf{E})$$

ne mund të themi se:

Bota filloi me një mohim (*flijim, sakrifikim*) *të* **Zotit**

Dhe rigjejmë kështu mitin e *Sakrificës Kozmogonike* (Cirlot, fq. 64).
E kështu me radhë...

Ne mund të interpretojmë $\bigcirc$ si *Qëndra* ($\bigcirc = (x = -x)$) e pra edhe si *Energjia infinite primordiale* e Qëndrës (Hyjnisë). $\oplus$ mund të interpretohet atëhere si *modifikimi i Energjisë primordiale* (*modification of primordial Energy*, Cirlot fq. 64). Të gjitha mitet kozmogonike i shërbejnë në instancë të fundit atëhere këtij modifikimi të energjisë primordiale, me gjithë se: *"...such a modification, so far as most primitive and protohistoric peoples are concerned, was seen to exist in such painful forms as mutilation, struggle or sacrifice."**

Vërejmë rè më në fund edhe sa vijon:
Mitet kozmogonike na tregojnë jo vetëm se si është bërë, se si është krijuar Bota, por edhe se si ajo mbahet. Vëmë rè me këtë rast se në shqip kemi *bahet* (bëhet) dhe *bahet* (mbahet). Kjo thuajse - homonimi flet vetë:

"*Bota* (m)***bahet*** *ashtu si* ***bahet***"

Kjo do të thotë se mitet kozmogonike përsëriten vazhdimisht (siç ka treguar ndër të tjerë edhe etnollogu i famshëm rumun, Mircea Eliade në librin e tij të njohur "Le mythe de l'Éternel Retour" (shih *Hyrjen*, fq. 154, 155).

Përsëritja e miteve kozmogonike e përtërit Botën.

---

* "Me gjithë se" një modifikim i tillë, për sa i përket popujve më primitivë dhe protohistorikë duket se ka ekzistuar në të tilla forma të dhimbshme si gjymtyrim, luftë dhe flijim (Cirlot fq. 64).

b. *Ndërtimi i Algoritmit Simbolik duke u nisur nga Hiçi*

Le të na jetë dhënë **Hiçi**, d.m.th, **asgjë**!... Kjo do të thotë, ndryshe, le të na jetë dhënë **zeroja**, e pra simboli ○.

Dimë se zero-ja, pra simboli ○, është zgjidhja e ekuacionit të Qëndrës, si "coincidentia oppositorum".

Mund të shkruajmë pra:

$$\textbf{Hiçi} = \textbf{zero} = ○ = (x = -x) = E$$

Por mund të shkruajmë gjithashtu, siç kemi parë, edhe:

$$E = (x = -x) = (x^2 + y^2 = 0)$$

si edhe:

$$E = (x = -x) = (X^2 + Y^2 = 0) = \infty = i^{*}$$

Kështu, duke na u dhënë *Hiçi* (d.m.th. **asgjë**) ne na është dhënë në të njëjtën kohë *Qëndra*, e pra *Zoti*, e *Tëra*, *infiniti*, *imagjineri*.**

Ndërtimi i Algoritmit Simbolik kryhet tani fare lehtë. Dhe vërtetë:

$$T_{(x=-x)} = -T_{(\leftrightarrow)}$$

(*Tabela e vërtetësisë së Qëndrës vështruar si një propozicion llogjik* = – *Tabela e vërtetësisë së propozicionit llogjik të shkakësisë*. - Shih për këtë edhe *P.Sh.A.S.*).

---

* Shih P.Sh.A.S., fq. 37.

** Le të përsërisim këtu shkarazi se tek Cirlot lexojmë: ○ *the All, the Universe, Infinity*

Pra, ndër të tjera, ne gjejmë se kemi gjer këtu:

$$Hiçi = \bigcirc = (x = -x) = \infty = i = - \leftrightarrow \quad ...(\mathbf{E})$$

Me qënë se x mund të jetë çfarëdo, duke vepruar si në *P.Sh.A.S.*, gjejmë:

$$E = (\uparrow = \downarrow) \qquad (Tabula\ Smaragdina)$$

si edhe:

$$E = (x = \boxed{x}) \qquad (Goethe)$$

Para se të vijojmë më tej, le të vëmë rè se përcaktimi i mendimit mitik është ai i një sistemi **akauzal** (Levy-Bruhl dhe më vonë Ernst Cassirer) e pra simb. $- \leftrightarrow$. Dhe është pikërisht ajo që ne gjejmë këtu ($E = - \leftrightarrow$).

Dhe tani vazhdojmë.

Kemi, duke marrë tabelat e vërtetësisë:

$$\mathbf{T}_{(x = -x)} = - \mathbf{T}_{(8)}$$

që nga:

$$E = (x = -x) = -8$$

Kemi më tej, me qënë se x mund të jetë çfarëdo:

$$(x = -x) = (\S = 2) = -\S 2 \qquad ...(\mathbf{E})$$

Dhe më pas:

$$E = \bigcirc = (x = -x) = (x^2 + y^2 = 0) = (y = \pm ix) =$$

*Drejtëzat izotrope, **të palëvizshme**:* $- \sim$

Me qënë se $(x = -x) = - (x \neq -x)$, mund të shkruajmë:

$$\mathbf{E} = \bigcirc = - (x \neq -x) = -\textcircled{1}$$

Më tej, me qënë se *zero* = 0 = $(x^2 + y^2 = 0)$ = *pikë gjeometrike* = *bosh* (angl. *void* dhe është *the mystic void* i mendimit të lashtë mistik që ne kështu rigjejmë) = – *i plotë* = –●, ku ● tregon të *plotën* (të *mbushurën*), *jo boshllëkun* e pra **materien**.

E kështu me radhë...

Pra, duke përmbledhur:

Hiçi = ○ = $(x = -x)$ = E = –● = –ᘯ (*jo konflikt, paqe*) = $(x = \boxed{x})$ (si *jashtë* dhe *brënda*) = –⊕ (*jo gjysëm, jo pjesë, jo cak*) = ∞ = i = $(x^2 + y^2 = 0)$ (*pika*) = – $(x \neq -x)$ (*jo dallim*) = ... *1*

Me qënë se:

a) ○ (*zero, hiçi*) është zgjidhja e **vetme** (1) e ekuacionit të Qëndrës $(x = -x)$, dhe me qënë se $(x = -x)$ = **Zoti**, kjo është njëlloj si të thuash se ka **vetëm** *një Zot*.

b) Dimë se* $E^2 = F$ e pra edhe $E = \sqrt{F}$, dhe me qënë se $E = i$, kemi $i = \sqrt{F}$, që nga $F = -1$, dhe me qënë se, nga ana tjetër, $E = -F$, do të kemi edhe $E = -(-1)$, e pra $E = 1 = \ldots - \frac{1}{2} = -2 = -(\chi) = \ldots$ (shih edhe *P.Sh.A.S.*).

Jemi në gjëndje pra të nxjerrim nga *Hiçi* (*zero*) të gjitha figurat simbolike të kodit E.

Figurat simbolike të kodi F nxirren duke patur parasysh se:

$$F = (x = x) = -(x = -x) = -E$$

---

* Rikujtojmë nxjerrjen e kësaj formule:

$E = (x = -x)$
$E^2 = (x = -x)^2$
$E^2 = (x^2 = x^2) = (X = X) = F$

E pra do të kemi:

$$F = -\bigcirc = \bullet = \oplus = \Omega = (-x = \boxed{x}) = (\uparrow \neq \downarrow) =$$
$$(x^2 + y^2 = r^2) = \leftrightarrow = \infty \ldots = -1 = \tfrac{1}{2} = 2 = \chi = \ldots$$

Me qënë se simboli ● mund të interpretohet, ndër të tjera, edhe si ai i *materies* e pra edhe si ai i *Botës materiale* dhe me qënë se atëhere tërë kodi ***F*** (***F*** = ●) mund të mendohet se nuk është tjetër veçse ai i *Botës materiale* (një interpretim), ne shikojmë se si, duke u nisur nga *hiçi*, mund të nxjerrim (deduktojmë), të ndërtojmë, të "krijojmë" tërë Botën, si atë *materiale* (● = ***F***), ashtu edhe atë *spirituale* ($E = -F = -\bullet = \bigcirc$).

Realizohet kështu ndër të tjera ëndrra e Rudolf Carnap-it*:

"Die logische Aufbau der Welt"
(Ndërtimi llogjik i Botës)

Është rasti këtu për të ricituar, lidhur me këtë problematikë, Heideggerin. Në librin "Was ist die Methaphysik?" (Ç'është Metafizika?) ai shkruan:

> "Parimi i qëmotshëm *ex nihilo nihil fit* (nga hiçi s'del, s'bëhet asgjë) merr pra një kuptim të ri, lidhur bash me problemin e Qënies dhe mund të formulohet prandaj në këtë mënyrë: *ex nihilo omne ens qua ens fit* (nga hiçi krijohet gjithshka)."

Pra nuk është e vërtetë që nga hiçi s'del asgjë, përkundrazi, **nga hiçi del gjithshka, nga hiçi krijohet gjithshka**.

Kjo, në rastin tonë, bën të mundur që, duke u *nisur nga hiçi, nga asgjë, ne të përftojmë në atë mënyrë që u tregua më lart, të dy kodet, të dy botërat, Qielloren* (***E***) *dhe Tokësoren* (***F***).

Në një pasazh të të njëjtit libër, Heideggeri shkruan:

---

* Fillosof dhe linguist amerikan me origjinë gjermane.

"Pyetja jonë mbi **hiçin** (se çfarë është *hiçi* - shën. i përkth.) duhet të na paraqesë tërë Metafizikën".

Algoritmi Simbolik që ne ndërtuam duke u nisur nga *hiçi* na lejon të provojmë lehtë edhe këtë pohim themelor të Heideggerit.

Shkruajmë:

Hiçi = ○ = −⊖

Dimë se:

⊖ = ● = *Materia*, "fizikja"

Nga ana tjetër:

−⊖ = ⊕ = ○ = ***E***

ku simboli ⊕ tregon *kapërcimin*, *superimin*, *tejkalimin* e **cakut** e pra, me qënë se ⊖ = ●, edhe atë të *Botës materiale* (●), e pra mbrrijtjen e **Meta**(*matanë*)**-fizikës**.

Siç shihet qartë në këtë studim:

> **Simbolet dhe ekuacionet simbolike të Algoritmit Simbolik prestohen fare mirë për transkriptimin** (përkthimin) **në gjuhë simbolike të të vërtetave të rëndësishme të Shkencës, Fillosofisë dhe Theollogjisë**...

Le ta zgjerojmë tani bisedën për të shtuar këtu edhe diçka tjetër me rëndësi.

Sot i kushtohet një vëmendje e madhe në shkencë (Fizikë, Kozmollogji...) **Hiçit**, herë herë ndën emra të ndryshëm si *fusha e vakuumit*, si *vrimë e zezë*, por herë herë edhe troç e drejt për së drejti, si "*Nothingness*" (*hiçësi*, *hiç*...). Flitet për "*The Perfect Symmetry of Nothingness*" (Simetria e Përsosur e Hiçit), "The *Unbroken Symmetry*" (Simetria e Pathyer) dhe për Krijimin e Botës prej saj, me "thyerjen e hiçit", me thyerjen e simetrisë së tij të përsosur, të "supersimetrisë" së tij (Broken Symmetry).

Në gjuhën e Algoritmit Simbolik kjo situatë përkthehet në këtë mënyrë:

○ = *Hiçi* = **E**

($x = -x$) = *Simetria Perfekte e Hiçit* (*The Perfect Symmetry of Nothingness*)

⊖ = ($x \neq -x$) = *Thyerja e Simetrisë Perfekte të Hiçit* (*Broken Symmetry*)

Por:

$$(x \neq -x) = (x = x) = F$$

Kjo thyerje lind Botën, pasi:

$$(x \neq -x) = (x = x) = F = \bullet = \textit{Bota materiale}$$

Pra **krijimi i Botës realizohet me një Thyerje të Simetrisë të Përsosur të Hiçit** (Broken Symmetry) ose, ç'është njëlloj, siç pamë, me një kalim nga kodi ***E*** (*Unbroken Symmetry*) në kodin ***F*** (*Broken Symmetry*).

Ky kalim është një **rënie** sepse:

$$F = \bullet = ♀ \ (\textit{rënie})$$

Skematikisht, "krijimi" i Botës mund të paraqitet, siç është treguar edhe gjetiu* si:

E (○) (Unbroken Symmetry)
↓
F (●) (Broken Symmetry)

Por ne kemi parë se të gjitha mitet kozmogonike (Botëlindëse) reduktohen që të gjitha pa përjashtim tek kjo skemë.

Që këndej një **pikë takimi** (ndër të shumtat) mes mendimit mitik dhe atij të shkencës së kohës sonë.

Vërejmë së fundi se një gjë e tillë (krijimi i Botës me anë të një *thyerjeje*, me anë të një *ndarjeje*) pasqyrohet drejtpërsëdrejti në Gjuhë.

Kështu p.sh. në gjermanisht **brechen** (*thyej*) ndërsa *Auf* **bruch** (dhe është gjithë po ajo rrënjë) = *thyerje; fillim*. Dhe me qënë se Gjuha referon, siç e dimë (shih *Hyrjen*) gjithmonë tek Qëndra dhe tek ngjarja më e rëndësishme atje, siç është krijimi i Botës, ne shikojmë se si edhe gjermanishtja e lidh krijimin e Botës

---

* Shih *Hyrjen* si edhe *P.Sh.A.S*

me një "thyerje" (të ○, e pra të simetrisë të përsosur të *Hiçit*).

Të njëjtën gjë gjejmë edhe në shqip, ku:

thymje = ⦶ = $(x = x)$ = $-(x = -x)$ = $(x \neq -x)$

dhe

theme*lim* = ●

Në shqip gjithashtu **nda**rje (⦶) dhe **ndë**rtim (●).

Në shqip gjithashtu **nda**rje dhe **ndr**eqje.

Në rusisht **de1its** (*делить*) = *ndaj,* dhe **de1ats** (*делать*) = *bëj.*

E kështu me radhë, e kështu me radhë...

c. *Një ballafaqim i drejtë për drejtë i Algoritmit Simbolik me Mendimin Mitik*

Ne e kemi ndërtuar Algoritmin Simbolik në një mënyrë krejt deduktive, duke u nisur nga disa premisa shumë të përgjithshme mbi mendimin mitik, siç është për shëmbull përkufizimi i Cassirer i këtij mendimi, etj., etj. Duke bëre këtë ne kemi mbrrijtur në rezultatet që dimë dhe që më tej na shpunë në zbulimin tepër të rëndësishëm të *pranisë të Algoritmit Simbolik në Gjuhë si edhe në fusha të ndryshme të Dijes*[*].

Po ne kemi bërë edhe më tepër se kaq: i kemi krahasuar përfundimet tona me një sërë të dhënash faktike të mendimit mitik (a simbolik) ashtu siç i shohim të parashtruara ato në libra që i kushtohen posaçërisht atij, siç është libri i famshëm tashmë i J.E. Cirlot "*A dictionnary of symbols*", nga i cili kemi cituar kaq herë.

Ky ballafaqim ka rikonfermuar plotësisht saktësinë e përfundimeve tona.

Le të rikujtojmë shkurtimisht, duke i rreshtuar përmbledhurazi ato këtu, disa prej tyre:

MENDIMI MITIK dhe

1. Përcaktimi i tij si një *mendim akauzal* (Cassirer, *Pjesa e parë* e këtij studimi, fq. 106, 110, 146, 158; *Pjesa e dytë*, fq. 23) dhe si *mendim ąllogjik* (Levy Brühl) (*Pjesa e dytë*, fq. 23, 86)

2. Pozimi i *Qëndrës* dhe vetitë e saj (*Pjesa e parë* e këtij studimi, fq. 117, 121, 147, 158, 164, 167) (Cirlot, *Centre: Pjesa e parë* e këtij studimi fq. 71, 99; *Pjesa e dytë* fq. 24, 25, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 39, 41, 43, 44, 47, 48, 49, 50, 58, 83, 84, 89; Cirlot, *Pjesa e dytë* fq. 47, 48, 49, 51,

---

[*] Shih *Hyrjen*.

53, 73)

3. Identifikimi i Qëndrës me **Pikën** (shih pikën 2)
4. Tabula Smaragdina (*Pjesa e parë* e këtij studimi fq. 159, 160; *Pjesa e dytë* fq. 32, 33).
5. Simbolizmi i numrit ***2*** (*Pjesa e parë* e këtij studimi fq. 94; *Pjesa e dytë* fq. 358).
6. Simboli i **nyjes** (*Pjesa e parë* e këtij studimi fq. 99; *Pjesa e dytë* fq. 52).
7. Mitet kozmogonike (*Pjesa e parë* e këtij studimi fq. 82; *Pjesa e dytë* fq. 83, 89, 150, 153, 154, 156, 157, 165, 181, 324, 357, 376).

.....

Le të shtojmë mbi këto të gjitha edhe diçka tjetër:

a) Mendimi mitik pozon:

Qëndra = pika (gjeometrike)

Lexojmë lidhur me këtë tek Cirlot (fq. 260):

" The point signifies unity, the Origin and the Centre".
(Pika do të thotë unitet, Origjinë dhe Qëndër).

Algoritmi Simbolik, jo vetëm që e pasqyron këtë të dhënë por edhe e vërteton llogjikisht atë, sepse kemi:

Algoritmi Simbolik: $\boldsymbol{E} = (\boldsymbol{x} = -\boldsymbol{x}) = (\boldsymbol{x}^2 + \boldsymbol{y}^2 = \boldsymbol{0}) = pika$

Tek Cirlot (fq. 25) lexojmë:

(Binary...) "... As Schneider has observed, the eternal **duality** of nature

means that no phenomena can ever represent a **complete** reality, but only one **half** of a reality".

(...Schneideri vëren se, **dualiteti** i përjetshëm i Natyrës nuk do të thotë gjë tjetër veçse që asnjë fenomen nuk mund të paraqes një realitet të **plotë**, por vetëm **gjysmën** e realitetit).

Sipas Algoritmit Simbolik kemi:

$$\textit{Phenomena} = \boldsymbol{F}$$
$$\textit{Noumena} = \boldsymbol{E}$$

Kemi gjithashtu:

$$\boldsymbol{F} = \bullet = -\bigcirc = \textit{non complete} = \circledcirc = \tfrac{1}{2} \cdot \bigcirc =$$
$$\textit{one half } (\tfrac{1}{2}) \textit{ of a complete } (\bigcirc) \textit{ reality}$$

E ja pra kështu ne shohim se edhe kjo e dhënë e mendimit mitik, sipas të cilës fenomenet e Natyrës paraqesin një realitet të mangët, një gjysëm realitet, është edhe ajo e pranishme në Algoritmin tonë Simbolik.

Dhe së fundi, duke dalë qëllimisht nga tema, shtojmë lidhur me simbolizmën e *nyjes* dhe të *Qëndrës* (në përputhje të plotë me të dhënat faktike të mendimit mistik) edhe sa vijon:

a) Në Ungjill* Krishti thotë:

"*Do të njihni të vërtetën dhe e vërteta do t'u bëjë juve të lirë*"

Me qënë se **e Vërteta** është *Zoti* vetë (e Vërteta absolute, e Vërteta paradigmatike, e vërteta "par excellence") e pra *Qëndra*, e pra $(\boldsymbol{x} = -\boldsymbol{x})$ e pra $\bigcirc$, ne mund të shkruajmë:

$$\textit{e Vërteta} = \bigcirc$$

---

* Ungjilli, Gjoni 8:32.

dhe nga ana tjetër *liria* = $-\aleph$. Pra e thëna e Krishtit përkthehet në Gjuhën e simboleve tona si:

$$\underset{\textit{e Vërteta}}{\bigcirc} = \underset{\textit{liria}}{-\aleph^{*}} \qquad \text{...(E)}$$

Ky ekuacion përkthen edhe një të thënë tjetër të rëndësishme nga Ungjilli: "*Atje ku është Fryma e Perëndisë atje është dhe liria*". (Në latinisht: *Ubi Spiritus Domini, ubi libertas* (II Korinthianët, 3:17)). Edhe këtu, me qënë se *Fryma e Perëndisë* = ○, përkthimi jep të njëjtin ekuacion simbolik si më sipër.

Me qënë se ○ = *e Vërteta* por edhe *Qëndra*, *Parajsa*[**], e thëna e Krishtit në Ungjill lidhet esencialisht me *mungesën e ligjit* ($-\aleph$) *në Parajsë* (○), siç lexojmë edhe në simbolizmin e Qëndrës tek Cirlot (shih *Pjesa e dytë* fq. 45)

Në Ungjill (Galatët 3:13) shën Pali thotë: "*Krishti na shpëtoi nga mallkimi i Ligjit*", pra Krishti bëri për neve, në gjuhën e simboleve $-\aleph$, na bëri, e thënë ndryshe, të meritojmë *Parajsën* (○).

b) Në Fizikën kuantike, në subatomikun e thellë, koncepti i Ligjit bie. Pra edhe atje kemi $-\aleph$. Që këndej (posë shumë arsyesh të tjera) shtyhemi detyrimisht, *llogjikisht* të mendojmë se **subatomiku i thellë ka vetira të ngjashme me ato të Parajsës**, dhe rikujtojmë përsëri e përsëri me këtë rast të thënën e Teilhard de Chardin: *Dans le coeur de la Matière il y a l'Esprit*,[***] që në gjuhë simbolike përkthehet siç dimë:

$$\bullet = \boxdot \qquad \text{...(F)}$$

Dhe me qënë se, sipas Algoritmit Simbolik, mund të shkruajmë ($\bullet = \aleph$) dhe ($\circ = -\aleph$), ekuacioni i mësipërm mund të shkruhet edhe si:

---

* Lidhur me simbolin $-\aleph$ si dhe me ekuivalencat e tij me simbole të tjerë të rëndësishëm, si bie fjala me simbolin ○ shih edhe *Pjesën e parë* e këtij studimi fq. 109, 110, 113; dhe *Pjesën e dytë* fq. 51, 54, 68, 72, 73, 77, 85).

** Cirlot, fq. 249: "**Paradise Lost** Symbolic of the mystic "Centre"..." (*Parajsa e humbur simbolizon Qëndrën mistike...*)

*** Shih edhe *Pjesën e parë* e këtij studimi fq. 115.

$$\text{Ꝺ} = \boxed{-\text{Ꝺ}} \qquad \text{...(F)}$$

Pra:

në këtë Botë (●) *ka ligje, ka domosdoshmëri* (Ꝺ),
ndërsa **në Botën tjetër**, *Qiellore* (e vetëm atje) (○),
ligjet bien dhe *ka Liri* (–Ꝺ)

Zgjidhet kështu pra rrjedhimisht problemi fillosofik kaq shumë i diskutuar dhe stërdiskutuar, ai i **lirisë** dhe **domosdoshmërisë**.

Dhe le t'i japim fund këtu. Gjatë gjithë studimit tregohet në një mënyrë mjaft bindëse, shpresojmë, se si faktet e mentalitetit mitik janë të përkthyeshme në Gjuhën e Algoritmit Simbolik i cili i rikonfermon, i pasqyron më së miri, dhe i "vërteton" llogjikisht ato edhe duke i *universalizuar*, që do të thotë duke gjetur zbatime të rëndësishme të tyre në fusha të ndryshme të Realitetit dhe të Dijes.

Kështu pra, Algoritmi Simbolik, siç del edhe nga ky ballafaqim i drejt për drejtë, është me të vërtetë një artikullim llogjik (ndoshta i vetmi i mundur) i Mendimit mitik.

d. Algoritmi Simbolik si HOLOGRAMË

Holograma është një strukturë në të cilën një pjesë përmban të tërën dhe mund ta riprodhojë atë.

Koncepti dhe teoria e asaj që njihet me emrin PARADIGMA HOLOGRAFIKE është përhapur së tepërmi sot në shkencën moderne. E referojmë pra lexuesin që dëshiron të thellohet më shumë në këtë problematikë, tek një literaturë e bollshme në anglisht e në gjuhë të tjera mbi këtë çështje.

Këtu ne duam vetëm të tregojmë (ndonëse e kemi prekur edhe gjetiu shkarazi këtë subjekt)* se si **Algoritmi Simbolik është një Hologramë**, një sistem pra i tillë në të cilën *një pjesë mund të riprodhojë të tërën*, d.m.th. tërë sistemin.

Le të themi që në krye se kjo ka të bëjë me faktin themelor që struktura holografike lidhet (ndonëse askush gjer më sot, me sa di unë, nuk e ka vënë këtë në dukje) me një llogjikë tjetër (*Antillogjikë*), me atë të *Tertium Datur* a kod ***E***. Edhe kjo sepse, sipas një formule të këtij kodi, kemi:

$$E = (E = F)$$

dhe me qënë se $E = \bigcirc$ dhe $F = \textcircled{\scriptsize I}$, mund të shkruajmë:

$$E = (\bigcirc = \textcircled{\scriptsize I})$$

dhe duke interpretuar $\bigcirc$ = *e tëra*, e $\textcircled{\scriptsize I}$ = *pjesa*, del se në ***E***:

pjesa ($\textcircled{\scriptsize I}$) = **e tëra** ($\bigcirc$)

---

* Shih Hyrja, fq. 102.

Praktikisht kjo do të thotë se nga një formulë a ekuacion simbolik të Algoritmit Simbolik ne mund të nxjerrim "automatikisht" të gjitha formulat apo ekuacionet e tjera. Le ta ilustrojmë këtë me ndonjë shëmbull.

Marrim ekuacionin:

$$-x = \boxed{x} \qquad \text{...(F)}$$

Ne dimë se:

$$(-x = \boxed{x}) = F = \text{Ⓘ}$$

d.m.th. se formula jonë është vetëm *një* **pjesë** (Ⓘ) *e* **tërë** (○) *sistemit.*

Mund të shkruajmë, duke shumëzuar të dy anët me -1:

$$-F = -(-x = \boxed{x}) = (x = \boxed{x})$$

Pra po *ai* x *si jashtë* (x) *ashtu dhe brënda* ($\boxed{x}$). Dhe me qënë se ***koncepti i brëndësisë është i kundërt me atë të jashtësisë***, me qënë se me fjalë të tjera *jashtë* = *– brënda,* del se mund të shkruajmë këtu:

$$\underset{\textit{jashtë}}{x} = \underset{\textit{brënda}}{-x} \qquad \text{...(E)}$$

dhe me qënë se:

$$(x = -x) = E = \text{○}$$

ne mbërrijmë kështu tek *e tëra,* e cila përputhet me *Qëndrën.* Duke u nisur atëhere nga Qëndra, ne mund të gjejmë çdo formulë a ekuacion simbolik të Algoritmit Simbolik. Në këtë mënyrë dhe ne e kemi kryer ndërtimin e Algoritmit Simbolik, d.m.th. duke u nisur nga Qëndra (shih *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik*) a ç'është njëlloj, duke u nisur nga Hiçi, me qënë se ○ mund të interpretohet, ndër të tjera, jo vetëm si *Qëndra*, e *tëra*... por edhe si *Hiçi* (shih *Ndërtimi i Algoritmit Simbolik duke u nisur nga Hiçi*).

Le të marrim edhe ndonjë shëmbull tjetër.

Le të nisemi nga formula:

$$\text{Ⓘ} = \infty \qquad \text{...(F)}$$

Shumëzojmë të dy anët me -1. Do të kemi:

$$(-\oplus = -\infty) \qquad \text{...(E)}$$

ose edhe:

$$(\bigcirc = -\infty) \qquad \text{...(E)}$$

dhe rigjejmë kështu një formulë të rëndësishme të kodit ***E*** dhe të mendimit mitik (*To undo the knot is equivalent to finding the Center* - Cirlot, 173) (*Të zgjidhësh nyjen është njëlloj si të gjesh Qëndrën*).

Duke shumëzuar të dy krahët e ekuacionit të fundit me -1 dhe duke interpretuar ○ si *hiç* si *bosh* ... do të kemi:

$$(-\bigcirc = \infty) \qquad \text{...(E)}$$

$$(\bullet = \infty) \qquad \text{...(F)}$$

Dhe rigjejmë kështu një tjetër formulë të rëndësishme të kodit ***F*** si edhe të gjitha interpretimet e saja të shumta e të rëndësishme, disa nga të cilat i kemi parë.

Kaluam kështu nga *një pjesë* e Algoritmit Simbolik:

$$(\oplus = \infty) = \boldsymbol{F} = \oplus = \textit{pjesë}$$

me ndërmjetësinë e Qëndrës:

$$(\bigcirc = -\infty) = \boldsymbol{E} = \bigcirc = \textit{Qëndra, e Tëra}$$

në *një pjesë tjetër* të Algoritmit Simbolik:

$$(\bullet = \infty) = \boldsymbol{F} = \oplus = \textit{pjesë}$$

Marrim edhe ndonjë shëmbull tjetër.

Nisemi nga formula: $(2 = -1) = \boldsymbol{F} = \oplus = \textit{pjesë}$

Pjesëtojmë të to dy anët me ***2***.

Do të kemi:

$$\mathbf{1} = -\frac{1}{2}$$

ose edhe:

$$\frac{1}{2} = -\mathbf{1}$$

ose edhe:

$$(\text{◐} = -\mathbf{1}) = \mathbf{F} = \text{◐} = \textit{pjesë}$$

Kaluam kështu nga një pjesë e sistemit në një pjesë tjetër të tij, nga formula $(\mathbf{2} = -\mathbf{1})$ në formulën $(\text{◐} = -\mathbf{1})$.

Duke shumëzuar të dy anët e ekuacionit të fundit me $-\mathbf{1}$ do to kemi:

$$-\text{◐} = \mathbf{1}$$

ose edhe:

$$(\text{○} = \mathbf{1}) = \mathbf{E} = \text{○} = \textit{E Tëra}$$

Rigjejmë pra kështu të *Tërën* (Qëndrën) që nga dhe mund të gjejmë çdo pjesë (formulë) tjetër të Algoritmit.

E kështu me radhë...

Vëmë rè tani sa vijon:

1) Vetia "holografike" lidhet siç pamë me përkatësinë në kodin ***E***. Me fjalë të tjera ne gjetëm se: që *një sistem të mund të vështrohet si një hologramë, ai duhet t'i përkasë kodit* ***E****, se vetëm ai përmban relacionin*:

$$(\text{◐} = \text{○}) = (\textit{pjesa} = \textit{E Tëra})$$

2) Ne pamë praninë e Algoritmit Simbolik në Gjuhë (shih *Hyrjen*). Ne pamë gjithashtu atje se fjalët, pra dhe gjuha, referojnë tek Qëndra e pra tek kodi ***E***. Duke qënë kështu, ne arrijmë në përfundimin se edhe:

GJUHA PËRBËN NJË HOLOGRAMË

3) Fizika Kuantike pozon në themel të saj *Parimin e Papërcaktueshmërisë*. Ai shkruhet simbolikisht, siç dimë:

Fizika Kuantike: *Parimi i Papërcaktueshmërisë* = $-\Phi$

mirëpo:

$$-\Phi = E$$

Kjo do të thotë atëhere se edhe *sistemi i Fizikës Kuantike përbën një hologramë*. Pra *nga* ***një pjesë çfarëdo*** (*parim, ligj, propozicion*, "fakt"...) *e Fizikës kuantike* ne *mund të* ***gjejmë çdo pjesë tjetër të saj***. Duke vepruar p.sh. në këtë mënyrë:

Fizika Kuantike = $-\Phi = E = \bigcirc = -\leftrightarrow = (x = -x)$
$= -\sim = -\aleph = -\bullet = (s = 0,\ t = 0) = \ldots$

Pra:

Parimi i *Papërcaktueshmërisë* (*Uncertainty Principle*) = $-\Phi$ =
Parimi i *Pandarshmërisë* (*Inseparability Principle*) = *Hiçi* (*Nothingness*) $(-\bullet)$ = Llogjika e *Tertium Datur* (Heisenberg dhe Weiszacker) $(x = -x)$ = *Akauzaliteti* $(-\leftrightarrow)$ = *mos lëvizja* $(-\sim)$ = *rënia* e konceptit klasik të *Ligjit* $(-\aleph)$ = *fusha a vakuumit* $(\bigcirc)$ = *Parimi i mos lokalizimit* $(s = 0)$ = *"Fizika pa kohë"* (*Timeless Physics*) $(t = 0)$ = ...

4) Dimë se Inkoshienti nuk bën dallim mes të kundërtave (shih *Hyrjen*, dhe citatin nga Otto Rank*).

Kjo do të thotë atëhere se mund të shkruajmë:

$$Inkoshienti = (x = -x) = E$$

Pra kështu edhe:

INKOSHIENTI PËRBËN NJË HOLOGRAMË

---

* Otto Rank, shih fq. 145.

Rikonferma "të tepërta" të këtij përfundimi:

a) Jacques Lacan*, psikollog, fillosof dhe linguist i shquar frëng i kohës sonë provoi se:

"L'Incoscient est articulé comme un language".
(Inkoshienti është i organizuar si një Gjuhë).

Po ne pamë se Gjuha përbën një hologramë, pra atëhere edhe *Inkoshienti përbën një Hologramë.*

b) Jungu, një psikollog i shquar, në bashkëpunim të ngushtë me Paulin, një fizikant i shquar, zbuluan anallogjira të thella mes *Teorisë së Inkoshientit* dhe *parimeve themelore të Fizikës Kuantike.*

Ata gjetën përfundimisht kështu një **izomorfizëm** strukture mes Inkoshientit dhe subatomikut të thellë.

Por ne pamë se:

Fizika Kuantike = Hologramë

kjo do të thotë atëhere se:

Inkoshienti = Hologramë

Ne kemi folur këtu dhe atje në këtë studim për "Les sciences des

---

* **Jacques-Marie-Émile Lacan** (1901 -1981) psikanalist dhe psikiatër i shquar frëng. Vepra e tij i detyron shumë Frojdit. Por ai shfrytëzoi dhe shumë burime të tjera informacioni nga fusha të ndryshme të Dijes, duke përfshirë këtu edhe **gjuhësinë**, **fillosofinë** dhe **mathematikën**.

Karakteri interdishiplinar i veprës së tij e ka bërë atë një figurë të ndritur si shkencëtar, fillosof dhe psikollog i madh i Kohës sonë.

Sipas idesë qëndrore të veprës së tij, njeriu është një krijesë e mënyrës së përdorimit prej tij të gjuhës. Duke u nisur nga kjo tezë, Lacani i shtjellon më tej studimet e tij mbi psikanalizën. Vepra e tij vazhdon të ushtrojë, edhe sot e kësaj dite, një ndikim të madh mbi zhvillimin e psikanalizës në tërë botën. Në Francë e gjetkë janë ngritur tani "shkolla" të ndryshme që mirren me përpunimin dhe shpënien më tej të mendimit lacanian. Që të gjitha këto shkolla, pamvarësisht veçorirave të tyre specifike, pranojnë unanimisht rëndësinë themelore të Inkoshientit, i cili, sipas Lacanit, duke i artikulluar në një gjuhë të përshtatshme dëshirat e folësit, shndërrohet në një përcaktues vendimtar të modalieteve të tija jetike.

profondeurs" (Shkencat e thellësive), që janë shkenca që arrijnë gjatë zhvillimit të tyre thellësira ekstreme, si ndër të tjera Fizika Kuantike, Psikollogjia Analitike e Jungut etj., e kështu me radhë. Është pikërisht ndër to që vihet rè fenomeni, tepër aktual sot, i **interdishiplinaritetit**, d.m.th. i afrimit të tyre me njëra tjetrën gjer në shkallën pothuajse të një identiteti strukture që e bën të lehtë kalimin nga njëra tek tjetra, siç qe rasti që përmendëm më sipër ndërmjet Fizikës Kuantike dhe Psikollogjisë Analitike të Jungut. E pra, pas tërë atyre që u parashtruan këtu, ne mund të mbrrijmë fare mirë në përfundimin se *shkencat që arrijnë këtë shkallë zhvillimi janë ato që bëhen të përfshijshme në kodin* ***E*** *dhe formojnë*, rrjedhimisht, *sisteme holografike*.

❖ ❖ ❖

Nga një literaturë e bollshme dhe aktuale, kemi përmbledhur këtu në një mënyrë disi të thjeshtuar e fragmentare sendet më themelore mbi atë që quhet sot *Paradigma Holografike* që përbën ndoshta **revolucionin më të madh mendor të kohës sonë**.

"Modeli holografik përbën një nga themelet kryesore të shkencës së rè holistike dhe të paradigmës holistike. Duke u nisur nga disa të dhëna thjesht fizike e mathematike, ai i shtrin e i zgjeron interpretimet e tij mbi tërë Realitetin fizik, material dhe në të gjitha dimensionet e koshiencës (vetëdijes). *Modeli holografik ngrihet mbi konceptin e një infomacioni global që lidh pjesën me të tërën*: pjesa bëhet një hologramë e të tërës me qënë se përmban mbrënda vetes të saj një paraqitje (përfytyrim) global të të tërës nga e cila rrjedh. Një gjë e tillë nënkupton një marrëdhënie informative të pareshtur, koherente dhe dinamike ndërmjet pjesës dhe të tërës.

Të *gjitha paradigmat mbi të cilat mbështetet shkenca janë në analizë të fundit* ***materialiste*** *dhe nuk nënkuptojnë* (implikojnë) *ekzistencën e ndonjë dimensioni tjetër përveç atij fizik dhe objektiv.*

Modeli holografik përkundrazi nënkupton, me sa duket, një kompleksitet teorik dhe një *thjeshtësi intuitive* të tillë sa që ta bëjë atë të domosdoshëm për të shpjeguar e kuptuar edhe shkencërisht një pjesë të madhe të marrëdhënieve mes Njëshit dhe të Tërës."

Tek holograma kemi *pjesën në të Tërën dhe të Tërën në pjesën.*

"Holograma lind nga *lazeri.* Për ndërtimin e një hologrami një tufë rrezesh lazer dërgohet në një gjysëm pasqyrë që e ndan atë në dy tufa identike. Tufa e parë mbetet e pastër, e pa përzier, kurse tufa e dytë projektohet mbi objektin që do të "fotografohet" dhe që e modifikon atë duke e reflektuar. Më pas të dy tufat, tufa e pastër dhe ajo e modifikuar, bashkohen dhe impresionojnë pllakën holografike mbi të cilën mbërrijnë kështu një tufë e pastër dhe një tufë e modifikuar nga objekti. Ndërmjet këtyre dy tufave ndodh fenomeni i interferencës që shfaqet mbi pllakën holografike në trajtën e disa rrathëve koncentrikë pa një kuptim të dukshëm. Po ja që këto vija interferenciale përmbajnë tërë informacionin tri-dimensional të objektit të fotografuar. Duke dërguar një tufë rrezesh të pastra lazer mbi pllakën e impresionuar përftohet një imazh (përfytyrim) tri-dimensional i objektit të fotografuar. Ky tridimensionalitet i detyrohet koherencës së tufës lazer. Por holograma ruan edhe surpriza të tjera. Ndryshe nga një film i zakonshëm fotografik në të cilin çdo pjesë përmban vetëm një pjesë të imazhit, pllaka e hologramës përmban tërë imazhin gjer në çdo pikë të tij: po ta thyejmë atë në qindra copa ne do të kemi të riprodhuar në çdo copë tërë imazhin. Disa veçantira e detaje humbasin vërtet por objekti do të na shfaqet me tërë tërësinë dhe unitetin e tij. Pra, çdo pikë e hologramës përmban, në një rend të përsosur tridimensional, çdo informacion mbi objektin.

Kështu pra modeli holografik është në esencë një *model informacioni global,* një *model universal,* i fuqishëm dhe pjellor."

Le të shohim tani më nga afër pas kësaj citate lidhjen e Paradigmës Holografike me kodin ***E*** të Algoritmit tonë Simbolik.

Ne kemi parë se:

$$\text{⦶} = \boxed{\circ} \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

Mund të interpretojmë $\circ$ = *e Tëra* e pra atëhere ⦶ = *një pjesë e të Tërës* ose, duke e shprehur këtë ndryshe, "Pjesa në të Tërën".

Nga ana tjetër $\boxed{\circ}$ do të mund të interpretohej si :

"*e Tëra* ($\circ$) *në* ($\square$) *pjesën* (⦶)"

Algoritmi Simbolik na jep gjithashtu:

$$E = (E = F)$$

ose edhe:

$$\bigcirc = (\bigcirc = \textcircled{\scriptsize I})$$

e pra atëhere *sipas pikëvështrimit të Qëndrës* (Zotit): "*Pjesa* (Ⓘ) *është e barabartë me të Tërën* (◯)", e pra atëhere edhe *Pjesa mund të riprodhojë të Tërën.*

Kështu pra që Algortimi ynë Simbolik, e kodet e tij ***E*** *dhe* ***F****, mund të vështrohet si një paradigmë e mirëfilltë holografike.* Jo vetëm, por ne mund të themi edhe me plot të drejtë se **Algoritmi ynë Simbolik është bash Gjuha e Paradigmës Holografike**: *çdo gjë që ka të bëjë me hologramën lidhet drejt për së drejti me Algoritmin tonë Simbolik.* Të gjitha vetirat e çuditshme, të jashtëzakonshme të Paradigmës Holografike mund të "parallogariten" me anën e Algoritmit tonë Simbolik. Kështu ne treguam gjer këtu se si kjo veti themelore e Paradigmës Holografike "Pjesa në të Tërën dhe e Tëra në Pjesën" mund të deduktohej fare lehtë nga Algoritmi ynë Simbolik.

Le të shohim se si mund të deduktohet edhe ndonjë "fakt" tjetër holografik.
Ne dimë se ***E*** është *kodi i thellësisë*, ndërsa ***F*** është ai *i cektësisë.*
Ne dimë gjithashtu se:

$$F = (\textcircled{\scriptsize I} \neq \bigcirc)$$

domethënë se në kodin ***F*** (që është, mos të harrojmë kodi i: **a**) cektësisë, façjatës së realitetit... **b**) i arsyes njerëzore, i llogjikës formale, i mendimit racional, i mendimit shkencor (shkenca klasike)), pjesa nuk është e barabartë me të tërën, pjesa nuk mund të riprodhojë të tërën; pra në këtë nivel që është ai i mendimit racional, i shkencës klasike, nuk ekziston kurrfarë paradigmë holografike.

Për këtë gjë ne lexuam dhe në citatin e riprodhuar më sipër:

> "Të gjitha Paradigmat mbi të cilat shkenca mbështetet janë, në një mënyrë a në një tjetër, materialiste, ato nuk implikojnë ekzistencën e ndonjë dimensioni tjetër veç atij fizik, objektiv..."

Po:

materializëm = *materie* = ● = F = $-E$ = ($\oplus \neq \bigcirc$) = jo paradigëm holografike = ($x = x$) = arsyeja = mendimi racional, shkencor, racionalizmi i Shkencës klasike...

Pra *Shkenca* (klasike) del se është *materialiste* edhe sipas Algoritmit tonë Simbolik, del se ajo *nuk e njeh dimensionin* E, se ajo nuk e njeh Paradigmën Holografike...

Kjo pra do të thotë edhe një gjë tjetër: se Shkenca e rè, mendimi i ri holografik shënon, ndër të tjera, *triumfin e Idealizmit mbi Materializmin.*

Vijojmë më tej me konfrontimin e vetirave të Paradigmës Holografike me ato të Algoritmit Simbolik.

Lexojmë në tekstin që po citojmë:

> "...Jemi në fillim të një epoke të rè zbulimesh. **Takimi mes shkencës dhe misticizmit** do të hapi të tjera mundësira dhe do të çlirojë potencialitete që është vështirë të mirren me mënd... Mund të parashikojmë diçka nga e ardhmja duke i marrë seriozisht aftësitë e jashtëzakonshme me të cilat qënë pajisur *jogët* e lashtë dhe *mistikët* e të gjitha kohërave..."

Po Algoritmi ynë Simbolik është pikërisht artikullimi llogjik i mendimit *Mistik*!... dhe nga ana tjetër ne pamë me shëmbulla të bollshme dhe të gjithanshme gjatë gjithë këtij studimi praninë e tij në Fizikën moderne, në fillosofi etj.

Më tej në tekst:

> "Fizikanti David Bohm thotë se Holograma është pikënisje për një përshkrim të rì të Realitetit, për atë që ai e quan *Rendi i Implikuar* (angl. *Implicate Order*)."

Bohmi dallon dy rende, njëri i jashtëm, i dukshëm, i cekët që përputhet me realitetin e prekshëm material, të cilin ai e quan *Explicate Order* dhe që nuk është gjë tjetër veçse kodi ynë F (realitetit ynë material, arsyeja njerëzore, ...) dhe *Implicate Order* që është një "realitet" (jo material) jo i dukshëm, jo i prekshëm, i thellë, i përfshirë, i "groposur" në të parin dhe i cili i përgjigjet Paradigmës Holografike. Ky model (the *Implicate Order*) iu desh Bohmit për të shpjeguar gjërat

e çuditshme, "absurde" (nga pikëpamja e llogjikës së vjetër, të zakonshme...) që ndodhin në Fizikën Kuantike, si ndër të tjera Parimin e Pandashmërisë (Inseparability Principle) e kështu me radhë. Por *Implicate Order* nuk është tjetër veçse kodi ynë E:

Rikujtojmë këtu nga Alg. Simb. këto dy formula:

$$E = \sqrt{F}$$

(kodi E është rrënja e kodit F)

$$F = \boxed{E}$$

(kodi E përfshihet, fshihet, është i "groposur", i "implikuar" në kodin F)

Posë kësaj, ne thamë se kodi E është një hologramë, kurse kodi F jo. Pra përputhjet:

$$F = \textit{Explicate Order} \quad \text{dhe} \quad E = \textit{Implicate Order}$$

janë të plota.

Le të vijojmë më tej me argumentime e shëmbuj të tjerë që vërtetojnë lidhjen e padiskutueshme të Algoritmit tonë Simbolik me Paradigmën Holografike.

Mund të shkruajmë nga sa thamë më sipër:

$$\textit{The Implicate Order}\ (\text{D. Bohm}) = \textit{Fizika Kuantike}\ (\text{N. Bohr}, \ldots)$$

Kjo do të thotë se Implicate Order është një modelim (i supozuar tërëshpjegues) i Fizikës Kuantike. Por tani:

Heisenbergu dhe Weiszacker propozojnë për të shpjeguar "absurditetet" e Fizikës së Rè, një llogjikë tjetër, atë të *Tertium Datur*, e pra $(x = -x)$, e pra E.

Pra edhe kështu del se:

$$\textit{Implicate Order} = \textit{Holographic Paradigm} = E$$

Ne kemi parë që çdo pjesë e Fizikës Kuantike mund të reduktohet (mund të bëhet të korrispondojë) me këtë apo atë veti, me këtë apo atë figurë simbolike të kodit E...

Le të rikujtojmë disa raste:

Parimi i Papërcaktueshmërisë = $-\oplus = \bigcirc = E$

Parimi i Pandashmërisë (Inseparability Principle) = $-\oplus = \bigcirc = E$

Fusha e vakuumit = $-\bullet = \bigcirc = E$

Akauzaliteti = $- \leftrightarrow = E$

E kështu me radhë...

Nga sa më sipër del edhe një herë në mënyrë të padiskutueshme ekuacioni "analogjik":

E = *Fizika Kuantike* = *Implicate Order* = *Holographic Paradigm*

Duke qënë kështu, siç u tha edhe më parë:

> **Ne jemi në gjëndje të deduktojmë, nga një analizë e thellë dhe nga interpretime të përshtatura të figurave simbolike në E, të gjitha vetitë e Paradigmës Holografike e, bashkë me të, edhe ato të Fizikës Kuantike e të Implicate Order.**

Por edhe anasjelltas: Njohja e Fizikës Kuantike, e Paradigmës Holografike e të Implicate Order, na ndihmon neve të "pikasim" vetira (interpretime) të reja të figurave simbolike në E dhe të ekuacioneve të ndryshme simbolike në këtë kod.

Dhe le të vijojmë tani më tej me të tjera e të tjera vetira të Paradigmës Holografike.

Lexojmë pra në tekstin që po citojmë:

> "Në një konferencë në Huston, Karl Pribram tha se "rrojmë në epokën e një ndryshimi të paradigmës që do të përhapet e do të shtrihet në të gjitha shkencat... Teoria (e rè) do të jetë në gjëndje të shpjegojë të gjitha ato fenomene që duket se *vijnë në kundërshtim me ligjet* e sotme në Shkencë, duke provuar se kufizimet mbi të cilat ato (ligjet) mbështeten janë "ngrehina" të mekanizmave tona

perceptuese. Fizika teorike ka demonstruar tashmë se ngjarjet në nivelin subatomik nuk mund të përshkruhen me terma mekanike."

"Pribram ka grumbulluar gjatë kërkimeve të tij shumëvjeçare prova të pakundërshtueshme se *struktura e* ***thellë*** *e trurit është holografike*, se ajo funksionon me fjalë të tjera në një mënyrë analloge me procesin fotografik pa lente që i dha Dennis Gaborit (zbuluesit të hologramës) çmimin Nobel."

"Një veti e çuditshme si e hologramës ashtu edhe e trurit është *shpërndarja e informacionit mbi tërë sistemin:* çdo pjesë, sado e vogël qoftë, është kodifikuar në mënyrë të tillë *që të mund të riprodhojë informacionin e të tërës.*"

"Përfytyrimet e trurit, abstraksionet e tij mund të jenë identike me një gjëndje të Gjithësisë. Pribram thekson e vlerëson gjithashtu intuicionet e jashtëzakonshme *të mistikëve dhe fillosofëve të lashtë,* shumë kohë para provave shkencore gjatë shekujve që erdhën pas. Një shëmbull ndër të shumtët është *përshkrimi metafizik i* ***Gjëndrës Pineale*** *si një sy i tretë.* Kohët e fundit është gjetur që pinealeja mund të jetë një *supergjëndër*, dhe kjo sepse sekretimi, nga ana e saj, i melatoninës shërben si një rregullator i veprimtarisë së gjëndrës pituitare që vështrohej gjer sot si gjëndra kryesore e trurit."

(Shih lidhur me këtë çështje edhe faqet 116, 424)

"Çdo aspekt i Universit përmban informacion mbi tërë Universin."

"Mbrënda modelit holografik *koha nuk ekziston* si një varg çastesh që vijnë njëri pas tjetrit në mënyrë lineare, nga "tani" në "pastaj". Del gjithnjë më e sigurt se *është intelekti ynë ai që na mban lidhur në burgun e kohës*... Çdo çast o aspekt i kohës duket se mund të ekzistojë kudo e përgjithmonë."

"Ka ekzistuar prej kohësh një konflikt i ashpër mes fesë "zyrtare" e misticizmit. Feja zyrtare kërkon që të lihet në harresë uni i brëndshëm, që t'u bindemi ligjeve, që të kryejmë ritualet, që t'u përmbahemi rreptësisht regullave shoqërore tradicionale. Kurse mistikët pohojnë me këmbëngulje që rruga drejt çlirimit të njeriut kalon përmes njohjes të vetvehtes."

"Sa më thellë të hysh në veten tënde aq edhe më shumë do të hapesh e do të

zgjerohesh. *Mbretëria e Qiejve është brënda teje. Përjetësia ekziston në çdo kokrrizë rëre.*"

"*Është hera e parë në historinë e njerëzimit që* ***shkenca dhe feja janë tashmë shokë e bashkudhëtarë*** *në aventurën e zbulimit të misterit kozmik.*"

"***Misticizmi dhe Fizika Moderne shihet se po na thonë në thelb të njëjtën gjë***... Kërkimet mbi trurin po ripohojnë gjithnjë e më shumë vizionet e paparashikueshme mistike."

"Metafora nuk ekziston!... Sipas Pribramit të gjitha metaforat janë, në një farë kuptimi, të vërteta. "Gjithshka është izomorfike" (në fillosofinë e Lindjes "si lartë ashtu dhe poshtë"). Ne po jetojmë ndoshta sot pasojat e një holograme shoqërore, një strukturë e organizuar ndërlidhjesh njerëzore..."

Le të diskutojmë pak mbi citatet e mësipërme para se të vijojmë më tej:

Në faqen 107: "...Teoria (e rè) do të jetë në gjëndje të shpjegojë të gjitha ato fenomene që duket se *vinë në kundërshtim me ligjet* e sotme në Shkencë..."

$$E = -\aleph$$

Dimë se simboli $\aleph$ mund të interpretohet gjithashtu ndër të tjera edhe si *ligj*. Pra në *kodin* E *bie koncepti i ligjit*. Por koncepti i zakonshëm i ligjit ka rënë edhe në Fizikën Kuantike, gjë me të cilën Einsteini nuk pajtohej. Janë të famshme fjalët e tij: "Unë nuk besoj se Zoti luan me zare...".

Por veç Einsteini kish pranuar rënien e Parimit të Shkakësisë (kauzalitetit) në Fizikën Kuantike, duke e cilësuar këtë të fundit (parimin e kauzalitetit) vetëm si një formë (ndërtim, "ngrehinë") të sistemit teorik (shih edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi, fq. 109).

Me qënë se *rënia e parimit të shkakësisë* mund të tregohet me $-\leftrightarrow$ dhe me qënë se *rënia e ligjit* mund të tregohet me $-\aleph$, dhe me qënë se:

$$-\leftrightarrow = E = -\aleph$$

Einsteini duke pranuar $-\leftrightarrow$, do të duhej të pranonte llogjikisht edhe $-\aleph$, do me thënë *rënien e konceptit të ligjit në Fizikën e Rè Kuantike* gjë që ai nuk e bëri **duke**

rënë pra kështu në kontradiktë llogjike me veten e tij.

Po le të vëmë rè këtu se simboli ⋈ mund të interpretohet edhe si *relativitet.* E pra atëhere $-\bowtie$ do të interpretohej si *jo relativitet, jo Teori e Relativitetit*, superimi i Teorisë së Relativitetit në Fizikën e Rè Kuantike.

Ndaj pra, *duke pranuar rënien e Parimit të Kauzalitetit në Fizikën e Rè, Einsteini do të duhej të pranonte jo vetëm rënien e ligjit por edhe rënien (superimin!) e Teorisë të Relativitetit në Fizikën e Rè, gjë kjo që do të ngjante së tepërmi, për Einsteinin, me një* ***vetëvrasje*** *teorike.*

Në tekstin e cituar ("...Në një konferencë në Huston, Karl Pribram...", fq. 110) thuhej ndër të tjera se ligjet nuk janë tjetër veçse ca "ngrehina" intelektualiste (të prodhuara nga intelekti).

Le ta provojmë edhe këtë me anë të Algoritmit tonë Simbolik:

$$\textit{Intelekti} = \textit{arsyeja} = (x = x) = F = \leftrightarrow (\textit{parimi i shkakësisë}) = \bowtie (\textit{koncepti i ligjit})$$

Del pra atëhere se vërtetë koncepti i ligjit (⋈) është vetëm një "ngrehinë" intelektualiste ($x = x$), ose, sikundër shprehet teksti që po citojmë, vetëm një ngrehinë e mekanizmave tona perceptuese....

Shohim pra se si Algoritmi ynë Simbolik edhe në këtë pikë, sikundër edhe në çdo pikë tjetër, arrin në rezultate identike me ato të Paradigmës Holografike.

Por Algoritmit ynë Simbolik, për një që di ta lexojë, ta interpretojë në mënyrë të gjithanshme e ta kuptojë thellë, thotë edhe shumë më shumë.

Dhe ja se si.

Mund të shkruajmë:

$$\textit{Intelekti} = \textit{Arsyeja} = \textit{llogjika formale} = (x = x) = F = -\bigcirc = \bullet = \textcircled{1} = (\textcircled{1} \neq \bigcirc) = \leftrightarrow = \boxed{\bigcirc} = \bowtie = \wr\!\wr = (s \neq \circ, t \neq \circ) = \sim = (x \neq -x) = -(x = -x) = -E = \ldots$$

Duke interpretuar figurat simbolike në F, sipas rrezeve të tyre semantike, ne arrijmë ndër të tjera edhe në këto përfundime që pajtohen me të dhënat e Paradigmës

Holografike:

1) Tërë Bota materiale (●) mund të vështrohet si një krijim i arsyes njerëzore ($x = x$), i Mendimit njerëzor (të deritanishëm).

2) Kjo Botë materiale e krijuar nga intelekti, arsyeja njerëzore ($x = x$), na lidh ne si *individë* (⏀) me *ligje* (⋈), na e *burgos* "Unin" tonë hyjnor, shpirtin, Frymën ... (⧈) në *kohë* ($t \neq o$) dhe në *hapësirë* ($s \neq o$), (kjo mund të shkruhet pra simbolikisht si: ⏀ = ⋈ = ⧈ = ($t \neq o$), ($s \neq o$) dhe të lexohet si:

Unë si *individ* (⏀) jam i *burgosur* shpirtërisht, në Unin tim të *thellë* (⧈) në *kohë* dhe në *hapësirë* (($t \neq o$), ($s \neq o$)), jam i lidhur me *ligje* (⋈)).

3) *Bota materiale* (●) *nuk ndjek Paradigmën Holografike* (⏀ ≠ ○)...

4) Gjithshka në *Botën materiale* (●) është e **ndarë** nga njëra tjetra (⏀), gjithshka në Botën materiale është pra *fragmentare* (⏀) .

5) *Arsyeja njerëzore* ($x = x$) mund të modelohet sipas materies dhe *Botës materiale* (●). Me fjalë të tjera, ekziston një izomorfizëm që lidh mendimin njerëzor (racional) me materien dhe *botën materiale* (●). Dhe rigjejmë kështu të thënën e Spinozës: "*Ordo rerum = ordo ideorum*". Në këtë përfundim ka arritur edhe Fillosofia e kohës sonë.

Në faqen 112 lexojmë: "Metafora nuk ekziston !... ".
"Komenti" ynë është ky. Ne kemi parë se:

$$E = (x = -x) = -(x = x) = -jo\ llogjika\ formale =$$
$$Antillogjika = \textbf{Anallogjia}$$

Po të thuash *anallogji* a të thuash *metaforë* është pak a shumë, në thelb, e njëjta gjë. Pra deri sa Algoritmi Simbolik me kodin e tij E punon me *anallogjira* (anallogjia si themel i mendimit simbolik e pra dhe i Algoritmit tonë Simbolik...) kjo do të thotë se për të ekzistenca e një raporti anallogjik flet për një barazim, për një identifikim pra të të dy entiteteve analloge. Ato, këto dy entitete, mund të quhen

izomorfe (fjalë greqisht që do të thotë *formë e barabartë*). Mund të thuhet edhe se ato "korrespondojnë" në kuptimin Baudlerian të fjalës (shih, *P.Sh.A.S.*).

Izomorfizmi si *identitet strukture* ndeshet në studimin tonë edhe në "takimet"(shih në *P.Sh.A.S.*). Kështu për shëmbull, tek ekuacioni simbolik në ***F***: (● = ☓) takohen, siç kemi parë: ***a***) Miti kozmogonik i Hieros Gamos; ***b***) E thëna e Krishtit në Ungjill ("Kush mëkaton bëhet skllav i mëkatit"); ***c***) Shpjegimi i inercisë nga ana e Ernst Mach; ***d***) Relativiteti i masës në Teorinë e Relativitetit. E kështu me radhë.

Natyra e këtij takimi mund të vështrohet si një identitet simbolik, a esencial, a anallogjik, e pra si një *izomorfizëm*.

> "...Fillosofia e Lindjes ka depërtuar në mendimin e Perëndimit edhe në të kaluarën... *Fryma e infinitit mund të bëhet pjesë e kulturës sonë dhe të rreshti së qënuri më* "diçka e jashtëzakonshme" ".

Dimë se Mendimi i Lindjes lidhet me kodin ***E*** (Mendimi mistik), ndërsa ai i Perëndimit, me kodin ***F*** (mendim racional, shkencor).

Por kemi, në bazë të Alg.Simb. (shih *P.Sh.A.S.*):

$$F = -[\infty]$$ e pra *jo infinit, jo frymë e infinitit*

Kurse:

$$E = \infty$$ e pra *Infinit, Fryma e infinitit*

"*Misticizmi dhe Fizika Moderne...*" (shih fq. 112)

Ne pamë mundësinë e artikullimit llogjik të mendimit mistik.

Ne pamë praninë e Algoritmit Simbolik në Gjuhë.

Ne pamë praninë e Algoritmit Simbolik (e pra dhe atë të Mendimit Mistik) në Fizikën Moderne.

Që këndej rrjedh krejt llogjikisht lidhja e Gjuhës me Fizikën Moderne, d.m.th. një raport izomorfizmi mes Gjuhësisë dhe Fizikës Moderne, të cilin ne e kemi vënë në dukje jo një herë e dy gjatë këtij studimi. Kështu pra **zbulimet e fundit të Shkencës rikonfermojnë saktësinë e përfundimeve tona lidhur me Algoritmin Simbolik (Mendimin Mistik), Gjuhësinë dhe Fizikën Moderne**.

"... Fushat e zbatimit të Hologramës mund të shtrihen në çdo disiplinë, që nga Fizika e gjer tek Informatika, Biollogjia, teoritë mjekësore, shoqërore e psikike të njeriut e gjer tek Kozmollogjia..."

Pamë se:

Paradigma Holografike = ***E***

Kjo do të thotë se mund të flitet atëhere për praninë e Algoritmit Simbolik në çdo fushë të Dijes dhe të çdo dimensioni të Realitetit. Pra:

Algoritmi Simbolik = Gjuhë Universale, gjuha e përbashkët e të gjitha dishiplinave...

Por ne kemi parë gjithashtu se Algoritmi ynë Simbolik, si artikullim llogjik i Mendimit Mistik, lidhet me Philosophia Perennis (shih *Pjesën e parë* të këtij studimi, fq. 98, 111), pra dhe atëhere nuk kemi përse të habitemi për karakterin e tij universal e të përjetshëm, po në atë mënyrë sikundër janë të përjetshëm e gjenetikisht të përçueshëm edhe arketipet e Jungut.

Le të vëmë rè këtu edhe se si:

Dija e Kohës sonë po përputhet në thelb me atë të kohërave më të lashta të Njerëzimit


Pra kemi një realizim të "rregullës" ($\alpha = \omega$). Ky barazim "fatal" po realizohet sot. Por, nga ana tjetër, ne dimë se:

$(\alpha = \omega) = E = \bigcirc = - \bullet =$ *jo më Botë materiale*, **Fundi i Botës**

Pra *Fundi i Botës* nuk duhet të jetë teorikisht dhe aq larg ...

"Leibnitzi, mathematikani dhe fillosofi i madh gjerman, flet për ekzistencën e një realiteti *metafizik* që ndodhet *ndën* Universin material dhe e lind atë... Hapësira dhe Koha, masa e një trupi dhe lëvizja në fizikë ... sipas tij janë *ngrehina* intelektualiste..."

Algoritmi Simbolik (e pra atëhere dhe Gjuha gjersa kemi provuar praninë e Alg.Simb. në Gjuhë (shih *Hyrjen*)) na jep:



Simboli ○ rri në Algoritmin tonë Simbolik për "realitetin metafizik" të Leibnitzit (ose edhe, ç'është njëlloj, për **Sub**stancën e Spinozës). Ky realitet metafizik, thotë Leibnitzi, e *lind* (gjeneron) Realitetin tonë material.

Algoritmi Simbolik na lejon ta provojmë edhe këtë.

Kemi:

$$○ = E \qquad ● = F$$

Por dimë se $E = \sqrt{F}$ e pra atëhere:

$$E^2 = F$$

E pra atëhere edhe:

$$○^2 = ● \qquad ...(F)$$

ekuacion ky që tregon se si Realiteti Metafizik që ndodhet *ndën*, *brënda* Realitetit material (⊡), e *lind* atë (●) duke *vepruar* mbi veten e vet ($○^2 = ○ \cdot ○$) (shih edhe faqe 409).

Që ky është një realitet metafizik dhe transhendental, kjo shihet algoritmitikisht qartë sepse:

$$Transhendencë = ⊕ = -◑ = ○ = E$$

(shih lidhur me këtë edhe fq. 57, 119, 453)

Nga ana tjetër, siç kemi parë dhe gjetiu:

Intelekti, arsyeja ... = $(x = x)$ = F = $(s \neq \circ, t \neq \circ)$ (hapësira, koha) = ● (masa) = ~ (lëvizja) ...

Po F është kodi i *fenomenit*, i *dukurive*, e jo ai i realitetit të mbramë, të vërtetë, por ai i një *realiteti iluzor* (realiteti i rremë i krijuar nga "magjia" e Majës në fillosofinë e lashtë Hindiane), ndërsa realiteti *primar, noumenik, esencial* lidhet me E.

Kështu pra, bash ashtu siç pohon Leibnitzi, Koha, Hapësira, masa, lëvizja... mund të vështrohen të gjitha si ngrehina intelektualiste.

Shohim pra kështu se shenjat e para të zbulimit të Paradigmës Holografike i kemi që në kohën e Leibnitzit (1712).

> "... Paradigma Holografike është një teori që lidh bashkë Biollogjinë dhe Fizikën në një sistem të hapur: një paradigmë *paradoksale, pa kufij* që shkenca jonë e priste prej kohësh..."

Edhe E është një "sistem" i hapur:

$E = (x = -x) = \bigcirc = -\textcircled{1}$ = *jo cak, jo kufi, i pakufizuar, i pafund...*

Ndërsa kodi i mendimit racional, shkencor, nuk është i tillë sepse kemi:

$F = (x = x) = \textcircled{1}$ = *cak, kufi, i kufizuar, i fundëm, jo i hapur...*

> "(Paradigma Holografike) bën të mundur një ndërveprim (*komunikim*) me realitetin *primar*, gjë që do të mund të shpjegojë misterin e "paranjohjes" (angl. *precognition*), shërimet mbrekullibërëse, përshkrimin e boshit si paradoksalisht të mbushur (Taoistët thonë: "Realiteti është bosh dhe Boshi është realitet") si edhe një sërë fenomenesh të tjera *paranormale...*"

Realiteti primar është "misteri".

Në formulën tonë:

● = ⊡

misteri është ○ -ja.

Nga ana tjetër me qënë se mund të shkruajmë:

$$F = \boxed{E}$$

Realiteti primar është ai që përfshihet në llogjikën (Antillogjikën) e kodit ***E***, llogjikën e Qëndrës, të Zotit.

Mundësia e ndërveprimit, kontaktit me realitetin primar, do të thotë atëhere "hapja e derës së komunikimit me Hyjninë" për të gjithë. Dhe është shkenca, armikja e betuar gjer dje e çdo misticizmi, ajo që po e bën sot këtë të mundur...

Që këndej del se edhe të gjitha eksperiencat paranormale... janë diçka reale (në kuptimin *primar* të fjalës) e pra të mundura. Kështu p.sh., mbrekullitë e Krishtit në Ungjill bëhen tani të besueshme nga të gjithë sepse "shkencërisht" të pranueshme.

> "... (Paradigma Holografike) do të jetë në gjëndje të shpjegojë fenomenet *transhendentale*, ngjarjet *paranormale*... bëhet i mundur kështu realizimi i një sistemi teorik që pritej prej shumë kohësh dhe i cili, duke u mbështetur në mathematikë, i bën vënd mbrënda Natyrës edhe të Mbinatyrshmes..."

Sipas Algoritmit Simbolik kemi:

$$Natyra = \text{numri simbolik } 2^* = \bullet \text{ (materia, Bota materiale...)}$$
$$= \boxed{\circ} \quad (\overrightarrow{x} = -x) = \text{Qëndra} = \text{Zoti} = \text{Fryma} = E\ Mbinatyrshmja...$$

(Edhe ekzistenca e gjëndrës pineale në **qëndër** të trurit dëshmon për *praninë e të Mbinatyrshmes në Natyrë*. Jo më kot gjëndra pineale quhet edhe **epifisis**, fjalë që rrjedh nga greqishtja *epi*(mbi)*fisis*(natyrë)).

Duke iu referuar edhe fragmenteve të citateve të tjera gjer këtu le të theksojmë edhe sa vijon:

Paradigma e Rè (holografike) është (a do të jetë shpejtë) në gjëndje të shpjegojë edhe fenomenet *paranormale*. Ajo vetëcilësohet si një teori *paradoksale* e pra në gjëndje si e tillë të shpjegojë paradokset...

Le të ndalemi pak mbi këtë çështje duke e trajtuar atë në rrafshin gjuhësor.

---

* Shih *Algoritmi Simbolik dhe Mendimi Mistik.*

Analizojmë për këtë qëllim fjalën *paranormal.*
Ajo ndahet në:

para normal

Prefiksi **para** ka dy kuptime: a) atë të *parësisë* b) atë të *negativitetit, mohimit, kundërvënies.*

Rrënja *para* gjendet e pastër (si operator i lirë), në sanskritisht me dy kuptime antitetike, si *i mirë, i keq, e kaluara, e ardhmja* etj., etj.

Lind pyetja: pse vallë *para* do të thotë simbolikisht edhe *1*, edhe -1 (ose $\S\!\!2$ si *kundërvënie*)*.

Për këtë le të mos harrojmë se Alg.Simb. na jep ekuacionin:

$$-1 = 2 \qquad \text{...(F)}$$

që mund të interpretohet si :

Një vjen i *pari* (*1*) si *pozitivitet* (*+1*).
Më pas (*2*) vjen i *dyti* si *negativitet* (*– 1*).

Ne, d.m.th. *Arsyen njerëzore*, e lidhim fillimin e *Botës* me -1 e pra me 2 dhe kjo sepse siç dimë:

Arsyeja = *Llogjika formale* = $(x = x) = F = -1 = 2 =$ ●
= *Bota materiale; fillimi* (*– 1*) i *Botës materiale* (●)

Ai që ne, me arsyen tonë quajmë *fillim*, është po, fillimi i Botës, por ky është një *moment i dytë* (*– 1 = 2*) *dhe jo i parë* (*1*).

E *para* është *mosfillimi* a, po deshëm, **Zoti**.

Pra *Zoti i parë* (dhe *i mirë:* $1 =$ ○ $= -$●) dhe *Bota materiale*, e *dyta* (dhe *negative*, dhe *e keqe*: $2 = -1 =$ ●).

Në gjuhën e fillosofisë hegeliane:

Teza: Fryma Absolute, Uniteti i të Kundërtave (– $\S\!\!2 = E = 1$).
Antiteza: Lufta e të Kundërtave ($\S\!\!2 = F = -1 = 2$).

---

* Vëmë rè shkarazi se kjo kundërvënie jepet në shqip me çiftin ekuivokal *i,e parë* (*1*) dhe *por* (*– 1*), ($\S\!\!2$)

Atëhere duke përmbledhur, fjala *paranormal*, duke patur parasysh këto dy kuptime të prefiksit "para" na jep:

$$paranormal \begin{cases} - \text{ normalitet} \\ 1 \text{ normalitet (normaliteti i parë)} \end{cases}$$

Pra ajo që vështrohet si *paranormale* ka qënë dikur "në krye të Herës" *normale*. Pra të lashtët, të stërlashtët, Njeriu Primitiv... kanë qënë në përgjithësi *paranormalë*, gjë që do të thotë, ndër të tjera, se fenomenet paranormale kaq të rralla e të jashtëzakonshme sot qënë për ta të shpeshta, të zakonshme dhe krejt normale.

Fakti që shkenca e sotme, duke u mbështetur në Teorinë e Paradigmës Holografike, vihet në gjëndje t'i shpjegojë ato, kjo do të thotë se ajo e bën këtë në sajë të një identifikimi teorik me mentalitetin primitiv (kur paranormalja ishte normalja) e pra duke u udhëhequr nga llogjika (antillogjika) e kodit ***E***. (Rikujtojmë se:

mendimi primitiv (mitik) = *akauzalitet* (Cassirer) = $- \leftrightarrow = E$)

Mos harrojmë se edhe për të zbërthyer "Fjalën" ne u mbështetëm po tek ky mentalitet primitiv me konceptin e tij të *Qëndrës* a, ç'është njëlloj të kodit ***E***.

Pra, siç shohim edhe shpjegimi i paranormalitetit nga Paradigma Holografike dëshmon për saktësisë e ekuacionit:

$$\text{Paradigma Holografike} = E$$

Paradigma Holografike, siç pamë e thamë më sipër, cilësohet edhe si *paradoksale*.

Le ta analizojmë këtë fjalë. Kemi:

para doks

doks është greqishtja $\delta o \zeta \alpha$, në kuptimin e "lavdisë" por edhe, veçanërisht në greqishten e vjetër fetare, në atë të të *vërtetës*.

Kështu fjala *paradoks* përdoret sot edhe në kuptimin *jo i vërtetë, kontradiktor*.

Por siç pamë:

$$para \begin{cases} 1 \\ -1, 2 \end{cases}$$

Pra fjala ***paradoks*** mund të merret në dy kuptime: 1) *jo lavdia; jo e vërteta,* 2) *lavdia e parë; e vërteta e parë.*


Por *e vërteta e parë* është *Qëndra*, "coincidentia oppositorum" ($x = -x$), *Zoti, Fryma e shënjtë* = ***E***

Nga ana tjetër:

$$Arsyeja = (x = x) = F = -E$$

Prandaj pra gjithshka lidhet me ***E*** duket për arsyen tonë të kufizuar ($(x = x) = \oplus$) *paradoksale*, si jo e vërtetë. Prandaj emergjenca sot e Paradigmës Holografike lidhet me emergjencën e kodit ***E***.

Vëmë akoma rè, në këtë zgjerim disi jo më kot të përzgjatur të bisedës mbi Paradigmën Holografike se, siç del nga fragmentet e citateve të riprodhuara, **Paradigma Holografike është Paradigma e Thellësive**, si e thellësisë së trurit, ashtu edhe të asaj të Psikes, të Fizikës... e të çdo dimensioni tjetër të Realitetit e të çdo fushe të Dijes. Ndaj pra ajo është edhe paradigma e çdo "Science des profondeurs", siç po priren të bëhen sot të gjitha shkencat. Por Antillogjika e kodit ***E*** është edhe ajo një paradigme thellësie sepse kemi:



Dhe së fundi, për të përfunduar, shtojmë se shkenca sot, veçanërisht me Paradigmën Holografike, po zbulon **misterin** (fjalë që lidhet me rrënjën e shqipes dhe të sanskritishtes *shtij*, *shtir* (shih fq. 262, 367, 459, 460, 462÷465, 468÷471, 489, 494)), me fjalë të tjera *misteri*, si dituri e *shtirë*, si dituri e *fshehur,* siç lexojmë në Ungjill (Pali, Efezinet 3:9) që nga themelimi i Botës, e pra bash themeli i Botës, Guri i saj i themelit që, sipas fesë së krishterë, është Krishti vetë. Pra **shkenca po prek sot themelin e Botës, po nxjerr në dritë misterin**, po e bën atë të kuptueshëm për të gjithë, gjë që do të sjelli me vete, në mënyrë të pashmangshme, **fundin e kësaj Botës sonë materiale** dhe **rivendosjen e një rendi të ri, shpirtëror, hyjnor, atë të "Mbretërisë së Qiejve"**, sipas gjuhës fetare të krishterë.

Tërë informacioni mbi Paradigmën Holografike si edhe çdo informacion tjetër të rëndësishëm dhe themelor, si të lashtë ashtu edhe të ri, ne e gjejmë të "varrosur" në

Gjuhë, që nga edhe, falë Algoritmit tonë Simbolik (i cili si një artikullim llogjik i Mendimit mitik mund të nxirret edhe ai vetë nga Gjuha) ne vihemi në gjëndje (ashtu siç tregohet në këtë studim) ta "ngjallim". Kuptojmë atëhere rëndësinë e madhe fillosofike të Gjuhësisë (ashtu sikundër ne e kuptojmë atë), si edhe pse nga fillosofë e linguistë të shquar të Kohës sonë ("Fillosofia Semantike") Gjuhësia është quajtur me të drejtë një "Pilot Science".

❖ ❖ ❖

Pas një "udhëtimi" kaq të gjatë nëpër labirinthet e mendimit mitik dhe mekanizmat e holla llogjike të organizimit të tij në një Algoritëm Simbolik që përbën bazën teorike të krejt këtij studimi (si edhe të një sërë studimesh të tjera të Autorit që presin ende radhën e botimit si: "*Fillosofia e llogjika e Gjuhës*", "*Roli mesianik i Gjuhës Shqipe*", "*Libri i aforizmave*", "*Urtësia e Gjuhës*"), le të kalojmë tani në pikën e dytë të kësaj *Hyrjeje* disi tani të harruar...

Le të shohim praninë e Algoritmit Simbolik në një sërë gjuhësh. Kjo do të provojë tezën themelore të studimit tonë sipas të cilës Gjuha ngrihet, si mbi themelin e saj, mbi mendimin mitik.

Kjo prani diktohet nëpërmjet polisemantizmit (polisemisë), nga tërësia e kuptimeve të ndryshme të së njëjtës fjalë. Por me qënë se polisemia bëhet shkak keqkuptimi (ekuivoku, ambiguiteti...) siç është vënë në dukje edhe në *Pjesën e parë* të këtij studimi, për t'ju shmangur atij, polisemantizmi në gjuhët relativisht të reja e më tej është thyer disi duke dhënë fjalë me diferencime të lehta dhe me kuptime të ndryshme.

Në shqip *me zanë* = *filloj* e pra simboli -1; *kap, zë* e pra simb. ☒ dhe me qënë se gjuha referon, siç do të shohim më poshtë, gjithnjë tek Qëndra dhe tek ngjarja më e rëndësishme atje, siç është krijimi i Botës, dhe me qënë se Qëndra: *coincidentia oppositorum* = $(x = -x) = \bigcirc$, në vend të ☒ ne do të shkruajmë ⊙. Në këtë mënyrë Shqipja shtron ekuacionin simbolik në ***F*** të Algoritmit:

$$-1 = \boxed{\odot} \qquad \text{...(F)}$$

I njëjti ekuacion dhe në të njëjtën mënyrë shtrohet ndër të tjera edhe nga gjermanishtja me **anfangen** = *filloj* e pra -1 dhe **fangen** = *kap, zë,* pra ⊙; i njëjti ekuacion dhe në të njëjtën mënyrë shtrohet edhe nga latinishtja me **inCIPere** = *filloj* e pra -1 dhe **CAPere** = *kap, zë* e pra ⊙.

Mund të shkruajmë atëhere përmbledhtas:

-1	=	⊡	...(**F**)
me zanë (zë) shq.		**me zanë** (zë) shq.	
anfangen gjerm.		**fangen** gjerm.	
incipere lat.		**capere** lat.	
...		...	

Kemi pra kështu një "consensio linguarum", që do të thotë *që të gjitha gjuhët thonë të njëjtën gjë duke shtruar të njëjtin ekuacion simbolik*. Shëmbullat që mund të sillen si nga shqipja (kryesisht, për shkak të pasurisë të saj të jashtëzakonshme me rrënjë të pastra a "operatorë të lirë" siç i kemi quajtur) ashtu dhe nga çdo gjuhë tjetër, janë të panumërta, ndaj pra dhe ne do të zgjedhim prej tyre ato më kuptimplotet.

Në shqip **qëndra** e pra ($x = -x$) ose edhe ○ dhe në të njëjtën kohë:

qëndron = *nuk lëviz*, $- \sim$

Kështu Shqipja postulon ekzistencën e një Qëndre, e një pike-refererimi të palëvizshme, të patundur, konstante e pra dhe absolute, siç bën edhe Mendimi Mistik për të cilin koncepti i Qëndrës është nga të gjithë ai më themelori.

Po të njëjtën gjë bën edhe anglishtja me **quite** = *krejt* e pra simb. ○, e pra atëhere edhe ($x = -x$) e pra atëhere Qëndra; dhe **quiet** = *i,e qetë, pa lëvizje, pa ndryshime...* e pra simb. $- \sim$.

Po të njëjtën gjë bën edhe italishtja me **colmo** = *i,e plotë* e pra simb. ○, dhe **calmo** = *i qetë*, e pra $- \sim$.

Dhe ja një tjetër "consensio linguarum":

○	=	$- \sim$	...(**E**)
qëndra shq.		**qëndron** shq.	
quite angl.		**quiet** angl.	
colmo it.		**calmo** it.	
...		...	

Në shqip: { **ndarë** e pra ⏀
ndryshim e pra ~

Në italisht: { **metà** (*gjysëm*), e pra ⏀
moto (*lëvizje*), e pra ~

Në anglisht: { **mutilation** (*gjymtyrim, sakatim*), e pra ⏀
mutation (*ndryshim*), e pra ~

Mund të shkruajmë pra:

⏀	=	~	...(**F**)
ndarje shq.		**ndryshim** shq.	
metà it.		**Moto** it.	
mutilation angl.		**mutation** angl.	
...		...	

Në shqip: { **i ndari**, (⏀)
i ndyri, (●)

Në sanskritisht: { **matra** (*matje*), e pra ⏀
matra (*materie*), e pra ●

Në rusisht: { **delits** (*ndaj*), e pra ⏀
delats (*bëj, materializoj*), e pra ●

Në anglisht: { **fall** (*ndaj*), e pra ⏀
filthy (*i ndyrë*), e pra ●

Mund të shkruajmë atëhere duke përmbledhur ("consensio linguarum"):

⦶	=	●	...(F)
i ndari shq.		**i ndyri** shq.	
matra sanskr.		**Matra** sanskr.	
delits rus.		**Delats** rus.	
fall angl.		**filthy** angl.	
...		...	

Në shqip: { **ndaj** (⦶)
ndaj (*për shkak se, për arsye se*) e pra ↔ dhe ($x = x$)

Në shqip përsëri: { **pjesë** (⦶)
pasi (*me qënë se, për shkak se, për arsye se*) ↔ dhe ($x = x$)

Në gjermanisht: { **halb** (*gjysëm*), e pra ⦶
des**halb** (*prandaj, për këtë shkak, për këtë arsye*), e pra ↔ dhe ($x = x$)

Në japonisht: { **wake** (*arsye, shkak*), e pra ↔
wakeru (*ndaj, dalloj, pjesëtoj*), si edhe
wakemae (*pjesë, porcion*), e pra ⦶

Në anglisht: { **ration** (*racion, porcion*), e pra ⦶.
Rational (që ka një *arsye*, një *shkak*), e pra ($x = x$), ↔

Në sanskritisht: { **ni-mita** = *i matur* e pra, me qënë se matja presupozon një *ndarje,* ⦶
njëkohësisht **ni-mita** = *i shkaktuar, që ka një shkak*, e pra simb. ↔

E kështu me radhë...
Mund të shkruajmë pra:

ⓘ	=	↔	...(F)
ndaj shq.		**ndaj** shq.	
pjesë shq.		**pasi** shq.	
kalb gjerm.		**deshalb** gjerm.	
ration angl.		**rational** angl.	
wakeru, wakemae jap.		**Wake** jap.	
ni-mita sankr.		**ni-mita** sankr.	
...		...	

Në shqip: { **pas** (*2*) ; **pasì** (↔)

Në gjermanisht: { **dann** (*pastaj, më pas*), e pra *2* ; **denn** (*prandaj, për këtë shkak*), e pra ↔

Në italisht: { **quindi** (*më pas, pastaj*), e pra *2* ; **quindi** (*prandaj*), e pra ↔

Në greqisht: { **δύο** (*dy*), e pra *2* ; **διο** (*prandaj, për këtë shkak*), e pra ↔

Në frëngjisht: { **puis** (*pas, pastaj*), e pra *2* ; **puis**-que (*pasi, për shkak se*), e pra ↔

Mund të shkruajmë pra :

2	=	↔	...(**F**)
pas shq.		**Pasì** shq.	
dann gjerm.		**Denn** gjerm.	
quindi it.		**Quindi** it.	
δύο gr.		**Διο** gr.	
puis fr.		**puis**-que fr.	
...		...	

Në shqip: { **i ndarë**, e pra ⦶
i ndyrë, e pra ●

Në rusisht: { **delits** (*делить*) - (*ndaj*), e pra ⦶
delats (*делать*) - (*bëj, materializoj*), e pra ●

Në gjuhën kineze: { **bàn** (*gjysëm*), e pra ⦶
ban (*bëj, materializoj*), e pra ●

Në shqip: { **ndarë** (⦶)
ndreq (*bëj, materializoj*), e pra ●

Në sanskritisht: { **matra** (*mat*), e pra me qënë se matja presupozon *një ndarje*, do të jetë simb. ⦶
matra (*materie*), e pra ●

Pra mund të shkruajmë:

⦶	=	●	...(F)
ndarë shq.		**ndyrë** shq.	
delits rus.		**delats** rus.	
bàn kin.		**Ban** kin.	
ndarë shq.		**ndreq** shq.	
matra sanskr.		**Matra** sanskr.	
...		...	

Në shqip: { **përzì**, e pra ⋈
zi, dhe ●

Në gjuhën kineze: { **hùn** (*përziej, lidh bashkë*), e pra ⋈
hùn (*i turbullë, i ndyrë, i fëlliqur*), e pra ●

Në gjermanisht: { **mit** (*bashkë*), e pra ⋈
sch**mutz**ig (*i ndyrë, i fëlliqur*), e pra ●

Në shqip: { **nyje** = ⚣ ; **nyj** (*fëlliq*) e pra ● }

Në rusisht: { **poll** (*пол*) – (*seks*), e pra ⚣ ; **poll**nij (*полный*) – (*i mbushur*), pra: – **bosh** = – ○ = ● }

Pra mund të shkruajmë:

⚣	=	●	...(**F**)
përzi shq.		**zi** shq.	
hùn kin.		**Hùn** kin.	
mit gjerm.		Sch**mut**zig gjerm.	
nyje shq.		**nyj** shq.	
poll rus.		**poll**nij rus.	
...		...	

Në shqip: { **i dytë** = **2** ; i n-**dytë** = ● }

si edhe: { **pas** = **2** ; **pis** = ● }

Në frëngjisht: { **puis** (*pas*) = **2** ; **pis** (*shumë i keq*) = ● }

Në shqip: { **dysh** = 2 ; **ndysì** = ● }

Në anglisht: { **follow** (*ndjek*) = **2** ; **filthy** (*pis*) = ● }

Në shqip: { **ndjek** = **2** ; **ndyj** = ● }

Pra mund të shkruajmë:

2	=	●	...(F)
i **dytë** shq.		i n**dytë** shq.	
pas shq.		**pis** shq.	
puis fr.		**pis** fr.	
dysh shq.		n-**dysì** shq.	
follow angl.		**filthy** angl.	
ndjek shq.		**ndyj** shq.	
...		...	

Në gjermanisht: { **schwarz** (*i ndytë, i zi*), e pra ●
schwer (*i rëndë*), e pra ♀

Në shqip: { i **pistë**, (●)
i **poshtëm**, (♀)

Në anglisht: { **filthy** (*i pistë*), (●)
to **fall** (*bie*), (♀)

Në shqip: { **fëlliq**, (●)
falem (*falitem*), (♀)

Në rusisht: { **Bjes** (*Бес*) (*djall, demon*), (●)
Vjes (*Вес*) (*peshë*), (♀)

Në shqip: { **bërje** (*materializim*), (●)
bjerrje (*rënie; humbje*), (♀)

Në rusisht: { **vjesh** (*вешь*) (*send material*), (●)
vjes (*вес*) (*peshë*), (♀)

Në shqip: { **pis**, (●)
peshë, (♀)

Në italisht: { **pessimo** (*shumë i keq*), (●)
peso (*peshë*), (♀)

Pra mund të shkruajmë:

●	=	♀	...(**F**)
schwarz gjerm.		**schwer** gjerm.	
pistë shq.		**poshtëm** shq.	
filthy ingl.		**Fall** ingl.	
fëlliq shq.		**falem** (falitem) shq.	
Bjes rus.		**Vjes** rus.	
bërje shq.		**bjerrje** shq.	
vjesh rus.		**vjes** rus.	
pis shq.		**peshë** shq.	
pessimo it.		**peso** it.	
...		...	

Në shqip: { **felë**, (◐)
falit, (♀)

Në anglisht: { **to fall (apart)** (*ndahem*), (◐)
to Fall (*bie*), (♀)

Në sanskritisht: { **ava-PAṬ** (*copëtoj*), (◐)
ava-PAT (*me rá*), (♀)

Në italisht: { **scindere** (*ndaj*), (◐)
scendere (*zbres*), (♀)

Pra mund të shkruajmë:

⊕	=	♀	...(F)
felë shq.		**falit** shq.	
fall ingl.		**Fall** ingl.	
ava-PAṬ sanskr.		**Ava-PAT** sanskr.	
scindere it.		**Scendere** it.	
...		...	

Në italisht: { **in** ka kuptimin e *mohimit,* e pra $-x$
in ka kuptimin e *mbrëndësisë,* e pra ☒

Në sanskritisht: { **ni** ka kuptimin e *mohimit,* e pra $-x$
ni ka kuptimin e *mbrëndësisë,* e pra ☒

Në gjuhën kineze: { **nai** ka kuptimin e *mohimit,* e pra $-x$
nai ka kuptimin e *mbrëndësisë,* e pra ☒

Pra mund të shkruajmë:

$-x$	=	☒
in it.		**in** it.
ni sanskr.		**ni** sanskr.
nai kin.		**nai** kin.
...		...

Le të shohim ndonjë zbatim të kësaj formule.
Për $x = 1$ do të kemi:

$$-1 = \boxed{1} \qquad ...(F)$$

Me qënë se -1 mund të interpretohet si *fillimi i Botës* (*fillimi* "par excellence"), dhe me qënë se 1 mund të interpretohet si *kapje, zënie* e Njëshit, e të Parit, e Parimit hyjnor, ne mund te themi se Bota filloi, u krijua me *krimin* (*Cosmoginic Sacrifice*) e "kapjes", "burgosjes" të Hyjnisë.

Gjuha e rikonfermon këtë (shih edhe fq. 121).

Le të marrim tani x = ○. Do të kemi:

$$-○ = ◎ \qquad \text{...(F)}$$

Por siç provon Algoritmi Simbolik dhe siç provohet edhe në rrafshin gjuhësor (shih më poshtë), kemi $-○ = ◑ = ●$. Zëvendësojmë tani në formulën e mësipërme. Do të kemi:

$$◑ = ◎ \qquad \text{...(F)}$$

si edhe

$$● = ◎ \qquad \text{...(F)}$$

Këto janë dy formula shumë të rëndësishme, siç do të shohim kur të flasim për "Urtësinë e Gjuhës", domethënë **për informacionin që mund të nxirret** (përftohet) **nga zbërthimi i "shifrës" së Gjuhës në nivelin e thellë të gjuhës simbolike, substrakt i përbashkët i të gjitha gjuhërave pa përjashtim**.

Le të kufizohemi këtu me ndonjë rikonfermim gjuhësor të këtyre formulave.

Në shqip:
- ◑ = *ndarë, asht nda,* **â ndà**
- ◎ = **ande** (*brënda**)

Në sanskritisht:
- **anda** = *ndarje, pjesë* (shq. *â ndà*)
- **anta** = *pjesë, kufi, ndarje*

Në sanskritisht gjithashtu: **anta**, **antara** = shq. *ande, brënda* (shq. *â ndà, â ndarë*)**.

---

* Shih edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi (fq. 114) (**Gazulli**, *Fjalorth i ri - fjalë të rralla të përdorura në Veri të Shqypnis, Tiranë 1941*).

** I njëjti kuptim jepet në latinisht me *intus* dhe në greqisht me *εντός* (endós) ... që lidhen pra kështu si me prejardhjen e tyre me Sanskritishten dhe Shqipen.

Mund të shkruajmë pra atëhere:

ⓘ	=	⊙	...(F)
â ndà shq.		**ande** shq.	
anta sanskr.		**anta** sanskr.	
...		...	

Për sa i përket formulës (● = ⊙) së dytë ajo jepet fare mirë me shqipen **zi** (●) dhe **zë** (⊙).

Në gjuhën kineze: { **xì** (*lidh, shtrëngoj*), e pra 𓃾
xì (*zihem*) (angl. *quarrel*), e pra 𓃿

Në shqip: { **zi**het (*kapet, lidhet*), e pra 𓃾
zihet (*grindet*) (angl. *quarrel,* it. *litigare*), e pra 𓃿

Si edhe { për**zi**het (angl. *to get mixed up*), e pra 𓃾
zihet (*grindet*), e pra 𓃿

Kemi pra atëhere:

𓃾	=	𓃿	...(F)
xi kin.		**Xi** kin.	
zihet shq.		**zi**het shq.	
për**zi**het shq.		**zi**het shq.	
...		...	

Në gjuhën kineze: { **xiàn** (*ligj*), (angl. *law*), e pra 𓃾
xiàn (*kufi*), (angl. *limit*), pra ⓘ

Në anglisht: { **bond** (*lidhje*), e pra 𓃾
bound (*kufi*), e pra ⓘ

Mund të shkruajmë:



xiàn kin. **xiàn** kin. ...(**F**)

bond angl. **bound** angl.

... ...

Në gjuhën kineze: { **zhè** (*thyej*), e pra ⊕
zhè (*përkul*), e pra ⌒

Në anglisht: { **bound** (*ndarje, kufi*), e pra ⊕
bend (*përkul*), e pra ⌒

Pra mund të shkruajmë:



zhè kin. **Zhè** kin. ...(**F**)

bound angl. **bend** angl.

... ...

Në hebraisht: {
asur... (*lidh, prangos, fut në burg*), e pra ⊗, ⊡
asur... (*filloj*) (angl. *begin*), e pra -1

'u kal (עוכל) (*u kap, u kall, u burgos*), e pra ⊡
hukhal (הוכל) (*filloi*), e pra -1

Kështu edhe hebraishtja si shqipja *me zë* (*zuri*) = *filloj* (i), ashtu si gjermanishtja me *fangen* dhe *anfangen,* latinishtja me *capere* dhe *incipere,* ... shtron ekuacionin e rëndësishëm simbolik:



-1 = ⊡ = [1] ...(**F**)

për të cilin është folur më sipër.

Në gjuhën kineze: { **zào** (*bëj; krijoj*) (*to make; to do; to create*)$_{angl.}$, e pra: ●
zā (*lidh; përziej*), e pra ☓.

Në shqip: { **zë** (*kap, lidh...*), e pra ☓
zi, e pra ●

Dhe sajohet përsëri kështu ekuacioni ☓ = ●, për të cilin është folur edhe më sipër.

Në hebraisht: { **min** (מִן) - *nga* (*from*)... *pjesë e...* (*part of*), *ç'prej* (*since*), *pas* (*after*), *për shkak se, për arësye se* (*because of...*)

Kështu me polisemantizmin e kësaj fjale (rrënjë të pastër), hebraishtja shtron këtë varg ekuivalencash simbolike:

Hebraishtja **min**:

$$-1 = \ominus = 2 = \leftrightarrow = (x = x) \quad \text{...(F)}$$

from *part of...* *after* *because of...*
since

Në gjermanisht: { **wieder** (*përsëri*), e pra **2**
wider (*kundra*), e pra -1, ose ☈

Në anglisht: { **again** (*përsëri*), e pra simb. **2**
against (*kundra*), e pra -1, ose ☈

Në italisht: { **ri-** si prefiks tregon *përsëritje*, e pra 2
ri- si edhe *të kundërtën*, e pra -1, ose ☈

Në shqip: { **prap** = *2*
prapa = -1; **prap**ësoj (*kundërshtoj*), e pra ☈

Në shqip: { **për s ëritje**, e pra 2
për t ëritje, e pra *−1*

Pra mund të shkruajmë:

2	=	*−1*	...(**F**)
wieder gjerm.		**wider** gjerm.	
again angl.		**again**-st angl.	
ri- it.		**ri-** it.	
prap shq.		**prapa, prapësoj** shq.	
për **s** ëritje shq.		për **t** ëritje shq.	
...		...	

Në japonisht: { **waru** (*thyerje, e çarë* - angl. *break; split*), e pra ⊕
waru (*i keq*; *gabim* - angl. *bad, wrong*), e pra ●

Kështu me këtë fjalë japonishtja shtron ekuacionin e rëndësishëm simbolik:

⊕ = ● ...(**F**)

që kemi parë më sipër.

Edhe vetëm kaq do të ish mjaft për të kuptuar përse në të gjitha këto raste është fjala. Por le të japin edhe të tjera shëmbulla të shkëputura nga gjuhë të ndryshme që shtrojnë, ***secila në mënyrën e vet***, *të njëjtat ekuacione simbolike.*

Në latinisht: { **condo** (*vu bashkë, mbledh bashkë* - angl. *to put together*), e pra ⊗
condo (*ndërtoj, themeloj*), e pra ●
condo (*fsheh*; *fut mbrënda, fut në burg*), e pra ⊡

Kështu latinishtja shtron në këtë mënyrë ekuacionin simbolik:

⊗ = ● = ⊡ ...(**F**)

Le të vëmë rè këtu shkarazi se **do** tek latinishtja *condo*, është shqipja **da** (folja *daj*), e pra simb. ⏀ dhe për ekuivalencë simbolike ⚷.

Në latinisht: { **caedo** (*ndaj, pres, shkurtoj* - angl. *cut, cut down*), e pra ⏀
cado (*bie* - angl. *fall*) dhe ♀

E pra kështu latinishtja shtron ekuacionin simbolik:

$$⏀ = ♀ \qquad ...(F)$$

Në japonisht: { **sakai** (*kufi* - angl. *border*), e pra ⏀
sakarou (*kundërshtoj, kundërvihem* -angl. *oppose*), e pra ♌

Në shqip: { **dasì** (*ndarje*), e pra ⏀
n**desh**je, e pra ♌

Në hebraisht: { **paràs** (*thyej* - angl. *break*), e pra ⏀
parà (*kundërshtoj*), e pra ♌
parà (*prij*), e pra -1

Kështu hebraishtja shtron ekuacionin simbolik:

$$⏀ = -1 = ♌ \qquad ...(F)$$

E tepërt të vërejmë këtu se në shqip **pres** (angl. *cut*) dhe **prijës** (angl. *leader*), lidhen me gllosat e mësipërme hebraishte. Shqipja shtron pra edhe kështu ekuacionin simbolik:

$$⏀ = -1 \qquad ...(F)$$

Në hebraisht: { **nafàl** (*bie, falitem* - angl. *to fall down*), e pra ♀
nafàl (*me ndodhë* - angl. *to happen*), e pra ●
hith-**nafèl** (*i,u bije* - angl. *fall upon, to attack*), e pra ♌

Në shqip:
- **bije** (angl. *fall down*), e pra ♀
- **bëj** (angl. *to do, to make*), e pra ●
- (*i,u*) **bije** (angl. *fall upon*), e pra ♌

Shqipja shtron kështu ekuacionin e rëndësishëm simbolik, si edhe hebraishtja.

$$\bullet = ♀ = ♌ \qquad \text{...(F)}$$

Në shqip:
- **ranë**, e pra ♀
- *i,u* **ranë**, e pra ♌

Në rusisht:
- **padats** (*bie*), e pa ♀
- **napadats** (*i, u bie*), e pra ♌

...

Ne mund të vazhdojmë me shëmbulla të panumërta nga të gjitha gjuhët si këto, por mendoj se edhe me kaq lexuesi është i bindur mbi *praninë e Algoritmit Simbolik* (Artikullim llogjik i Mendimit Mitik) në Gjuhë, shka dhe duhej treguar.

Përpara se të kalojmë më tej tek pika tjetër, le të vëmë re lidhur me sa më sipër sa vijon:

a) *fillimi, i pari...* etj. etj. janë treguar me -1 dhe jo me 1, numër ky i fundit që është ai i Zotit.

b) Ne pamë me shëmbulla nga gjuha se $2 = -1$, kështu pra *i pari real* d.m.th. në këtë *Botën tonë materiale* është në të vërtetë *i dyti* (*2*). Po kemi:

$$2 = \bullet$$

Për shëmbull, në shqip *i dyti, i ndyti; pas, pis;* në anglisht *to follow, to defile....*

Pra atëhere:

$$-1 = 2 = \bullet \qquad \text{...(F)}$$

ku simboli i fundit mund te interpretohet si: *e keqja, materia, djalli...*

Që këndej del se *materia, e keqja, djalli...* përfaqësojnë *negativitetin* "par excellence", *kulmin e negativitetit.*

Algoritmi Simbolik dhe Gjuha na japin gjithashtu:

$$2 = \text{⦶} = \tfrac{1}{2} \qquad \text{...(F)}$$

i **dyti** shq.	i **ndati** shq.
pas shq.	**pjesë** shq.
puis fr.	**pièce** fr.
secondo it.	**secante** it.
...	...

Që këndej del pra se:

$$-1 = \text{⦶} = \tfrac{1}{2} \qquad \text{...(F)}$$

Do me thënë se *i pari, fillimi...* në këtë botë është *negativ* dhe *gjysmak* (pra e tillë është edhe bota. Gjermanishtja e rikonfermon më së miri këtë me:

nicht, e pra -1

nacht, e pra $\bullet$

Simboli i fundit është, siç dimë, edhe ai *i materies* dhe *i djallit.* Djalli është Mefistofeli tek "Fausti" i Goethes dhe ndër atributet (*cilësitë, karakteristikat e tij*) janë *negativiteti* (*mohimi, −1*) e *keqja* (●), *ndarja, copëtimi, fragmentimi, të qënurit i pjesshëm* (⦶). Lexojmë në veprën e sipërpërmendur përcaktimi që Mefistofelit (djallit) i bën vetes së tij:

Ich bin der Geist
Der stets *verneint* (*−1*)

So ist denn alles, was ihr Sünde (●)
Zerstörung, kurz das Böse (●) nennt
Mein eigentliches Element

Ich bin ein *Teil* des Teils (◐)
Der anfangs (*1*) *alles* war (○).

(Unë jam Fryma
Që përherë *mohon* (*−1*).

Pra dhe gjithshka, që ju quani *mëkat* (●)
Shkatërrim, shkurt e keqja (●)
Është bash thelbi im.

Unë jam një pjesë e asaj *pjese* (◐)
Që në fillim (*1*) një e *Tërë* ish (○))

Mund të shkruajmë pra:

Mefistofeli: $-1 = ◐ = ●$ ...(**F**)

Tek vargjet e mësipërme pamë edhe një gjë tjetër, në *fillim* (*pa fillim*) ka qënë ○ (*e Tëra*), pastaj në një çast të dytë kjo *e Tërë* është *mohuar* $-1, -○$ dhe është mbajtur prej saj vetëm një *pjesë* (◐).

Në mënyrë poetike Goethe na thotë pra se Bota është krijuar me një *kalim* (*rënie*) nga kodi ***E*** (○, ...) tek kodi ***F*** (●, ...), ashtu sikundër pohon unanimisht tërë Mendimi mitik dhe bashkë me të edhe Gjuha.

Dhe kalojmë atëhere në një pikë tjetër. Le të shohim se si Gjuha pozon Qëndrën e pra dhe referon vazhdimisht tek ajo.

Gjuha e bën këtë në disa mënyra, drejt për së drejti dhe tërthorazi. Le të shohim një mënyrë të drejtë për drejtë të pozimit të Qëndrës nga Gjuha.

Dimë se:

$$Qëndra = Coincidentia\ oppositorum = (x = -x)$$

Pra sa herë që një gjuhë pozon ekuacionin e *fundit*, ne kemi të drejtë të themi se ajo pozon *Qëndrën*.

Le të shohim disa shëmbulla (ndonëse me këtë punë jemi marrë edhe në *Pjesën e parë* të këtij studimi, sido që jo në një mënyrë kaq të organizuar).

Në sanskritisht:

$$\textbf{para} = \begin{cases} i\ pari \\ i\ fundit \end{cases} \quad \begin{cases} i\ mirë \\ i\ keq \end{cases} \quad \begin{cases} e\ kaluara \\ e\ ardhmja \end{cases}$$

Në shqip: **i parë** = *1* dhe *por* = -1, e pra $1 = -1$, e pra duke shumëzuar të dy krahët me x, do të kemi $(x = -x)$.

Në greqisht: **hyper** (*υπέρ*) = *lartë* e pra $\uparrow$, **hypo** (*υπό*) = *poshtë* e pra $\downarrow$.

Kështu greqishtja pozon:

$$\uparrow = \downarrow \qquad ...(\mathbf{E})$$

Dhe rigjejmë në këtë mënyrë "Tabula Smaragdinën" (◯) që del si një rast i veçantë i ekuacionit të *Qëndrës*, për $(x = \uparrow)$.

Në anglisht: **push** (*shtyj*), e pra $\rightarrow$ dhe **pull** (*tërheq*), e pra $\leftarrow$.

Kështu anglishtja shtron ekuacionin:

$$\rightarrow = \leftarrow \qquad ...(\mathbf{E})$$

që është një rast i veçantë i ekuacionit të *Qëndrës* për $(x = \rightarrow)$.

Në shqip: n**alt** (↑) dhe **ult** (↓).

Në shqip: i **larë** (○), i **le**rosur (●).

Në frëngjisht: **dessus** (*lartë*), e pra ↑, **dessous** (*poshtë*), e pra ↓.

Në gjuhën kineze: **xuàn** (*i zi, i errët*), e pra ●; **xuè** (*borë; i pastër*), e pra – ●.

Në hebraisht: **kadosh** (קָדוֹשׁ) - *i shënjtë* (***x***); *i ndyrë* (– ***x***).

...

Mund të sillen shëmbulla pafund nga gjuhë të ndryshme të pozimit të Qëndrës në këtë mënyrë. Që tregimi i të kundërtave me një çift homonimik a thuajse homonimik (një nga partnerët e çiftit është diferencuar lehtë në një fazë të dytë të zhvillimit të Gjuhës për t'ju shmangur keqkuptimit) nuk është "aksidental", këtë e provon fakti se në gjuhët tepër të lashta ka qënë gjithmonë kështu, d.m.th. të kundërtat tregoheshin me të njëjtën fjalë.

Le të citojmë lidhur me këtë çështje dy autorë të shquar, një linguist dhe një psikiatër.

Carl Abel, një gjuhëtar i mirënjohur gjerman, në librin e tij me titull: *"Enleitung in ein Aegyptisch-Semitisch-Indoeuropäisches Wurzelwörterbuch"* botuar në Wiesbaden më 1884, shkruan:

> "... die ersten Begriffe *werden geradezu mit ihrem Gegenteil in demselben Worte untergebracht, und haben ohne das Gegenteil ursprünglich nicht gedacht worden, nicht gefasst worden können*" (fq. 32).
>
> (... Konceptet në krye të herës tregoheshin me të njëjtën fjalë si edhe të kundërtat e tyre. Në atë kohë ato nuk mund të mendoheshin e të kuptoheshin në asnjë mënyrë pa të kundërtat e tyre.)

Ai jep një listë të gjatë fjalësh nga gjuha egjiptiane që shprehin koncepte të kundërta, ndonëse ruajnë të njëjtën formë, si për shëmbull:

qen = *fortis* = i fortë	**sept** = *destruere* = shkatërroj
qen = *debilis* = i dobët	**sept** = *construere* = ndërtoj

tem = *includere* = përfshij	**un** = *esse* = me qënë
tem = *excludere* = përjashtoj	**un** = *deesse* = mos me qënë
...	...

Është e qartë nga këto shëmbulla se gjuha e lashtë egjiptiane pozon si referencë absolute Qëndrën me të gjitha pasojat, që nga kjo rrjedhin, si bie fjala, *akauzaliteti*, domethënë shpjegimi i ngjarjeve dhe i Realitetit jo nëpërmjet lidhjes shkak-efekt, gjë që lidhet drejt për së drejti, siç kemi parë, me Mendimin primitiv, mitik, etj. etj.*

Autori tjetër është Otto Rank, nxënës i shquar i Freudit dhe zbatues i ideve të tij në letërsi, në art në përgjithësi, në Gjuhësi, etj. Në studimin me titull: "*Die Bedeutung der Psychoanalyse für die Geisteswissenschaften*", në versionin italisht, me titull "*La Psicanalisi e le sue applicazioni*", nga i cili ne edhe do të citojmë, në kapitullin "*Etnologia e Linguistica*" ne lexojmë, ndër të tjera, për sa i përket çështjeve që na interesojnë lidhur me Gjuhën:

> "...la conoscenza dell'Inconscio è di massima importanza për la comprensione dell'origine e dello sviluppo iniziale della lingua, perchè *custodisce le primitive forme del pensiero che concorrono, nei primissimi tempi, alla formazione del linguaggio.* Sull'intima relazione esistente tra il pensiero e la lingua è difficile avanzare un'ipotesi, senza farsi un'idea precisa sul modo di pensare dell'uomo primitivo.
>
> L'influenza sul pensiero di alcuni meccanismi psichici *Inconsci* può essere sostenuta sin d'ora... Così, oltre alle peculiarità già ricordate, appartiene al **conscio** anche quella di suscitare il sentimento di ***incompatibilità*** *dei contrari:* invece ***l'Inconscio dal canto suo preferisce unirli anche qaundo essi si presentano diametralmente opposti.*** Proprio come ha rilevato un illustre filologo (K. Abel: Über den Gegensinn der Urworte, Leipzig 1884) già da molti decenni, dimostrando che *questo era un tratto constante delle lingue antiche:*
>
> *esse* ***designavano*** *spesso* ***delle coppie di contrari con la stessa***

* Shih edhe P.Sh.A.S.

espressione che solo in seguito si dividevano in due differenti parole dal significato opposto...

La capacità di astrarre e di pensare per concetti si è costituita solo lentamente... Per quanto riguarda la questione circa le *forme di pensiero usate dai primitivi che* ***non usavano concetti***, possiamo farci un'idea rapportandolo all'***Inconscio***.

Anche ***l'Inconscio non conosce la formazione dei concetti*** e si serve di un'altro aiuto, più prossimo all'intuizione, che gli permette, për lo meno in una certa misura, di essere adeguato alla peculiarità ed al nesso delle cose: ***il simbolismo***. Può *dunque accadere che due rappresentazioni nel nostro pensiero siano strettamente legate nella loro vita psichica Inconscia...* (fq. 118-120, të përkthimit italisht, Otto Rank, Hanns Saches: "*Psicanalisi e sue applicazioni*", Sugarco Edizioni).

(... Njohja e Inkoshientit ka një rëndësi të dorës së parë për kuptimin e zanafillës dhe zhvillimit të Gjuhës sepse "*ai përmban trajtat primitive të mendimit, të cilat ndikuan në kohërat më të hershme në formimin e Gjuhës.* Pa patur një idè të qartë e të saktë mbi mënyrën e të menduarit të njeriut primitiv është e vështirë të ngrihet një hipotezë mbi lidhjen e ngushtë mes mendimit dhe gjuhës.

Por që tani mund të flitet pa frikë për ndikimin e disa mekanizmave psikike të pavetëdijshme (Inkoshiente) mbi mendimin...

... Kështu, përveç veçorive që u përmendën më sipër Koshienti ka edhe një veti tjetër: ai lind ndjenjën e *mospajtueshmërisë të të kundërtave; ndërsa Inkoshientit përkundrazi, i parapëlqen t'i njënjësojë* (identifikojë) *edhe atëhere kur ato paraqiten diametralisht të kundërta.* Ashtu pikërisht sikundër ka vënë në dukje një filolog i shquar (K. Abel: "*Über den Gegensinn der Urworte*", Leipzig, 1884 - "*Mbi kuptimet e kundërta të fjalëve të hershme*") që prej disa dhjetëra vjetësh duke provuar se "Ky ishte një *tipar i zakonshëm i gjuhërave të lashta; ato i tregonin shpesh çiftet e të kundërtave me të njëjtën shprehje, e cila vetëm më vonë ndahej në dy fjalë të ndryshme me kuptime të kundërta ...*

Aftësia e *abstraksionit* dhe të të menduarit me *koncepte*, është arritur dalë ngadalë... Për sa i përket çështjes *mbi format e mendimit që përdornin njerëzit*

e hershëm, të cilët **nuk përdornin koncepte**, mund të formojmë një idè duke i referuar ato tek Inkoshienti. **Edhe Inkoshienti nuk e njeh "formimin e koncepteve"** dhe përdor një mënyrë tjetër, më pranë intuitës, që i lejon, të paktën gjer në një farë mase, të shprehë me besnikëri veçoritë dhe lidhjet e sendeve mes tyre: **Simbolizmin**. Mund të ndodhë pra kështu që dy përfytyrime në mendimin tonë të lidhen ngushtë mes tyre në jetën psikike në nivelin e Inkoshientit.)

Teksti i cituar rikonfermon faktin se **gjuhët e para i kanë treguar dy koncepte të kundërta me të njëjtën fjalë**, si edhe se **krijimi i gjuhës lidhet me Inkoshientin dhe jo me Koshientin**, si edhe pra atëhere si rrjedhim, se **gjuhët e para kanë qënë simbolike dhe jo konceptuale, gjë që do të thotë se ato përshkruanin simbole dhe jo koncepte**. Dhe nuk mund të ishte ndryshe. Edhe kjo sepse gjersa gjuha ngrihet, siç kemi parë, si mbi themelin e saj mbi mendimin mitik, dhe me qënë se mendimi mitik pozon si referencë *Qëndrën* dhe *akauzalitetin* [*Qëndra*: $(x = -x) = - \leftrightarrow =$ *akauzaliteti*], ky mendim nuk mund të shprehej ndryshe, në mënyrë adeguate, veçse me simbole. Dijetarët (etnollogët, fillosofët, linguistët...) flasin shpesh për *Gjuhën e harruar** *të Simboleve*. Nga ana tjetër mund të vërtetohet rigorozisht që një mendim që pozon Qëndrën nuk mund të jetë kurrsesi konceptual e pra do të jetë simbolik. Ne do të zgjatemi disi rreth kësaj çështjeje sepse lidhet ngushtë e drejt për së drejti me metodollogjinë e analizave tona gjuhësore që *priren t'i shpjegojnë* (motivojnë) *fjalët duke i përcjellur ato si në zanafillën e tyre të lashtë tek ky apo ay simbol*. Kështu për shëmbull, në studimet tona, fjala gjermanisht **sterben** motivohet siç kemi parë në instancë të fundit, përmes shqipes *bën* **sterr,** me simbolizmën e të *zezës* (●).

Ne pamë se:

$$Qëndra = (x = -x) = -(x = x) = -parimi\ i\ Identitetit$$

$$= -llogjika\ formale = -Arsyeja$$

* Shih edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi, fq. 12.

Por llogjika *formale* (llogjika e *Tertium Non Datur*, siç quhet gjithashtu), operon me koncepte, kështu që llogjika tjetër, ajo e *Qëndrës* (a llogjika e *Tertium Datur*, siç quhet gjithashtu), nuk mund të operojë me koncepte. Le të vërtetojmë se ajo mund të operojë vetëm me simbole.

Për këtë mund të arsyetojmë kështu: koncepti realizohet, është i mundur vetëm në sajë të një *abstraksioni,* lat. *abstractio,* që lidhet gjithnjë me një *substractio,* domethënë me një *zbritje,* me një *heqje nga e Tëra.* Duke treguar të *Tërën* me ○, *zbritja, heqja* e pra *abstraksioni,* e pra fundja më në fund koncepti, do të tregohej me ⦶ (= − ○ = *jo e Tëra* por vetëm një pjesë e saj). Ky simbol është arketipikisht edhe ai i *ndarjes,* ai i *cakut,* ai i *përcaktimit,* ai i *kufizimit,* ai i *përkufizimit.* Si i tillë ai do të jetë i kundërt me simbolin e *papërcaktueshmërisë*, të *papërkufizueshmërisë,* etj., etj, e pra simbolikisht:

$$⦶ = -(-⦶)$$

Por kemi:

$$-⦶ = ○ = (x = -x) = \textit{Qëndra}$$

E pra atëhere, duke përmbledhur:

$$\text{koncepti} = (x = x) = ⦶ = -○ = -(x = -x) =$$

$$-\text{Qëndra} = -\text{ Llogjika e } \textit{Tertium Datur}$$

Lexojmë tani tek libri i Jean Chevalier*:

"Au lieu de se fonder sur le principe du tiers exclu, comme la logique conceptuelle, la symbolique présuppose au contraire un principe du tiers inclus..."

(Në vend që të ngrihet, si mbi themelin e saj, mbi parimin e të Tretit të Përjashtuar si logjika konceptuale, simbolizimi presupozon përkundrazi një parim të të Tretit të Përfshirë...)

---

* Jean Chevalier, "*Dictionnaire des symboles*" Robert Laffont Editeur, fq. XX-XXI

Teksti flet qartë, ai na thotë se llogjika e të *Tretit të Përfshirë*, që është llogjika e *Qëndrës* e cila, nga ana e saj, sikundër e kemi parë, lidhet ngushtë me Mendimin Mitik, *nuk mund të operojë me koncepte por vetëm me simbole* e pra se *Gjuha e mendimit mitik nuk mund të jetë tjetër veçse një gjuhë simbolike.*

Kështu pra ne me të drejtë mund të themi se:

Gjuhët e para kanë qënë simbolike

Duke qënë kështu:

Ne me të drejtë e kërkojmë shpjegimin e fundit të një fjale jo tek një koncept, por tek një simbol.

Ne pamë disa shëmbulla të pozimit të drejtpërdrejtë të Qëndrës nga Gjuha. Por Gjuha e pozon Qëndrën, i referohet asaj edhe në mënyra të tjera që mund t'i quajmë të tërthorta.

Për shëmbull, pamë se gjermanishtja me *wieder* (*përsëri*), e pra *2* dhe *wider* (*kundër*) e pra -1, shtron ekuacionin simbolik (të Mathematikës mistike):

$$\boxed{2 = -1}^{*} \qquad \text{...(F)}$$

---

* Për të vërtetuar se $2 = -1$ dhe $\frac{1}{2} = 2$ (Mathematika mistike) mund të arsyetojmë, p.sh. kështu:

Nisemi nga ai që vështrohet si themeli i mathematikës mistike (shih Cirlot, fq. 236):

$$9 = 0$$

Që këtej mund të nxjerrim: $3 + 3 + 3 = 0$

E pra atëhere edhe: $3 = 0$

Mund të shkruajmë edhe: $2 + 1 = 0$

Ose edhe: $2 = -1$

Çfarë dhe duhej vërtetuar.

Nisemi përsëri nga ekuacioni $(3 = 0)$. U shtojmë të dy anëve të barazimit **1**. Do të kemi:

$$3 + 1 = 1$$

$$4 = 1$$

Pjesëtojmë të dy anët me 2 dhe do të kemi:

$$2 = \frac{1}{2}$$

Që nga dhe nxirret se $2 + 1 = 0$, $3 = 0$ por edhe gjithashtu $-3 = 0$, që nga edhe $3 = -3$ e pra edhe $1 = -1$ e pra dhe më në fund $(x = -x)$ = *Coincidentia oppositorum* = *Qëndra*.

Ne dimë se:

$$\text{Qëndra} = (x = -x) = \bigcirc = -\textcircled{D} = -\tfrac{1}{2} = -2 = \ldots \qquad \ldots(\mathbf{E})$$

Por gjuha na jep:

Në shqip: **ndaj** = Ⓓ dhe **ndaj** (*shkak, arsye*), e pra $(x = x)$.

Në anglisht: **ratio** (*arsye*), e pra $(x = x)$ dhe në të njëjtën kohë **ration** (*racion, porcion*), e pra Ⓓ, e pra edhe $\frac{1}{2}$, si edhe 2.

Në gjermanisht: des**halb** = për këtë arsye e pra $(x = x)$, **halb** = *gjysëm*, e pra $\frac{1}{2}$, e pra edhe 2.

Në italisht: **ragione** (*arsye*), e pra $(x = x)$ dhe **regione** (*krahinë, pjesë*), e pra $\frac{1}{2}$, e pra edhe **2**.

E kështu me radhë, siç kemi parë, në një sërë gjuhësh.

Por dimë se:

$$\textbf{Qëndra} = (x = -x) = -(x = x)$$

e pra atëhere edhe: -2 (e pra 1), $-\frac{1}{2}$ (e pra 1), $-\textcircled{D}$, e pra $\bigcirc$.

Kështu pra Gjuha e bën arsyen *gjysmake* ($\frac{1}{2}$) dhe *sekondare* (*dytësore, që vjen pas...*) (2), e bën të *plotë* ($\bigcirc$) dhe *primare* (1), atëhere, rrjedhimisht *Qëndrën*. Kjo është prapë për të pohuar karakterin primar, absolut të referimit tek Qëndra duke e ekuivalentizuar këtë të fundit me 1 dhe me $\bigcirc$. Shkarazi vëmë rè se ekuaconi $\bigcirc = 1$ jepet, për shëmbull nga shqipja me *kre* (1) dhe *kre-jt* ($\bigcirc$).

Çfarë dhe duhej provuar.

Dhe meqënëse $\frac{1}{2} = 0.5$, e pra sipas mathematikës mistike $0 + 5 = 5$, kemi gjithashtu:

$$2 = \tfrac{1}{2} = 5$$

Një tjetër mënyrë referimi tek Qëndra, është edhe kjo: operatori i lirë (rrënja e pastër) **ar** në një sërë gjuhësh shpreh *parimin dritësor* a ndryshe, ne mund të shprehemi kështu, *parimin yllësor*. Por siç lexojmë tek Cirlot (faqe 310), *ylli* identifikohet në mendimin mistik me Qëndrën. Duke qënë kështu tek: shq. **dar** (ku **a** është e gjatë duke zëvendësuar një formë arkaike me **aa**) ne duhet të shohim **dà ar** dhe me qënë se:

$$\textbf{ar} = \textit{Qëndër} = \bigcirc$$

ne shikojmë se **dà ar** mund të shkruhet simbolikisht si ⦶, ku ○ rri për **ar** dhe "|" rri për **da** (*ndarje*).

E njëjta gjë mund të thuhet për *yll,* në fjalët si *p-yll, f-yll, m-yll,* ... e kështu me radhë. Në gjuhë të tjera (p.sh. romane) ai ka dhënë artikullin e shquar (në lat. **ille** = **ai**, që nga edhe nyja e shquar (articolo determinativo) në it. **il**). Në gjuhë të tjera ky artikull u pasvihet emrave, si bie fjala në rumanishten **-ul**. Po një pasvënie e tillë vihet rè edhe në shqip si në **uth-ull, qerth-ull**, ... Duke qënë kështu, duke përgjithësuar lidhur me këtë mënyrë të pozimit të Qëndrës nga Gjuha, ne mund të themi se, gjer në një farë mase, *një numër i madh fjalësh mund të vështrohen si thjesht mënyra të ndryshme të përcaktimit të Qëndrës.* Dhe arrijmë kështu tek një paralelizëm i përsosur mes parimit bazë të Fillosofisë së Spinozës dhe llogjikës së Gjuhës: tek Fillosofia e Spinozës kemi një SUBSTANCË (fjalë për fjalë "shka qëndron **ndën**"; *lirisht* në angl. *The underlying Reality*) dhe një morì modusesh (mënyrash se si kjo substancë determinohet, manifestohet) që nuk janë tjetër veçse sendet e kësaj Bote. Mos harrojmë se *Qëndra* = $(x = -x)$ = ○ = − ⦶ = e *papërcaktuar* e pra dhe *e papërkufizueshme*, e pra dhe *e pamatshme*, e pra dhe *e pa konceptueshme* (pamë se Qëndra shprehej me simbole e jo me koncepte...). Dhe e tillë është edhe Substanca e Spinozës. Pra atëhere, po ashtu si sendet në fillosofinë e Spinozës nuk janë tjetër veçse moduse, mënyra të ndryshme të përcaktimit të *Substancës,* po ashtu edhe **fjalët mund të vështrohen thjesht si mënyra** (*moduse*) **të ndryshme të përcaktimit të Qëndrës.**

Gjuha i referohet Qëndrës edhe ndryshe.

Qëndra vështrohet si një entitet i privilegjuar me predikate, atribute që zotërojnë një shkallë intensiteti maksimal, superlativ, infinit... Pra dhe **Gjuha** atëhere, **duke iu referuar siç pamë Qëndrës, nuk mund të emërtojë** (denominojë) **veçse kështu, në mënyrë** (shkallë) **superlative, absolute**.

Le të sjellim ndonjë shëmbull konkret. Le të marrim në frëngjisht fjalën: **dommage** (shq. *dam*). Del pyetja: Si është krijuar kjo fjalë? Sipas një *paradigme,* sipas një modeli (të epërm) si çdo fjalë tjetër. Kjo do të thotë se ajo duhet ta zotërojë vetinë e "dëmshmërisë" në një shkallë superlative. Pyesim: Nga cili na vjen **dami** më i madh, kush është vetë mishërimi i **damit**? **Demoni**!... Ndaj pra dhe fjala *dommage* në frëngjisht, siç mund të provohet edhe me një procedure të thjeshtë etimollogjike, është sajuar sipas *modelit* të demonit.

Le të marrim një shëmbull tjetër. Në rusisht, siç kemi parë **bjez** (*без*) = *pa* (angl. *without*), pra kjo fjalë shpreh *mangësi, negativitet*. Por djalli, demoni vështrohet dhe përcaktohet theollogjikisht si një qënie e mangët e pra si e tillë edhe *negative* (*mangësi = jo plotësi, jo tërësi* = $-\bigcirc = -1$ = *negativitet*), *e keqe* (●). Ai është madje qënia më e mangët, më negative, më e keqe që mund të ekzistojë. Kështu atëhere fjala *bjez* ($-\bigcirc$, −1) në rusisht është sajuar duke patur parasysh *demonin*, i cili në rusisht quhet **bjes** (*бес*).

Le të marrim në anglisht fjalën **son** (*djali*). Si është krijuar kjo fjalë? Si çdo fjalë tjetër, duke patur parasysh një paradigmë të epërme, *djalin* "par excellence". Por *djali* "par excellence", është **dielli**. *djali i Qiellit*, në anglisht **sun**. E njëjta gjë edhe në shqip me ***djalë / diell;*** e njëjta gjë në gjermanisht me **Sohn** (*djali*) dhe **Sonne** (*dielli*), dhe e njëjta gjë në rusisht me **sin** (*сын*) dhe **sonce** (*солнце*).

Në shqip **i zoti** (angl. *able*; *skillfull*; *capable*). Si është krijuar kjo fjalë? Me referencë tek **Zoti**, që është vetë Qëndra, që është modeli i pambrritshëm i çdo zotësie, zotësia pra "par excellence".

Në anglisht kemi **good** (*i mirë*). Edhe kjo fjalë ka shumë të ngjarë që të jetë krijuar me referencë tek Zoti, në anglisht **God**, mishërimi dhe burimi i çdo mirësie (angl. **good***ness*).

Në shqip **pak** (it. *poco*, angl. *few, a little*). Kjo fjalë është krijuar me

referencë, si model i epërm, tek fjala **pikë** (angl. *point*), dhe kjo sepse **pika** që është si pikë gjeometrike një *vrimë* përfaqëson pakësinë absolute, "par excellence" mungesën absolute të çdo sasie. Le të vëmë rè këtu shkarazi se ekziston ekuacioni *pikë* (gjeometrike) = *Qëndër*[*] e pra, duke qënë kështu, kemi prapë edhe ne këtë rast një referencë tek Qëndra. Vëmë rè gjithashtu se në shqip thuhet për shëmbull "Më jep një *pikë* uji", për të thënë "Më jep *pak uji*", gjë që rikonfermon edhe më tepër tezën se **pak** < **pik** ku shënja "<" rri si këtu e gjetkë gjatë këtij studimi për "*vjen nga...*".

Në shqip **zë** (*filloj* - angl. *to begin*). Si është sajuar kjo fjalë? Ndoshta duke ju referuar *zë-nies* (*fillimit*) arketipal (të Botës) me anë të *zë-rit* (*zanit*). Në të folmen e Veriut *zani* dhe *zania* (në tosk.: *zëri* dhe *zënia*) = *fillimi* [**].

Në shqip **ndërtoj** (angl. *to build*). Kjo fjalë është sajuar me referencë tek *ndar-ja* dhe kjo për arësye se ndërtimi i parë (ai i Botës) është kryer, sipas një miti kozmogonik me anë të një ndarjeje.

Në shqip **themel** (angl. *foundation*). Kjo fjalë është sajuar me referencë tek *thym*-ja, dhe kjo sepse themeli i parë (i Botës) është vënë me anë të një *thymje* (*ndarje*, *prerje*, etj.). Vëmë re këtu shkarazi se në gjermanisht: ***brechen*** (*thyej*) e pra simb. ⌀, ndërsa *Aufbruch* (*fillimi*) e pra simb. -1. Jo vetëm mitet kozmogonike flasin për një *thymje primordiale* por edhe shkenca moderne e Kozmollogjisë flet për thymjen e Supersimetrisë[***] si shkas për krijimin e Botës materiale, të Kozmosit.

Në rusisht **delats** (*делать*) = *bëj*. Kjo fjalë është sajuar me referencë tek fjala tjetër rusisht: *delits* (*делить*) = *ndaj*, *pjestoj*. Dhe kjo sepse fillimi i Botës është kryer mitikisht dhe mistikisht me një ndarjeje. Paracelsus: "Die Separatio

---

[*] *pika gjeometrike* = $(x^2 + y^2 = 0) = (x = -x) =$ *Qëndra*

[**] "**Sound** In India, the sound of Krishna's flute is the magical cause of the birth of the world. The pre-Hellenic maternal goddesses are depicted holding lyres, and with the same significance. There are other traditional doctrines which hold that sound was the first of all things to be created, and that which gave rise to all others...". (Në Hindi zëri i fyellit të Krishnës vështrohej si shkaku magjik i lindjes të Botës. Perëndeshat amësore pre-Helenike, pikturohen me lira në dorë, gjithë po me atë kuptim. Sipas disa doktrinave të tjera tradicionale, zëri ka qënë gjëja e parë që është krijuar dhe që u bë pastaj zanafilla për lindjen e të gjitha sendeve të tjera duke filluar me dritën, ose me ajrin dhe zjarrin...), Cirlot, fq. 300.

[***] Shih *Ndërtimi i Algoritmit Simbolik duke u nisur nga Hiçi*.

ist aller Geburt Anfang".

Në shqip **bash**-k (angl. *together*) lidhet, siç mund të provohet, brënda Shqipes me fjalën *pes* = 5. Dhe kjo sepse Gjuha, siç e kemi thënë e përsëritur kaq e kaq herë, referon gjithnjë tek një paradigmë a model absolut, superlativ, primordial. Në këtë rast referenca është tek bashkimi "par excellence" i njohur si "Martesa e Shënjtë" (greq. *Hieros Gamos*) mes *Qiellit* (me numër simbolik 3) dhe *Tokës* (me numër simbolik 2). Simboli i këtij bashkimi është numri *pes* (5). E pra dhe këtu referenca është tek një model superior, qëndror.

Mund të vijojmë kështu për një kohë të gjatë. Por mendojme se edhe me kaq lexonjësi e ka të qartë që Gjuha, edhe në këtë mënyrë, sikundër edhe në një sërë mënyrash të tjera, referon tek Qëndra dhe tek Ngjarja më e rëndësishme atje përmes saj: Krijimit të Botës.

Kjo duhet kuptuar mirë, ndryshe thelbi i thelbeve të Gjuhës do të na shpëtojë. Kështu kur Shqipja na thotë p.sh. "Nga ndarja, ndyrja" duke shtruar në këtë mënyrë ekuacionin e rëndësishëm simbolik: (⌀ = ●), kjo nuk do të thotë se "çdo ndarje është e ndyrë", por që ndarja e parë qe e tillë, sepse ajo u bë shkas për krijimin e Botës e cila sipas Mendimit Mistik është e tillë, e ndyrë, e keqe.

Kështu gjithashtu kur Shqipja na thotë "Çdo *bërje* është një *bjerrje*" kjo nuk do të thotë se është gjithmonë kështu, se "Çdo" bërje është një bjerrje, sepse referenca është tek "bërja" e parë, tek ajo e Botës, që qe me të vërtetë një *bjerrje* (një *rënie*, angl. *fall*) për Mendimin Mistik.

Kur gjermanishtja na thotë se *fillimi*, *zënia* (gjerm. *Anfang*), lidhet me një *kapje*, me një *zënie* (gjerm. *fangen*), kjo nuk do të thotë se çdo fillim kryhet në këtë mënyrë, d. m., th. me një *kapje*, me një *zënie*, por vetëm fillimi i Botës u krye ne këtë mënyrë. E kështu me radhë...

Kështu pra, e përsërisim edhe një herë: **referenca është gjithnjë tek Qëndra dhe, përmes saj, tek Krijimi i Botës**, dhe ajo vlen në mënyrë absolute vetëm për ato dhe jo për çdo situatë (fjalë) që modelohet sipas tyre por nuk identifikohet realisht me to.

Në lëmin e Etnollogjisë vihet rè diçka analloge me sa pamë më sipër lidhur me referencën tek Qëndra dhe tek ngjarja më e rëndësishme në të. Le të shfletojmë për këtë librin "*Le mythe de l'éternel retour. Archetypes et*

répétition" të Mircea Eliade*. Në këtë libër tregohet se si për njeriun primitiv gjithshka, çdo veprim, duhej kryer sipas një modeli të epërm, hyjnor, ndryshe do të mos kishte ndonjë kuptim dhe do të mos ishte madje as real dhe as efikas. Por le ta lëmë vetë autorin të na flasë për këtë. Në kapitullin: *Répétition de la Cosmogonie* (fq. 30 të *Editions Gallimard*, 1969), ai shkruan:

> 1) Toute création **répète** l'acte cosmogonique par excellence: La Création du Monde. (Çdo krijim përsërit aktin kozmogonik "par exellence": krijimin e Botës.)
>
> 2) en consequence, tout ce qui est **fondé** l'est au Centre du Monde (puisque comme nous savons, la Création elle-même s'est effectué a partir d'un centre). (Për pasojë, gjithshka që ka një **themel**, e ka atë në Qëndër të Botës (sepse siç dimë, vetë Krijimi është bërë duke u nisur nga një qëndër.)
>
> Në kapitullin "Modèles divines des rituels (fq. 33) lexojmë "... chez les **primitifs non seulement les rituels ont leur modèle mythique, mais n'importe quelle action humaine acquiert son efficacité dans la mesure ou elle *répète* exactement une action accompli au commencement des temps par un dieu, un héros ou un ancêtre".**
>
> **("...tek njerëzit primitivë jo vetëm ritualet kanë një model të tyre mistik, por edhe çdo veprim njerëzor bëhet i efektshëm për aq sa *përsërit* pikë për pikë një veprim të kryer në fillim të kohërave nga një perëndi, nga një hero apo nga një paraardhës i rëndësishëm.")**

Në kapitullin: "*Les mythes et l'histoire*", lexojmë ndër të tjera:

> **Un objet ou un acte ne devient réel que dans la mesure ou il *imite* ou *répète* un archetype. Ainsi la realitè s'acquiert exclusivement par *répétition* ou *participation*;** tout ce qui n'a pas un modèle exemplaire est "dénue de sens", c'est-a dire manque de réalité. Les hommes auraient donc tendence a devenir archetypaux et paradigmatiques... L'homme des cultures traditionelles ne se reconnait comme réel que dans la mesure ou il cesse d'être

---

* Shih *Pjesën e parë* të këtij studimi **Mircea Eliade**:, fq. 16, 124, 135, 203, 213

lui-même (pour un observateur moderne) et se contente d'**imiter** et de **répéter** les gestes d'un autre. En d'autre termes, il ne se reconnait comme **réel**, c'est-a-dire comme "véritablement lui - même" que dans la mesure ou il cesse précisement de l'être (fq. 48).

(Një objekt ose një veprim bëhet real vetëm për sa e për aq sa ai **imiton** apo **përsërit** një arketip. Kështu pra Realiteti arrihet vetëm nëpërmjet **përsëritjes** apo **pjesëmarrjes**; një send (a veprim) që nuk ka një model shëmbullor, "nuk ka kuptim", nuk ka realitet. Njerëzit do të prireshin pra të bëheshin arketipalë dhe paradigmatikë... Njerëzit e kulturave tradicionale e gjykonin veten si qënie reale vetëm për sa e për aq sa reshtnin së qënuri ata vetë (për një vëzhgues modern) dhe mjaftoheshin së imituari e së përsërituri *gjestet* (*bëmat*) e një tjetri. Me fjalë të tjera, njeriu tradicional e quan veten real, d.m.th. si "me të vërtetë ai vetë" vetëm për sa e për aq sa rresht së qënuri i tillë)

E njëjta gjë ndodh, siç pamë, edhe në Gjuhë: **çdo fjalë duhet të referojë tek një model, tek një paradigmë, ku koncepti që ajo shpreh realizohet në një dimension madhor, epror dhe arketipal par excellence. Kështu pra mënyra e denominimit (emërtimit) është bash në frymën e njeriut të hershëm, të asaj kohe pra kur ajo, Gjuha, dhe u krijua.**

Le të kalojmë tani në një çështje tjetër. Ne kemi parë se si fjalët me polisemantizmin dhe homonimitë e tyre shtrojnë ekuacione simbolike. Por këto ekuacione simbolike shprehin, kur përfshihen në kodin ***E***, *Qëndrën* dhe gjithshka ka të bëjë me të, a e thënë ndryshe: atë kohë pa kohë, atë hapësirë pa hapësirë para se Bota materiale të krijohej*, ndërsa, kur përfshihen në kodin ***F***, ato shprehin mite kozmogonike.

Le ta bëjmë më të qartë nëpërmjet shëmbullash se përse është konkretisht fjala.

Ne dimë se të gjitha mitet kozmogonike mund të përmblidhen në një kalim

---

* Rikujtojmë:

Qëndra = ($x = -x$) = E = (s = o, t = o) (*jo hapësirë, jo kohë*) = − ● = *jo Botë materiale...*

(që është një *rënie*) nga kodi ***E*** në kodin ***F***. Kjo del e qartë po të kihet parasysh se ***E*** = ○ = *hiçi* (ndër të tjera...); ***F*** = ● = *materia*, *Bota materiale* (ndër të tjera...). Kështu kalimi nga *Hiçi* tek *materia* dhe tek *Bota materiale* (krijimi) është pra, siç shihet, një **kalim** nga *kodi* ***E*** në *kodin* ***F***. Pra të gjitha mitet kozmogonike, sado të larmishme dhe sado të ndryshme nga njëri tjetri (në formë) qofshin, duhet t'i binden domosdoshmërisht kësaj skeme. Me qënë se nga ana tjetër kemi edhe:

$$F = \bullet = ♀ = \textit{rënie}\ (\text{angl. } \textit{fall})$$

ne mund të themi atëhere se krijimi i Botës lidhet me një *kalim* nga ○ (***E***) tek (***F***, ●), që do të thotë edhe me një *rënie* (♀) nga *FRYMA* (○ ka edhe një interpretim të tillë) tek *MATERIA* (●).

Skematikisht:

Krijimi i Botës = { ***E*** (○) ↓ ***F*** (●)
(*Miti Kozmogonik*)

Ato sa lexojmë lidhur me këtë çështje tek Cirlot e rikonfermojnë këtë.

"... It is almost unnecessary to point out that this form of motion, rotation on the vertical plane - descending and ascending - echoes the Platonic theories **of the soul's "fall" into material existence** and its need to find salvation by returning along the same path..." (fq. 383)

(...S'është ndoshta aspak e nevojshme të vëmë në dukje se një lëvizje e tillë, vërtitje në planin vertikal - zbritje e ngjitje - u bën jehonë teorive platonike mbi **"rënien" e shpirtit në ekzistencën materiale** dhe nevojën për të kërkuar shpëtim duke u kthyer pas nëpër të njëjtën rrugë...)

"...the terrestrial maze, as a structure or a pattern, is capable of reproducing the celestial, because both allude to the same basic idea - **the loss**

of the spirit in the process of creation - that is, the "fall" in the neoplatonic sense - and the consequent need to seek out the way through the "Centre", back to the Spirit... " (fq. 173)

(... labirinthi tokësor, si një strukturë a model, është në gjëndje të riprodhojë labirinthin qiellor edhe sepse që të dy nënkuptojnë të njëjtën idè bazë: **humbjen e Frymës gjatë procesit të krijimit, me fjalë të tjera, "rënien", në kuptimin neoplatonik të fjalës dhe nevojën, për pasojë, për të kërkuar një rrugëdalje përmes "Qëndrës", duke u kthyer prapë pas, tek Fryma**...)

Në shqip miti i rënies jepet ndër të tjera me:

*Çdo **bërje**, është një **bjerrje** (rënie; humbje)*

Në italisht:

*Ogni **accadere** e' un **cadere***

Në shqip gjithashtu:

*Bota **filloi** me nje **falje** (falitje)*

E kështu me radhë...

Këto janë ca shëmbulla lidhur me pasqyrimin e mitit kozmogonik të rënies në Gjuhë. Rënia e Adamit dhe Evës nga Parajsa rikonfermon mitin kozmogonik të krijimit. Lexojmë gjithnjë tek Cirlot (fq. 249):

"**Paradise Lost**. Symbolic of the mystic "Centre" - or rather, of its manifestation in space. Living aside the Christian dogma, there are a host of Western and oriental legends dealing with the lost Paradise. The **fall** of man from the paradisiac state and his return to it find varied manners of symbolic expression, the most characteristic being the labyrinth..."

(**Parajsa e Humbur**: Simbolizon "Qëndrën" Mistike, ose, më saktë, manifestimin e saj në hapësirë. Duke lënë këtu mënjanë dogmën e krishterë, mund të themi se ka një numër të madh legjendash si në Perëndim ashtu edhe në Lindje që flasin për Parajsën e Humbur... **Rënia** e njeriut nga gjëndja e tij

parajsore dhe kthimi i tij përsëri atje, kanë gjetur mënyra e trajta të shumta shprehjeje, por më karakteristikja syresh mbetet gjithmonë simboli i labirinthit.)

Puna jonë tani është të tregojmë një sërë shëmbullash që flasin për **përmbajtjen e miteve kozmogonike në Gjuhë.**

Një nga mitet kozmogonike është edhe ai i *çgjymtyrimit* (angl. *dismemberment*) të një Qënie Hyjnore me pjesët e të cilit ndërtoheshin pastaj pjesët e ndryshme të Kozmosit.

Një mit tjetër kozmogonik është ai i *sakrificës* (flijimit) kozmogonike që shpjegon krijimin e botës me një krim, me vrasjen e një Qënie Hyjnore.

Një mit tjetër kozmogonik është ai i *përpjekjes, konfliktit, ndeshjes, luftës* mes dy entiteteve të kundërta.

Një mit tjetër kozmogonik është ai i *Hieros Gamos*, martesës së shenjtë, bashkimit të Qiellit dhe Tokës.

E kështu me radhë...

Por pamvarësisht formave të ndryshme nëpërmjet të cilave mitet kozmogonike na paraqiten, ato janë që të gjitha simbolikisht ekuivalente mes tyre sepse mund të reduktohen në instancë të fundit në një kalim nga kodi ***E*** në kodin ***F***, siç vumë në dukje dhe më lartë.

Le të citojmë lidhur me këtë çështje nga Cirlot (fq. 65):

> "Cosmogony: The basis of most cosmogonies is the "cosmic *sacrifice*", expressing the idea that *the creation of forms and matter can take place only by* ***modifying primordial energy.*** Such a modification, so far as most primitive and protohistoric peoples are concerned, was seen to exist in such painful forms as **mutilation, struggle or** sacrifice. In Babylonian cosmogony it assumed the form of the killing of the original mother Tiamat (the dragon) whose body was used in the creation of heaven and earth. Hindi tradition

links the **struggle** of the gods with a tribe of devils called Asuras, or with monsters of some other kinds. According to the Rigveda, the gods would sacrifice a primeval being - the giant Purusha... In Scandinavia it was the giant Ymir who was dismembered by the Aesir gods and then used as the material for the creation of the world... Clearly, then, these cosmogonies have a psychological implication because *they express the central idea that there is no creation without sacrifice, no life without death...* Here we have the origin of all the bloody sacrifices of the world's religions."

(Kozmogonia: Themeli mbi të cilin ngrihet një numër i madh kozmogonish (lindja, prejardhja e Kozmosit) është "Sakrifica (flijimi) kozmike" që përçon idenë se krijimi i formave dhe i materies bëhet i mundur dhe realizohet vetëm nëpërmjet një **modifikimi** të **energjisë primordiale**.

Një modifikim i tillë, ndër popujt më primitivë dhe protohistorikë, realizohej në trajta të tilla të dhimbshme si *çgjymtyrimi*, *lufta* dhe *sakrifica* (flijimi, therroria, kurbani).

Në Kozmogoninë babilonase ky modifikim (i energjisë primordiale) merrte trajtën e vrasjes së nënës zanafillore Tiamat (dragoi), trupi i së cilës u përdor për krijimin e Qiellit dhe Tokës. Traditat hindiane e lidhin krijimin e Botës me **luftën** e perëndive me një fis djajsh, të quajtur Asuras ose me të tjera lloje monstrash. Sipas Rigvedas perënditë flijuan një qënie primordiale - gjigantin Purusha. Në Skandinavi i flijuari qe gjiganti Ymir i cili u shpërbë nga perënditë Aesir dhe u përdor pas asaj si lëndë e parë për krijimin e Botës... S'ka dyshim se të gjitha këto kozmogonira përmbyllin një nënkuptim psikollogjik sepse *ato shprehin idenë qëndrore se nuk mund të ketë krijim pa sakrificë, nuk mund të ketë jetë pa vdekje...* Që këndej dhe arsyeja dhe zanafilla e kurbaneve të përgjakshme të feve të ndryshme në botë.)

Në tekst na thuhet se krijimi i Botës kërkon një "modifikim të energjisë primordiale". Fjala *modifikim* këtu do të thotë *zvogëlim*. Por kalimi nga kodi E në F (skemë tek e cila, siç pamë, reduktohen të gjitha mitet kozmogonike) është pikërisht një modifikim, një zvogëlim, dhe kjo sepse:

$$E = \bigcirc \quad \text{dhe} \quad F = \textcircled{\scriptsize |}$$

dhe është e qartë se ⦶ < ○ ku simboli "<" rri këtu për *më e vogël*. Nga ana tjetër, me qënë se:

$$\bigcirc = \infty = (x = -x) = \text{Qëndra}^*$$

ne shohim se krijimi i Botës realizon një kalim nga:

infiniti (○, ∞) tek *finiti* (e mbaruara, e fundmja) (⦶)

Qëndra, nga ana tjetër, është një qëndër energjie, një energji që nuk mund të jetë tjetër veçse infinite. (Një gjë e tillë mund të vërtetohet rigorozisht.) Kështu pra, me ndihmën e simboleve arketipale të Algoritmit tonë Simbolik dhe lidhjeve llogjiko-mathematike mes tyre, ne jemi në gjëndje të vërtetojmë saktësinë e atyre sa lexojmë lidhur me krijimin e Botës përmes modifikimit të energjisë primordiale që, siç pamë, ishte infinite.

Le të tregojmë tani se ky mit themelor e përgjithësues kozmogonik është i "përmbyllur" në Gjuhë.

Le të marrim për shëmbull në frëngjisht fjalën **commencer**. Zbërthimi i kësaj fjale në pjesët e saj përbërëse jep **con men cer**. Këtu **con-** (*me*, angl. *with*), është prostatike, që do të thotë se nuk ndikon në semantizmin (kuptimin) e fjalës. **-cer** është një mbaresë foljore që ka shumë gjasë të jetë e identifikueshme me shqipen **kry**, **krej** dhe sanskritishten **khara** (*kryej*, *bëj*). Pra tërë theksi semantik rëndon mbi **men**. Në frëngjisht gjithashtu *di* **min** uer (*zvogëloj*). Në frëngjisht gjithashtu **moins** (it. *meno*), **minus** (= −), e kështu me radhë. Në të gjitha këto raste ne kemi të njëjtën rrënjë të pastër a, operator të lirë. Duke afruar atëhere *comMENcer* me *diMINuer*, ne mund të themi (me qënë se gjuha referon gjithmonë tek Qëndra dhe tek ngjarja më e rëndësishmja atje, siç është krijimi i Botës) se "Le Monde a comMENcé par une diMINution"**. Dhe kjo është pikërisht ajo që lexuam tek Cirlot lidhur me fillimin e Botës nëpërmjet një modifikimi (zvogëlimi) të Energjisë primordiale.

---

* Shih *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik.*

** Bota ka filluar me një zvogëlim.

Gjuha na thotë dhe në shumë mënyra të tjera se Bota ka filluar me një zvogëlim me të cilin edhe mbahet, që do të thotë që kalimi përtej cakut të këtij zvogëlimi do ta shkatërronte atë (sepse do të kishim:

$$> \text{⦶} = -\text{⦶} = \bigcirc = -\bullet = \textit{jo më materie, jo më Botë materiale...})$$

Në sanskritisht **matra** (*matje, masë* - angl. *measure*) e pra ⦶, dhe **matra** (*materie*) e pra simb. ●, e pra dhe Botë materiale. Por ⦶ < ○ = zvogëlim.

Në shqip **ndaj** = ⦶, **ndyj** = ● mund të interpretohet në të njëjtën frymë.

Nga ana tjetër, me qënë se ⦶ mund të interpretohet edhe si një *çgjymtyrim* (angl. *dismemberment*), ekuacioni simbolik (i përftuar përmes Gjuhës si më sipër) (● = ⦶) mund të interpretohet edhe, ndër të tjera, si miti i krijimit të *Botës materiale* (●) nëpërmjet një *çgjymtyrimi* (⦶). Rigjejmë kështu në gjuhë edhe një tjetër mit kozmogonik.

Në italisht **metà** (*gjysma*), e pra simb. ⦶ dhe **moto** (*lëvizje*), e pra simb. ~.

Italishtja shtron kështu ekuacionin simbolik:

$$\underset{\textit{metà}}{\text{⦶}} = \underset{\textit{moto}}{\sim} \qquad \text{...(F)}$$

që mund të interpretohet si fillimi i lëvizjes e pra krijimi i Botës me anë të një *zvogëlimi* (⦶ < ○), me anë të një *ndarje*, a me anë të vendosjes së një *kufiri*, a me anë të një *sakatimi*, ... e kështu me radhë, interpretime të cilat përbëjnë që të gjitha mite të ndryshme kozmogonike.

Në anglisht **mutilation** (*sakatim*), e pra simb. ⦶ dhe **mutation** (*ndryshim*) e pra simb. ~. Edhe anglishtja na thotë të njëjtën gjë duke shtruar të njëjtin ekuacion simbolik:

$$\underset{\textit{mutilation}}{\text{⦶}} = \underset{\textit{mutation}}{\sim} \qquad \text{...(F)}$$

Në shqip **ndeshje** e pra simb. Ϛ2 dhe **ndysì** e pra simb. ●.

Shqipja shtron kështu ekuacionin simbolik:

$$\underset{ndeshje}{\text{Ω}} = \underset{ndysi}{\bullet} \qquad ...(\mathbf{F})$$

Simboli ● mund të interpretohet edhe si *materie, Botë materiale.* Atëhere sipas Shqipes del se:

Bota materiale (●) është ndërtuar me një *ndeshje, përpjekje, luftë* (Ω)

Rigjejmë kështu mitin kozmogonik të krijimit të Botës nëpërmjet një *ndeshje* (angl. *struggle*) për të cilën flitet, më sipër, në citatin nga Cirlot.

Në të njëjtën frymë kozmogonike mund të interpretohet edhe kjo aforizëm në italisht:

Dopo ogni lotta (Ω) *un lutto* (●)*

Dhe po ashtu aforizma e shqipes:

Me u **zi** (Ω) *sjell* **zi** (●)

Në frëngjisht **pas** (shq. *pa* – it. *senza, non...*), e pra simb. -1; **pis** (shq. *më e keqe* - it. *peggiore, pessimo...*), e pra simb. ●. Kështu frëngjishtja, shtron ekuacionin simbolik:

$$\underset{pas}{-1} = \underset{pis}{\bullet} \qquad ...(\mathbf{F})$$

që mund të interpretohet, ndër të tjera, si:

Bota materiale filloi me një mohim

Me qënë se $1 = \bigcirc$ *, ekuacioni i mësipërm mund të shkruhet edhe si:

---

* *Pas çdo zënieje, një zi.*

$$-\bigcirc = \bullet \qquad \text{...(F)}$$

që mund të interpretohet në *frymë kozmogonike* si:

Bota është krijuar me mohimin (therjen, vrasjen) *e një Qënie Hyjnore*

Dhe rigjejmë kështu motivin (mitin) e Sakrificës së mirëfilltë kozmogonike, d.m.th. të **krym**jes së Botës me një **krim**.

Në gjermanisht **nicht** (*jo*) e pra simb. -1 dhe në të njëjtën kohë po në gjermanisht **nacht** (*natë*) e pra simb. ●, kështu edhe gjermanishtja shtron ekuacionin simbolik:

$$\underset{nicht}{-\bigcirc} = \underset{nacht}{\bullet} \qquad \text{...(F)}$$

e pra shpreh kështu njëlloj si frëngjishtja mitin kozmogonik me anë të një sakrifice (kurbani).

Në shqip po ky mit mund të shprehet ndër të tjera me **posë** (*përveç, me përjashtim të..., duke hequr* ...), duke hequr, e pra simb. $-x$ ose edhe, me qënë se Gjuha, siç thamë e pamë, referon tek Qëndra $-\bigcirc$; dhe me **pis** (angl. *filthy*), e pra simb. ●.

Në shqip gjithashtu **hek** (*një*), e pra simb. -1 (me qënë se siç e kemi vënë në dukje Bota për Mendimin mistik fillon me një *negativitet*) dhe në të njëjtën kohë **heqje** (*vuajtje*) e pra simb. ●.

Në të dy këto raste shqipja shtron ekuacionin simbolik:

$$\underset{posë,\ hek}{-\bigcirc,\ -1} = \underset{pis;\ heqje\ (vuajtje)}{\bullet} \qquad \text{...(F)}$$

Një mit tjetër themelor kozmogonik është edhe ai i Martesës së Shenjtë,

---

* Saktësia e këtij ekuacioni rikonfermohet siç kemi parë në rrafshin gjuhësor edhe, ndër të tjera, nga shqipja *kre, krejt*.

i bashkimit zanafillor për të krijuar Botën. të *Qiellit* (parimit mashkullor, ***3***) dhe *Tokës* (parmit femëror ***2***). Kështu numri simbolik i *martesës së shenjtë* është ***5*** siç lexojmë edhe tek Cirlot:

> "The *hieros gamos* is signified by **the number *five*, since it represents the union of the principle of heaven (three) with that of the** *Magna Mater* (two) (fq. 253)".
>
> (*Hieros gamos* tregohet me numrin pesë (**5**), me qënë se paraqet bashkimin e parimit Qiellor (**tre**) me atë të Magna Mater (**dy**))*

Duke qënë kështu shqipja me **pes** (5) dhe **pis** (●), duke interpretuar simbolin e fundit si *materie*, *botë materiale* shpreh pikërisht këtë mit kozmogonik.

Të njëjtën gjë bën dhe rusishtja me **pjat** (***пять***) = **5** dhe **pjatno** (***пятно***) = *njollë* e pra simb. ●. Pra mund të shkruajmë:

5	=	●	...(F)
pesë		*pis*	
пять		***пятно***	

Shqipja e shtron po këtë ekuacion me *bash-k* e pra simb. ☧ dhe *pes* = **5**.

Vëmë rè paraprakisht se nuk ka asnjë vështirësi për të vërtetuar linguistikisht se kemi **bash**-k < **pes** = **5** dhe kjo sepse **b** dhe **p** janë që të dy buzore, **sh** dhe **s** janë që të dy sibilante dhe nga ana tjetër në turqisht kemi **besh** = **5**.

Së dyti, rikujtojmë se Gjuha referon gjithmonë tek Qëndra dhe tek ngjarja me e rëndësishme në të dhe përmes saj, d.m.th tek krijimi i Botës (sipas këtij apo atij miti kozmogonik).

Duke qënë kështu, me qënë se **5** shpreh simbolikisht bashkimin më zanafillor, bashkimin paradigmatik, bashkimin "par excellence", është e natyrshme që gjuha ta emërtojë (denominojë) bashkimin (çdo bashkim) sipas fjalës **pes**, që nga dhe në shqip **bash**-k. Mund të shkruajmë si përfundim:

---

* Shih edhe p.sh. *Pjesa e parë* e këtij studimi, fq 166.

●	=	∞	=	5	...(F)
krijimi i Botës materiale	përmes një	**bashkimi**		*paradigmatik (Hieros gamos)*	

Ky mit kozmogonik shtrohet nga shqipja edhe me **nyje** (∞) dhe **nyj** (●).

Pra shqipja shtron ekuacionin:

∞	=	●	...(F)
nyje		*nyj*	

Dhe ky është, siç shihet, identik me ekuacionin e *Hieros Gamos*.

Në anglisht **to undo** = − **do** = *ç'bëj,* e pra simb. − ●.

Po në të njëjtën kohë në anglisht **to undo** (*the knot* = *nyjen*) = *zgjidh* e pra simb. − ∞. Kështu anglishtja shtron ekuacionin simbolik:

−∞	=	−●	...(E)
to undo		*to undo*	

Duke shumëzuar të dy anët e këtij ekuacioni me -1, do të kemi:

∞ = ● ...(F)

që është ekuacioni i krijimit të Botës materiale me anë të një bashkimi, siç pamë edhe më sipër.

E sollëm këtë shëmbull edhe për të treguar se "çbirimi" i miteve kozmogonike që fshihen thellë në gjuhë, kërkon herë herë ndonjë "artific", ndonjë procedurë "të tërthortë".

Në shqip **therr** mund të jepet simb. si $-x$ dhe, me qënë se Gjuha referon gjithnjë tek Qëndra, mund të shprehet simbolikisht si −○. Nga ana tjetër në shqip **thurr** dhe, me qënë se Gjuha referon tek Qëndra, është fjala për *thurrjen*,

krijimin e Botës.

Mund të shkruajmë:

$$-\bigcirc = \Upsilon \qquad \text{...(F)}$$

Por mund të shkruajmë, duke u mbështetur jo vetëm tek Algoritmi Simbolik por edhe drejtë për drejtë tek Gjuha: $-\bigcirc = \bullet$, dhe pra atëhere, duke zëvendësuar në ekuacionin e mësipërm, do të kemi:

$$\bullet = \Upsilon \qquad \text{...(F)}$$

Dhe ky është pikërisht ekuacioni kozmogonik i *Hieros Gamos*.

Ekuivalenca simbolike ($-\bigcirc = \bullet$) që ne shfrytëzuam më sipër dhe që shpreh në vetvehte mitin kozmogonik të *kurbanit* (*kurbani = një qënie hyjnore* = $\bigcirc$) jepet nga gjuha për shëmbull në shqip me ***posë*** (*përveç*) ($-\bigcirc$), dhe ***pis*** ($\bullet$), si edhe me ***mos*** ($-\bigcirc$), ***mush*** ($\bullet$) si edhe në shumë mënyra të tjera si në shqip ashtu dhe në gjuhë të ndryshme.

Le të vëmë rè me këtë rast edhe një gjë tjetër të rëndësishme. Ne mund të kalojmë nga një mit kozmogonik tek një tjetër, qoftë edhe vetëm linguistikisht, duke u mbështetur me fjalë të tjera vetëm tek Gjuha.

Në gjermanisht kemi p.sh.: ***schwarz*** ($\bullet$) dhe ***schwer*** (♀) dhe kjo është shprehja simbolike e mitit biblik të *rënies* (♀) të Adamit dhe Evës nga Parajsa për shkak të *mëkatit* ($\bullet$) të kryer *duke thyer urdhërin e Zotit*. Kjo është në të njëjtën kohë edhe dogma e mëkatit origjinal të Theollogjisë të Krishterë si edhe ajo e *Rënies* (angl. *Fall*) në përgjithësi.

Po ky mit jepet në rusisht me ***Bjes*** (*бес*) - (*djalli*), ($\bullet$) dhe ***vjes*** (*вес*) - (*peshë*), e pra ♀.

Po ashtu në shqip me ***pis*** ($\bullet$) dhe ***pesh*** (♀) e kështu me radhë.

Le të kalojmë tani, *nëpërmjet gjuhës,* nga ky mith tek ndonjë tjetër.

Në rusisht ***без*** (bjez) = *pa* (angl. *without*) e pra simb. $-\bigcirc$ dhe ***вес*** (vjes) = *peshë* (♀).

E pra simbolikisht do të kemi:

$$-\bigcirc = \varphi \qquad \text{...(F)}$$

Por kemi (shih më sipër), $-\bigcirc = \bullet$, e pra atëhere, duke zëvendësuar në ekuacionin e mësipërm, do të kemi:

$$\bullet = \varphi \qquad \text{...(F)}$$

Në shqip, siç pamë *nyj* (●) = *nyje* (⚹), që është ndër të tjera, siç dimë, edhe miti kozmogonik i Hieros Gamos. Por, nga ana tjetër, në shqip *ndysì* (●) = *ndeshje* (♋). Pra ne kalojmë kështu nga miti kozmogonik i Hieros Gamos në mitin kozmogonik të krijimit të Botës me anë të një *ndeshje, konflikti, lufte*. Me qënë se në shqip *ndyrje* (●) = *ndarje* (⌀), ne kalojmë kështu tek miti kozmogonik i krijimit të Botës përmes një *sakatimi* (angl. *mutilation*).

E kështu me radhë...

Provuam në këtë mënyrë se si, *qoftë edhe duke u mbështetur vetëm tek Gjuha, ne mund të kalojmë nga një mit kozmogonik tek një tjetër*. Kjo atëhere do të thotë se **në nivelin simbolik të gjitha mitet kozmogonike janë ekuivalente**. Ajo që e bëri të mundur këtë përfundim qe mundësia e kalimit, qoftë edhe duke u mbështetur vetëm tek Gjuha, nga një simbol tek tjetri. Kjo do të thotë atëhere se një simbol, një pjesë e kodit ***F*** a kodit ***E***, mund të riprodhojë gjithshka përfshihet në këto dy kode, d.m.th. të gjitha simbolet që bëjnë pjesë aty si edhe, për pasojë, të gjitha interpretimet konceptuale (rrezet semantike) të të gjithë këtyre simboleve. Kjo cilësi e Algoritmit Simbolik e pra rrjedhimisht edhe e Gjuhës, vë në dukje faktin themelor se *Gjuha* (ashtu si Algoritmi Simbolik) *është një sistem* ***holografik*** *apo shkurt një* ***hologramë****, e pra, siç pamë, një sistem i tillë ku çdo pjesë është në gjëndje të riprodhojë të Tërën*[*].

Kjo na lejon t'i përgjigjemi edhe kësaj pyetje: sa mite kozmogonike ka e mund të ketë, sa është numri i tyre dhe si mund t'i gjejmë ato?

---

[*] Shih edhe *Algoritmi Simbolik si Hologramë*.

Përgjigja është kjo:

Numri i miteve kozmogonike të mundshme është i barabartë me shumën e të gjitha interpretimeve konceptuale të të gjitha figurave simbolike në kodin *F*.

*Për gjetjen (krijimin) e një miti kozmogonik mjafton të nisemi pra nga një interpretim çfarëdo i një figure çfarëdo të kodit **F**.*

Marrim për shëmbull simbolin ⊕. Një rreze semantike e kësaj figure simbolike është edhe *matja* (angl. *measure*, sanskr. *matra*).

Po kemi:

matje = ⊕ = ● = *materie; krijim i Botës materiale*

Sanskritishtja e rikonfermon një gjë të tillë në një mënyrë krejt transparente siç kemi parë me ***matra*** (*matje*) dhe ***matra*** (*materie*). Shtojmë mbi këtë se ky është vërtet një mit kozmogonik, por një pohim i tillë rikonfermohet edhe nga shkenca më bashkëkohëse (Fizika Kuantike) sipas së cilës:

Realiteti material krijohet gjatë procesit të matjes

*Ky është një moment kur Miti dhe Shkenca **takohen**, kur si njëri si tjetra thonë, secili në gjuhën e vet, të njëjtën gjë. Raste të tilla takimi mes Mendimit Mitik dhe Shkencës bashkëkohëse janë të panumërta.*

Por ne kalojmë kështu në një pikë tjetër:

Shkenca e rè e zgjeruar e Etimollogjisë

Në këtë studim procedohet ndryshe nga shkenca e vjetër e Etimollogjisë për zbulimin e prejardhjes së fjalëve dhe për përcaktimin e vjetërsisë së tyre si edhe të sistemeve gjuhësore në të cilët ato përfshihen. Këtu i jepet përparësi Semantikës ndaj Fonetikës. Dhe kjo sepse, porsa që pranohet se fjalët kanë një kuptim më vete (dhe ne e dimë mirë tashmë se çfarë kjo do të thotë), shkenca e kuptimeve, e pra *semantika*, duhet të lozi patjetër një rol vendimtar.

Vendoset kështu një lidhje e ngushtë mes Gjuhës (brendia kuptimore e fjalëve) dhe Mendimit, e pra atëhere edhe mes Gjuhës e Fillosofisë. Le ta sqarojmë këtë me ndonjë shëmbull.

Marrim në sanskritisht fjalën **matra** në kuptimin e *materies* dhe fjalën **matra** në kuptimin e *matjes*.

Për të shpjeguar kuptimet kaq të ndryshme të së njëjtës fjalë, ne s'kemi rrugë tjetër veçse t'i drejtohemi fillosofisë (si "shkencë" e Mendimit). Dhe fillosofia, e pyetur siç duhet dhe në thellësi, na thotë se mes **matjes** dhe **materies** ekziston një lidhje e thellë. Të lashtët e kanë ditur këtë, pra dhe për ta "sinjalizuar" atë, i kanë treguar me të njëjtën fjalë këto dy koncepte, në dukje kaq të ndryshme.

Por këtë lidhje e ka *rizbuluar* sot edhe shkenca e Fizikës, e cila në stadin e saj më aktual, na thotë krejt haptas se "Materia dhe objektet materiale lindin gjatë procesit të matjes". Pa këtë poçes, *materia* (*lënda*) nuk do të mund të lindte, të krijohej. Ky është një pohim tej tërëpërmbysës i vizionit të vjetër të shkencës klasike. Në instancë të fundit, na thotë më tej Fizika Kuantike, me qënë se *matja* **krijon** *materien* dhe me qënë se matjen e kryen shkencëtari, vrojtuesi, është atëhere ai, *vrojtuesi që, vetëm me faktin e vrojtimit,* ***krijon*** *materien dhe sendet materiale*. Po ky është një pohim fillosofik. Dhe ja pra se si neve, duke studiuar fjalën sanskrite **matra**, më saktë, biseminë e saj, me qëllime "thjesht"

etimollogjike, u hodhëm papritmas e padashur në Fillosofi.

Saktësinë e etimollogjizimit, të shpjegimit të bisemisë të fjalës sanskritishte **matra** duhet ta vendosë në instancë të mbrame, shkenca, fillosofia. Dhe ato e vendosin pozitivisht, duke na rikonfermuar shkencërisht, fillosofikisht, se është fjala në të dy rastet për të njëjtën rrënjë dhe se nuk kemi të bëjmë aspak këtu me një rastësi. Njihet teza e famshme e fillosofit të madh idealist anglez Berkley: *Esse est percepi*, që do të thotë, me fjalë të tjera, se *sendet ekzistojnë për sa mund të perceptohen*, se është vetë e vetëm *akti i perceptimit* (e pra i vrojtimit, i matjes), ai që krijon sendet dhe botën materiale.

Ky shëmbull na zbulon një pikë të rëndësishme takimi ndërmjet gjuhës sanskritishte (*matra, matra*), Mendimit Mitik, Fizikës Kuantike dhe Fillosofisë (Berkley).

Nga ana tjetër Algoritmi Simbolik na jep:

$$\underset{\substack{\textbf{matra}_{\text{sanskr.}} \\ \textit{ndarë}_{\text{shq.}}}}{\oplus} \quad = \quad \underset{\substack{\textbf{matra}_{\text{sanskr.}} \\ \textit{ndyrë}_{\text{shq.}}}}{\bullet} \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

gjë që do të thotë se Algoritmi Simbolik rikonfermon saktësinë, vërtetësinë e bisemisë së fjalës sanskritisht **matra** gjersa kjo bisemi prestohet për të shtruar një ekuacion simbolik të rëndësishëm të kodit $\boldsymbol{F}$ (që në shqip jepet ndër të tjera edhe me *ndarë / ndyrë*).

Mund të sillen shëmbulla të panumërta të kësaj natyre, ***takimesh*** *themelore mes fushash të ndryshme të Dijes*. Por ajo për të cilën më tepër se çdo gjë tjetër ne jemi të interesuar të nxjerrim në pah këtu, është fakti i **zgjerimit** që sjell me vete shkenca e rè e etimollogjisë që e kontrollon saktësinë e rezultateve të saj duke dalë jashtë suazës të një specializimi e profesionalizmi të ngushtë, për t'u mbështetur mbi një kriter më të sigurt e universal vërtetësie të rezultateve, siç është ai që na ofron mendimi, fillosofia e madje, do të shtonim këtu, edhe *Philosophia Perennis* d.m.th. fondi i artë i urtësisë enciklopedike, universale dhe të pavdekshme të Njerëzimit.

Le të shikojmë tani një aspekt tjetër, më të mirëfilltë, të zgjerimit të shkencës

së rè të etimollogjisë ndaj të vjetrës. Ky është zgjerimi që ajo i bën mundësisë së përqasjes (afrimit dhe krahasimit) të gllosave nga dy gjuhë të ndryshme për qëllime etimollogjike. Ajo zbulon dhe merr parasysh mes fjalëve të ndryshme të një sistemi gjuhësor një sërë lidhjesh jo vetëm llogjike, por edhe **mitike**, të cilat shkenca klasike e etimollogjisë s'i mirrte parasysh dhe nuk mund t'i mirrte dot parasysh.

Një gjë e tillë bëhet e mundur edhe e sidomos për faktin se, sipas asaj, *fjala referon tek e mbramja jo tek koncepti* (*siç mendonte shkenca klasike e etimollogjisë*) *por tek simboli* i cili lidhet me një kod tjetër llogjik, me atë të të *Tretit të Përfshirë* (shih *Hyrjen*).

Dimë se llogjika e të *Tretit të Përfshirë* (ajo e simbolit) mund të shkruhet:

$$(x = -x) = E = \bigcirc$$

ndërsa ajo e të *Tretit të Përjashtuar* (ajo e konceptit):

$$(x = x) = F = \textcircled{1}$$

Por shihet qartë se:

$$\bigcirc > \textcircled{1}, \quad \text{e pra} \quad E > F$$

pra dhe kështu del vetiu se:

Shkenca e rè e etimollogjisë > Shkenca e vjetër e etimollogjisë

Ku shenja ">" ka këtu kuptimin e një gjerësie më të madhe, atë të *përfshirjes*.

Dhe tani le të sjellim disa shëmbulla lidhjesh mitike mes fjalëve të cilat shkenca e vjetër e etimollogjisë i linte "llogjikisht", me "arsye", detyrimisht jashtë...

Le të marrim në sanskritisht fjalën **sûrya** = *diell*.

Ne mund të themi pa frikë se kjo fjalë s'është tjetër veçse shqipja **syri** = fr. *oeil*, angl. *eye*. Pse? Po sepse:

1. Këto dy fjalë kanë forma të përngjashme (janë thuajse homonime).

2. Ekziston një lidhje mitike (por jo "logjike") mes tyre.

Dhe me të vërtetë tek libri kaq herë i cituar i Cirlot lexojmë:

"(The Sun) in India, as **Sûrya**, it is the eye of Varuna; in Persia, it is the eye of Ahuramazda; in Greece, as Helios, the eye of Zeus (or of Uranus), in Egypt, it is the eye of Ra, and in Islam, of Allah" (fq.317).

((Dielli) në Indi, si **Sûrya**, vështrohet si *syri* i Varunës; në Persi ai është **syri** i Ahuramazda-s; në Greqi, si Helios, është **syri** i Zeusit (ose i Uranusit), në Egjipt është **syri** i Ra dhe në Islamizëm ai i Allahut).

Po për ato arsye angl. **sun** = *dielli*, lidhet mitikisht me shqipen **syni**. Gjithmonë tek Cirlot, lidhur me diellin lexojmë:

"... the Sun appears as the direct **son** and heir of the god of heaven ..." (fq. 317).

(... Dielli paraqitet si **bir** dhe si trashëgimtar i drejtpërdrejt i perëndisë së Qiellit...).

Ndaj pra dhe në shqip:

$$\textbf{syni} \rightarrow \textbf{sun}_{\text{angl.}} \rightarrow \textbf{son}_{\text{angl.}}$$

si edhe:

$$\textbf{çuni}_{\text{shq.}} \rightarrow \textbf{syni}_{\text{shq.}} \rightarrow \textbf{sun}_{\text{angl.}} \rightarrow \textbf{son}_{\text{angl.}}$$

Vëmë rè se në shqip lidhja mitike e anglishtes *sun* dhe *son*, jepet edhe me *djali* dhe *dielli*.

Për arsyet që numëruam më lartë, shkenca klasike e Etimollogjisë nuk mund ta bënte kurrsesi këtë lidhje e pra do ta linte atë jashtë, do të mos e përfillte.

Nga ana tjetër, me qënë se shqipja **syni** lidhet me anglishten **sun** (*dielli*), dhe me qënë se *dielli* lidhet llogjikisht, me *vitin*, i cili nuk është gjë tjetër veçse një vërtitje e plotë e Tokës rreth Diellit, del se fjalë të tilla si **sene** $_{\text{turq.}}$ = *vit* ; **senior**

lat., **senior** angl. = *plak;* **senato** it. = *senati* (kuvendi i pleqve në Romë) e kështu me radhë mund të reduktohen etimollogjikisht tek shqipja **syni**, duke gjetur kështu në këtë mënyrë në të motivimin e tyre të plotë.

Një tjetër shëmbull analog do të ishte ai i sanskritishtes **vatsa** (*viç);* në shqipen e Veriut edhe **vjeta**.

Në sanskritisht **vatsa** = *viç* (*vjeta*) por edhe *vjet* (fr. *année*, angl. *year*). Kemi të bëjmë pra këtu me një bisemi, d.m.th. me dy kuptime krejt te ndryshme të së njëjtës fjalë. Por ndonëse mes tyre nuk ekziston asnjë lidhje llogjike, ekziston veç një lidhje mitike. Dhe kjo për arsye se **vatsa** në sanskritisht do të thotë edhe *djal* (qoftë edhe në kuptimin përkëdhelës, si i biri i Lopës, personazh madhor në Panteonin hindian), edhe *vit;* e pra jemi në kushtet e një lidhjeje mitike mes **diellit** dhe **djalit**, gjë për të cilën u fol gjerë e gjatë më lartë. Që këndej pra atëhere lidhja në shqip mes **vjeta** (*viçi*) dhe **vjet** (angl. *year*).

Duke qënë kështu fjalë të tilla si **vetus** lat. = i *vjetër; vetustà* it.; *veterano* it.; **vjet**hij rus. (*ветхий*) = *i vjetër*, etj., etj., lidhen të gjitha si me motivuesin e tyre të mbramë me shqipen **vjeta** = *viç*.

Shëmbulla lidhjesh të tilla mitike **që vetëm shkenca e rè e etimollogjisë që ne po inagurojmë në këtë studim mund të na japë**, mund të silleshin plot e përplot. Mjaft syresh janë sjellë edhe në *Pjesën e parë* të këtij studimi. Me qënë se Gjuha ka lindur në një kohë kur vizioni (gjerm. *Weltanschauung*) që sundonte në tërë botën ishte ai mitik (sikundër është ende sot, në kohën tonë, ai racional e shkencor), del se **lidhjet mitike që shkenca klasike e etimollogjisë s'i ka përfillur, janë më të hershmet, më të thellat e pra dhe më të qenësishmet**.

Në shëmbullat që sollëm më sipër, lidhja mitike mes fjalëve të përngjashme e me kuptime të ndryshme, zbulohej drejt për së drejti nëpërmjet konsultimit me një fjalor të thjeshtë simbolesh (siç është p.sh. ai i Cirlot).

Por në një morì rastesh të tjera këto lidhje nuk janë të lehta për t'u diktuar. Duhet t'i drejtohemi për këtë si një *ndërmjetësi* një aparati të veçantë *euristik* (zbulues) siç është ***Algoritmi Simbolik*** që përbën një artikullim llogjik të mendimit mitik.

Ndonjë shëmbull nga praktika e procedura konkrete e etimollogjizimit sipas metodave të Shkencës së rè të etimollogjisë do ta bëjë më të qartë se përse është fjala.

Le të supozojmë se duam të dimë diçka mbi etimollogjinë e fjalës anglishte **down** që do të thotë *poshtë*.

Kjo është një fjalë e përbërë. E ndajmë në elementet e saj përbërëse (rrënjë të thjeshta a "operatorë të lirë", siç i kemi quajtur në *Pjesën e parë* të këtij studimi).

Do të kemi:

down —> **do + wn**

-wn është një trajtë e evoluar e një anglishte (anglosaksone) **ben** (krahaso me gjermanishten *schrei*-**ben**, *ster*-**ben**) që si një desinencë (mbaresë) verbalizonjëse do të thotë me shqipen **bën**, **ban** (fr. *faire*). Kështu që theksi semantik rëndon i tëri mbi **do**. Duhet pra që ky operator të tregojë konceptin e "poshtë-sisë", të "ramjes" a një koncept tjetër, lidhur por, në një mënyrë a në një tjetër, shumë ngushtë me të. Në anglisht **do** nuk e kryen këtë funksion. Por në shqip ne mund ta identifikojmë atë me **da** (folja *daj*) e pra simb. ⏀.

Algoritmi Simbolik na jep lidhjen (ekuacionin):

$$⏀ = ♀ \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

ku simboli i dytë shpreh konceptin e *rënies* e pra edhe atë të të qënurit *poshtë*. Dhe kështu ne atëhere kuptojmë përse fjala *down* e anglishtes ka atë kuptim që ka, d.m.th. *poshtë*.

Dhe këtu procesi i etimollogjizimit (që shndërrohet kështu në një proces **motivimi**) merr fund. Mund ta përmbledhim shkurtazi këtë proces si:

poshtë = ♀ = ⏀ = (**bën dà**)$_{\text{shq.}}$ (**do wn**)$_{\text{angl.}}$ (**down**)$_{\text{angl.}}$

Shtojmë këtu se në mendimin mitik, koncepti i *rënies* (e pra edhe ai i të

qënurit *poshtë*) edhe ai i *ndarjes* janë lidhur ngushtë bashkë në mitin kozmogonik të krijimit të Botës me një ndarje nga Zoti (Zoti = ○, ndarje nga Zoti = ⊕) pasuar nga një **rënie** (♀). *Ky është miti kozmogonik i quajtur i rënies* (angl. *fall*).

Në Theollogji, kjo është *ndarja* e engjëjve rebelë, me në krye Luciferin, *nga Zoti* (⊕) dhe *rënia* e tyre pas asaj *nga Qielli, nga Parajsa* (♀). Në këtë shëmbull pamë pra se si për të mbrrijtur tek miti kozmogonik (shpjegues e motivues) ndërmjetësia e Algoritmit Simbolik ishte, si edhe në shumë raste të tjera, e domosdoshme.

Le të marrim tani në frëngjisht fjalën **tomber** (*me rà,*) e pra simb. ♀.
Veprojmë si më sipër:

ber = shq. *bërë,*
tom = shq. *thym* (nga folja *me thy*).

me rà = ♀ = ⊕ = **(bërë thym)** shq. **(tom ber)** fr. **(tomber)** fr.

Ja, edhe këtu motivimi i fjalës frëngjisht *tomber* u bë duke e reduktuar atë (me ndihmën e shqipes) në një **mit kozmogonik**. Pra edhe këtu ajo që bëri të mundur motivimin (e pra etimollogjizimin) qënë lidhjet mitike, **miti**.

Mund të ndaleshim, lidhur me këtë çështje këtu, por me qëllim që lexuesi të "shkathtësohet" disi në **teknikën** e motivimit po marrim edhe ndonjë shëmbull tjetër.

Zgjedhim për këtë qëllim në shqip fjalën **ndaj** që do të thotë: 1) *pjesëtoj*; 2) *pranë*; 3) *pra, për këtë shkak, për këtë arsye*.

Pra tre kuptime krejt të ndryshme.

Ky është një rast (fenomen) i rëndomtë në gjuhë, ai i **polisemisë** (kuptime të shumta, të ndryshme të së njëjtës fjalë). Shkenca klasike e Etimollogjisë nuk është në gjëndje ta shpjegojë, ta zgjidhi "misterin" (për të) të polisemisë dhe pra kur përpiqet ta "shpjegojë" e bën këtë duke kuturuar se, gjatë evolucionit të gjuhës, fjalë që në fillim kanë qënë të ndryshme, jo vetëm nga kuptimi por edhe

nga forma, kanë ardhur duke u afruar rastësisht, herë herë gjer në atë pikë sa edhe të përputhen. Po punët natyrisht janë krejt ndryshe. Kuptimet e ndryshme të fjalës polisemike kanë mes tyre lidhje të thella mitike që, siç thamë, shkenca klasike e etimollogjisë as i dinte dhe as çante kokën t'i diktonte.

Por le të kthehemi tek shëmbulli i ynë.

Fjala **ndaj** në kuptimin e pjesëtimit do të paraqitej simb. ⦶.

Por Algoritmi Simbolik na jep:

$$⦶ = \aleph = 2 = \ldots \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

dhe $\aleph$ mund të interpretohet, ndër të tjera, edhe si *ngjitur* e pra *pranë*. Dhe motivohet kështu kuptimi i dytë i kësaj fjale. Por kemi gjithashtu:

$$\underset{ndaj}{⦶} = \underset{ndaj}{\leftrightarrow} = \underset{ndaj}{(x = x)} \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

dhe motivohet kështu edhe kuptimi i tretë i fjalës *ndaj*, ai i *shkakësisë* (për shkak se...), ai i *arsyes* (për arsye se ...). Ja pra atëhere përse shqipja i tregon këto tre kuptime me të njëjtën fjalë: sepse ato kanë një lidhje të thellë mes tyre.

Për t'u siguruar se kjo nuk është prapë një rastësi, le të shohim nëse e njëjta gjë ndodh edhe në ndonjë gjuhë tjetër.

Në gjermanisht **halb** (*gjysëm*), e pra ⦶ dhe në të njëjtën kohë des**halb** (*për këtë shkak*) ($\leftrightarrow$), (*për këtë arsye*) ($x = x$).

Në frëngjisht **puis** = *2*, e pra në bazë të Algoritmit Simbolik edhe $2 = F = ⦶$, **pièce** (*pjesë*), dhe në të njëjtën kohë **puis**-que (*pasi, mbasi, për shkak se, për arsye se*) ($\leftrightarrow$, ($x = x$)).

Në shqip përsëri: **pas**, e pra $2 = F = ⦶$, dhe **pasi** = $\leftrightarrow$, ($x = x$).

Në sanskritisht: **ardha** (*gjysëm*), $\frac{1}{2}$, ⦶, dhe **artha** (*shkak; arsye*), e pra $\leftrightarrow$, ($x = x$).

E kështu me radhë në një sërë gjuhësh. Kemi kështu një rikonfermë pangjuhësore. Për t'i rënë shkurt tërë kësaj bisede që do të vinte gjatë të vijohej (ndonëse jo pa fryt e interes) le të vërejmë se:

Fakti që gjuha e vështron arsyen si *dytësore* ($(x = x) = 2$) dhe si *gjysmake* ($(x = x) = \text{Ⓓ} = \frac{1}{2}$) është në përputhje të plotë si me mentalitetin e lashtë e të stërlashtë që ishte irracional, e po ashtu edhe me frymën e fillosofisë dhe shkencës moderne që e ka zbritur tashmë prej kohësh Arsyen nga froni i saj mbretëror.

Kështu pra Gjuha me polisemantizmin e fjalëve të saja ruan të paprekur në shekuj një thesar të paçmuar informacioni fillosofik e shkencor, gjë për të cilën duhet t'ia dimë për nder...

Mund të sillnim edhe shumë e shumë shëmbulla të tjerë. Po ato lexonjësi do t'i gjejë me shumicë e në çdo hap në motivimin, me anë të shqipes, të fjalëve polisemike të Sanskritishtes. Pra po i japim fund këtu, duke menduar se vërtetuam, për lexonjësin tonë të mënçur e mirëdashës, çfarë duhej vërtetuar: *gjerësinë më të madhe e tërëpërfshirëse të Shkencës sonë të rè të etimollogjisë ndaj asaj klasike.*

Ritheksojmë këtu se Shkenca e Rè jonë e Etimollogjisë, e bën atë një "Science des profondeurs", siç janë ndër të tjera sot Fizika Kuantike, Psikollogjia Analitike e Jungut etj., gjë që herët a vonë do të ndodhte. Kjo i jep asaj mundësira të shumta ndërkomunikimi e ndërveprimi brënda kuadrit të shfaqjes e konsolidimit relativisht të vonë të **interdishiplinaritetit** bashkëkohor me përfitime të shumanshme dhe të ndërsjellta në fushën e Njohjes.

Urtësia e Gjuhës

Analiza e Gjuhës (fjalëve) me ato kritere dhe me atë metodollogji të veçantë dhe origjinale me të cilën ne e kemi kryer, ku etimollogjia, fillosofia dhe llogjika bashkëpunojnë ngushtë mes tyre, **na lejon të vjelim nga Gjuha një informacion themelor që prek të gjitha fushat e Dijes dhe të gjitha sferat e Realitetit dhe që ka qënë i burgosur dhe i fjetur në të për shekuj e shekuj të shekujve me radhë**...

Por le të marrim ndonjë shëmbull konkret që do të na lejoje të shohim qartë në këtë problematikë.

Ne pamë se fjalët shtrojnë ekuacione simbolike dhe se ekuacionet simbolike, nga ana tjetër, shtrojnë mite kozmogonike, mite kozmogonike që, siç pamë fare pak dhe siç do të shohim më shumë më poshtë, mund të interpretohen edhe në shumë mënyra të tjera, jashtë Mitit, si të vërteta shkencore, fillosofike, theollogjike, etj., etj. jo vetëm të kohës sonë por të të gjitha kohërave. Dhe kjo i detyrohet faktit se referenca e Gjuhës, siç u përpoqëm të tregojmë në një mënyrë sa më bindëse, është për tek Qëndra, qëndër që identifikohet në instancë të fundit me Hyjninë, me Zotin që është siç shprehet Dante "... la somma Sapienza...".

Për shëmbull me *ndarje / ndyrje* shqipja siç pamë, shtronte ekuacionin simbolik:

$$\text{◑} = \bullet \qquad \text{...(F)}$$

Le të shikojmë disa interpretime të ndryshme të këtij ekuacioni:

1) Interpretojmë:

◑ = *kufi*

dhe:

● = *Bota materiale, Kozmosi, Universi material*

Mund të shprehim atëhere këtë gjykim:

Bota materiale ka një kufi

Dhe ja kozmollogjia moderne provon **krejt shkencërisht** se është pikërisht kështu. Kozmosi, na thotë ajo, ka një *fillim dhe fund në Kohë* (Teoria e Big Bang-ut dhe Big Crunch-it), si edhe *një kufi në Hapësirë* (Teoria e vrimave të zeza)*.

2) Interpretojmë ⦶ si *Separatio* (*ndarje*). Rigjejmë Paracelsus-in, mistikun e mjekun e famshëm të Mesjetës: *Die Separatio is aller Geburt Anfang.*

3) Interpretojmë ○ si *Zoti*. Kemi të drejtë ta bëjmë këtë sepse ○ (interpretuar si zero) = $(x = -x)$ = *Coincidentia oppositorum* = *Qëndra* = *Zoti*.

⦶ do të mund të interpretohet atëhere si *ndarje* nga Zoti.

Interpretojmë tani ● si *mëkat*. Mund të formulojmë atëhere këtë gjykim:

"Mëkati është ndarje nga Zoti"

Me qënë se simbolin e mësipërm (●), mund ta interpretojmë edhe si *Bota materiale*, ne mund të themi atëhere se *"Bota është e ndarë nga Zoti"*, që do të thotë ndër të tjera se ajo nuk është në gjëndje të komunikojë me të.

4) Duke interpretuar ⦶ si *copë, grimcë...* ne mund të shprehim atëhere këtë mendim që Fizika rikonfermon:

Materia është e përbërë nga pjesë, copa, grimca.

Ne rigjejmë kështu edhe atë që fizika quan *natyra diskrete* e materies dhe të gjithshkaje lidhet me të**.

---

* Shih për këtë edhe fq. 107, *Pjesa e parë* e këtij studimi.

** Si p.sh. *energjia* në bazë të formulës $\mathbf{e = mc^2}$ të Einsteinit.

Me qënë se Algoritmi simbolik na jep:

$$\sim \; = \; \text{⊕}^{*}$$

dhe me qënë se *lëvizja*, siç dimë, lidhet ngushtë me *energjinë*,** shikojmë se si nga Gjuha ne mund te nxjerrim natyrën diskrete të energjisë a, ç'është njëlloj, ekzistencën e *kuanteve të energjisë.*

Dhe së fundi vëmë rè se mund të përgjithësojmë e të themi se gjithshka përfshihet ne kodin ***F*** është e *kuantizueshme*, dhe kjo sepse mund të shkruajmë:

$$\boldsymbol{F} \; = \; \text{⊕} \; = \; \textit{kuanta, kuantizim}$$

E kështu ne gjejmë se edhe *bashkëveprimi* (⊗) është i kuantizueshëm, po ashtu edhe *koha*, po ashtu edhe *hapësira*, po ashtu edhe ... edhe ... (*çdo interpretim i një rreze semantike çfarëdo të një figure simbolike çfarëdo të kodit* ***F***).

Fizika Kuantike rikonfermon saktësinë e këtij përfundimi që mund të bëhet të rrjedhë vetëm nga Gjuha (e pamë se si ...).

Mund të shkruajmë siç dimë:

$(\boldsymbol{x} = \boldsymbol{x})$	=	⊕	...(**F**)
llogjika formale		*cak*	
arsyeja njerëzore		*përcaktim*	
llogjika e të Tretit të përjashtuar		*determinim*	

Ky ekuacion jepet nëpërmjet gjuhës p.sh. me gjermanishten ***deshalb*** = *prandaj, për këtë arsye* $(\boldsymbol{x} = \boldsymbol{x})$ dhe ***halb*** = *gjysëm* e pra ⊕; në shqip ***ndaj*** =

---

* Nëpërmjet gjuhës: p.sh. italishtja *moto* = *metà.*

** Kujtojmë p.sh. formulën e energjisë kinetike: $e_k = ½ mv^2$

për këtë arsye[*] ($x = x$), *ndaj* ($\oplus$), e kështu me radhë në një sërë gjuhësh.

Në qoftë se shumëzojmë të dy anët e ekuacionit të mësipërm me -1, do të kemi:

$$-(x = x) \quad = \quad -\oplus$$

e pra edhe:

$$-\oplus \quad = \quad (x = -x) \qquad \text{...(E)}$$

papërcaktim — *llogjika e të*
parimi i papërcaktueshmërisë — *Tretit të Përfshirë*
në Fizikën Kuantike
Fizika Kuantike

Pra del, edhe duke u nisur vetëm nga Gjuha, se ***në Fizikën Kuantike për të shpjeguar "paradoksalitetin" e rezultateve duhet përdorur një tjetër llogjikë.***

Kjo shpjegon, ndër të tjera, edhe përse Heisenbergu dhe Weizsacker[**] propozuan për këtë qëllim *llogjikën e të Tretit të Përfshirë.*

Një tjetër shëmbull përsëri nga Gjuha.

Në shqip ***pjesë*** = $\oplus$ dhe ***pasi*** (*për shkak se...*) = $\leftrightarrow$.

Pra shqipja shtron kështu ekuacionin simbolik:

$$\oplus = \leftrightarrow \qquad \text{...(F)}$$

Shumëzojmë të dy anët e këtij ekuacionin me -1. Do të kemi:

$$-\oplus = -\leftrightarrow \qquad \text{...(E)}$$

E pra atëhere edhe:

$$\textit{Fizika Kuantike}\ (-\oplus) = \textit{akauzalitet}\ (-\leftrightarrow)$$

gjë që flet për disfunksionimin e ligjit të shkakësisë në nivelin subatomik të

---

* Shih edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi, fq. 161.

** Shih edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi, fq. 159.

studiuar nga Fizika Kuantike. Shkenca "zyrtare" rikonfermon praktikisht këtë rezultat, me të cilin detyrohet të "pajtohet" më në fund edhe vetë Einsteini, armik i betuar i vizionit mistik të fizikantëve kuantistë mbi Botën*.

Ne mund të vazhdonim me të tjera shëmbulla të:

deduktimit me mjete thjesht gjuhësore të parimeve dhe fakteve bazë të fizikës kuantike dhe në përgjithësi të tërë Dijes bashkë kohore

por do dilnim fare jashtë kufijve të një studimi thjesht gjuhësor. Por ne shohim, sidoqoftë, edhe me kaq, se Gjuha është si një rezervuar i pashtershëm informacioni edhe shkencor. Askush gjer më sot nuk e ka parë Gjuhën nën këtë aspekt që do të mund ta quanim edhe *evristik* (*zbulues*) me gjithë se ka patur edhe gjuhëtare (si Carnap) dhe fillosofë (si Heidegger) që kanë nuhatur diçka të madhërishme dhe të thellë në gjuhë në fushën e Njohjes, ndonëse pa mundur të arrijnë në përfundime konkrete siç bëmë ne këtu. Jo më kot Gjuha u quajt në kohërat moderne "*a pilot science*" dhe u arrit të thuhet: "*Die Überwindung der Methaphysik durch logische Analyse der Sprache*"** (Carnap). Kështu në kohën tonë **Gjuhësia u vështrua si një disiplinë fillosofike e mirëfilltë**. Ndaj pra dhe:

Analizat tona fillosofike (*llogjike, etimollogjike*) *janë plotësisht të justifkuara nga pikëpamja e Dijes së Kohës sonë, ndonëse jo nga ajo e Gjuhësisë klasike tek pozitat, tashmë të superuara të së cilës, kanë ngecur ende të gozhduar jo pak gjuhëtarë nga brezi i vjetër.*

Ne mund të themi se ashtu sikundër kalimi nga fizika klasike (*deterministe*, ⓓ) në Fizikën moderne (*indeterministe*, $-$ ⓓ) s'është veçse një *kalim* (*ngjitje*) nga kodi *F* në kodin *E*, po ashtu edhe kalimi nga linguistika klasike në linguistikën moderne mund të vështrohet prapë gjithashtu si një *kalim* (*ngjitje*) nga kodi *F* në kodin *E*.

---

* Shih edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi, fq. 109.

** Superimi i Metafizikës nëpërmjet Analizës Llogjike të Gjuhës.

Dhe nuk mund të rrimë pa shtuar këtu edhe diçka me rëndësi.


Pamë se të gjitha mitet kozmogonike mund të silleshin në një ***rënie*** nga ***E*** në ***F***. Por ***E*** = ○ = **Hiçi**, shka *nuk* është *krijuar* (it. *l'Increato*) dhe ***F*** = ● = *Bota materiale*, ajo shka është *krijuar* (it. *il Creato*). Duke qënë kështu, *kalimi* (*ngritje*) nga kodi ***F*** në kodin ***E***, do të jetë një kalim *dal Creato all'Increato*.

Kështu pra atëhere jo vetëm Fizika por:

> **Të gjitha degët e Dijes së Kohës sonë, të quajtura "sciences des profondeurs" rreken të rrokin, të përshkruajnë jo më *këtë Botë materiale*, të *krijuar*, por *Atë Botë, spirituale*, të *pa krijuar*.**

Në këtë botë të pa krijuar *himanente* (të futur thellë, si një "pykë" në Botën tonë materiale) gjithshka është e *pandryshueshme* (***E*** = − ∼) gjithshka është e *përjetshme* (***E*** = (t = ○)) gjithshka është *universale* (***E*** = (s = ○)), gjithshka është e *lirë* dhe *absolute* (− ∞) ... Kjo atëhere, do të thotë, ndër të tjera, se **rezultatet e analizave tona gjuhësore janë përfundimtare, ato nuk mund të ndryshojnë, të superohen** dhe po ashtu është edhe informacioni i pasur dhe i larmishëm që vilet nga këto analiza.

Që Bota e *pakrijuar* (it. *l'Increato*) e pra edhe e padukshme është e "mbrëndashkruar" (*himanente*) në Botën tonë materiale, kjo del fare e qartë nga formula:



formulë kjo që përftohet nëpërmjet Gjuhës në shumë mënyra, si për shëmbull nëpërmjet bisemisë të italishtes **ni** (sanskritishtes **ni**, gjuhës kineze **nai** ...) që

jep:

$$-x = \boxed{x} \qquad \text{...(F)}$$

dhe në të cilën duke marrë $x = 0$ gjejmë përfundimisht formulën e mësipërme sepse kemi:

$$-\bigcirc = \boxed{\bigcirc}$$

ose edhe

$$\bullet = \boxed{\bigcirc}$$

❖ ❖ ❖

Më në fund, për të përfunduar këtë *Hyrje* enkas të përzgjatur, ne duhet të tregojmë konkretisht dhe me hollësi:

procedurën tonë standard për kryerjen e analizave gjuhësore për synime etimollogjike dhe jo vetëm...

Ne shfrytëzojmë për këtë qëllim:

a) Mundësitë e reduktimit (përkthimit, transkriptimit, kodimit...) të gllosave në simbole.

b) Lidhjet mitike mes fjalëve.

c) Faktin themelor sipas të cilit Gjuha referon tek Qëndra, e pra edhe, në instancë të fundit, tek simboli themelor ○ si ai i *Qëndrës*, i *Zotit*, i *Hiçit*...

d) Ekuacionet simbolike të Algoritmit që na lejojnë ndër të tjera të justifikojmë (motivojmë) edhe kuptimet e dyta, të treta... të së njëjtës fjalë, d.m.th. polisemantizmin e saj.

Le ta ilustrojmë këtë procedurë standarde me ndonjë shëmbull nga sanskritishtja.

Në sanskritisht:

artha - *qëllim*; *shkak*, *motiv*; *leverdi pratike*, *materiale*; *send*, *objekt*; *fakt*, *realitet*; *kuptim* (fr. *sens*, *signification*) (*pronë*, *të mira mteriale... organ mashkullor; seks..* **-e -ena** *për shkak të, për arsye se...*)

Analiza jonë fillon me *zbërthimin* e kësaj fjale "të përbërë" në fjalët e thjeshta (rrënjë të pastra, operatorë të lirë) që ë përbëjnë. Vëmë rè këtu shkarazi se sipas vetë Sanskritishtes kjo është një fjalë e thjeshtë dhe jo e përbërë, dhe kjo sepse **ar** dhe **tha** në sanskritisht nuk janë operatorë të lirë.

Momenti i dytë është *identifikimi* (këtu me anë të shqipes) të këtyre pjesëve të thjeshta.

ar- në shqip është anglishtja *gold*, e pra dhe *drita* me qënë se në mendimin mitik "ari vështrohet si drita minerale"*. Simboli i saj është mitikisht ○. Është e tepërt të vëmë në dukje se duke qënë kështu **ari** identifikohet me Qëndrën.

-tha është shqipja **thy** në kuptimin *ndarjes, e çarjes*, e pra simb. ⌀.

Transkriptimi jep pra:

$$\textbf{artha}_{\text{sanskr.}} = \textbf{ar thy}_{\text{shq.}} = \oslash$$

Le të motivojmë tani nëpërmjet ekuacioneve simbolike të Algoritmit Simbolik kuptimet e ndryshme të kësaj fjale në sanskritisht.

Kemi:

$$\underset{\textbf{ar thy}}{\oslash} = \underset{\textit{shkak}}{\leftrightarrow} \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

$$\underset{\textbf{ar thy}}{\oslash} = \underset{\textit{send, objekt}}{\bullet} \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

$$\underset{\textbf{ar thy}}{\oslash} = \underset{\textit{seks}}{\infty} \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

$$\underset{\textbf{ar thy}}{\oslash} = \underset{\textit{arsye, i arsyeshëm, me kuptim}}{(x = x)} \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

Ne mund të motivojmë në këtë mënyrë jo vetëm kuptimet e ndryshme të fjalës **artha**, por edhe ato të fjalës **ardha** = *krahinë, anë, pjesë* (fr. *région, côté, partie*); *gjysëm* (fr. *demi, moitié*), me qënë se të gjitha këto kuptime reduktohen tek po ai simbol ⌀ (sanskr. *ardha* = shq. *ar dà*) si edhe fjala *artha* që po shqyrtojmë. Kjo tregon ndër të tjera se këto dy fjalë, "siç *del qartë vetëm me*

* Shih edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi, fq. 65.

ndihmën e Shqipes" janë e njëjta fjalë.

Me kaq analiza jonë etimollogjike merr fund, por ne mund ta zgjerojmë bisedën: **a**) për t'u bindur (stërbindur) se përfundimet tona janë të sakta; **b**) për të nxjerrë ndonjë informacion të rëndësishëm nga kjo analizë (rikujtojmë se Gjuha, çdo gjuhë, përmban një informacion të rëndësishëm që prek të gjitha sferat e Dijes).

1) Ekuacioni ⏀ = ↔ pohohet, ripohohet nga të gjitha gjuhët, ne këtë e pamë. Kemi pra një *consensio linguarum*. Dhe me qënë se ⏀ = ***F*** = ½ s'ka dyshim se ***artha*** = ***ardha*** (gjysëm). Vetë Sanskritishtja i veçon këto dy fjalë sepse, duke mos patur operatorët e lirë përkatës, nuk arrin të kuptojë strukturën e tyre intrinseke dhe pra edhe identitetin e tyre simbolik e pra esencial.

Edhe ekuacioni ⏀ = ● është tepër i përhapur në gjuhët e ndryshme. (Në shqip p.sh. me *ndarë / ndyrë, pjesë / pis* ...)

Të njëjtën gjë mund të themi edhe për ekuacionin: (***x*** = ***x***) = ⏀ = ½.

P.sh. në italisht *ragione* (*arsye*) / *regione* (*krahinë, pjesë*).

Kështu sanskritishtja me polisemantizmin e **artha**, shtron vargun e ekuivalencave simbolike:

$$⏀ = ½ = ● = ↔ = ⋈ = \ldots \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

Le të shumëzojmë krah për krah me -1. Do të kemi:

$$-⏀ = -½ = -● = -↔ = -⋈ = \ldots \qquad \ldots(\mathbf{E})$$

Duke interpretuar mund të themi p.sh.:

Në Fizikën kuantike e cila ngrihet si mbi themelin e saj të patundshëm mbi parimin e ***papërcak****tueshmërisë* (− ⏀) *ligji i shkakësisë nuk vlen më* (− ↔).

Në fizikën kuantike një matje e saktë është e pamundur (− ⏀).

Në fiziken kuantike, ne ndeshemi në nivelin subatomik me fushën e vakuumit (− ● = *jo materie*).

Me qënë se ⦶ = *cak, kufi*, dhe me qënë se *shpejtësia e dritës përbën në Fizikën klasike një kufi*, ne mund të shkruajmë edhe:

kufi, limit... ⦶ = **c**

Por në Fizikën Kuantike, siç e pamë, kemi − ⦶ e pra atëhere edhe ○ e pra > ⦶ e pra edhe > **c**. Kjo do të thotë atëhere se:

Në *Fizikën kuantike shpejtësia e dritës është e kapërcyeshme, se atje mund të flitet, siç thuhet, për* ***superluminozitet***.*

Ja pra se si ky fakt i rëndësishëm që shpjegon në Fizikën Kuantike edhe shumë fakte të tjera të rëndësishme, *mund të nxirrej vetëm nga analiza e fjalës sanskrite* ***artha***.

Mund të arsyetohej edhe ndryshe:
Dihet se ekziston formula

$$\leftrightarrow = v \leq c$$

që do të thotë se ligji i *kauzalitetit* (↔) funksionon për sa *shpejtësia e trupit* (***v***) është *më e vogël* (<) ose e *barabartë* (=) me *shpejtësinë e dritës* (***c***).

Me qënë se:

$$\leftrightarrow = F = ⦶ = ● \ldots$$

kjo do të thotë se në këtë rast jemi në kushtet e kodit ***F***, e pra të *Fizikës Deterministe* (⦶), ose *Klasike*, si edhe pra në ato të një *Realiteti material* (●).

Ja pra përse atëhere *brënda kufive* (⦶) të Fizikës Klasike si edhe pra të *Botës materiale* (●), *shpejtësia e dritës* (***c***) përbën me të vërtetë një kufi të *pakapërcyeshëm* (≤ ***c***).

Por ne dimë se në Fizikën Kuantike, *ligji i kauzalitetit*, siç detyrohet ta pranojë këtë edhe vetë Einsteini, **bie**, e pra në këtë fizikë, do të kemi simbolikisht:

$$- \leftrightarrow$$

e pra rrjedhimisht edhe:

$$\geq c$$

d.m.th. me fjalë të tjera, *mundësinë e kapërcimit të shpejtësisë së dritës* në **subatomikun** e thellë, që del pra kështu edhe si një **Botë jomateriale** (− ●), si një botë "fantazmash", si "një spooky physics" siç e quante me të tallur, por pa të drejtë, Einsteini.

Kemi gjithashtu, nga analiza e mësipërme: $-\textcircled{D} = -(x = x)$

Pra ne mund të themi se: *në Fizikën Kuantike* $(-\textcircled{D})$ ***llogjika formale*** $(x = x)$ *a shkurt arsyeja a llogjika e të Tretit të Përjashtuar nuk vlen më.*

Ky fakt që nxirret gjithmonë vetëm nga analiza e fjalës ***artha***, gjen rikonfermë të plotë në Fizikën kuantike, në të cilën e për të cilën Heisenberg dhe Weiszacker propozuan pikërisht llogjikën e të Tretit të Përfshirë, siç pamë. Nga analiza e fjalës sanskrite *artha* doli edhe se:

$$\textbf{artha} = \textcircled{D} = \bullet = \leftrightarrow = (x = x) = \Bumpeq = \ldots \quad \ldots(\mathbf{F})$$

Interpretojmë simbolin e fundit si *relativitet.*

Del atëhere se fizika *deterministe* $(\textcircled{D})$ është në të njëjtën kohë edhe një fizikë *relativiste* $(\Bumpeq)$, që do të thotë se tek ajo mund të zbatohet për çdo entitet që bën pjesë në të (*masë, lëvizje, kohë, hapësirë...*) **parimi i relativitetit.**

Nga ana tjetër, me qënë se:

$$\textit{Fizika Kuantike} = \boldsymbol{E} = -\boldsymbol{F} = -\textit{ fizika deterministe}$$

kjo do të thotë atëhere se parimet e Teorisë së Relativitetit nuk mund të zbatohen në fizikën kuantike të mirëfilltë a e thënë ndryshe:

Teoria Kuantike dhe Teoria e Relativitetit
janë të papajtueshme mes tyre.

E kështu me radhë, e kështu me radhë...

Gllosar

Një parathënie e shkurtër

Po japim më poshtë një listë të gjatë konkordancash mes Sanskritishtes dhe Shqipes. Për specifikën e këtyre konkordancave këtu në *Pjesën e dytë* kemi folur bollshëm si në *Hyrje* ashtu edhe gjetiu. Këtu duam të vëmë rè vetëm sa vijon:

1) Renditja e fjalëve nuk ndjek ndonjë kriter të caktuar, ajo është arbitrare.

2) Autori ka lejuar me dashje përsëritjen këtu e atje (por gjithmonë në kontekste të reja), të një informacioni tashmë të dhënë.

3) Një rëndësi e veçantë i është kushtuar asaj që autori quan herë herë "zgjerim të bisedës".

Ky zgjerim bëhet për një sërë qëllimesh:

a) Për të vënë në dukje, shkarazi, rolin "mesianik"* të shqipes, d.m.th. aftësinë e Gjuhës Shqipe për të ndërmjetësuar mes një fjale të huaj dhe simbolit tek i cili ajo tek e mbramja, në mënyrë të "pavetëdijshme", referon e prehet (shih edhe *Hyrjen*), a, e shprehur në zhargon profesional, mes *signifié* (sendi, koncepti që do të emërtohet) dhe *signifiant* (fjala që e emërton atë)**.

Në raste të tilla tregohet se si Shqipja është në gjëndje të motivojë jo vetëm fjalën sanskritisht në shqyrtim, por edhe tërë një sërë fjalësh të huaja (frëngjisht, anglisht ...) që lidhen drejt a tërthor semantikisht me të.

b) Për të rikonfermuar e përligjëruar më mirë motivimin, me argumente llogjikë, fillosofikë e shkencorë.

---

* Në studimin ende të pabotuar "Roli Mesianik i Gjuhës Shqipe" autori i ka kushtuar një vëmëndje të veçantë këtij roli ndërmjetësues e tërëshpjegues të Gjuhës sonë.

** Kjo terminollogji është përdorur për herë të parë nga *Ferdinand de Saussure* (1857 - 1913), gjuhëtar e fillosof zviceran, që vështrohet si babai i strukturalizmit dhe vepra e të cilit ka patur një jehonë të madhe në gjuhësinë e fillosofinë moderne dhe bashkëkohore.

Në këto raste inkursionet në fusha krejt ekstralinguistike janë të pashmangshme. Kështu për shëmbull, për të rikonfermuar saktësinë e analizave tona gjuhësore të fjalëve që shprehin konceptin e *arsyes* në një sërë gjuhësh (duke e përcaktuar atë me terma që shprehin në të njëjtën kohë edhe *mangësi, gjysmakëri, kufi* e kështu me radhë*) ne na është dashur ta zgjerojmë bisedën në disa drejtime, duke sjellë rikonferma të detajuara nga Mendimi Mistik, drejt për së drejti i hetuar dhe i konsultuar, ashtu edhe nga Fillosofia e Kohës sonë, duke riprodhuar për këtë qëllim tërë një kapitull nga vepra monumentale e Kantit**, "*Kritika e Arsyes së pastër*".

Një shëmbull tjetër: në sanskritisht fjala **matra** do të thotë në të njëjtën kohë edhe **matje** edhe **materie** (shih *Hyrjen*, fq, 126, 127, 129...). Kjo bisemi (sikundër në vija të përgjithshme çdo tjetër bisemi e polisemi ...), nuk është aksidentale por përkundrazi kuptimplote dhe qëllimore. Këtë e rikonfermon Fizika moderne kuantike ku thuhet krejt haptas, pa kurrfarë mundësi keqkuptimi, se *materia* dhe objekti material krijohet gjatë procesit të *matjes* (shih *Gllosari*, fq. 348).

Ja shkurtimisht edhe disa shëmbulla gllosash të tjera përligjërimi i motivimit të të cilave bën të pashmangshme nevojën e rikonfermimeve ekstralinguistike (shkencore, fillosofike, theollogjike, etj.).

Në shqip *i/e* **metë**. Kjo fjalë duhet lidhur me fjalën tjetër shqip **mat** (angl. *to measure*). Del pyetja pse? Përgjigja: "Sepse çdo **matje** është e **metë**". Kush e rikonfermon këtë? Shkenca e Fizikës Moderne me Parimin e Papërcaktueshmërisë të Heisenbergut (shih Gllosari, fq. 442).

Në sanskritisht **doṣa** = *ligësi*; *mëkat* ...; *natë* ... (shih *Pjesën e parë* të këtij studimi fq. 94 si edhe Gllosari, fq. 230).

Ne e motivojmë këtë fjalë sanskritisht me shqipen **dysh**.

Por për të argumentuar, rikonfermuar e përligjëruar saktësinë e këtij motivimi, ne duhet ti referohemi mendimit mistik, natyrës ogursëze të numrit **dy** pranë të gjithë popujve primitivë.

---

* Shih *Hyrjen* si edhe *Gllosarin*, fq. 207.

** Shih *Gllosarin*, fq. 405.

Edhe këtu jemi të detyruar të dalim nga kufijtë e një gjuhësie "të mirëfilltë", klasike...*

E kështu me radhë...

Shëmbulla të tilla në tekst janë të shumta.

c) Zgjerimi i bisedës bëhet edhe për një qëllim tjetër.

Me qënë se ne mendojmë se jemi duke inauguruar një Shkencë të Rè, të *zgjeruar* të Etimollogjisë**, zgjerimet e bisedës në çdo drejtim të dobishëm janë të mirëpritura. Këto zgjerime duhet të jenë "përfshirëse", në mos po edhe, mundësisht, "tërëpërfshirëse". Kjo do të thotë që ato duhet t'i japin edhe Shkencës tonë të Rè të Etimollogjisë statusin e një "science des profondeurs". Dhe dihet që karakteristika themelore e një shkence të tillë është *interdishiplinariteti*, do me thënë një identitet strukture a izomorfizëm me degët e tjera të Dijes. Një shëmbull i tillë "bashkëpunimi" në këtë kuptim, është edhe ai mes Jungut dhe Paulit që gjetën se si Psikollogjia dhe Fizika moderne thonin në esencë të njëjtën gjë ***.

Ne, nga ana jonë, gjetëm ndër të tjera, falë "pleonazmave" të "zgjerimeve të bisedës" një paralelizëm befasonjës e të thellë mes Gjuhës dhe Fizikës, a, për të qënë më të saktë, mes parimeve të Gjuhësisë sonë të rè dhe atyre të Fizikës Kuantike (shih ndër të tjera *Algoritmin Simbolik si Hologramë*). Po ne gjetëm atëhere kështu edhe një paralelizëm mes kësaj Gjuhësie dhe Psikollogjisë jungiane të Inkoshientit (shih edhe *Hyrjen*).

Ne gjetëm, përveç kësaj, natyrën holografike**** të Algoritmit Simbolik e pra të Mendimit Mitik e pra, në instancë të fundit, të Gjuhës. Gjetëm me fjalë të tjera, se edhe Gjuha është një Hologramë sikundër tërë Universi (shih *Algoritmin Simbolik si Hologramë*), sikundër edhe vetë truri i njeriut (shih *Algoritmin Simbolik si Hologramë*), sipas studimeve dhe zbulimeve të fundit të Fillosofisë e

---

* Shih Cirlot, fq. 232.

** Shih edhe *Shkenca e Rè e zgjedhur e Etimollogjisë.*

*** Shih edhe *Algoritmi Simbolik si Hologramë.*

**** Shih edhe *Algoritmi Simbolik si Hologramë.*

të Shkencës të Kohës sonë.

Shtojmë mbi këto të gjitha se gllosari sanskritisht ndiqet nga një gllosar i shkurtër hebraisht. Arsyet pse është bërë një gjë e tillë tregohen shkoqur edhe në mënyrë bindëse në faqet 483- 484, pararirëse të gllosarit hebraisht.

Pra referojmë atje.

Shqipja dhe Sanskritishtja

paṭa - m. *drap tissé, étoffe, vêtement*
(*pëlhurë, stofë e endur, stofë, veshje, rrobë*)

Është shqipja ***petku***.
Në sanskritisht gjithashtu edhe: **paṭi** = fr. *sorte d'étoffe* (*lloj stofe*).
Disa kompozita me këtë fjalë:

°**kuti** - f. *tente* (*tendë, çadër*)

Është shqipja:

Kuti-ja prej ***pet-ku*** (*stofë, rrobë, pëlhurë...*)

°**veçman** - nt. *tente* (*tendë, çadër*)

Është shqipja:

E veçuemun prej petku

(Kujtojmë në shqip: *veç, veçoj, veçuemun* ...)

paṭānta - m. *bord d'une étoffe* (*skaja, kufiri, ana e një rrobe*)

-ānta do vështruar si:

ā nta

dhe me shqipen si:

â ndá (*asht ndá; është ndarë*)

e pra simb. ⦶, symbol ky që është, ndër të tjera, edhe ai *i ndarjes, i kufirit, i skajit, i cakut, i limitit,* etj.

Pra, gjithmonë me shqipen:

E ndara (*ānta*) e **pet***kut* (*paṭa*)

Në sanskritisht edhe:

paṭāntara

me të njëjtin kuptim (*skaji i petkut*). Këtu **āntara** është shqipja *â ndarë*.

Le ta zgjerojmë pak biseden:

Vëmë rè se frëngjishtja **bord**, që i përgjigjet sanskritishtes *ānta* (që *reduktohet* tek shqipja *â ndà*, e pra tek simboli ⦶, sikundër që e pamë), mundet e duhet zbërthyer në **bor d** dhe me shqipen **bër da**, e pra simb. ⦶.

Mund të shkruajmë atëhere pra, duke vënë në dukje rolin "mesianik" (ndërmjetësues) të shqipes:



⦶ **(bër DÀ)**$_{shq.}$ **(bord)**$_{fr.}$

Vëmë rè në këtë rast se operatori (rrënja e pastër) shqipe *bër* (fr. *faire*), përdoret shpesh në frëngjisht si "verbalizonjës", domethënë me kuptimin e *bërjes, kryerjes* të një veprimi, si bie fjala në *tom-ber, succom-ber* etj.

Tek anglishtja **boundary** = *kufiri, caku,* etj. do parë gjithashtu shqipja *bâ â ndarë* (*është ndarë*), e pra simboli ⦶.

Mund të shkruajmë pra edhe në këtë rast:



⦶ **(bë a ndarë)**$_{shq.}$ **(boundary)**$_{angl.}$

Do të themi se anglishtja *boundary* përshkruan, me *ndërmjetësinë e shqipes*, simbolin ⦶, një rreze të spektrit semantik të të cilit ajo përfaqëson.

paṭṭa - m. *table, tablette (pour inscrire eu dessiner); plaque; surface lisse.* *(pllakë për të mbishkruar a vizatuar); pllakë, sipërfaqe e rrafshtë, e lëmutë.*

Është shqipja **petë**.

su - *préfixe* devant noms (y compris n. verbe aux); *bon, bien, beau, agréable, convenable, abondant, aisé, a un haut dégrée;* rar. comme particule indépendante.
(prefiks përpara emrave (duke përfshirë këtu edhe emra foljorë); *i mirë, mirë, i bukur, i këndshëm, i përshtatshëm, i bollshëm, në një shkallë të lartë;* rallë si pjesë e pamvarur)

Është shqipja **shumë** (lat. *summa*), që duhet vështruar si:

sh (*su*) **jam** dhe **su-jamun**

Në shqip është ruajtur i përdorshëm vetëm kuptimi i *sasisë*, jo ai i cilësisë (*i mirë, i bukur,* etj.).

Por vëmë rè se edhe në shqip përdoret cilësia për të treguar sasi, si bie fjala: *bukur fort* (*shumë fort*), *bukur qartë* (*shumë e qartë*) e kështu me radhë. Ashtu dhe në mjaft gjuhë të tjera, si bie fjala në anglisht: *pretty sure* (*shumë i sigurtë*); ku *pretty* në anglisht do të thotë *i bukur, i hijshëm,* etj...

Mund të shohim këtu po deshëm një shfaqje në gjuhë të parimit dialektik "rritje e ndryshimeve sasiore = cilësi", lexuar nga e djathta në të majtë, do me thënë duke vënë theksin kryesor tek cilësia që vështrohet primare.

Në qoftë se duam të gërmojmë më thellë në prejardhjen e kësaj fjale sanskritisht (si edhe në shqip, latinisht, etj.) duhet vështruar si rrënjë e pastër, e mirëfilltë, a e thënë ndryshe, si operator i lirë në të, vetëm bashkëtingëllorja **S** (*Sigma*, vija sigmoide e ndarjes, siç cilësohet në librat e simboleve). Kuptimi i saj i mirëfilltë dhe themelor është ai *i ndarjes*, si në simbolin e famshëm kinez **jing-jang** (shih figurën).



S ndan kështu dy parimet, *parimin mashkullor* (*pozitiv i bardhë, qiellor, diellor, ...* **jang**) dhe atë *femëror* (*negativ, i zi, tokësor, hënor, ...* **jing**).

Meqënëse Algoritimi Simbolik (strukturizim llogjik i mendimit mitik!) na jep ekuacionin simbolik:

$$\textcircled{1} = \infty$$

që mund të shkruhet natyrisht edhe si:

$$\textcircled{S} = \infty$$

Ne shohim se **S** edhe *ndan* ($\textcircled{1}$) edhe *bashkon, lidh* (∞).

Që punët qëndrojnë kështu, që **S** jo vetëm *ndan* por dhe *lidh, bashkon,* e vërteton ndër të tjera edhe fakti se tek libri i simboleve të Cirlot, të cilin ne e kemi cituar vazhdimisht gjatë këtij studimi, "*The* **knot** (= *nyja* e pra simboli ∞) *implies also the symbolism of the spiral and of the* ***sigmoid line***...* (fq. 172)"**.

Meqenëse nga ana tjetër Algoritmi na jep:

$$\infty = -1$$

ne mund të shkruajmë edhe:

$$\mathbf{S} = -1$$

Në shqip *Sigma* (S) përdoret zakonisht me këtë vlerë (*negative* = –).

Kështu për shëmbull në shqip **s**'*punoj* = **nuk** *punoj* = –*punoj*.

Por tek fjala *shumë* (*: jam* **S**) ajo është përdorur në kuptimin e mb**ledh**jes

---

* Lidhet gjithashtu edhe me simbolizmin e spiralit dhe të vijës sigmoidale.

** Nyja implikon edhe simbolizmin e spiralit e, gjithashtu edhe atë të vijës *sigmoidale.*

(= *lidhje*-**s**), të *shtimit*, e pra mund të themi në një *kuptim pozitiv* (**S** = +).

Në rusisht **S** (atje në të shkruajtur si **c**) përdoret më shpesh në kuptimin e *mbledhjes*, të *lidhjes*, *bashkimit*, do me thënë si ⊗ (e pra edhe si +). Për shëmbull **so** *mnoj* (***me*** *mua*); **s** *çellovekom* (***me*** *njeriun*).

Në shqip:

dà (fr. *séparer*) = ⊕
dhe (fr. *et*, angl. *and*) = ⊗

Mund të vërtetohet se është fjala për të njëjtin operator të lirë (rrënjë) në të dy rastet. Dhe vërtetë, në shqip **dh** tregon shpesh edhe *ndarje*, si bie fjala *dhashë* (it. *ho dato*), *dhuratë* (it. *dono*, fr. *don* gr. *dhoro* (*δώρο*)). Simboli që përshkruhet në të gjitha këto raste është krejt natyrshëm ⊕. Pra mund të thuhet kështu se shqipja pozon ekuacionin simbolik (edhe në këtë mënyrë, sikundër që e pozon atë edhe në disa mënyra të tjera).

⊕ = ⊗
da *dhe*

Nga ana tjetër në anglisht kemi **and** = *dhe* $_{shq.}$ dhe në të njëjtën kohë:

end = *fundi* $_{shq.}$

Pra mund të themi se edhe anglishtja pozon ekuacionin simbolik:

⊕ = ⊗
end **and**
(*fundi*, *caku i mbramë*) (*edhe; lidhje, shtesë, bashkim...*)

Mund të vërtetohet se anglishtja *end* si edhe *and* reduktohen (e pra motivohen) tek shqipja ***â nda*** (fr. *est séparé*), simb. ⊕.

Vëmë rè gjithashtu se në shqip kemi:

dasì (fr. *séparation, division*) simb. ⦶ dhe në të njëjtën kohë **disà** (fr. *plusieurs, maintes...*) e pra *më tepër se një*, gjë që ne do ta tregojmë me simbolin ✗.

Kështu shqipja pozon ekuacionin simbolik:

$$⦶ = ✗$$

Kështu shpjegohet, ndër të tjera, përse **S** (sigma) jep krahas kuptimit të *ndarjes*, të *bashkimit* edhe atë të *shumicës, pluralitetit*, siç shohim në prefiksin sanskrit **su** (kuptimet: *i bollshëm, në një shkallë të lartë*, etj.).

su-kathā - f. *belle histoire* (*historí e bukur*)

Tek sanskritishtja **kathā** duhet parë shqipja *ka tha, ka thanë...* (fr. *a dit*).

Vëmë rè, me këtë rast, se sanskritishtja e përdor edhe në kompozita të tjera operatorin e lirë **thā** (në shqip *tha, them* etj.). Por në sanskritisht ai nuk gjëndet kurrë më vete, i pamvarur dhe në atë kuptim që të jetë në gjëndje të motivojë fjalët sanskritishte që e përmbajnë si pjesë përbërëse.

su-dayita - a.v. très *aimé* (*shumë i dashur*)

Lidhet me shqipen **dua**, **due**, ... (folja *me dashtë*). Një pjesore e lashtë e kësaj folje është **dūjt** (*du+jet*), si bie fjala në *shkru-jt, lu-jt*, etj.

Pra është shqipja **shu-më dūjt**.

su-duḥkha - nt. *grand tourment; a.* très *pénible*, très *difficile* (*torturë, vuajtje e madhe; shumë vuajtjeplotë, shumë i vështirë*)

Do zbërthyer si:

su duḥ kha

Dhe është shqipja:

shumë dysh ka

(Shih për këtë edhe gllosën e mëposhtme!)

duḥkha - a. *pénible, désagréable, douloureux; difficile, malaise;* nt. *douleur, peine, chagrin, détresse, souci; mal, malheur, désagrément, ennui, malaise, difficulté, embarras;* **-aṃ ḳr-** *causer de la peine, affliger, ...* (*i dhimbshëm, i pakëndshëm, vuajtjeplotë; i vështirë, jo i volitshëm;* nt. *dhimbje, vuajtje, hall, merak; e keqe, fatkeqësi, pakënaqësi, vështirësi...* **-aṃ ḳr-** *shkaktoj dhimbje, bëj të vuaj...*)

Do zbërthyer në:

duḥ kha

ku: **duḥ-** = *devant sifflantes pour* **duṣ** (përpara bashkëtingëllores sibilante (fishkëllyese) rri për **duṣ**).

Prandaj pra:

duḥ = duṣ

E pra është shqipja **dysh** = **2**; **-kha** është shqipja **ka** (folja *kam*). Pra tërë fjala sanskritisht do të thotë:

ka **dysh** = ka ***2*** = ***2***

Të gjitha kuptimet e kësaj fjale lidhen me simbolizmin e *dyshit* për të cilin kemi folur gjetkë.*

su-dhī - a. et m. *intelligent, avisé, sage; intelligence* (*i zgjuar, me përvojë, i urtë...; inteligjencë...*)

Është shqipja *shumë dí* (folja *díj*).

---

* Sidoqoftë po rikujtojmë këtu shkurtimisht ato sa thuhen për të tek libri i Cirlot:

"TWO. Stands for *echo reflection, conflict* and *contraposition*... It is also symbolic of the first nucleus of **matter**, of *Nature in opposition to the Creator*... In all esoteric thought, two is regarded as **ominous**: it connotes **shadow** and the **bisexuality** of all things, or dualism. Two, then, is the number associated with the *Magna Mater*... (232)"

(Dyshi. Rri për *pasqyrim, konflikt* dhe *kundërvënie*... Ai simbolizon gjithashtu bërthamën e parë të **materies**, sikundër edhe *natyrën* në kundërvënie me *Krijuesin*... Në të gjitha fillosofitë ezoterike, numri **dy** vështrohet si **ogursëz,** ai rri për **hije**, për **biseksualitetin** e të gjitha gjërave, për **dualitet**... *Dyshi* është gjithashtu numri që lidhet në *Magna Mater*...)

su-dāru - nt. *bon bois* (*dru i mirë*)

Është shqipja *shu-më* **dru**.

su-durmanas - a. très *attristé* (*shumë i mërzitur, i dëshpëruar, ...*)

dur- = *devant voyelles sonores pour*, **duṣ-** (përpara zanoreve dhe bashkëtingëlloreve të zëshme, rri në vënd të **duṣ-**).

Pra kemi:

su-durmanas = **su-duṣ mana-s**

Dhe me shqipen:

shumë dysh mën-ja (= *mëndja*)

ose simbolikisht: ☿ . *2* . **mën**-ja

Dhe me qënë se:

2 = ● = ☿ = ♉ = ♀ = ...,

do të kemi akoma:

☿ . *2* (= ●; = ♋; = ♉; = ♀; =...) **men**-ja

E pra atëhere, që ka:

shumë mendime të zeza, të këqija, ... (●), *të kundërta* (♋), *të ngatërruara, të vështira* (♉), *depresive, rrënuese* (♀).

dur-avabodha - a. *inintelligible* (*që s'kuptohet*)

Do zbërthyer si:

dur a va bo dha

Pamë (shih më lart) se **dur** = **duṣ**.

Kemi me shqipen:

dysh â bâ bâ di

ku *di* është folja *dij* (fr. *savoir, connâitre...*).

Pra:

di-ba-*ja* (*dituri-bërja*) **â**(*sht*) **bà** : *2* (dysh)

Dhe me qënë se:

2 = *–1* = ● = 𐌘 = 𐌔𐌄 = ...

Me fjalë të tjera:

Dituria (*njohja*) *e së cilës është e pamundur* (–1), *e keqe, e errët* (●), *e ngatërruar* (𐌘), *kontradiktore* (𐌔𐌄) ...

su-duşkara - a. *très difficile à faire* (*shumë e vështirë për t'u kryer*)

Do zbërthyer si:

su duş kara

dhe me shqipen:

shumë **dysh kry**

Dhe me qënë se: **dysh** = *2* = ● = 𐌘 = 𐌔𐌄 = ..., do të kemi atëhere:

𐌘 . **kry** (*krymje e ngatërruar, e vështirë, e ndërlikuar...*)

𐌔𐌄 . **kry** (*krymje që ndesh qëndresë, për të cilën duhet të përpiqesh shumë ...*)

su-duşta - a. c. *très mauvais* (*shumë i keq*)

Është shqipja *shu-më dysh* ose edhe *shumë dështú.*

Dhe me qënë se *2* = ● = *i keq* ..., fjala sanskritisht *su-duşta* gjen në këtë mënyrë, me anë të Algoritmit Simbolik dhe *me ndërmjetësinë e shqipes*, shpjegimin e saj të plotë.

su-durvida - a. *très difficile à savoir*
(*di-ja, njohja e të cilit është tepër e vështirë*)

Do zbërthyer si:

su dur vi da

Dhe me qënë se *dur* = *duş* (shih më lart), do të kemi atëhere me shqipen:

shumë **dysh bë di**

E pra simbolikisht:

χ . *2.* (**di**-*bërja*)

Dhe me qënë se: *2* = $\aleph$ = *e ndërlikuar, e vështirë...*:

χ . $\aleph$. (**dì**-*bërja*)

e pra përfundimisht:

shumë e ndërlikuar për t'u ditur, për t'u njohur ...

su-cetas - a. *très intelligent* (*shumë i zgjuar, i zgjuet, i qutë...*)

Është shqipja ***shu**më i* **qutë**.

a-khaṇḍa - a. *non divisé, entier; intégral;* - a.m *sans interruption*
(*i pandarë, i tërë, integral..., pa ndërprerje*)

Zbërthimi jep:

a kha ṇḍa

ku:

a - pjesëz (parashtesë) me kuptim privativ (si në greqisht, latinisht, etj...)

kha - shqipja *ka* (folja *kam*)

ṇḍa - shqipja *nda* (fr. *séparer, diviser, désunir...*)

Simbolikisht pra kjo fjalë do të paraqitej si:



Sipas Algoritmit Simbolik ekziston ekuacioni simbolik:

Simboli i fundit është ndër të tjera, sipas mendimit mistik edhe *ai i të Tërës, i pafundësisë* (Cirlot: *A dictionary of symbols*, fq.123)*.

Shpjegohen kështu, duke u mbështetur tek shqipja (jo tek sanskritishtja në të cilën operatori **nda** nuk ekziston në gjëndje të lirë!) të gjitha kuptimet e fjalës së mësipërme sanskritisht.

a-khaṇḍita - a. *non endommagé, non troublé, intact*
(*i padëmtuar, i patrazuar, i pacënuar*)

Zbërthimi jep:

a kha ṇḍita

ku: **a** = *– 1* (–)
kha - *ka* (folja *kam*)
ṇḍita - *ndātë* (fr. *separé, divisé...*)

Trajta me **aat** (āt) është një trajtë e lashtë e pjesores në shqip. Krahaso me *rāt, thāt, māt...*

Nga sa më sipër, simbolikisht kjo fjalë do të paraqitej si: 

Është i njëjti simbol që përshkruante dhe fjalën prandaj mund të themi se këto dy fjalë janë e njëjta fjalë-simbol, a e thënë ndryshe, ato janë rreze të ndryshme të spektrit semantik (kuptimor, konceptual) të operatorit të lirë shqip *ndātë, nda,* të negativizuar (– **nd**).

Shtojmë se në shqip kemi **dām** (fr. *dommage*) që lidhet kështu brënda shqipes me operatorin e lirë shqip *da, damun* (fr. *séparer, diviser*) e pra me simbolin .

Latinishtja *damnus*, lidhet e *shpjegohet* kështu me shqipen *damun* (fr. *divisé,*

* = *Infinity, the Universe, the All*

séparé). Ashtu dhe italishtja *danno* ku grupi **mn** ka dhënë **nn** (asimilim progresiv) ashtu dhe frëngjishtja *dommage* ku **mn** ka dhënë **mm** (asimilim regresiv).

a-kāṇḍa - a. *sans motif, inattendu; tout a coup* (*pa arsye, papritur, befas...*)

Zbërthimi jep:

a kā ṇḍa

e pra me shqipen:

– **ka nda** (*i padam*) = (*non séparé, non divisé*)$_{fr.}$

pra simbolikisht – ⌀.

Le të shpjegojmë nëpërmjet simbolit tek i cili fjala sanskritisht sillet *me ndërmjetësinë* e shqipes, kuptimet e ndryshme të kësaj fjale.

Vërejmë, së pari, sa vijon:

Në latinisht:

ratio { *pjesë*, *porcion*, e pra simb. ⌀ ; *Arsye*

Në gjermanisht:

Halb { *gjysëm*, e pra simb. ⌀ ; (në trajtën *desHalb*) = *për këtë* ***arsye***

Në sanskritisht:

ardha { *pjesë*, e pra simb. ⌀ ; (në trajtën *artha*) = *arsye*

Në shqip:

ndaj { *pjesëtoj*, (fr. *diviser*), e pra simb. ⌀ ; *për këtë* ***arsye***

Shohim pra se në të gjitha këto gjuhë, nëpërmjet një homonimije a thuajse-homonimije pozohet ekuacioni:

$$\textbf{arsye} = \text{⦶}$$

Një gjë e tillë i ka rrënjët më thellë.

Le të përpiqemi tani të përmbledhim shkurtimisht këtu ato sa thamë lidhur me këtë çështje në *Hyrje*.

Dimë se:

$$\textbf{Qëndra} = \textit{coincidentia oppositorum} = (x = -x) = \text{○}$$

Por $x = -x$ është *kontradikta e hapur* e pra *absurdi*. Pra dhe *arsyeja* do të jetë atëhere:

$$-\textbf{absurd} = -(x = -x)$$

e pra akoma edhe $(x \neq -x)$ e pra edhe gjithashtu: $(x = x)$ = *parimi themelor i llogjikës formale* (*Parimi i identitetit formal*) a shkurt i *llogjikës* nga e cila **tërë** kjo llogjikë mund të bëhet të rrjedhë. Kështu gjejmë se:

arsye = **llogjikë** (*formale* ose e të *Tretit të Përjashtuar*)

Por **arsye** $= -(x = -x)$ sjell me vete edhe $-\text{○}$, e pra *jo e tëra* (një interpretim) dhe pra akoma ⦶.

Kështu përfundimisht:

$$\textbf{arsye} = \text{⦶}$$

Shohim kështu, ndër të tjera, se ***arsyeja* është e *mangët***, se ajo nuk mund të na udhëheqë në njohjen e ***tërë*** (○) Realitetit, por vetëm të një *pjese*, të *gjysmës së tij* (⦶). Në këtë përfundim ka arritur edhe Fillosofia moderne duke filluar me *Kantin*. Kështu lindi si rrymë fillosofike iracionalizmi, ekzistencializmi etj.

Shohim se të parët tanë e kanë ditur këtë të vërtetë (si edhe shumë e shumë

të tjera). *Dhe ky informacion ishte fshehur në gjuhë, i depozituar, i ruajtur në shekuj të shekujve atje...*

adhara - a. *situé au-dessous, inférieur*
(*që ndodhet poshtë, i poshtëm, inferior...*)

Zbërthimi jep:

a dhara

ku **a** është shqipja **â** (*asht*) ndërsa **dhara** lidhet me shqipen ***darë*** (fr. *séparé, divisé*) etj. etj., e pra simb. ⏀.

Për të argumentuar këtë mjafton të mbështeteni tek ekuacioni simbolik në ***F***:

⏀ = ♀

Vërnë rè me këtë rast se frëngjishtja *tomber* është e zbërthyeshme përmes shqipes: *tom ber*, do me thënë në *bër dām* (fr. *fait divisé*) e pra ⏀ që nga pastaj ♀. Po ashtu në shqip *felë* (*pjesë, e ndarë*) e pra ⏀ dhe në të njëjtën kohë *fal, falit* (*bie*; krahaso me gjerm. *fallen*, angl. *to fall...*) e pra simb. ♀. Akoma në shqip *ndanë*, pra simb. ⏀ dhe në të njëjtën kohë *ndën* e pra simb. ♀. Gjithashtu në shqip *pjesë* e pra ⏀ dhe në të njëjtën kohë *peshë* (fr. *poid*) e pra simb. ♀.

Nga sa më sipër shohim ndër të tjera, se shqipja shtron pastër ekuacionin simbolik për të cilin është fjala këtu:

⏀	=	♀	...(**F**)
felë		*falë, falit*	
ndan		*ndën*	
pjesë		*peshë*	

agraya - a. *qui est en tête, le meilleur; le plus ancien; éminent*
(*që qëndron në krye, më i miri; më i lashti; i shquar*)

Lidhet me shqipen **kreu** që është më produktive në shqip se në sanskritisht, ku ndodhet krejt e izoluar në disa pak kompozita dhe kurrë në gjëndje të lirë.

(Kujtojmë në shqip: *për-kryt, kre-jt, kryemje* ...)

sam-agra - *entier, intégral*... (*i tëri, mbarë, krejt*...)

Theksi semantik bie mbi **-agra** që lidhet me shqipen *kre* (*kre, krye,*...) dhe *kre*-jt.

Sufiksi **-jt**, i rëndomtë në shqip, qëndron për *jetë* (kohë e foljes *jam, me qënë*). E gjejmë edhe në sanskritisht si edhe në rusisht (**-jat**) si edhe në ndonjë gjuhë tjetër gjithë po me këtë funksion.

Vëmë rè me këtë rast se edhe në sanskritisht ekziston, ndonëse jo në një mënyrë krejt të pastër, paralelizmi i dy homonimeve sinjifikative të shqipes:

kre (*i pari*), **kre**-jt (*e tëra*)

nëpërmjet *agra* dhe *sam-agra* respektivisht, që përkthehet në ekuivalencën e njohur simbolike (shih *Hyrjen*):

1	=	○
kre		*krejt*
a-gra		*sam a-gra*

Shtojmë se kjo ekuivalencë jepet në shqip edhe me:

parë (**1**) m-**barë** (○)

vraṇa - *blessure, cicatrice* ... (*plagë, blanë, varr, e vrame*...)

Është shqipja **vraj**, e **vranë**...

Në sanskritisht gjithashtu:

vraṇayati - fr. *blesser* (*me plagos, me varrue*)
vraṇita - fr. *blessé* (*i plagosun, i varruem*)

vi-vasana - *dévêtu, nu* (*i ç-veshun, lakuriq*)

Lidhet me shqipen **veshun**.

Prefiksi **vi-** ka në sanskritisht (si, në rusisht, si në gjuhën kineze *vu*, si edhe në një sërë gjuhësh të tjera), kuptimin e *mohimit*. Kjo shpjegohet me faktin se kjo gërmë (**v**) lidhet me gërmën e *dytë* të alfabetit (në greqisht *beta*, në hebraisht *beth*, etj.); nga ana tjetër gërma e dytë e alfabetit në këto gjuhë ka vlerën numerike ***2***.

Nga ana tjetër (shih *Hyrjen*) dihet ekuacioni simbolik:

$$2 = -1$$

që shpjegon kështu edhe përsenë e kuptimit *negativonjës* (*mohues*, *privativ*) të **vi-** në sanskritisht.

pari-bhraṣṭa - a.v. *tombé, tombé de; sombré, ruiné, perdu*
(*i rënë, i rënë nga, i fundosur, i shkatërruar, i humbur...*)

Mund të zbërthehet në:

pari bh ra aṣṭa

Dhe me shqipen:

bërë ba rá âsht

do me thënë: *asht* **bërë : ba rá**, e pra përfundimisht e simb. ♀.

pari-Bhram - *errer, aller par ici par là; se mouvoir en ronde, décrire un cercle autour...*
(*endem, shkoj andej e këndej; vij rrotull, përshkruaj një rreth ...*)

Kjo fjalë në sanskritishte përshkruan pra simbolin: ⊙
Ajo mund të vështrohet si shqipja:

bër ba rām

ose akoma më shkoqur:

bër ba rá jam

e pra:

bër : *jam ba* ***rá***

E pra atëhere shohim se si sanskritishtja pozon, qoftë edhe në një mënyrë gjer diku të tërthortë, ekuivalencën e rëndësishme simbolike:

$$\text{♀} = \odot \qquad \ldots\textbf{(F)}$$

tashme të njohur prej nesh (shih *Hyrjen*) që ***krahason lëvizjen rrethore me një rënie****.

Vëmë më në fund në dukje se po ky ekuacion mund të nxirrej lehtë edhe nga shqipja nëpërmjet:

$$\begin{cases} \textbf{rāt} \text{ (fr. } \textit{tombé}\text{), e pra simb. } \text{♀} \\ \textbf{rrath} \text{ (fr. } \textit{cercle}\text{), e pra simb. } \bigcirc \end{cases}$$

ose:

$$\begin{cases} \textbf{rāt} \text{ (fr. } \textit{tombé}\text{), e pra simb. } \text{♀} \\ \textbf{rot-ull} \text{ (fr. } \textit{en cercle, tout autour}\text{), e pra simb. } \bigcirc \end{cases}$$

ose edhe:

---

* Ky ekuacion simbolik shpreh idenë gjeniale që sipas legjendës i erdhi në mendje Newtonit kur i ra mbi kokë një mollë ("Molla e Newtonit"). Atëhere ai e krahasoi *vërtitjen* e planetëve rreth *diellit* me një *rënie:*

⊛	=	♀
Vërtitja e planetëve reth diellit		***rënie***

Pra ne shohim kështu që të lashtët (këtu hindianët e lashtë) e kanë pas ditur këtë, siç dëshmon informacioni që ne nxjerrim nga analiza e gjuhës së tyre. Pra dhe Newtonit nuk ju desh që ta gjente veçse të kujtohej, ta zgjonte këtë kujtim që flinte thellë në inkoshientin e tij si edhe në tërë Inkoshientin Kolektiv.

rām (fr. *tombé*), e pra simb. ♀
rum-b-ull, e pra simb. ◯
rum-b-ull-ak, e pra simb. ◯

Vëmë rè me këtë rast sa vijon:

a) kemi folur për diferencimet pak a shumë të lehta të "partnerëve ekuivokalë" (çiftet homonimike a thuajse homonimike) për të shquar kuptime (interpretime konceptuale) brënda të njëjtës fjalë-simbol (shih edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi).

Kjo shpjegon atëhere ndryshimet mes *rāt* dhe *rrath*, ndërmjet *rāt* e *rrotull* e kështu me radhë.

b) **rrath** ka qënë dikur trajta e njënjësit (shumës i singularizuar), tashmë trajta *rreth*.

c) shqipja **rot-ull** do zbërthyer në *yll* (*-ull*) *rāt* (fr. *étoile tombée*); *-ull* është një prapashtesë a mbaresë-nyje që përdoret rëndom në shqip si e tillë dhe që duhet identifikuar me fjalën tjetër brënda shqipes *yll*.

Jashtë shqipes e gjejmë në latinishte në trajtën e **ille**, në italisht në trajtën e **il**, nyje e gjinisë mashkullore. Në rumanisht haset shpesh si nyje e pasvënë. Krahaso në këtë vështrim në shqip fjalët: *uth-ull, kum-b-ull, shëm-b-ull, kun-g-ull,* etj.

Da (Y) (-°**dyati**; *dita* -°**tta -dāya**) - *partager* (*me ndà*)

Është shqipja **daj**.

dara - a. ifc. *qui fend, déchire*; m. *fente, trou, creux, cavité, caverne* (*që thyen, ndan, gris; vrimë, guvë, shpellë...*)

Është shqipja **dar** e pra simbolikisht ⊕. Sipas Algoritmit Simbolik kemi:



vrimë, guvë, shpellë ...(F)

Një kompozitë me këtë rrënjë është edhe:

°**çlatha** - a. *un peu relaché* (*pak i çlodhur*)

Fjala sanskritisht **çlatha** është shqipja **çlodh**. Kjo e fundit do zbërthyer si:

ç loth e pra – **loth**.

Në sanskritisht nuk ekziston *loth* si operator i lirë (rrënjë më vehte) dhe ne e gjejmë atë në këtë fjalë si të përngjitur. As **ç** si mohues nuk ekziston në gjëndje të lirë në sanskritisht. Prandaj pra dhe kjo fjalë e sanskritishtes është e motivueshme vetëm përmes shqipes.

Vërejmë gjithashtu se fjala *loth* lidhet brënda shqipes me fjalën *lith* (fr. *lier*) e pra simb. $\aleph$.

Kështu që kemi:

$$(\textbf{çlatha})_{\text{sanskr.}} = (\textbf{çloth})_{\text{shq.}} = (\textbf{çlith})_{\text{shq.}} = -\aleph$$

Simbol ky i fundit që është ndër të tjera edhe ai *i lirisë, i zgjidhjes.*

Për sa i përket kuptimit tjetër që jepet në sanskritisht me *dara* në kuptimin "un peu" (*disì, pak...*) duhet patur parasysh se:

$$(\textbf{dara})_{\text{sanskr.}} = (\textbf{dār})_{\text{shq.}} = \ominus = {}^1/_2$$

Po kemi: $\ominus < \bigcirc$, si edhe: ${}^1/_2 < 1$.

Dhe me qënë se $\bigcirc$ është *e tëra*, $\ominus$ është atëhere *i pari më i vogël*, ose i *vogli arketipal*, që nga do të marrin emrin (në bazë të atyre që kemi thënë në *Hyrje*) të gjithë "të vegjlit", prandaj pra **dara** mund të ketë krahas kuptimit të *ndarjes* edhe atë të *vogëlsisë*.

Në shqip **dasì** = *ndarje* (simb. $\ominus$) dhe **disì** = *jo shumë, pak* janë e njëjta

fjalë-simbol a, e thënë ndryshe, janë ndërtuar me të njëjtin operator të lirë (rrënjë të paster).*

Vëmë rè më në fund se edhe shqipja **dromca**, **thërmija**, janë që të dyja përshkrime të simbolit ⌀. *Dromca* nga **dar**; *thërmija* nga **thyer**.

dabhara - a. *petit, précaire* (*i vogël, i brishtë*)

Është shqipja **dà** *bërë*, e pra simb. ⌀; dhe mund të themi të gjitha ato që thamë më lart.

doşa - m. *soir, obscurité* (*mbrëmje, terr, errësirë*)

Pra simb. ●. Por dimë se Algoritmi Simbolik pozon:

$$2^{**} = \bullet \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

Prandaj pra kjo fjalë lidhet me shqipen **dysh** (*2*).

dūsa - a. ifc. *souillé de* (*i ndyrë, i fëlliqur...*)

Simbolikisht ●.

Është përsëri shqipja **dysh** (*2*) me qënë se siç pamë edhe më lart *2* = ●.

dus° (**dur°**, **duç**, **duh°**... **du°**...) - Préfixe impliquant une idée péjorative:

---

* Përfitojmë nga rasti për të vënë në dukje se shqipja shtron me të njëjtën rrënjë një varg të gjatë ekuivalencash simbolike nga i cili po japim këtu vetëm një segment:

$$\underset{dasì}{\oplus} = \underset{\substack{disì \\ (jo\ krejt)}}{-\bigcirc} = \underset{\substack{disà \\ (më\ shumë\ se\ një)}}{\not{X}} = \ldots \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

** Rikujtojmë nga Cirlot (fq. 232): "...(two) Its also symbolic of the first nucleus of matter, of nature in opposition to the creator ... In all esoteric thought, two is regarded as **ominous** ... it connotes **shadow** and the bisexuality of all things ..."

mauvais, difficile, dangereux, défectueux, inférieur
(prefiks që shpreh një ide, një koncept pexhorativ: *i keq, i vështirë, i rrezikshëm, difektoz, inferior...* etj.).

Është shqipja **dysh (2)** e pra një pjesë e mirë e kuptimeve të këtij prefiksi sanskritisht rrjedhin nga figurat simbolike që bëjnë pjesën në kodin ***F*** (shih Alg. Simb.).

Me qënë se ***2*** = ***F***, kemi atëhere:

2 *dysh* (sanskr. *duṣ*)
⊕ *Difektoz*
● *i keq; vdekjeprurës, i rrezikshëm*
☿ *i ngatërruar; i vështirë*
–1 *negativ, mohues*
☋ *kundërshtues, konfliktues*
♀ *inferior, i ultë, i poshtër*

Vëmë rè se edhe në gjuhët moderne (italisht, frëngjisht, anglisht...) prefiksi **dis** (*de, di, ...*) ka gjithë po këto kuptime dhe është gjithmonë shqipja **dysh** (gr. *δυσ-*).

duṣ-kara - a. *difficile a faire, a supporter; difficile, ardu*
(*që bëhet me vështirësi, që durohet me vështirësi,* etj., etj.)

Është shqipja:

dysh kry

e pra simbolikisht:

2 *kry*

si edhe me qënë se:

2 = ***F*** = ☿ = *e ngatërruar, e vështirë...*
☿ **kry**

duç-cyava - na. *difficile a ébranler, inébranlable*
(*i vështirë për t'u shkyer, për t'u çarë; i pashkyeshëm, i paçarshëm...*)

Është shqipja:

dysh ça bâ

Mund të shkruajmë gjithashtu:

bâ : dysh çá

ose edhe:

bâ : *2* çá

dhe me qënë se $2 = -1$, si edhe $2 = \infty$, kemi përfundimisht:

∞ çaj

ose edhe

∞ . ⓘ (*çarje e ngatërruar, e vështirë*)

dhe

– çaj

ose edhe

– ⓘ (*i pa-çajshëm*)

dur-bhida (**-bheda**, -a. **bhedya** -a. v.) - *difficile a briser, a diviser, a rompre*
(*i vështirë me u ça, me u nda, me u thye...*)

Shqipja jep:

dy bë dà

(ku *bë* është folja *bëj; da* folja *me dà...*).

Nga ana tjetër:

dy = *2*, dhe **dà** = ⓘ

Dhe me qënë se Algoritmi jep:

$2 = \infty$ ...(**F**)

Tërë fjala përshkruan kështu grupin simbolik:



vështirë me **u çá**

duṣ-parīkṣya - a.v. *difficile a examiner, a explorer*
(*i vështirë për t'u sh-qyr-tuar, për t'u eksploruar...*)

Do zbërthyer si:

duṣ parī k ṣya

dhe me shqipen:

dysh bëri ka sy

ose edhe:

ka bërë : dysh sy

Dhe simbolikisht duke treguar **syun** me piktogramën  , do të kemi:

2 

Dhe duke vënë në vend të *dyshit* ekuivalentët e tij simbolikë, do të kemi gjithashtu:

–1  ose ose etj. etj.

Këto kombinime (*fjalë*) mund të interpretohen në shumë mënyra, sipas kuptimeve që do t'u japim simboleve prefiksuese. Kështu për shëmbull:

një vështrim i dyfishtë, një vështrim i dyshimtë...(***2***)
një vështrim kritikues, mohues, dizaprovues...(***– 1***)
një vështrim i keq (●)
një vështrim, një shqyrtim i vështirë ()
...

dur-bhara - a. *difficile a porter, a supporter, lourd, intolérable: difficile a retenir; lourdement chargé de ...*
(i vështirë për t'u mbajtur, për t'u duruar, i padurueshëm; i vështirë për t'u për-mbajtur; i ngarkuar rëndë, me barrë të rëndë...)

Dimë që:

$$\textbf{dur} = \textbf{duş} = \textbf{dysh}_{\text{shq.}} = \textbf{2}$$

bhara është shqipja *me bār, me bart, ... barrë...* Pra tërë fjala sanskritisht jep simbolikisht:

2 . bar

ose edhe:

(2, −1... ♀... ♉, ... *F*) bar

Duke e "prefiksuar" rrënjën **bar** me një interpretim çfarëdo të një figure simbolike çfarëdo të kodit ***F***, lindin kuptime të ndryshme për fjalën që po shqyrtojmë. Kështu për shëmbull:

♀ **bar** do të japi kuptimin e një *barre të rëndë* (*lourdement chargé de...*)
♉ **bar** do të japi kuptimin *vështirë me u mbajt* (*difficile a porter*)
−1 **bar** do të japi kuptimin *i pa mbajtshëm, i padurueshëm, i papërmbajt shëm...* (*intolérable...*)...

dur-vāşas - a. *mal vêtu, nu* (*i veshur keq, lakuriq*)

Është shqipja:

dysh vesh

dhe me qënë se kemi:

$$2 = \bullet = \textit{i keq, keq...}$$

si edhe:

$$2 = -1 = \textit{jo, nuk, ç'...}$$

atëhere:

***2*. vesh** = ● **. vesh** = *i keq veshur* = *–1* **. vesh** = *i ç'veshur, lakuriq*

dur-adhīta - a.v. *mal appris ou lu* (*që është mësuar a lexuar keq*)

Është shqipja:

dysh â ditë

e pra dhe :

2 **ditë**

e pra edhe:

● **ditë**

e pra:

keq ***ditë***

(S'do harruar se **dur°** përpara zanoresh e bashkëtingëlloresh të zëshme rri në vënd të **dus°**).

dur-anta - a. *dont le terme est difficile a atteindre, interminable, infini; qui finit mal, qui aboutit a un malheur*
(fundi i të cilit është vështirë të arrihet, i pacaktë, i pafund; që mbaron keq, që përfundon me një fatkeqësi…)

Është shqipja:

dysh â nda

e pra simbolikisht:

2 ⌀

Me qënë se: **2** = ***F*** = ᛝ = ● = –1…, do të kemi:

ᛝ ⌀ = *fund* (⌀) *i ngatërruar* (ᛝ), *i vështirë…*

● ⌀ = *që mbaron* (⌀) *keq*, (●), *që përfundon me një fatkeqësi…*

–1 ⌀ = –⌀ = *i pacaktë, i pafund…* etj. etj.

dur-ghaṭa - a.v. *difficile a exécuter, difficile* (*i vështirë për t'u kryer, i vështirë*)

Është shqipja:

dysh gatú (*gatuaj, gatit, godit...*)

ku

dur = **duṣ** = *2* = ***F*** = ☓ = *i ngatërruar, i vështirë...*

dur-ākṛti - a. *mal formé, difforme, laid, défiguré* (*i keqformuar, i shëmtuar...*)

Është shqipja:

dysh â kryjtë

E pra simbolikisht:

2 **kryjtë** = ● **kryjtë** = *i kryjtë keq, i keqformuar* etj. etj.

dur-udaya - a. *qui se manifeste difficilement* (*që manifestohet, shfaqet me vështirësi*)

Është shqipja:

dysh u dá

E pra simbolikisht: **2** ⊕ dhe me qënë se **2** = ***F*** = ☓, mund të shkruajmë edhe: ☓ ⊕, që mund të interpretohet si *ndarje* (⊕) *e ngatërruar* (☓), e pra *e vështirë*.

Vërejtje:

a) Që manifestimi lidhet me një *ndarje*, me një *dallim* (e pra dhe me një *dal-je*) ne këtë tashmë e dimë (shih edhe *Hyrjen*) dhe analiza e Gjuhës e rikonfermon këtë prapë e prapë. Dhe në fakt ne dimë se ○ është ndër të tjera edhe simboli i **pa-për-CAK-tushmërisë** (○ = −⊕) si edhe ai i *Zotit* si *Coincidentia oppositorum*: $(x = -x) = ○$.

Nga ana tjetër Zoti është *i padukshëm, i pamanifestuar në vetvehte, në mënyrë*

imediate (të *drejtë për drejtë, pa ndërmjetës* a *ndërmjetësi*...), Manifestimi i Zotit lidhet dhe është i mundur vetëm me *mohimin* e Tij (kujto: *The Great Cosmogonic Sacrifice*) e pra me $-\bigcirc$, e pra atëhere edhe me $\oplus$, e pra shqip **u dà** dhe sanskritisht **u daya**.

b) Me qënë se: $2 = F = -1 = \ldots$, duke interpretuar prefiksin **dur** sipas këtyre figurave simbolike dhe interpretimeve të tyre konceptuale, tërë fjala sanskritisht do të mund të kishte edhe shumë e shumë kuptime të tjera, si bie fjala, për $F = -1$, do të kemi $-\oplus = \bigcirc = -\bullet$, kuptimin *i pa manifestuar* (dhe në fakt $-\oplus = \bigcirc$); *i padukshëm* etj. etj.

Për $F = \bullet$ do të kishim p.sh. kuptimin *manifestimi i të cilit* ($\oplus$) *lidhet me një fatkeqësi* ($\bullet$) ose *i keqshfaqur* etj. etj. Por fjala sanskritisht *dur-udaya* nuk i ka praktikisht të gjitha këto kuptime. Ato janë *represuar* për të shmangur *ambiguitetin* (*keqkuptim, konfuzion*), porse ato ekzistojnë si *potencialitete të fjetura* në këtë fjalë.

nir-antara - a. *sans intervalle, dense, compact, contigu, ininterrompu, continu, perpétuel; constant, fidèle; sincère; plein; qui n'est pas différent, identique.* **-am** - *étroitement, de près, fermement, continuellement, immédiatement, aussitôt*
(*pa ndërprerje, pa boshllëqe, i dëndur, i ngjeshur, i vazhdueshëm; i amshueshëm; i pandryshueshëm, besnik; i sinqertë; i plotë; jo i ndryshëm; identik.* **-am** *ngushtësisht, nga afër, vendosmërisht, vazhdimisht, në mënyrë imediate, menjëherë...*)

Sanskritisht **nir** = **nih** = **ni** = prefiks që tregon në këtë gjuhë edhe *brëndësi* edhe *mohim*. Mund ta krahasojmë me shqipen **në** (*brëndësi*) dhe **nuk** (lat. *nec*) (mohim). *Nuk* mund të jetë një diferencim i lehtë nga *në*, në një kohë të dytë, për shmangie ambiguiteti.

Në italisht (latinisht) kemi të njëjtën gjë me **in**.
Mund të shkruajmë:

$$(\mathbf{ni})_{\text{sanskr.}} = (\mathbf{in})_{\text{it.}} \begin{cases} -x & (mohim)\ (\text{p.sh. } in\text{-}eguale,\ in\text{-}capace,\ \ldots) \\ \boxed{\text{x}} & (brëndësi)\ (\text{p.sh. } in\ casa,\ \ldots) \end{cases}$$

Në këtë mënyrë sanskritishtja (dhe italishtja e më pak shqipja në këtë rast) pozojnë ekuacionin e rëndësishëm simbolik:

$$-x = \boxed{\text{x}} \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

që është një nga formulat më interesante të kodit të Formës, me interpretime të shumta në fusha të ndryshme të Njohjes.

Këtu **ni** është marrë në kuptimin *negativ*, prandaj mund të shkruajmë:

$$\mathbf{ni} = -1$$

Pjesa tjetër e fjalës *antara* do zbërthyer si:

a ntara

dhe me shqipen:

â ndarë

e pra simbolikisht:

$$\ominus$$

Kështu që tërë fjala sanskritisht do të na japi:

$$\mathbf{nir\text{-}antara} = -\mathbf{â\ ndarë} = -\ominus$$

Le të tregojmë tani se si me ndihmën e Alg.Simb. dhe të shqipes jemi në gjëndje të motivojmë të gjitha kuptimet e ndryshme të kësaj fjale, tërë spektrin e saj konceptual.

Kuptimi:

$$pa\ interval = -\ominus = -(\langle\cdot\cdot\rangle)$$

$$i\ plotë = -\ominus = \bigcirc$$

i vazhdueshëm, pa ndërprerje = $-\textcircled{1}$
i përjetshëm, i amshueshëm... = $-\textcircled{1}$ = ○ = $(x = -x)$ =
"coincidentia oppositorum" = *Zoti* (*Deus*) dhe dimë se *Zoti është i përjetshëm (ëtërnel, perpétuel...) kostant, i pandryshueshëm..., besnik...*

Këto kuptime dalin drejt për së drejti si atribute të Zotit, ose ato mund të nxirren edhe nga ekuacioni simbolik:

$$E = -\textcircled{1} \qquad \ldots(\mathbf{E})$$

Kështu kemi:

$$-\textcircled{1} = E = - \sim \qquad \ldots(\mathbf{E})$$

ku $\sim$ është simboli i *lëvizjes, i ndryshimit.*

Vëmë rè se kjo ekuivalencë mund të nxirrej drejt për drejt edhe nga shqipja:

ndarë = $\textcircled{1}$, **ndry-shim** = $\sim$

Duke "shumëzuar" me -1 do të kemi:

$$-\textcircled{1} \quad = \quad - \sim \qquad \ldots(\mathbf{E})$$

jo ndarje — *jo ndryshim, jo diferencë* etj.

Kuptimi "i sinqertë" nxirret në këtë mënyrë:

(nir-antara) $_{\text{sanskr.}}$ = (*nuk* **â ndarë**) $_{\text{shq.}}$ = $-\textcircled{1}$ = E = $-(-x = \boxed{x})$
= $(x = \boxed{x})$ = *si jashtë ashtu dhe brënda* = *i sinqertë*

Kuptimi *immédiatement, aussitôt* ... nxirret në këtë mënyrë:

(nir-antara) $_{\text{sanskr.}}$ = (*nuk* **â ndarë**) $_{\text{shq.}}$ = $-\textcircled{1}$ = E = ○ =
$(x = -x)$ = **Qëndra** = *timelessness, spacelessness,* e pra $(t = 0)$
koha zero e pra *jashtë kohës;* $(s = 0)$ e pra *jashtë hapësirës.*

Pra vërtetë: *aussitôt, immédiatement...* (shih edhe *P.Sh.A.S.*).

Kështu me ndërmjetësinë e shqipes dhe me ndihmën e Algoritmit Simbolik ne mundëm të shpjegonim të gjitha kuptimet e fjalës sanskritisht **nir-antara**, kuptime që duken shumë të ndryshme e pa lidhje me njëri-tjetrin (*dense, perpétuel, sincère* ...) po që në fakt lidhen që të gjitha me figura simbolike ekuivalente të të njëjtit kod *E*.

Nga sa shohim dhe nga sa pamë duket se *të vjetrit e kanë njohur Algoritmin Simbolik*. Kështu që ne vetëm sa e rigjetëm atë.

anta - m. *bord, limite; bout, fin, ...; mort; voisinage...; intérieur;* **-am** *jusq'à;*
-at ifc. *depuis; jusqu'à*
(*kufi, cak, limit; fund...; vdekje; afërsi... brëndësi; deri...; pas; deri...*)

Do zbërthyer si:

a nta

dhe me shqipen si:

â ndá

e pra atëhere simb.:

⦶

Le të shohim tani se si, pas reduktimit, me ndërmjetësinë e shqipes, të fjalës sanskritisht *anta* tek simboli përkatës, mund të shpjegojmë të gjitha kuptimet e kësaj fjale.

Kuptimi i *kufirit*, i *cakut* etj. jepet fare mirë nga simb. ⦶.

Kuptimi i *vdekjes* jepet prapë mirë simbolikisht po nga ky simbol me qënë se *vdekja* lidhet me një *ndarje* të shpirtit nga trupi.

Vëmë rè me këtë rast se në sanskritisht, koncepti i *vdekjes* jepet gjithashtu edhe me fjalën **doşa** që lidhet me shqipen **dasì** (⦶ = ● = *vdekje*); me shqipen **dysh** (2 = ⦶ = ● = vdekje); me shqipen **des** (v-**des**), me angl. **die** që motivohet (kjo e fundit) me shqipen **daj** (fr. *séparer*) e kështu me radhë.

Kuptimi i *délivrance, solution...* (*çlirim, zgjidhje...*) shpjegohet me faktin se ndarja e shpirtit nga trupi (vdekja) vështrohet si çlirim i shpirtit, si zgjidhja e tij nga skllavëria e trupit. Ky mendim bën pjesë në vizionin e lashtë hindian për Botën dhe Njeriun.

Le të shpjegojmë tani kuptimin e *brëndësisë* (fr. *intérieur*). Kemi:

$$\textbf{(anta)}_{\text{sanskr.}} = \textbf{(â ndà)}_{\text{shq.}} = \oplus = \boxed{\circ}$$

Simboli i fundit është ai i "brëndësisë, i "brëndësimit të parë", ai i simbolit ○ do me thënë i Zotit (*Zoti* si *Deus Immanens*, do me thënë *i himun, i hyrë*).

Le të shpjegojmë (motivojmë) tani kuptimin **dépuis** (shq. *pas*).
Algoritmi simbolik na jep:

$$\textbf{(anta)}_{\text{sanskr.}} = \textbf{(â ndà)}_{\text{shq.}} = \oplus = 2 = \textit{pas}\ (\text{fr. } \textit{dépuis, puis, ...})$$

Le të shpjegojmë tani kuptimin **deri** (fr. *jusq'à*):

$$\textbf{(anta)}_{\text{sanskr.}} = \textbf{(â ndà)}_{\text{shq.}} = \oplus = (\quad) = \underset{A}{(}\!\!<\!\cdot\cdot\!>\!\!\underset{B}{)} = \text{nga } A \textbf{ deri } B$$

Vëmë rè dhe sa vijon:

1) Shqipja **deri**, duke u mbështetur në sa më sipër, duhet vështruar si e prejardhur nga **darë** (pjesore e foljes *daj*).

2) Rusishtja **do** (*∂o*) = *deri* (*jusq'à ...*) do lidhur me shqipen **dà** (*daj, darë,...*) që edhe e motivon atë.

3) Në gjermanisht **bis** = *deri* lidhet me latinishten **bis** = *2 herë* = *2*.

Por *2* = ⊕ = (<··>). E pra atëhere edhe gjermanishtja **bis** në kuptimin *deri* përshkruan, ndonëse tërthorazi, të njëjtin simbol.

Kuptimi i afërsisë (*voisinage*) shpjegohet:

a) me faktin se simboli ⦶ vjen *menjëherë* pas simbolit ○, pra dhe është *më i afërmi* me të, ndaj tij (ndaj pikës së referencës absolute).

b) sepse dimë se: ○ = ***1*** dhe ⦶ = ***2***. Por dimë edhe se ***2*** ndjek *menjëherë* pas ***1***.

c) sepse dimë se: ⦶ = ⨵, dhe ky simboli i fundit është ai i *lidhjes*, e pra dhe ai i *afërsisë*.

antar - adv. *à l'intérieur, dans les appartements, au milieu, entre, dedans, (brënda, në apartamentet, në mes, ndër, në...)*

Do zbërthyer si:

a ntar

e pra me shqipen:

â ndar

e pra simbolikisht:

⦶

Dimë se ⦶ = ⊡. Këtu ○ (referenca absolute, Zoti!...) është *brënda* (○).

Është e qartë, pas kësaj se edhe fjala latine *intus* (*brënda*) është prapë shqipja *â ndá* ashtu sikundër edhe greqishtja *endhós* (*ενtός*).


Në fjalorin e Gazullit mbi fjalët e rralla të Malësisë së Madhe gjejmë **ande** = *brënda* (*Ande lopa! = hy brënda lopë!...*) (shih edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi, fq. 115).

Vetë fjala **brënda** do zbërthyer si **bër enda** dhe më tej si *bër â nda*, e pra atëhere simb. ⦶, e pra atëhere edhe si ⊡, simbol ky i fundit që edhe e motivon atë.

Ashtu dhe fjalët latinisht, italisht e frëngjisht... *intra, entre, entrare, introire, ...* janë të gjitha të motivueshme përmes shqipes *â ndar*.

Edhe vetë fjala frënge *dans* do shpënë për t'u motivuar, tek shqipja *dan* (folja *me dà*) që e përcjell këtë fjalë frëngjisht tek simboli ⊡, që ajo "pa e ditur" (brënda sistemit leksikor frëng, s'ka ndonjë mjet gjuhësor për ta ditur...)

përshkruan:



antara - a. *intérieur; proche, intime; éloigné de; différent de; place (libre); ouverture; contenu; espace intermédiaire; clause; distance, éloignement; différence;* if. qqch. *d'autre que...; particularité, occasion; point faible...* **-am**... *dedans, dans l'intervalle, entre; a cause de...; pendant...; sans...* (*i brëndshëm; i afërt, intim, larg nga...; i ndryshëm nga; i brëndshëm; vend* (*i lirë*); *e hapur, vrimë; përmbajtje; hapësirë e ndërmjetme; klauzolë; distancë, largim; diferencë, ndryshim...; diçka tjetër; detaj, rast; pikë e dobët; ...* **-am** *brënda, brënda intervalit, ndër, ndërmjet; për shkak të...; ndërsa ...; pa ...*)

Duhet zbërthyer si:

a ntara

dhe me shqipen:

â ndarë

e pra simbolikisht:

Që nga ky simbol, nga ekuivalencat e tij simbolike dhe nga interpretimet e tyre konceptuale, ne duhet e mund të nxjerrim teorikisht të gjitha kuptimet, në dukje të shkëputura, mes tyre, të fjalës sanskritisht *antara*.

Shkruajmë:

 ...(**F**)

Dhe kemi kështu kuptimin e *brëndësisë* (fr. *intérieur*).

Vërë rè me këtë rast se frëngjishtja *intime* lidhet prapë me shqipen ***â ndamë*** e pra  , e pra për ekuivalencë simbolike  që jep fare mirë kuptimin e *brëndësisë*, e pra dhe atë të *intimitetit* ( , *Zoti, i Pari i brëndësuar, i fshehur, i imanentuar, Deus Immanens*, e pra *i brëndësuari paradigmatik* sipas të cilit

gjuha emërton, siç dimë*).

Kështu kjo fjalë frëngjisht (me prejardhje latine) me ndërmjetësinë e shqipes (*â ndamë*), përcillet tek simboli ⦶ që ajo në një mënyrë të "pavetëdijshme", përshkruan dhe, që andej, me ndihmën e Algoritmit Simbolik, tek simboli ⊡ që edhe e motivon atë. Kjo procedurë është **standarde** siç e kemi parë dhe mund të paraqitet këtu në këtë mënyrë:



Le të motivojmë tani kuptimin **larg nga**... (fr. *éloigné de*...).

Mund të shkruajmë sipas Algoritmit:

$$⦶ = (\ll\cdot\cdot\gg) = larg$$

Vëmë rè se tek simboli ○ nuk kemi asnjë distancë, gjithshka atje është *një*, gjë që mund të vërtetohet (shih edhe *P.Sh.A.S.*) në këtë mënyrë:

$$○ = (x = -x) = (x^2 + y^2 = 0) = (y = \pm ix) = \textit{drejtëzat izotrope}$$

mbi të cilat siç e dimë *distanca* nga një pikë çfarëdo në një tjetër është zero.

Tek ○ ***s'ka ndarje*** edhe sepse ne mund të shkruajmë për shëmbull:

$$○ = -⦶ = \textit{jo ndarje}$$

Pra është *ndarja* ajo që e ***krijon distancën***. Gjë që bën pra të pranueshëm kalimin simbolik të mësipërm:

$$⦶ = (\ll\cdot\cdot\gg) = larg$$

↓ ↓

ndarje *dis*-**tan**-*cë*

---

* Shih për këtë çështje Hyrjen.

Vëmë rè me këtë rast edhe sa vijon.

Fjala **distantia** (lat.) do zbërthyer si:

dis-tan-tia

ku:

dis = shq. **dysh** = *2* = *–1* (siç e kemi parë)

tan = shq. **tan** (*e tana, e tëra...*) e pra simbolikisht ○ (simbol, ndër të tjera, i *tërësisë*)

Pra atëhere tërë fjala **dis-tan**-*tia* do të thotë simbolikisht:

2 . *e tana* = **– 1 . e tana** = **– e tana** = –○ = ⊕ = (<··>)

distanca

Operatori i lirë shqiptar (rrënjë e pastër) **tan** (herë herë edhe në trajtën **tin** etj.) është përdorur edhe në të tjera fjalëformime në gjuhët me prejardhje kryesisht latine. Kështu bie fjala në fjalën:

des-tin-o = *fati*

Me shqipen kjo fjalë do shikuar si:

dés (e) **Tana**

ose edhe si:

dysh (e) **Tana**

E pra simbolikisht:

2 Tana = **2** ○ = **–1** ○ = –○ = ⊕

*Simboli i fundit është ai që përshkruan çdo fjalë në kuptimin e **fatit** në çdo gjuhë të botës.*

Kështu për shëmbull latinishtja *fatus* lidhet me fjalën *fetë* (it. *fetta - pjesë, rrisk*) e pra simb. ⏀.

Në shqip fjala **rrisk** ka edhe kuptimin e *fatit* edhe atë të *pjesës* e pra simb. ⏀. Në rusisht fjala *dolja* (*доля*) do të thotë *fetë, rrisk, pjesë* edhe në të njëjtën kohë **fat**. Në rusisht gjithashtu *udel* (*удел*) = *fat*, nga folja *delíts* (*делить*) = *me ndà*, pra simb. ⏀. Në greqisht gjithashtu *meros* (*το μέρος*) = *pjesë* (⏀), ndërsa *mira* (μοίρα) = *fat*, pra simb. ⏀.

Vëmë rè me këtë rast se operatori shqiptar **tan**, lidhet ndoshta me kinezçen **Tao**, një nga kategoritë fillosofike më themelore të krejt fillosofisë të lashtë kineze. Kjo mund të duket e çuditshme dhe e papranueshme linguistikisht, me qënë se siç na thuhet, këto dy gjuhë (shqipja dhe kinezçja) bëjnë pjesë në dy familje gjuhësore krejt të ndryshme... Por duhet patur parasysh se prapë ekziston një numër jo i vogël konkordancash mes shqipes dhe kinezçes*.

Kështu, ndër të tjera, kemi edhe të tilla konkordanca mes këtyre dy gjuhëve:


Kineze		Anglisht	Shqip
chāi	=	*tear apart*	*çaj*
shŭai	=	*decline; weakening*	*shuaj*
nèi	=	*inner part; inside;*	*në*
bēi	=	*carry on one's back; be burdened*	*baj*
wei	=	*do; become*	*bëj*
dì	=	*the earth; land; ground*	*dhè*
ku	=	*weep; cry*	*kjaj, vu ku-jën;*
lăo	=	*old, aged*	*i la-shtë*
kŏ	=	*mouth*	*go-ja*
shŏu	=	*guard; look after; observe*	*shoh*
zāi	=	*disaster; calamity*	*zì*
zá	=	*mischellaneous; mixed...*	*për-zì*

* Siç e vë në dukje autori i këtij shkrimi në një studim tjetër të tij ende të pabotuar me titull "Roli Mesianik i Gjuhës Shqipe".

zā	=	*tie, bind; fasten;*	*zâ, zânë*
duàn	=	*cut, break off, snap; dis-continue;*	*daj, dān*
chàng	=	*sing;*	*kangë*

E kështu me radhë...

Siç thamë, fjala **Tao** në gjuhën kineze ka një kuptim themelor fillosofik e fetar.



Sipas **Taoizmit** (fillosofisë së Taos) ekzistojnë dy entitete rivale dhe të kundërta, **jing** (parimi *femëror*, a *negativ*, që korrespondon me ngjyrën e *zezë*), dhe **jang** (parimi *mashkullor*, a *pozitiv*, që korrespondon me ngjyrën e *bardhë*). Kjo dikotomi mes këtyre dy parimeve, atij *negativ* (–, **Jing**) dhe atij *pozitiv* (+, **Jang**), përshkon tërë realitetin*. Ky është një dualitet që gjendet në çdo send

* Ja se çfarë lexojmë lidhur me këtë simbol tek Cirlot (fq. 47) :

"... In China, activity, or the masculine principle (Yang), is represented by a white circle (depicting heaven), whereas passivity, the feminine principle (Yin) is denoted by a black square (portraying earth). The white circle stands for energy and celestial influences and the black square for telluric forces. The interaction implicit in dualism is represented by the famous symbol of the Yang-Yin, a circle divided into two equal sections by a sigmoid line across the diameter, the white section (Yang) having a black spot within it, and the black (Yin) a white spot. These two spots signify that there is always something of the feminine in the masculine and something of the masculine in the feminine. The sigmoid line is a symbol of the movement of communication and serves the purpose of implying – like the swastika – the idea of rotation, so imparting a dynamic and complementary character to this bipartite symbol. The law of polarity has been the subject of much thought among Chinese philosophers, who have deduced from this bipolar symbol a series of principles of unquestionable value, which we here transcribe: a) the quantity of energy distributed throughout the universe is invariable; b) it consists of the sum of two equal amounts of energy, one positive and active in kind and the other negative and passive; c) the nature of cosmic phenomena is characterized by the varying proportions of the two modes of energy involved in

e në çdo shfaqje të jetës si ekzistencë. Themi shkarazi që teoria e Freudit mbi "panseksualizmin" i ka rrënjët këtu*.

Jing e *Jang* përftohen nga **ndarja** e të *Tërës* (*Tao*) në dy pjesë:

$$- \bigcirc = \textcircled{\scriptsize D} = \textcircled{\scriptsize S} = \S2 \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

Ato luftojnë mes tyre ($\textcircled{\scriptsize D} = \S2$), ato alternohen mes tyre ($\textcircled{\scriptsize D} = \odot$) (një herë *jing*, një herë *jang*...) dhe ky është *Qarkullimi*. Çdo shfaqje jetike, çdo fenomen në Natyrë ka një përqindje të caktuar *jing* (*negativitet*) dhe një

---

their creation. In the twelve months of the year, for example, there is a given quantity of energy drawn from six parts of **Yang** and six of **Yin**, in varying proportions."

(...Në Kinë, aktiviteti a parimi mashkullor (Jang) paraqitet nga një rreth i bardhë (që rri për Qiellin), ndërsa pasiviteti a parimi femëror (Jing) jepet si një katror i zi (që paraqet Tokën). rrethi i bardhë rri për energji dhe influenca qiellore ndërsa katrori i zi, për energji tokësore. Bashkëveprimi që nënkupton ky dualizëm paraqitet nga simboli i famshëm i Jang-Jingut: një rreth i ndarë në dy pjesë të barabarta nga një vijë sigmoidale (nga një **S**) përmes diametrit. Prej tyre, pjesa e bardhë (Jang) ka brënda saj një pikë të zezë, ndërsa pjesa e zezë (Jing) një pikë të bardhë. Kuptimi i këtyre dy pikave është ky: ka kurdoherë diçka femërore tek mashkulli sikundër edhe diçka mashkullore tek femra. Vija sigmoidale e ndarjes simbolizon një lëvizje komunikimi dhe implikon, sikundër dhe svastika, idenë e vërtitjes, duke i dhënë kësaj ndarje dyshe një karakter dinamizmi dhe koplementariteti. Ligji i polaritetit (i të kundërtave) ka qënë objekti i një meditimi të gjatë e të thellë nga ana e fillosofëve kinezë që kanë mundur të deduktojnë nga ky simbol bipolar një sërë parimesh me një vlerë të padiskutueshme të cilat po i rreshtojmë këtu: a) sasia e energjisë e shpërndarë në Univers është e pandryshueshme; b) ajo përbëhet nga dy sasira të barabarta energjie, njëra pozitive dhe aktive, dhe tjetra negative dhe pasive; c) natyra e fenomeneve kozmike karakterizohet nga përpjesëtimet e ndryshueshme të këtyre dy llojeve të energjisë që marrin pjesë në krijimin e tyre. Kështu, p.sh. gjatë dymbëdhjetë muajve të vitit kemi një sasi të caktuar energjie që përftohet nga gjashtë pjesë **Jang** e gjashtë pjesë **Jing** në përpjesëtime të ndryshme.)

* Tek Cirlot (fq. 290) lexojmë:

"... Now the Freudians have reduced the great majority of object, depending upon whether their predominant characteristic is that of the container or the contained to either feminine or masculine sexual implication; but is nothing new in this, for implicit in the ancient Chinese **Yang-Yin** symbol is in the notion of a classification whereby all things fall within a system which locates the genders at opposites poles, corresponding to the duality of sexes."

(... Dishepujt dhe ndjekësit e Frojdit i ndajnë sendet në dy kategorira; në njërën prej tyre përfshihen ato që kanë tipare objektesh që shërbejnë për të përmbajtur (futur brënda), dhe që cilësohen si femërore, ndërsa në tjetrën ato që kanë tipare objektesh që përmbahen (futen brënda) dhe që cilësohen si mashkullore. Por duhet thënë se këtu nuk ka asgjë të re, sepse kjo është edhe ndarja që bën simboli i lashtë kinez i Jang-Jingut sipas të cilit të gjitha sendet përfshihen brënda një sistemi që i vendos sekset e ndryshme në dy pole të kundërt që u përgjigjet bash dualitetit të tyre.).

përqindje të caktuar *jang* (*pozitivitet*). Këto përqindje ndryshojnë (variojnë) sipas sendit dhe fenomenit.

Kthehemi tani tek **Tao**. Tao është *mbi* këtë ndarje, *mbi* këtë opozitë, *mbi* këtë alternim. **Tao** është ***njëkohësisht*** edhe **jing** ($-x$) edhe **jang** (x), e pra ne mund të shkruajmë atëhere se:

$$\textbf{Tao} = (x = -x)$$

Mirëpo dimë se:

$$\textbf{Qëndra} = (x = -x) = \bigcirc$$

Kështu pra *koncepti i* ***Taos*** *përputhet me atë të* ***Qëndrës***; dhe nga ana tjetër simboli i fundit është ai i *të Tërës, të* ***Tanës***. Pra dhe mund të konkludojmë se:

$$(\textbf{Tao})_{\text{kin.}} = (\textbf{Tan})_{\text{shq.}}$$

Kjo bisedë mund të zgjatej dhe të zgjerohej më tej, por kufijtë që i kemi vënë vetes në këtë studim, na detyrojnë të ndalemi këtu.

Le të vijojmë tani me motivimin e kuptimeve të tjera të fjalës sanskrite **antara**.

Kuptimi: *i ndryshëm nga...* (fr. *différent de...*).

Me qënë se:

$$\textbf{antara}_{\text{sanskr.}} = \textbf{â ndarë}_{\text{shq.}} = \textcircled{\scriptsize |} = -\bigcirc$$

ne mund të themi se këtu është fjala për një *ndryshim nga* ○. Mirëpo ○, mos harrojmë, është **referenca absolute**. Kështu pra $-\bigcirc$ është i pari i ndryshëm dhe rikujtojmë prapë e prapë se *Gjuha emërton sipas të Parit* (shih lidhur me këtë çështje edhe *Hyrjen*). Prandaj pra dhe operatori i *ndarjes* shërben për të dhënë edhe kuptimin e *ndryshimit* ($\textcircled{\scriptsize |} = -\bigcirc$).

Shqipja e jep bukur këtë gjë:

$$\begin{cases} \textbf{\textit{ndarë}} \text{ (fr. } \textit{séparé, divisé...}\text{)}, & \text{dhe:} \\ \textbf{\textit{ndryshe}} \text{ (fr. } \textit{différent}\text{)} \end{cases}$$

ku në të dy rastet është fjala për operatorin e ndárjes (**ndr-**).

Me qënë se *ndryshimi* (e ndryshmja nga ***1***) është treguar simbolikisht me χ dhe me qënë se ne kemi nga ana tjetër, sipas Algoritmit:

$$\chi = F = \sim = \textit{lëvizja, transformimi, ndryshimi}$$

ne mund të shkruajmë atëhere:

$$\underset{\textit{ndarë}}{\circledcirc} = \underset{\textit{ndryshe}}{\chi} = \underset{\textit{ndryshimi (lëvizja)}}{\sim} \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

Në qoftë se do t'i shumëzonim të dy anët e këtij ekuacioni me -1 do të gjenim:

$$-\circledcirc = -\chi = -\sim \qquad \ldots(\mathbf{E})$$

ose pra:

$$\bigcirc = 1 = -\sim \qquad \ldots(\mathbf{E})$$

Pra:

Qëndra ($\bigcirc = (x = -x)$) është **një** (1), ajo *nuk lëviz*, po *qëndron* ($-\sim$)

Prandaj pra *Qëndra* ($\bigcirc$) është me të vërtetë *Pika e referimit absolut* ose e thënë ndryshe, **Invarianti absolut i çdo transformacioni**.

Vëmë rè se edhe në italisht kemi:

metà-moto (*gjysmë-lëvizje*)

si dhe

mutilare - mutare (*gjymtoj - ndryshoj*)

Pra mund të shkruajmë:

$$\underset{\substack{\textit{metà}\\ \textit{mutilare}}}{\circledcirc} = \underset{\textit{moto}}{\sim} = \underset{\textit{mutare}}{\chi} \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

Në gjermanisht ***ander*** = *tjetër* (fr. *autre, différent*) dhe *verändern* = *ndryshoj*. Duke patur parasysh se kemi:

$$\textbf{(ander)}_{\text{gjer.}} = \textbf{(â ndarë)}_{\text{shq.}} = \text{⦶}$$

duke treguar *verändern* (ku *ver-* është shqipja *bër*, si një prefiks verbalizonjës) me χ, ne shohim se edhe gjermanishtja pozon, me ndihmën e shqipes dhe të Algoritmit Simbolik ekuacionin:

$$\underset{\substack{\textit{ander}\\(\textit{â ndarë})}}{\text{⦶}} = \underset{\textit{verändern}}{\chi} \qquad \ldots\textbf{(F)}$$

Kuptimi i *vrimës, hapjes* (fr. *ouverture*):

$$\textbf{(antara)}_{\text{sanskr.}} = \textbf{(â ndarë)}_{\text{shq.}} = \text{⦶} = \boxed{\circ}\searrow \quad \begin{matrix}\textbf{vrima}\\ \textit{ouverture}\\ \textit{espace libre}_{\text{fr.}}\end{matrix}$$

"espace libre" sepse ○ është edhe simboli i *Boshit* (*Mystic Void*).

Kuptimi i *përmbajtjes* (fr. *contenu*):


$$\textbf{(antara)}_{\text{sanskr.}} = \textbf{(â ndarë)}_{\text{shq.}} = \text{⦶} = \boxed{\circ}\searrow \quad \begin{matrix}\textit{përmbajtja}\\ \textit{contenu}_{\text{fr.}}\end{matrix}$$

○ (*Qëndra, Zoti* ...) është *i Përmbajturi i Parë*, e pra dhe *Përmbajtja e Parë*. *Ai* (*Zoti*), u bë i tillë, pas mitit kozmogonik, pas krijimit të Botës. *Ai* u bë kështu *Sub-stanca* e Botës... (rikujtojmë në fillosofinë e Spinozës:

Deus sive Sub-stantia...).

Le të shpjegojmë tani përse fjala shqip *përmbajtje* ka dy kuptime: atë të ***brëndësisë***, të diçkaje që është *brënda*, të *sub-stancës*, dhe njëkohësisht edhe atë të *ndalimit, pengimit, frenimit, represimit, inhibimit* ...

Algoritmi Simbolik na jep:



Kemi kështu një përcaktim tjetër të *përmbajtjes* si koncept fillosofik: *përmbajtja është ajo që përmbahet* (që *lidhet*, që *inhibohet*... që *nuk lihet të dalë jashtë*, etj. etj.).


Po ashtu si në shqip edhe në italisht: **contenuto** = *përmbajtja* (në kuptimin e *brëndësisë* dhe në të njëjtën kohë edhe në kuptimin e *ndalesës*, *represimit*, etj). Po ashtu edhe në gjermanisht, ku:

Inhalt = *përmbajtje, brëndësi, substancë*; ndërsa:
halten = *ndaloj, represoj,* etj. etj.

Nuk është pra kështu fjala për një rastësi, por për një parim të rëndësishëm fetar-fillosofik, sikundër që Algoritmi Simbolik (artikullim i Mendimit Mitik!) na lejon ta kuptojmë edhe më lehtë, më mirë e më qartë.

Kuptimi *hollësi* (fr. *particularité*) jepet fare mirë nga simboli ⓘ që është ndër të tjera edhe ai i *pjesës* (fr. *part* që nga dhe *particularité*).

Kuptimi *pikë e dobët* (fr. *point faible*) jepet nga simboli:



(sepse *e zbuluar, e pambuluar, e pa mbrojtur*...)

Kuptimi *sans* (shq. *pa*) jepet nga ekuacioni:

$$(\textbf{antara})_{\text{sanskr.}} = (\textbf{â ndarë})_{\text{shq.}} = \text{⦶} = -\bigcirc = -1 \quad \ldots(\textbf{F})$$

pa

pas, sans fr.

Dhe kjo është *pa*-ja e parë, arketipike, paradigmatike nga e cila zuri fill Bota (*mohimi, sakrifikimi i Hyjnisë*: $-\bigcirc$).

Kuptimi *për shkak të ...* (*a cause de ...*), do me thënë simbolikisht $\leftrightarrow$ (simboli i *shkakësisë materiale* në llogjikën mathematike) jepet nga fakti se:

$$(\textbf{antara})_{\text{sanskr.}} = (\textbf{â ndarë})_{\text{shq.}} = \text{⦶} = \leftrightarrow = \textit{për } \textbf{shkak } \textit{të}$$

... (fr. *a cause de...*)

Kuptimi *ndër-sa* (fr. *pendant*) del nga se kemi:

$$(\textbf{antara})_{\text{sanskr.}} = (\textbf{â ndarë})_{\text{shq.}} = \text{⦶} = (\ll\cdot\cdot\gg) = \textit{ndër-mjet} =$$

ndër-sa (fr. *pendant; dans l'intervalle...*)

Duket qartë se shqipja **ndër**-*mjet* dhe **ndër**-*sa* lidhen brënda shqipes me operatorin **ndarë** që edhe i motivon ato.

Kështu pra me ndërmjetësinë e shqipes (*â ndarë*) dhe me atë të Algoritmit Simbolik, ne shpjeguam (motivuam) të ***gjitha*** kuptimet e ndryshme të fjalës sanskrite *antara*.

antarayati - *dissimuler* (*shtirem, hiqem si nuk jam*)

-yati është këtu një sufiks verbalizonjës (në rusisht *jat* (*ять*)) dhe ndoshta shqipja *jetë* (folja *me qënë*). Në shqip e gjejmë ndër të tjera në *shpe-jt, kre-jt* e kështu me radhë. Kemi:

$$(\textbf{antara})_{\text{sanskr.}} = (\textbf{â ndarë})_{\text{shq.}} = \text{⦶} = \boldsymbol{F} = (-\boldsymbol{x} = \boxed{\text{x}}) =$$

jam jashtë ($-\boldsymbol{x}$), si *nuk jam brënda* ($\boldsymbol{x}$), e pra *shtirem, jam hipokrit* (fr. *dissimuler*)

apa - préf. *marquant écart, privation, absence, infériorité*
(parashtesë që tregon devijim, privim, mungesë, inferioritet)

Është shqipja **â pa** (fr. *est sans...*), e pra simb. -1. Kuptimet e tjera dalin, përmes Algoritmit në këtë mënyrë:

(apa) $_{\text{sanskr.}}$ = **(â pa)** $_{\text{shq.}}$ = -1 = F = $(x^2 + y^2 = r^2)$ = $-(x^2 + y^2 = 0)$ = *jo qëndër*, e pra *decentrim, devijim; jo pikë* e pra *jo pikërisht ...* = $-\bigcirc$ = *jo e plotë*, e pra *privim, mungesë ...* = ♀ = *inferioritet...*

apa-varga - m. *fin; béatitude, délivrance finale*
(fundi; lumturi, çlirim final (përfundimtar))

Është shqipja:

â pa varg-*onj*

E pra simb. $-\aleph$.
Algoritmi Simbolik na jep:

$-\aleph$ = E = $-\bullet$ = *fund i botës, i jetës materiale, jo të këqija, jo vuajtje, jo të zeza ...* = $-\beth$ = **paqe** = $\bigcirc$ = *Dritë, hyjnizim...* = *lumturi* (fr. *béatitude*)

Këto përfundime janë të gjitha në përputhje të plotë me fillosofinë e lashtë hindiane dhe me Budizmin, sipas të cilit, njeriu në këtë Botën tonë materiale, është në gjëndje të bëjë vetëm jetën e një skllavi, të një qënieje të lidhur me vargonj...

apa-latā-bhavana - a. *dénoué de feuillage*
(i çveshur nga gjethet, pa gjethe, pa fletë...)

Do zbërthyer si:

a pa latā bha vana

dhe me shqipen:

â pa f-letë bâ ban

ku **ban** është folja *me bâ*.

Ka mundësi që ***f-letë*** në shqip të jetë një shumës i singularizuar, si bie fjala *rreth* për *rrath*, etj. Këtë e rikonfermon edhe fakti se në shqip kemi edhe **f-lat-ra**. Në gjermanisht *Blatt* dhe në shumës *Blätter*.

Pra, shqipja *fletë* ka qënë siç duket *bâ latë*, dhe që këndej për efekt ndryshimesh fonetike të njohura e të pranueshme *f-letë*.

Kuptimi i fjalës, pas "reduktimit" në shqip është *-fletë* (*pa fletë*; fr. *dénoué de feuillage*...).

apa-LAP - *nier* (*mohoj*)

Do zbërthyer si:

a pa LAP

dhe me shqipen:

â pa llap

Rrënja **Lap** (*lapati; lâlapa*....) ka në sanskritisht kuptimin: *causer, bavarder*... (shq. *flas, llap* ...).

$$(\mathbf{apa})_{\text{sanskr.}} = (\mathbf{â\ pa})_{\text{shq.}} = -1$$

Pra tërë fjala:

apa-LAP = – **llap** = **llap** – *1* = **llap** (*them*) **jo** = *mohoj* (fr. *denier, nier*...)

apa-lapana - nt. *flatterie; diffamation* (*lajkë; përfolje, difamim*...)

Do zbërthyer si:

a pa lapana

dhe me shqipen:

â pa llapun

e pra:

llapun -1

Mirëpo Algoritmi Simbolik jep:

$-1 = F = (-x = \boxed{x}) =$ *ndryshe jashtë* $(-x)$ e *ndryshe brënda* (x)

e pra:

hipokrizi, si edhe *lajkë* ... = ● = *zi; keq*...

Pra atëhere:

(apa-lapana) $_{\text{sanskr.}}$ = **(â pa llapun)** $_{\text{shq.}}$ = *llapun:* -1 = *llapun:* $(-x = \boxed{x})$
= *të folur hipokrit, fallco, të folun me lajka*... (fr. *flatterie*) = *llapun:* (●)
= *me folë keq, me fol zi për dikë*... (fr. *diffamation*)

apa-lapa - m. *fait de cacher;* **-in** a. *qui cache*
(*me fsheh; që fsheh;... fsheharak*)

Kemi:

(apa-lapa) $_{\text{sanskr.}}$ = **(â pa llap)** $_{\text{shq.}}$ = (*llap:* -1) = *nuk* (-1) *llap* =
fsheh, nuk e nxjerr të vërtetën... (fr. *cacher*...)

ose edhe: ...$(-1) = F =$ ⊡, ku ○ rri për të *vërtetën* dhe ⊡ për *fshehja e të vërtetës*.

apa-vāraka - m. *lieu clos* (*vend i mbyllur*)

Kemi:

(apa-vāra ka) $_{\text{sanskr.}}$ = **(â pa vërë)** $_{\text{shq.}}$ = *– vërë* (*vrimë*)
= *pa vrimë* = *i mbyllur* (fr. *lieu clos*)

Pjesa **-ka** mund të identifikohet me foljen *ka* të shqipes ose mund të jepet edhe një interpretim tjetër: **vār-ak(a)**. Dhe në këtë rast do të kishim *var* = shq. *vërë*, ndërsa **-ak(a)** mund të vështrohej si një prapashtesë e rëndomtë në sanskritisht që mund të krahasohet me të njëjtën prapashtesë në shqip si për shëmbull në *trumc**ak***, *boshnj**ak***, ...etj. etj.

apa-vedha - m. *mauvais percage* (*d'une pierre*) (*çpim i keq i një guri...*)

Kemi:

$$(\textbf{apa-vedha})_{\text{sanskr.}} = (\textbf{â pa bë dà})_{\text{shq.}} = (dá: -\textit{1})$$

Po Algoritmi Simbolik jep:

$$-1\ (\hat{a}\ pa) = F = \bullet = \ominus\ (dá) = \boxed{\circ}\ \downarrow$$

vrimë, çpim (fr. *percage*)

Kemi atëhere përfundimisht:

$$(\textbf{apa-vedha})_{\text{sanskr.}} = (-\ \textbf{bë dà})_{\text{shq.}} = \bullet = \boxed{\circ}\ \downarrow$$

mauvais fr. — *percage* fr.

e keqe — *vrimë, çpim*

apa-vṛtti - fr. *fin, disparition* (*fund, zhdukje*)

Kemi:

$$(\textbf{apa-vṛtti})_{\text{sanskr.}} = (\textbf{â pa } \textit{vërtit})_{\text{shq.}} = -\textit{vërtitje} = -\odot$$

Po Algoritmi Simbolik jep:

$-\odot = -F = E = -\bullet$ = *jo materie, jo botë materiale* = *zhdukja e materies, e realitetit material, fundi i botës* (fr. *fin, disparition*).

Algoritmi na jep akoma: ... $E = \bigcirc$ = *Nirvana*, "*Mystic Void*"...

apa-vidyā - f. *ignorance* (*padije*)

Kemi:

(**apa-vidyā**)$_{\text{sanskr.}}$ = (**apa vi dyā**)$_{\text{sanskr.}}$ = (**â pa bâ dije**)$_{\text{shq.}}$ = (është bërë *pa dije*)$_{\text{shq.}}$ = – *dije* = *padije* = *ignorance*$_{\text{fr.}}$

apa-varjita - a.v. *lâché, séparé...* (*i lëshuar, i ndarë...*)

Kemi:

(**a pa var jita**)$_{\text{sanskr.}}$ = (**â pa var jetë**)$_{\text{shq.}}$ = (*është i pa varur*) = *i lirë, i lëshuem*

E pra simb. –⋛; *jetë* këtu është kohë e foljes me *qënë* (p.sh. *do të jetë* ...). Të njëjtin funksion ka edhe **jita** (edhe **yati**, *jat*, *jet*...), në sanskritisht: prapashtesë verbalizonjëse (foljore)...

apa-hati - f. *expulsion* (*nxjerrje jashtë, përjashtim...*)

Është shqipja **â pa hyt**, ku **hyt** është pjesore e lashtë e foljes *HYJ*.
Pra kemi:

(**apa-hati**)$_{\text{sanskr.}}$ = (**â pa hyt**)$_{\text{shq.}}$ = –**hyt** = –⊡ = ○ = *për-jasht-im* (fr. *expulsion*)

apa-ha - a. ife. *qui éloigne, qui détruit* (*që largon, që shkatërron...*)

Kemi:

(**apa-ha**)$_{\text{sanskr.}}$ = (**â pa hy**)$_{\text{shq.}}$ = –**hy** = –⊡ = –***F*** = ***E*** = –⋛ = *çthurrje, çngatërrim, shkatërrim...* = –● = *çlëndëzim, shkatërrim* (fr. *déstruction*) = ⊡↘ = *dalje, largim* (fr. *éloigner*)

apa-hartṛ - ag. *qui enlève ou détruit, qui expie*
(*që nxjerr e largon; që shkatërron; që shlyen një dënim*)

Ku: **tṛ** është këtu një prapashtesë që tregon vepruesin, si në shqip **-tor**, **-tar**, si për shëmbull në *punë-tor* (ai që bën *punën*, që *punon*); *luftëtar*, etj.

Atëhere kemi:

(**apa-har tṛ**)$_{\text{sanskr.}}$ = (**â pa hyr tor**)$_{\text{shq.}}$ = (– *hyr-tor*) = (ai që bën *jo* **hyrje**) = (ai që bën *dalje*) = (ai që *nxjerr*, ai që *heq* e *largon*...)

Simbolikisht tërë fjala do të tregohej me:

$$- \boxed{\tilde{\circ}}$$

ku me $\sim$ është treguar *lëvizja* e pra *veprimi*, e pra dhe *vepruesi*, kurse me $\boxed{\circ}$ *hyrja*.

Me qënë se:

$\boxed{\circ}$ = ***F*** = ● = **lyej** = *krim, mëkat* = *materie, botë materiale*...

Atëhere:

$- \boxed{\circ}$ = $- F$ = ***E*** = $-$ ● = *shlyerje, ai që shlyen, shlyersi* (fr. *qui expie*) = *ai që shkatërron*... (fr. *qui détruit*)

Mos harrojmë këtu se simboli ● ka vërtetë kuptimin e të *keqes*, të *fajit*, të *mëkatit*, por ai ka në të njëjtën kohë, edhe kuptimin e *materies* e të *botës materiale*.

apa-HAN - *éloigner; détruire* (*en enlevant*)
(*largoj; shkatërroj* (*duke nxjerrë e hequr*))

Kemi:


(apa-HAN) $_{\text{sanskr.}}$ = **(â pa hyn)** $_{\text{shq.}}$ = – **hyn** = *del, nxirret, hiqet...* (fr. *éloigner*)

Simbolikisht kjo fjalë do të paraqitej si: $-\boxed{\circ}$

Po Algoritmi jep: $-\boxed{\circ} = -F = E = -\bullet$ = *shkatërrim i materies, i lëndës, çlëndëzim* = ○ = *an-***nihil***-im*; kthim në *Mystic Void*-in parafillestar (para lindjes së botës lëndore), në *Nirvana*[*].

Simboli ○ që është ai, ndër të tjera, i *Qëndrës* i *Zotit*, i *Hyu*-t, etj. etj., mund të vështrohet edhe si ai i *Unit universal*, i *Atman*-it. Sipas Fillosofisë së lashtë hindiane, çdo njeri është në një farë mënyre e shkalle *Atman*, do me thënë *Hyjni*, në kuptimin që *Ai, Zoti*, është brënda secilit prej nesh. Edhe latinët kështu kanë menduar sikur e provon ndër të tjera shprehja: "*Est Deus in nobis*". Dhe kështu ka menduar e mendon tërë mendimi mistik botëror.

Algoritmi Simbolik e rikonfermon këtë. Dhe në fakt, ai na lejon të shkruajmë:



Duke qënë kështu, atëhere mund të shkruajmë:

(apa-hata) $_{\text{sanskr.}}$ = **(â pa hytë)** $_{\text{shq.}}$ = $-\boxed{\circ}$ (*vehtja, uni...*) = *jo vetja, jo uni*

E pra:

që ka shmangur nga vetja (fr. *qui a détourné de soi*).

apa-haraṇa - nt. *fait d'enlever; de favoriser la fuite* (*d'un prisonnier*) (*heq, nxjerr; favorizoj ikjen* (*e një të burgosuri*))

---

[*] Në sanskritisht *pralaya* = *fund i botës, çlirim* dhe zbërthehet në **pra la-ya** dhe me shqipen *para-li-thjes*, e pra simb. – ⋈ e pra *para thurrjes*, e pra edhe ... = ***E*** = –● = ○ = ...

Kemi:

(apa haraṇa) $_{\text{sanskr.}}$ = **(â pa hyrun)** $_{\text{shq.}}$ =

– **hyrun** = – ⊡ = – *F* = *E* = – ☓ = *çliroj, çburgos...*

apa-hantṛ - ag. *qui écarte* (*që shmang, që i shmanget...*)

Kjo fjalë është prapë fjala *apa-hartṛ* për sa i përket rrënjëve të pastra (*operatorëve të lirë*) me të cilët është formuar, por veç këtu **har** është zëvendësuar me *han* si në shqip *hyr* dhe *hyn* (siç dihet trajta me *rotacizëm*, me **r** në shqip, është e të folurës së Jugut).

Ky zëvendësim i **n** me **r** në sanskritishte është bërë me qëllim që të shmangë keqkuptimin.

Simboli që kjo fjalë përshkruan është po ai (si *apahartṛ*) do me thënë:

– ⊡̃

Me qënë se ○ është *Qëndra* si edhe *Vehtja* (shih më lart) tërë ky simbol fare mirë mund të interpretohet atëhere si *ai që kryen* (~) *shmangien* (–) *nga vehtja* (⊡); *që shmang, që devijon... që largon...* (fr. *écarter, éloigner, détrourner...*).

apa-BHAṢ - *moy. insulter* (*shaj, poshtëroj..*)

BHAṢ është shqipja *Bëzaj* (*bë zâ*) në kuptimin *flas, them, thërras ...*

(apa) $_{\text{sanskr.}}$ = **(â pa)** $_{\text{shq.}}$ = *–1*

Por Algoritmi Simbolik na jep:

–1 = *F* = ● = **keq** ...

Pra, tërë kuptimi i fjalës është:

flas, them (*bëzaj*) fjalë *të këqija* (*–1* = ●) e pra **shaj**, fr. *insulter*.

apa-MAN - *mépriser (përbuz)*

MAN është në sanskritisht folja *me menue, me men-d-ue.*
manas në sanskritisht = *menja (mën-d-ja).*
apa është shqipja *â pa = – 1*

Por Algoritmi Simbolikisht jep:

$$-1 = \bullet = \textbf{keq}$$

Pra tërë fjala do të thotë:

mendoj (MAN) **keq** (*apa* = – *1* = ○)

Por *të mendosh keq për dikë* do të thotë *ta përbuzësh atë...*

apa-kāra - m. *fait de causer du tort, dommage; méprise (shkaktimi i një padrejtësie, një dëmi; gabim...)*

Kemi:

$$(\textbf{apa-kāra})_{\text{sanskr.}} = (\textbf{â pa kry})_{\text{shq.}}$$

Nga ana tjetër: *â pa = – 1 = F =* ● = *e keqe*, **dëm**; **gabim** (me qënë se ● = –○ = – *e vërteta...*).

Pra:

kryj **â pa** = *kryj – 1* = *kryj* ● = ...

apa-KṚ - *écarter, enlever; faire tort, injurier; faire du mal ((shmang, heq; kryej një padrejtësi; bëj të keqe...)*

°**krta** - *lésé, maltraité;* nt. *injurier (i dëmtuar, i keqpërdorur; shaj...)*

Është shqipja **â pa kryj** = *kryj – 1* = *kryj* ● = etj. etj. (shih *apa*-**kāra**).

Për kuptimin "shmang, heq..." etj. kij parasysh se:

a pa = -1 = ● = $-\bigcirc$ = $-(x = -x)$ = – *qëndra* = *çpërqëndrim* = *devijim* = *shmangje* etj. etj.

Lidhur me kuptimin *shaj* (fr. *injurier*) vëmë rè se në shqip kemi **GËR**-*thas* që lidhet me sanskr. **KṚ si edhe me** fr. **CR**-*ier*, fjalë këto që rrjedhin ndofta nga shqipja **GRY**-*ka*, **GËR**-*mazi*, etj. etj.

apa-vatsa - a. *sans veau* (*pa viç*)

Është shqipja: **â pa viç** (*është pa viç...*).
Ose edhe *â pa vjeta*, meqenëse në Veri, në Malësi, *viçit* i thonë edhe *vjeta*.

apa-hāsa - m. *rire të moquerie* (*e qeshur tallëse*)

hāsa është shqipja *qesh, qesh-je*.
apa është shqipja **â pa** = **pa** = -1 = ***F*** = ● = **keq** = ♀ = *ulje; poshtërim...*
Pra kuptimi i fjalës është atëhere: *qeshje e keqe, qeshje ulëse, poshtëruese...*

apa-hāsya - a.v. *digne de moquerie* (*që është bërë për t'u tallur*)

Shih **apa-hāsa**
Siç shihet sanskritishtja e përkufizon *talljen* (fr. *moquerie*) si *qeshje negative, qeshje e keqe, qeshje poshtëruese...*

an-apara - a. *sans second* (*pa të dytë*)

a (përpara një zanore **an**) është privative në sanskritisht, pra simb. -1, $-$.
para është shqipja (*i, e*) **parë** (fr. *premier...*).

Atëhere:

apara = – **para** = – **parë** $_{\text{shq.}}$ = *jo i parë* = *i dytë*

dhe:

an-apara = – *i dytë* = *pa të dytë* (fr. *sans second*)

an-abhidhāna - nt. *fait de ne pas exprimer* (*fakti i të mos shprehurit*)

Do zbërthyer si:

an a bhi dhāna

dhe me shqipen:

– **â bâ** *dhānë*

e pra:

nuk â(sht) *bâ dhanë* = *nuk asht dhanë* = *nuk asht shpreh...*

an-abhibhāṣin - a. *qui ne s'adresse pas à ...* (*që nuk i drejtohet* (*dikujt*)...)

an = **a** = – *1*, (shih më lart)
(abhi) $_{\text{sanskr.}}$ = **(â bâ)** $_{\text{shq.}}$
(bhāṣin) $_{\text{sanskr.}}$ = **(bëzan)** $_{\text{shq.}}$

Pra me shqipen:

nuk (– *1*) *â bâ bëzan*

E pra: *qi nuk bëzan, që nuk i bëzan kujt, nuk i drejtohet* (fr. *qui ne s'adresse pas à*).

an-apalapa - a.v. *qui ne nie pas* (*që nuk mohon, që nuk thotë "jo"*)

an = **a** = – *1* = –
apa = *â pa* $_{\text{shq.}}$ = *pa* = – *1* = –
lapa = **llap** $_{\text{shq.}}$

Pra atëhere:

(an-apalapa) $_{\text{sanskr.}}$ = –(– **llap**) $_{\text{shq.}}$ = *që nuk* (–) *llap*
(*thotë*) *jo* (–) = *që nuk mohon...*

an-antya - nt. *infinité* (*pambarimësi, pafundësi...*)

an = **a** = – *1* = –
antya = **(â ndà)** shq.

pra:

(an-antya) sanskr. = – **(â ndà)** shq.

e simbolikisht:

$-\oplus$

Por Algoritmi jep:

$-\oplus = E = \bigcirc = (x = -x) =$ *Qëndra = Zoti = pafundësia*

Vërejtje:

Mund të arsyetohej edhe kështu:

$-\oplus$ = *jo kufi, jo limit e pra pakufishmëri e pra pafundësi...*

Ose edhe: $-\oplus = \bigcirc$, dhe ky simbol i fundit është në mendimin mitik ai i *All, Infinity...* siç e kemi parë edhe në raste të tjera.

an-antarvāsas - a. *qui n'a pas de sous-vêtement* (*që s'ka ndën-veshje; që s'ka të poshtme, që s'ka ndërresa, të mbathura, etj. etj.*)

an = **a** = – *1* = –
antar = **(â ndar)** shq. = $\oplus$
vāsas = **(vesh-je)** shq.

Pra:

(an-antarvāsas) sanskr. = –**(â ndarë veshje)** shq. = $-\oplus$ **veshje**

Po Algoritmi jep:

$\oplus$ = ⊡ = ♀

brënda ndën *poshtë*

E pra atëhere:

– (*veshje* ⊡) = *pa veshje të brëndshme, pa nënveshje*

si edhe:

– (*veshje* ♀) = *pa veshje të poshtme*, etj. etj.

an-anta - a. ***infini, illimité; éternel; Çiva; Vişnu, etc.***
(*i pambarim, i pakufijtë; i përjetshëm, Shiva, Vishnu, etj.*)

an = **a** = *– 1* = –
anta = **(â nda)** $_{shq.}$ = ⊕

Pra:

(an-anta) $_{sanskr.}$ = **(an anta)** = **(– â ndà)** $_{shq.}$ = – ⊕ = **in** (–) *fini* (⊕)
= *non limite* = *illimité* = *i pakufijtë*

Me qënë se – ⊕ = ○ = (*x* = – *x*) = **coincidentia oppositorum** = **Deus** = *éternité* (*përjetësi*); dhe me qënë se Shiva, Vishnu... janë nga perënditë kryesore të Panteonit hindian të lashtë, ata quhen edhe *të përjetshmit, të pavdekshmit* (fr. *éternel* (*an-anta*)).

°**kara** - a. *qui rend infini* (*që të bën të pafundëm*)

Është shqipja:

(– â ndà) kryej = – ⊕ **kryej**, *kryej* ○

an-apakārin - a. *qui ne fait tort à personne* (*që nuk i bën të keqe njeriu*)

an = **a** = *– 1*
apa = **(â pa)** $_{shq.}$ = *– 1* = –
kārin = **kryen** $_{shq.}$

Nga Algoritmi Simbolik kemi:

– 1 = ***F*** = ● = *e keqe*

Pra, atëhere:

(an-apakarin) $_{\text{sanskr.}}$ = – (– **kryen**) = – (**kryen** -1) = – (**kryen** ●)
= *nuk* (–) *kryen* ● = *nuk kryen të keqe* = *nuk bën të keqe*

an-ādi - a. *qui n'a pas de commencement* (*që s'ka nisje, që s'ka fillim*)

an = **a** = -1 = –
ādi = **(â dà)** $_{\text{shq.}}$ = ⦶

Por Algoritmi Simbolik jep:

⦶ = ***F*** = -1 = *fillimi, nisja*

Rikujtojmë me këtë rast sa vijon:

a) Paracelsus: *Die Separatio ist aller Geburt Anfang* (*Ndarja është fillimi i çdo lindjeje, i çdo bërjeje*).

b) Në shqip **ndër-toj** lidhet me rrënjën (operatorin e lirë) **ndar**, e pra simb. ⦶.

c) Në fillosofinë e Hegelit ⦶ do të përfaqësonte shprehjen simbolike të **ndarjes** (*Separatio*) të Frymës Subjektive nga Fryma Objektive brënda Frymës Absolute (◯). Kjo është Antiteza, momenti i **dytë** (*2*) i Triadës Hegeliane, simbolikisht pra -1^{*}. Me Antitezën (*Luftën e të kundërtave*) fillon Bota materiale, lind materia si *Alienacion* (*tjetërsim*) *i Frymës Absolute*. Materia dhe Bota materiale mund të paraqiten simbolikisht si ●. Dhe Algoritmi Simbolik jep:

⦶	=	⧖	=	-1	=	●	=	...(**F**)
ndarja e dy frymërave (Separatio)		*lufta e të kundërtave, e dy frymërave*		*nisja*		*e botës materiale*		

* Meqënëse në algoritmin simbolik, në mathematikën mistike dhe në gjuhë jepet barazimi:
$2 = -1$

ç) Sipas fesë së krishterë Bota materiale nisi me mëkatin origjinal (në origjinë, në zanafillë të krijimit të Botës). Ky mëkat qëndron në ndarjen nga Zoti, në mohimin e Tij. Pra:

Mëkati origjinal = ● = ⊕ = *ndarja* (/) *nga Zoti* (○)

Mirëpo Algoritmi Simbolik na jep:

● = **Mëkati**, *materia; Bota materiale* = ⊕ = *ndarja; ndarja nga Zoti; ndarja e dy frymërave* = –○ = *mohimi; mohimi i Zotit; mohimi i Frymës; mohimi i të Tërës; mohimi i përsosjes... mohimi i Qëndrës... deçentrimi, dalja nga Qëndra, ekzistenca* (nga latinishtja *exit* = *me dalë, dalje...*) = ***–1*** = *nisja, fillimi; antiteza; lindja e lëndës, e Botës lëndore,* ● = ***2*** = ***...F***

d) Në rusisht (siç e kemi parë edhe tjetër herë) **delits** (*делить*) = *me ndá*, e pra simb. ⊕ dhe në të njëjtën kohë **delats** (*делать*) = *me bë, me ndërtue*, simb. ●, etj.

e) Në shqipen e lashtë (shih Fjalorin e Kristoforidhit) **bdaj** që zbërthehet në *bë* **daj**, e pra simb. ⊕, do të thotë *bëj*.

f) Sipas miteve kozmogonike, Bota është krijuar nga sakrifikimi i një Qënie Hyjnore, nga **ndarja** e trupit e tij për **ndër**-*timin* e pjesëve të ndryshme të Gjithësisë.

Të gjitha këto shëmbuj, të cilëve mund t'u shtoheshin edhe shumë e shumë të tjerë, rikonfermojnë saktësinë e zbërthimit të gllosës sanskrite **ādi** ashtu siç e bëmë më sipër dhe sjelljen e saj tek shqipja **â dà** dhe përfundimisht tek simboli ⊕. Shtojmë edhe se, me qënë se Gjuha emërton sipas të Parës (ngjarjes më të rëndësishme siç është krijimi i Botës) fjala *fillim* këtu do të kuptohet si *fillimi i Botës*.

Vëmë rè gjithashtu se ajo që ne quajmë *fillim, nisje*, fr. *commencement* nuk mund të tregohet me ***1*** me qënë se Algoritmi na jep:

$$\bigcirc = 1$$

dhe pra atëhere:

$$-\bigcirc = \oplus = \bullet = \textit{fillimi i Botës Materiale} = -1 = 2 \quad \ldots(\mathbf{F})$$

Kështu pra *fillimi* duhet të tregohet simbolikisht me -1 (e pra si i tillë vështrohet si një negativitet, si një e **keqe.** Fillimi i Botës, krijimi i saj, sipas fillosofisë së lashtë hindiane nuk është tjetër veçse një mashtrim, një iluzion i Majës) me qënë se $-1 = \bullet = e\ keqe$, ose me 2, gjersa, siç pamë: $-1 = 2 = \ldots$ etj. etj.

an-āmiṣa - a. *désintéressé; sans viande* (*i çinteresuar; pa mish*)

an = **a** $= -1 = -$
ā = **â** $_{\text{shq.}}$ (= *asht*)
miṣa = **mes**; *mish*

Analizojmë fjalën frënge *désintéressé*. Ajo zbërthehet në:

des inter esse

ku:

des = **dysh** $_{\text{shq.}}$ = **2** $= -1 = -$
inter = **(â ndar)** $_{\text{shq.}} = \oplus = \bullet =$ *materie, substancë, mushje...*

E pra atëhere, duke marrë parasysh se **esse** është latinishtja *me qënë*, tërë fjala frëngjisht jepet simbolikisht si:

$-\bullet$ = **pa substancë**, *pa mish*, *bosh* e pra edhe *pa interes*, diçka për të cilën *s'ke përse interesohesh* (sepse *s'ka ndonjë përfitim material*, etj. etj.)

Kuptimi tjetër: *sans viande* del nga shqipja:

$$-mish = pa\ mish$$

Vëmë rè se sanskritishtja nuk është në gjëndje të shpjegojë këto dy kuptime kaq të largëta të fjalës *an-āmiṣa*, kurse shqipja po, sepse kemi:

mish = **mush** (fr. *remplir*) = – ○ (*jo bosh*) = ● *substancë, materie, përfitim material* = *interes*...

an-asthan - a. *dépourvu d'os* (*që s'ka kocka, pa eshtëna*)

an = **a** = – *1* = –

Pra me shqipen: – *eshtën* = – *asht* = *pa ashtna*.

an-asūri - a. et m. *non dépourvu de sagesse, sage* (*jo pa urtësi, i urtë*)

an = **a** = – *1* = –
a = – *1* = –
sūri = **syri** shq. (fr. *oeil*)

Lexojmë tek Cirlot (fq. 99) lidhur me simbolizmin e *syrit*:

"**Eye**: The essence of the question involved here is contained in the saying of Plotinus that the eye could not be able to see the sun if, in a manner, it were not itself a sun. Given that the sun is the source of light and that light is symbolic of the intelligence and of the spirit, then the process of seeing represents a spiritual act and symbolizes understanding. Hence the "divine eye" of the Egyptians - a determinative sign in their hieroglyphics called "wadza" - denotes: "He who feeds the sacred fire or the intelligence of Man" - ***Osiris*** in fact.

(**Syri**: Thelbi i çështjes për të cilën bëhet fjalë këtu qëndron në të thënën e Plotinit sipas të cilit, syri nuk do të ishte i aftë ta shikonte diellin sikur të mos qe, në një farë mënyre, edhe ai vetë një diell. Me qënë se dielli është burimi i dritës dhe se drita simbolizon inteligjencën dhe frymën, procesi i të parit paraqet një akt spiritual dhe simbolizon të kuptuarit. Prandaj pra dhe "syri hyjnor" i Egjiptianëve - një shenjë përcaktuese në hieroglifet e tyre e quajtur

"Vadza" - do të thotë: "Ai që ushqen zjarrin e shënjtë apo inteligjencën e Njeriut, me fjalë të tjera ***Osiris***.)

Rikonfermohet kështu saktësia e ekuacionit:

$$(\textbf{sūri})_{\text{sanskr.}} = (\textbf{syri})_{\text{shq.}}$$

Nga ana tjetër në sanskritisht:

sūrya - m. *soleil, dieu du Soleil* (*dielli, perëndia e diellit*)

Kjo rikonfermon akoma dhe më mirë ekuacionin e mësipërm si edhe motivimin e fjalës sanskritisht që po shqyrtojmë e cila mund të motivohet brënda sanskritishtes me fjalën **sūrya** = *diell* si simbol i *dritës* e pra i *ditës*, e pra i *ditunisë* ose me anë të shqipes **syri** = fr. *oeil*.

Nga sa më sipër del, ndër të tjera, se latinishtja **scio** (që nga *scientia* = *shkenca*) = *di, njoh*... lidhet si me zanafillën e saj me shqipen **shoh** = fr. *voir*, ashtu sikundër edhe greqishtja **sofia**, lidhet po në atë mënyrë me shqipen **shof** (fr. *voir*).

an-asūya - a. *non envieux* (*jo ziliqar, jo smirxhì*...)

an = **a** = – *1* = –
a = **â** $_{\text{shq.}}$ (= *asht*)
sūya = **sy** $_{\text{shq.}}$, *syni, syri* ...

Pra atëhere kemi:

$$(\textbf{an-asūya})_{\text{sanskr.}} = (-\ \textbf{a sūya})_{\text{sanskr.}} = -\ (\textbf{â sy})_{\text{shq.}} = \textit{pa sy} = \textit{që s'ka sy}\ (\textit{të lig})$$

Vërë rè se edhe fr. *en-vier* = *me pas zilí* lidhet brënda frëngjishtes me foljen *voir* = *me pa*, *me shikue* që organikisht lidhet përsëri me **syrin**.

Ashtu dhe rusishtja **zavidjets** (*завидеть*) = *me pas zilì* lidhet brënda rusishtes me **videts** (*видеть*) = *me pa*.

Kështu edhe në një sërë gjuhësh të tjera. Kjo rikonfermon akoma dhe më

mirë saktësinë e motivimit tonë të mësipërm të fjalës sanskritisht në shqyrtim.

an-avekṣā - f. *absence d'égards* (*mungesë kujdesi, mungesë respekti...*)

an = **a** = – *1* = –
ave = **â bë** $_{shq.}$ (= *â bâ*)
k = **ka** $_{shq.}$
ṣā = **sy** $_{shq.}$

Pra kemi:

(an-vekṣā) $_{sanskr.}$ = **(an a ve k ṣā)** $_{sanskr.}$ = (– **â bâ ka sy)** $_{shq.}$ =
Që nuk shtie sytë, që nuk sheh, që nuk kujdeset, që nuk respekton...

Vëmë rè se fr. *égard* lidhet edhe ajo brënda frëngjishtes me foljen *garder* = *shoh, shtie sytë*, etj. etj. si edhe *regarder* etj. etj.

an-avekṣaka - *a.ifc. qui n'a pas égard à...(që nuk sheh për, që nuk çan kokën për, që nuk kujdeset për, që nuk ka respekt, etj.)*

(Shih **an-avekṣā**)

an-avekṣaṇa - nt. *insouciance* (*moskokëçarje, indiferencë, etj.*)

Duke vepruar si në rastin e **an-avekṣā**, arrijmë në:

– **(â ba ka synë)** $_{shq.}$ = *që nuk ka sy për...,*
që nuk sheh, nuk kujdeset për asgjë...

an-avastha - a. *qui n'a pas de base ferme, inquiet, etc.*
(*që nuk ka një bazë të qëndrueshme, i shqetësuar...*)

an = **a** = – *1* = –
ava = **â bâ** $_{shq.}$
stha = **shti** $_{shq.}$ (folja *shtij, shtin* etj.)

Pra:

(an-avasthana) $_{\text{sanskr.}}$ = **(– â bâ shtin)** $_{\text{shq.}}$ = *që nuk ashtë shti = qi nuk asht* ***ngul****, e pra që nuk* ***ngel****, që nuk qëndron, që lëviz, që nuk është i qetë...*

an-avasthāna - nt. *impermanence, incertitude* (*paqëndrueshmëri, pasiguri...*)

Duke vepruar si në rastin e **an-avastha** gjejmë përfundimisht:

(– â bâ shtin) $_{\text{shq.}}$ = *qi nuk ka... shtimje, që nuk ka themel, që është i paqëndrueshëm,* etj.

an-abhra - a. *sans nuages* (*pa ré*)

Do zbërthyer si:

an a bh ra

dhe me shqipen:

– â bâ rè

do me thënë:

që nuk ka ré...

an-abhyāsa - m. *fait de ne pas s'occuper de...; paresse* (*mos marrje me..., mos zënie me...; përtacì*)

Do zbërthyer:

an abhy ā sa

dhe me shqipen:

– â bâ â zâ (*zan*)

do me thënë që *nuk asht* **zanê** (me ndonjë punë), *që nuk merret me asgjë, përtac...*

a-nidāna - a. *sans fondement* (*pa themel*)

Do zbërthyer si:

a ni dāna

a këtu rri për **â**, *asht*... Pra me shqipen:

â nuk dān

dhe simbolikisht: – ⊕. *

Algoritmi Simbolik jep:

$$\oplus = \bullet = \boxdot = \Bowtie = \wr = \varsigma = -1 = \ldots\ldots\textbf{(F)}$$

Simbolet që figurojnë këtu mund të interpretohen si:

⊕ = *ndarje*; *individ*; *send me vehte*... *kufi*
● = *lëndë*, *Bota lëndore*...
⊡ = *Hyrja* e parimit hyjnor brënda duke formuar kështu bazën mbi të cilën ngrihet, sipas mendimit mitik, *tërë bota materiale* (*Deus Immanens: Zoti i* **hymun**, **Hyu**, *ai që* **hyu**...)
⋈ = *thurrja*, *lidhje e dy parimeve* (*mashkullor dhe femëror, pozitiv dhe negativ, Hieros Gamos*)
♀ = *poshtë*, **ramje** (e Frymës)
-1 = *fillimi* (i Botës), *Antiteza*...
≀ = *kundërvënia e dy parimeve*, *lufta e të kundërtave*

Ne kemi parë (shih *Hyrjen*) se krijimi i Botës materiale lidhet me kalimin nga kodi ***E*** në kodin ***F***. **Çdo figurë në këtë kod, mund të merret, siç dimë, si një mit kozmogonik.**

Po që na intereson këtu është fakti se pa *ndarje* nuk do të kishim as *ndër-tim*

---

* Mund të jepet edhe një motivim tjetër i kësaj fjale sanskritishte duke e vështruar atë si **– danë**, me fjalë të tjera duke marrë **a** = -1 dhe duke patur parasysh se në sanskritisht krahas rrënjës **dana** në kuptimin e ndarjes kemi dhe **nidana** gjithë po në atë kuptim.

të botës, pa *thymje* nuk do të kishim as *themelim* të saj.

Vëmë rè shkarazi këtu se në latinisht **condire** = *themeloj, ndërtoj* (kujtojmë: "*ab urbe condita*" = *që nga themelimi i qytetit* - dhe është fjala këtu për Romën).

Kjo fjalë, duke u mbështetur në sa pamë këtu, duhet zbërthyer si:

con dire

ku **dire** është shqipja **darë** (fr. *séparer, diviser...*). Ashtu dhe tek **con dita** është fjala për shqipen **dāt**, pjesore e lashtë e foljes **daj**.

Vëmë rè së fundi se në shqip, **themel** zbërthehet si:

them **el**

dhe më tej

Ylli (i) **thym**

Dhe me qënë se: **Ylli** = **Qëndra*** = ○, atëhere:

Ylli i thym = ⏀

Pra dhe shqipja pozon:

themel = ⏀

a-nibandhana - a. *sans. motif, sans données précises*
(*pa shkak, pa arsye; pa të dhëna të sakta...*)

Do zbërthyer si:

a ni ban dhana

ku: **a** - është shqipja **â** (= *asht*)
ni - është në sanskritisht një parashtesë mohuese, e pra simb. "–"
ban - është shqipja *ban* (fr. *faire*)
dhana - është shqipja **dān** (*i dam*, nga folja **daj**, **dan**, etj.) e pra simb. ⏀.

---

* The "flaming star" is a symbol of the mystic Centre (Cirlot, fq. 310) (Ylli flakërues është një simbol i Qëndrës mistike)

Pra kemi përfundimisht me shqipen:

â nuk ban dān

e pra simb. $-\textcircled{D}$.

Po Algoritmi Simbolik jep:

$$\textcircled{D} = \leftrightarrow \qquad \text{...(F)}$$

ku $\leftrightarrow$ simbolizon, siç dimë, *kauzalitetin* e pra dhe *motivin*, *shkakun*, etj. Duke shumëzuar të dy anët e ekuacionit të mësipërm me -1 kemi:

$$-\textcircled{D} = -\leftrightarrow \qquad \text{...(E)}$$

ku:

$-\textcircled{D}$ = **a-nibandhana** $_{\text{sanskr.}}$ = **â nuk ban dan** $_{\text{shq.}}$ = ...

$-\leftrightarrow$ = *sans motif* $_{\text{fr.}}$ (*pa shkak, pa arsye...*)

Rikujtojmë me këtë rast sa vijon:

Në shqip ***ndaj*** do të thotë në të njëjtën kohë fr. *séparer*, e pra simb. $\textcircled{D}$ dhe *prandaj*, *për këtë shkak, për këtë arsye...*, e pra simb. $\leftrightarrow$. Pra mund të shkruajmë:

$$\underset{\textbf{ndaj}_{\text{shq.}}}{\textcircled{D}} = \underset{\textbf{ndaj}_{\text{shq.}}}{\leftrightarrow} \qquad \text{...(F)}$$

Duke shumëzuar të dy anët e këtij ekuacioni me -1 gjejmë:

$$\underset{\substack{\textit{nuk daj}_{\text{shq.}} \\ \textbf{nuk dan}_{\text{shq.}} \\ \textit{ni ban dhana}_{\text{sanskr.}}}}{-\textcircled{D}} = \underset{\substack{\textit{sans motif}_{\text{fr.}} \\ \textit{(pa shkak)}}}{-\leftrightarrow}$$

Pra si në shqip ashtu dhe në sanskritisht *operatori i ndarjes dhe ai i shkakësisë janë ekuivalentë.* E njëjta gjë mund të thuhet, siç kemi parë, edhe për shumë gjuhë të tjera. Kështu për shëmbull në italisht:

metà (*gjysma*, ½) = ⦶
motivo (*shkak, arsye*) = ↔

Në italisht përsëri:

quindi = *indi* = *pas, pastaj, pas asaj*... e pra simb. *2*
quindi = *ndaj, prandaj, për këtë arsye*... e pra simb. ↔

Po Algoritmi na jep:

$$2 = F = ⦶ = (\text{â } \textbf{ndá})_{\text{shq.}} = \textbf{indi}_{\text{it.}}$$

Pra mund të themi se italishtja me ndihmën e shqipes (**indi** = **â ndá**) pozon edhe ajo ekuacionin (⦶ = ↔).

Kuptimi tjetër i kësaj fjalë lidhet me shqipen të *dhënat*, të *dhanat* ... (sanskr. *dhana*).

a-nipāna - nt. *fait de pas boire, soif* (*të mos pirët, etje*)

Do zbërthyer si:

a ni pāna

dhe është shqipja:

â (*asht*) **nuk pin**

KHYĀ - khyāti... - pass. *être nommé, s'appeler, être connu, dite, annoncer, déclarer* (*me u quejt, quhem, njihem, them, lajmëroj, deklaroj* ...)

Është shqipja ***quaj*** si edhe *shquaj*...

khaṇḍa - m.nt. *fissure, brèche, brisure, lacune; partie, fragment, morceau, portion, section, chapitre, division; nombre, multitude...*
(e çarë, e thyer, seksion, boshllëk; pjesë, fragment, copë, kapitull, ndarje; numër, shumësi...)


Do zbërthyer si:

kha ṇḍa

dhe me shqipen:

ka ndâ (*ka ndarë...*)

pra simb. ⦶. Të gjitha kuptimet e fjalës *khaṇḍa* s'janë veçse interpretime të ndryshme të këtij simboli:



Vërë rè se **Kha** (shqipja *ka*) në kuptimin e foljes *kam* nuk është rrënjë e pastër në sanskritisht (operator i lirë).

Vërë rè gjithashtu, lidhur me sa më sipër (ekuacioni: ⦶ = ✗), se në shqip kemi *dasì* (⦶), *disà* (✗, *më shumë se një, pluralitet, shumësi...*)

---

* Sepse ○ = *infinit* ∞, dhe *zero;* dhe *infiniti dhe zero*, siç na mëson mathematika nuk mund të vështrohen si "numra".
Nga ana tjetër ⦶ = – ○ = *jo zero, jo infinit,* pra një sasi e caktuar, një numër.

Në anglisht:

to *sever* (*ndaj*) = ⊕
several (*disà*) = ✗

khaṇḍana - ag. *cassant, réduisant en morceaux, détruisant;* nt. *fait de couper, de mettre en morceaux...* (*shqip: që thyen, që bën copa copa, që shkatërron...; premje, copëtim...*)

Është shqipja:

ka ndà (n)

(shih **khaṇḍa**)

a-dāna - a. *qui ne donne pas...*: nt. *fait de ne pas donner* (*që nuk jep;* nt. *mos-dhanje*)

a këtu është privative, pra "–".
Atëhere, me shqipen:

– dhan

do me thënë *që nuk jep* etj. etj.

Vëmë rè se në shqip (si gjer dikù edhe në sanskritisht) kemi:

dān (fr. *séparer, couper*, etc.), dhe:
dhān (fr. *donner*)

Ato përshkruajnë të njëjtin simbol (⊕).

Dhe është e qartë përse, sepse akti i **dhënies** presupozon atë të **ndarjes** (*heqja, ndarja nga vetja*).

Duke qënë kështu fjala italisht *dare = me dhanë* lidhet si me zanafillën e saj me shqipen *darë* (folja **daj**); dhe fjala italisht *donare* lidhet prapë me shqipen **dhan** e **n-dan** që e shpie (kjo e fundit) fjalën italisht tek simboli që ajo përshkruan, do me thënë ⊕.

Po në atë mënyrë frëngjishtja *donner* lidhet me shqipen *damun*, po për atë

arsye (referimi tek simboli ⏀ që kjo fjalë përshkruan).

tulya - a. *égal, équivalent, homogène, identique, similaire, de la même espèce, de la même catégorie, comparable, pareil à...*
(i barabartë, i barazvlefshëm, homogjen, identik, i ngjashëm, i të njëjtës kategori, i të njëjtit lloj, i krahasueshëm me ..., i tillë si ...)

Është shqipja *i tillë*, it. *tale*, fr. *tel*... etj.

apa-HI - *se délivrer de* (*shlirohem nga ...*)

Është shqipja *â pa hí* (folja me **hy**).
Pra simbolikisht:

$$- \boxed{\circ}$$

Por Algoritmi Simbolik jep:

$$- \boxed{\circ} = -F = \mathbf{E} = -\aleph$$ = *zgjidhem, çlirohem* (fr. *se délivrer de*...)

a-pariccheda - m. *absence de discrimination* (*mungesë diskriminimi*)

Do zbërthyer si:


a pari c che da

këtu: **a** - "–"
pari - sh. *bëri*
c - është shqipja *qi, që*...
che - është shqipja *ke, ka*... (folja *kam*)
da - është shqipja *da* (folja *daj* ...)

Tërë fjala sanskritisht "e reduktuar" tek shqipja jep:

– bëri qi ka da

pra shkurtimisht: *nuk bën damje* (*dallime*) e pra simbolikisht:



Fjala fr. *discrimination* (lat. *discriminatio*) sillet tek shqipja që edhe e motivon atë në këtë mënyrë:

dis	**kre**-*jt* *jamun*
dysh (*2*)	**kre**-*jt*
–1 (–)	○

E pra përfundimisht: –○ = ⊕.

Rrënja e pastër (operator i lirë) e shqipes **kre**-jt shpjegon (shpie tek simboli përkatës) edhe fjalën tjetër fr. **discret** (lat. *discretus*) në kuptimin *i moderuar, i ndërprerë* (në fizikë termi *diskret* përdoret për të treguar një *madhësi jo të vazhdueshme*).

Dhe në fakt:

(discret) $_{\text{fr.}}$ = **(dis cret)** $_{\text{fr.}}$ = **(dysh krejt)** $_{\text{shq.}}$ = *2 krejt* = *–1 krejt* = *–krejt* = –○ = ⊕

Me qënë se simboli ○ është jo vetëm ai i të **tanë**-*s* (*tërës*) por edhe ai i *kon*-**tin**-*uitetit* (*vazhdueshmërisë, pa ndërprerje*...), fjala fr. *continue* = *i vijueshëm, i pandërprerë,* duke u zbërthyer si:

con *tin* ue

ku: **con** = + = *+1* (nyje bashkuese, pohuese) e pra si e tillë këtu mund të mos përfillet (si në Algjebër...), na lejon të shkruajmë më tej:

+ tin-ue = –⊕ = ○

Që nga dhe:

(tin-) $_{fr.}$ = ○ = **(tan)** $_{shq.}$

Ky është një rast nga të shumtët e *inkapsullimeve* të rrënjëve të pastra (operatorë të lirë) të shqipes në gjuhët që lidhen me latinishten.

ati-vira - m. *grand héros* (*hero i madh*)

ati- është në sanskritisht një parashtesë me kuptimin kryesisht të një cilësie të shpënë në shkallë sipërore, tej çdo kufiri, gjë që i jep kësaj parashtesë shpesh edhe një kuptim *negativiteti*.*

Ka shumë mundësi që të jetë shqipja:

â tej - (shqip edhe *për-tej* = *bër tej*...)
vira - është shqipja *burr*

Pra tërë fjala sanskritisht ka kuptimin me shqipen:

tej burr

ati-vistīrṇa - a.v. *trop étendu* (*tepër i shtrirë*...)

Është shqipja: *â tej ba shtrin.*

ati-vistara - m. *extrème détail, grande extension*
(*hollësi e madhe, shtrirje e madhe*...)

Është shqipja: *â tej bâ shtrí.*

ati-vibinna - a.v. *entierèment percé* (*i përshkuar tej përtej*...)

-binna është shqipja *ban nda*. Tek **nn** duhet parë një asimilim regresiv i **nd**. Prandaj pra tërë fjala është me shqipen:

---

* Le të kujtojmë fjalën e urtë greke: *Pan metron ariston* (*Çdo gjë e mirë brënda masës* (*kufirit*)).

â tej bâ bâ ndà
bâ ndà


që simbolikisht mund të shprehet si ⊕. Por Algoritmi Simbolik jep:

⊕ = ***F*** = ⊡ *çpim* (fr. *percé*)

Nga ana tjetër në shqip:

â tej = **përtej** = *tej për tej*

E pra atëhere paraqitja simbolike e fjalës sanskritisht duke qënë paraqitja simbolike e *tej për tej çpim* mund të jepet me simbolin:

tej (*përtej*)  *çpim*

ati-VAC - *blâmer; parler en termes exagéré de qq'un (qortoj, flas në mënyrë të tepruar për dikë...)*

Është shqipja: *â tej vikat.*

ati-virya - a. *très puissant ou courageux* (*shumë i fuqishëm* ose *trim*)

Është shqipja: *â tej burrë.*

ati-sakhi - m. *grand ami* (*shumë mik, shumë shok...*)*

Është shqipja: *â tej shok.*

---

* Siç shihet shqipja **shok** lidhet me sanskritishten **sakhi** dhe nuk vjen aspak nga latinishtja **socius** (siç e nxjerr E. Çabej në "Studime Gjuhësore").

Shtojmë këtu se **sa u tha për fjalën *shok* , vlen edhe për një numër shumë të madh gllosash të shqipes të cilat gabimisht apo qëllimisht janë nxjerrë me prejardhje latine, apo sllave, apo greke, apo ...**, ndërsa siç shihet në këtë studim ato lidhen drejt për së drejti me trungun e përbashkët të të gjitha gjuhërave indoevropiane, d.m.th. me sanskritishten.

aty-asita - a. *très noir* (*shumë i zi*)

Është shqipja: *â tej zì*.

Kujtojmë në shqip *të* **zi**-*të* = *e zeza,* që afrohet më shumë me formën sanskrite **sita**.

aty-ādara - m. *respect excessif* (*respekt i tepruar*)

Është shqipja:

â tej â nder

e pra:

â (*asht*) **tej nder**

Vëmë rè këtu se njeriu i *nderuar* është ai që siç thuhet në shqip *ha bukë veç*..., ai që *veçohet* (për merita të veçanta nga të tjerët) e pra që *ndahet* nga të tjerët, që është i *ndarë* nga të tjerët. Kështu që fjala *nder* (në sanskritisht *dara*) lidhet me konceptin e *darjes* (*ndarjes*), në të dy gjuhët.

aty-ardha - a. *plus de la moitiè* (*më tepër se gjysma*)

ar është shqipja *ar* (angl. *gold*).

Lexojmë tani tek Cirlot diçka mbi simbolizmën e *arit:*

> "**Gold**: in Hindu doctrine, gold is the "mineral *light*". According to Guénon, the Latin word for gold - "*aurum*" - is the same as the Hebrew for light "*aor*". Jung quotes the delightful explanation offered by the alchemist Michael Maier in "De Circulo Physico Quadrato" to the effect that the sun, by virtue of millions of journeys round the earth (or conversely) has spun threads of gold all round it. Gold is the image of *solar light* and hence of the *divine intelligence*. If the heart is the image of the sun in man, in the earth it is gold. Consequently, gold is symbolic of all that is superior, the glorified or "fourth state" ...
>
> ...Gold is also the essential element in the symbolism of the hidden or elusive treasure which is an illustration of the fruits of the *spirit* and of supreme

illumination (fq. 119 -20).

(**Ari**: Sipas doktrinës Hindu, ari përfaqëson "*dritën* minerale". Sipas Guénonit, fjala latine që tregon arin - "*aurum*" - lidhet me hebraishten "*aor*" që do të thotë *dritë*. Jungu citon një shpjegim të këndshëm të dhënë nga alkimisti Michael Maier në "De Circulo Physico Quadrato" sipas të cilit dielli, duke u vërtitur me miliona herë rreth tokës (ose anasjelltas) ka endur fije ari (kumash) rreth saj. Ari simbolizon *dritën diellore* dhe, rrjedhimisht, *mençurinë hyjnore.* Ndërsa tek njeriu rolin i diellit e lot, në një farë mënyre, zemra, këtë rol në tokë e lot ari. Për këtë arsye, ari simbolizon gjithçka është e epërme, "gjëndjen e katërt" të lavdishme pas të tre gjëndjeve të para...

Ari përbën gjithashtu një element thelbësor në simbolizmin e Thesarit të Fshehur që vjen si një ilustrim i begatisë që sjell me vete *Fryma* dhe *Ndriçimi* i epërm.)

Duke qënë kështu mund të shkruajmë:

$$\textbf{Ar} = \textit{Drita} = \textbf{Qëndra} = (x = -x) = \bigcirc$$

Nga ana tjetër **-dha** është shqipja **dà** (folja *daj*).
Pra atëhere tërë fjala *ardha* do të thotë **ar dà**:

$$\textit{ar i damun} = \bigcirc \textit{i damun} = \textcircled{\scriptsize I} = \tfrac{1}{2}$$

aty është shqipja *â tej*.
Pra tërë fjala sanskritisht "reduktohet" në shqip si:

â tej ar da

e pra simbolikisht:

> ⊕

e pra edhe:

> ½

Ku > rri për *më i madh* si në mathematikë.

ati-lubdha - a.v. *très avide;* **-ā** - f. *extrême cupidité* (*shumë llupës, makut; makutëri shumë e madhe*)

Është shqipja: *â tej llups.*

ati-lobha - m. *cupidité;* **-tā** - f. *id.* (*llupje, makutëri*)

Është shqipja: *llupje.*

aty-anta - a. *constant, ininterrompu; qui passe les bornes, violent, extrême; entier;* **-am** *de façon ininterrompue, pour toujours; très, tout à fait.* (*i pandryshueshëm, i pandërprerë; që kalon kufijtë, i dhunshëm, ekstrem; i tërë;* **-am** *në mënyrë të pandërprerë, për gjithmonë; tepër, krejt, fare*)

$$(\textbf{anta})_{\text{sanskr.}} = (\textbf{â ndà})_{\text{shq.}} = \textcircled{1}$$

$$(\textbf{ati})_{\text{sanskr.}} = \textbf{â tej}$$

Pamë se parashtesa **ati** kishte përveç kuptimit të *tepërisë* edhe atë të *negativitetit.* Dhe kjo s'është një gjë e rastit dhe konvencionale po shprehëse e një koncepti të thellë fillosofik. Në shqip kjo e vërtetë jepet me fjalën e urtë *e tepërta prish...*, në greqishte, siç pamë, me *Pan metron ariston.*

Shkenca, e veçanërisht ajo moderne, rikonfermon saktësinë e kësaj të vërtete a më saktë të këtij parimi të cilin ne mund ta shprehim simbolikisht kështu:

$$x \ggg = -x$$ *

---

* Ky parim është në themel, në fiziollogji, të mekanizmit të "feedback"-ut.

Le të shohim tani dy zbatime të tij, njërin në fizikën moderne dhe tjetrin në kozmollogjinë moderne.

Pozojmë në formulën (inekuacionin) e mësipërm:

$$x = \textcircled{1}$$

Duhet të kemi atëhere:

$$\textcircled{1} \ggg = -\textcircled{1} = \bigcirc$$

Le ta interpretojmë simbolin $\textcircled{1}$ si *ndarje.*

Kthehemi tani tek **aty-anta**. Mund të shkruajmë me shqipen:

â tej â ndà

e pra edhe, duke u mbështetur në sa më sipër:

– â nda

e pra simb. $-\oplus$, ose edhe për ekuivalencë simbolike: $\circledcirc$.

Simbolet e fundit shpjegojnë kuptimin: *i pandërprerë* ($-\oplus$) (fr. *ininterrompu*), *që kalon kufijtë* ($\circledcirc$) (fr. *qui passe les bornes*).

Le të shpjegojmë tani kuptimin **i pandryshueshëm** (fr. *constant*).

Sipas Algoritmit Simbolik kemi:

Dihet që sa më thellë futemi në materie, në nivelin atomik e subatomik *grimcat* (thërrmija elementare...) bëhen gjithnjë e më të vogla, me fjalë të tjera copëtimi i materies bëhet gjithnjë më i madh, arrin në një shkallë gjithnjë e më të imtë. Kjo vijon e arrihet gjer në një nivel kaq të thellë subatomik ku nuk mund të flitet më për "objekte fizikë" (grimca etj.) të ndara nga njëra tjetra. Kjo është zona ku ndërhyn *Parimi i Pandashmërisë* (angl. *Inseparability Principle*).

Vëmë në dukje me këtë rast, siç kemi bërë herë-herë edhe në ndonjë rast tjetër, këtë fakt tepër të rëndësishëm: *Parimet e formulat që ne gjejmë nga analiza e Gjuhës (me atë metodollogji të veçantë me të cilën ne e kryejmë atë), gjejnë zbatim edhe në sfera të tjera të Realitetit dhe të Dijes Njerëzore*. Kjo shpie në:

hipotezën e ekzistencës të një bërthame parimore të përbashkët për të gjitha fushat e Dijes.

Sot flitet shumë për këtë.

Le të pozojmë tani:

$$x = ♀$$

Ku simboli ♀ mund të interpretohet si "gravitet". Duhet të kemi në bazë të formulës së mësipërme:

$$♀ \ggg = -♀$$

Dhe vërtetë, në Kozmollogjinë moderne tregohet se si rritja e tepruar e masës gravitacionale të trupave qiellore (të disa prej tyre) shpie në atë që quhet *kolapsi i gravitetit*, me lindjen e një *vrime të zezë* (*black hole*).

Algoritmi Simbolik (strukturizim llogjik i Mendimit Mistik!) na lejon ta shpjegojmë edhe këtë, d.m.th. lindjen, pas kolapsit të gravitetit, të vrimës së zezë.

Me qënë se sipas Algoritmit Simbolik ♀ = ●, mund të shkruajmë edhe:

$$♀ \ggg = ● \ggg = -● = \textit{jo më materie} = ○ = \textit{vrimë, boshllëk...}$$

$$\text{ⵔ} \quad = \quad \sim \qquad \ldots \textbf{(F)}$$

ndar-je *ndr-y-shim*

Rikujtojmë me këtë rast se fakti i rëndësishëm që **ndryshimi** lidhet me një **ndarje** jepet bukur në shqip, siç e kemi parë dhe herë tjetër, në tjetër kontekst*, me çiftin thuajse-homonimik *ndarje-ndryshim*. Në italisht ai jepet me **metá** (*gjysëm*) dhe **moto** (*lëvizje*). Pra italishtja pozon kështu:

$$\text{ⵔ} \quad = \quad \sim \qquad \ldots \textbf{(F)}$$

metà *moto*

E njëjta gjë përsëritet drejt a tërthor edhe në një sërë gjuhësh, kryesisht të lashta.

Le ta shpjegojmë tani më "teorikisht" përse ndodh kështu, përse me fjalë të tjera, ndryshimi në gjuhë është lidhur me *ndarjen*.

Gjuha, siç dimë, referon gjithmonë tek ngjarja e **parë** arketipale, paradigmatike**. Kjo ngjarje është, siç dimë, Krijimi i Botës që realizohet (kur në një trajtë, kur në një tjetër...) me një kalim nga kodi ***E*** në kodin ***F***. *Pra ai lidhet me një ndryshim* (∼) *të kodit*.

Nga ana tjetër dimë se ***E*** = ○, ***F*** = ⵔ. Pra "ky ndryshim" (∼) qëndron në një **ndarje** (kalimi nga ○ në ⵔ).

Pra, mund të shkruajmë:

$$\text{ⵔ} \quad = \quad \sim \qquad \ldots \textbf{(F)}$$

ndarje *ndryshim*

Duke shumëzuar të dy anët e ekuacionit të mësipërm me – ***1*** do të kemi:

---

* Në një studim si ky **përsëritjet janë të pashmangshme**. Dhe kjo për arsye se çështjet dhe problemet që trajtohen në të si edhe zhvillimet dhe zgjidhjet e tyre paraqesin një ndërthurrje "natyrore", e pra, siç kuptohet lehtë, një përsëritje të së njëjtës. **Porse kjo përsëritje** (*që është e pashmangshme dhe që bëhet* ***me dije*** *e jo për harresë*) **kryhet gjithmonë në kontekste të ndryshme gjë që edhe e justifikon atë.**

** Shih *Hyrjen*.

$-\textcircled{1}$ = $-\sim$ ... **(E)**

– **â ndà** *i pandryshueshëm*

– *ndarje* (fr. *constant*)

Le të shpjegojmë tani kuptimin *i tërë* (fr. entier).

Pamë se:

aty-anta = ... – **â ndà** = $-\textcircled{1} = \bigcirc$ = e **tana**, e **tëra**...

(një nga interpretimet e shumta të këtij simboli...)

Le të shpjegojmë tani kuptimin *ekstrem*.

Dimë se:

$\bigcirc = (x = -x)$ = **Qëndra**

dhe "vlerat" që e kënaqin ekuacionin e *qëndrës* janë dy:

zero (0)

dhe:

infiniti (∞)

Do me thënë *pambarimisht e vogla* (**0**) dhe *pambarimisht e madhja* (∞), dhe këto janë *dy ekstreme* (*ekstremume*) absolute, superlative...

Le të shpjegojmë tani kuptimin *për gjithmonë* (fr. *pour toujours*).

Pamë se:

aty-anta = ... $-\textcircled{1} = \bigcirc$

Por:

$\bigcirc = (x = -x)$ = **Qëndra** = **Zoti** = *përjetësia*...

aty-artha - a. *excessif;* **-am** *violemment, très, à l'excès*

(*i tepruar; në mënyrë të dhunshme, të fuqishme, shumë, me tepri*)

(artha) $_{\text{sanskr.}}$ = **(ar thy)** $_{\text{shq.}}$ = $\textcircled{1}$

Dhe kemi me shqipen, duke patur parasysh se:

$$(\textbf{aty})_{\text{sanskr.}} = -1 = (\textbf{â tej})_{\text{shq.}}$$

$$-(\textbf{ar thy}) = -\oplus = \oplus = \textit{përtej kufirit, masës, me tepri...}$$

(Shih në këtë pikë edhe **aty-anta**)

tamas - nt. *obscurité, ténèbres ...; enfer, région infernale; éclipse; obscurité mentale, ignorance, erreur* (*errësirë...; ferr, vëndi i ferrit; eklips; errësim mendor, padije, gabim...*)

Do zbërthyer si:

tam as

Ku **-as** është folja *asta* e sanskritishtes në kuptimin: *është*. Nga ana tjetër **tam-** do zbërthyer me shqipen si *dam* (folja *daj*).

Kemi atëhere:

$$(\textbf{tamas})_{\text{sanskr.}} = (\textit{ash-t}\ \textbf{dam})_{\text{shq.}} = \oplus = \bullet = \textit{terr, errësirë... padije}\ \text{etj.}$$

Këtu lidhet edhe rusishtja **temnó** (*темно*) = *errësirë*; **tma** (*тьма*) = *errësirë*, si edhe latinishtja **tene-bra** (me shqipen: *bërë dān*).

Këtu lidhet gjithashtu edhe anglishtja **dim** (shq. *dām*) = *terr, errësirë...*

nir-doşa - *exempt de défauts ou de fautes, innocent, impeccable* (*pa gabime a të meta, i pafajshëm, pa mëkat, i përsosur*)

Ku: **nir** = **niş** = **nih** = ... = -1 = "–"

Është shqipja: *nuk dysh*, e pra simbolikisht:

$$-2$$

Po Algoritmi jep:

–2 = –⦶ (*pa të meta*) = –● (*pa mëkat, i pafajshëm*) = ○ (*i përsosur*)

nir-daya - a. *dénué de pitié, implacable, rude, violent, cruel...*
(*i pamëshirshëm, mizor, i vrazhdë, i përdhunshëm, shpirtkazëm...*)

Është shqipja:

nuk dua (folja *me dashtë ... dua, duaj,* etj.)

nir-ṇij - *laver, enlever par le lavage...* (*laj, heq me larjen...*)

Është shqipja:

nuk nyj (*nuk ndoht*)

Në shqip do të jepej edhe me **çnyj**.

nir-āmiṣa - a. *décharné; qui n'obtient pas de butin ou de récompense; dénué de désirs charnels*
(*pa mish; që nuk merr plaçkë a shpërblim; pa dëshira mishërore*)

Është shqipja:

nuk â mish

nir ṇikti - f. *lavage, fig. expiation* (*larje, fig. shlyerje faji...*)

Është shqipja:

nuk â ny̓ gatis (*katis, godit*)

nir-dhana - a. *dépossédé, pauvre* (*i çpronësuar, i varfër...*)

Është shqipja:

nuk dhana (që është *pa të dhëna* e pra *i varfër...*)

nir-dravya - a. *immatériel; dépourvu de richesse, pauvre*
(jo i lëndshëm, jo material; pa pasuri, i varfër...)

Ku **dravya** do zbërthyer si:

dra vya

ku theksi semantik bie tek **dra** (**-vya** është një prapashtesë që mund të jipet me shqipen *baj*). Nga ana tjetër kemi:

$$(\mathbf{dra})_{\text{sanskr.}} = (\mathbf{dar})_{\text{shq.}}$$

Po sipas Algoritmit Simbolik kemi:

$(\mathbf{dar})_{\text{shq.}} = \oplus = \bullet =$ *materie, sende materiale, të "*mira*" materiale...*

Pra, tërë fjala sanskritisht jepet me simbolin:

$-\bullet =$ *(pa materie, jo materiale, jo të mira materiale...)*

që ajo edhe përshkruan në mënyrë të vetëdijshme apo të pavetëdijshme...

nir-ghāta - m. *destruction; tempête, orage, ouragan, bourrasque, coup de tonnerre, tremblement de terre*
(shkatërrim; stuhí, shtërgatë, tallaz, rrufe, tërmet...)

Është shqipja:

nuk gatue

(nuk gatit, nuk godet... nuk ndërton, nuk bën...).

Mund të jepej në shqip me *çgatitje.*

Kuptimet e tjera, të *shtërgatës*, të tallazit, të tërmetit etj. etj. shpjegohen me faktin se gjuha denominon (emërton) siç dimë, në mënyrë superlative (shih *Hyrjen*), dhe pra shkatërrimi *par excellence* do të që shkatërrimi, *Fundi i Botës* i

cili në të gjitha mitet e lashta si edhe në Ungjill paraqitet i shoqëruar me të tilla fenomene të jashtëzakonshme dhe të llahtarshme.

Parashtesa **shtër-** (si edhe **ster-**) në shqip tregon tepërí dhe, si e tillë, ajo duhet të ketë treguar dikur edhe *negativitet*, dhe kjo sepse siç kemi parë:

$$x \ggg = -x$$

Duke qënë kështu fjala shqip *shtër-gata* ka të njëjtën strukturë të fjalës homologe në sanskritisht me qënë se: *shter* = *nir* = -1 = $-$.

nir-apatrapa - a. *sans honte, sans pudeur, sans embarras, impudique, non timide* (*pa turp, që nuk ndruhet, që s'ka frikë, i paturpshëm...*)

Është shqipja:

nuk â bâ turp

nir-hrīka - a. *qui n'es pas timide, impertinent, audacieux* (*që s'ka frikë, që s'është i ndrojtur, i guximshëm...*)

Është shqipja:

nuk frikë

pari-nir-ṇij - *nettoyer, laver complètement* (*pastroj, laj krejtësisht*)

Është shqipja:

m-barë nuk nyj

e pra: *laj* (*nuk nyj* = $-$*nyj*) *m-barë* (*krejt*).

Vëmë rè këtu se **pari** është shqipja *parë*, (i, e) *pari* e pra simbolikisht ***1***.

Po Algoritmi Simbolikisht jep:

$$\underset{parë}{1} = \underset{m\text{-}barë}{\bigcirc} \qquad \ldots \textbf{(E)}$$

Diferencimi mes *parë* dhe *m-barë* në shqip është bërë në një moment të dytë për të shmangur keqkuptime. Në sanskritisht ky diferencim nuk është bërë.

pari-PĀ - *boire avant ou après; absorber; soustraire* (*pi para ose pas; thëthij, zbres, heq*)

°**pīta** - *bu; soustrait* (*pirë; i zbritur*)

a) Është shqipja:

parë pi (*pi para*)

Në sanskritisht fjala *pari* (*para*) ka, sipas rregullës ($x = -x$) (*Gjuha pozon Qëndrën*) dy kuptime të kundërta, ***para*** e ***prapa***. (fr. *boire avant ou après*).

b) Është shqipja:

bërë pi (fr. *absorber*)

c) Është shqipja:

bërë pijtë (fr. *bu*)

d) Është shqipja:

bërë pa (fr. *soustraire - me zbritë*, veprimi aritmetik i zbritjes, –)

pari-PĀ - *protéger de tous les côtés, défendre; observer, maintenir* (*mbroj nga të gjitha anët, mbroj; vë ré, vëzhgoj, mbaj...*)

Është shqipja:

a) **m-barë pá** (fr. *proteger de tous les côtés...*)

b) **bërë pá** (fr. *observer*, etj.)

pari-pāka - m. *maturité, perfection* (*pjekje, përsosje*)

Është shqipja:

bëri pjek

paktṛ - ag. *qui cuit* (*që pjek*)

Është shqipja:

pjek-tor

niṛ-pa - m. *protecteur d'hommes, roi, prince*
(*mbrojtës njerëzish, mbret, princ...*)

Është shqipja:

nir pa

ku **nir** është formë e lashtë për *njerí*, dhe **pa** ka kuptimin këtu: që *sheh*, që *kujdeset*, që *ruan*.

niṣ-phala - a. *sans fruit, stérile* (*pa fryte, shterp*)

Është shqipja:

nuk pjell

niṣ-tula - a. *qui n'a pas son égal* (*që s'e ka shokun, që s'e ka të barabartin...*)

Këtu shqipja:

nuk (i,e) **tillë**

pari-dhāraṇa - nt. *fait de supporter, d'endurer; patience, tolérance*
(*të duruarit; durim, tolerancë*)

Është shqipja:

bërë duron, si edhe *durim* etj.

pātra - nt. *vase pour boire, coupe, gobelet* (*vazo për të pirë, gotë...*)

Është shqipja:

potiri

pātr - ag. *buveur, buveur de...* (*që pi, pirës...*)

Është shqipja:

pij-tor

Mā-mimīte ... **māti**... - *mesurer, délimiter en mesurant; comparer (en mesurant) avec; répondre aux mesures, suffire à... mesurer; ériger* (*mat, vu kufijtë* (*duke matur*); *krahasoj me; i përgjigjem matjeve, mjaftoj për...; mat, ngre, ndërtoj*)

Është shqipja *mas, mat* si edhe shqipja:

mja-*ft* (fr. *suffire*)

Simboli që përshkruan kjo fjalë është ⊕.

Mirëpo ne dimë se ky është edhe simboli i **ndar**jes që nga në shqip **ndër**tim (në rusisht **delits** = *ndaj* dhe **delats** = *bëj*). Dimë nga ana tjetër se *ndërtimi* (*ndërtimi arketipal; ndërtimi, krijimi i Botës*) presupozon një *ndarje*. Kjo shpjegon përse rrënja **mā**, **māti**... ka dhe kuptimin e *ndërtimit*, të *ngritjes* (të një ndërtese).

mā - particule nég. *ne...pas...; que... ne ... pas, pourvu que... ne... pas; pour que... ne... pas; ... "non!"* (pjesëz mohuese *të mos..., që të mos ... mjaft që të mos... ; "mos!"*)

Është shqipja: **mos**, si edhe **mo**!..., si dhe **mà** (në të folmen e veriut).

maṃsa - nt. *viande, chair* (*mish*)

Zbërthehet në **ma ṃsa**, dhe është shqipja *me mish* (*prej mishi, e mishtë*, etj. etj.).

māṃsavikrayin ose **māṃsavikretṛ** - m. *boucher* (*kasap*)

Duhet zbërthyer si:

mā ṃsa vi kra yi

dhe

mā ṃsa vi kre tṛ

ku: **yin** - është një prapashtesë vepruesi (agjenti)

tṛ - është një prapashtesë vepruesi (agjenti) si në shqip *-tor, -tar*...etj.

vi - është një parashtesë foljore që tregon ndër të tjera mohim. Ajo nuk është tjetër veçse gërma e *dytë* e alfabetit (gr. *beta*, hebr. *Beth*, e kështu me radhë) që për faktin se është *e dyta* ka dhe kuptimin e numrit *dy* (kështu edhe në greqisht, në hebraisht etj. etj.).

Por Algoritmi Simbolik na jep:

$$2 = -1$$

Prandaj pra dhe:

$$\textbf{vi} = 2 = -1 = -$$

Por me qënë se, gjithmonë sipas Algoritmit Simbolik:

$$-1 = F = \textcircled{\scriptsize |} = \textit{ndarje, prerje}\ldots$$

Atëhere **vi** ka edhe kuptimin e *prerjes*, të *ndarjes* (⏀).

Atëhere tërë kuptimi i fjalës është:

ai (**tṛ**) *që kryen* (**kra**, **kre**...) *prerjen* (**vi**) *e mishit* (**māṃsa**) = **mishprestori**

māṃsabhūta - a. *qui constitue ou comporte de la viande* (*që përbën a ka mish*)

bhūta është shqipja *bāt, bët...* (pjesore e lashtë e foljes *baj, bëj...*) *bëjt-ur*...etj. etj.

Pra tërë fjala mund të jepet si:

me mish bëjtur (*që është bërë me mish...*)

mita (MĀ) - a.v. *mesuré, limité* (*par...*) *modéré, court* (*i matun, i kufizuar* (*nga...*) *i moderuar, i shkurtër*)

Është shqipja: **i māt**, *i matun...* (nga folja *me mat*).

Pra, mund të shkruajmë:

(mita) $_{\text{sanskr.}}$ = **(māt)** $_{\text{shq.}}$ = ⊕ = *i kufizuem, i shkurtuar, i shkurtë, i "matur"* (*i moderuar*)...

mitabhāṣitṛ - ag. *qui parle peu* (*që flet pak*)

mitabhāṣin - ag. *qui parle peu* (*që flet pak*)

Do zbërthyer si:

mita bhā ṣi tṛ

Dhe me shqipen do të qe:

bëzator i mat-*un*

ku **ṣi** është shqipja **zâ** (*zëri*, it. *voce*) një rrënjë e pastër dhe e thjeshtë në shqip (operator i lirë) por jo në sanskritisht; ose dhe:

bëzan-*ës* **i mat**-*un*

mitabhukta ose **mitabhuj** - a. *qui mange peu* (*që ha pak*)

Me shqipen:

met - (*mat, matun...*) **bë ha gatis**

ose:

met - (*mat, matun*) **bë haj**

ku **met** rri këtu për *jo i plotë* e pra simb. ⓘ. Dhe kuptimi i fjalës është:

që është i metë në të ngrënë..., që ha i matur... etj. etj.

mitāhāra - a. *qui mange peut;* m. *alimentation réduite, diète*
(*që ha pak, ushqim i reduktuar, dietë*)

-hāra lidhet me shqipen *ha, haj*... dhe më thellë akoma me shqipen *hyr*.

Në sanskritisht **bhuj** (fr. *manger*) do të thotë kështu me shqipen *bë haj* por edhe *bë hyj* (*fus mbrënda*). Koncepti *i ngrënies* është lidhur kështu me atë të *hyrjes* (në gojë, në stomak).

Kështu dhe anglishtja *food, to feed, fed*... (*ushqim, me ushqye, i ushqyer*, etj.) mund të lidhet ndoshta me shqipen *fut, fus*; në anglisht: *to fit* = *që futet, që hyn, që përshtatet;* ... Në shqip thuhet edhe *cfus* (= *ha*).

Që **bhu**-*kta*, **bhuj** duhet të ndahet në **b hu** (*bë hy*), siç bëmë ne më sipër, këtë na e rikonfermon fjala sanskritishte *mitā hāra* ku **hara** është shqipja *hyr* siç thamë dhe ka të njëjtën kuptim në sanskritishte si (*b*)-**hu**, **huj**.

Ndaj pra dhe:

a) trajta më e thjeshtë është si në shqip **haj** (dhe jo *bhuj*, *bhu* si në sanskritisht).

b) sanskritishtja *hu*, *huj*, *hara* lidhen të gjitha si me motivuesin e tyre me shqipen *hyj*, *hyr* (fr. *entrer*).

c) vëmë rè se edhe fjala shqip *buka* shpi tek **b** (h)**u ka** do me thënë *ka bë* **hy** dhe lidhet kështu me sanskritishten *bhukta*.

Këto të gjitha ishin disa kompozita në sanskritisht me fjalën *mita*.
Fjala që po shqyrtojmë do të jepej me shqipen ***Hamës i matur***.

MITH-mithitvā - *s'accoupler* (*me u çiftëzue* në të gjitha kuptimet...)

Është prapë fjala sanskrite *mita* (MĀ) që përshkruante, siç pamë, simb. ⌀. Edhe kjo sepse Algoritmi Simbolik jep:

⌀	=	***F***	=	⚯
i matun, i kufizuar				*i lidhur, i çiftëzuar*
mita				**mith**

Në sanskritisht këto dy fjalë të bashkërrënjëshme vështrohen dhe shqyrtohen veçmas. Kjo bëhet ose sepse hartuesit e fjalorit sanskrit (të diturit e lashtë hindianë) nuk dinin lidhjen simbolike mes tyre (që, me fjalë të tjera, përshkruanin dy simbole ekuivalente), ose sepse ata, ndonëse e dinin këtë, prapë i kanë veçuar këto dy fjalë për qëllime të shmangies të keqkuptimit... Kjo që thamë këtu vlen edhe për shumë raste të tjera, siç do të shohim më tej.

Përsërisim me këtë rast atë që kemi thënë edhe diku gjetkë si një rregull të përgjithshme:

> **Dy fjalë me kuptime të ndryshme, në çfardo gjuhë qofshin, nëse janë homonime a thuajse homonime (të ngjashme) dhe nëse përshkruajnë të njëjtin simbol apo simbole ekuivalente, ka shumë mundësi të jenë të bashkërrënjëshme.**

Vëmë rè se në shqip kemi **me** në kuptimin ⚯ që lidhet me sanskritishten **MĀ**, për sa i përket formës, dhe me **MITH** për sa i përket kuptimit.

Vërejmë se në gjermanisht kemi: **mit** = ⚯, në greqisht **metà** = fr. *avec* (shqip *me*) dhe **pas** (fr. *après*) e pra simbolikisht ***2***.

Po Alg.Simb. jep:

⚯	=	***2***	...(**F**)
metá $_{gr.}$		**metá** $_{gr.}$	
(*me* $_{shq.}$		*pas* $_{shq.}$)	

Dhe kështu shpjegohet bisemia e fjalës *metá* në greqisht.

vi-manyu - a. *sans colère, sans ressentiment* (*pa inat, pa urrejtje...*)

Kemi: **vi** = *2* = *–1* = –

dhe nga ana tjetër: **manyu** = **mëní** $_{shq.}$ Pra kuptimi i tërë fjalës sanskritishte që shqyrtojmë është: *–mëni* = **pa mëni**...

vi-manas - a. *perplexe, découragé, désolé*
(*i pavendosur, i dekurajuar, i dëshpëruar*)

Dimë se **vi** = *2*. Dhe pra atëhere *vi-manas* në kuptimin *i pavendosur* është shqipja:

me dy mëndje

Me qënë se **vi** = *2* = *F* = ● (*zi*) = ☧ = ... kuptimet e tjera dalin vetvetiu si *që mendon zi, që është i ngatërruar* (☧), *që është i pavendosur*... etj.

a-nipuṇa - a. *maladroit* (*jo i shkathët...*)

a = *–1*
ni = prostatike
puṇa = *puna* $_{shq.}$

Pra:

– **puna** (*që s'di të punoje*... etj. etj.)

an-ārata - a.v. *qui ne cesse pas;* **-am** - *sans cesse*
(*që nuk pran, që nuk pritet*... **-am** - *pa pushim, pa ndërprerje...*)

an = **a** = *–1*
ā = **â** (*asht*)
rata = *rāt* (folja shqip *me rà*)

pra simb. ♀. Dhe me qënë se:

rāt = ♀ = ***F*** = ⊕ = *prerje, ndërprerje...*

atëhere:

(– **â rāt**)$_{shq.}$ = –♀ = –⊕ = *pa prerje, pa ndërprerje, pa pushim...*

an-āhara - a. *qui ne se nourrit pas; fait de ne pas se nourrir, jeune* (*që nuk ushqehet; të mos ushqyerit, agjërim*)

an = **a** = ***–1***
ā = **â** (*asht*)
hara = **ha**$_{shq.}$ (fr. *manger*) si edhe shqipja *hyr* (fr. *entrer, s'introduire*)

Pra tërë fjala sanskritisht jep:

– â ha
– â hyrë

dhe simbolikisht:

– 

a-nimiṣ - m. *Dieu* (*Perëndia, Zoti*)

a = ***–1***
ni = *prostatike*
miṣ = *mish*

Pra tërë fjala sanskritishte do të thotë me shqipen:

– mish

Por dimë se: **mish** = ●

Pra:

– mish = –● = ○ = (***x*** = ***–x***) = *Qëndra, Zoti, Fryma*

Pra Zoti përcaktohet, përfytyrohet si *jo prej mishi*, e pra si *Frymë e kulluar*. Kjo është në përputhje të plotë me ato sa lexojmë në Ungjill:

"Zoti është Frymë dhe si Frymë duhet ta adhurojmë"

a-nirbhinna - a.v. *ininterrompu; indifférencié; non blessé*
(*i pandërprerë, i padiferencuar, i pa plagosur*)

a = **â** (*asht*)
nir = **ni** = **nuk**
bhinna = **ba ndà**

Vërejmë se *bhinna* është një trajtë e kontraktuar e *bhinda* ose *bhanda* (asimilim regresiv) siç rezulton nga analiza e leksikut të sanskritishtes, pra simbolikisht do të kemi:

$$-\textbf{ba nda} = -\textcircled{D}$$

dhe me qënë se $\textcircled{D}$ = *i ndërprerë*, do të jetë $-\textcircled{D}$ = *i pandërprerë.*

Nga ana tjetër, me qënë se:

$$-\textcircled{D} = \boldsymbol{E} = (x = -x) = -(x \neq -x) = \textit{jo diferencim}$$

Dhe me qënë se $\textcircled{D}$ = **dam** $_{\text{shq.}}$ *damje, ndarje*, por edhe *dam* (fr. *dommage*), atëhere pra:

$$-\textcircled{D} = \textit{i padëmtuem, i paplagosun}$$

a-nirvedita - a.v. *non manifesté; non déprimé, hardi*
(*jo i shfaqur; jo i depresuar, i guximshëm*)

$$\begin{cases} \textbf{a} = \textbf{â} \\ \textbf{nir} = \textbf{nuk} \\ \textbf{vedita} = \textit{ve dita} = \begin{cases} \textit{ba } \textbf{ditë}_{\text{shq.}} \\ \textit{ba } \textbf{dâtë}_{\text{shq.}} \end{cases} \end{cases}$$

Atëhere pra:

– **bâ ditë**
– **bâ dātë**

Pra:

– **ditë** = **jo ditë** = *i paditur* e pra dhe *i pashfaqur* (fr. *non manifesté*)

si edhe:

– **dātë** = –⏀

Por dimë se:

⏀ = ***F*** = ● = *i mër-**zi**-tur, humor i zi* =
♀ = *i rënë shpirtërisht, i depresionuar*

Pra atëhere:

–⏀ = *jo i mërzitur, jo i depresonuar...*

Vërejtje:

Dimë se Bota materiale nisi, u manifestua me një *damje* (rikujtojmë të thënën e famshme të Paracelsus: *Die Separatio ist aller Geburt Anfang*...), e pra simbolikisht ⏀.

Duke qënë kështu, damje dhe shfaqje (manifestim) janë në instancë të fundit e njëjta gjë (përshkruajnë të njëjtin simbol e janë pra simbolikisht, pra edhe esencialisht, e njëjta gjë).

Prandaj dhe sanskritishtja përdor të njëjtën fjalë **vedita** në dy kuptimet, në atë të **di**-jes dhe në atë të **da**-m-jes.

a-nivedana - nt. *acte de ne pas faire connaître* (*të mosnjohurit, të mosditurit*)

Me shqipen:

â nuk bâ din (që *nuk din*...)

a-niçam - a. *ininterrompu; adv. sans trêve* (*pa ndërpremje; pa pushim*)

Me shqipen:

â nuk çām (që *nuk ūsht i* **çām**)

e pra simb. – ⊕, symbol ky që jep kuptimin e *pandërprerjes* etj. etj.

Vëmë rè se rrënja **ÇA** (shq. *çaj, çava, çamë...*) është shumë produktive në sanskritisht, sikundër nga ana tjetër edhe në shqip.

a-niççita - a.v. *indecis;* **-ta** - f. *incertitude* (*i pavendosur; i pasigurtë*)

Do zbërthyer si:

a niç cita

Dhe me shqipen:

â nuk çāt

çāt është pjesore e lashtë e foljes *çaj* në shqip (si *thātë, dhātë, pat, rat,* etj. etj.).

Pra simbolikisht fjala paraqitet si:

– ⊕

Mund të shkruajmë edhe:

– ⊕ = – ( )

Pra: *as* (–) *këndej* "(" *as* (–) *andej* ")", e pra *i pavendosur...* (fr. *in-décis*). Që këndej del edhe kuptimi *i pasigurisë, i dyshimit...*

Vëmë rè se për një njeri të vendosur, në shqip thuhet *është* **i prerë**. Edhe fjala frëngjisht *décis* do të thotë në kuptimin e saj të parë: *i prerë.*

a-nişna - a. *non initié, non formé* (*i pa iniciuar, i paformuar...*)

a = ***–1***

nişna = (i, e) **nisun** $_{shq.}$ (nga folja *me nis*)

Vërejmë se në shqip *njish* (trajta e lashtë: *nish*) = ***1***.

an-ișta - a. *désagréable; contraire au droit; interdit;* nt. *malheur, événement funeste* (*i pakëndshëm; kundër të drejtës, i ndaluar; fatkeqësi, ngjarje e kobshme*)

Është shqipja:

asht – *1*

Mirëpo dimë se:

$$-1 = F = \bullet = \varphi = \text{♌} = \ldots$$

që nga dalin të gjitha kuptimet e kësaj fjale sanskrite (si interpretime të figurave simbolike në ***F***).

anu-rathyā - f. *bordure de la rou* (*ana e rrotës*)

Është shqipja:

ana(s) **rrota** (*anës rrotës... ana e rrotës, e rrethit, e rrathit...*)

Vërejmë se trajta **rrath** ka qënë dikur trajta e *njënjësit*, kurse **rreth** ajo e *shumësit* (shumës i singularizuar).

anu-kathana - nt. *rapport* (*raport*)

Këtu:

anu = **anas** $_{\text{shq.}}$; pas $_{\text{shq.}}$
kathana = **ka thanë** $_{\text{shq.}}$ (folja *them*)

Pra atëhere tërë fjala *anu-kathana* është shqipja *anas ka thanë, **2** ka thanë, pas ka thanë, ka thanë* **pas** e pra **pasthënie** dhe ky është pikërisht edhe kuptimi *i raportit ...*

an-ārabhya - a.v. *qu'on ne peut commencer* (*që nuk mund të fillohet...*)

an = **a** = -1
ā = **â** (*asht*)
ra = **ra** (folja shqip *me rà*)
bhya = **baj** (folja *me bâ*)

Pra tërë fjala sanskritishte "përkthehet" me shqipen:

– â rà bâ

e pra:

– â bâ rà = – bâ rà = – ra = $-$♀

Po dimë se:

♀ = ***F*** = -1 = $-$○ = ⊕ = ● = ⊡ = ⚹ = ⚺ = ...

Po -1 është *fillimi*, pra atëhere edhe:

$-$♀ = $-(-1)$ = *jo fillimi, që nuk ka fillim*

Vërejtje:

1) ♀ mund të interpretohet si *rënia* e Engjujve rebelë me në krye Luciferin, ngjarje kjo që, sipas mitit biblik, u bë shkas për krijimin e Botës sonë materiale.

2) ● është ndër të tjera edhe simboli i *materies*, e pra dhe i *materializimit*, e pra dhe i krijimit të Botës sonë materiale.

Po ky simbol është edhe ai *i mëkatit* dhe rigjejmë kështu dogmën e mëkatit origjinal në themel të botës materiale, bash në fillimin, origjinën e saj.

3) ⊕ është ndër të tjera simboli *i ndarjes* dhe dihet (siç e kemi parë e thënë edhe gjetkë) se Bota materiale nisi me një ndarje (Paracelsus, Hegeli, etj.).

Meqenëse ○ mund të interpretohet edhe, ndër të tjera, si *Hyjnia*, $-$○ do të jetë atëhere *mohimi i Hyjnisë*, ajo që mendimi mitik e quan *Sakrifica Kozmogonike* që bëri të mundur, me fjalë të tjera, *lindjen e lëndës* dhe *të Botës lëndore*. Sipas Algoritmit Simbolik:

$$-\bigcirc = \text{⏀}$$

Simboli i fundit mund të vështrohet si "modifikimi" i energjisë primordiale (që jepet nga simboli ○).*

Pra:

$-\bigcirc$ = *Sacrifice,*
⏀ = *mutilation; modification of primordial energy;*
Ϟ = *struggle*
...

Me fjalë të tjera:

Çdo figurë simbolike në kodin *F* mund të interpretohet si shprehëse e njërit prej miteve të ndryshme Kozmogonike të cilët janë të gjithë ekuivalentë mes tyre

Kështu për shembull: ⊡ do të ishte simboli i *Deus Immanens* a e thënë ndryshe me shqipen, e *hymjes së Hyut* që dha mundësinë e krijimit të Botës siç Alg.Simb. e tregon qartë:

⊡ = -1 = ● ...(F)
hymja e Hyut *fillimi* *i Botës materiale*

---

* Lexojmë me këtë rast tek Cirlot:

"The basis of most cosmogonies is the "cosmic sacrifice", expressing the idea that creation of forms and matter can take place only by modifying primordial energy. Such a modification, so far as most primitive and protohistoric peoples are concerned, was seen to exist in such painful forms as mutilation, struggle or sacrifice..."

(Themeli mbi të cilin ngrihet pjesa më e madhe e kozmogonive është "sakrifica kozmogonike" që shpreh idenë se krijimi i formave dhe i materies mund të bëhej vetëm me një modifikim të energjisë primordiale. Një modifikim i tillë përfytyrohej nga popujt më primitivë dhe prehistorikë në trajta të tilla të dhimbshme si gjymtyrim, luftë dhe sakrificë...)

♂ është ndër të tjera edhe simboli i *thurrjes*, e pra dhe *i thurrjes së Botës*. Ai është në të njëjtën kohë edhe simboli i *hieros gamos* (*martesës së shënjtë*), bashkimit të parimit mashkullor (*qiellor*, **3**) dhe parimit femëror (*tokësor*, **2**) që përbën edhe ky, krahas simboleve të tjera në ***F***, një mit kozmogonik.

♌ është ndër të tjera edhe simboli i *luftës, i ndeshjes, i konfliktit*, dhe dimë, sipas një miti kozmogonik* se Bota ka filluar me një luftë.

an-ārambha - a. *qui n'entreprend rien;* m. *fait de ne pas entreprendre*
(*që nuk fillon, që nuk ndërmerr asgjë; të mos ndërmarrit asgjë...*)

an = **a** = -1
ā = **â** (*asht*)
ram = **ram** (folja *me rá*)
bha = **bâ** (folja *me bâ*)

Pra me shqipen:

(– â rām bâ) = – **(â bâ rām)** = **(– rām)** = –♀

Dhe pasi arritëm këtu mund të përsërisim ato sa thamë për fjalën **an-ārabhya**.

Vërejtje:

♀, një tjerër figurë simbolike e kodit ***F***, mund të vështrohet si shprehëse e një miti Kozmogonik**.

---

* Hindu tradition links (the creation of the world) with the **struggle** of the gods with a tribe of devils called Asuras, or with monsters of some other kind. (Cirlot, fq. 65)

** Tek Cirlot (xxvii) lexojmë:
"Plato in "Timaeus" and Plotinus in the "Enneads" elaborate the idea that the soul is a stranger on earth, that it has *descended* from the spaceless and timeless universe, or that it has *fallen*, on account of sin, into matter, that it initiates a process of life-giving growth corresponding to the period of involution".

Që krijimi i Botës lidhet me një *rën-ie* (♀), ky ka qënë edhe mendimi i pjesës më të madhe të popujve të lashtë e të stërlashtë.

Duke qënë kështu, me qënë se: ○ = *Frymë, shpirt, jo mish, jo materie* (– ●), simboli ♀ është krejt i përshtatshëm për të treguar *rënien e shpirtit, të Frymës;* nga ana tjetër kjo *rënie e Frymës* u bë shkas i *lindjes së Botës materiale* (♀ = ●), dhe filloi kështu një periudhë involucioni, prandaj pra dhe simboli – ***1*** me të cilin ne kemi treguar *fillimin* (*e Botës*), është fare i përshtatshëm.

Vëmë rè me këtë rast se në shqip:

{ **filloj** = – ***1***
{ **fal**, *falit, falitem*... (*bie*) = ♀

Kështu pra shqipja lidh *fillimin* e Botës me një *falje, falitje*... në përputhje të plotë me sa lexuam tek Cirlot.

Në gjermanisht **Anfang** = *fillimi,* e pra simb. – ***1***.

Përsëri në gjermanisht **fangen** = *kap, robëroj*... (**Gefangene** = *i kapur rob, i burgosur*...), e pra simb. ⊡.

Kështu pra gjermanishtja pozon:

– ***1***	=	⊡	... **(F)**
anfangen		**fangen**	

Po ashtu edhe latinishtja, ku:

{ **capere** = *me kap*, e pra: ⊡
{ in-**cipere** = *filloj*, e pra: – ***1***

(Platoni tek "Timeo" si dhe Plotini tek "Enneadet" thonë se *shpirti* është i huaj mbi tokë, se ai ka *zbritur* nga një univers jashtë hapësirës dhe kohës, a, ndryshe, se ai *ka rënë* për shkak të *mëkatit* në materie, me të cilën nis një proces rritjeje jetëdhënës që i përgjigjet një periudhe involucioni).

Po ashtu edhe shqipja:

zâ = *filloj*, e pra: – *1*
zâ = *kap, burgos, e pra:* ⊡

Ne vëmë rè kështu se mitet e ndryshme kozmogonike janë pasqyruar në një mënyrë a në një tjetër edhe në Gjuhë.

Në tekstin e porsacituar nga Cirlot, ne lexuam ndër të tjera se *Fryma* (*shpirti*) bie në materie për shkak të mëkatit...

Mund të shkruajmë:

● → *mëkat*
→ *e keqe*
→ *i zi, e zezë*
→ *materie, botë materiale, mish*

○ = *Fryma*

● = ♀ = *rënia e Frymës*
⊡ = *rënia e Frymës* brënda në materie
⚹ = *kapja, zënia* (*e Frymës*)
– *1* = *fillimi, zënia e Botës*
...

Në shqip:

za (**zan, zanje**) = *fillim* = – *1*
za (*zan, zanje*) = *kapje* = ⚹
za (*zan, zanje*) = *burgosje, robërim* = ⊡
za (*zanje, zimje*) = *grindje, rrahje* = ⚸ (angl. *struggle*)
zi (*me u zi...*) = ⚸
zi (*e zezë...*) = ●

Pra shqipja pozon kështu me poliseminë sinjifikative të operatorit të saj të lirë (rrënjë e pastër, e thjeshtë): **Z** (a, i, ë,...) serinë e ekuivalencave simbolike në ***F***, çdo njëra prej të cilave mund të vështrohet si shprehje simbolike e një miti kozmogonik:

-1	∞	Ω	$\boxdot$	●
za	*zâ*	*zâ*	*zâ*	*zi*
zë	*zanë*			
	zunë	*me u zanë*	*zanje*	
	zënë	*me u zi*	*zënie*	

Me qënë se: ● = *mëkat*, kemi:

-1	=	●
zâ		**zi**

Shqipja **za**, **zi**... vërteton me mjetë gjuhësore saktësinë e mitit sipas të cilit *Bota filloi me një mëkat* (*Dogma e Mëkatit Origjinal*; *arsyeja e rënies së Frymës*, e pra dhe e *krijimit të materies*...).

Me qënë se Algoritmi Simbolik jep:

$$-1 = 2 \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

ne shohim se *krijimi i Botës* s'është *momenti* i parë, por i dytë. Ai lidhet në fillosofinë e Hegelit me *Antitezën* si moment i dytë i Triadës Hegeliane, dhe jo pra me Tezën, momenti i parë, Fryma Absolute ende e *pa alienuar* (e *pa jetërsuar*). Me qënë se:

$$2 = \Omega = \ldots \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

Dhe me qënë se Ω mund të vështrohet edhe si *lufta e të kundërtave* ne shohim se:

Lufta e të kundërtave është momenti i dytë dhe jo i pari, siç e paraqet dialektika marksiste.

Me qënë se:

lufta e të kundërtave = ♀♂ = *2* = *–1* =
F = ♀ = ● (*bota materiale*)

ne shohim se Bota materiale filloi me luftën e të kundërtave. Por ky pohim i dialektikës hegeliane është në pajtim të plotë me mitin kozmogonik të *luftës* siç pamë kur cituam lidhur me këtë çështje Cirlot, edhe sikundër lexojmë gjithë po tek Cirlot:

> "Traditat hindiane e lidhin krijimin e Botës me luftën e perëndive kundër një tribù djajsh të quajtur Asuras ose me përbindësha të ndonjë lloj tjetër."

Në shqip kemi *ra, re, ram, rāt, rash*, etj. etj. = ♀.
Por pamë se: ♀ = *–1* = *fillimi, kreu i Botës...*

Në hebraisht:

Rosh = *kokë, krye*
Resh-*ith* = *fillim*

E pra ka mundësi, duke u mbështetur nga sa u tha më sipër, që këto fjalë hebraisht të lidhen me shqipen *rash* (folja *me rà*)*.

Me qënë se fillimi duhet treguar me *–1* për arsyet që u shpjeguan edhe më sipër (ndër të tjera: *fillimi i Botës = involucion...*), dhe me qënë se nga ana tjetër *–1* është *mohimi dialektik* me të cilën krijohet nga e vjetra (mohimi i së vjetrës) e *ré-ja;* dhe me qënë se nga ana tjetër:

e re-ja = *–1* = ***F*** =
♀ = (**rá, ré, me ra, rash, ram**, ...)$_{\text{shq.}}$

---

* Në fund të këtij studimi jepen një numër i gjatë konkordancash mes Shqipes dhe Hebraishtes.

ne shohim se *i ri, e re-ja, rish-tas*... nga njëra anë, që lidhen simbolikisht me -1 dhe *rá, ré, me rá, rash, ram, rat,* ...etj. nga ana tjetër që lidhen me simbolin e *ramjes*, do me thënë ♀, janë pra në shqip e njëjta fjalë-simbol.

Shqipja na thotë atëhere se:

Fillimi i botës është diçka ***e ré*** *e si i tillë, është një mohim dialektik i së vjetrës*

Këtu është:

$$E\ vjetra \quad \bigcirc = E$$
$$E\ reja \quad -\bigcirc = -1 = F$$

Pra krijimi i Botës është kurdoherë (edhe sipas të gjitha miteve kozmogonike) një kalim nga kodi ***E*** në kodin ***F***.

E **reja** është, nga ana tjetër, ajo që **rà**, (-1 = ♀), por kemi sipas Alg.Simb.:

$$-1 = ♀ = \ldots F = ● = \textit{mëkat, e zezë, e keqe...}$$

Duke qënë kështu kuptojmë se fjala italisht **reo** = *fajtor* lidhet si me motivuesen e vet me shqipen *rā, ré,* ...(folja *me rà*...).

Në rusisht: **raz** = *një*, por *raz* në rusisht shërbën gjithashtu si një prefiks me vlerë negative, mohuese, do me thënë simbolikisht edhe: *raz* $= -1$. Për shëmbull:

razdevatsa = *me u çvesh*
razuçits = *me harrue* atë që ke mësue, *me çmësue*

Rusishtja *raz* është, në bazë të atyre që u thanë këtu, shqipja *rash* (*me rà*), hebraishtja *rosh*, etj.

Me qënë se: **rà, rè**... në shqip = ♀, por edhe -1 (e *re-ja, i riu, rish-tas*...) sikundër që e pamë, dhe me qënë se nga ana tjetër -1 është *momenti i dytë* (*Antiteza*) e me qënë se edhe sipas Alg.Simb.:

$$-1 = 2$$

atëhere pra shqipja **ra**, **re**, **ri**... etj. mund të japi, të shprehi potencialisht edhe këtë kuptim (d.m.th. atë të numrit ***2***).

Duke qënë kështu kuptojmë atëhere pse prefiksi latinisht **ri**, **re**, ...**ris**, **res**... që tregon *negativitet* (*– 1*) dhe në të njëjtën kohë *përsëritje* (*2*) si në latinisht si edhe në të gjitha gjuhët që vijnë prej saj, lidhet me shqipen **re**, **ri**, ... *rish-tas*... etj. Ato të gjitha kanë shfrytëzuar *in acto* këtë vetì, mundësi, *in potentia* të shqipes.

Dhe ndalemi këtu, duke vënë rè së fundi edhe sa më poshtë:

Frëngjishtja **entreprendre** (*ndërmarr, filloj*...) zbërthehet si:

entre (*ndër*) **prendre** (*marr*)

entre është sanskritishtja *antara* dhe shqipja *â ndarë* tek e cila reduktohet edhe vetë sanskritishtja *antara*. Kemi atëhere:

fillimi = *– 1* = ⦶ = **(â ndarë)** $_{shq.}$ **(antara)** $_{sanskr.}$ **(entre)** $_{fr.}$

Me qënë se *Die Separatio* (⦶) *ist aller Geburt Anfang* (*– 1*), mund ta ndërpritnim vargun e ekuivalencave motivuese të fjalës frëngjishte *entre* tek simboli ⦶ (= *â ndarë*).

Shqipja *ndërmarr* duhet zbërthyer natyrisht si:

marr ndar = *marr* ⦶ = *marr – 1* = *filloj, nis*...

an-ārūḍha - a.v. *non tombé dans* (*që s'ka rënë në, brënda*...)


an = *– 1*
ā = **â** (*asht*)
rū = **rã** (folja *me* rà) = ♀
ḍha = **ndë** (= *në*) = **nda** = ⦶ = ⊡

Pra simbolikisht tërë fjala jep:

– ♀ ⊡

jo ra ndë

ose edhe:



Mos harrojmë se në shqip kemi edhe:

anda, ande = *br-ënda* ⊡

an-ābādha - a. *non entravé* (*i pa penguem*)

an = a = –1

Zbërthimi bëhet si:

– ā bā dha

dhe me shqipen:

– â bâ dà = – Dà = –Ⓘ

Dimë se:

–Ⓘ = *E* = –ᘉ = –ᘓ = –● = ...

Pra *jo kundërshtim* (–ᘉ); *jo bllokim* (–●); *jo kapje, jo lidhje, jo pengesë,* frëngj. *non entravé* (–ᘓ) etj. etj.

Vërë rè se në shqip kemi *me badhër dikë...*, në kuptimin *pengoj, mërzis* (krahaso me angl. *bother* po me atë kuptim), etj. etj.

Vërë rè gjithashtu se vetë frëngjishtja *entraver* zbërthehet si:

entra ver

dhe me shqipen:

â ndarë â bër

e pra:

â bër â ndarë

a bër : ⊕

E pra edhe:

⊕ = ***F*** = ● = *bllokim* = -1 = *mohim* = ☊ = *kundërshtim* = ☌ = *lidhje, pengesë*, etj. etj.

mahāgiri - m. *grande montagne* (*mal i madh*)

Është shqipja:

Gur i madh

Vëmë rè me këtë rast se në rusisht **gorà** = *mal* dhe lidhet natyrisht me sanskritishten *giri* dhe shqipen *gur*.

Le të vëmë rè këtu edhe një gjë tjetër:

Trajta **maha** e sanskritishtes për **i,e madh**, është ruajtur në shqip në **mahem**. Por në shqip gjithashtu **mehem**. Kështu *mahem* e *mehem* formojnë në shqip një çift ekuivokal, një zbatim të rregullës madhore të Gjuhës, me të cilën ajo pozon Qëndrën: $x = -x$. Një gjë e tillë flet për "autoktoninë" e kësaj rrënje në shqip.

mahābhara - a. *très lourd* (*shumë i rëndë*)

Është shqipja:

e madhe barrë

mahāratha - m. *grand char* (*qerre e madhe*)

Është shqipja:

e madhe rrotë (*rreth, rrathë...*).

mahāvira - m. *grand héros* (*hero i madh*)

Është shqipja:

i madh burr

mahāhasa - a. *qui a de grands éclats de rire* (*që qesh me të madhe*)

Është shqipja:

e madhe qesh-je

mahāmedha - m. *grand sacrifice* (*flijim i madh*)

Fjala **medha** është shqipja *me* **DÀ** e pra simbolikisht:

Por kemi:

a) ⌀ = −○ = *mohimi; sakrifica;* sakrifica kozmogonike që bëri të mundur lindjen e Botës.

b) ⌀ = *Separatio* dhe rikujtojmë Paracelsus: *Die Separatio ist aller Geburt Anfang.*

c) *Flijimi* kryhej në kohërat e lashta me rastin e hedhjes së *themelit*. Por vetë fjala *them-el* lidhet brënda shqipes me foljen *thyej, i thym, ...* e pra me sim. ⌀. Ashtu dhe në gjuhë të tjera. Kështu për shëmbull në latinisht **condire** = *themeloj* dhe zbërthehet me shqipen:

ka ndarë

e pra simb. ⌀.

Ekuacioni simbolik:

⌀ = ● .... **(F)**

ndarje **ndyrje**

materie,

botë materiale

tregon qartë se lindja e materies, e botës materiale, presupozon një *ndarje* (dhe kjo *një mohim, një flijim*, me qënë se: ⊕ = – ○, dhe me qënë se: ○ = *Qëndra; Zoti; Hyjnia...*, është fjala këtu atëhere për një *flijim hyjnor* siç na mëson edhe mendimi mistik nëpërmjet tezës së *Great Cosmogonic Sacrifice*). Dhe kjo është një arsye tjetër për të parë tek sanskritishtja *medha* shqipen *me DÀ*.

mahāmoha - m. *grand égarement mental; qui égare l'esprit* (*dit d'un charme*)
(*çoroditje e madhe mendore; që prish mëndjen* (thuhet për magjinë)...)

Është shqipja:

mahnitje e madhe

Vëmë rè se në shqip kemi: edhe *mahì = jo e vërtetë; shaka.*
Ka shumë të ngjarë që *mahì* dhe *magjì* të lidhen me të njëjtën rrënjë.

mahāvela - a. *aux grands vagues* (*me valë, dallgë të mëdha...*)

Është shqipja:

e madhe valë

pari-GHAṬ - *caus. toucher, faire sonner* (*les cordes d'un instrument*),
(*prek, tingëlloj-telat e një vegle muzikore*)

Është shqipja:

për - kas, për - ket
n - gas, n - get

ku **pari** këtu rri për shqipen *bëri*.

pari-ghātin - a. *détruisant, transgressant* (*ordre*),
(*që shkatërron, që transgreson* (rendin)...)

Ku: **pari-** është përdorur në kuptimin – *1* (krahaso me greqisht *para-* si

p.sh. në fjalën *para-normal* = – *normal* etj. etj., si edhe me shqipen *por* (angl. *but*, fr. *mais*...) që tregon *kundërshti*, e pra – ***1***).

Le të shpjegojmë shkurtimisht përse *pari* në sanskritisht ka këtë kuptim *negativ*. Kjo për arsye se *i pari* i kësaj Botë është negativ, dhe kjo për shkak se bota materiale filloi me një mohim (Mohimi i parë dialektik, antiteza në fillosofinë hegeliane; Mohimi (*vrasja*) e Hyjnisë në mitin e Flijimit Kozmogonik).

Kuptimi tjetër i **pari** në sanskritisht është ai i *bër-jes*. Pra:

$$(\textbf{pari})_{\text{sanskr.}} \begin{cases} -1 \\ \textbf{bërje},\ \oplus,\ \bullet \ldots F \end{cases}$$

Algoritmi Simbolik na lejon të kuptojmë thellësinë e kësaj bisemije të rëndësishme:

$$pari = -1 = F = \oplus\ (= \text{ndar-}ja,\ \text{ndër-}timi) = \bullet\ (i\ Botës\ materiale) = \text{bër-}je\ldots$$

Prandaj pra në motivimin e gllosave sanskritisht prefiksi *pari* mund të merret si në njërin kuptim ashtu dhe në tjetrin, sipas rastit.

ghātin lidhet me shqipen:

gatuaj, gatis, godis...

Pra kemi atëhere:

$$(\textbf{pari-ghātin})_{\text{sanskr.}}\ (-\ gatuan)_{\text{shq.}} = (-\textbf{gatit})_{\text{shq.}} = prish,\ shkatërron$$

Kuptimi tjetër i kësaj fjalë, ai i *transgresionit* (fjalë për fjalë: *i kapërcimit, i shkeljes së kufirit, ligjit*, etj.) shpjegohet si vijon:

$$-\ gatit = shkatërrim = -\bullet = -F = -\oplus = jo\ kufi = \oplus\!\!\!\!+ = kapërcim\ i\ kufirit = -\aleph = jo\ ligj,\ shkelje\ e\ ligjit,\ \ldots$$

pari-galita - a. *tombé, enfoncé* (*i ram, i ngulun*)

Është shqipja:

bërë *n*-**gul**
bërë *n*-**gulit**

vi-tamas - a. *délivré des ténèbres, non abscurci, clair*
(*i çliruar nga terri, jo i errësuar, i qartë*)

Këtu:

vi = *2* = *–1* ...(**F**)



Vërë rè se në anglisht:

damn *-ed* = *i dënuar, i mallkuar, i* ***damun*** *nga Zoti,* ***demoniak***...

Dhe prapë në anglisht **dim** = *i errët, i ngrysur* etj. etj.
Pra me ndërmjetësinë e shqipes anglishtja shtron ekuacionin simbolik:

damned = **dim** ...(**F**)
damn (*i errët*)
(shq. *i dam, i damun*
... folja: **daj**)

E njëjta gjë edhe në gjermanisht ku:

verdammt = *i mallkuar, i damun prej Zotit*, etj.
Dämmerung = *muzg, errësirë*

Në rusisht: **Tma** (*Тьма*) = *terr, errësirë* dhe është për arsyet që parashtruam më sipër prap shqipja *dam... thỳm...* (⏀).

Në shqip:

⏀	= ●	...(**F**)
ndar	*ndyrë*	
pjesë	*pis*	
felë	*fëlliq*	

vandāru - *a respectueux, plein d'égards envers qq. 'un*
(*që respekton, që nderon*)

Është shqipja: **ba nderù**

vi-ViC - *séparer, trier; distinguer, discriminer; trancher* (*une question*), *examiner, délibérer; manifester, déclarer...*
(*me ndà, me veçue, me t-harr; me dallue, me diskriminue, me e prè* (*një çështje*); *me shqyrtue, me marrë një vendim... ; me shfaq, me manifestue...*)

ViC është këtu shqipja ***VEÇ-oj***.

vi- si prefiks tregon përfundimin e veprimit të kryer nga **VIC** (krahaso me rusisht *vi* - (*вы*)) ose heqjen mënjanë të të *veçumes*, etj. etj.

Le të shpjegojmë tani kuptimin *me shfaq* (fr. *manifester*). Kemi:

(Vi-ViC) $_{\text{sanskr.}}$ = **(veçoj)** $_{\text{shq.}}$ = ⏀ = ***F*** = ● = *Bota materiale*
(si *manifestim, shfaqje e botës spirituale,* simbolikisht e ○...)

Vërejtje:

1) frëngjisht:

Sé-par-er

është shqipja:

bërë **S**

do me thënë:

bërë ⊘

ose edhe:

bërë ⦶

2) frëngjisht:

dis tin guer

reduktohet tek shqipja:

dysh TAN kry
2 **TAN kry**

Dhe me qënë se ***2*** = ***– 1***, kemi:

kry : – TAN

dhe me qënë se e **TANA** = **0**, atëhere kemi:

kry : – ○ = ⦶ = dà, dalloj...(fr. *distinguer*)

3) frëngjisht:

dis cri min er

reduktohet tek shqipja:

dysh kre-jt jamun ar

dhe duke mos përfillur sufiksin verbalizonjës **ar** (fr. *er*) kemi:

jamun : *dysh kre-jt*

Dhe me qënë se **krejt** = ○, kemi atëhere:

2 . ○

Dhe me qënë se ***2*** = ***– 1***, kemi gjithashtu:

– ○ = ⦶ = **dà**, *dalloj... diskriminoj*

vi-varta - m. *changement, transformation;* ifc. *apparence de; transformation du principe spirituel (Dieu) en monde des phénomènes (philos. Vedānta);* - **na** ag. *qui tourne, qui roule; qui change, transforme;* nt. *Fait de rouler; circulation, va-et-vient; changement, revirement;* **-in** ag. *Qui tourne,* etc.; *qui se détourne; qui change...* **-ita** - a.v. *qu'on a fait tourner; qui tourne; déforme*

(*ndryshim, transformim; dukshmëri, dukje e... transformim i parimit frymor (shpirtëror, spiritual) (Zotit) në Botën e fenomeneve (fillosofia Vedānta)* - **na**, *që vërtitet, që rrotullohet; që ndryshon, transformon;* **nt.** *të rrotulluarit; qarkullim, jak-e-eja, kthim; ndryshim, ndryshim i plotë;* **-in** ag. *që vërtitet etj.; që heq dorë, që devijon; që ndryshon;* **-ita** a. *që është bërë të vërtitet, që është vënë në lëvizje; që vërtitet; i (e) deformuar)*

Shqyrtojmë më parë prefiksin **vi-** për të cilin kemi folur edhe më parë që tregon *ndarje, shkatërrim, shpërndarje, diskriminim, deviacion* etj. *intensitet.* Përpara emrave: *që s'ka, i keq; i dalluar* (fr. *dis-tin-ct*); *shumë.*

Siç kemi shpjeguar edhe gjetkë **vi-** lidhet me gërmën e dytë të alfabetit (hebr. *Beth*, gr. *beta*, it. *bi*, etj. etj.). Që këndej:

$$\mathbf{vi} = 2$$

por: $2 = F = \bullet =$ kuptimi i **keq** $= -1$ (kuptimi *që s'ka*) $=$
$-(x^2 + y^2 = 0) = -$**Qëndër** $=$ kuptimi i **devijimit** $=$
$\not{X}$ kuptimi i *disa, shumë*

e kështu me radhë.

Vëmë rè se disa nga vlerat semantike të këtij prefiksi foljor jepen në gjuhët me prejardhje latine nga prefiksi **dis** (*di, dès, de,...*) që lidhet me shqipen *dysh* e pra me tërë spektrin semantik të numrit *2* si simbol.

varta është shqipja *vërtit* e pra simbolikisht ⊙.

Le të tregojmë se si duke u mbështetur sa më sipër dhe me ndihmën e Algoritmit Simbolik mund të nxirren lehtë kuptimet e ndryshme të fjalës **vi-varta** në sanskritisht.

1) Kuptimi i *ndryshimit, transformimit:*

Dimë se:

$$\odot = F = \sim$$

Dhe $\sim$ është ndër të tjera edhe simboli *i lëvizjes, i ndryshimit*, etj. Nga ana tjetër, me qënë se Gjuha emërton sipas të *Parit,* objekti i ndryshimit, i transformimit është ○ a ndryshe ***E***. Prandaj pra, *ndryshimi, transformimi* është kalim nga:

○ (***E***) në ● (***F***)

do me thënë ai *ndryshim*, ai *transformim* që u bë shkak për krijimin e Botës materiale.

vi- këtu flet për *ligësinë, negativitetin* e këtij transformimi:

(**vi-** = ***2*** = ***−1*** = ● ...)

për faktin që kjo *vërtitje* (*varta*) lidhet me një *devijim* (nga Qëndra, nga Zoti, ...) me një *negativitet*, etj. etj. Pra dhe ***transformacioni*** **zanafillor nga e cila lindi bota është një *deformacion*.**[*]

Por **vi-** mund të tregojë këtu edhe *shkëputjen, ndarjen, veçimin* pas *vërtitjes* (që shkaktoi *transformimin*) e *produktit* të këtij transformimi, do me thënë të Botës materiale nga Zoti.

Pra fjala sanskritisht që po shqyrtojmë mund të interpretohet kështu edhe si *veçim* (**Vi-**) me anë të *vërtitjes* (**varta**). E pra atëhere simbolikisht si:

⦶	=	⊙	...(**F**)
vi-		**varta**	
(*veçim*)		*vërtitje*	

Veçim me anë të vërtitjes

---

[*] Sipas Kozmogonisë Moderne, Krijimi i Botës ka ndodhur me kalimin nga Simetria e Përsosur, e Pathyer e Hiçit (Perfect, Unbroken Symmetry of Nothingness) në Simetrinë e Thyer (Broken Symmetry) pra, me simbolet tona, nga ○ në ⦶, e pra nga ***E*** në ***F***. Kështu që edhe sipas shkencës moderne të Kozmollogjisë, Krijimi i Universit lidhet me një **devijim**, me një **deformim**. *Ky është një nga* **takimet** *e shumta mes të dhënave të mendimit të lashtë mistik dhe mendimit të sotëm shkencor.*

Po **veçimi**, çdo *veçim*, si i tillë, është **ndarje** (⌀), *nga Zoti* e pra si i tillë ai bëhet shkas për *krijimin e materies*, të *botës materiale* (⌀ = ●).

Por me qënë se: **vi** = *2* = *pas* = *pasojë*, fjala sanskrite që po shqyrtojmë mund të tregojë këtu edhe rezultatin, pasojën (**vi-**) e vërtitjes (**varta**) që është: **ndryshimi** (kalimi nga ***E*** në ***F***), etj. etj.

Shohim pra se çfarëdo kuptimi që t'i japim **vi-** (brënda kuptimeve të mundshme) dalim gjithnjë po atje.

Fjala *devijim* lidhet edhe me *largimin* nga *vija e drejtë*, e pra nga *drejtësia*, nga *normalja* e kështu me radhë. Le të tregojmë se si me ndihmën e Algoritmit Simbolik mund të jepet edhe ky kuptim i *devijim*it.

Mathematika na thotë se dy drejtëzat izotrope (imagjinere) *janë harmonikisht të konjuguara me dy drejtëza çfarëdo* (reale) *pingule mes tyre*[*].

Dimë se *drejtëzat izotrope* ($y = ix$, $y = -ix$) përftohen nga zbërthimi i ekuacionit të Qëndrës së rrethit, do me thënë të $(x^2 + y^2 = 0)$.

Por nga ana tjetër:

$$(x^2 + y^2 = 0) = (x = -x) = 0$$

Duke treguar dy drejtëzat pingule mes tyre me **+**, kemi atëhere ekuacionin:

$$+ = \circ$$

ku shënja "=" duhet marrë këtu si *konjugim harmonik*. Drejtëzat pingule janë reale, kurse qëndra, është irreale (imagjinere). Pra dy drejtëzat pingule (**kryqi**) mund të vështrohen kështu si përfaqësueset më të afërta (në italisht *coniugato, congiunto, coniuge... i konjuguem, i afërt, bashkëshort...*) reale të Qëndrës, e pra të Zotit.

Por simboli **+**, duke qënë edhe ai i *pingules* (⊥), si formuese e një këndi të **drejtë**, do të mund të vështrohej si simboli i *drejtësisë*, ndërsa simboli **–** **+** do të ishte kështu ndër të tjera ≮, një *oblike* (∠), një vijë e *shtrëmbër*, e pra një *devijim*, e pra simboli i *padrejtësisë*.

---

[*] Shiko lidhur me drejtëzat izotrope apo imagjinare *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik*.


Pra kemi:

$$\not + = - + = - \circ$$

devijim **decentrim**

Pra ne shohim kështu se *decentrimi* është në të njëjtën kohë edhe *devijim*, *largim* nga Zoti e drejtësia e Tij.

Relacioni + = o është paraqitur simbolikisht në një sërë kryqesh në trajtën*:



Ja pak a shumë disa kryqe të tillë në Irlandë.



Nga sa më sipër del edhe një kuptim tjetër i thellë i kryqit me Qëndrën në mes, ai i **Tetramorfit**, si edhe ai i simbolizmës së numrit *pesë* (5).

Lexojmë për këtë tek Cirlot, fq. 271:

---


* Kuptimi:

o = **Qëndra**, **Ati** (*i fshehur, imagjiner, Qiellor*)

\+ = **Biri**, manifestimi i Atit (*real, mbi Tokë*)

"...the quinary is symbolic of the whole of the material world (denoted by the quaternary) plus the centre or quintessence..."

(... pesa simbolizon tërësinë e Botës materiale (që simbolizohet nga numri katër dhe katrori) plus Qëndrën ose Kuintesencën...)



Tetramorfi: Të katër Ungjillorët dhe Krishti në mes si *Pantakrator* (fjalë greke kjo që do të thotë Mbajtësi i Gjithëshkaje). Kjo pikturë gjëndet në San Isidoro de León, Spanjë.

Para se të kalojmë më tej në motivimin e kuptimeve të tjera të fjalës sanskritisht *vi-varta* vërejmë sa më poshtë:

Në shqip **dre**-*dhje* që mund të paraqitet simbolikisht si ⊙, dhe *n*-**dry**-*shim* (transformim), simbolikisht ~, lidhen që të dyja me radikalin (operatorin e lirë) të shqipes **-dr-**, zgjerime të thjeshta të të cilit ato janë. Pra dhe shqipja e lidh transformimin (si *n*-**dry**-*shim*) me një vërtitje **dre**-dhje).

Në shqip kemi gjithashtu:

*n***dër***tim* = ●
*n***dar***ë* = ◐
*n***dry***shim* = ~
dre*dhje* = ⊙
*n***dyr***ë* = ●

Pra shqipja pozon:

ndërtim = ⊙ = ~ = ◐ = ●

dredhje *ndryshim* *ndarje* *ndyrje, materie, Botë materiale*

Me fjalë të tjera shqipja na thotë se *ndërtimi* (*krijimi*) i *Botës materiale* (●) mund të vështrohet si një *ndryshim* (~) nga një *gjëndje* a *entitet* i mëparshëm, ndryshim që realizohet me një *dredhje* (*vërtitje*) (⊙), a ç'është njëlloj, me një *ndarje* (◐) nga Zoti, a ç'është prapë njëlloj, me një *ndyrje* (*mëkat, krim*, etj. etj.) (●).

Vëmë rè se në anglisht:

to turn = me u vërtit
to turn out = rezulton; del në dritë, del (*se*) ...

Pra dhe në anglisht *vërtitja* lidhet me një *ndryshim* dhe me rezultatin e këtij *ndryshimi* (*pasojat*).

Në rusisht:

obratits (*обратить*) (*obrashçats* (*обращать*)) = *vërtit, qarkulloj; shndërroj, transformoj*

Në rusisht gjithashtu: *oborot* (*оборот*) = *vërtitje* , që zbërthehet në **obo rot** dhe me shqipen *â bâ* ***rrotë*** (*rreth, rrath...*; në shqip **rrot***ulloj*...). Po në rusisht kemi gjithashtu edhe: **na oborot** (*на оборот*) = *përkundrazi*, e pra simbolikisht -1. Kështu rusishtja shtron ekuacionin e rëndësishëm simbolik:

$$\odot = -1$$

Me qënë se krijimi i botës është kalimi nga kodi E në kodin F ne mund të shkruajmë atëhere simbolikisht:

$$\sqrt{E} = -E = F^{*}$$

Pra rusishtja rikonformon faktin e krijimit të botës me një vërtitje. Në shqip:

ndarje = ⊕ **ndyrje** = ●

dhe nga ana tjetër "**dr***edhje*" - *n***dyr***je*. Ne mund të shkruajmë atëhere:

⊙	=	⊕	=	●
***dr**edhje*		*n**dar**je*		*n**dyr**je*
vërtitja	=	*shkaku i*		
		***lind**jes*		*së **lënd**ës (materies), i Botës materiale*

* Shih për këtë P.Sh.A.S.

Ne mund të themi atëhere se sipas shqipes (dhe jo vetëm):

vërtitja (⊙) ***është shkaku*** (◐)* ***i krijimit të Botës materiale*** (●)

Dhe rigjejmë kështu hipotezën shkencore të krijimit të materies e të botës materiale nga një *shakullere*, nga një *vorbull* (fr. *tourbillon*, rus. *vihr*) zanafillor, nga një *tornado* origjinar.

Ne shohim kështu se si kjo hipotezë ndodhej e *groposur* në gjuhë (sanskritisht, shqip, etj.) nga e cila ne me *majeutikën*** e Algoritmit (me Algoritmin Simbolik si *mami*) e nxorëm në dritë.

Atëhere, kjo do të thotë se:

hipoteza kozmogonike, moderne e shkencore, bën pjesë në repertorin e miteve kozmogonike të mendimit mistik

Një kuptim tjetër i rëndësishëm i **vi-varta**, *është* transformimi i parimit shpirtëror (Zotit) në botën e fenomeneve (fillosofia *Vedanta*).

Ne dimë se:

$$\textit{parimi shpirtëror} = \textit{Fryma} = \textit{Zoti} = \textit{Qëndra} = \textit{Coincidentia oppositorum} = (x = -x) = \bigcirc = E$$

dhe se:

$$\textit{Bota e fenomeneve} = \textit{Bota materiale} = \bullet = F$$

Pra **vi-varta** jep kështu **kalimin** nga E në F, kalim tek i cili mund të reduktohet çdo mit kozmogonik.

---


* Rikujtojmë se:

$$\underset{\textit{ndarja}}{\oplus} = \underset{\textit{shkaku}}{\leftrightarrow} \qquad ...(\mathbf{F})$$

** Majeutika - është metoda e veçantë zbuluese që përdorte fillosofi i dëgjuar grek Sokrati. Ai e quajti kështu këtë metodë nga fjala greqisht *maja* (μαια) që do të thotë *mami*. Pra, ashtu si *mamia* nxjerr nga barku i nënës fëminë, thoshte Sokrati, ashtu dhe unë nxjerr nga mendja e njerëzve të *Vërtetën*.

Vëmë rè me këtë rast edhe sa vijon:

a) në hebraisht:



Pra **vi-varta** na flet atëhere për krijimin e Botës përmes **vërtitjes** së **Erës** (*Frymës*). Flet, me fjalë të tjera, për krijimin e Botës përmes një **Tornado**, një *Uragan*, një *Shakullerë*, *vorbull* (fr. *tourbillon*).

b) Me qënë se në bazë të mendimit mitik, si edhe sipas Algoritmit, fundi i Botës dhe fillimi i Botës duhet të barazohen:

$$[(\alpha = \omega) = (x = -x)]$$

dhe me qënë se fjala sanskritisht *vi-varta* flet për krijimin e Botës me një *tornado*, ne shohim se bota materiale duhet të ketë filluar gjithashtu me një *shtrëngatë* (*tufan, vorbull,* "tornado"), (siç del nga ana tjetër edhe nga vetë analiza e kuptimeve të fjalës sanskrite **vi-varta**), dhe kështu po edhe duhet të mbarojë.

Fjala sanskrite **vi-varta** na thotë tërthorazi se kemi:

$$Rot\, \boldsymbol{E} = \boldsymbol{F}^{*}$$

Ku **Rot** rri për **rotor** dhe është në fizikën teorike shenja për të treguar një *vërtitje*. Me fjalë të tjera $\boldsymbol{F}$ (*bota materiale, bota fenomenale...*) mund të përftohet nga një *rrotullim*, *vërtitje* e $\boldsymbol{E}$ (*Fryma, Bota spirituale, Bota noumenale*, "*Mbretëria e Qiejve*" ... etj. etj.).

Duke përsëritur le ta provojmë edhe një herë këtë.

Dimë se:

---

* Shih edhe P.Sh.A.S.

$$E = (x = -x)$$
$$F = (x = x)$$

Dimë se tabelat e vërtetësisë së E dhe F mund të paraqiten respektivisht si:

$E =$

I I	=	–
I –	=	I
– I	=	I
– –	=	–

$F =$

I I	=	I
I –	=	–
– I	=	–
– –	=	I

Le të *vërtitim* tani tabelën e vërtetësisë së E (*grupin* E) me një kënd prej 90°. E tregojmë këtë vërtitje me *Rot* E.

Do të kemi:


Rot $E =$

– –	=	I
– I	=	–
I –	=	–
I I	=	I

$= F$

Çfarë duhej provuar.

Këtu:



Kështu pra ne nxorëm ekuacionin e rëndësishëm:


$$\textbf{(vi-varta)}_{\text{sanskr.}} = (Rot\ E = F)$$

Vëmë rè se ky ekuacion mund të nxirret më shkurt edhe duke arsyetuar kështu:

$$E = \sqrt{F}$$

Nga ana tjetër: $F = -1 = \ldots$, pra: $E = \sqrt{-1} = i$
ku i është njësia imagjinare në mathematikë.

Dihet nga mathematika se i^2 tregon një *vërtitje* të i-së me një kënd prej 90° në drejtim të kundërt me akrepat e sahatit, rrotullim i cili është e barabartë me -1 (siç tregohet në figurë).



Pra mund të shkruajmë:

$$i^2 = \circlearrowleft i = -1$$

Pra atëhere:

$$\circlearrowleft E = \circlearrowleft i = -1 = F$$

pra:

$$Rot\ E = F$$

Një kuptim tjetër i **vi-varta** është *dukje e...* Pra:

vi-varta = *dukurí* (it. *apparenza*)

e pra *jo realitet i mbramë, jo e vërtetë...*

Le ta "vërtetojmë" këtë:

(vi-varta) = **Rot** E = F = ● = *bota materiale* = *bota fenomenale* = *bota e* **dukurive** *të Natyrës* = **dukje** (it. *apparenza*)

Kujtojmë se për Mendimin Mistik, kjo bota jonë materiale është *e rrejshme*, s'është veçse një *dukje* etj. etj.

bheda - *fait de briser, de rempare, de fendre, percer, rupture; explosion; perforation; expansion, épanouissement; division, disjonction, séparation, discorde, rupture d'une alliance, trahison; interruption, dérangement, infraction; modification, différence, distinction; variété...*
(të thyerit, të këputurit, të çpuarit; thyerje, këputje, plasje; çpuarje; shtrirje, zgjerim, shtjellim; pjesëtim,ç'bashkim, ndarje, grindje, prishje e një aleance, tradhëti; ndërprerje, thyerje (shkelje) ligji; modifikim, diferencë, dallim; larmi, ndryshmëri...)

Është shqipja:

bë DÁ

e pra simbolikisht: ⦶

Algoritmi Simbolik na jep:

$$⦶ = F$$

Dhe kemi atëhere:

$$F \begin{cases} = \boxed{\circ} & \text{(kuptimi i } \textit{çpuarjes}\text{, fr. } \textit{perforation}\text{)} \\ = \text{ᘯ} & \text{(kuptimi } \textit{i grindjes, i konfliktit,}\text{ fr. } \textit{discorde}\text{; në shqip } \textit{dá} \text{ dhe } \textit{dasì}\text{)} \\ = -1 & \text{(kuptimi i } \textit{diferencës}\text{)} \\ = \sim & \text{(kuptimi } \textit{i ndryshimit}\text{ dhe pra } \textit{i të ndryshmes}\text{, që do të mund të tregonim simbolikisht me } \chi\text{, dhe } \textit{i larmisë}\text{ - fr. } \textit{variété}\text{)} \\ = (\lessdot\cdot\cdot\gtrdot) & \text{(kuptimi } \textit{i zgjerimit, i shtrirjes...}\text{)} \\ = \text{☼} & \text{(kuptimi i } \textit{plasjes}\text{, fr. } \textit{explosion}\text{)} \\ = \ldots & \end{cases}$$

Kuptimet e tjera si *me thye, pjesëtim* etj., dalin nga simboli ⦶.

Kuptimi i *modifikimit* lidhet me atë të *ndryshimit*. Por Algoritmi Simbolik jep:

$$\underset{ndarje}{⦶} = \underset{ndryshim}{\sim} \qquad \ldots \textbf{(F)}$$

Duke qënë kështu, me qënë se, me fjalë të tjera, *ndryshimi* (e pra dhe *modifikimi*) lidhet me një *ndarje*, fjala latinisht **modificare** zbërthehet si:

mo di fi care

dhe me shqipen:

me DÁ bë kry

E pra:

kryej : **bë me DÁ**

e pra *bëj DÁ* (dhe është sanskritishtja **bheda**) e pra përfundimisht:

DÁ

e pra simbolikisht: ⌀

Le ta zgjerojmë tani pak bisedën.

Qëndra, duke qënë *Zoti*, është, duke u shprehur me gjuhën e Spinozës, edhe **Substanca** (nga latinishtja **substans** = që qëndron **ndën**); dhe vërtetë Algoritmi Simbolik na jep:

●	=	⊡	=	♀	...(**F**)
lënda, materia		*Sub-stanca* (këtu: ajo që është *brënda, esenca*)		ajo që ndodhet poshtë, ndën (***Sub**stanca*)	

Nga ana tjetër ne kemi vetëm një **Substancë** (sikundër Spinoza e vërteton në pjesën e parë të kryeveprës së tij fillosofike "*Etika*") dhe një infinitet **modusesh** (prapë sipas Spinozës).

Algoritmi Simbolik e bën këtë krejt të dukshme, të prekshme dhe bindëse. Dhe vërtetë:

Substanca = **Qëndra** = $(x = -x)$ = $(x^2+y^2=0)$ = **Qëndra e rrethit**


Moduset = – **Substanca** = – **Qëndra** = – $(x = -x)$ = $(x = x)$ = $(x^2+y^2=r^2)$ = **periferia e rrethit**

***Qëndra** e rrethit është vetëm një, **ajo** përbëhet **vetëm** nga **një** pikë, kurse **periferia** e tij përbëhet nga një **infinitet pikash**.*

Me qënë se:

modusi = me dá = ⊕ = *F* = ⊙

Ne shohim se *moduset* (*format*) janë vendosur mbi periferinë e rrethit e pra, me qënë se pikat e rrethit janë infinit, ashtu dhe numri i moduseve përmes të cilave *Substanca* (*Zoti*) shprehet është *infinit*. Secili prej tyre përputhet me një pikë të periferisë së rrethit. Pra, mund ta paraqesim situatën edhe në këtë mënyrë:



Do të arrinim në të njëjtin përfundim edhe duke u bazuar tek:

Substanca = ***E*** = $(x = -x)$ = *një zgjidhje e vetme* **(0)**
Modusi = *forma* = ***F*** = $(x = x)$ = *një infinitet zgjidhjesh* (∞)

Tek libri i Cirlot, nga i cili kemi cituar kaq shpesh, lexojmë lidhur me sa më lart:


" ...To leave the *circumference* for the *centre* is equivalent to moving from the exterior to the interior, from *form* to *contemplation*, from *multiplicity* to *unity*...".

(... Të largohesh nga periferia e rrethit për nga qëndra, është njëlloj si të lëvizësh nga jashtë brënda, nga format tek esenca, nga shumësia tek njësia...)

gjë që rikonfermon saktësinë e diagramës sonë të mësipërme. Me qënë se:

$$\text{◐} = F = \bullet = \textit{materie, send material...}$$

skema e mësipërme do të mund të ndërtohej edhe si:



Dhe kjo skemë do të paraqiste kështu lindjen e sendeve ($\bullet_n$) nga hiçi (○).

Këtu s'ka asgjë për t'u habitur sepse, siç kemi parë, të gjitha mitet kozmogonike janë të reduktueshme në instancë të fundit në një *kalim* (*hop, kërcim...*) nga ***E*** në ***F***, e pra atëhere edhe nga një *kalim* nga ***1*** (= ***E***) tek ***X*** (= ***F***), do me thënë nga **njëshi** (*e vetmja, unikja...*) tek e **shumta** (*multipliciteti, pluraliteti...*), nga ○ (***E***) tek ● (***F***), do me thënë nga **hiçi** tek **diçi**, do me thënë tek *sendi material*, tek *bota materiale* e kështu me radhë.

Vëmë rè me këtë rast sa vijon:

Anglishtja **thing** (*send*) për arsyet që pamë më sipër duhet të lidhet me shqipen **thyn**, simbolikisht ◐ e pra edhe = ***F*** = ●, do me thënë pra *send* (◐) *material* (●).

Po ashtu dhe gjermanishtja **Dinge** (*send*) mund të shpjegohet (*motivohet*) me shqipen **dan** e pra simbolikisht ◐ etj. etj.

Gjithashtu tek anglishtja **kind** (*lloj*), po për të njëjtat arsye, duhet parë shqipja **ka nda** e pra simbolikisht ◐.

Edhe tek vetë fjala shqipe **send** duke e zbërthyer këtë fjalë në:

s + end

Dhe më tej në:

s + e + nd

Dhe duke vështruar **s** si prostatike e pra pa semantizëm, ne mund të shohim këtu fjalën shqipe:

â nda

e pra:

⏀ (*send*) = ● (*material*)

Kjo fjalë shqip lidhet si me një fjalë **bashkësimbolase** (që përshkruan të njëjtin simbol) me anglishten **asunder** = *separately; apart; into parts...* (*veç, ndaras, në pjesë...*) në të cilën pjesa sinjifikative përbëhet nga **under**, dhe është shqipja **â ndarë**, dhe simbolikisht pra ⏀.

Në gjermanisht: **besonderer** = *i veçantë* dhe do zbërthyer si:

be s o nder er

ku **s** është prostatike, **er** në fund është një prapashtesë mbiemëronjëse (adjektivonjëse).

Pra mbetet:

be o nder

dhe kemi kështu shqipen:

bë â ndar

e pra simb. ⏀, që motivon plotësisht kuptimin e fjalës gjermanishte.

Në gjermanisht gjithashtu **sondern** = *por, në kundërshtim me,* e pra simbolikisht -1. Por Algoritmi Simbolik na jep:

-1 = ⏀ = $\mathfrak{S}$ ...(**F**)

por *ndarje dasì* *kundërshtim*

Pra dhe fjala **sondern** e gjermanishtes s'është tjetër veçse shqipja *â ndarë* = ⏀ = ... Gjermanishtja e ka përdorur shqipen **â ndarë** edhe në shumë fjalë të saj të tjera, si për shëmbull në: **ander** = *tjetër.*

Kjo fjalë duhet zbërthyer si:

a nder

Dhe është shqipja **â ndarë** e pra simb. ⏀. Por ⏀ = ***F*** = ***2***, dhe simboli i fundit motivon fjalën gjermanishte **ander**.

Në gjermanisht:

verändern = **ndryshoj** e pra simbolikisht ~

Para se të trajtojmë motivimin e kësaj fjalë gjermanisht me anë të shqipes, le të vëmë rè sa vijon:

Në shqip:

ndarë dhe **ndryshoj**

Kështu shqipja shtron ekuacionin simbolik:

⏀ = ~ ...(**F**)

ndarë *ndryshoj*

Në italisht:

metà = *gjysma* = ½ = ⏀

mutare = *ndryshoj* = ~

Pra dhe italishtja shtron ekuacionin:

⏀ = ~ ... (**F**)

metà *mutare*

E njëjta gjë përsëritet edhe në shumë e shumë gjuhë të tjera, do me thënë koncepti i *lëvizjes,* i *ndryshimit,* lidhet, me fjalë të tjera, me atë të *ndarjes.* Kjo

shpjegohet fillosofikisht (theollogjikisht, kozmogonikisht) me faktin se Bota u krijua me një **ndarje**, sikundër që shprehet në të thënën e artë të Paracelsit: *Die Separatio ist aller Geburt Anfang* .... Sipas fillosofisë së Hegelit është *ndarja e Frymës Subjektive nga ajo Objektive në gjirin e Frymës Absolute gjë që lindi Botën materiale si një alienacion (tjetërsim) të Frymës Absolute*. Por *me krijimin e Botës materiale filloi edhe lëvizja, ndryshimet*, etj. etj.

Algoritmikisht:

⊕	=	●	=	~	... **(F)**
ndarja		*ndyrësimi*		*ndryshimi*	
		materia		*lëvizja*	

Kthehemi tani tek gjermanishtja **verändern**. Kjo fjalë do zbërthyer si:

ver ä nder n

dhe me shqipen:

bër â ndar

e pra simb. ⊕, dhe me qënë se: ⊕ = ***F*** = ~ (*lëvizje, ndryshim*), fjala gjermanisht motivohet kështu përmes shqipes dhe ndihmës së Algoritmit Simbolik (strukturizim llogjik i mendimit mitik!) plotësisht.

bhedakara -ī, -˚kṛt - ag. *qui provoque la discorde parmi...*
(*që shkakton grindjen, dasinë ndërmjet...*)

Është shqipja:

bë DA kry
(*ai që kryen darjen, dasinë...*)

bhedasaha - a. *qui peut être détaché* (*de ses alliés*) *corruptible*
(*që mund të ndahet nga aleatët e tij; i korruptueshëm*)

Është shqipja:

bë dá shok (*që ndahet nga shokët...*)

bhedita - a.v. *fendu, brisé, rempu, etc.* (*i çarë, i thyer, i këputur etj.*)

Është shqipja:

bë dātë

e pra simb. ⦶.

an-atidūre - adv. *pas trop loin* (*jo tepër larg*)

Do zbërthyer në:

an ati dūre

dhe me shqipen:

as (– *I*) **â tej darë**

dhe simbolikisht:

– (**darë** ⋙)

ose edhe:

– (≪••≫) ⋙

Ku simboli i parë, do me thënë (≪••≫) është ai i **dis-tan-cës**, që rrjedh nga **dar**-*ja*. Siç e kemi vënë në dukje edhe gjetkë, fjala latinishte (italishte) **dis**-*TAN-tia* vjen nga një shqipe:

dysh TAN = *2* **TAN** = *2* ○ = –○ = ⦶ = (≪••≫)

ose edhe:

des TANA

– **Tana** = – ○ = ⦶ = (≪••≫) ... (**F**)

a-tula - a. *ineomparable* (*i pa krahasueshëm*)

ku: **a** = – *1*
tula = *i, e tillë*

Pra tërë fjala jep:

– (*i, e*) **tille** = *s'ka të tillë*

e pra dhe *i pakrahasueshëm.*

atīndriya - a. *au-dessus des sens, supra-sensible;* n. nt. *esprit, âme* (*përtej, përmbi shkisat, mbishkisore; frymë, shpirt*)

Do zbërthyer si:

atī a ndr i ...

dhe me shqipen:

â tej ndar-jes

Dhe simbolikisht:

> ⦶

Po ne dimë se ○ > ⦶. Pra kemi:

○ ose – ⦶

Pra kjo fjalë sanskritisht përshkruan kështu simbolin ○ a ç'është njëlloj – ⦶.

Le të bëjmë tani këto vërejtje për të justifikuar rezultatin e arritur e pra edhe për të vërtetuar se ne e kemi motivuar saktë fjalën e mësipërme sanskritishte.

1) Ne dimë se kemi sipas Algoritmit:

$(x = -x)$ = ○ = **Zoti** = **Fryma**

e pra frëngjisht **esprit**.

Me qënë se nga ana tjetër **shpirti** lidhet ngushtë me *Frymën*, simboli ○ mund të shërbejë për të përshkruar edhe *shpirtin*.

2) Në shqip fjala **shkisat** lidhet brënda shqipes me fjalën **shkyesat**, e pra me foljen *shkyej*, që jep simbolikisht ⊕. Me fjalë të tjera ***shkisat***, *shkyejnë, ndajnë, analizojnë* informacionin primar. Ndaj quhen në shkencë edhe *analizatorë*. Informacioni primar pasi *ndahet* nga *shkisat*, rikompozohet nga sistemi qëndror (truri, "mëndja") në një mënyrë origjinale, duke na dhënë kështu imazhin e botës materiale dhe objekteve në të. Krijohet me fjalë të tjera kështu i ashtuquajturi Realitet Objektiv që sipas fillosofisë së lashtë hindiane (dhe jo vetëm asaj...) është krejt një iluzion, një mashtrim i Mayas*.

Shkisat dhe sistemi nervor qëndror (*truri*) krijojnë kështu një botë **fenomenale** (të *dukshme*, të përbërë nga *dukuri*). Prapa saj, si burim i saj i fshehtë e i pandarë, qëndron **noumeni** ose Realiteti Absolut.

3) Në shqip fjala **ndjesitë**, lidhet brënda shqipe me foljen *ndaj* e pra kemi simb. ⊕. E kemi kështu prapë *shkisat* (*shkyesat*), e prapë sanskritishten *ndri*... Ne shikojmë pra kështu se si shqipja ashtu dhe sanskritishtja përdorin për të shprehur konceptin e *shkisës*, e *ndjesisë* të njëjtën folje *ndaj* (në shqip), *ndarë* (në sanskritisht si pjesë e foljes shqipe *ndaj*). Kështu pra shqipja në instancë të fundit na lejon që të motivojmë dhe të bazojmë fillosofikisht fjalën sanskritishte që po shqyrtojmë.

4) Sanskritishtja na thotë, *implicite*, me fjalën e saj **atīndriya** se bota e *përmbishkisore*, e pra e *mbinatyrshme*, është e njohëshme por jo nëpërmjet kanalit *shkisor* e *mendor*, por nëpërmjet **Shpirtit**, **Frymës**. Edhe kjo sepse ky realitet i *mbramë, themelor, absolut* është **spiritual**.

Fizika moderne në të cilën vërshon bollshëm, triumfues sot Mendimi Mistik, po detyrohet të pranojë përherë më shpesh e më tepër se, siç shprehet ndër të tjerë Teilhard de Chardin: *Dans le coeur de la Matière il y a l'Esprit* (Në zëmër të materies qëndron Fryma).

5) Nga fjala e mësipërme sanskritisht ne marrim vesh se realiteti që **shkisat**

* Në mithollogjinë e lashtë hindiane Maya si mashtrim, si iluzion, identifikohet shpesh herë edhe me Mara-n, Djallin...

krijojnë është **material**. Edhe kjo sepse, ndër të tjera:

a) në shqip **ndarë** (ⓘ) - **ndyrë** (●) dhe simboli i fundit është edhe ai i *materies*.

b) në sanskritisht:

dravya - nt. *substance, objet, chose, matière* (*substancë, objekt, sens, materie*)

Por rrënja **ndr** që përbën bërthamën semantike të fjalës sanskritishte që shqyrtojmë dhe që do të thotë, *shkisë*, dhe rrënja **dra** që përbën bërthamën semantike të fjalës **dra**vya që do të thotë *materie* në sanskritisht janë e njëjta rrënjë, është fjala në të dy rastet për shqipen **ndarë**, e **darë** që ne që e njohim shqipen, e dimë se janë e njëjta rrënjë, e njëjta folje.

Kjo pra tregon se, siç thamë, bota, realiteti që na paraqesin *shkisat* (duke *shkyer*, duke *ndarë*, duke *rikompozuar* më tej nëpërmjet sistemit nervor qëndror, trurit, *informacionin primar noumenal*...) është **material**. Ne mund të themi kështu: **Janë shkisat ato që e krijojnë materien dhe materialitetin e Botës, e kësaj bote**. Ky është mesazhi që na përçon, përmes dhjetëra e dhjetëra shekujsh e përmes shqipes, Fillosofia e lashtë hindiane...

a-dhruva - a. *a. non constant, éphémère* (*jo i qëndrueshëm, kalimtar*...)

Do interpretuar me shqipen si:

â* dar *ba

do me thënë **â bâ dar**, e pra **dar**, simb. ⓘ.

Algoritmi Simbolik jep:

$$ⓘ = \sim$$

ku $\sim$ është, siç e dimë, simboli i *lëvizjes*, i *ndryshimit*.

Që këndej pra dhe kuptimi *jo i qëndrueshëm, kalimtar*, etj., etj.

Vërejmë me këtë rast sa vijon:

1) Në shqip kemi:

ndarë (⦶) - **ndryshim** (∼)

në italisht:

metà (⦶) - **mutare** (∼)

2) Në gjermanisht: **verändern** = *ndryshoj* (∼), zbërthehet, siç e kemi parë, si:

ver ä nder n

dhe me shqipen:

bër â ndar = ⦶

Kështu pra, me ndihmën e shqipes, edhe gjermanishtja si italishtja, si edhe sanskritishtja shtron ekuacionin e rëndësishëm algoritmik:

⦶ = ∼ ...(**F**)

a-dhruva - a. *indéterminé* (*i papërcaktuar*)

Do interpretuar me shqipen si:

a (s) **dar u bâ**
u bâ – **dar**

e pra: – **dar**,

e simbolikisht:

–⦶ ...(**E**)


Dimë se simboli ⦶ është ndër të tjera edhe ai i *CAK-ut*, e pra i *përCAKtimit*, kështu që –⦶ do të jetë atëhere ai *i pa-përCAKtimit, i papërcaktueshmërisë...*

Vetë frëngjishtja ***déterminé*** interpretohet me shqipen si:

jamun (*miné*) **ar** (*er*) **dāt** (*dét*)

ku: **ar** = ○, **dāt** është pjesore e lashtë e foljes **daj**.

Pra atëhere tërë kjo fjalë simbolikisht duket qartë se vlen:



a-gada - m. *absence de mal, santé; remède; simple;* a. *bien portant (mungesë të keqeje, shëndet; ndreqje, shërim; i thjeshtë;* a. *që është mirë me shëndet*)

a-ja këtu është një prefiks mohues siç lexojmë në fjalor:

> ***a*** *(para bashkëtingëlloreve);*
> ***an*** *(para zanoreve) prefiks: mohim, privim (mungësim, kundërshtim); para emrave, rrallë përpara përemrave dhe foljeve.*

Le të zgjerohemi pak mbi kuptimin e këtij prefiksi duke e parë çështjen nga pikëpamja e llogjikës dhe fillosofisë së Gjuhës.

Gërma **a** në të gjitha alfabetet e gjuhëve të ndryshme është gërma e parë.

Nga ana tjetër ne dimë se gërmat e alfabetit janë përdorur dikur si numra (si akoma sot në greqisht, hebraisht ...).

Kështu për shëmbull:

a (*alfa, alef*) = *1* (në greqisht **α'**)
b (*beta, beth*) = *2* (në greqisht **β'**)

e kështu me radhë.

Pra mund të shkruajmë:

a = *1*

Mirëpo sipas Algoritmit Simbolik (strukturizim llogjik i mendimit mistik!) kemi:

a = *1* = (*x* = – *x*) = **Qëndra** = **Zoti** = ... ○
= ***E*** = –***F*** = –● = ...

Pra **a** (= *1*) *mohon* **formën** (– *F*) e pra tërë *botën materiale* (– ●) e çdo send në të, si edhe *tërë llogjikën njerëzore* (*arsyen*):

$$\mathbf{a} = 1 = E = -F = -(x = x) = -\textit{llogjika formale}, -\textit{Arsyeja njerëzore} \ldots$$

Kështu duhet shpjeguar pra ndoshta edhe kuptimi negativ që i jepet kësaj zanoreje, kësaj gërme të parë të alfabetit në një sërë gjuhësh.

Duke dalë disi jashtë nga tema, le të shohim disa shëmbulla të a-së privative, në greqisht.

1) avaris (*ἀβαρής*) = *pa peshë, shumë i lehtë* (angl. *weightless, very light, inponderous ...*)

Do zbërthyer si: **a var is** ku **-var-** lidhet me shqipen **barrë** dhe **-is** është një prapashtesë ndoshta e identifikueshme me shqipen **ash**(t) dhe me sanskritishten **aṣ** (*ta*), po me atë kuptim. Pra:

$$(\textbf{avaris})_{gr.} = (\textbf{a var is})_{gr.} = (-\textbf{barrë}\ \text{ash(të)})_{shq.} = -\text{♀} = (\textbf{weightless})_{engl.}$$

2) Avyssos (*ἄβυσσος*) = *abys, hymnerë, e çarë, boshllëk* (angl. *abyss, gulf, chasm ...*)


Do zbërthyer si:

a vyss os

dhe me shqipen: – **byth** *ash*(*t*)

dhe pra simbolikisht:– ●

e pra: *pa byth, pa fund* = ○ *Honì, Abisi*



Një etimollogji e tillë rikonfermohet edhe, ndër të tjera, nga rusishtja:

bezdnà (*бездна*) = *abys*

Dihet se në rusisht **dno** (*дно*) = *fundi* (it. *il fondo*) ndërsa bez (*без*) = *pa*.

Pra:

abisi = *бездна* $_{rus.}$ = *pa fund* (*pa byth*)

Vëmë rè me këtë rast se në italisht **honì**-së që ka trajtën e një **koni** të hapur, *bosh* (*pa byth*) në fund i thonë:

in-buto

Dimë se në italisht:

in → ☒ (shëmbull: *in casa*)
in → $-x$ (shëmbull: *infelice*)

Këtu është marrë kuptimi: $in = -x = -1 = -$.

Pra kemi:

in buto = – buto

dhe me shqipen: **– byth**

e pra simbolikisht si më sipër.

3) **adhiálytos** (*ἀδιάλυτος*) - angl. *undispersed, unscattered, insoluble, indissoluble, undissolved ...* (*i pashpërndarë, i papërdarë...; i pazgjidhshëm, i pa zgjidhur, i pa tretur...*)

Do zbërthyer si:

a dhia lyt -os

dhe me shqipen:

– da lith ash(t)

Ku **da** lidhet ne shqip me foljen **daj** (angl. *to separate, to divide...*) e pra simb. /, ose ½, ose ⊘.

lyth (*lith*) në shqip jep simbolikisht ⨷, simbol ky ndër të tjera, edhe i *bash*kimit, i *m-b-**ledh**-je-s* (fjalë për fjalë: *me bë **lidh**je*).

Pra simbolikisht tërë fjala jep:

– / ⨷

ose edhe:

– ½ ☓, etj.

Dhe me qënë se simbolikisht:

/ = ½ = ⓘ = ... = –*1*

mund të shkruajmë se vlera simbolike e fjalës në shqyrtim është:

– (–*1*) ☓

ose edhe:

– – ☓

e pra përfundimisht:

☓

që do të thotë, për ekuivalencë simbolike (kodi ***F***) edhe –(–●) që lidhet me kuptimin e *jo tretje,* jo *çpërbërje* (*no dissolution*) të një sendi lëndor.

Mund të vijonim kështu për një kohë të gjatë duke ilustruar jo vetëm përdorimin e **a**-së privative në greqisht që është krejt e njëllojtë si në sanskritisht, por edhe **reduktimin** siç bëmë më lartë të rrënjëve greqisht në operatorë të lirë shqip që bën të mundur motivimin e fjalëve greqisht në shqyrtim, por do të zgjateshim më tepër nga ç'duhej dhe na lejohet në një studim si ky mbi shqipen dhe sanskritishten.

Le të kthehemi pra përsëri tek sanskritishtja **a-gada**.

Kjo fjalë do zbërthyer si:

a ga da

dhe me shqipen:

– **ka dà**

e pra simbolikisht: –ⓘ

Duke dashur të vëmë më mirë në pah rolin ndërmjetësues (motivues, "mesianik") të shqipes, mund të shkruajmë:

i mirë = ○ –● –ⓘ (– **ka dà**)$_{shq.}$ (**a-gada**)$_{sanskr.}$

Simboli në të cilin ne arrijmë kështu dhe që fjala sanskritisht **a-gada** përshkruan "në mënyrë të pavetëdijshme" (me qënë se motivimi është i mundur vetëm me anë të shqipes) duhet të shpjegojë të gjitha kuptimet e kësaj fjale sanskritishte, kuptime që duhet të bëjnë pjesë (si rreze të veçanta) në spektrin semantik (konceptual) të këtij simboli.

Le të shqyrtojmë me radhë këto kuptime:

a) mungesa e *të keqes*, simb. $-\bullet$.

Sipas Algoritmit Simbolik kemi:



Dimë se sipas Algoritmit Simbolik kemi:

$$-\oplus = \bigcirc$$

Simboli i fundit mund të interpretohet, ndër të tjera, edhe si **e tëra**, **e plota**.

Kjo do të thotë se njeriu vështrohet si i shëndoshë kur është **i plotë**, **i tërë** (*pa ndonjë defekt, pa ndonjë dëmtim,* etj., etj.).

Duke qënë kështu kuptojmë përse në anglisht **whole** ka edhe kuptimin e *të tërës* (○) si dhe atë të *shëndet*-it.

Kjo mund të zbërthehet si:

w hole


ku **w** është shqipja **b** (*a, ë...*) (angl. *to do*). Një prefiks i tillë është i rëndomtë në anglisht*.

Pjesa tjetër **hole** lidhet me greqishten **holos** = *e tëra*.

Duke qënë kështu anglishtja (me ndihmën e greqishtes) jep:

---

* Kështu **wreath** = *kurore*, zbërthehet në **w reath** dhe me shqipen **bë** rreth, e pra simb. ○.




(lidhur me **w hole** = *i shëndosh; i shënjtë,* kujto: fr. **santé** = *shëndet,* dhe **saint** = *i shënjtë*)

Le të hapim këtu një parantezë dhe le ta zgjerojmë disi bisedën.

Që **tërësia** lidhet me **mirësinë** këtë na e rikonfermon edhe shqipja me:

mbarë = *tërë, krejt*
i,e **mbarë** = *i mirë*


Pra dhe shqipja jep:



Po shqipja bën edhe më tepër se kaq, dhe vërtetë:

i mbrimun = *i arritur*
i mbaruem = *që ka marrë fund; që është i përsosur.*

Shqipja jep pra kështu një **spektër** shumë të pasur të simbolit ○:



Kemi shtuar këtu edhe **bara**-*zija* sepse kemi të bëjmë me të njëjtin operator të lirë pa prefiksimin me **m** që si në shqip, si në sanskritisht, ashtu edhe në hebraisht dhe në një sërë gjuhësh të tjera është "prostatik", a e thënë ndryshe "a-semantik" ndonëse shpesh herë, dhe mund t'i jepet vlera kuptimore (që nuk ndikon në kuptimin e tërë fjalës) **me** (gr. *syn*-, it. *con*-, rus. *s*-, ...).

Na mbetet tani të "vërtetojmë" ekzistencën e këtij spektri mistikisht.

Ne e dimë që mendimi mistik pozon Qëndrën si kategorinë e tij më të lartë dhe si pikën e tij absolute të referimit.

Nga ana tjetër kemi:

Qëndra = **Coincidentia oppositorium** = $(x = -x)$ = ○ = **Zoti**

Dhe dihet se *vetëm Zoti* (○) është i *përsosur* (*i mbaruem*) dhe *vetëm Zoti* është *i mirë** (*i mbarë*).

Mund të shkruajmë:

$$○ = 1$$

Që mund të interpretohet se ka ***vetëm*** **një** *Zot*, se *Zoti* është **një**:

Vijojmë më tej.

Le të vërtetojmë tani ekuacionin:

○ = **fundi**

mbarë *mbarim*

Me qënë se Gjuha mbështetet në mendimin mistik që është, siç dimë, edhe një mendim simbolik, shfletojmë për këtë fjalorin e simboleve të Cirlot.

Në faqen 40 lexojmë:

> "In all symbols expressive of the mystic Centre, the intention is to reveal to Man the meaning of the primordial ***paradisal state*** and to teach him to identify himself with she Supreme Principle of the Universe."
>
> (Të gjitha simbolet që shprehin Qëndrën mistike, synojnë t'i zbulojnë

* Ungjilli sipas Markut 10:12.

Njeriut ***Gjëndjen Parajsore*** zanafillore dhe ta mësojnë atë të identifikohet me parimin suprem të Universit).

Prandaj pra njeriu (dhe, bashkë me të, tërë Njerëzimi) arrin qëllimin e tij të epërm vetëm kur **mbrin *tek Qëndra***, e pra ***tek Zoti,*** e pra ***tek Gjëndja Parajsore***, e pra simbolikisht tek ○ (e **mbara**).

Ky është **mbarimi** i udhëtimit të tij spiritual: ai bëhet kështu **i mbrīm** (*i arritur, i pjekur* ...), **i mbarūm** (*i përsosur* ...) etj., etj.

b) Le të vërtetojmë tani kuptimin e **bara-zi-s**, do me thënë vërtetësinë e ekuacionit simbolik:

$$○ = (=)$$

Le të rikujtojmë se "*Gjuha emërton në mënyrë zanafillore* (sipas *të Parës*, sipas *të Parit* ...) *sipërore* (*superlative*), *paradigmatike* ...". Ndaj pra dhe në shprehjen gjuhësore të konceptit të *barazimit* ajo do ta "pagëzojë" këtë koncept duke marrë për model ***barazimin maksimal***, *barazimin "par excellence"* që do të thotë *barazimin mes* ***dy kuideve*** *sa më të largëta, sa më të ndryshme* mes tyre e pra barazimin mes "dy të kundërtave".

Por barazimi mes dy të kundërtave shkruhet simbolikisht:

$$(x = -x)$$

dhe kjo është *Coincidentia oppositorum* e pra *Qëndra*, e pra *Zoti*, e pra simboli ○.

Pra gjuha do të zgjedhi për të shprehur konceptin e barazimit një fjalë që do të jetë *homonime* (dhe më pas, me zhvillimin e Gjuhës do me thënë me degradimin e saj nga një gjuhë simbolike në një gjuhë konceptuale: *thuajse homonime*) me atë që shpreh Qëndrën ku ndodh *shkalla më e lartë e barazimit*, ajo mes të kundërtave.

Por:

Qëndra = $(x = -x)$ = ○ = **mbarë** (një interpretim)

Pra atëhere edhe:

(=) = ○ = **bara**zim

Shpjeguam kështu të gjitha interpretimet e simbolit ○ në shqip, duke motivuar thellë, fillosofikisht **homoniminë** e fjalëve që përshkruajnë në shqip rrezet e ndryshme të spektrit të tij semantik.

c) Le të shqyrtojmë tani kuptimin e *thjeshtësisë* (fr. *simple*) që duket krejt pa ndonjë lidhje me të tjerët.

Algoritmi jep:

$$\bigcirc = -\aleph = \textit{jo i ndërlikuar} = \textit{i thjeshtë} \qquad \ldots(\mathbf{E})$$

I ndërlikuar, i përbërë, i ngatërruar, i përzier do të qe siç dimë $\aleph$.

Ekuacioni i mësipërm është një ekuacion simbolik në kodin **E**, të cilin ne e njohim tashmë (*P.Sh.A.S.*). Ai mund të interpretohet, duke qënë se simboli ○ është *Qëndra, Zoti,* edhe si:

Zoti (○) është (=) i thjeshtë ($-\aleph$)

ose edhe, duke interpretuar simbolin $\aleph$ si *lidhje, skllavëri,* $-\aleph$ = *i lirë:*

Zoti (○) është (=) i lirë ($-\aleph$)

Ose edhe, duke interpretuar simbolin ○ si *e vërteta* (me qënë se ○ = *Coincidentia oppositorium* = *Qëndra* = *Zoti* = *E Vërteta* (*e Mbrame, Absolute...*) dhe simbolin $-\aleph$ si *liri,* ne rigjejmë të thënën e famshme të Krishtit në Ungjill (Gjoni 8:32):

Do të mësoni të ***vërtetën*** (○) *dhe e vërteta do t'u bëjë juve* ***të lirë*** ($-\aleph$)

Ose, duke interpretuar ○ si *Qëndër* dhe $\aleph$ si *nyje* rigjejmë këtë të vërtetë themelore të mendimit mistik:

To undo the ***knot*** was ***equivalent*** to finding* the ***Centre***

(Të zgjidhësh ***nyjen*** (–⋈) është ***njëlloj*** (=) si të gjesh ***Qëndrën*** (◯))

E kështu me radhë...

Në përgjithësi, duke u bazuar tek ky shëmbull, si edhe në shumë të tjerë të shpërndarë këtu e atje nëpër faqe të këtij studimi:

> *Ne mund të rigjejmë e të gjejmë një informacion shumë të pasur e të gjithanshëm që prek të gjitha fushat e dijes së lashtë dhe të rè dhe që buron i papenguar nga analiza, "zbërthimi" i energjisë informative që përmban Gjuha, po njëlloj si lënda në zbërthimin e saj bërthamor.*

Por nuk është sigurisht këtu vëndi për t'u zgjatur rreth kësaj çështjeje. Kjo është bërë në studime të tjera të autorit që presin të shohin dritën e botimit si: *"Algoritmi Simbolik e disa zbatime të tij"*, *"Fillosofia e llogjika e Gjuhës"*, etj., studime nga të cilat dhe janë marrë këtu materiale të ndryshme që janë përdorur për **zgjerimin** dhe **thellimin** e çështjeve.

Në rusisht **gad** (*гад*) (si edhe **gad**-*kij* (*гадкий*)) = *i keq, i poshtër, i ndyrë...*

Është e qartë se është fjala prapë këtu për rrënjën sanskritisht **gad** (nga **a-agad** ose anasjelltas...) e pra atëhere shqipja *ka dà...* = ⦶ = ● = *i keq, i poshtër, i ndyrë...*

Mos harrojmë se shqipja shtron ekuacionin simbolik:

⦶ = ● ...(**F**)

me çiftet gjysëm-homonimike:

i ndarë	*i ndyrë*
pjesë	*pis*
felë	*fëlliq*
ndaj	*ndyj*
...	...

* Cirlot: *A Dictionary of Symbols*, fq. 173.

Me qënë se, siç dimë:

$$\bigcirc = (x = -x) = \textit{Coincidentia oppositorum} = \textit{Deus}$$

Simboli ⦶ mund të interpretohet atëhere si *ndarja nga Zoti*; dhe me qënë se simboli ● mund të interpretohet si *e keqja, mëkati,* ekuacioni i mësipërm simbolik mund të interpretohet në mënyrë që të përputhet me përkufizimin klasik (në theollogjinë e të gjitha feve të rëndësishme, duke përfshirë këtu edhe fenë e krishterë) të mëkatit:

"Mëkati (●) është (=) ndarje nga Zoti (⦶)"

Sipas dogmatikës së fesë së krishterë në origjinë të Botës materiale qëndron *mëkati origjinal* (*zanafillor*) që shpesh identifikohet me mëkatin e Adamit dhe Evës që thyen urdhërin e Zotit duke ngrënë nga pema e ndaluar në kopshtin e Edenit (Parajsë). Me qënë se simboli ● mund të interpretohet, nga ana tjetër siç dimë (shih *P.Sh.A.S.*) edhe si *materie*, si *botë materiale*, del se *Bota materiale* (●) mund të vështrohet si e **krijuar** vërtetë nga ky *krim zanafillor*, do me thënë nga ky *mëkat në origjinë* (lat. *peccatum originalis*).

Nga ekuacioni simbolik (⦶ = ●), siç nga çdo ekuacion tjetër simbolik ne mund të nxjerrim një informacion mjaft të pasur që prek çdo sferë të Dijes dhe të Realitetit.

Bie fjala: le ta interpretojmë simbolin ● si *bota materiale* dhe simbolin ⦶ si *kufi*.

Rigjejmë kështu zbulimin e fundit të Kozmollogjisë bashkohëse sipas të cilit Kozmosi *ka një kufi* (është i *fundëm*) *në kohë* (Teoria e *Big Bang-ut* dhe e *Big Crunch*) dhe *në hapësirë* (Teoria e Vrimave të Zeza, *Black Holes*).

Me qënë se:

$$⦶ = -\bigcirc = \textit{jo e tëra, jo e gjitha}$$

(me qënë se simboli ○ ka ndër të tjera edhe kuptimin e të të *tërës*, e *të gjithës*) ne mund të themi atëhere se Bota (*materiale*) (●) nuk është tërë bota (−○),

do me thënë pikërisht atë që pohon për arsyet e mësipërme (ekzistenca e vrimave të zeza) edhe kozmollogjia moderne.

Duke interpretuar simbolin ⦶ si *matje* (çdo *matje* presupozon një *ndarje*) dhe simbolin ● si *lëndë, materie* ne mund të formulojmë këtë gjykim *apodiktikisht* (*llogjikisht, aprioristikisht!*) të vërtetë:

"**Materia** (çdo *send* material) (●) **është** (=) **e matshme** (⦶)"

Por nga ana tjetër ne mund të shkruajmë edhe:

$$-\bullet = -\circledcirc \qquad \ldots(\mathbf{E})$$

ekuacion simbolik që del, me një shumëzim të të dy krahëve me (-1), nga ekuacioni i mësipërm.

Kjo atëhere na lejon që të saktësojmë gjykimin tonë:

"**Materia dhe vetëm materia është e matshme**"

Kështu koncepti i **matjes** dhe ai i **mater-ies** mund të identifikohen, siç ndodh bie fjala në sanskritisht ku:

matra = materie (●)
matra = matje (⦶)

Ashtu, ndër të tjera, edhe në italisht **materia** dhe **metro**.

Nga sa më sipër del qartë që për një "*send*" jo material *matja* është e *pamundur*. Por dihet se: – **materie** = **Frymë**.

Pra atëhere:

"**Fryma s'ka masë**"

Pamundësia e matjes (e një matje të saktë) ndeshet në Fizikën e sotme

Kuantike ku, në nivelin e thellë subatomik, çdo matje e saktë është e pamundur*.

Kjo i bën jehonë aforizmës shqipe:

"Çdo matje është e metë"

që ndërtohet mbi gjysëm-homoniminë **mat-met**.

Pamundësia e matjes (të saktë) në nivelin e thellë subatomik, parashikohet nga Algoritmi Simbolik (Strukturizim llogjik i mendimit mistik!) fare lehtë. Dhe vërtetë:

Fizika Kuantike = *parimi*
i papërcaktueshmërisë (Heisenberg) = $-\oplus$ = *jo matje*

Duke qënë kështu ne pra mund të themi:

Fizika Kuantike = *fizika e thellësisë ekstreme të materies* =
– matje = $-\oplus$ = ***E***

Por Algoritmi Simbolik jep gjithashtu:

$-\oplus$ = ***E*** = $-\bullet$ = **jo materie** = *boshllëk* = **vakuum**

Pra në thellësinë ekstreme të materies duhet të mos ketë më lëndë, duhet të ekzistojë një **vakuum**. Dhe vërtetë Fizika kuantike na provon se **sub-stanca**

---

* Fizika Kuantike ngrihet e tëra si mbi themelin e saj mbi *Parimin e Papërcaktueshmërisë* (angl. *Uncertainty Principle; Principle of Indeterminism*). Sipas këtij parimi nuk është e mundur të njihet (**matet**) me tërë saktësinë e duhur në të njëjtën kohë si pozicioni (vënd-ndodhja) e grimcës ashtu edhe momenti i saj i quajtur edhe "impuls" që përcaktohet si **m . v** (masë shumëzuar për shpejtësi) dhe tregohet zakonisht me **p**. Ky parim që u zbulua më **1927** nga Werner Heisenberg (1901-76) formulohet zakonisht në këtë trajtë:

$$\Delta x . \Delta p_x \geq {}^{h}/_{4}\,\pi$$

ku Δx përfaqëson gabimin që mund të bëhet në njehsimin e koordinatës x (pozicionit) të grimcës, kurse Δp_x është gabimi që mund të bëhet në njehsimin e komponentes x (sipas boshtit të abshisave) të momentit të grimcës; **h** është konstantja e Planckut (e barabartë me raportin e energjisë të një kuanti të energjisë mbi frekuencën e saj **v**; do me thënë:

$$h = E / v$$

Vlera e saj është **6. 626176 x 10^{-34} Js**)

e fundme, e mbrame e materies është fusha e **vakuumit**.

Vëmë rè me këtë rast se *fusha e vakuumit* e Fizikës moderne nuk është tjetër veçse *The mystic void* (*boshllëku mistik*) i Mendimit Mistik, koncepti i të cilit përputhet me atë të Qëndrës Mistike. Ky është *një rast tjetër, nga të panumërtat, e përputhjes së koncepteve dhe parimeve bazë të shkencës moderne (këtu fizika moderne) me konceptet e parimet themelore të Mendimit Mistik*. Kjo e bën të mundur, me atë sukses të çuditshëm që vihet rè, edhe zbatimin e Algoritmit Simbolik (strukturizim llogjik i Mendimit Mistik!) dhe, për pasojë edhe atë të informacionit që nxirret nga analiza etimollogjike - fillosofike - llogjike e Gjuhës (si për shëmbull e gjuhës shqipe)* në fushat e ndryshme të Dijes.

Dhe le të kthehemi pas këtij disgresioni disi të gjatë tek sanskritishtja:

a-gad

Në sanskritisht kemi gjithashtu:

gada - m. *maladie* (*sëmundje*)

Ne arritëm në përfundimin se:

$$(\mathbf{gada})_{\text{sanskr.}} = (\mathbf{ga\ da})_{\text{sanskr.}} = (\mathbf{ka\ dà})_{\text{shq.}} = (\mathbf{DA}) = \text{⦶} = \bullet$$

= *e keqja, të keqtë, e liga, ligështia, sëmu**ndja*** (fr. *maladie*)

Le të kërkojmë tani të tjera rikonferma të këtij ekuacioni (**gada** = **ka DA** = ⦶ = ● = *e keqe*, ...), nëpërmjet vetë sanskritishtes ashtu edhe nëpërmjet gjuhësh të tjera.

Në sanskritisht:

KAD - fr. *détruir* (*shkatërroj*)

---

* Studimet e Leshan, Fritjof Capra, David Bohm ... si edhe të shumë shkencëtarëve dhe fillosofëve të shquar të Kohës sonë e rikonfermojnë në mënyrë tepër bindëse lidhjen e Fizikës moderne me Mendimin Mistik të Lindjes.

Duhet parë në këtë fjalë shqipja **ka dà**.

Në qoftë se *sendin material* e tregojmë me simbolin ●, simbolet  ose $^{\bullet}/_{2}$ që tregojnë **damjen** janë të gjitha ekuivalente me:

$-\bullet$ = *jo më send material, shkatërrimi (asgjësimi) i sendit material...*

Dhe me qënë se $-\bullet = \bigcirc$ = **hiçi**, *sendi material* kthehet kështu në **hiç** (që nga dhe lindi $-\bigcirc = \bullet$).

Vëmë rè me këtë rast edhe sa vijon:

Në shqip fjala **thurr** jepet simbolikisht me . Sipas një miti kozmogonik, bota është ndërtuar me një *thurrje* të dy parimeve (*mashkullor, qiellor, 3;* dhe *femëror, tokësor, 2*). Duke treguar botën materiale me simbolin ●, kjo që thamë shkruhet:

 = ● ...(**F**)

Thurrja e dy parimeve — *Bota materiale*

Duke qënë kështu, ne mund të mendojmë se në shqip fjala *shkatërrim* dhe *çngatërrim* janë e njëjta fjalë.

Dhe vërtetë:

çngatërrim = $-$*ngatërrim* = $-$

shkatërrim = $-\bullet$

Kështu shqipja shtron ekuacionin simbolik:

$-$ = $-\bullet$ ...(**E**)

çngatërrim — *shkatërrim*

Duke shumëzuar të dy anët e këtij ekuacioni me (-1), ne rigjejmë ekuacionin e mësipërm të *Hieros Gamos* (të krijimit të botës nëpërmjet një Martese të Shënjtë mes dy parimeve, atij mashkullor dhe atij femëror). Kjo

rikonfermon saktësinë mistike të ekuacionit të fundit.

Duke qënë kështu, frëngjishtja **détruir** mund të zbërthehet në:

dé tru ir

ku: **-ir** - është një sufiks foljor e pra pa ndonjë vlerë semantike të mirëfilltë
dé - (edhe *des*) është shqipja, *dà*, *dasí*, e pra simb. ½
tru - është shqipja *thurr*, e pra simb. ⊗

Atëhere kemi:

$$\textbf{détruir}_{fr.} = \ldots \textbf{thurr}_{/2} = \otimes_{/2} = -\otimes = \textit{çthurrje, çngatërrim, shkatërrim}$$

Vëmë rè me këtë rast edhe sa vijon:

Në shqip **therr** dhe me qënë se gjuha referon gjithnjë tek *e Para*, tek *Ngjarja e Parë* (*par excellence*), e pra tek *Krijimi i Botës*, sikundër që e kemi parë, *i therruri* këtu është *Hyjnia* (*Sakrifica Kozmogonike*) e pra simb. ○. *Therrja* pra atëhere do të paraqitet si −○.

Kjo ***therrje*** (−○) bëri të mundur ***thurrjen*** (⊗) e *botës materale* (●) sepse kemi:

$$-\bigcirc = \otimes = \bullet \qquad \ldots\textbf{(F)}$$

gjë kjo që rikonfermohet nga Mendimi Mistik.

Duke qënë kështu shqipja mund të formulojë këtë gjykim (aforizëm):

"Nga therrja, thurrja..."

që flet bukur e shkurt për mitin e kozmogonik të ***thurrjes*** së *botës materiale* nga ***therrja*** e *Hyjnisë*.

Vazhdojmë më tej: **kad**, funksionon në sanskritishte si një farë parashtese

që u jep fjalëve që u përgjigjet një kuptim *keqësonjës* (fr. *péjoratif*) e pra simbolikisht ●. Ja një shëmbull:

kadvada - a. *qui parle mal* (mb. *që flet keq*)

Pra dhe këtu:

kad = $(\textbf{ka dà})_{\text{shq.}}$ = ⏀ = ● = *keq, keqësonjës ...*

Vëmë rè me këtë rast se në shqip *kuvet*, me ***kuvet*** (*me bisedue, me folë*) lidhet nëpërmjet shqipes *vet* me sanskritishten **vada**.

Në sanskritisht gjithashtu:

kadana - nt. *déstruction* (*shkatërrim*)

Mund të përsërisim ato që thamë për **kad**.

$(\textbf{kadana})_{\text{sanskr.}}$ = $(\textbf{ka dana})_{\text{sanskr.}}$ = $(\textbf{ka dān})_{\text{shq.}}$ (folja me **dà**) = $\bullet/_{2}$

= –● = shkatërrim, asgjësim, hiçësim (–● = ○ = **hiçi** ...)

Vëmë rè se **dān** është pjesore e foljes **daj**, një trajtë e shkurtuar (e reduktuar) e saj nga:

damun **dān**

si edhe gjithashtu:

thamun **thān**
lamun **lān**
etj., etj.

Që punët qëndrojnë vërtetë kështu me **dān**, e rikonfermon fakti se në këtë trajtë (të reduktuar) pjesorja e foljes **daj** është përdorur në një sërë fjalësh me kuptime të përafërta, si për shëmbull **dën**-oj fjalë kjo që paraqitet simbolikisht

si ⏀ sikundër që e dimë, e pra përshkruhet edhe ajo nga **damun** që është pjesore e plotë (e pa reduktuar) e foljes **daj**.

Vëmë rè më në fund lidhur me këtë çështje se, për shëmbull, **lamun** duhet zbërthyer si **là jamun** (*jamun* këtu: folja *jam, me qënë*).

jamun i sufiksuar në këtë mënyrë ndeshet rëndomtë në greqishten **-menos**, si bie fjala në fjalën **kajmenos** = *i mjeri, i shkreti,* që është bërë *për të qarë hallin*. Kjo fjalë do zbërthyer me shqipen si:

kaj jamun (*jam kjà, jam qarë...*)

ku **kaj** (angl. *to cry*) është trajtë e lashtë dhe dialektike (në Veri, në Kosovë...) e **qaj**. Evolucioni i kësaj fjalë ka ndjekur ndoshta këto faza:

kaj klaj kjaj qaj

Vijojmë më tej:

kaḍāra - a. *brun, tanné* (*i zeshkët, i nxirë*)

Pra simbolikisht ●. Pra shqipja jep:

i zeshkët, i nxirë = ● = ⏀ **(ka darë)**$_{shq.}$ **(kaḍāra)**$_{sanskr.}$

Në sanskritisht gjithashtu:

kadru - a. *brun, tanné* (*i zeshkët, i nxirë*)

Dhe arsyetimi është njëlloj si në rastin e **kaḍāra**. Në pothuajse të gjitha shëmbullat e mësipërme çështja ishte të provohej se:

$$\begin{cases} \mathbf{K}(a)\ \mathbf{D}(a, \text{-}ara, \text{-}ana\ \ldots) \\ \mathbf{G} \end{cases}$$

të sanskritishtes zbërthehen me shqipen **ka dà** (*darë, dan,* etj.) e pra simbolikisht me ⦶, zbërthim që motivonte kuptimet e fjalëve përkatëse.

Por në vënd të **d**-së (*dhëmbore* e zëshme) mund të kemi edhe **t** (*dhëmbore* e pazëshme). Edhe në këtë rast fjala sanskritishte do të tregojë një **ndarje**, a pasojat e një **ndarjeje**.

Shqyrtojmë pra disa shëmbulla të tilla:

kati - adv. *combien? Quelques; plusieurs*
(*sa? disa; më tepër se një ...*)

Sjellja tek shqipja dhe tek simboli shpjegues bëhet si vijon:



⦶ = **(ka dà)**$_{shq.}$ = **(ka ti)**$_{sanskr.}$ = **(kati)** $_{sanskr.}$

Algoritmi simbolik jep:

⦶ = -1 (*jo një*) = $\not X$ (*disà*)

Vërë rè se në shqip kemi:

dasì = ⦶
disà = $\not X$

Pra shqipja shtron kështu ekuacionin simbolik:

$$\underset{dasì}{⦶} = \underset{disà}{\not X} \qquad \ldots\textbf{(F)}$$

Ne shohim kështu se shqipja na mëson ndër të tjera se **sasia** përftohet si një **dasì** (*ndarje*(⦶)) e *njëshit* ($\not X$) a ç'është njëlloj e simbolit ○, simbol ky që është ndër të tjera ai i *infinitit*, i të *gjithës*, i *zeros*, i *Qëndrës*, i *Zotit*... Kjo dhe i ka shtyrë popujt e lashtë të mendojnë se Bota, me larminë e shumësinë e saj është krijuar nga ***therrja*** *e Njëshit* ($-1, -○$) dhe *ndarja e tij* (*e Hyjnisë*) në pjesë të ndryshme (⦶, $\not X$) me të cilën u krijuan sendet e ndryshme të botës (pemë,

male, dete, etj., et.). Pra shqipja me ekuacionin simbolik:

$$-\bigcirc\ (-1) \quad = \quad \underbrace{\aleph \quad = \quad \bullet \ldots}_{} \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

Therrja *e Njëshit* (*Hyjnisë*) **thurrja** *e botës materiale*

na flet për *krijimin e Botës.*

Gjithashtu në sanskritisht:

katipaya - *quelques, plusieurs* (*disa, më shumë se një*)

Do zbërthyer si:

kati paya

dhe me shqipen:

baj (*paya*) ka **dà** (*kati*)

e pra *ka Dà*, e pra *Da*, e pra ⏀, etj., etj.

Në sanskritisht gjithashtu:

ghaṭā - f. *multitude; groupe* (*shumicë; grup ...*)

Do zbërthyer si:

gha ṭā

dhe me shqipen:

ka dà

e pra simb. ⏀.

E pra, për ekuivalencë simbolike:

$$\text{⏀} \quad = \quad -1 \text{ (jo një)} \quad = \quad \aleph \text{ (më shumë se një, shumë...)}$$

Në të gjitha shëmbullat e mësipërme u pa se *operatori* (= *rrënja e pastër, e thjeshtë ...*) *signifikatif* (*kuptimplotë, semantik, që ka vlerë sememe ...*) ish kudo

DA (*dan, ta, ti, dar*... etj., etj.) që shpinte tek simboli ⌀ dhe interpretimet e ndryshme të tij.

Para tij (si një farë prefiksi që s'mbante peshë semantike të mirëfilltë) vinte **ka, kha**, ... **gha** ... që ne e identifikuam me shqipen **ka** (folja *kam*).

Por prefiksimi i operatorit **DA** në sanskritishte mund të bëhet edhe me mënyra të tjera. Si bie fjala me *BHA, BHE* ... që lidhen me sanskritishten **BHA** = *baj* (fr. *faire*), sikundër edhe me shqipen **Ba**(j) gjithëpo me atë kuptim.

Le të marrim ndonjë shëmbull të tillë:

Bheda - m. *fait de briser, de rompre; division, séparation; discorde ...; variété; corruption* (*thyerje; pjesëtim, ndarje; grindje, mosmarrëveshje; larmi; korruptim ...*)

Kjo fjalë do zbërthyer në:

Bhe da dhe me shqipen *bë dà*

e pra, përfundimisht, **DA** dhe simbolikisht: ⌀.

Nga ky simbol dhe nga ekuivalencat e tij duhet të përftohen të gjitha kuptimet e sanskritishtes **Bheda**. Le ta provojmë:

$$
\begin{aligned}
(\textbf{Bheda})_{\text{sanskr.}} &= (\textbf{Bë da})_{\text{shq.}} = (\textbf{Dà})_{\text{shq.}} \\
&= \oplus \ (\textit{ndarje, pjesëtim}) \\
&= \text{ß} \ (\textit{grindje, mosmarrëveshje}) \\
&= -1 \ (\textit{jo një, jo njëlloj, të ndryshme...}) \\
&= \not{X} \ (\textit{disà}) \\
&= \sim \ (\textit{ndryshim, fr. variation...}) \\
&= \varsigma \ (\textit{korrupsion, degradim...}) \qquad \ldots (\textbf{F})
\end{aligned}
$$

Kështu pra falë shqipes si edhe Algoritmit Simbolik (që mund të nxirret i gjithi nga shqipja si edhe, ndonëse jo po aq lehtë, edhe nga çdo gjuhë tjetër); ne vihemi në gjëndje të shpjegojmë (motivojmë) të gjitha kuptimet e kësaj fjale sanskritisht.

Le të vëmë rè tani se fjala fr. **corruption** rrjedh nga latinishtja **corrumpo** = **con+rumpo** ku *con* është një prefiks afirmues, pra me vlerën *+1* dhe që pra si i tillë mund të mos merret parasysh, ndërsa **-rumpo** në latinisht do të thotë *me thye*. Pra një njeri i *korruptuar* është një njeri *i thyer, i thyeshëm* dhe pra simboli ✗ (*thyerja e njëshit*) është krejt adekuat për këtë kuptim, sikundër dhe simboli ekuivalent me të ♀ që tregon **ram**-*je, dekadencë, poshtërsi*...

Vëmë rè me këtë rast edhe sa vijon:

a) tek frëngjishtja *rompre* (lat. *rumpo*) mund të shihet shqipja **rām bër**, e pra simboli ♀.

b) shqipja mbulon fare mirë një pjesë të ekuivalencave të mësipërme, sepse kemi:

Në shqip:

⊕	=	●	=	♋	=	✗	...(**F**)
dasì		*n-dysì*		*n-desh-je*		*disà*	

Duke u mbështetur në sa më sipër, ne mund të mendojmë se anglishtja **bad** (*i keq*) shpjegohet me shqipen:

i keq = ● = ⊕ = **(ba dà)**$_{shq.}$ = **(ba d)**$_{angl.}$ = **(bad)**$_{angl.}$

Gjithashtu edhe rusishtja **bedà** (*бедà*) = *e keqe, fatkeqësi, mënxyrë* mund të motivohet nga shqipja gjithë po në atë mënyrë:

mënxyrë
fatkeqësi
e zezë

= ● = ⊕ = **(bë dà)**$_{shq.}$ = **(bedà)**$_{rus.}$

Shqipja shtron ekuacionin simbolik:

$$\underset{i\ dātë}{\oplus} = \underset{i\ dytë}{2} = \underset{i\ n\text{-}dytë}{\bullet} \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

Ekuacionin:

$$\oplus = 2 \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

që është në përputhje të plotë me Algoritmin Simbolik (strukturizim llogjik i Mendimit Mistik!) e gjejmë edhe në shumë gjuhë të tjera.

Kështu për shëmbull në italisht:

secondo (*i dyti*) = *2*
secante (nga **secare** = *me prè*) *prerëse, sekante,* e pra simb. ⊕.

Shqipja e shtron këtë ekuacion të rëndësishëm simbolik edhe me:

$$\underset{dasì}{\oplus} = \underset{dysh}{2}$$

Një sërë gjuhësh të tjera e shtrojnë këtë ekuacion me ndihmën e shqipes, Kështu për shëmbull, në rusisht:

vtoroj (*втopoй*) = **i dyti** = *2*

Kjo fjalë ndahet në:

v tor oj

dhe me shqipen **bë dar** ose edhe:

bë thyer


e pra simbolikisht ⊕ ose edhe χ.

Kështu edhe ajo, rusishtja, shtron me ndihmën e shqipes, ekuacionin e rëndësishëm simbolik:

$$2 = \text{⏀} \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

vtoroj *bë dar*
bë thyer
bë ther

Në gjermanisht: **andere** (*tjetri*), e pra *jo i pari* (jo *njëshi*) po *i dyti* (*dyshi*), e pra simb. *2*. Kemi:



Në anglisht:

other = *tjetri, jo i pari, i dyti* (*2*)

Motivohet me shqipen në këtë mënyrë:



Vërejmë se në rastin e anglishtes *other* që sillet siç pamë tek shqipja *â ther*, del dhe më qartë se si përftohet *i dyti* (*i ndyti*, ●) dhe pra edhe si **lindi lënda** dhe vetë bota lëndore: me **lëndimin** e Hyjnisë, me **krymjen e krimit** të **therrjes** *të të Parit, të Hyjnisë,* gjë që është në përputhje të plotë me mitet kozmogonike të popujve të lashtë.

Kështu tek Cirlot (fq. 64) lexojmë:

> ***Cosmogony***. The basic of most cosmogonies is the *cosmic sacrifice*, expressing the idea that the creation of form and matter can take place only by modifying primordial energy. Such a modification, so far as most primitive and protohistoric people are concerned, was seen to exist in such painful forms as mutilation, struggle or sacrifice. In Babylonian cosmogony it assumed the form of the **killing** of the original mother **Tiamat** (the dragon), whose body was used in the creation of heaven and earth. Hindu tradition links the struggle of the gods with a tribe of devils called Asuras, or with

monsters of some other kind. According to the Rigveda, the gods would sacrifice a primeval being- the giant Purusha...

(Në themel të pjesës më të madhe të kozmogonive qëndron ideja e *sakrificës kozmike*, sipas të cilës krijimi i formave dhe i lëndës mund të bëhet vetëm me një modifikim të energjisë primordiale. Një modifikim i tillë, pranë popujve primitiv dhe protohistorik, mirrte trajtën e dhimbshme të gjymtyrimit, të luftës ose të flijimit. Në kozmogoninë babilonase ish fjala për **vrasjen** e nënës zanafillore **Tiamat** (dragoi) trupi i së cilës shërbeu për krijimin e qiellit dhe tokës. Traditat hindiane flasin për luftën e perëndive kundër një fisi djajsh të quajtur Asuras ose me përbindësha të ndonjë lloji tjetër. Sipas Rigvedës, perënditë flijuan një qënie të hershme, gjigantin Purusha...)

Ne pamë me shëmbulla nga sanskritishtja si edhe nga një sërë gjuhësh të tjera rikonfermimin gjuhësor të ekuacionit simbolik:

$$\text{⦶} = 2$$

Kjo do të thotë se ajo që mund të thuhet mistikisht për simbolizmën e numrit *2* vlen edhe për simbolin ⦶.

Lidhur me simbolizmën e numrit *2* tek Cirlot (fq. 232), siç është parë edhe gjetkë, thuhen ndër të tjera edhe këto:

Two: "...it is also symbolic of the first nucleus of the *matter*, of nature in opposition to the creator... In all esoteric thought *two* is regarded as *ominous*... it connotes *shadow* and the bisexuality of everything, *dualism*... "

(**Dy**: ...simbolizon gjithashtu bërthamën e parë të *lëndës*, natyrën në kundërvënje me krijuesin... Në të gjitha përfytyrimet ezoterike *dyshi* vështrohet si një numër ogursëz... ai lidhet me *hijen* dhe me biseksualitetin e gjithshkaje, me *dualizmin*...)

Pra, ndër të tjera, simbolikisht:

$$2 = \bullet = \text{Ω} = -\bigcirc = \begin{matrix} -God \\ -good \end{matrix} \quad ...(F)$$

two *shadow ominous matter* *conflict* *opposition to the Creator*

E njëjta gjë pra mund të thuhet edhe për simbolin ⊕ që mund të përfshijë kështu tërë simbolizmën e numrit *2* e pra dhe tërë spektrin semantik të këtij simboli.

Duke e *shpënë* (*reduktuar*) fjalën sanskritishte **doşa** tek shqipja **dysh** ose, ç'është njëlloj për efekt simbolizmi, tek shqipja **dasí**, kjo është arsyeja që kemi në sanskritishte:

doşa - m. (*nt.*) *défaut... vice, faute, erreur, manquement... péché, tort, transgression, crime, outrage, dommage, effets désastreux, conséquence fâcheuse; malignité, méchanceté...*
(*defekt, e metë, ves, gabim, mungesë... mëkat, padrejtësi, transgresion, krim, ofezë... dëm, pasojë katastrofale... ligësi...*)

Vetëm në këtë mënyrë (duke e *shpënë* fjalën **doşa** tek shqipja **dysh** ose **dasì**...) mund të *shpjegohet* (motivohet) tërë larmija e kuptimeve të saj në dukje kaq të ndryshme por që lidhen me një segment të spektrit semantik të bashkësisë së figurave simbolike në ***F***.

Lexonjësi do të jetë në gjëndje, shpresojmë, ta bëjë këtë vetë, duke u mbështetur në të gjitha ato që janë thënë më parë (shih ndër të tjera edhe N*jë parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik*). Prandaj pra dhe nuk po zgjatemi më tej.

Por le të ndalemi pak, sidoqoftë, tek informacioni a mesazhi fillosofik, theollogjik e mitik që fjala sanskritishte **doşa** me tërësinë e spektrit të saj semantik (që shqipja na lejon ta çlirojmë e ta justifikojmë) na përçon.

Ne pamë se numri ***dy*** (*2*) (shih më sipër citaten nga Cirlot) simbolizonte në të njëjtën kohë si **materien** ashtu dhe të **keqen**.

Nga kjo del, sipas Mendimit Mistik, se *Bota është e keqe*, se Bota është një

mashtrim (në fillosofinë e lashtë hindiane: një gënjeshtër, një iluzion i Mayas) si edhe, duke u mbështetur në sa më sipër (në kuptimet e ndryshme të fjalës sanskritisht **doṣa**) se ajo është *defektoze*, se ajo është e *gabuar*, e *gënjeshtërt*, *mëkatare* (e lindur nga një mëkat, *mëkati origjinal, peccatum originalis* (sipas theollogjisë së krishterë) se ajo është *e padrejtë*, se ajo është *kriminele* (e lindur siç është nga një **krim**, që përputhet me mitin e Sakrificës Kozmogonike dhe që shpjegon përse në shqip **krim** dhe **krymje** (*krijim*) përbëjnë një çift gjysëm-homonimik, etj. etj.), se ajo është fyese për Zotin (me qënë se *Bota* = ● = $-\bigcirc = -(x = -x) = -$**Qëndra** $= -$*Coincidentia oppositorum* $= -$*Deus*...; ndaj pra dhe Krishti predikon në Ungjill mosdashurinë për Botën materiale dhe parathotë fundin e saj...), se ajo është plot me ***ligësira***, me *keqësira* e *vojtje*, se dashuria për të është e ***dëmshme*** për njeriun, se ajo (*bota*) është një pasojë ***katastrofale*** në theollogjinë judaike e të krishterë të mosbindjes të Adamit dhe Evës në kopështin e Edenit për të mos ngrënë pemën e ndaluar të dallimit të së mirës nga e keqja... e kështu me radhë.

Lexuesi mund ta plotësojë e pasurojë këtë "kuadro klinike" të Botës (sipas pikëpamjes së Mendimit Mistik, do me thënë Weltanschauung-ut të lashtë mbi themelin e të cilit bëhet i mundur sajimi i Gjuhës dhe i gjuhërave...) me të tjera e të tjera detaje, thellësia dhe larmija e të cilave do të mvarej nga kultura e dijet e tij të gjithanshme. Por ne po e lëmë me kaq se, duke u zgjeruar pafund këtu e atje, do të ishte e pamundur t'i vihej një kufi këtij studimi të cilit, në fakt, vetëm artificialisht mund t'i vihet një cak e një kufi, me qënë se Mendimi Mistik me të cilin ai përpiqet të **shpjegojë**, lidhet, përmes *Qëndrës*, me **infinitin***.

...

aṇḍa - nt. *oeuf, testicule* (*veze, koqe*)

Do zbërthyer si:

a ṇḍa

dhe, me shqipen:

â ndá = ⓘ

---

* **Qëndra** = $(x = -x)$ = ○ = *e gjitha* = ∞ = *infiniti*; shih lidhur me këtë edhe: *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik.*

Algoritmi Simbolik jep:

$$\text{⦶} = (x = x) = (x^2 + y^2 = r^2) = (x^3 + y^3 + z^3 = r^3) = \textit{sferë} = \text{◍}$$

e pra dhe **Vé**. Pra, duke përmbledhur:

$$\text{◍} = \text{⦶} = (\textbf{â nda})_{\text{sh.}} = (\textbf{a ṇḍa})_{\text{sanskr.}} = (\textbf{aṇḍa})_{\text{sanskr.}} = \textit{vé}$$


aṇḍabhedana - nt. *brisement de l'oeuf* (*thyerje e ve-s, e vez-ës*)

a ṇḍa bhe dana

Dhe me shqipen:

◍	=	⦶	...(F)
â ndà		**bë dān**	
(*veja*)		(*ndarja e ve-së*)	

Pra përfundimisht:



Në sanskritisht gjithashtu:

aṇḍagata - *qui est dans l'oeuf* (*që gjëndet brënda në vé*)

Do zbërthyer si:

a ṇḍa **ga ta**

◍ **(ka dà)**$_{\text{shq.}}$ = ⦶ = ***F*** = ⊡

ose edhe:


⊠ = *brënda*

Pra tërë fjala jepet simbolikisht si:



brënda vesë

Ose në një simbol të vetëm:



Rikujtojmë se shqipja **brënda** do zbërthyer si:

br enda

e pra:

bër â ndà = ⊕ = ⊡ = ⊠

Vëmë rè lidhur me këtë, do me thënë lidhur me simbolizmën e *vezës* e pra të **ve**-së së Botës, tek Cirlot (fq. 94) ndër të tjera edhe sa vijon:

> "**Egg**: A great many prehistoric tombs in Russia and Sweden have revealed clay eggs which had been left there as emblems of immortality. In the language of Egyptian hieroglyphs, the determinative sign of the egg represents potentiality, and the seed of generation, the mystery of life. This meaning persisted among the alchemists, who added explicitly the idea that it was the container for matter and for thought. In this way was the transition effected from the concept of the egg to the **Egg** of the **World**, a cosmic symbol which can be found in most symbolic traditions-Indian, Druidic, etc... The Easter egg is an emblem of immortality which conveys the essence of these beliefs. The golden egg from which Brahma burst forth is equivalent to *the Pythagorean **circle** with a central point (or hole)*."
>
> (**Ve**-ja: Në një numër të madh varresh parahistorike në Rusi dhe në Suedi janë zbuluar **ve**-zë prej argjile që janë lënë atje si emblema pavdekshmërie.

Në gjuhën e hieroglifeve egjiptiane, shënja karakteristike e vezës është *potencialiteti, fara e gjenerimit, misteri i jetës*. Këtë karakteristikë të vesë e gjejmë edhe tek alkimistët të cilët shtuan mbi këtë edhe diçka tjetër: idenë se ve-ja ishte si një enë brënda së cilës përmbahej materia dhe mendimi. Realizohej në këtë mënyrë kalimi nga koncepti i ve-së në atë të **Ve**-së së **Botës**, një simbol ky kozmik që ndeshet ne shumë tradita simbolike hindiane, Druidike etj... Veja e Pashkës është një emblemë pavdekshmërie që përçon esencën e këtyre besimeve. Veja e Artë që nga brënda së cilës Brahma (Perëndi kryesore hindiane - shën. i përkth.) shpërtheu jashtë është e barazvlefshme *me **rrethin** e Pitagorës me një pikë qëndrore (vrimë)*...)

Sa më sipër *justifikon* figurat tona simbolike që barazojnë *venë* me *rrethin* (*sferën*) dhe me *qëndrën* si një *pikë* (*vrimë*) *brënda* (⊙= *Qëndra, pikë, vrimë*...)

ati-gambhīra - a. très *profond, mystérieux;* très *grave*
(*shumë i thellë, i mistershëm, shumë i rëndë*)


Do zbërthyer si:

a ti gam b hīra

dhe me shqipen:

â tej kam bâ hyrë

E pra simbolikisht:



Algoritmi Simbolik jep:

⊡ = ● = ♀ ...(**F**)

Pra atëhere edhe:

♀ ⋙ = **â tej randë** (fr. *grave*)

Le të japim ndonjë sqarim dhe le ta zgjerojmë disi bisedën:
Fjala **myster** do zbërthyer si **my ster**, dhe me shqipen:

me shtir (fr. *enfoncer, mettre dedans...*)

gjë që simbolikisht jep pikërisht ⊡, e pra edhe:

⊡ = ***F*** = ● = **ster**$_{shq.}$ (*i zi, i errët...*)

Pra **misteri** është diçka shumë e thellë (shumë e *shtirë* dhe e *vështirë*), ai është *e vërteta e mbrame* që për ne njerëzit, qënie të vdekshme dhe të kufizuara, është tepër i *errët* (shq. *sterr*).

Është e tepërt të shtojmë këtu se **misteri**, ky send kaq *i thellë, i rëndë* dhe *i errët* për ne, s'është tjetër veçse **Zoti** (*Qëndra*, etj, etj.).

ati-gahana - a. très *profond* (*shumë i thellë*)

Do zbërthyer si:

a ti ga hana

dhe me shqipen:

â tej ka hyn (*ka tej hyrë ...*)

e pra simbolikisht:

⊡ = ♀ ⋙

etj., etj.

ati-guru - a. *plus important* (*que*) (*më i rëndësishëm se...*)

Është shqipja:

â tej gur

Fjala frëngjisht **important** lidhet brënda frëngjishtes me **porter** = *me bar, me mbart...* dhe pra me shqipen ***bart*** (sanskr. *bharta*) e më në fund me shqipen **barra** (*pesha*, gr. *város* (*βαρος*) = *i rëndë*).

Fjala frëngjisht **grave** lidhet me shqipen **guri** si *sendi më i rëndë* par excellence (rikujtojmë se Gjuha emërton sipas të *Parit, Zanafillorit,*

Superlativit... do me thënë sipas atij (asaj) që e ka një cilësi - cilësinë, vetinë që fjala emërton - në shkallën më të lartë!). Në shqip: *gur i rëndë!* (= *tepër i rëndë*). *Guri* pra si prototipi i rëndesës, prandaj pra dhe në sanskritisht **guru** qëndron për *peshë*, për *rëndesë*.

ati-PĀ - *faire boir a l'excès* (*i jap të pije dikujt me tepricë*...)

Është shqipja:

â tej PI

ati-nirdaya - a. *sans aucune pitié* (*pa asnjë mëshirë*)

Vëmë rè paraprakisht se **nir** = *– 1* (krahaso edhe me shqipen **nuk**...).
Kemi atëhere:

a ti nir daya

dhe me shqipen:

â tej nuk dua (që nuk do fare, aspak)

a-kathita - a.v. *non mentionné*
(*që nuk është përmendur, që nuk është thënë*...)

Do zbërthyer si:

a ka thita

dhe me shqipen:

– **ka thotë** (ose **thātë**)
– **thotë** (fr. *non mentionné*)

Vërejmë me këtë rast se ne kemi folur për ekzistencën në shqipen e lashtë të një pjesoreje në **āt**.

Kështu:

ka **pas**	*ka* **pāt**
ka **la**, lamun	*ka* **lāt** (*asht lāt, i lāt*)
ka **thà**, *thamun*	*ka* **thāt** (*i thātë*, si pjesore e adjektivuar)

ka **rà**, *ramun* *ka* (*asht*) **rāt**
etj., etj.

aṃça - m. *part, partie, morceau, division* (*pjesë, copë, ndarje...*)

Do zbërthyer si:

aṃ ça

Dhe me shqipen **jam ça**, e pra simbolikisht ⊕ e pra ◖ ose ◗, e pra vërtetë *copë, pjesë,* etj.

Vëmë rè me këtë rast se në rusisht: **çast** (*часть*) = *pjesë, copë* dhe është shqipja **ça asht** e pra ⊕ e pra ◖ etj. etj.

a-kṛta - a.v. *non fait, non travaillé, non mur; incréé* (*që s'është bërë, që s'është punuar; që s'është pjekur* (*i pabërë*); *i pakrijuar ...*)

Me shqipen, duke qënë se **a** = –, – **krytë**, d.m.th. *i pakryt, i pakry, i pakryer, i pabërë* (*i papjekur*).

Vëmë rè kështu, ndër të tjera, se fr. *créer* (lat. **cre**-*are*) rrjedh nga sanskritishtja **kṛ** a shqipja *kry, kryej,* etj.

a-kṛta-in - a. *qui n'as pas atteint son but*
(*që s'ja ka arritur qëllimit, që s'ja ka dalë ne krye...*)

Kemi me shqipen – **krytë** etj. (shih më sipër).
Vëmë rè me këtë rast se ne shqip:

kreu (*kry*) = *fillimi,* dhe në të njëjtën kohë:
kreu (*kry, ka kry*) = *mbaroi*, e pra *mbarimi, fundi.*

Kështu shqipja na thotë se *fillimi* dhe *mbarimi* janë një, a e thënë ndryshe, shqipja shtron ekuacionin e rëndësishëm mistik, simbolik:

α	=	ω
(*alfa*)		(*omega*)
kreu		*kreu*

Le të lexojmë tani tek: *"Jean Chevalier: Dictionnaire des symboles"* Robert Laffont, fq. 22, kuptimin e thellë mistik të simbolit *Alfa Omega* (**α ω**) që shqipja shtron nëpërmjet një ekuacioni simbolik (*kreu-kreu*) në mënyrën që pamë.

"*Alpha et Oméga*

Ces deux lettres se trouvent au début et à la fin de l'alphabet grec. Comme elles sont censées contenir la **clef** de l'univers, *celui-ci est entièrement enfermé entre ces deux extrémités*. L'alpha et l'oméga symbolisent donc la **totalité** de la connaissance, la **totalité** de l'être, la **totalité** de l'espace et du temps.

L'auteur de l'Apocalypse attribue ces deux lettres a Jésus - Christ, le témoin fidèle, le Premier né d'entre les morts, le Prince des rois de la terre... "C'est moi l'Alpha et l'Omega, dit le Seigneur Dieu. Il est, il était et il vient, le Maître de tout" (Apocalypse 1 4-8). C'est signifier que le Christ est le principe et la fin de toute chose."

(Këto dy gërma ndodhen në krye dhe në fund të alfabetit grek. Ato përmbajnë **çelësin** e Universit, ky i fundit përfshihet mbrënda këtyre dy ekstremeve. Alfa dhe Omega simbolizojnë pra kështu **tërësinë** e njohjes, **tërësinë** e qënies, **tërësinë** e hapësirës dhe të kohës.

Autori i Zbulesës ja mvesh këto dy gërma Jisu Krishtit, dëshmitari besnik, i paralinduri nga të vdekurit, Princi i mbretërve të dheut... "Unë jam Alfa dhe Omega, thotë Zoti, Ai që është, ai që ish, ai që do të vijë" (Zbulesa 1 4-8). Kjo do të thotë se Krishti është *fillimi* dhe *fundi* i gjithëshkaje.)

Le të përpiqemi të shpjegojmë tani përse vallë në mendimin mistik Alfa dhe Omega simbolizojnë **tërësinë**.

Alfa dhe Omega përfaqësojnë një *çift të kundërtash*, pra x (*Alfa*) dhe $-x$ (*Omega*).

Prandaj mund të shkruajmë:

(Alfa = Omega) = $(x = -x)$ = *Coincidentia oppositorum* =
Zoti = ○ = *e tëra, infiniti* *

Le të vëmë rè me këtë rast se në shqip:

"*Nga një* **kre** *në* **kre**-*në tjetër asht* **kre**-*jt*... "

që jep kështu pra:

(Alfa ⟶ **Omega)** = ○
kre *kre* *kre-jt*

Në sanskritishte (*Alfa = Omega*) jepet me fjalën **para**. Kemi:

para - ... *vieux, ancien* (*i kaluem, i vjetër, i lashtë*)

e pra **alfa**. Dhe në të njëjtën kohë: *qui suit, postérieur, futur, dernier, extrême...* (*që ndjek, që vjen pas, i ardhëm, i fundit, ekstrem*) e pra **omega**.

Pra:

Alfa = **Omega**
↓ ↓
(para **para)**

Jo vetëm, por sanskritishtja na thotë haptas edhe se të jesh në të njëjtën kohë edhe *Alfa* edhe *Omega*, kjo do të thotë të jesh *Zoti vetë* (sikundër e pamë edhe me ndihmën e Algoritmit Simbolik).

Dhe vërtetë, në sanskritisht:

Para - *premier...; dernier...; Esprit Suprême, Absolu*
(*i pari...; i fundit...; Fryma sumpreme, Absoluti*)

---

* Shih për këtë edhe Cirlot (fq. 123):
○ = *Infinity, the Universe, the All*

Do me thënë:

(premier = dernier) = **(Alfa = Omega)** = *Esprit Suprème, Absolu*

Po **absolu** është **Zoti** dhe vetëm **Aí**.

Vëmë re me këtë rast se fjala *absolu* lidhet me latinishten *absolutus* që do të thotë fjalë për fjalë *i zgjidhur* (si edhe për rrjedhojë *i gjetur i pafajshëm, i lënë i lirë...*). Pra simbolikisht:

Absolu = **Absolutus** $_{\text{lat.}}$ = *i zgjidhur* = $-\aleph$ *

Po Algoritmi Simbolik na jep:

$$-\aleph = \boldsymbol{E} = (x = -x) = \bigcirc = \textit{Zoti}, \quad \text{etj. etj.}$$

---

* Vëmë re se në shqip i **shlum** nga folja **shloj** (*lë të lirë*) do të jepte simb. $-\aleph$. Po në shqip gjithashtu **shlym** (*që nuk është i lym, që s'është i njollosur, i turpëruar..., që e ka shly borxhin, fajin*) e pra simb. $-\bullet$.

Shqipja shtron kështu ekuacionin simbolik:

	$-\bullet$	$=$ $-\aleph$	...(**E**)
	shlymje	shlumje	

ekuacion që mund të shkruhet edhe si:

	$\bigcirc$	$=$ $-\aleph$	...(**E**)
E pra edhe	$(x = -x)$	*i shlum*	...(**E**)
	Qëndra	*i lirë*	
	Zoti	*Absoluti*	

Në shqip mund të formulojmë këtë aforizëm:

"*Në krye* **shlym***ja, më pas* **shlum***ja*"

Tek fjala *absolut* theksi semantik bie tek **sol** që lidhet me hebraishten **shal**om (שלם), me latinishten **sal**us (it. *salute*; shq. *shëndet*), me arabishten **sel**am, e kështu me radhë, të gjitha fjalë këto që shprehin konceptin e *paqes*, të *lirisë*, të *mirëqënies*, të *pafajësisë* etj.

Gjithë po kjo rrënjë shpreh edhe konceptin e *shpëtimit* (të shpirtit). Kështu në italisht **sal**vare (*shpëtoj*), **Sal**vatore (*shpëtimtari*) ... **sol**vere (*zgjidh, shluej*) e pra simb. $-\aleph$.

Në shqip **shël**bej, **Shël**byesi (*shpëtimtari, Krishti*)

Kështu pra, nga sa më sipër, del se fjala latinishte **absolutus** mund të motivohet fare bukur me shqipen **â shlu, â shlūt**.

agrya - a. *qui est en tête, le meilleur, le plus ancien; éminent*
(*që rri në krye, më i miri; më i vjetri; i naltë, i madh*)

Do zbërthyer si: **a grya**

dhe me shqipen:

â kreu
â krye

Të tjerat kuptohen vetiu.

agra - nt. (*rar. m.*) *pointe, sommet, extrémité... le meilleur de;* - **e** *en face de...; d'abord, à l'origine; avant*
(*majë, kré, kre-shtë, ekstremitet... ; më i miri nga... ;* - **e** *para, përballë... në krye* (*në fillim*)... *në krye* (*në zanafillë, në origjinë*)

Do zbërthyer si:

â gra

dhe me shqipen:

â kre (*kry, krye*)

a-kṛtya - a.v. *qu'il ne faut pas faire;* nt. *action de ne pas faire, acte fautif*
(*që nuk duhet kryer; veprim mos-kryerjeje, veprim i metë, i gabuar...*)

Do zbërthyer si:

a kṛt ya


dhe me shqipen:

– krȳt

Kuptimi i *veprim i gabuar...* nxirret duke patur parasysh se:

a = *–1* = *F* = ● (*keq*) = ⓘ (*jo i plotë, i metë, i mangët ...*)

e pra:



E pra *veprim* (*krymje*) që s'është për *të kryer* (*–1*), *veprim i gabuar* (●), *veprim i metë* (⏀), *veprim i dështuar* (♀), etj. etj.

a-kr̥tsna - a. *incomplet* (*jo i përkrym, jo i plotë ...*)

Do zbërthyer në:

a kr̥t sna

dhe me shqipen:

– **krỹt** = *jo i kryt, jo i krym, i pakrym, i pakrytë*
= –○ (*jo i plotë, jo i përkrym...*).

a-kr̥tsnavid - a. *dont la science n'est pas complète*
(*dituria e të cilit nuk është e plotë*)

Do zbërthyer si:

a kr̥t sn a vi d

dhe me shqipen:

– **krỹt â bë di**

Ku di është shqipja **di**, *dij* (*me ditë*, etj.) E pra kuptimi është:

di-*je e pa* **përkrỹt** (*a pa përkryeme*)

a-khaṇḍa* - a. *non divisé, entier, intégral;* **-am** *sans interruption*
(*i pandarë, i tërë...* **-am** *pa ndërprerje*)

---

* Kjo fjalë është analizuar edhe më parë. Rishqyrtimi i saj këtu ka për qëllim një "zgjerim bisede".

Do zbërthyer si:

a kha ṇḍa

dhe me shqipen:

– ka ndá

E pra simbolikisht:

$-\oplus$ = *i pa ndarë... pa ndër-prer-je*

Vëmë rè se:

$-\oplus = E = \bigcirc$ = *i tërë*

Vëmë rè me këtë rast edhe sa vijon:

a) frëngjishtja *en*-**tier** lidhet me shqipen **tërë** (fr. *tout*), e pra simb. $\bigcirc$.

b) frëngjishtja **con-tinu** (*i vazhdueshëm, i pandërprerë*) do zbërthyer si:

con tin-u

ku **con** = *+1*, e pra si e tillë mund, semantikisht, të mos përfillet (krahaso me *+1* në shumëzimin algjebrik).

Pra duhet që:

tinu = *pa ndërprerje* = $-\oplus = \bigcirc$

pra **tinu** në frëngjisht nuk mund të jetë tjetër atëhere veçse shqipja *tanë* (*e gjitha, e tëra*) = $\bigcirc$.

Mund të themi pra se **tin**-u është një *inkapsullim* në frëngjisht i operatorit të shqipes **tan** (*e gjitha,* $\bigcirc$), ashtu sikundër edhe **tier** është një inkapsullim i shqipes **tër** (*e gjitha,* $\bigcirc$).

Shihet se frëngjishtja një herë ka *huar* (e *fshehur*) nga shqipja operatorin e lirë që i është dashur nga e folmja e Veriut (**tan**), një herë tjetër gjithë po këtë operator të rotacizuar nga e folmja e Jugut (**tër**).

Saktësia e kësaj etimollogjie mund të rikonfermohet në shumë mënyra. Për

shëmbull kështu:

Marrim në frëngjisht fjalët:

dis**tance** (*largësi*) dhe des**tin** (*fat*)

Le të provojmë se të dy këto fjalë përmbajnë, të *inkapsulluar*, operatorin e lirë të shqipes *tan* = ◯.

Grafikisht *distanca* mund të paraqitet si:

$\underset{A}{(}\!\!\ll\!\cdots\!\gg\!\!\underset{B}{)}$ (*Distanca* nga pika **A** gjer në pikën **B**)

Por Algoritmi Simbolik jep:

◐ = ( ) = (····) e pra edhe $\underset{A}{(}\!\!\ll\!\cdots\!\gg\!\!\underset{B}{)}$ (*distanca*)

Po dimë se ◯ = **tan** $_{shq.}$ dhe **dis** është shqipja **dasì** (*dysh*).

E pra atëhere:

dasì (/) **tana** (◯)

Kështu kemi:

distance $_{fr.}$ = **(dis tan ce)** = **(dasì** e **tana)** =
(dysh e **tana)** = **(des** e **tana)** = ◐

Dhe kjo sepse:

dysh = *2* = *–1* = –◯


Pra:

dysh Tana = *2* **Tana** = – **Tana** = – ◯ = ◐

ashtu dhe:

des Tana = ● **Tana** = – **Tana** = – ◯ = ◐

Pra, duke përmbledhur kemi:



Le të shqyrtojmë tani frëngjishten **destin**. Simboli që përshkruan koncepti i *fatit* (fr. *destin*) është në të gjitha gjuhët ⏀. Le ta provojmë këtë me ndonjë shëmbull nga gjuhë të ndryshme.

Në italisht: **fato** = *fati* ndërsa **fetta** = *fetë* = ⏀

Në shqip: **rrisk** = *fati*, dhe **rrisk** = *fetë* = ⏀

Në rusisht: **dolja** (*доля*) = *fati*, dhe **dolja** = *fete, pjesë* = ⏀

Në rusisht edhe **udjel** (*удел*) = *fati*, ndërsa **delits** (*делить*) = *ndaj, pjesëtoj*, e pra ⏀

Në greqisht: **mira** (*μοιρα*) = *fati*, ndërsa **meros** (*μερος*) = *pjesë*, e pra ⏀.

...

Duke qënë kështu duhet të kemi:

$$(\textbf{destin})_{\text{fr.}} = \text{⏀}$$

Zbërthejmë:

$$(\textbf{destin})_{\text{fr.}} = (\textbf{des tin})$$

Dihet se **des-**, **dis-**, **dé**... është në frëngjisht një prefiks me vlerë ***– 1.***

Ai lidhet me shqipen **dysh** (gr. *dys*).

Dhe me qënë se **dysh** = *2*, dhe me qënë se sipas Algoritmit Simbolik (Mendimi mistik) *2* = $-1 = -\bigcirc$, që këndej rrjedh edhe vlera *mohuese* e këtij prefiksi në frëngjisht. Pra:

$$(\textbf{destin})_{\text{fr.}} = (-\textbf{tin}) = \ominus$$

ekuacion ky që vërtetohet vetëm për:

$$\textbf{tin} = \bigcirc$$

Sepse në këtë rast do të kemi:

$$-\bigcirc = \ominus \qquad \text{...(F)}$$

Një identitet simbolik në (*F*), siç dihet. Por $\bigcirc = \textbf{tan}_{\text{shq.}}$, pra duhet atëhere që:

$$(\textbf{tin})_{\text{fr.}} = (\textbf{tan})_{\text{shq.}}$$

Kështu pra fjala frëngjisht (e për pasojë latinisht) **destin** (lat. *destinus*) reduktohet *pa mbetje* tek shqipja **dysh** (*dasì*, *des*...) **Tana**, duke gjetur kështu motivimin e saj të vetëm dhe të përpiktë.

akşi - nt. (**akşa** *aux cas faibles... etc. etc.*) *oeil, organe des sens*
(**akşa** *në rasat e dobëta; sy, syni,.. ; organ i shqisave...*)

Do zbërthyer si:

a k şi

dhe me shqipen:

â ka sy = 

akşigata - a. *situé devant les yeux; qui est dans les yeux* (*comme une épine*); *détesté*
(*i vendosur në sytë; që ndodhet, gjëndet ne sy* (*si një halë*); *i urryer...*)

Do zbërthyer si:

a k ṣi gata

dhe me shqipen:

gjet â ka sy *(që gjëndet në sy...)*

a-khaṇḍita - a *non endommagé, non troublé, intact; non détourné de son objet (i pa dëmtuar, i pa turbulluar, i paprekur; i pashkëputur nga objekti i vet...)*

Do zbërthyer si:

a kha ṇḍita

dhe me shqipen:

– ka ndātë

e pra simb. –⦶

Le të nxjerrim nga ky simbol kuptimet e ndryshme të kësaj fjale sanskritisht. Algoritmi Simbolik jep:

–⦶ = ○ = *i plotë, i paprekur...*
–⦶ = ***E*** = –● = *pa dam, jo i damtuem*

(*dëmi* i vështruar si një *e keqe*, e pra simb. ●)

–⦶ = –Ω = – ~ = –◯ = ...

Të gjitha këto simbole (*jo konflikt, jo grindje... jo ndryshime, jo paqëndrueshmëri...; jo vërtitje...* etj. etj.) japin së bashku **zbërthimin** e konceptit *i pa turbullue...*

Le të vëmë rè tani sa vijon:

Ne shohim se si shqipja (ashtu sikundër në një mënyre implicite edhe sanskritishtja) e lidh **damin** (fr. *dommage*) me një **damje** (në shqip **dam** do të thotë në të njëjtën kohë edhe *i dam, i ndarë* ... edhe *dam, e keqe, dëmtim* etj. etj.).

Kjo ka arsyet e saja të thella në mitet kozmogonike të tërë Njerëzimit e pra

dhe në ato të Hindisë së lashtë.

Dihet se sipas miteve kozmogonike (si edhe, posë kësaj, edhe sipas një sërë fillosofëve të shquar të Perëndimit, si Paracelsus, Hegel, etj. etj. si edhe gjithashtu sipas theollogjisë së krishterë) Bota është krijuar nga një **damje**. Damje nga kush? Nga **Zoti**!...

Ne dimë se:

$$Zoti = Coincidentia\ oppositorum = (x = -x) = \bigcirc$$

Pra **damja** nga *Zoti* do të tregohet simbolikisht: ⦶.

Por **damje** nga Zoti do të thotë edhe **mohim** i Zotit sepse kemi sipas Algoritmit Simbolik:

$$⦶ = -\bigcirc$$

Po **mohimi** i Zotit do të thotë *mëkat, ateizëm, materializëm,* etj. etj.

Kështu pra për krijimin e *Botës materiale* (●) u desh një *mëkat* (● = −○), *peccatum originalis* i theollogjisë së krishterë), një *krim* (−○), etj. etj. E pra atëhere edhe një **dâm** (*dëm*). Dhe me qënë se kjo **damje** është dami më i madh dhe *i parë* (*zanafillor*), Gjuha, që referon gjithnjë, sikundër e dimë, tek *e para*, tek *sipërorja*, etj. etj. emërton **damin** (fr. *dommage*) në shqip sipas **damjes** (fr. *division, séparation*).

Kështu shqipja shtron ndër të tjera ekuacionin:

$$\underset{\textbf{dam}\ (\textit{séparation})_{\text{fr.}}}{⦶} = \underset{\textbf{dam}\ (\textit{dommage})_{\text{fr.}}}{●} \qquad \ldots\textbf{(F)}$$

Kuptohet se edhe frëngjishtja **dommage** reduktohet tek shqipja **damun**, ashtu sikundër edhe latinishtja **damnus** dhe italishtja **danno**, edhe e sidomos, sepse shqipja shpjegon thellë **pse**-në e fjalëve të tilla për të treguar *damin* (fr. *dommage*), do me thënë lidhjen e **damit** me **damjen**.

Një kuptim i kësaj fjale sanskritishte (**a-khaṇḍita**) është edhe *non détourné*

de son objet... (*i pa shkëputur nga objekti i vet...*).

Për të shpjeguar (motivuar) këtë kuptim duhet të hyjmë pak thellë në fillosofinë e lashtë dhe atë moderne.

Damja (*ndarja*) mes SUBJEKTIT dhe OBJEKTIT që bëri të mundur krijimin e Botës materiale si edhe NDËRGJEGJEN (*Koshiencën*) dhe njohjen RACIONALE të saj (Botës), lidhet me një ndarje të së **Tërës**, të Asaj që ishte një dhe e VETME.

Me qënë se, siç dimë:

$$\textbf{e Tëra} = \bigcirc = 1 = \textit{një}\ \textbf{e Vetme}$$

Kjo **damje** në Subjekt dhe Objekt do të paraqitej simbolikisht si:

$$\textcircled{\scriptsize |} \quad \text{ose edhe si} \quad \not{X}$$

Ndarja në Subjekt dhe në Objekt (gjë që sjell kundërvënien mes tyre) do të mund të tregohej si:

$$(\textit{Objekt} \neq \textit{Subjekt}) = (\textit{E jashtmja} \neq \textit{E brëndshmja}) = (x \neq \boxed{x})$$

pra:

$$\underset{\textit{e jashtmja}}{x} \quad \neq \quad \underset{\textit{e brëndshmja}}{\boxed{x}}$$

Por me qënë se kemi, siç dimë, nga Algoritmi:

$$\boxed{x} = -x \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

Duke bërë zëvëndësimet do të kemi në këtë rast:

$$x \neq -x$$

pra edhe:

$$-(x = -x)$$

E pra, me fjalë të tjera:

$$(x = x)$$

E pra:

$$-\bigcirc$$

E pra:

$$\text{⦶}\ (damje) = \bullet\ (dam)$$

Ja pra përse fjala që tregon **damin** në sanskritisht (**khaṇḍita**) mund të tregojë edhe *shkëputjen nga objekti* (fr. *...détourné de son objet ...*).

Kështu pra ne shpjeguam me anë të shqipes të gjitha kuptimet e fjalës sanskritisht:

a-khaṇḍita

Le ta zgjerojmë tani pak bisedën në planin fillosofik.

Simboli ● është, siç dimë, simboli i *të keqes, i dëmit, i mëkatit, i vdekjes* etj. etj.; por ai është në të njëjtën kohe edhe ai i *materies*.

Kjo atëhere do të thotë se pa *shkëputje të Subjektit nga Objekti*, që do të thotë pa një *diskordancë* (*mosmarrëveshje*) mes tyre, pa një *kundërvënie* (fr. *opposition*) mes tyre, ne nuk do të kishim *as materie* e *as botë materiale*.

Kjo është, siç e kemi parë edhe tjetër herë, në përputhje të plotë me ato sa na mëson fillosofia e Hegelit. Sipas kësaj fillosofie **bota materiale** zë fill (si *alienacion i Frymës Absolute,* si *materializìm* i saj) me *ndarjen* në gjirin e *Frymës Absolute* (⦶) të *dy Frymave, Subjektive* dhe *Objektive* që ishin gjer atëhere në harmoni të plotë mes tyre (që i përgjigjeshin plotësisht njëra tjetrës) dhe me kundërvënien pra mes tyre, gjë që shkruhet simbolikisht si:

⦶	=	$(-x \neq x)$	=	⧖	=	●	=	-1
ndarja		*ndarja*		*kundërvënia*		*Bota materiale*		*Antiteza*

Pra, shpjegimet tona gjer këtu janë në përputhje mes të tjerave, edhe me Fillosofinë e Hegelit. Hegeli këtë *moment të dytë* (= *të ndytë*, ● = *2*) të triadës së tij të famshme e quan *Antitezë* (*– 1*). Ky është pra sipas tij një moment

involutiv, negativ, i keq..., (gjë që del qartë edhe për faktin se ai lidhet me *alienimin* domethënë *çmendinë* e **Frymës Absolute**...).

Por ne mund të vërtetojmë se me *lindjen* e materies dhe të botës materiale, si rrjedhim i *damjes* (e pra, sipas shqipes, edhe i **damit** *zanafillor, themelor...*) lind edhe *llogjika, arsyeja* njerëzore (lat. *ratio*) si edhe vetë *koshienca.*

damja = ⦶ = F = ($x = x$) (**llogjika formale**, shkurt, *llogjika, bon sensi,* **arsyeja** njerëzore...) = ($-x = \boxed{x}$) = *kundërvënia e të jashtmes dhe të brëndshmes = kundërvënia mes Objektives dhe Subjektives* (*kusht i domosdoshëm për ekzistencën e Koshiencës*).*:

> "La condition fondamentale de toute conscience est **l'antithèse** du sujet et de **l'objet**" ("*Kushti themelor i çdo koshience është kundërvenja e subjektit dhe objektit*")

Vëmë rè më në fund, si rikonfermim i kësaj që thamë, se në latinisht *ratio* do të thotë në të njëjtën kohe edhe *pjesë, porcion* e pra simbolikisht ⦶ edhe *arsye* e pra, *llogjikë* e pra ($x = x$). Kështu që latinishtja shtron në këtë mënyrë ekuacionin:

$$\underset{\textbf{ratio}}{\text{⦶}} \quad = \quad \underset{\textbf{ratio}}{(x = x)} \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

(copë, porcion) (arsye)

ā-dhāra - m. *support, base; soutien... ; digue...*
(*mbështetje, bazë, themel...; ... digë, pendë, cfrat...*)

Do zbërthyer si:

ā dhāra

dhe me shqipen:

â dārë (fr. *divisé, separé...*)

e pra simbolikisht:

⦶

---

* Shih edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi, fq. 167.

Nga simboli ⊕ ne duhet të jemi në gjëndje të nxjerrim të gjitha kuptimet e fjalës sanskrite **ā-dhāra**. Sipas Algoritmit Simbolik mund të shkruajmë:

(ā-dhāra)$_{sanskr.}$ = **(â dārë)**$_{shq.}$ = ⊕ = ***F*** = ♀ = ⊡ = ⚸ = ...

Themeli, mbështetja, mbajtësja universale dhe *e parë* është **Zoti**.

Dimë se, sipas një Mitit Kozmogonik, Krijimi i Botës u bë me *sakrifikimin* (flijimin) *e Hyjnisë*, gjë që mund të paraqitet si:

Krymja e Botës = *Sa-kri-fi-kimi i Hyjnisë* = –○

Po Algoritmi Simbolik jep:

– ○ = ⊡ = ***F*** = ⊕ = ● = ⚸ = ♀ = ...

Do me thënë **Hyjnia** (○) pas *sakrifikimit* (–○) që bëri të mundur *krymjen e Botës materiale* (●) *ra poshtë* (♀) dhe *u bë themeli, substanca* (nga latinishtja **sub-stans** = fjalë për fjalë *që qëndron poshtë*) dhe në të njëjtën kohë **sub jek ti** (nga latinishtja fjalë për fjalë: *i hedhur poshtë, që rri shtirë poshtë;* por në të njëjtën kohë edhe *Kreu, Kryefjala..., Subjekti...*) i çdo *diskuri, i gjithshkaje:* ⊡.

Ai (*Zoti*) **bâni** (*bëri*) = –○ = ● (*Botën materiale*)
Ai (*Zoti*) **bân** (*mban*) = –○ = ⊡ = ⚸ = ● (*mban Botën materiale*)

Prandaj pra dhe në sanskritisht kuptimi *suport, bazë,* etj. etj.

Edhe një sërë gjuhësh të tjera rikonfermojnë sa pohuam më lartë. Kështu në shqip:

themel

do zbërthyer si:

thy jam Yll

ku **Yll** (fr. *étoile*) është epitet i Zotit, sikundër që e vërtetojnë ato sa mund të

lexojmë tek Cirlot (fq. 310):

> "**Star**: As a light shining in the darkness, the star is a symbol of the **Spirit**... the "flaming star" is a symbol of the **mystic Centre** ..."
>
> (**Ylli**: si një drite që ndrin në terr, Ylli është simboli i **Frymës**... "Ylli flakëronjës" është një simbol i **Qëndrës mistike**... ").

Por ne dimë se:

Qëndra = *Coincidentia oppositorum* = $(x = -x)$ = ○ = **Zoti**

Që këndej pra dhe ekuacioni:

Ylli = **Zoti**

Pra fjala: **themel** = *jam Yll thý* . E pra atëhere edhe:

⦶ = ***F*** = −○ = ⊡ = *themeli*

ose po deshëm, edhe:

⊡ = *themeli*

Vëmë rè që në hebraisht: **El** = **Zoti**, si bie fjala në emra të tillë si Na**thana**-el = **Dhun**-tija e Zotit, etj.

Në italisht: **fondare** (*themeloj*), nga shqipja:

bë ndarë

e pra simbolikisht:

⦶ = ⊡ = ●

Në italisht gjithashtu:

edificare = *ndërtoj, themeloj*

Do zbërthyer si **e di fi care** dhe me shqipen:

â dá bâ kry

Do me thënë:

kry : â bâ DÁ

e pra përfundimisht:

DÁ = ⊕ = ***F*** = ⊡ = ●

Në rusisht: **zdanie** (*здание*) = **ndër-tesë**, **ndër***tim*, **them***elim*...
Do zbërthyer si:

z *dan* -ie

ku **z** është këtu një prefiks asemantik (edhe **s** përpara bashkëtingulloreve jo të zëshme në rusisht, me vlere *+1* e pra si e tillë e papërfillshme, si edhe me vlerë ⊗ (shqipja *me, dhe*). Pra tërë fjala reduktohet semantikisht tek **dan** e pra tek shqipja **dān** (folja *me dá*) e pra simb. ⊕, e pra edhe:

– ○ (Sakrifica kozmogonike, *therrja* e Hyjnisë) = ⊡ (*Hymja e Hyut, himanentizimi i Zotit...*) = ● (*materia, Bota materiale...*)

Të gjitha këto rikonfermojnë prapë e prapë saktësinë e zbërthimit, e motivimit të fjalës sanskritisht **â dhāra**.

Për sa i përket kuptimit **diga** duke patur parasysh se funksioni i *digës* si objekt është *ndarja e ujrave* (angl. *breakwater*) simboli që ajo përshkruan është krejt natyrshëm ⊕, e pra kemi përsëri shqipen **â dāre**.

Në rusisht:

damba (*дамба*) = *diga,* është shqipja **ba dam**, e pra ⊕

Në gjermanisht:

Damm = *diga,* dhe është shqipja **Damun**, pra ⊕

Në anglisht:

dam = *diga* është shqipja **dām**, e pra ⊕

Në italisht:

diga, dhe është shqipja **dà ka**, e pra edhe *ka dá*, e pra ⊕

Duke e zgjeruar bisedën vëmë rè se *digës* në shqip i thonë edhe **pendë**.
Le ta shpjegojmë (motivojmë) këtë fjalë.
Kemi:

pendë = **pe ndë** = **bë ndá** = ⊕ etj, etj.

Po në shqip *pendë* do të thotë edhe **çift**. Bie fjala *një pendë qé*..., e pra simbolikisht ⚯.

Shqipja shtron kështu ekuacionin simbolik:

⊕	=	⚯	...(**F**)
pendë		**pendë**	
(*digë*)		(*çift*)	

të cilin ne e dimë se është i vërtetë. Le ta thellojmë edhe me tej këtë bisedë...

a) Mund të vërtetojmë se shqipja **pendë** (që zbërthehet si **bë nda**) lidhet me greqishten **pende** (πεντε) = ***5*** dhe kjo për arsye se është numri që simbolizon *Martesën e Shënjtë* (mes *Qiellit*, **3** dhe *Tokës* **2**) do me thënë **çiftëzimin** (e pra edhe **çiftin**!) **e parë**, nga i cili, sipas mitit, lindi Bota materiale. Pra rrjedhimisht:

5	=	⚯	...(**F**)
pende $_{gr.}$		**pendë** $_{shq.}$ (*çift*)	

b) Mund të vëmë në dukje se shqipja e shtron edhe krejt ndryshe me mjetet e saj ekuacionin simbolik (***5*** = ⚯). Dhe vërtetë ne shqip:

pes (*5*) dhe **bash-***k* (⋈)

formojnë një çift thuajse homonimik.

Kalimet:

b ⇆ **p**

ş (*sh*) ⇆ **s**

janë të rëndomta e të lehta gjatë kalimit nga një fjalë në tjetrën brënda të njëjtës gjuhe si edhe ndërmjet gjuhësh të ndryshme për arsye që s'është vështirë të kuptohen.

Si rikonfermë e faktit që **pes** = **bash-***k* mund të përmëndim turqishten **besh** = **pes** $_{shq.}$ (5), që rrjedh nga shqipja **pes** me kalimet:

p → **b**

s → **sh**

c) Ekuacioni i mësipërm shtrohet nga shqipja edhe në këtë mënyrë:

⊕ = ⋈

dà **dhe**

Po kështu në anglisht:

end = *fundi* (shqipja **a ndà**) = ⊕

and = *edhe*, dhe (shqipja **a ndà**) = ⋈

Pra anglishtja shtron kështu ekuacionin:

⊕ = ⋈ ...(**F**)

end $_{angl.}$ **and** $_{angl.}$

Po ashtu ne gjermanisht:



Ende gjer. **und** gjer.
(*fundi*)shq. (*edhe*)shq.

(Zbërthimi bëhet me shqipen **â ndà**). E kështu me radhë...

ç) Vëmë rè se italishtja **ponte** = *ura* (angl. *bridge*) dhe greqishtja **pende** (*πεντε*) = ***5***, janë e njëjta fjalë-simbol.

Lexojmë për këtë qëllim diçka mbi kuptimin simbolik të urës.

> **Bridge**: According to Guénon the roman "pontifex" was literally a "builder of bridges" that is, of that which bridges two separate worlds... For the Israelites, it was the sign of the Covenant between the Creator and his people, and, in China, the sign denoting the union of heaven and earth. For the Greeks, it was Iris, a messenger of the gods. And there are a great many cultures where the bridge symbolizes the *link* between what can be perceived and what is beyond perception ... (Cirlot 33).
>
> (**Ura**: Sipas Guénon-it "pontifeksi" (papa, sh. i përkth.) ishte fjalë për fjalë një "ndërtues ure", i asaj ure që lidh dy botëra të ndara mes tyre... për Hebrejtë, ura ishte shënjë e Paktit ndërmjet Krijonjësit dhe popullit të tij. Në Kinë, ajo ishte shënjë e bashkimit të Qiellit dhe Tokës. Për grekët, ishte Iris-it, një lajmëtare e perëndive. Ekzistojnë gjithashtu një sërë kulturash në të cilat ura simbolizon *lidhjen* mes atyre sendeve që mund të perceptojmë dhe atyre që ndodhen përtej perceptimit tonë...)

Siç shihet pra mund të shkruajmë:

ura =

po pamë se:

5 =

Pra:

ura = ***5***

Prandaj pra dhe:

$$\textbf{(ponte)}_{it.} = \textit{ura} = \text{⋈} = \textbf{(pende)}_{gr.} = \textit{pesë} = \textbf{5}$$

Dhe të dyja këto fjalë, siç pamë, shpjegohen me shqipen **bë ndá**.

Vëmë rè, së fundi, se fjala **ura** në shqip ka mundësi të lidhet me **Iri**-s, *lajmëtarja e perëndive*.

Me fjalën **Iris** lidhet edhe **Iride**, në kuptimin e *ylberit*, sepse, siç lexojmë në Cirlot (fq. 33):

> "St. Bernard has said that the Roman Pontiff, as the etymology of his name suggests, is a kind of bridge between God and Man. For this reason the rainbow is a natural symbol of pontificate...
>
> (Shën Bernardi ka thënë se Papa i Romës (lat. *Pontifex* = fjalë për fjalë *Urë-bërës*) ashtu sikundër etimollogjia e emrit të tij të lë të kuptosh, është si një farë **ure** ndërmjet Zotit dhe Njeriut... Për këtë arsye ylberi është një simbol i natyrshëm i pontifikatit...)

Mund të vijonim më tej por po ndalemi këtu.

ā-dhāna - *fait de mettre,* etc. *dépôt; fait de mettre au monde... de faire, de provoquer...* (*vënie mënjanë, depozitim; lindje; bërje, provokim...*)

Do zbërthyer si:

ā dhāna

dhe me shqipen:

â dān

E pra simb. ⦶. Me qënë se Algoritmi Simbolik jep:

⦶ = ⊡ ...(**F**)

ndaj *ndaj veç, depozitoj*

shpjegojmë kështu kuptimin e *depozitimit,* e *heqjes mënjanë,* e *ruajtjes...* Le të vëmë rè me këtë rast sa vijon: Simboli ⌀, me qënë se Gjuha referon gjithnjë tek *i Pari,* tek *Ngjarja e Parë* (*Krijimi i Botës*) etj. etj., mund të interpretohet si:

Modifikimi (/) i Energjisë Primordiale (○)

Lexojmë, lidhur me këtë, tek Cirlot (fq. 64) sa vijon:

> "**Cosmogony**: The basis of most cosmogonies is the "*cosmic sacrifice*" expressing the idea that THE CREATION OF FORMS AND MATTER CAN TAKE PLACE ONLY BY **MODIFYING** Primordial Energy..."
>
> (Ajo që përbën themelin e pjesës me të madhe të kozmogonive është "*Sakrifica kozmogonike*" me të çilen shprehet idea se KRIJIMI I FORMAVE DHE I MATERIES MUND të KRYHET VETËM NËPËRMJET **MODIFIKIMIT** të Energjisë Primordiale...")

Prandaj simboli ⌀ mund të interpretohet, ndër të tjera pra, edhe si shprehës i **modifikimit** (fjalë latinisht që mund të reduktohet tek shqipja ne këtë mënyrë:

mo di fi care

me DÁ ba kry = DÁ = ⌀)

të **Energjisë primordiale** (○).

Dimë se:

$$○ = (x = -x) = \infty$$

Me fjalë të tjera kjo energji primordiale është **infinite** (*Energjia Qëndrore, Hyjnore...*), ajo është e *pakufishme,* e *pafundme...*

Modifikimi e bën atë të **fundme**, e pra simb. ⌀.

Algoritmi Simbolik na jep:

⊕ = ***F*** = ● (*krijimi i materies, i Botës materiale...*) = ⊡ (*konservimi i Energjisë primordiale*) = ♀ (*rënia në fund, në themel të Energjisë primordiale*)

Pra *Energjia Primordiale* vërtetë modifikohet së "jashtmi" duke na dhënë Botën materiale, por në të njëjtën kohë ajo **ruhet e tëra**, **e paprekur** në thelb, në **zëmrën**, **qëndrën** e Materies, e Botës Materiale që nëpërmjet *modifikimit* (*zvogëlimit, kufizimit, fundëzimit*) të saj krijohet. Kjo Energji është e **lidhur** (♌) e pra jo e **lirë** (–(–♌)), e pra *jo e disponueshme në gjëndje natyrale*.

Por në qoftë se do të gjëndej në një mënyre a në një tjetër mjeti, metoda për ta "zgjidhur" atë, për ta çliruar atë, do të përfitohej një energji jashtëzakonisht e madhe.

Por veç, në të njëjtën kohë, *materia* (●) që e "përfshin" atë, që e ka brënda atë (⊡), do të *asgjësohej*, do të *anihilohej* (–♌ = –● = –⊡ = ○ = *nihil* (*hiç*), *anihilim* (kthim në *hiç*)).

Lexonjësi që na ka ndjekur gjer këtu e kupton se këtu është fjala për të ashtuquajturën ENERGJI ATOMIKE. Kështu pra *analiza e Gjuhës* (*këtu e gjuhës sanskritishte*) *na shpie në konceptin e një energjie primordiale* (*atomike*) *që mund të shlirohet me shkatërrimin e materies*.

Duke u mbështetur tek Algoritmi Simbolik (e pra përsëri tek Gjuha që e përmban atë dhe nga e cila ai mund të nxirret), ne mund të gjejmë edhe formulën që tregon ekuivalencën mes energjisë së çliruar dhe energjisë së përfituar, siç kemi bërë në *Pjesën e parë* të këtij studimi, do me thënë formulën:

$$E = mc^2$$

Kuptimi i *bërjes, lindjes* etj., del duke patur parasysh ekuacionin simbolik:

⊕ = ● ...(**F**)

ku ⊕ simbolizon n-**darjen** (këtu: **dhāna**), kurse ● materien, e pra **lëndën**, e pra dhe **lindjen** (*e materies, e botës materiale, lëndore,* etj.).

Kështu pra, duke interpretuar simbolin ● *si Botë materiale, shohim se edhe* Sanskritishtja rikonfermon mendimin (*mitik, fillosofik...*) sipas të cilit Bota është krijuar nëpërmjet një **ndarjeje** (rikujtojmë Paracelsus: *Die Separatio* (⌀) (*sanskr.* **ā-dhāna**) *ist aller Geburt* (●) *Anfang*).

Rikujtojmë gjithashtu, me këtë rast, se ne rusisht **delits** (*ndaj*), e pra simbolikisht ⌀ dhe **delat** (*bëj*), e pra simbolikisht ●.

Nga ana tjetër Algoritmi Simbolik na mëson se kemi:

$$\underset{\textit{lëndim}}{-\bigcirc} = \underset{\textit{lindja}}{\oslash} = \underset{\textit{lënda}}{\bullet} \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

Pra mund të themi atëhere se:

LËNDA LIND *nga një* **LËNDIM** *i Zotit* ($-\bigcirc = -$**Zot**)

Që *lindja* lidhet me një *ndarje*, do me thënë vërtetësia e ekuacionit:

$$\oslash = \textbf{lindje}$$

kjo rikonfermohet linguistikisht nga shumë e shumë gjuhë. Kështu për shëmbull në italisht:

$$\begin{cases} \textbf{parte} = \textit{pjesë} \\ \textbf{spartire} = \textit{me ndà} \\ \textbf{parto} = \textit{lindje, pjellje} \end{cases}$$

Në shqip:

$$\begin{cases} \textbf{felë} = \textit{pjesë} \\ \textbf{pjell} = \textit{lind} \end{cases}$$

Ne motivuam kështu të gjitha kuptimet e fjalës sanskritisht: **ā-dhāna**.

Shtojmë se **ā-dhāna** lidhet mbrënda sanskritishtes me foljen **ā-DHA** = *me*

dhanë; *bëj, lind,* etj., *marr një trajte, një forme...*

Me fjalë të tjera *bërja* vështrohet si marrje e një forme, do me thënë si një proces **formalizimi**. Pra sanskritishtja pozon:

⦶ ●

ndarja = *bërja* = *marrja e një forme.*

Me fjalë të tjera, simbolikisht:

⦶ = ● = (***x*** = ***x***) ...(**F**)

ndarja *bërja* *formë*

formalizim

logjikë formale

Kuptojmë atëhere:

a) përse kodi ***F*** duhet quajtur me të drejtë, sikundër që ne e kemi quajtur, **kod formal**;

b) përse kodi ***E*** = – ***F*** = – **formë**; është një kod **aformal** e pra **esencial**, sikundër dhe është quajtur nga ne.

Kështu Sanskritishtja (dhe Tërë Fillosofia e lashtë hindiane prapa saj) *bën dallimin mes asaj që* ***lind*** (*formë, materie...*) *dhe asaj që* ***nuk lind*** (*Esencë, Frymë...*) mes **fenomenit** (duke përdorur terminollogjinë kantiane) (***F***) dhe **noumenit** (***E***).

adhikya - nt. *surplus, excès* (*shtesë, tepricë*)

Do zbërthyer si:

a dhi kya

dhe është shqipja:

ka edhe

(fr. *il y a de plus, il y a un surplus* = *ka më tepër, ka një tepricë...*).

Vëmë rè se vetë fjala **edhe** në shqip do ndarë si në pjesë më të thjeshta, në:

e dhe

e pra:

â (*ë, është*) **dà**

e pra simbolikisht ⏀, e pra, për ekuivalencë simbolike edhe ⋈ (⏀ = ⋈).

Po ashtu, siç kemi parë, edhe në gjermanisht:

und (â ndà) $_{shq.}$

dhe në anglisht:

and (â ndà) $_{shq.}$

fjalë që shpien simbolikisht, përmes shqipes, tek ⏀, e pra simbolikisht tek ⋈ që i motivon këto fjalë.

a-dhmāna - *accroissement* (*rritje, shtim...*)

Është shqipja **ā damun** e cila mund të zbërthehet edhe si **a dà jamun**, e pra simb. ⏀.

Algoritmi simbolik jep:

$$\bigcirc = 1$$
$$⏀ = \chi$$

e pra "*më tepër se nji*", *shtim, shumëzim* etj. (Mos harrojmë se në shqip:

$$⏀ = \chi \qquad \text{...(F)}$$
dasì disā)

Mund të arsyetohej edhe kështu: Sipas Algoritmit Simbolik kemi:

$$⏀ = \odot \qquad \text{...(F)}$$

Dhe me qënë se, siç dimë:

$$\text{⦶} = F = (x^2 + y^2 = r^2) = \odot$$

vijimi i procesit të **damjes** do të jepte:

$$\frac{1}{2} = \text{⦶} = \odot$$

$$\frac{1}{4} = \odot$$

$$\frac{1}{8} = \odot$$

$$\ldots = \ldots$$

E pra kështu një **zmadhim**, një **rritje**.

Vëmë rè tani sa më poshtë:

a) Vetë fjala shqip **i madh** do zbërthyer si **me DÀ** e pra simbolikisht ⦶, pra edhe:

$$\text{⦶} = (\lessdot\cdot\cdot\gtrdot) \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

me dà **zmadhim**

etj. etj., ose edhe χ = *shtim, shumëzim...*

b) Ashtu edhe hebraishtja **gadol** (*i madh*) do zbërthyer me shqipen **ka dallue**, e pra ⦶, e pra:

$$\text{⦶} = (\lessdot\cdot\cdot\gtrdot)$$

etj., etj.

c) Anglishtja **increase** (*me u shtue, me u rrit,* etj.), lidhet me shqipen **kris** ne kuptimin *çahet*, e pra simb. ⦶, etj., etj.

Ashtu edhe italishtja **crescere** = *me u rrit, me u shtue...,* do zbërthyer me shqipen:

kris kry (*kryej krisjen, ndarjen,* etj. etj.).

Ideja që qëndron në themel të të gjitha këtyre shpjegimeve është se **e shumta** ka lindur nga **e pakta**, do me thënë nga **pika** (*Qëndra*), si një **ndarje** e saj, idé që është ne përputhje të plotë me mendimin mistik të të gjithë popujve të *Botës*, të lashtë dhe të rinj.

ādya - a. *premier, en tête, prééminent, sans parallèle;* ifc. *qui commence par,* etc. (*i pari, në krye, i shquar, që është në majë, i pakrahasueshëm; që fillon me,* etj.)

Do zbërthyer në:

ā dya

dhe me shqipen:

â dà

E pra simb. ⊕; e kemi për ekuivalencë simbolike edhe *–1*, dhe ky është vërtetë **fillimi** i Botës materiale e pra, sipas Gjuhës (mendimit mistik) çdo *fillim,* e pra dhe *e para,* e pra dhe *i pari...*

Një sqarim këtu është i nevojshëm:

Sipas mendimit mistik, Krijimi i Botës, fillimi i saj, duhet vështruar si një **involucion**, e pra një të shkuar **prapa** e *jo përpara*. Kjo është arsyeja që *fillimi i botës* dhe *fillimi në përgjithësi*, tregohet simbolikisht me *– 1* (dhe jo me *1*).

Lidhur me tezën se krijimi i botës është vështruar nga të lashtët si një involucion, lexojmë ndër të tjera, tek Cirlot (fq. 294):

> "...Yet Homer reserves the end of the periplus of Odysseus for a triumphant but affectionate "return" to his wife, his hearth and home. This is a mystic idea analogous *to the mystery of the **fall** of the soul into the material plane of existence (by the process of **involution**) and to the necessity of it's returning to the starting - point (**evolution**) - a mystery which has been expounded by Platonic idealism and by Plotinus in particular.*"

(...Homeri i përfundon peripecitë e Odisesë me një "kthim" dashuriplotë tek gruaja e tij, tek vatra dhe shtëpia e tij. Kjo është një ide mistike e ngjashme me atë *të misterit të* ***rënies*** *së shpirtit në nivelin material të ekzistencës (nëpërmjet procesit të* ***involucionit****) dhe të nevojës të kthimit të tij tek pika e nisjes (****evolucion****) - një mister ky, përhapja e të cilit e ka burimin tek idealizmi i Platonit si edhe e sidomos tek ai i Plotinit.*)

Rikujtojmë gjithashtu se edhe krijimi i Botës materiale sipas Fillosofisë së Hegelit, realizohet, si *alienim* (*tjetërsim*) e në të njëjtën kohë si *sendëzim* i Idesë Absolute, me *antitezën* e pra simb. -1.

Edhe "fakte" të tjera flasin për këtë që thamë. Kështu në një sërë gjuhësh, si latinisht, italisht, greqisht, etj. fjala **anti** do të thotë edhe **para** (angl. *before*) edhe, në të njëjtën kohe, **kundra** (angl. *against*), e pra simbolikisht -1. Pra, duke përmbledhur:

$$-1 \begin{array}{l} \nearrow \textit{para} \\ \searrow \textit{kundra} \end{array}$$

Pamë se Bota ka filluar me një **ndarje**. Por dimë se simbolikisht: **ndarje** = ⦶, dhe nga ana tjetër:

$$⦶ = -○ = -1$$

Gjë që vërteton prapë a prapë përse **fillimi** $= -1$.

a-dṛtya - a.v. *respectable; qui doit être respecté, observé*
(*i nderuar, që duhet të respektohet; që duhet t'i përmbahesh...*)

Është shqipja:

â (n)**deri**

Le të krahasojmë këtu me shqipen:

*i për-n-***derti**

si edhe me fjalët shqip *i ndershëm*, *nder*, etj. etj.

ā-DṚ - *respecter; respecté, estimé* (*nderoj; i nderuar, i çmuar...*)

Është shqipja:

â dar, n-der-oj

Le të japin ndonjë sqarim si edhe le ta zgjerojmë disi biseden.

Më *i nderuari* nga të gjithë, me *i çmuari* nga të gjithë, është **Zoti**.

Ai është **i ndarë** nga të tjerët dhe nga *tërë* **Bota** jonë *materiale*, të paktën kështu është menduar dhe mendohet. Shkurt: *Ai ha bukë* **veç**... (*Deus Transcendens*).

Që këndej në shqip paralelizmi:

i ndar (*i veçuar*)

dhe:

nder (fr. *honneur, respect...*)

Ky paralelizëm vihet rè edhe në gjuhë të tjera. Për shëmbull në rusisht:

çast (*pjesë*)	**çastnij** (*i ndarë, i veçantë, privat*)
çest (*nder*)	**çestnij** (*i nder-shëm, i nder-uar...*)

dhe kemi shqipen **çá** *asht* (pjesore e foljes **çaj**) e pra simb. ⦶.

Në sanskritisht: **vandura** (*nder*). Kjo fjalë zbërthehet si:

va ndura


dhe është shqipja:

bâ ndār
bâ ndér

simbolikisht: ⦶

Pra operatori i *ndarjes* (⦶) shërben në të gjitha këto gjuhë për të shprehur edhe *nderin*.

Por kemi:

ndarë = ⦶ = −○ = 

dhe simboli ○ është ai *i Hyjnisë, i Zotit,* që siç shohim është i *ndarë* nga *të tjerët,* nga *Bota materiale* (● = ⊡) është në Qëndër (○ = (***x*** = − ***x***)), është i veçantë, e kështu me radhë.

Prandaj pra, duke përfunduar, **DR̨**, tek sanskritishtja **-DR̨** është shqipja **dar** (*ndar,* etj.) e pra simbolikisht ⦶ e, për ekuivalence simbolike, ⊡ ose edhe, me qënë se ○ = ***1*** kemi edhe [1] simbol ky i fundit që shpreh në mënyrë adeguate konceptin e **nderit**, e të **nderuarit** (*të Nderuarit të Madh, të Adhuruarit, të Zotit...*).

ardha - a. *a moitié, demi; constituant la moitié;* m. nt. *moitié;* **-e** *au milieu de...* (*përgjysëm, gjysëm, që përbën gjysmën; gjysëm;* **-e** *në mes të...*)

Do zbërthyer si:

ar dha

ku: **ar** lidhet përbrënda sanskritishtes me:

ari - m. *rou, disque* (*rrotë, disk*), e pra simb. ○.

Për korrespodencën **ar** (angl. *gold*) = ○, është folur në *Pjesën e parë* të këtij studimi, pra dhe nuk po zgjatemi më tej.

dha është shqipja **dà**.

Pra simbolikisht:

$$(\mathbf{ardha})_{\text{sanskr.}} = (\mathbf{ar\ dhà})_{\text{sanskr.}} = (\mathbf{ar\ dà})_{\text{shq.}} = ⦶ = \boldsymbol{F} = {}^{1}/_{2}$$

⦶ = (|) *në mes të...*

Që këndej dalin të gjitha kuptimet e kësaj fjale:

Gjysma ($^1/_2$), në **mes** [(|)]

artha - m (*rar. nt.*) *but; cause, motif; avantage pratique, utilité, récompense; chose, objet; fait, réalité, propriété, biens; affaire, cas; sens, signification; membre viril...*
(qëllim; shkak, motiv; përfitim praktik, dobi, shpërblim; send, objekt; fakt, realitet; pronë, të mira materiale; punë, rast; kuptim, domethënie; organ mashkullor...)

Zbërthimi do bërë si:

ar tha

dhe me shqipen:

ar dà (ose *ar thy*)

E pra simb. ⦶. Nga ky simbol ne duhet të nxjerrim të gjitha kuptimet e fjalës sanskrite *artha*.

Sipas Algoritmit Simbolik kemi:

$$⦶ = F = ● = ↔ = ⋈ = (◯ \neq ⊡) = (x = x) = \ldots\ldots(\mathbf{F})$$

1) Kuptimi i *shkakut, motivit...* del nga ekuivalenca:

$$⦶ = ↔ \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

Vërë rè se ky ekuacion i rëndësishëm shtrohet nga shqipja në disa mënyra, si për shëmbull, me:

$$⦶ \quad . \quad = \quad ↔ \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

ndaj (*séparer, diviser*) fr. — **ndaj** (*prandaj, për këtë shkak,* etj. etj.)

lidhur me këtë çështje është folur edhe në *Pjesën e parë* të këtij studimi, prandaj

dhe referojmë atje.

2) Lidhur me kuptimet: *realitet, send, objekt...*, le të kemi parasysh se këtu është fjala për një *realitet, send, objekt...* **material**, e pra simb. ●. Por, siç tregohet më sipër:

artha = **ar dá** = ⦶ = ● = *realitet material,* etj. etj.

3) Kuptimi i **pronës** del duke patur parasysh ekuacionin simbolik në ***F***:

⦶ = ● = ⊡

ku ○ mund të interpretohet si **ar** e pra si **vlerë**, dhe □ si *kufiri, rrethimi i pronës...*

4) Kuptimi i **kuptimit** mund të *shpjegohet* (*motivohet*) në disa mënyra. Për shëmbull kështu:

a) *kuptimi* është ai që **kapet** e pra atëhere simbolikisht ⊡ (me qënë se Gjuha referon gjithnjë tek e **para** e cila është ○*, sepse kemi, siç dimë: ○ = ***I***). E pra atëhere edhe, për ekuivalencë simbolike: ⦶ = *ar dà* = *artha*, etj. etj.

b) ose edhe: në frëngjisht *sens* do të thotë në të njëjtën kohë *kahje* dhe *kuptim*.

Dhe kjo nuk është e rastit, *sepse vetëm atje ku ne mund të dallojmë dy* ***kahje*** (fr. *sens*) *mund të ekzistojë një* ***kuptim*** (fr. *sens*).

Le ta vërtetojmë këtë.

Sipas Algoritmit Simbolik kemi:

---

* Simboli ○ kur paraqitet si i "okultuar", i fshehur, i reçesivuar, i "ndaluar" ... si *Deus Immanens* bëhet i vogël, do me thënë si ○. Kështu që:

○ = ○

që do të thotë se këto dy simbole janë i njëjti simbol por në dy pozicione të ndryshme.

kuptimi = **llogjika** = **arsyeja** = $(x = x)$ =
$-(x = -x)$ = $-(\bigcirc = \boxed{\star})$ = $(\bigcirc \neq \boxed{\star})$ =
diferencim, **dallim** *i dy kahjeve* (*senseve*)

Çfarë duhej provuar.

c) Mund të arrinim në të njëjtin përfundim edhe nëpër një rruge tjetër.

Që diçka të këtë një kuptim të caktuar duhet të shprehi një *koncept*. *Koncepti*, nga ana tjetër, si i tillë, është diçka që lejon një *përCAKtim*. Por *përCAKtimi* lidhet me vendosjen e një *Caku*, e pra atëhere kemi:

kuptim = **koncept** = **përCAKtim** = **CAK** = ... = ⏀ = **ar dà** = **artha**

5) Kuptimi i *organit mashkullor* del duke arsyetuar në këtë mënyrë:

organ mashkullor = **organ seksual** = ♂ = ⏀ = **artha**

Vëmë rè me këtë rast se ne shqip:

i ardhshëm = *i arsyeshëm* (shqipja e lashtë e Malësisë),
herdhe = *organe gjenitale mashkullore* (fr. *testicules*).

Pra dhe në shqip ruhet po ai paralelizëm mes arsyes dhe *organit gjenital mashkullor* si edhe ne sanskritisht. Kjo flet për një afërsi të thellë fillosofike, për një "Weltanschauung" të afërt mes dy gjuhërave e pra dhe mes dy popujve që kanë folur këto gjuhëra.

Le ta thellojmë dhe le ta zgjerojmë me tej këtë bisedë në drejtime të tjera (jo gjuhësore), gjë që do të na lejoje të nxjerrim një informacion me vlerë dhe aktual.

Kemi: **ardha** (*gjysma*), etj. e pra simb. $^1/_2$, ⏀... dhe nga ana tjetër **artha** = *shkaku, arsyeja,... ; sendi, objekti... ; organi mashkullor,* etj. etj.

Këto dy fjalë (**ardha** dhe **artha**) janë e **njëjta** fjalë, në kuptimin se lidhen me dy operatore identike, njëri nga të cilët, në rastin e dytë, është diferencuar lehtë (**dha** që kalon në **tha**; **dh** dhe **th** janë që të dyja dhëmbore, dhe ndryshimi i

vetëm mes tyre është se *e para është e zëshme*, dhe *tjetra është e pazëshme*).

Për ta vërtetuar më mire këtë arsyetojmë në këtë mënyrë:

Sipas Algoritmit Simbolik (Strukturizim llogjik i Mendimit Mistik, mbi botëkuptimin e të cilit ngrihet tërë Gjuha, çdo gjuhë...) kemi:

$$F = (x = x) = \textbf{llogjika formale}; \textit{ llogjika, arsyeja njerëzore}$$

e pra sanskritisht **artha** (⦶ *gjysma*, fr. *moitié, demi* ....); e pra sanskritisht **ardha** (= $^1/_2$ = ⦶ = ●, e pra *send, objekt material...* = ⚹ *seks, seksualitet, organ seksual* e pra dhe *organ mashkullor*, fr. *membre viril...*)

Me qënë se:

$$⦶ = -○$$

ne shohim se sipas sanskritishtes (dhe tërë mendimit mistik) ***arsyeja*** *nuk është diçka e plotë* (−○), nuk është diçka që rrok gjithshka, *të gjithën* (○), e që shpjegon pra *gjithshka* (○). Një zonë i shpëton asaj, dhe është zona përtej kufirit, përtej cakut që ndan këtë botën tonë materiale, të dukshme, nga bota tjetër spirituale, qiellore, e padukshme... Po të jetë se arsyeja do të orvatej me forcat e veta të depërtonte edhe në atë zonën tjetër, gjë që do të mund ta shprehim simbolikisht me:

$$⊕$$

do të kishim:

$$⊕ = ○ = -⦶ = -(x = x) = - \textbf{Arsye}$$

Me fjalë të tjera, *në këtë rast,* ***arsyeja*** *do të binte në kundërshtim me veten e saj.*

Me fjalë të tjera *arsyeja*, duke u orvatur të *transgresoj* (*kapërcej,* të *shkel kufirin...*) (⊕), të hidhet përtej *cakut* që i është vënë ((*x* = *x*) = ⦶) e paguan shtrënjtë, dënimi që merr është me vdekje, është asgjësimi i saj i plotë (−⦶ = −(*x* = *x*)).

Kjo problematikë është studiuar mjaft thellë, në lëmin e Fillosofisë, për herë të parë nga Kant. Në librin e tij të famshëm: *"Kritika e Arsyes së Pastër"* (*Kritik*

der reinen Vernunft) ai zbuloi *"Antinomitë e Arsyes së Pastër"*, me fjalë të tjera të tilla situata kur arsyeja bie në kundërshtim me veten e saj, që do të thotë, më konkretisht, se ajo është në gjëndje të provojë me të njëjtën saktësi llogjike dy propozicione (*gjykime, teza*) krejt të kundërta, gjë kjo që ndodh, siç thamë, kur ajo **shkel** në një territor të **huaj** për të, siç është **Metafizika**.

Antinomitë e Kantit ndahen në **Tezë** e **Antitezë**.
Ato janë katër.
Po i riprodhojmë ato këtu shkurtimisht:

Tezë	***Antitezë***
1 Bota ka një fillim në kohë dhe është gjithashtu e kufizuar në hapësirë.	**1'** Bota nuk ka një fillim në kohë dhe as ka ndonjë kufi në hapësirë, por është e pafundme si në kohë ashtu dhe në hapësirë.
2 Çdo substancë e përbërë në këtë botë përbëhet nga pjesë të thjeshta, dhe nuk ekziston diçka që të mos jetë e thjeshtë ose mos të jetë e përbërë nga pjesë të thjeshta.	**2'** Asnjë send i përbërë në këtë botë nuk përbëhet nga pjesë të thjeshta dhe nuk ekziston askund diçka që të jetë një send i thjeshtë.
3 Shkakësia (kauzaliteti) sipas ligjeve të Natyrës nuk është e vetmja shkakësi nga e cila fenomenet e Natyrës mund të kenë rrjedhur. Për shpjegimin e tyre është e nevojshme të pranohet një tjetër shkakësi, shkakësi nëpërmjet lirisë.	**3'** Nuk ka liri, por gjithshka në botë, ndodh vetëm sipas ligjeve të Natyrës.
4 Botës i përket, qoftë si pjesë apo qoftë si shkak i saj, diçka që ekziston si një qënie absolutisht e domosdoshme.	**4'** Nuk ekziston ndonjë qënie e domosdoshme si shkak i botës, as në botë, as jashtë saj.

Po zgjatemi disi mbi këtë çështje, por një gjë e tillë është tepër e nevojshme në qoftë se duam të kuptojmë thellësinë marramënthore të informacionit që përmbahet në Gjuhë, këtu në gjuhën sanskritishte e veçanërisht tani në fjalën e saj *artha* dhe *ardha*.

I drejtohemi përsëri Algoritmit Simbolik.

Arsyeja, thamë, kur i kapërcen kufijtë e saj, bie në kundërshtim me veten, gjë që ne e paraqitëm si:

$$\oplus \quad = \quad -\,(x = x)$$

Mirëpo, siç na mëson Algoritmi:

$$-\,(x = x) \quad = \quad (x = -x)$$

E ja pra atëhere përse në këtë rast arsyeja bie në kundërshtim me veten e saj, dhe pse është në gjëndje të **provojë** njëlloj si vërtetësinë e x **(tezës)** ashtu edhe atë të $-x$ **(antitezës)**.

Kalimi nga $(x = x)$ në $-\,(x = x) = (x = -x)$ është kalimi nga kodi F në kodin E, a, e thënë ndryshe, nga Llogjika e të **Tretit të Përjashtuar** (*Tertium Non Datur*) tek Llogjika e të **Tretit të Përfshirë** (*Tertium Datur*). Kjo llogjikë e fundit është, siç dimë, *llogjika e të Përtejmes, e Botës së Padukshme, shpirtërore,* të cilën arsyeja nuk është në gjëndje ta **kapi**, ta kuptojë dhe ndaj pra, i duket absurde dhe jo ekzistuese. Ajo, kjo botë e padukshme, **kapet** vetëm nga *intuita metafizike*, nga *imagjinata artistike*, nga *besimi mistik*, tri aktivitete njohëse këto që funksionojnë që të treja, siç mund të vërtetohet, sipas kodit E.

Ja vlen të zgjerohemi pak mbi këtë çështje.

Teza dhe ***antiteza*** *në antinomitë kantiane përputhen*, ndonëse askush, me sa di unë, s'e ka vënë kurrë këtë gjë në dukje, me Tezën dhe Antitezën hegeliane.

Dhe ja përse:

Sipas Tezës hegeliane, të dy Frymërat, *Fryma Subjektive* dhe *Fryma Objektive* janë **një**, ato nuk kanë ndonjë **dasì** mes tyre, prandaj pra dhe mund të shkruajmë simbolikisht:

Teza = $-\oplus$ = ○ = ***E***

Në fazën e *Antitezës*, Frymërat ndahen dhe kundërvihen, e pra kemi:

Antiteza = $\oplus$ = ***F***

Por kemi, sipas Algoritmit Simbolik:

F = $-$ ***E*** = $-$○ = ● (*Bota materiale*) = $\oplus$ (*kufizim në Kohë* dhe *Hapësirë*...)

Pra duke u nisur nga **Teza** (kodi ***E***) dhe duke kaluar ne **Antitezë** (kodi ***F***) ne gjejmë se Bota është e kufizuar në kohë e hapësirë.

Është e rëndësishme të vihet rè, me këtë rast këtu se në këtë përfundim ka arritur sot edhe Kozmollogjia moderne, sipas të cilës Kozmosi ka një *fillim* (e pra *cak, kufi* ...) në *kohë* (*Teoria e Bing Bangut*) dhe një *fund* (e pra *cak, kufi* ...) në *kohë* (*Teoria e Big Crunch*), si edhe gjithashtu *një kufi në hapësirë* (*Teoria e Vrimave të zeza*).

Kjo do të thotë, ndër të tjera, *se informacioni që ne nxjerrim nga Gjuha* (këtu gjuha sanskritishte, por sigurisht edhe nga çdo gjuhë tjetër, sikundër autori i këtij studimi provon edhe ne studimet e tjera të tij), *është një informacion* **gjithmonë** *aktual dhe i vërtetë e gjer edhe madje* **paraprijës** (kujtojmë dyndjen e mendimit mistik në mendimin shkencor sot, si edhe gjithashtu në tërë diturinë e kohës sonë).

Vërejmë lidhur me sa më sipër se Antiteza në Antinomitë e Arsyes së Pastër të Kantit *përputhet me Antitezën*, momentin e dytë në Triadën hegeliane (Tezë, Antitezë, Sintezë)* dhe pra me një pohim të kodit ***F***; kjo rrjedh edhe për arsye se:

Antiteza = $-$**Teza** = $-$***E*** = ***F*** = ● = *Bota Materiale*

Duke qënë kështu Antiteza nuk mund të shikojë *kufijtë* (*fillimin e fundin*) *e*

* Shih fq. 81, **120**, 257...

botës materiale me të cilën ajo identifikohet, pra do pohojë pafundësinë e saj në hapësirë dhe pavdekësinë e saj.

Le të vërejmë gjithashtu se Antiteza në fillosofinë e Hegelit lidhet me *luftën e të Kundërtave*, dhe kjo sepse kemi:

Antiteza = ***F*** = $-\bigcirc$ = $\textcircled{1}$ = $\S\!\!\!2$ = **Lufta e të kundërtave**

Dhe këtu zë fill interpretimi marksist i fillosofisë hegeliane, sipas të cilit *materia është e përjetshme*, se *bota materiale s'ka fund as në kohë as në hapësirë*, se *ajo nuk është krijuar*, se *nuk ka botë të përtejme*, se *gjithshka është materiale a produkt i trashë a i hollë i materies*, se *nuk ka Shpirt, nuk ka Frymë, nuk ka Zot*, etj. etj.

Shihet lehtë se tërë interpretimi marksist i fillosofisë hegeliane, duke u lidhur si me themelin e saj me Antitezën, përfshihet i tëri në kodin ***F***, sikundër që do të mund të tregohej edhe më konkretisht (siç është bërë në një sërë studimesh të tjera të Autorit).

Lidhur me antinominë e dytë:

> Në fizikën kuantike është kërkuar (Heisenberg e të tjerë) *"The prime matter"* (lat. *materia prima*) do me thënë një *substancë* (*sub-stans = që rri prapa, që rri ndën...*) e *thjeshtë*, *fillestare* dhe *themelore* nga e cila të prodhoheshin, të lindnin të gjitha grimcat materiale. Dhe ja **u gjet më në fund se kjo substancë nuk mund të ishte materiale, nuk mund të ishte e dukshme dhe e perceptueshme, por e padukshme, e paperceptueshme shkisërisht, *jo materiale* por *spirituale***.

Shkruajmë atëhere:

Substanca e thjeshtë, themelore, primare... = *Spiritus* = *Frymë* = $\bigcirc$ = ***E*** = $-\aleph$ (*jo e përbërë, jo e përzier,* e **thjeshtë**, *e pastër...*)

Ja pra që ekziston, siç pohon Teza, një *Substancë e thjeshtë* ($-\aleph$) nga e cila

rrjedhin më pas të gjitha të tjerat, të përbëra, materiale.

Është rasti këtu për të treguar se si kjo substancë e thjeshtë themelore, spirituale etj. etj., prodhon të gjitha të tjerat, jo të thjeshta, materiale, etj. etj.

Kemi, sipas Algoritmit:

$$-\aleph = (\textit{substanca e thjeshtë}) = \boldsymbol{E}$$

Nga ana tjetër dimë se kemi (shih *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik*):


$$\boldsymbol{E}^2 = -\boldsymbol{E} = \boldsymbol{F} = \oplus\ (\textit{pjesë, pjesëz, "grimcë"}, \text{angl. } \textit{particle...}) = \bullet\ (\textit{materiale}) = \aleph\ (\textit{jo e thjeshtë, e përbërë}) = \boxed{\circ}\ \textbf{sub-}\textit{stanca e thjeshtë}\ (\circ = -\aleph)\ \textit{spirituale}, \text{ etj. etj.},$$

si *themel* i përbashkët i të gjitha grimcave materiale dhe i tërë botës materiale.

Kujtojmë se sipas Algoritmit kemi:

$$\boldsymbol{E} = \sqrt{\boldsymbol{F}}$$

E pra kemi:



Pra ***Substanca e thjeshtë*** (spirituale) *duke vepruar mbi veten e vet* (*autoveprim*) ($\boldsymbol{E}^2 = \boldsymbol{E} \,.\, \boldsymbol{E}$) *prodhon të gjithë botën materiale.*

Nga ana tjetër dimë se:

$$\boldsymbol{E}^2 = \boldsymbol{E}.\boldsymbol{E} = -\boldsymbol{E} = -\bigcirc = -\bullet$$

Dhe kemi kështu paraqitjen simbolike të mitit kozmogonik të krijimit të Botës (●), përmes *Sakrifikimit* (a *vetësakrifikimit*) të *Parimit Hyjnor*, të *Hyjnisë* (–○).

Le të risjellim këtu, në trajtë anekdote, një fakt "kurioz" në gjenezën e iderave themelore të Fizikës moderne.

Thuhet se Heisenbergu, autori i parimit të famshëm të *papërcaktueshmërisë* (simb. –⦶) i shkruan Bohrit*, një tjetër bashkëthemelues i rëndësishëm i Fizikës kuantike, sa vijon:

> "Unë mendoj se duhet të ekzistojë një *substancë e parë* e cila duke vepruar mbi veten e saj, duhet të prodhojë të gjitha grimcat, të gjitha substancat e tjera..."

Bohri i gjegjet:


> "Hipoteza yte më pëlqen, por nuk e di nëse është aq e çmendur sa duhet për të qënë e vërtetë! ..."

Ne pamë se substanca që vepronte mbi veten e saj, i përmbahej kodit ***E***, dhe me qënë se ***E*** = –● (*jo materie, jo materiale...*) = ○ = *Fryma, hiçi, vakuumi, fusha e vakuumit...*, kjo substancë duhet të jetë *jo materiale* (–●) por *Spirituale* (○), ajo duhet të jetë gjithashtu *bosh*, ajo duhet të jetë kështu *hiçi*, ajo duhet të jetë kështu *vakuumi*, ajo duhet të jetë kështu *fusha e vakuumit* në fizikën kuantike.

Heisenbergu në studimet e tij flet rëndshëm për domosdoshmërinë e ekzistencës së *fushës së vakuumit*, si fusha e fundme brënda thellësisë ekstreme të materies. Kështu pra atëhere mund të thuhet edhe se *vakuumi duke vepruar mbi veten e vet prodhon tërë grimcat materiale...* Simbolikisht dhe në mënyrën më të përgjithësuar ne mund të shkruajmë:

---

* Shkencëtar i shquar danez i shekullit të kaluar që hodhi dritë mbi strukturën e atomit dhe që dha një kontribut të qënësishëm në krijimin e Fizikës së re Kuantike.



Vëmë rè në këtë rast se:

$$\bigcirc = (x = -x) = \textit{Coincidentia oppositorum} = \textit{Deus}$$

Ne mund të themi atëhere se *të gjitha grimcat materiale e pra dhe tërë Bota materiale*, ***krijohet*** (*prodhohet*) *nga Zoti që* ***vepron mbi veten*** *e Tij* (*vetëveprim*) ($\bigcirc \cdot \bigcirc$) *e si pasojë* ***vetëmohohet*** ($-\bigcirc$), duke krijuar kështu *grimcat* ($\textcircled{\scriptsize◐}$) *materiale* (●), tërë materien, tërë Botën materiale.

Shohim pra atëhere se si *hipoteza shkencore e Heisenbergut dhe Miti i Sakrificës Kozmogonike i Mendimit Mistik përputhen. Dhe ky është një ndër rastet e shumta kur Shkenca Moderne dhe Mendimi Mistik* (*mitik*) *thonë simbolikisht të njëjtën gjë*. Kjo dhe ka bërë që shkenca moderne, ndër të tjera Fizika, t'i drejtohet sot, në kërkim të një platforme, të një themeli fillosofik të rezultateve dhe zbulimeve të saj aq të çuditshme dhe të *paarsyeshme* sa të duken absurde, Mendimit Mistik.

Para se të përfundojmë me këtë pikë, le të vërejmë edhe sa vijon:

a) Hipoteza e Heisenbergut ishte "aq e çmëndur" sa të qe e vërtetë, siç kërkonte Bohri. Dhe vërtetë:

Prime matter (lat. *materia prima, substanca e parë...*)

del sipas hipotezës së tij se është simbolikisht ○. Por kemi, siç e dimë:

$$\bigcirc = (x = -x) = -(x = x) = \textit{jo llogjikë formale, jo llogjikë,}$$
jo arsye, diçka e paarsyeshme, diçka absurde, diçka e "çmendur..."

b) *Fusha e vakuumit* e Fizikës moderne (kuantike) si substrakti më i thellë, më i mbramë i materies dhe që është në vetvete si e tillë jo materiale, përputhet me konceptin e Mendimit Mistik të *Boshit mistik* (angl. *Mystic Void*) i cili përputhet nga ana e tij me atë të **hiçit** (it. *nulla*, angl. *nothingness*, fr. *nèant*).

Lexojmë mbi simbolizmën e *hiçit*, (Cirlot, fq. 229):

> **Hiçi**: Upanishadet flasin për disa *stade* (*faza, shtresa*) të koshiencës së Qënies, duke nisur që nga gjëndja e të qënurit "zgjuar" (një gjëndje kjo e mbushur me forma objektive) e gjer tek ajo e gjumit, e ëndrrës që strukturohet sipas impulsesh subjektive dhe të thella e gjer më në fund tek koshienca e thellë, pa imazhe, pjesë e gjumit më të "rëndë".
>
> Kjo gjëndje e fundit lidhet me *hiçin mistik* (angl. *Mystic Void.*). Është mjaft e rëndësishme, në qoftë se duam të kuptojmë siç duhet konceptin e *Nirvanës* si edhe atë, gjithashtu, të *asgjësimit* (*hiçëzimit*), të kihet e qartë se ky "hiç" i misticizmit lindor nuk do të thotë një mohim absolut, një vdekje të gjithshkaje, por indiferencimi, mungesa, me fjalë të tjera, e çdo opozite e kontrasti dhe, për pasojë, mungesa e dhimbjes dhe e dinamizmit. Guéinon gjatë përshkrimit të kësaj doktrine të stërlashtë hindiane thotë ndër të tjera: "Në këtë gjëndje indiferencimi, objektet e ndryshme, si të jashtme ashtu dhe të brëndshme, të manifestimit individual nuk shkatërrohen por vijojnë të ekzistojnë në një mënyrë "parësore", si të unifikuar për faktin se nuk konceptohen ndën aspektin sekondar dhe kontigjent të dallimit; ato ndeshen domosdoshmërish brënda mundësive të Unit që mbetet koshient në vetvehte për të gjitha mundësitë e tij të vështruara "padallimisht" në "koshiencën integrale".
>
> Ky koncept i *hiçit* si "*realitet jo objektiv*" e pra *i pashprehshëm*, ka mundësi të jetë përçuar përmes Lindjes së Mesme edhe Persisë tek mistikët çifutë. Sipas rabinit Joseph ben Shalen që jetoi në Barcelonë në shekullin XIII, një rëndësi e veçantë i do kushtuar ndër përshkrimet simbolike të Zotit në reveletën e Tij, atyre që lidhen me *hiçin mistik* që ngre krye e bëhet i dukshëm në çdo "humnere-çarje" të ekzistencës. Ai thotë më tej se në çdo

transformim të realitetit, në çdo krize* ose çast vuajtjeje, në çdo metamorfozë ose ndryshim forme, si edhe në çdo rast kur gjëndja e një sendi pëson një ndryshim (*alterohet*) abisi (*humnera*) e *hiçit* hapet dhe bëhet e dukshme për një çast mistik, sepse asgjë nuk mund të ndryshojë pa ardhur në kontakt me këtë zonë të Qënies Absolute që mistikët e lindjes e quajnë *HIÇ* (angl. *Nothingness*)... Ekziston një anagramë kabalistike që rikonfermon sa më sipër duke vënë në dukje se si *hiçit* në hebraisht i thonë **Ain**** dhe se po këto gërma shërbejnë për të formuar fjalën **Ani** (*unë*).

Pra, siç shohim nga kjo citate, *hiçi* është prap **Qëndra**, ashtu sikundër edhe **pi**-*ka* gjeometrike që është *jo materiale* (– *pika fizikë*, –●) është prap *boshi*, është prap *hiçi*, është prap **qëndra**, është, e thënë ndryshe, simboli **PI**, në simbolikën kineze, një **vrimë** në imazhin rrethor të hapësirës që paraqet *shtegun e transhendencës*, e pra **Qëndrën**.

Duke qënë kështu ne mund të shkruajmë ekuacionin:

Zoti = Hiçi

Nga ana tjetër ne shohim se si nga Hiçi del gjithshka, se Hiçi prodhon gjithshka. Po ky është një *hiç* që s'është sigurisht i tillë, që s'është mungesa e gjithshkaje sikundër arsyeja jonë priret krejt natyrshëm ta përfytyrojë.

Jo vetëm fizika moderne por edhe fillosofia moderne arrin sot në konkluzionin se nga *Hiçi Mistik* dalin të gjitha, prodhohen të gjitha.

---

* Angl. *crise* nga shqipja *kris*.

** Algoritmi Simbolik na ndihmon në të kuptuarit e barazimit esencial **Ain** (*hiçi*) = **Ani** (*unë*). Dhe vërtetë ne mund të shkruajmë në gjuhën e simboleve ekuacionin:



***in*dividi**	*material*	*Zoti*
	mishëror	*Hiçi*

Kjo do të thotë se njeriu e ka brënda Zotin dhe Mbretërinë e Tij (○). Këtë e rikonfermojnë edhe shumë pasazhe nga Ungjilli si për shëmbull ky: "...Mbretëria e Qiejve nuk vjen në mënyrë që të bjerë në sy; dhe as do të thuhet: ja tek është këtu, ja tek është atje... Dhe kjo sepse *Mbretëria e Qiejve është brënda jush*". (Ungjilli sipas Llukës, 17:20-21).

Kështu bie fjala, në fillosofinë e Heideggerit, një nga përfaqësuesit më të shquar të ekzistencializmit modern, në librin e tij *"Çfarë është Metafizika?"* (gjerm. *"Was ist die Metaphysik?"*) lexojmë lidhur me këtë çështje, ndër të tjera, edhe sa vijon (fq. 101):

"Qënja e pastër dhe Hiçi i pastër janë e njëjta gjë."

Kjo tezë e Hegelit (vijon më tej Heideggeri) mbetet e vërtetë.

Dhe më poshtë:

"Parimi i lashtë *ex nihilo nihil fit* (nga hiçi nuk prodhohet asgjë, nga asgjë nuk prodhohet asgjë) merr pra një kuptim tjetër që lidhet me vetë "problemin e Qënies" dhe që mund të formulohet në këtë mënyrë: *Ex nihilo omne ens qua ens fit* (nga hiçi prodhohet gjithshka)". (fq. 102)

"Qënja vetë përmban zanafillimisht në esencën e saj *hiçin"*. (fq. 93)

"Shkenca do të deshte, me një gjest superioriteti, ta mohonte *hiçin*. Por ne pamë se vetë ekzistenca e Shkencës është e mundur vetëm në se ajo mbahet brënda *hiçit*. Ajo mund ta kuptojë veten e saj, për sa është dhe ç'është, vetëm në se nuk e mohon *hiçin"*. (fq. 103)

"Mohimi përbën një pjesë integruese të esencës së mendimit njerëzor" (fq. 95)

"Rikonfermohet kështu, në vija të përgjithshme, ajo sa u tha më sipër: *Hiçi* është origjina e mohimit dhe jo anasjelltas". (fq. 96)

(Këto citate janë marrë nga libri i Heideggerit në përkthimin italisht: *"Che cosa è la Metafisica"* Milano, Fratelli Bocca, Editori 1942).

Le të mjaftohemi hë për hë me kaq.
Vëmë rè pra se:

a) sipas fillosofisë se Heideggerit, *hiçi* është themeli dhe origjina e gjithshkaje (domethënë i çdo sendi material). Algoritmi e tregon qartë këtë me formulën:



...(**F**)

Bota Materiale *hiçi*

Shikojmë në këtë rast se **hiçi** (○) rri i **fshehtë** ⊡ (fillosofikisht *immanens*) në këtë botë:

"...hiçi na fshihet në karakterin e tij zanafillor..." (Heidegger, fq. 94)

Ky është "*Deus absconditus*" i mistikëve të krishterë, si bie fjala i Nicola di Cusa që shkruan tërë një libër pikërisht me këtë titull (*Zoti i fshehur*), ky është *Zoti i panjohur* i Shën Palit* e kështu me radhë.

b) Heideggeri thotë:

"Hiçi është origjina e mohimit dhe jo anasjelltas" (fq. 96)

Kjo do të thotë atëhere se simbolikisht mund të shkruajmë:

$$\bigcirc = 1$$
$$-1 = 2$$

Algoritmi Simbolik rikonfermon vërtetësinë e ekuacioneve të mësipërme. Por kjo do të thotë gjithashtu se *mohimi prodhohet nga hiçi*. Ne dimë se kemi:

$$\oplus = -1$$

Ku ○ është **hiçi**. Pra mund të themi se *mohimi* del nga **ndarja** *e hiçit.*

---

* Veprat e Apostujve , 17 22-24

Rikujtojmë këtu se në shqip për shëmbull:

i dātë = i ndarë (Ⓓ)
i dytë = *2*

dhe Algoritmi Simbolik jep:

$$2 = -1$$


Pra mund të themi kështu edhe se *mohimi* sjell më vete një **zgjerim** të *hiçit*, një **fryrje** të tij. Dhe vërtetë dimë se:

$$\bigcirc = \mathbf{E} = (x = -x) = (x^2 + y^2 = 0)$$

dhe:

$$-1 = F = (x = x) = -(x = -x) = -(x^2 + y^2 = 0)$$
$$= (x^2 + y^2 = r^2)$$

Grafikisht:



Kjo tregon pra edhe një here se *mohimi vjen pas hiçit*.

Nga ana tjetër kemi, siç e kemi parë:

$$\underset{\textit{hiçi}}{\bigcirc \cdot \bigcirc} = -\bigcirc = \underset{\textit{mohimi}}{-1}$$

---

* Kjo sa thuhet këtu mbi **fryrjen e hiçit**, lidhet në një farë mënyre me teorinë e Inflacionit në Kozmollogjinë moderne.

Gjë që tregon se *"mohimi* **prodhohet** nga *hiçi"*, nga *hiçi* që vepron mbi veten e vet, e pra pa ndihmën e ndonjë entiteti tjetër.

Rikonfermohet pra kështu vërtetësia (apodiktike) e pohimeve të Heideggerit. Po ka edhe më, ne dimë se kemi:

$$\textit{Mendimi shkencor} = \textit{mendimi racional} =$$
$$\textit{Ratio} = \textit{Arsye} = \textit{llogjika formale} =$$
$$\textit{llogjika e Tertium Non Datur} = (x = x) = F = -1$$

Rikonfermohet kështu ajo sa thotë Heideggeri (fq. 95):

"Mohimi bën pjesë integruese në esencën e mendimit njerëzor"

Hediggeri thotë me tej (ibidem, fq. 99):

"Pyetja jonë mbi hiçin duhet të na paraqiti vetë metafizikën"

Me fjalë të tjera mund të shkruajmë:

$$\bigcirc = \textbf{Metafizika} \qquad \ldots(\mathbf{E})$$
$$-\bigcirc = \textbf{Fizika} \text{ (gr. } \varphi\acute{\upsilon}\sigma\eta = \textit{natyra}) \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

E pra kështu dy kodet tona janë: njëri për zbulimin e të vërtetave të Metafizikës (të *Përtejmes*) dhe tjetri për zbulimin e të vërtetave të Fizikës (shkencave të ndryshme). Kjo pra e bën mendimin njerëzor që mbështetet mbi llogjikën e *të Tretit të Përjashtuar* (*llogjika formale, llogjika aristoteliane, arsyeja njerëzore...*) krejt të paaftë për zbulimin e të vërtetave metafizike (ose **noumenike**), sikundër që Kanti e vuri rè dhe e provoi i pari.

Nga sa pamë ne arrijmë në përfundimin mes të tjerave se edhe fillosofia moderne (Heidegger) lidhet ngushtë me Mendimin Mistik. Ka një sërë shkrimesh të botuara sot që e vënë në dukje këtë fakt*.

* Shih për shëmbull librat:

Kjo bisedë mund të zgjerohej dhe të pasurohej së tepërmi duke dhënë mundësinë e nxjerrjes së një informacioni tepër të rëndësishëm fillosofik, por po ndalemi këtu për arsye që nënkuptohen. Lexonjësit mund t'i duken pa vend të gjitha këto disgresione të gjata fillosofike e shkencore në një libër të tillë si ky që duhej të sillej e përsillej vetëm mbi një truall të mirëfilltë linguistik... Por ai duhet të këtë parasysh se *është fjala këtu për një linguistikë disi në mos po krejt ndryshe nga e zakonshmja, tradicionale. Ai* (lexuesi) *duhet të këtë parasysh se pikëpamja nga e cila ne vihemi për ta shqyrtuar fenomenin linguistik është thellësisht fillosofike dhe kjo sepse, porsa që zbulohet që fjalët kanë një kuptim, se nuk janë konvencionale dhe arbitrare, atëhere ato domosdoshmërish duhet të shihen si përçuese të një vizioni mbi Botën. Dhe ky vizion nuk mund të jetë tjetër veçse fillosofik e madje, metafizik. E pra atëhere është fillosofia e lashtë dhe e rè, është metafizika e lashtë dhe e rè, është mendimi i lashtë dhe i ri që jo vetëm duhet të shërbejë si një mjet euristik për "zbulimet" tona linguistike* (kryesisht **shpjegimi i fjalëve, çpalosja e kuptimit të fshehtë, motivimi** i tyre*), por edhe si një kriter i sigurtë dhe i gjithpranishëm për saktësinë e zbërthimeve tona. Njohja e të gjitha fillosofive që janë fundja më në fund një fillosofi e vetme, ajo që Leibnitzi e pagëzoi me emrin* ***Philosophia Perennis*** (Fillosofia e përjetshme),

---

Heidegger's Hidden Sources : East Asian Influences on His Work by Reinhard May, Graham Parkes (Editor).

Carlo Saviani: *L'Oriente di Heidegger*, Genova, Il Melangolo, 1998.

Shih për sa i përket lidhjes së ngushtë të fillosofisë së Hedeggerit me mendimin mistik e pra edhe me Perennial Philosophy edhe librin: *Heidegger and the asian thought*; edited by Graham Parkes, 1987, University of Hawaii Press.

Ja se çfarë shkruan lidhur me këtë libër "*The Japanese Journal of Religious Studies*".

"The present volume is rich in anecdote and provides a valuable overview of the state of the debate between Heidegger and Asia. It shows how Heidegger's critique of metaphysics has in principle brought to an effort to understand the deepest philosophies of the East in metaphysical terms and cleared the horizon for **an encounter in which the simplicity and otherness of Tao and Zen discourse can be properly appreciated, and in which texts such as those of Vedanta, often dismissed as "mystical", can be understood anew as works of "thought"**.

(Ky vëllim është i pasur me anekdota dhe jep një panoramë me vlerë mbi debatin e Heideggerit me Azinë. Ai tregon që kritika e Metafizikës nga ana e Heideggerit e ka nxitur këtë të fundit për një përpjekje për të kuptuar fillosofitë më të thella të Lindjes në terma metafizike dhe ka pastruar horizontin **për një takim në të cilin thjeshtësia dhe universaliteti i diskursit Taoist dhe Zen mund të çmohet në shkallën e duhur dhe ku tekste të tilla si ato të Vedanta-s, të lëna mënjanë si "mistike", mund të rishikohen e të kuptohen sërishmi si vepra të "Mendimit"**.)

është një kusht, një kërkesë e domosdoshme në këtë metodollogji të rè linguistike. Sa më thellë, sa më tepër ne t'i mbështetim argumentat tona (lidhur me motivimin e fjalëve sanskritisht dhe lidhur me ***reduktimin*** *e tyre zbërthyes, shpjegues në shqip), mbi tërë diturinë e kohërave duke gjetur në të një konvergjencë, një unanimitet rikonfermimesh, aq më të sigurtë do të jemi se ecim në rrugë të drejtë. Prandaj pra inkursionet, sipas rastit e nevojës, në fusha të ndryshme ekstralinguistike nuk kanë përse të na vihen në dukje si një e metë, si një dalje jashtë temës.* Përkundrazi...

Le të kthehemi përsëri tek Kanti.

Në antinominë e tretë të Arsyes së Pastër thuhet, siç pamë:

Teza pohon ekzistencën e një shkakësie tjetër,
një shkakësi nëpërmjet lirisë.

Simbolikisht:

lirì = – **skllavëri** = – ⋈

Ne dimë se *shkakësia* e zakonshme jep ekuivalencën:

$$\leftrightarrow = \bowtie \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

Duke shumëzuar të dy krahët me (– *1*) do të kemi:

$$-\leftrightarrow = -\bowtie \qquad \ldots(\mathbf{E})$$

Do me thënë *shkakësia përmes lirisë* për të cilën na flet teza nuk është gjë tjetër veçse *akauzaliteti* i Fizikës kuantike $(-\oplus)^*$, të cilën edhe vetë Einsteini, kundërshtar i vendosur i Fizikës kuantike dhe i "absurditeteve" të saja, detyrohet

---

* Mos harrojmë se:

Fizika kuantike = Parimi i Papërcaktueshmërisë = $-\oplus = \bigcirc =$
$(x = -x) = E = - \leftrightarrow = -\bowtie = \ldots$

ta pranojë. Ja fjalët e tij tekstuale:

> "Hitherto people have looked upon the Principle of Causality as a proposition which would in the course of years admit of experimental proof with an ever-increasing exactitude...
>
> Now, Heisenberg has discovered a flaw in the proposition... The Principle of Causality loses its significance as an empirical proposition.
>
> Causality is thus only conceivable as *a Form of the theoretical system.*"*
>
> (Gjer më sot është parë tek Parimi i shkakësisë një propozicion që me kalimin e kohës do të mund të vërtetohej eksperimentalisht me një saktësi gjithnjë e më të madhe...
>
> Mirëpo Heisenbergu gjeti në këtë propozicion një të metë... Parimi i Shkakësisë e humbet kështu rëndësinë e tij si një propozicion empirik.
>
> Shkakësia tanimë është e konceptueshme vetëm si një "Formë e sistemit teorik".)**

Vëmë në dukje me këtë rast se *akauzaliteti* ($- \leftrightarrow$) sjell më vete si pasojë llogjike *mosligjishmërinë, lirinë* ($- \leftrightarrow = -\aleph$). Fizika kuantike, fizikë e subatomikut të thellë, flet qartë sot për rënien, për inefikasitetin e konceptit klasik të ligjit, gjë të cilën Einsteini nuk e pranoi dhe shqiptoi me këtë rast fjalët e famshme: *Unë nuk besoj se Zoti lot me zare...* Por duke vepruar kështu, shihet qartë se si **Einstein-i bie në kundërshtim me veten e tij**, sepse ***pranimi*** i *akauzalitetit* (dhe ai e pranoi) sjell më vete llogjikisht siç e pamë edhe pranimin e *ilegalitetit*, e *paligjshmërisë*, e *lirisë* në subatomikun e thellë***.

Për sa i përket Tezës në antinominë e katërt****, ne dimë se sipas Algoritmit

---

* Kjo citatë është vendosur edhe në *Pjesën e parë* të këtij studimi (fq. 109) por përsëritja e saj këtu është bërë me qëllim që lexuesi ta ketë atë më lehtë e më qartë parasysh.


** Shih librin e James L. Christian; *Philosophy, Rinehart Press*, San Francisco, fq. 390.

*** Me anë të Algoritmit Simbolik kjo do të vërtetohej fare thjesht:

$$\text{Akauzalitet} = - \leftrightarrow = \mathbf{E} = -\aleph = \textit{jo ligj, liri}$$

**** "Botës i përket, qoftë si pjesë apo qoftë si shkak i saj, diçka që ekziston si një qënie absolutisht e domosdoshme."

Simbolik kemi:



Prandaj pra Teza ka dhe këtu të drejtë.

Fakti që Fizika moderne gjithmonë e më tepër flet për një Substancë Spirituale në themel të materies dhe të tërë ngrehinës së Gjithësisë*, e rikonfermojnë këtë. Le të sjellim prapë e prapë ndërmend shprehjen e bukur e të goditur të Teilhard de Chardin:

Dans le coeur de la matière il y a l'Esprit...

Le të rikthehemi pas këtij disgresioni të gjatë por të nevojshëm tek Sanskritishtja...

Në qoftë se Sanskritishtja e bën arsyen gjysmake (**artha** = *arsye*, ardha = *gjysma* e pra, *arsye* = **artha** = **ardha** = $^1/_2$, ◑), kjo do të thotë se ajo nuk është e përshtatshme, sipas fillosofisë së lashtë hindiane, të na ndriçojë mbi të *tërën* [○ = $(x = -x)$] por vetëm mbi *një pjesë të saj* [◑ = $(x = x)$], se ajo nuk mund të na informojë mbi *noumenin* (esencën e gjërave) por vetëm mbi *fenomenin* (sipërfaqen, façatën e gjërave). Edhe në gjuhë të tjera, siç e kemi e parë, vërehet e njëjta gjë.

Kështu në italisht:

$$\begin{cases} \textbf{ragione} = \textit{arsye} = (x = x) = \leftrightarrow \\ \textbf{regione} = \textit{krahinë, pjesë} = ◑ \end{cases}$$

Në latinisht:

---

* Shih për këtë edhe librin e Jean Guitton: *Dieu et la science* (Bernard Grasset, Paris). Ky libër është përkthyer edhe në shqip me titullin *Zoti dhe shkenca*, Infbotues-2005.

$$\begin{cases} \textbf{ratio} = \textit{arsye} = (x = x) = \leftrightarrow \\ \textbf{ratio} = \textit{porcion, pjesë} = \textcircled{1} \end{cases}$$

Në shqip:

$$\begin{cases} \textbf{pse}\text{-ja} = \textit{arsyeja} = (x = x) \\ \textbf{pjesa} = \textcircled{1} \end{cases}$$

etj. etj.

Kjo pra (që arsyeja ishte gjysmake) dihej mirë nga të gjithë popujt e lashtë, siç dëshmon gjuha e tyre. Në gjermanisht kjo duket edhe me **troç**:

$$\begin{cases} \textbf{deshalb} = \textit{për këtë arsye} = (x = x) \\ \textbf{Halb} = \textit{gjysma} = \textcircled{1} \end{cases}$$

Por atëhere si, njeriu do të mos këtë kurrë mundësi të ketë një pamje mbi të **tërën** e diç të njohi nga e *Përtejmja*?

Po, na përgjigjen drejt e tërthorazi fillosofitë dhe fetë e lashta, por jo në mënyrë *racionale*, jo me *mendje*, jo përmes *mendimit!*... Po si? Përmes **ekstazës** (= *dalja nga vetja*) fetare, mistike, përmes një hovi mistik falë të cilit njeriu bashkohet, identifikohet me Hyjninë.

Nga ana tjetër, e **tëra** (simbolikisht – $\textcircled{1}$, e pra $\bigcirc$) rroket, sipas fillosofisë të lashtë hindiane, jo përmes dy syve, por përmes *Syrit të tretë* (*Syri i Shivës*)...

Lexojmë lidhur me këtë në librin e Jean Chevalier: *Dictionnaire des Symboles,* Robert Laffont éditeur:

> "Cette perception **unitive** est la fonction du troisième oeil, l'oeil frontal de **Shiva**. Si les deux yeux **physiques** correspondent au soleil et à la lune, le **troisième** oeil correspond au feu. Sen regard réduit tout en cendres, c'est -à - dire, qu'exprimant le présent sans dimensions, la **simultanéité**, *il détruit la manifestation*. C'est le *Prajnâ-chaksus* (oeil de la sagesse) ou *Dharma- chaksus* (oeil de Dharma) des bouddhistes qui, situé à la limite de **l'unité** et de la **multiplicité**, **de la vacuité e de la non vacuité**, permet de les saisir

simultanément. C'est en fait un organe de la vision **intérieure**, et partant une "*extériorisation de l'oeil du coeur* ... Le troisième oeil indique la condition **surhumaine**, celle *où la clairvoyance atteint sa perfection.*

La vision dualistique est aussi une perception mentale: "L'âme a deux yeux" écrit Silesius: " l'un regard le temps, l'autre est tourné vers l'éternité. Selon les Victorins, l'un est l'amour, l'autre la fonction intellective. On conçoit de nouveau que la vision intérieure doit unifier de telles dualités. Selon Platon et saint Clément d'Alexandrie, "l'oeil de l'âme" est non seulement unique, mais sans mobilité; il n'est donc susceptible que d'une perception globale et synthétique. La même expression d'"oeil du coeur ou de l'esprit" peut être relevée chez Plotin, chez Augustin ou chez saint Paul, chez saint Jean Climaque, chez Philotée le Sinaite ou chez Elie l'Ecdicos, ou chez saint Grégoire de Nazianze... L'oeil du coeur c'est l'homme "voyant" Dieu, mais aussi Dieu "voyant" l'homme. Il est l'instrument de **l'unification** de Dieu et de l'âme, du Principe et de la manifestation... (fq. 551)

(Ky perceptim **njënjësues** është një funksion i syrit të tretë, syri ballor i **Shivës**. Ndërsa të dy sytë **fizikë** i përgjigjen diellit dhe hënës, syri i **tretë** i përgjigjet zjarrit. Vështrimi i tij shndërron gjithshka në hi, që do të thotë se duke shprehur të tashmen pa dimensione, **simultanitetin** (*njëkohshmërinë*), ai *shkatërron manifestimin*. Është fjala këtu për *Prajna - chaksus* (*syri i urtësisë*) ose *Dharma - chaksus* (*syri i Dharmës*) i budistëve që, i vendosur në skaje të unitetit (*njënjëshmërisë*) dhe multiplicitetit (*shumësisë*), të boshllëkut dhe të mos-boshllëkut, lejon rrokjen e të dyve në mënyrë simultane. Ky është në fakt një organ i pamjes së brëndshme dhe, në të njëjtën kohë, një *jashtësim i syrit të zëmrës*... Syri i tretë flet për një gjëndje mbinjerëzore, në të cilën *qartëpamësia arrin përsosjen e saj*.

Edhe pamja dualistike është gjithashtu edhe ajo një perceptim mendor: *"Shpirti ka dy sy"* shkruan Silesius: *"Njëri vështron kohën, tjetri është kthyer nga përjetësia"*. Sipas Viktorinëve, njëri është dashuria, tjetri funksioni intelektual. Është e qartë se pamja e mbrëndshme duhet t'i unifikojë këto dualizma. Sipas Platonit dhe shënjt Klementit të Aleksandrisë, "*syri i shpirtit*" jo vetëm që është unik por edhe nuk lëviz ndaj pra ai është i aftë vetëm për një perceptim global dhe sintetik. E njëjta shprehje "*syri i zemrës ose i shpirtit*"

ndeshet edhe tek Plotini, tek Agostini si edhe tek shën Pali, shën Gjon Klimaku, Filoteu Sinaiti, Elia i Ekdikos ose shën Grigori i Nazianzit... Syri i zemrës është njeriu që "sheh" Zotin, por edhe gjithashtu Zoti që "sheh" njeriun. Ai përbën mjetin e **unifikimit** të Zotit dhe të shpirtit, të Parimit dhe të manifestimit...)

Syri i tretë a *Syri i Shivës* njihet në Anatomi me emrin *Pinealis* ose *Epiphysis* (fjalë për fjalë **E Mbinatyrshmja**). Ajo është mbeturina e një syri të tretë tek njeriu. Sot më në fund kemi një interesim shumë, po shumë të madh për këtë gjëndër, gjer dje të mospërfillur dhe të pa vënë rè.

Pa hyrë në hollësira të tjera rreth kësaj çështje, hollësira të cilat mund të lexohen sot në një literaturë tepër të bollshme, le të vëmë veçanërisht në dukje lidhur me Epifizën, *antiseksualitetin* e saj. Lexojmë lidhur me këtë ato sa shkruan në një revistë mjekësore shkencore të viteve `80-të, hormonollogia e shquar rumune, Elena Damian:

"...All in all, the data presented herein show that the pineal has an inhibitory role in the reproductive function. These data, together with many others reported in the literature, substantiate the involvement of the pineal gland in the male gonad functioning... "

(Shkurt e me një fjale, të dhënat e paraqitura këtu tregojnë se gjëndra pineale ka një rol pengues, frenues në funksionin riprodhues. Këto të dhëna, së bashku me shumë të tjera, të sjellura në literaturë, provojnë ndërhyrjen e gjëndrës pineale në funksionimin e gonadës mashkullore...)

"... Research carried out on various species of laboratory animals showed that pinealectomy caused a gain in the weight of the testis ovary and the accessory sexual glands. Pineal treatment, as opposed to pineal ablation, caused a weight loss of gonads and partially or totally corrected the pinealectomy induced effects..."

(Eksperimente të kryera mbi lloj lloj kafshësh laboratorike, nxorën në shesh se ektomia (heqja) e gjëndrës pineale bëhej shkas për një rritje në peshë të ovariumit testikular si edhe të gjëndrave seksuale sekondare. Trajtimi me pinealen, si i kundërt me heqjen e saj, sillte me vehte një humbje të peshës së

gonadeve si edhe një korrigjim të plotë ose pjesor të efekteve të rrjedhura nga heqja e pineales...)

Pra mund të shkruajmë:

$$Epifisis = -seks = -\infty$$

Mirëpo Algoritmi Simbolik na jep:

$$-\infty = E = -F = -\bullet = \bigcirc = 1 = \ldots$$

Le të interpretojmë:

$-\bullet$ = *jo materie, jo botë materiale, jo manifestim*

e pra rigjejmë kështu atë sa lexuam rreth simbolizmit të Syrit të tretë të Shivës:

Son regard réduit tout en cendres... Il détruit la manifestation...

Me qënë se nga ana tjetër:

$$-\bullet = \bigcirc = (x = -x) = \textbf{Qëndër} = \textbf{Zoti} = E = 1 \ldots$$

ne shohim se Syri i Shivës është Sy Hyjnor dhe se ai, si i tillë, i bindet kodit **E** dhe jo kodit **F**, e pra *jo logosit formal, jo llogjikës njerëzore,* **jo arsyes**...

Është interesant të vihet rè se Syri i Tretë lidhet me llogjikën e *të Tretit të Përfshirë* (*Tertium Datur*). Pra Syri i Tretë i Shivës është pikërisht *i Treti që u përjashtua* (Llogjika e të Tretit të Përjashtuar), dhe kjo sepse, ndryshe, iluzioni i një Bote materiale (loja, mashtrimi i Majës sipas Fillosofisë së lashtë hindiane) që na jepet nga dy sytë e tjerë nuk do të mund të funksiononte. Pra ne mund të themi edhe se:

E = kodi *i Syrit të tretë të Shivës* (*Epifiza*)

$$F = \text{kodi } i \textit{ dy syve}$$

Dhe kemi kështu një riklasifikim a riemrim tjetër, origjinal, e që lidhet me fillosofinë e lashtë hindiane të dy kodeve tona, të dy logoseve a dy llogjikave.

Kështu pra, pyetjes se si mund të vihemi në kontakt me Realitetin e Mbramë, me të Përtejmen, me Zotin fundja më në fund, mund t'i përgjigjemi edhe kështu: me *Syrin e Tretë të Shivës*, pra me *Epifizën*. Se si e qysh bëhet kjo është një çështje tjetër që del nga kufijtë e këtij studimi, por përpjekje të shumta po bëhen sot për **riaktivizimin** në një mënyrë a në një tjetër, për **hapjen** në një mënyrë a në një tjetër *të Syrit të Tretë të Shivës*.*

Nga sa pamë del edhe se:

$$\textit{seksualitet} = \aleph = F = (x = x) = \textit{llogjika formale,}$$
$$\textit{arsyeja njerëzore} = \bullet = \textit{materia, bota materiale.}$$

Vëmë rè atëhere sa më poshtë:

a) llogjika formale ose arsyeja njerëzore lidhet ngushtë me seksualitetin, ekziston me fjalë të tjera një ekuivalencë e tillë:

$$\textit{racionalitet } (x = x) = \textit{seksualitet } (\aleph)$$

gjë që sanskritishtja e shpreh me biseminë e fjalës:

artha = *cause, raison, motif...; membre viril*

b) Me qënë se:

$$\textit{arsyeja} = (x = x) = F = \bullet = \textit{materia, bota materiale ...}$$

ne shikojmë se si **mendimi** (*arsyeja njerëzore*) dhe **materia** udhëhiqen e

* Shih për shëmbull, ndër shumë e shumë libra të tjerë: Serena Roney - Dougal: *"Where Science & Magic meet"*, Element, 1991.

rregullohen që të dyja nga e njëjta llogjikë, nga i njëjti logos (atij *formal*, ***F***). Ky është atëhere dhe shpjegimi i **përse**-së njeriu mund me anë të mendimit të njohë Botën materiale (**sipërfaqen** e saj, *anën* e saj *fenomenale* por **jo** *brëndinë* e saj të thellë *noumenale* që është si e tillë jo materiale, e pra **spirituale**...). Kjo ka shtyrë disa mendimtarë të shquar të kohës sonë (si për shëmbull: Arthur Koestler, në librin e tij *"the Sleepwalkers"*[*], etj. etj.) ta përfytyrojnë botën si një mendim, që do të thotë me fjalë të thjeshta se *brumi, mekanizmi i mendimit,* i të menduarit është njëlloj si ai i Botës materiale. Spinoza e përcaktoi këtë paralelizëm (i quajtur shpesh edhe *paralelizmi psikofizik*) me shprehjen e famshme: *Ordo rerum est ordo ideorum* (fjalë për fjalë: *Rendi i sendeve është i barabartë me atë të iderave*).

c) Me qënë se, siç pamë:

Pinealis = – **Seksualitet** = – **Penis** (fr. *membre viril*)

ne mund të shkruajmë edhe se:

F = *llogjika e Penusitetit* (*Tertium non Datur*)

E = *llogjika a Pinealitatit* (*Tertium Datur*)

Dhe ndalemi këtu:

bodhita - a.v. *qu'on fait connâitre, enseigné, communiqué, annonce, expliqué, instruit, informé* (*që bahet me ditë, që mëson, që komunikon, i njoftuem, i shpjeguem, i instruktuem, i informuem...*)

Duhet zbërthyer si:

bo dhita

dhe me shqipen:

bâ dītë (folja: *di, ditë...* etj. etj.).

---

[*] Arthur Koestler; *The Sleepwalkers*, a history of man's changing vision of the universe; Penguin Books ltd. (1959).

Të gjitha kuptimet dalin lehtë e krejt natyrshëm nga ky reduktim i fjalës sanskritisht tek shqipja (*dij, me ba me ditë, i ditun,* etj. etj.).

bodhya - a.v. *a connâitre, a comprendre ... qu'on doit instruire* (*për me ditë, për me kuptue; që duhet udhëzuar...*)

Duhet zbërthyer si:

bo dhya

dhe me shqipen:

bâ dí (folja *dij, ditë, ...dituri...*).

bodhi - f. *connaissance parfaite, révélation suprême, illumination not. qui mène à l'état du Buddha* (*njohje, dituri e përsosur, zbulesë supreme, ndriçim, veçanërisht i tillë që shpie në gjëndjen e të qënurit si Buda...*)

Do zbërthyer si:

bo dhi

dhe me shqipen:

bë di (folja *dij, ditë, dituri,* etj. etj.)

Vëmë rè me këtë rast se në shqip **dituni** lidhet me **ditë** (fr. *jour*) e pra edhe me *dritën*. Duke qënë kështu kuptojmë, përmes shqipes, edhe kuptimin e *ndriçimit* (fr. *illumination*).

Vëmë rè më në fund se emri **Buda** s'është tjetër veçse shqipja **Ba di** (*Ai* që *di*, Ai që nuk rron në *natën e padijes* por në *ditën e ditunisë*... etj. etj.).

bodhaka - *ikā* - ag. *qui réveille; qui instruit* (*që zgjon, që mëson...*)

Do zbërthyer si:

bo dha k a

ku: **-ka** është një prapashtesë që tregon personin, agjentin që kryen veprimin

(në shqip për shëmbull: **-tor**, **-cak**, etj. etj.)

Pjesa tjetër është shqipja:

bâ di (folja *dij, dita, dituni,* etj. etj.)

Vëmë në dukje këtu se në shqip:

ditë (fr. *jour*)

dhe:

me u ditë = *me u zgjue,* si për shëmbull në shprehjen:

Si u dite? (*si u gdhive, si u zgjove*)

Prandaj pra rrënja **ditë** lidhet në shqip edhe me *zgjimin,* po ashtu si edhe kuptimi *qui révéille* i kësaj fjale sanskritishte.

Vëmë rè me këtë rast edhe se në një sërë gjuhësh (që pasqyrojnë mendimin e lashtë të kohës së krijimit të tyre) *inteligjenca* lidhet me **ditën**, me **dritën**, me gjëndjen *zgjuar* (jo fjetur), ndërsa *mosinteligjenca* me **natën**, me **terrin**, me gjëndjen *fjetur*, me gjumin.

Prandaj pra dhe ne shqip: *i zgjuar* do të thotë edhe *që nuk fle,* që ka dalë, që është përmendur nga gjumi, por në të njëjtën kohë edhe *inteligjent.*

Po kështu edhe në greqisht: éksipnos (*ἔξυπνος*) - që ka dalë (eks-) nga gjumi (hypnos), që është zgjuar dhe në të njëjtën kohë: *i zgjuar, inteligjent.*

bhedya - a.v. *qui peut être fendu ou brisé ou perforé*
(*që mund të çahet, të thyhet ose të çpohet...*)

Do zbërthyer si:

bhe dya


dhe me shqipen:

bë daj (folja *me da*)

Pra kemi:

(bhedya)$_{\text{sanskr.}}$ = **(bhe dya)**$_{\text{sanskr.}}$ = **(bë daj)**$_{\text{shq.}}$

Por sipas Algoritmit Simbolik kemi edhe:



Përftohen kështu të gjitha kuptimet e fjalës sanskritisht **bhedya**.

bhedi-n (bhedana, ...) - *qui ébranle... ; qui contrevient à une convention, qui interrompt, qui trouble ou endommage*
(që çan, që thyen; që thyen një marrëveshje, që ndërpret, që turbullon ose dëmton...)[*]

Do zbërthyer si:

bhe din

është shqipja:

bâ dān (folja *ndaj, daj*).

E pra simbolikisht:



...(**F**)

Del kështu edhe kuptimi i *damit* (fr. *dommage*).
Vërejmë me këtë rast (duke përsëritur e zgjeruar) se, siç kemi parë[**]:

a) Fjala frëngjisht **dommage** lidhet me shqipen **damun**, pjesore e foljes *daj*, sikundër është edhe *dām*.

---

[*] Shih edhe faqen 332.

[**] Shih faqet: 152, 211, 212, 293, 379, 380 ...

damun *dommage*
(-mun)$_{shq.}$ = **(-mm)**$_{fr.}$

(asimilim regresiv)

b) Fjala italisht **danno** (shq. *dām*) lidhet me shqipen *damun*.

damun *danno*
(-mun)$_{shq.}$ = **(-nn)**$_{it.}$

(asimilim progresiv)

Në latinisht **damnus** (shq. *dām*) dhe është prapë shqipja *damun* etj. etj.

c) Në italisht **dannato, condannato** ... (shq. *i mallkuar, i ndëshkuar, i dënuar*) lidhet përsëri me shqipen *damun* dhe kjo sepse:

damun = ⏀ = ***F*** = ● = ♀ = –○

ku ● është ndër të tjera simboli *i të keqes, i të Zezës, i fatkeqësisë, i mallkimit, i Demonit, i Djallit* që ndahet nga Zoti (⏀) dhe e mohon, dhe i *kundërvihet* (–○) dhe që bie, rrëzohet nga froni *qiellor* (♀).

Po kështu edhe fr. *damner, condanmer...*, gjer. *verdammt,* angl. *dam, condemned, damned* etj. etj. të gjitha lidhen si me motivuesin e tyre një shqipe **damun**, simb. ⏀.

Shqipja **damun** motivon gjithashtu, siç është vënë në dukje edhe në *Pjesën e parë* të këtij studimi, edhe greqishten **daimon** etj. etj.

Demoni është **dëm***tuesi i parë*, që nga edhe fjala **dam** në shqip si në kuptimin e **damjes** ashtu edhe në atë të **damit** (fr. *dommage*).

bīja (*në kompozita, fjalë të përbëra...*) - fr. *germe* (*filiz, ajo që mbin*)

Lidhet me shqipen **mbij** (fr. *germiner*) dhe **bij** (*mbij* si edhe fr. *fille; fils...*)

ava-PAṬ - *mettre en pièces* (*coptoj*)

Do zbërthyer si:

a va PA Ṭ

me shqipen:

â bâ Ba dà

(â bâ) : bâ dà = dà = ⏀ = (*mettre en pièces*)$_{fr.}$, (*pjesëtoj, coptoj*)$_{shq.}$

ava-PAT - fr. *tomber* (*me rá*)
ava-PAD - fr. *tomber* (*me rà*)

Do zbërthyer si:

a va PA Ṭ
a va PA D

Dhe me shqipen:

(â bâ) : bâ dà = dà = ⏀

Por sipas Aloritmit Simbolik kemi:

⏀ = ♀ ...(**F**)

Dhe simboli i dytë shpreh kuptimin e **ramjes** (fr. *tom-ber*).
Vëmë rè me këtë rast se Sanskritishtja shtron ekuacionin simbolik në ***F***:

⏀	=	♀	...(**F**)
ava-PAṬ		**ava-PAT**	
(*pjesëtoj, ndaj*)		(*bie*)	

Ky ekuacion simbolik është tepër i rëndësishëm në Gjuhë. Ai shpreh **rënien** (♀) si pasoje e **ndarjes** (nga Zoti) (⏀), *ndarje* dhe *rënie* që bën të mundur *fillimin, ndërtimin e Botës materiale.*

Vëmë rè me këtë rast se ne shqip:

felë (*copë, pjesë*) = ⏀
fal (*falit*) = *bie, dështoj...* = ♀
filloj = -1 *

Kështu shqipja shtron ekuacionin simbolik:

$$\underset{felë}{⏀} = \underset{\substack{falem \\ falitem}}{♀} = \underset{filloj}{-1} \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

Kujtojmë se në shqip kemi gjithashtu:

$$\begin{cases} \textbf{ndarë} = ⏀ \\ \textbf{ndreq, ndër-}toj = ● \ (send\ material) \end{cases}$$

ava-NIJ - *laver;* °**nikta** - *lavé* (*laj; larë...*)

Është shqipja:

$$\textbf{a ba NYJ} = \textbf{NYJ} = ●$$

Këtu kemi të bëjmë me një rast të pozimit të Qëndrës në Gjuhë, do me thënë një rast të ekuacionit ($x = -x$). Në rastin kur:

$$x = ○, \qquad -x = -○ = ●$$

do të kemi:

$$\underset{(\mathbf{NIJ})_{sanskr.}}{○} = \underset{(\mathbf{NYJ})_{shq.}}{●} \qquad \ldots(\mathbf{E})$$

Siç shihet një krah i ekuacionit i përket një gjuhe, krahu tjetër një gjuhe tjetër. Si shqipja ashtu edhe sanskritishtja kanë hequr dorë nga partneri

* Fillimi është treguar me -1 me qënë se *fillimi i Botës* lidhet me një *involucion*, sipas Mendimit Mistik; me *Antitezën*, sipas Fillosofisë Hegeliane...

kontradiktor (shqipja nga *NYJ* = *laj*, sanskritishtja nga *NYJ, NIJ* = *nyj, ndyj*...). Dhe kjo, si gjithmonë, për të shmangur keqkuptimin.

Shëmbulla rastesh të tilla janë të shumta ndër gjuhët e ndryshme.

Kështu, bie fjala, në italisht:

caldo = *nxehtë*

kurse në anglisht:

cold = *ftohtë* (gjerm. **kalt**)

Pra mund ta shkruajmë:

$$\begin{array}{ccc} x & = & -x \\ (caldo)_{it.} & & (cold)_{angl.} \\ nxehtë & & -\ nxehtë = ftohtë \end{array} \qquad \ldots(\mathbf{E})$$

Një shëmbull tjetër.

Në gjermanisht **spät** = *vonë*; ndërsa në shqip **shpejt** = *herët*. Pra kemi:

$$\begin{array}{ccc} x & = & -x \\ (shpejt)_{shq.} & & (spät)_{gjerm.} \\ & & -\ shpejt = vonë \end{array}$$

E kështu me radhë*.

Vërë rè, duke u mbështetur në sa me sipër, edhe sa vijon:

Fjala italisht *netto* (*i pastër*) rrjedh nga sanskritishtja **nikta** (fr. *lavé*), me një asimilim progresiv:

$$(\mathbf{-kt})_{sanskr.} \rightarrow (\mathbf{-tt})_{it.}$$

Për arsyet që parashtruam më sipër ajo lidhet gjithashtu me shqipen

* Lidhur me këtë çështje shih dhe *Pjesën e parë* të këtij studimi.

nyt (= *– netto*).

Nga ana tjetër italishtja me çiftin ekuivokal **netto** = *i pastër...* (○) dhe **notte** = *natë* e pra (●) e shtron drejtpërdrejt ekuacionin e *Qëndrës* ($x = -x$):

$$\begin{array}{ccc} x & = & -x \\ \bigcirc & = & -\bigcirc = \bullet \\ (netto)_{it.} & & (notte)_{it.} \\ (i\ pastër) & & (natë) \end{array} \qquad \ldots(\mathbf{E})$$

Vërë rè me këtë rast se shqipja e shtron edhe ajo drejtë për së drejti këtë ekuacion me:

$$\begin{array}{lcl} i\ pastër & = & \bigcirc \\ i\ pistë & = & -\bigcirc = \bullet \end{array}$$

Nga ana tjetër gjermanishtja **Nacht** = *natë*, e pra simb. ●, është e qartë që lidhet me sanskritishten **nikta**, me greqishten **nikta** (*νυχτα*) = *natë*, me shqipen i **nytë** (sikundër edhe italishtja **notte**) e kështu me radhë.

Vërë rè gjithashtu se ne gjermanisht:

$$\begin{array}{ccc} \bullet & = & -1 \\ Nacht & & nicht \end{array} \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

Ky është një ekuacion mjaft i rëndësishëm që mund të interpretohet në mënyra të ndryshme:

1) *E keqja* (●) e pra dhe djalli lidhet me një *negativitet*, janë pra *diçka negative* (-1).

Kështu *Mefistofeli* (*djalli*) tek Fausti i Goethes thotë:

Ich bin der Geist	(*Unë jam Fryma*
Der stets **verneint**...	*që gjithmonë* **mohon**...)

2) *Materia* pra dhe *Bota materiale* (●) ka lindur nga *një mohim* (*– 1*). Dhe ne e dimë se është pikërisht kështu sepse:

a) Algoritmi Simbolik jep:

$$● = -○$$

Dhe *i Mohuari i Madh* që bëri të mundur *krijimin e Botës* (*Sakrifica Kozmogonike*) është vetë **Zoti**.

b) Sipas fillosofisë se Hegelit, Bota krijohet si pasojë e alienacionit të Frymës Absolute, në momentin e *Antitezës*, Antitezë që mohon Tezën, do me thënë *Frymën Absolute*, *Zotin*, e pra $-○$, e pra -1 etj. etj.

c) Ne mund të themi edhe se *krijimi i Botës* (●) është një **involucion** (*– 1*) siç është dhe teza e vetë Mendimit Mistik i konsultuar drejt për së drejti.

Kështu tek Cirlot lexojmë:

> "... The great themes of death and resurrection, related respectively with the cycle of **involution** (progressive **materialization**) and *evolution* (**spiritualization** or the **return** to the point of **origin**), gave rise to many myths and legends..." (fq. li)
>
> (... Temat e mëdha të vdekjes e të ngjalljes që lindin respektivisht në ciklin e involucionit (**materializim** progresiv) dhe në atë të evolucionit (**spiritualizim** ose **kthim** tek pika e **origjinës**), janë bërë burim i shumë miteve dhe legjendave...)*

a-mita - a.v. *non mesuré, démesuré, indéterminé*
(*i pamatur, i pamasë, i papërcaktuar*)

Do zbërthyer si:

a mita

---

* Shih lidhur me këtë çështje edhe në faqen 397, ku, në një citat nga Cirlot, flitet për "**rënien** e shpirtit në planin material të ekzistencës nëpërmjet procesit të **involucionit**".

dhe me shqipen:

– **mat** (*jo māt*, që *s*'është ***māt***)

E pra simbolikisht:

$$-\textcircled{1}$$

Ky simbol jep edhe kuptimin e *papër***cak***tueshmërisë* ($-\boxed{1}$).

Vëmë rè se në Fizikë parimi i *papërcaktueshmërisë* ($-\textcircled{1}$) lindi si pasojë e pamundësisë së matjes së saktë në subatomikun e thellë.

Kështu pra koncepti i **matjes** dhe ai i *përcaktueshmërisë* (*determinizmit*) lidhen bashkë, sepse përshkruajnë që të dy të njëjtin simbol ($\textcircled{1}$).

a-mythyā - adv. *sincèrement* (*sinqerisht*)

Do zbërthyer si:

a myth yā

dhe me shqipen:

– **mat** = $-\textcircled{1}$

Le të tregojmë tani se simboli $-\textcircled{1}$, a vetë ai, a ndonjë ekuivalencë e tij simbolike mund të na japi kuptimin e *sinqeritetit*.

a) Simboli $\textcircled{1}$ mund të interpretohet ndër të tjera edhe si: *gjysma, ndërmjetësi, në mënyrë të ndërmjetme**, *të tërthortë* etj. etj.; kurse simboli $-\textcircled{1}$ do të thoshte në këtë rast *e tëra* e pra një njeri që thotë *tërë të vërtetën* e jo vetëm një pjesë, gjysmën e saj dhe aspak tërthorazi, por drejtë për së drejti... Dhe një njeri i tillë është pikërisht ai që ne e quajmë *i sinqertë*.

b) Dimë se Algoritmi Simbolik jep:

$$-\textcircled{1} = \boldsymbol{E} = (\boldsymbol{x} = \boxed{x})$$

Formula a fundit mund të interpretohet edhe si:

---

* Mund të shkruajmë $\textcircled{1} = (\,|\,)$ dhe ky simbol i fundit jep në mënyrë krejt adekuate kuptimin e *ndërmjetësit* (|), e pra edhe atë të **ndër**-*mjet-ësisë*...

Siç paraqitet jashtë (***x***) *ashtu është edhe mbrënda* (***x***)

E pra, atëhere, *i sinqertë, që nuk fsheh gjë...* Kurse formula e *pasinqeritetit*, e *hipokrizisë* do të qe:

$$\text{⦶} = F = (-x = \boxed{x})$$

Do me thënë *ndryshe jashtë* $(-x)$ *e ndryshe brënda* $(\boxed{x})$.

a-mythyākṛ - *rendre vrai* (*me e bâ të vërtetë*)

Do zbërthyer si:

a mythy ā kṛ

dhe me shqipen:

– **met** (*mat*) *â krý*

Do me thënë:

â (*asht*) **kry jo** (–) **e metë** (*mat*)

e pra simbolikisht:

$$-\text{⦶}^{*}$$

Nga interpretimi i këtij simboli duhet të përftohet kuptimi i të vërtetës.
Algoritmi Simbolik na jep:

$$-\text{⦶} = \bigcirc = (x = -x) =$$
Coincidentia oppositorum = *Zoti* = **E Vërteta**

Me qënë se:

---

* Me qënë se ⦶ është ndër të tjera edhe simboli i jo të *plotës* (që jepet simbolikisht ○), pra atëhere, e *plota*, e *përsosura* mund të paraqitet simbolikisht edhe me $-$⦶.

Simboli ⦶ është edhe ay i *matjes*. Duke qënë kështu kuptojmë atëhere aforizmën e shqipes:

Çdo matje është e metë

Fizika Kuantike e rikonfermon vërtetësinë e këtij pohimi me qënë se në Subatomikun e thellë, në bazë të parimit të Heisenbergut, nuk mund të ketë matje të saktë, kështu që çdo matje atje nuk mund të jetë veçse e metë (shih për këtë edhe ne faqen 198).

E Vërteta = $-\oplus$ = $\bigcirc$ = E

ne shikojmë se *kodi* E është kodi i të *vërtetës*, kodi i *vërtetësisë* dhe pra atëhere *kodi* $F = -E$ = *jo i vërtetë*. Ai mbetet të jetë kështu kodi i *fallsitetit, i rrenës.*

Mos harrojmë se:

$$F = (x = x) = (x^3 + y^3 + z^3 = r^3) = \textit{sipërfaqja e sferës}$$

shkurt **sipërfaqe**.

F është pra kështu *kodi i sipërfaqes* së gjërave, dhe si i tillë **i cektë**, e pra **i rremë** (fenomenal, kodi i dukurive, kodi i atyre që ***duken*** *se janë, po s'janë*...).

Le të nxjerrim nga sa më sipër disa pasoja të rëndësishme fillosofike.

a) Me qënë se:

$$-\oplus = \textit{e vërteta} = E$$

Ne *jemi në gjëndje të dallojmë atëhere të* ***vërtetën*** *nga* ***gënjeshtra***.

Mund të themi:

> "**Gjithshka i përmbahet *kodit* E është *e vërtetë*** (*absolutisht e vërtetë*) *është* ***hyjnore*** *është* ***e mirë***, *është* ***e thellë***, etj. etj."

> "**Gjithshka i përmbahet *kodit* F nuk është *e vërtetë***, është ***e rreme***, ***fallco***, ***djallëzore***, ***e keqe***, ***e cekët*** etj. etj."

Bëhet e mundur kështu *ndarja e pastër* (*dikotomia e qëruar*) mes të *Vërtetës* dhe *Rrenës*, mes të *Mirës* dhe të *Keqes*, mes *Zotit* dhe *Djallit*, etj. etj.

Për fillosofët e lashtë hindianë kjo dikotomi ishte krejt e qartë dhe e pastër, siç dëshmon ndër të tjera edhe analiza e Gjuhës sanskritishte.

Në një mënyrë më të detajuar mund të themi edhe se:

> "**Të gjitha interpretimet konceptuale të figurave simbolike në E janë të vërteta**".

"Të gjitha interpretimet konceptuale të figurave simbolike në *F* janë të rreme".

b) Dimë se:

$$E\ Vërteta = -\textcircled{1} = E = -\aleph$$

Duke qënë kështu jemi në gjëndje atëhere të kuptojmë përse në greqisht të vërtetës i thonë: *Alithia* (*αλήθεια*).

Kjo fjalë do zbërthyer si:

a lith - ...

ku **a** është privative, e pra:

– lith

Duhet, nga sa pamë, që:

$$e\ vërteta = -\aleph$$

pra duhet që:

$$(-\ \textbf{lith}) = -\aleph$$

që nga dhe:

$$\textbf{lith} = \aleph$$

Kështu pra tërë fjala greqisht **alythia** mund ndoshta të shpjegohet me rrënjen shqipe **lith** (*lidh...*) = $\aleph^*$.

Nga sa më sipër del gjithashtu se e Vërteta është e *zgjidhur* ($-\aleph$) (e pra dhe

---

* Me analizën e kësaj fjale greke është marrë edhe Heideggeri duke mbërritur pak a shumë në përfundime të njëjta, por, sigurisht, pa bërë motivimin e saj me anë të shqipes që ishte për të një gjuhë krejt e panjohur.

Përfitojmë nga rasti të vëmë në dukje se Heideggeri ka qënë ndoshta një nga fillosofët e parë të rëndësishëm të kohës moderne që është orvatur ta analizojë gjuhën dhe fjalët nga një pikëpamje thjesht fillosofike, pak a shumë siç bëjmë pjesërisht edhe ne në këtë studim, ndonëse në një mënyrë më sistematike, më frontale dhe rrënjësore.

Analizat fillosofike të gllosarit kryesisht të greqishtes së vjetër janë shpërndarë në vepra të ndryshme të Heideggerit por kryesisht në atë me titull: "Esenca e Gjuhës" (gjermanisht "Das Wesen der Sprache").

e *zgjedhur*, për të *zgjedhurit*... për të *zgjidhurit* nga zinxhirët e mashtrimit të kësaj bote...)*.

Vëmë në dukje me këtë rast se në greqisht:

lythos (λιθος) = *gur; materie*

e pra simbolikisht: ●.

Pra ne shohim se:

E Vërteta = **alithia** = $-$*lithia* = $-$*lith* = $-\aleph$ = $-$*lithos* = $-$●

Kjo do të thotë se natyra e të vërtetës nuk është materiale por **spirituale**.

Ne shikojmë gjithashtu se si greqishtja, me ndihmën e shqipes, shtron ekuacionin simbolik:

$$\underset{a\text{-}\mathbf{lith}\text{ia}}{-\aleph} = \underset{-\mathbf{lith}\text{os}}{-\bullet} \qquad \ldots(\mathbf{E})$$

Kështu greqishtja (me ndihmën e shqipes) flet qartë për natyrën **spirituale** (*jo materiale*) të së Vërtetës.

c) Pamë se *e Vërteta* = $-\oplus$

Por simboli i fundit ($-\oplus$) mund të interpretohet edhe si *Parimi i*

---

* *Zgjedhja* (angl. *choice*) lidhet me një propozicion llogjik të quajtur edhe ai i "disjunksionit të rreptë" ose ai i "*ose ... ose ...*" (lat. *aut... aut*) (shih për këtë edhe *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik*). Ky propozicion tregohet me simbolin $\underline{\vee}$. Tabela e tij e vërtetësisë përputhet me atë të $-\aleph$ (jo konjunksion) e pra ai shpreh kështu konceptin e *lirisë* ($-\aleph$).

Mund të themi pra se me çiftin thuajse homonimik i *zgjedhur*, i *zgjidhur* shqipja shtron ekuacionin simbolik:

$$\underset{i\ zgjedhur}{\underline{\vee}} = \underset{i\ zgjidhur}{-\aleph}$$

Kemi të njëjtën gjë edhe në italisht ku:

scelto = i zgjedhur = $\underline{\vee}$
sciolto = i zgjidhur = $-\aleph$

papërcaktueshmërisë i Heisenbergut, themeli mbi të cilin ngrihet tërë Fizika Kuantike.

Duke qënë kështu del se:

Parimi i Papërcaktueshmërisë në Fizikën Kuantike është i vërtetë
(absolutisht i vërtetë)

Pra dhe tërë Fizika kuantike (çdo propozicion i saj), që ngrihet mbi të del se është e vërtetë... Me qënë se:

$-\oplus = -\aleph$ = *absolut, jo relativ; i thjeshtë, ...*

del, ndër të tjera, se Fizika Kuantike është e **thjeshtë**, gjë që do të thotë se ajo s'ka ku të shkoj më tej, se ajo nuk mund t'i ndryshojë më tej parimet e saj që janë absolutisht të vërteta*.

Me qënë se më tej:

$-\oplus = \bigcirc$ = *i, e plotë*

kjo do të thotë se Fizika Kuantike është e plotë, është perfekte e se pra nuk ka përse të shtjellohet më tej (parimisht)**.

Me qënë se:

e Vërteta $= -\oplus = -\bullet$

ne shohim se Fizika Kuantike ($-\oplus$ = **parimi i papërcaktueshmërisë** në Fizikën Kuantike) në nivelin më të thellë subatomik, nuk studion më materien, por të kundërtën e saj, **vakuumin**, **Frymën**[***] gjë që i përgjigjet të vërtetës së

---

* E njëjta gjë nuk mund të thuhet për Fizikën Relativiste, sepse kemi:

Fizika relativiste = *relativitet* = $\aleph = -(-\aleph)$ = *jo e thjeshtë ...*

** E njëjta gjë nuk mund të thuhet për Fizikën Relativiste, me qënë se:

Fizika relativiste = *relativitet* = $\aleph = F = \oplus = -\bigcirc$ = *jo e plotë, jo e përsosur...*

*** Vëmë rè në shqip: *vrimë* (nga një trajtë e lashtë **vrymë**) (fr. *trou*), e pra *boshllëk*, *mungesë materieje*, *vakuum* dhe në të njëjtën kohë në shqip **frymë** (fr. *Esprit*).

fakteve...)*

Duke i rënë shkurt dhe duke përfunduar, ne shohim se si:

Analiza e Gjuhës sanskritishte (sikundër edhe e çdo gjuhë tjetër) na jep mundësi të nxjerrim një informacion që na lejon të gjykojmë mbi vërtetësinë a jo të propozicioneve të Fizikës, si edhe t'i zbulojmë ato vetë (këto propozicione) **me një interpretim adekuat të figurave e formulave simbolike që fjalët e Gjuhës përshkruajnë** (këtu Sanskritishtja).

Që këndej del **lidhja e thellë mes Gjuhësisë dhe Fizikës e në përgjithësi tërë shkencës bashkëkohore**, *gjë që nxirret në pah për herë të parë në këtë studim.*

Kjo do të thotë edhe një gjë tjetër: **se të lashtët i kanë ditur të gjitha këto që ne dimë sot, që ne sot po zbulojmë e do të zbulojmë, se ata kanë ditur gjithshka**, sepse duke operuar me kodin ***E*** **(*E* = ○ = e tëra**, *gjithshka...*) kanë mundur të gjejnë të *Vërtetën* (○), *absolute* (–ϗ), të *Vërtetën e mbrame* (**ω**).**

ç) Ne pamë se si greqishtja shtronte, me mdihmën e shqipes, ekuacionin simbolik:

$$\underset{(alithia)}{-\text{ϗ}} \quad = \quad \underset{(lithos)}{-\bullet} \qquad \ldots(\mathbf{E})$$

Me qënë se: $-\bullet = \bigcirc = (x = -x)$ = **Qëndra = Zoti = e Vërteta**, duke interpretuar –ϗ si *liri*, ne rigjejmë të thënën e famshme të Krishtit në Ungjill:

Edhe në italisht vihet rë e njëjta gjë. Atje **spira**glio (*vrimë*) ndërsa **spiri**to (*frymë*), etj. etj., gjë që i përgjigjet të vërtetës së fakteve...

* Shih *Pjesën e parë* të këtij studimi, faqe 112.

** Vë rë se në shqip:

mbarë	=	*e tëra* = ○
i,e mbrame	=	*i,e fundit,* ω (*Omega*)
i,e mbarë	=	*i,e mirë*
i mbaruem	=	*i përsosur*

"Do të mësoni të vërtetën (○) *dhe e vërteta do t'u bëjë juve të lirë* (–☌)" *

Ekuacioni i mësipërm, duke interpretuar ☌ si *ligji* dhe ● si *mëkati* mund të vështrohet si *përkthimi simbolik* i të thënës së Palit:

"Pa ligjin (–☌) *mëkati është i vdekur* (–●)" **

Duke shumëzuar të dy anët e ekuacionit të mësipërm me -1 gjejmë:

$$☌ = ● \qquad ...(F)$$

që mund të vështrohet si *përkthimi* simbolik i të thënës së Krishtit:

"Kush mëkaton (●) *bëhet skllav* (☌) *i mëkatit."* ***

Ekuacioni i fundit mund të vështrohet edhe si paraqitja simbolike e *Hieros Gamos* (Martesa e Shenjtë) (☌) nga e cila u përftua *bota materiale* (●).

Me qënë se, siç pamë *e vërteta* (sanskritisht):

$$\textbf{a-mythyā} = -\oplus = E = -☌ = ○ = -● = -♀ = -♌ = \ldots$$

ne shohim se Bota e krijuar (nëpërmjet *Hieros Gamos, martesës së shënjtë, thurrjes...*) mohohet nga e *Vërteta* (–☌).

Dhe dalim pra përsëri kështu tek mendimi themelor i Fillosofisë së lashtë hindiane sipas të cilës *Bota është e rreme, bota është e keqe* e kështu me radhë.

Biseda mund të zgjerohej edhe shumë më tepër se kaq, por detyrohemi të ndalemi, për arsye të kuptueshme, këtu...

---

* Shiko Ungjillin sipas Gjonit (8.32).

** Shiko Pali, Rromakët (7:8).

*** Shiko Ungjillin sipas Gjonit (8:34).

amla - a. *acide;* m. *acidité, chose acide* (*i thartë, thartì, send i thartë...*)

Është shqipja:

i amël (*i am-b-ël*) = fr. *doux*; angl. *sweet*; it. *dolce*

për *antitezë?*.

Ky është një rast tjetër, ndër të shumtët, kur Gjuha shtron drejt për së drejti ekuacionin e Qëndrës, por për të shmangur keqkuptimin, mban vetëm një krah të ekuivokut (ekuacionit), ndërsa krahu tjetër mund të gjëndet në një sistem tjetër gjuhësor, si këtu ne shqip.

Shkruajmë:

$$x = -x$$

Duke marrë:

$$x = \textbf{i amël}$$

do të jetë:

$$-x = \textbf{i thartë}\ (\text{ose } i\ hidhur)$$

Pra kemi:

$$x = -x$$
$$(\textbf{i amël})_{\text{shq.}} \quad (\textbf{amla})_{\text{sanskr.}}$$
$$doux_{\text{fr.}} \quad acide_{\text{fr.}}$$

UṢ-oṣati; uṣyate - *brûler; punir; détruire* (*djeg, dënoj, shkatërroj*)

Me këtë rrënjë lidhet shqipja:

ashk (*zjarr shpirtëror*) dhe **eshkë**

uṣna - a. *chaud; impétueux:* nt. m. *chaleur, ardeur...*
(*i nxehtë; i vrullshëm: nxehtësi, ashk...*)

Rigjejmë shqipen **ash-k**.

vedin - ag. *qui sait, versé dans; qui perçoit, éprouve; qui annonce...*

(*që di; që ndjen, që provon; që lajmëron, që njofton...*)

Duhet ndarë ne:

ve din

dhe është shqipja:

bë din (fr. *qui sait*)
bâ din

Për sa i përket kuptimeve të tjera, shqipja jep:

n-din (*ndjen*) = fr. *sent, perçoit*
bâ din (*ba me ditë...*) = fr. *qui annonce...*

veditṛ - ag. *qui sait* (*që di...*)

Do zbërthyer si:

ve di tṛ

dhe me shqipen:

bë di { **tur** / **tor** / **tar** }

ku: **-tor**, **-tar**, etj. janë në shqip prapashtesa vepruese (agjenti) sikundër është **tṛ** në sanskritisht (krahaso me shqipen *dije-tar*, etj.).

BANDH - *lier, attacher; nouer, joindre; capturer, faire prisonnier, saisir; arrêter, réprimer, empêcher... ; construire, bâtir,* not. *un pont, une digue: confiner, tracer des limites; composer,* not. *un poème, produire... ;* pass. *être lié,* etc. fig. *être esclave du péché, retomber dans le mal, être éprouvé, souffrir de...*
(*lidh, fiksoj, ngjit, bashkoj; ndaloj, prangos; me u lidh pas, me rrethue, mvesh; lidh* (me nyje), *bashkoj... ; ndërtoj, veçanërisht një urë, një digë; kufizoj, caktoj kufijtë; kompozoj, thurr, kryesisht një poemë, prodhoj... ;*

e kal. *jam lidhur,* etj. etj. ; *jam skllav i mëkatit, ribie në të keqen; vuaj nga...*)

Do zbërthyer si:

ba ndh

dhe me shqipen:

bâ ndá

Pra simboli që përshkruan kjo fjalë është ⊕.

Ky simbol shpjegon kuptimet: *kufizoj, caktoj kufijtë* si edhe kuptimin *ndërtoj*, si edhe kuptimin e *digës* (angl. *dam*).

Rikujtojmë se shqipja me:

⊕	=	●	...(**F**)
ndarë		**ndr**-*eq,*	
		ndër-*toj*	
		(realizimi ***material***)	

flasin qartë për lidhjen konceptuale ndërmjet **ndërtimit** (*krijimit.* etj.) dhe **ndarjes**, çështje që ne e kemi ndjekur gjetiu edhe në planin fillosofik*.

Rikujtojmë gjithashtu se në rusisht:

delits (*делить*) = *ndaj*, e pra ⊕
delats (*делать*) = *bëj*, e pra ●

E kështu me radhë edhe në një sërë gjuhësh të tjera.

Pra, ne shikojmë kështu se si parimi i Mendimit Mistik, sipas të cilit *Krijimi i Botës Materiale* (●) ka kërkuar një *ndarje* (⊕) gjen një pasqyrim drejt për së drejti në gjuhë (sanskritisht, shqip, rusisht, etj.).

---

* Vërejmë se jo çdo *ndreqje* bëhet me një *ndarje*, por ndreqja e parë, ndërtimi i Botës, është bërë sipas mendimit mitik me një **ndarje**, dhe nga ana tjetër, siç dimë, gjuha referon gjithnjë tek e **Para** (siç është këtu krijimi i Botës).

Kuptimi i dytë themelor i fjalës **BANDH** është ai i *lidhjes*. Pra kjo fjalë shpreh kryesisht *ndarje* (⌀) dhe *lidhje* (⋈).

Kjo shpjegohet me faktin se Algoritmi Simbolik (Strukturizim llogjik i Mendimit Mistik mbi themelin e të cilit ngrihen të gjitha gjuhët) jep, siç dimë:

$$⌀ = ⋈ \qquad \text{...(F)}$$

Ky ekuacion jepet, ndër të tjera, në shqip me:

pes = *5*, dhe **pjesë** = ⌀

Dimë se sipas mendimit mistik **pesa** simbolizon *Martesën e Shënjtë* (*Hieros Gamos*) ndërmjet Qiellit (*parimi mashkullor*, **3**) dhe *Tokës* (*parimi femëror*, **2**) me të cilin **Bota u krijua**.

Pra mund të shkruajmë:

5	=	⋈	=	●	...(F)
Martesë e Shënjtë				*Bota materiale*	

Por ne kemi në shqip, siç pamë:

5 = **pesë** = **pjesë** = ⌀

Që këndej pra dhe, përmes shqipes, përftohet ekuacioni simbolik:

⌀	=	⋈	...(F)
pjesa		**pesa**	
		(*Hieros Gamos*)	

Por ky ekuacion del në shqipe siç kemi parë edhe drejt për së drejti. Dhe në fakt në shqip kemi:

pesë = *5*, dhe **bash-k** = ⋈

Prandaj mund të shkruajmë:

$$\underset{\textbf{pesë}}{5} \quad = \quad \underset{\textbf{bash-k}}{\text{ꝺ}} \qquad \ldots\textbf{(F)}$$

Le të saktësojmë me këtë rast këto dy pika:

a) pesë = **pjesë** sepse kemi:

pjesë = ½ (pjesa "par exellence", *pjesa prototipike, paradigmatike...*) = **0,5** e pra sipas mathematikës mistike **: *5***

b) pes = **bash-k** sepse **p** dhe **b** janë të dyja dybuzore dhe **s** dhe **sh** (ş) janë që të dyja *fërshëllyese* (*sibilante*). E pra ky kalim është fare i lehtë dhe i natyrshëm.

Mbi këtë, le të vëmë rè se në turqisht:

besh = ***5***

dhe është, s'ka dyshim, shqipja **pes**. Kjo tregon lehtësinë a kalimit të mësipërm.

Vëmë rè se në shqip kemi gjithashtu:

dhe = *also* $_{\text{angl.}}$; *et* $_{\text{lat.}}$ ... = ꝺ

që lidhet mbrënda shqipes me **dhà** (... *ti dhé*...) që lidhet me **da** (fr. *séparer, diviser*...), e pra përfundimisht simb. ⓓ.

Mund të shkruajmë pra:

$$\underset{\textbf{dhe}\ _{\text{shq.}}}{\text{ꝺ}} \quad = \quad \underset{\textbf{dà}\ _{\text{shq.}}}{\text{ⓓ}} \qquad \ldots\textbf{(F)}$$

Gjithashtu ne anglisht:

end = *fundi*, ***kufiri*** *i mbramë*, e pra: ⓓ
and = **edhe**, (pra koncepti i bashkimit): ꝺ

Kështu anglishtja shtron ekuacionin simbolik:

$$\underset{\textbf{end}}{\circledcirc} = \underset{\textbf{and}}{\aleph} \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

Po ashtu dhe gjermanishtja me: **Ende** (*fundi*) dhe **und** (*edhe*), etj. etj.

Pasi e shpjeguam qartë, siç shpresojmë, këtë çështje, e kemi të lehtë të motivojmë kuptimet e tjera të fjalës sanskritisht: *lidh, nyje... thurr, kompozoj, ...skllav, prangos,* etj. etj., që lidhen të gjitha me konceptin primar të **lidhjes** ($\aleph$).

Me qënë se, siç dimë, Algoritmi Simbolik jep:

$$\circledcirc = \aleph = \bullet = \boxdot \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

ne shikojmë se fjala **BANDH** e sanskritishtes mund të shprehi në të njëjtën kohë si konceptin e *ndarjes* ($\circledcirc$) (në modalitete e nuanca të ndryshme) ashtu edhe atë të *lidhjes* ($\aleph$) (me modalitete e shkallë të ndryshme), të *materies* ($\bullet$) (Botës materiale), si edhe po ashtu atë të *mëkatit* ($\bullet$), të *burgosjes, kapjes,* ($\boxdot$) etj.

Kuptimi "*Jam skllav i mëkatit...*" që kjo fjalë shpreh, mund të jepet nga:

$$\underset{(jam)\ skllav}{\aleph} = \underset{i\ mëkatit}{\bullet} \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

Vëmë rè se si Sanskritishtja (mendimi i lashtë fillosofik-fetar hindian) e vështron **lindjen e lëndës** si një **lëndim** të *Parimit Hyjnor* ($\bigcirc$), si një *vuajtje*, si një *skllavëri*, si një *mëkat*, si një *burgosje të Shpirtit* (*Parimit Spiritual*), si një *humbje të Lirisë* ($\aleph = -(-\aleph)$ = *jo liri...*).

Të gjitha këto përkojnë plotësisht me frymën që përshkon fund e majë Ungjillin (*Dhjata e Rè*). *Krishti erdhi që të na shlirojë, të na shpëtojë nga të këqijat e kësaj Bote, nga skllavëria, nga të ligat* (ligjet) *e saj* e kështu me radhë.

Kur Krishti na thotë në Ungjill:

"Kush **mëkaton** (●) *bëhet skllav* (⊗) *i mëkatit..."*

ne shohim se Ai na rikujton një njoftim të lashtë të një diturie të stërlashtë siç është ajo e Hindisë. Ndaj pra, edhe këtu, si edhe në shumë vënde të tjera të këtij studimi (analiza e leksikut të sanskritishtes) mund të vihet rè një përputhje e Frymës së Fillosofisë e Theollogjisë Ariane me mësimet e **Krishtit**.*

Duke qënë se ○ është, ndër të tjera, simboli *i Hyjnisë* (*Zotit*), simboli ⊡ mund të interpretohet si *burgosja* e Hyjnisë, si kusht i domosdoshëm për krijimin e *Botës Materiale* (●).

---

* Një libër që flet mbi një sërë paralelizmash ndërmjet doktrinës së krishterë dhe asaj budiste është edhe ay i Marcus Borg, me titull *Jesus and Buddha: The Parallel Sayings*, Ulysses Press (publisher), June 1997.

Le të ndalemi pak tek kapitulli **Salvation** nga ky libër. Autori vë në dukje se rruga e shpëtimit (shëlbimit) sipas Krishtit dhe sipas Budës janë e njëjta rrugë. Po le ta lemë vetë autorin të flasë:

Shpëtimi

Për Jisun është një derë e ngushtë, për Budën - një mal i lartë, por mesazhi është në të dy rastet po ay. Qëllimi i mbramë është të jesh i pastër në shpirt. Por janë të pakët ata që ja mbërrijnë kësaj.

Që të dy flasin për një ndarje të shpirtërores nga truporja dhe për ndjekjen e të parës dhe heqjen dorë nga e dyta. Kjo është një punë e thjeshtë, por jo veç e lehtë. Liria mund të fitohet duke u kapur pas të vërtetës dhe duke mos ju dorëzuar joshjeve dhe ngasjeve të kësaj bote. Ji zëmërqëruar, thotë Krishti; bë mirë dhe spastro zëmrën tënde, thotë Buda. Qëllimi drejt të cilit jemi nxitur të priremi është për të dy Qielli, ai vënd ku ne do të jemi tashmë të shlirtë nga mëkatet e kësaj bote si edhe nga çdo rimishërim (angl. reincarnation) i mëtejshëm.

S'kini veçse të ndiqni "rrugën" dhe të kini besim, thonë që të dy. Dhe si njëri, ashtu dhe tjetri, janë të bindur se këto fjalë do të hapin dyert e lirisë sa kohë që mospërfillja e tyre do ta bëjë shpirtin të lëngojë në skllavëri.

Dhe vijnë pastaj një sërë paralelizmash konkrete mes të thënave të Krishtit dhe atyre të Budës lidhur me *Shpëtimin*.

Jisui: Do të njihni të vërtetën dhe e vërteta do t'u bëjë juve të lirë (Gjoni 8:32)

Buda: Ai që ndjek të vërtetën do të jetë i lumtur si në këtë Botë ashtu dhe në të përtejmen (Dhammapada 13:2).

Jisui: Si lum zëmërqëruarit se do të shohin Perëndinë (Mateu 5:8).

Buda: Ai që do të meditojnë natë e ditë në vetmi mbi dashurinë e pastër e të sinqertë për të gjithë dhe gjithshka, do ta shohë Brahmën me sytë e tij e do të bisedojnë me të sy ndër sy, e do të dishkutojnë me të i çpenguar (Digha Nikaya 19:43).

E kështu me radhë: me dhjetëra e dhjetëra paralelizma mbi subjekte të ndryshme si mbi Urtësinë, dashurinë, ngasjet, shpëtimin ...

Hyjnia bëhet kështu **Substanca** universale e Botës materiale (rikujtojmë: **Sub stans** = *Ai që qëndron ndën...*), *Deus Immanens* (fjalë që zbërthehet si **himman ens**; ku **-ens** do të thotë **qënie** dhe **himman** është shqipja **i/e himun**, siç e kemi vënë në dukje edhe gjetiu. Pra tërë kjo fjalë do të thotë: *Zoti i himun.* Vëmë re me këtë rast se në shqip: **Hyu** = **Zoti** dhe në të njëjtën kohë **hyu** (fr. *entra...*; në gjuhën egjiptiane të lashtë **Hmn** = *Hyu* (*Zoti*) dhe është, siç kuptohet qartë shqipja **hymun**, nga folja *hyj*)).

Ne mund të diktonim në kuptimet e ndryshme të fjalës sanskrite **bandh** edhe shumë e shumë implikime të tjera të rëndësishme, por do të zgjateshim tepër.

Sidoqoftë, le të përsërisim këtu përmbledhtas ato sa kemi thënë në faqen 124 të këtij studimi.

Në shqip **ZÂ**: 1) = *kap, burgos,* e pra simb. ⊡ dhe ⋈ ; 2) = *filloj*, e pra – *1*, dhe është fjala për *fillimin e fillimeve*, atë të Botës Materiale.

Në latinisht po ashtu: *in CIPere* = *filloj*, e pra – *1*, (me qënë se fillimi i botës: a) lidhet me një involucion siç e kemi parë; b) lidhet me Antitezën në Fillosofinë hegeliane).

Capere (*kap*), e pra ⊡, dhe ⋈.

Në gjermanisht: *Anfang* (*fillimi*), e pra *–1*; *fangen* (*me kap, me burgos*) etj., e pra ⊡, dhe ⋈.

Me fjalë të tjera: jo vetëm në sanskritisht, krijimi, fillimi i Botës lidhet me "kapjen" e Parimit Hyjnor, të Frymës, të Zotit por gjithashtu edhe në një sërë gjuhësh të tjera dhe mund të themi se, në një mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, ky fakt mund të nxirret nga analiza e çdo gjuhe, e të gjitha gjuhëve të Botës. Dhe s'ka si të jetë ndryshe gjersa **gjuhët, të gjitha gjuhët, ngrihen si mbi tabanin e tyre fillosofik, botëkuptimor, mbi Mendimin Mistik, strukturizimi llogjik i të cilit është Algoritmi ynë Simbolik.***

---

* Siç kemi vënë rë edhe gjetiu, sot flitet rëndshëm për ekzistencën e një background-i të përbashkët, primordial, botëkuptimor për të gjithë popujt e botës, i njohur me emrin "Philosophia Perennis". Këtu poshtë po japim një informacion të shkurtër mbi të:

Philosophia Perennis (angl. Perennial Philosophy, shq. Fillosofia e Përjetshme) mbështetet mbi idenë e ekzistencës së një sërë të vërtetash të përbashkëta për të gjithë popujt e për të gjitha kulturat. Ky term ka qënë përdorur për herë të parë nga mathematikani dhe fillosofi gjerman Gottfried Leibniz, për të treguar një fillosofi të përbashkët e të përjetshme që qëndron ndën të gjitha fetë dhe veçanërisht ndën rrymat mistike brënda tyre. Ky term u popullarizua më vonë nga Aldous Huxly në librin që ai botoi në 1945 me titull "The Perennial Philosophy". Termi "Perennial Philosophy" është përdorur gjithashtu për të përçuar konceptin e "një të vërtete të përjetshme" në *Sanatana Dharma* të Sanskritishtes.

Sipas parimeve themelore të Fillosofisë së Përjetshme, njerëzit në kultura dhe në epoka të ndryshme, kanë provuar, duke mbajtur shënim për to, perceptime të ngjajshme për sa i përket natyrës së realitetit, unit, botës dhe kuptimit dhe qëllimit të ekzistencës. Këto ngjashmëri flasin për disa parime universale të "nëndheshme" që përbëjnë themelin e përbashkët të shumicës dërmuese të feve të ndryshme.

Diferencat që mund të vihen rè mes këtyre perceptimeve themelore janë vetëm për shkak të diferencave kulturore dhe mund të shpjegohen tërësisht nën dritën e këtyre kondicionimeve kulturore.

Ndër këto perceptime të përbashkëta janë dhe bindjet se:

Bota fizike ose fenomenale nuk është realiteti i vetëm; ekziston edhe një tjetër realitet. Bota materiale është vetëm hieja e një realiteti më të lartë i cili nuk mund të kapet më anë të shkisave po për të cilin shpirti i njeriut dhe intelekti i tij dëshmojnë bollshëm për sa i përket rrënjëve të thella të tij.

Njeriu pasqyron natyrën e një realiteti të dyanshëm: trupi material i nënshtrohet ligjeve fizike të lindjes dhe të vdekjes, por aspekti tjetër i ekzistencës njerëzore as vdes dhe as humbet duke u identifikuar siç bën me intelektin apo Frymën që përbën thelbin e thelbeve të shpirtit njerëzor. Ky realitet i dytë nuk është vlerësuar aspak siç duhet në Perëndim në mos po dhe është mospërfillur krejt.

Të gjithë njerëzit zotërojnë aftësinë (ndonëse të atrofizuar nga mospërdorimi) për perceptime intuitive të të vërtetës së mbrame, absolute si edhe për sa i përket vetë natyrës së realitetit. Të tilla perceptime përbëjnë qëllimin përfundimtar e thelbësor të ekzistencës së tyre. Fetë e ndryshme, kryesisht ato më madhoret, përpiqen të krijojnë një lidhje ndërmjet shpirtit njerëzor dhe të këtij realiteti të lartë e të mbramë. Ky realitet i mbramë në fetë abrahamike (Judaizmi, Kristianizmi dhe Islamizmi) quhet Zot. Zoti është parimi absolut nga i cili buron çdo ekzistencë dhe tek i cili do të kthehet çdo ekzistencë. Në fetë jo teistike, siç janë Budizmi dhe Taoizmi, e mbramja apo absolutja përshkruhet disi ndryshe.

Këto perceptime të përhapura botërisht mendohet se janë me vlerë dhe të besueshme për arsye të koherencës së tyre, si edhe të faktit të ngjashmërisë së tyre pamvarësisht se shpesh herë burimet nga rrjedhin janë të ndryshme dhe të pamvarura.

Sipas Huxley, Fillosofia e Përjetshme është:

Metafizika që pohon ekzistencën e një Realiteti Hyjnor, i qënësishëm për botën e sendeve, të jetës, të njerëzve dhe të mëndjeve, **psikollogjia**, e cila dikton në shpirtin e njeriut diçka të ngjashme në mos po edhe identike me Realitetin Hyjnor, **etika**, sipas të cilës qëllimi i mbramë i njeriut duhet të jetë bërthama imanente dhe transhendente e çdo qënieje. Mbetje (angl. *rudiments*) të Fillosofisë së Përjetshme mund të gjënden në diturinë tradicionale të popujve primitivë në çdo

bandhana -ī - ag. *qui lie, qui attache;... fait d'emprisonner, captivité; construction... digue* (fig. *aussi*); *fait de retenir, répression etc. etc.* (*që lidh; burgosje, robëri; ndërtim... ; digë* (edhe në kuptimin figurativ); *përmbajtje, ndalim, represion...*)

Duhet zbërthyer si:

ban dhana (ose: *ba ndhana*)

dhe është shqipja:

ban dana (ose *bâ ndana*)

e pra Algoritmikisht do të kemi:

(**bandhana**)$_{\text{sanskr.}}$ = (**ban dana**)$_{\text{shq.}}$ = ⓘ (kuptimi ndër të tjera i *digës*)* = ⋈ (dhe del kuptimi i *lidhjes, prangosjes...*) = ⊡ (dhe del kuptimi i *burgosjes*, i *robërisë* etj. etj.) = ● (dhe del kuptimi i *ndërtimit, realizimit material...*), etj. etj.

bandhu - m. *relation, connexion, association, parenté... allié... compagnon, ami, mari...* (*relacion, marrëdhënie, lidhje, farë e fisni... aleat... shok, bashkëshort, mik...*)

Do zbërthyer si:

ban dhu

dhe me shqipen:

ban dà

e pra simb. ⓘ e për ekuivalencë simbolike ⋈.

Nga ky simbol i fundit mund të nxirren të gjitha kuptimet e kësaj fjale në sanskritisht, sikundër lexonjësi mund ta shohë lehtë...

---

vend të botës ndërsa trajtat e saja plotësisht e gjer në fund të shtjelluara, mund t'i gjejmë në të gjitha fetë e mëdha të njerëzimit.

* Në anglisht *dam* dhe është shqipja **dām**, nga folja *me dà* ; në rusisht *damba* dhe është shqipja *bâ* **dām**; në gjermanisht *Damm* dhe është shqipja **damun**, etj. etj.

Vëmë rè këtu se në anglisht:

bound - *kufi, limit, cak...; kufizoj, përcaktoj...*

dhe është shqipja *bë ndá* e pra simbolikisht ⊕, simbol nga i cili mund të dalin të gjitha kuptimet e fjalës *bound* në anglisht.

Në anglisht gjithashtu:

bond - *lidhje, bashkim... (in bounds = në hekura, në burg, në zinxhirë...)*

e pra simb. ⊗. Dhe është përsëri shqipja: **bë (bâ) ndá** e pra simb. ⊕ dhe për ekuivalence simbolike ⊗. Nga ky simbol i fundit mund të nxirren lehtë të gjitha kuptimet e kësaj fjale.

Diferencimi i lehtë nga *bound* në *bond* është kryer për të shmangur keqkuptimin, siç kemi pare që ndodh shpesh në Gjuhë.

Që kemi në të dy rastet për të njëjtën fjalë, kjo shihet edhe nga fakti se në anglisht: *bound* do të thotë jo vetëm *kufi, cak,* etj. (pra simb. ⊕) por edhe i *ob*-lig-*uar* (*i lidhur, i detyruar...*) e pra simb. ⊗. Prandaj mund të themi se anglishtja me ekuivokun që krijojnë të dy kuptimet e fjalës *bound* shtron ekuacionin e rëndësishëm simbolik:

⊕	=	⊗
bound		**bound**
(*cak, kufi*)		(*lidhje, obligim...*)

Edhe gjermanishtja **Bund** = *lidhje, bashkim, aleance,* etj. lidhet edhe ajo me sanskritishten **bandhu** dhe motivohet gjithashtu përmes shqipes:

bâ ndá = ⊕ = ⊗

Vëmë rè gjithashtu se fjala anglisht:

husband = *bashk-shorti, burri...*

ndahet në **hus** (që rri për **haus** = *shtëpi*) dhe **band** (në kuptimin e *shokut*, e të *bashkëlidhurit*, e *aleatit*, etj.).

Por **band** ndahet në **bâ ndá** e pra simb. ⏀ dhe për ekuivalencë simbolike ⚯.

Edhe fjala **banda** në italisht, në të gjitha kuptimet që lidhen me një "*bashkësi njerëzish që kryejnë të njëjtën punë...* " zbërthehet me shqipen:

bâ ndá

që përshkruan simbolin ⏀, e pra, për ekuivalencë simbolike ⚯, simbol ky i fundit që edhe motivon kuptimin e fjalës *banda* në italisht.

bandhura - *penché. courbé, arrondi; ondoyant*
(*i përkulur, i krrusur, i rrumbullakosur, i dallgëzuar...*)

Do zbërthyer si:

ban dhura

dhe me shqipen:

ban dārë, (ose *ba ndarë*)

E pra, simbolikisht: ⏀.

Algoritmi Simbolik jep:

⏀ = ◠ ...(**F**)

Që nga edhe kuptimi: *i përkulur, i krrusur, i rrumbullakosur...*

Algoritmi simbolik jep gjithashtu edhe:

⏀ = ◠ = ~ ...(**F**)

dhe simboli i fundit mund të interpretohet fare mirë edhe si *dallgëzim*.

Vëmë rè se në anglisht:


to **bend** = *përkul, krrus...*

Dhe ndahet në:

be nd

dhe me shqipen:

bë ndá


e pra simb. ⌀, dhe për ekuivalencë simbolike  nga dhe del kuptimi i *përkuljes, krrusjes,* etj,

Vërë në dukje me këtë rast edhe ngjashmërinë me sanskritishten, ngjashmëri që *vihet në dukje vetëm me ndihmën e shqipes* ku **nda** dhe **ndarë** janë që të dyja pjesore të foljen **daj**, e pra:

$$(\textbf{-nd})_{\text{angl.}} = (\textbf{ndarë})_{\text{shq.}} = (\textbf{-ndhura})_{\text{sanskr.}}$$

Vërë rë gjithashtu se po të jetë se simbolin ⌀ do ta interpretonim si *thyerje*, dimë se: *Një njeri që* ***thyhet*** *është edhe një njeri që* ***përkulet***...

Shohim pra kështu se si anglishtja me *ekuivoket* e saj dhe me **ndërmjetësinë** e shqipes (Roli **mesianik** i Gjuhës Shqipe) shtron ekuacionin simbolik:



...(**F**)

bandin - a. *captif, prisonnier, esclave* (*i kapur, rob, i burgosur, skllav...*)

Do zbërthyer si *ba ndin* (ose *ban din*) dhe me shqipen *bâ ndan* e pra simb. ⌀, dhe për ekuivalencë simbolike ⋈ si dhe ⊡, simbole që japin kuptimet e fjalës sanskritishte që po shqyrtojmë.

Vërë rë se edhe angl. **bondage** (*skllavëri*), etj. motivohet edhe ajo, njëlloj si sanskritishtja, me shqipen **bë ndá**.

Vërë rë gjithashtu me këtë rast se anglishtja **boundary** (*kufi*) do zbërthyer

si:

bou ndary

dhe me shqipen:

bë ndarë

e pra simb. ⦶, simbol që mund të interpretohet fare mirë, ndër të tjera, edhe si ai i *kufirit*.

Në anglisht gjithashtu: **border** (*kufi, skaj*), dhe do zbërthyer si:

bor der

dhe me shqipen:

bër dar

E pra simb. ⦶

BHID - (...**bhidya**... **bhinna**...) *fendre, briser, fracturer, rompre, diviser... percer, perforer; interrompre; détacher ... être en désaccord avec soi-même, être troublé ou perplexe...; changer, altérer; distinguer, faire une différence* etc. etc.
(*thyej, frakturoj, çaj, ndaj... çpoj, zgjidh ndërpres,... jam në kundërshtim me veten time, jam i turbulluar, i pavendosur...; ndryshoj, deformoj; dalloj, bëj një ndryshim* etj., etj.)

Do zbërthyer si:

BHI D

dhe me shqipen:

Bë dà

E pra simb. ⦶, që nga dhe dalin kuptimet e ndryshme të kësaj fjale:

⦶ = *thyej, çaj, ndaj, këpus, çkëpus, ndërpres,* etj. etj.

Me qënë se sipas Algoritmit Simbolik:

$$\text{⊕} = \boxdot \qquad \ldots\textbf{(F)}$$

del kështu edhe kuptimi *çpoj, brimoj* etj.

Me qënë se:

$$\text{⊕} = \boldsymbol{F} = \text{ß} = \ldots$$

kemi kuptimin: *jam në kundërshtim me veten time, ... zihem,* etj.

Me qënë se:

$$\text{⊕} = \boxdot = \text{ß} = \sim = \bigcirc \qquad \ldots\textbf{(F)}$$

dy simbolet e fundit japin kuptimet e *lëvizjes* dhe të *ndryshimit...*

Kuptim i *pavendosur* del, ndër të tjera, edhe kështu:

$$\textbf{(BHI D)}_{\text{sanskr.}} = \textbf{(bë da)}_{\text{shqip.}} = \text{⊕} = \boldsymbol{F} = -\boldsymbol{E} = -\underline{\mathbf{V}} =$$

jo vendim, jo zgjidhje, etj. etj.

Kuptimi: *bëj, përbëj një ndryshim* (*faire une différence*) del edhe duke patur parasysh se:

$$\text{⊕} = \boldsymbol{F} = -\boldsymbol{E} = -(\boldsymbol{x} = -\boldsymbol{x}) = (\boldsymbol{x} \neq -\boldsymbol{x}) =$$

jo barazi, ndryshin, diferencë...

sthāpana - *acte de tenir, de fixer, de maintenir ... d'immobiliser; ... d'ériger...* **-ika** a. *mis en dépôt* (*të mbajturit, të fiksuarit... të mbajturit palëvizur... të ngriturit* (*të ndërtuarit*) ... **-ika** *depozitim, vënë në depo*)

Është shqipja:


shtí ban

(*që është bërë shtí, shtirë... që është shtirë*), e pra simbolikisht: ⊡.

Ne dimë se:


$$\text{○} = -\sim = \textit{jo lëvizje}$$

Ne dimë gjithashtu se kemi sipas Algoritmit Simbolik:



...(**F**)

Ose edhe, atëhere:



...(**F**)

Prandaj pra, sipas Gjuhës (Mendimit mitik) porsa diçka *shtihet* brënda ajo nuk lëviz më, po qëndron ashtu sikundër qëndron edhe vetë Qëndra (që ndodhet brënda).

Lidhur me kuptimin *ngre* (ndërtoj), fr. *ériger*, shih edhe më poshtë fjalën sanskrite **sthīta**.

Ka një sërë fjalësh me kuptime të ndryshme (por që lidhen mes tyre algoritmikisht) me këtë rrënjë. Le t'i shqyrtojmë ato:

sthīti - f. *fait de se tenir, de rester, de résider, résidence, séjour; monde, terre, situation; état,* (it. *stato*), *position, rang, dignité... rang, loi, ... règle ... discipline, ordre, frontière, borne, arrêt, suspension...* (*rri, mbetem, qëndroj, banoj, banim; botë, tokë, situatë; gjendje, pozicion, gradë, dinjitet... rregull, ligj, disiplinë, rend, kufi; cak, ndalesë, pezullim...*)

Është shqipja **shtitë** (*shtirë, shtimun*) nga folja *shtij*, me **shtì** ...

Le të shikojmë tani se si me anë të Shqipes dhe të Algoritmit Simbolik mund të motivojmë kuptimet e ndryshme të kësaj fjale në sanskritisht.

Kemi **shtij** = *x*  , e pra  , ose, me qënë se Gjuha emërton paradigmatikisht, edhe , e pra edhe dhe del kështu kuptimi i të **qëndruarit**.

Po del kështu edhe kuptimi i të *futurit* (shtirurit) *brënda* e pra edhe ai i një vendi ku njeriu futet brënda për t'u **stre**huar, e pra kuptimi i **shtë**pisë (fr. *résidence*).

Me qënë se:



del kështu edhe kuptimi i *cakut*, i *kufirit*.

Me qënë se:



del kështu edhe kuptimi i *ndaljes* (fr. *arrêt*).

Fjala frënge **état** lidhet si me prejardhjen e saj më të afërme me latinishten **status**, si diçka që *rri*, që *qëndron*, që *nuk lëviz* tashmë, si diçka e *qëndrueshme*... Pra edhe në këtë rast është shqipja **shti**, **shtīt**, e pra simb ⊡, e pra atëhere, si më sipër ⊡~.

Duke qënë kështu fjala **shtet** në shqip nuk lidhet si me motivimin e saj të mbramë e përfundimtar, me latinishten *status* por me shqipen **shtīt** ashtu si dhe vetë latinishtja dhe italishtja (nga shqipja ose, ç'është njëlloj, nga sanskritishtja).


Kuptimi i **ndërprerjes** (fr. *suspension*), i *pezullimit* (të lëvizjes) jepet nëpërmjet atij të *shtimjes*, *futjes*... me qënë se:



Kuptimi i **ligjit** jepet nga:



Kuptimi i **Botës**, *Tokës*... del duke patur parasysh se kemi:



sthīta (STHĀ) - *qui se tient debout, immobile, qui attend; qui reste; situé; qui entre ou est dans; ... établi, admis...; occupé à...; qui fait ; est en charge* (*që qëndron në këmbë, i palëvizshëm, që pret; i vendosur, që hyn apo është në; i pranuar...; i zënë në...; që bën; që përgjigjet për...*)

Është shqipja **shtit**, **shtītë** (*i shtim, i shtirë...*).

Kuptimi që *hyn, është në, brënda...* jepet direkt nga shqipja:

shtij, i shtim =  *nuk lëviz, është ngulitur, është fiksuar, është vendosur*

Vëmë rè, para se të vijojmë më tej, se në të gjitha këto raste që po shqyrtojmë dhe po përpiqemi të shpjegojmë kuptimet e ndryshme të së njëjtës rrënjë me fleksionimet e saj të ndryshme, Gjuha (këtu sanskritishte) niset nga fakti *se çfarë është* (ndodhet) *brënda nuk lëviz, nuk ndryshon...* e pra simb.  ; vetëm ajo që është jashtë lëviz , $\sim$.

Pra Gjuha në një rast të tillë niset nga ekuacioni ynë simbolik:

$$F = \boxed{E} \qquad \text{...(F)}$$

i cili jep:

$$\bullet = \boxed{\circ} \qquad \text{...(F)}$$

si edhe, ndër të tjera, edhe:

$$\sim = \boxed{-\sim} \qquad \text{...(F)}$$

Me qënë se:

$$F = \sim \quad \text{dhe} \quad E = \bigcirc = -\sim$$

mund të themi edhe se sipas Gjuhës (si edhe sipas mentalitetit primitiv, mistik dhe mitik mbi të cilin ajo ngrihet) *një entitet, porsa që futet* (shtihet, shtiret...) *brënda qëndërzohet, e pra nuk lëviz, e pra nuk ndryshon, duke fituar kështu të gjitha atributet e Qëndrës, duke iu përmbajtur "rregullave" të kodit* ***E***.


Në shqip kjo jepet bukur me:

"*Shka* ***ngulet*** () ***ngelet*** ($-\sim$)"

...si edhe gjithashtu edhe me zbërthimin e fjalës **ndal**, ku **n** mund të vështrohet si privative (rri për *nuk*) e pra kuptimi: 1) *nuk dal* (it. *non esco,* angl. *not to come out*):  dhe; 2) *ndaloj* (nuk lëviz) e pra $-\sim$.

Por shqipja shkon edhe më tej me këtë varg thuajse homonimish: *ndal, dal,*

dalloj, dallohem, me të cilat jep:




relacione këto që janë të sakta jo vetëm sipas Alg. Simb. por edhe sipas fillosofive të të gjitha kohërave.*

Kuptimi **occupé à**... (*i zënë me...*) del lehtë për arsye se të **shtirit** bën:

Në shqip thuhet "*i zënë me punë ...* ", por edhe "*e kam shtënë* (shti, shtirë) *në punë*", "*asht shti në punë...*" etj., etj.

Vëmë rè me këtë rast se në rusisht **zanjats** (*занять*) = *me zanë*, lidhet si me prejardhjen e saj me foljen shqip *zâ, zanë*, dhe kjo sepse rrënja **z** (*a, i, e, u ....*) në shqip ka një polisemantizëm shumë të pasur, gjë që nuk mund të thuhet për rusishten *zanjats*. Shqipja shtron me këtë rrënjë ndër të tjera edhe këtë varg ekuivalencash simbolike:



Me ekuivalencën simbolike:



shqipja na thotë se "*Bota asht e zanë* (ka filluar) *me zanjen* (kapjen, burgosjen)

---

* Ekuacioni i mësipërm (⊕ = ●), rikujtojmë se jepet ndër të tjera në rusisht me *djelits* (*делить*) (⊕), dhe *djelats* (*делать*)(●).

e parimit hyjnor (○)", ashtu sikundër të njëjtën gjë na thotë edhe gjermanishtja, siç kemi parë* me *anfangen* dhe *fangen*, latinishtja me *incipere* dhe *capere* e kështu me radhë. Të gjitha këto gjëra nuk i kemi në rusisht, prandaj pra dhe ...

Vëmë rè shkarazi se me ekuivalencën *zâ* (☓) dhe *zi* (●) shqipja shtron mitin kozmogonik të *Hieros Gamos*, me *zâ, zë* (filloj, – *1*) dhe *me u zi* (☊) dhe *zi* (●), *shqipja shtron "mitin e fillimit* (– *1*) *të Botës materiale* (●) *me një luftë, përpjekje* (☊)".

Nga sa më sipër del se edhe fjala **zanat** (it. *mestiere*, angl. *trade*) nuk është aspak me prejardhje turqishte, siç shumëkush dhe mund të mendojë, por ajo lidhet mbrënda shqipes me foljen *me u zanë*.

Gjithë po ashtu tek italishtja **mestiere**, duke iu referuar edhe kuptimeve të tjera si sanskr. *sthīta* (*STHĀ*-) duhet parë një shqipe *me shtirë* (folja *shtij, shtirë*).

Vëmë rè shkarazi këtu, siç kemi bërë edhe gjetiu, se anglishtja **busy** (i zënë) dhe **business** lidhen, si me prejardhjen e tyre, me operatorin e lirë të shqipes *zë, zënë*... **busy** është me fjalë të tjera shqipja *bë zë*(n).

Kuptimi **debout** (*në këmbë, ngritur*...) lidhet me kuptimin e *ndërtimit* (në shqip *ndërtoi një shtëpi = ngriti një shtëpi*). Dhe kjo sepse është *themeli*, është i *shtīti* (i shtiri) që e bën të mundur ndërtimin, **ngritjen** (fr. *ériger***) e një ndërtese, etj. Mos harrojmë se ai që *shtihet* (i shtiri) është *kurbani* d.m.th. *qënia e pafajshme* (pa mëkat) e *panjollosur*, etj., etj. që flijohet dhe *shtihet* në hendekun, në gropën e themelit.

Sipas Algoritmit Simbolik:

– ○	=	⊡	= ● ...(F)
flijimi		*themeli*	*ndërtimi* ("ngritja"),
i qënies hyjnore			*krijimi i sendeve materiale,*
(kurbani)			*i Botës*, etj.

* Shih *Hyrja*.

** Shih edhe kuptimin e fr. *ériger* (me ngrit) tek fjala sanskr. **sthāpana**.

Kështu Bota dhe është krijuar: *me flijimin e një qënie të pafajshme, hyjnore,** e pra me një **padrejtësi**, e pra me një **krim**. Dhe, duke **imituar** këtë paradigmë (*ngjarje* të *parë***), ajo ashtu dhe vijon *rikrijimin, përtëritjen, mbajtjen* ***.

Kuptimi frëngjishtes **état** (it. *stato*) shpjegohet prapë lehtë, sepse:



shtī *qëndron, nuk lëviz (sta)* it.

Në italisht **stato** është pjesore e foljes *stare* (qëndroj). Nga sa më sipër, kjo fjalë nuk është tjetër veçse shqipja *shtirë*, pjesore e foljes *shtij*.

Mund të shkruajmë:

état fr. < *status* lat. < *shtīt* shq.

Në italisht **stato** ka dhe kuptimin e *shtetit*. Shteti, i vështruar si një entitet i patundur, i qëndrueshëm. Kështu pra shqipja motivon mbrënda vetes të saj fjalën *shtet* me anë të shqipes *shtīt* (operatori *shtij*) dhe ajo motivon po ashtu edhe italishten *stato*, frëngjishten *état*... e kështu me radhë...

Frëngjishtja *établi* është italishtja *stabilito* që lidhet me latinishten *stabilis* (*i qëndrueshëm, i palëvizshëm*), e pra – ~.

Por ne pamë se si:



shtī

kjo do të thotë atëhere se shqipja shpjegon edhe lat. ***sta**bilitas*, it. ***sta**bile* fr. ***éta**bli*, etj., etj.

Dhe le të vijojmë më tej me fjalë që lidhen me foljen sanskritishte *STHĀ-* a, ç'është njëlloj, me operatorin e lirë të shqipes *SHTĪ* -j.

---

* Në shqip kjo jepet bukur me *Fillimi me një flijim.*

** Në shqip: fjala *ngjarje* do të thotë në të njëjtën kohë edhe *ndodhì* por edhe *ngjasim*...

*** Shih ato sa thotë lidhur me këtë çështje edhe Mircea Eliade në librin *l'Éternel Retour*, shih *Hyrjen.*

stheman - m. *fermeté, fixeté (patundshmëri, ngulitje)*

Është shqipja **shtimun**.

Ne dimë se kjo fjalë e shqipes është pjesore e foljes *shtij*. Ajo mund të zbërthehet si:

shti jamun

Motivimet janë si tek **sthīta (STHĀ-)**.

sthairya - nt. *fermeté, solidité ; immobilité, durée, permanence, constance, persévérance; attachement ... dévotion (qëndrueshmëri; soliditet; palëvizshmëri; vazhdueshmëri; këmbëngulje; pandryshueshmëri...; përkushtim)*

Lidhet me shqipen **shtirë**.

Vërë rè se në sanskritisht:

stheman - shq. *shtimun*
sthairya - shq. *shtirë*

pra gjejmë në sanskritisht të dy trajtat, si atë të të folmes të Veriut në shqip (*shtimun*), ashtu edhe atë të Jugut (*shtirë*).

Sanskritishtja i përdor këto dy variante të së njëjtës rrënjë për të diferencuar nuanca kuptimore mbrënda të së njëjtës fjalë.


Motivimi i të gjitha kuotimeve të kësaj fjale nuk paraqet ndonjë vështirësi pas të gjithë atyre që u thanë lidhur me këtë rrënjë. Ua lëmë pra lexuesve...

stheya - *il faut se tenir tranquille; rester; fixer l'esprit sur... (duhet të rrish i qetë; të qëndrosh; të mbetesh... të ngulësh vëmëndjen, të përqëndrohesh në ...)*

Kuptimi kryesor që shpjegon edhe të gjitha kuptimet e tjera është ai i të *mos ndryshuarit*, i të *qëndruarit* e pra atëhere edhe ai i të *përqëndruarit*, etj.

Lidhet me shqipen **shtij**.

Mund të shkruajmë:



stimita - edhe kjo fjalë jep kuptimet e *moslëvizjes*, të *qëndrueshmërisë*, e *fiksimit* e kështu me radhë

Dhe pra dhe motivimi i saj bëhet njëlloj si edhe ai i fjalëve të tjera po prej kësaj rrënje.

Është shqipja **i shtim, i shtimtë**.

stambhita - *figé, paralisé; arrété, supprimé, amené au point de mort* (not. par magie)
(*i fiksuar, i paralizuar; i ndaluar, i arrestuar, i suprimuar, i shpënë gjer në prag të vdekjes* (sidomos me anë të magjisë))

Është shqipja **shtim bâ**, *shtimbëjtur...*

Kujtojmë me këtë rast se në të folmen çame ekziston trajta: *u bite = u bë.*

Të gjitha kuptimet dalin po me atë procedurë si më sipër, me fjalët e shqyrtuara nga e njëjta rrënjë:



sthâpya - ... *enfermer dans; plonger dans* ... (*mbyll, shtij në..., zhys në ...*)

Është shqipja **shti** *baj*.

Me këtë fjalë sanskritisht (që zbërthehet me anë të shqipes) lidhet edhe shqipja **shtëpi** (vend ku futesh, ku mbyllesh, të **stre**hohesh).

Rikujtojmë se gjermanishtja **Heim** (*shtëpi*), është formuar edhe ajo nëpërmjet konceptit të **hymjes**, e të futjes mbrënda, e **shtir**jes.

Le ta zgjerojmë tani bisedën dhe le të përgjithësojmë. Të gjitha fjalët sanskritisht që pamë gjer këtu si: *sthāpāna, sthīti, sthīta (STHĀ), stheman, stheya, stimita, stambhita, sthairya* ... lidhen që të gjitha me rrënjën shqip **SHT-** (në variantet a më saktë fleksionimet e saj të ndryshme: *shtimun, shtīr, shtij, shti bai* ...) rrënjë që ka ekuivalentin homonimik dhe thuajse homonimik në sanskritisht dhe që, duke shprehur konceptin primar e të drejtpërdrejt të *shtirjes*, futjes brënda... ne mund ta shprehim simbolikisht me ⊠ ose edhe me qënë se Gjuha, siç dimë, emërton paradigmatikisht, me ⊡ .

Me qënë se ○ = −∼, kemi edhe:



figurë simbolike kjo që përmbledh në vetvete konceptin e **shtimjes** edhe atë të të **shtangies** d.m.th. të *moslëvizjes*, të *qëndrueshmërisë*, të *pandryshueshmërisë*, të *besnikërisë*, të *përqëndrimit*, të *përkushtimit*, të *mos ndërprerjes*, (me qënë se ○ = −∼ = *jo ndryshim, jo ndarje* (−∼ = −⊕), *jo ndërprerje*); atë të *themelit* e pra edhe atë të *themelimit* e pra të *ndërtimit*, atë të *shtetit* (si një entitet a strukturë që nuk lëviz, që supozohet e qëndrueshme); atë të *fortësisë*, me qënë se forca dhe fortësia presupozojnë një rezistencë ndaj ndryshimeve, e pra një mosndryshueshmëri, e kështu me radhë... të gjitha koncepte këto të lidhura *gjenetikisht* me atë të **shtimjes**, e pra simb. ⊡ e pra edhe, siç pamë, ⊟∼.

Një mori fjalësh të huaja (italisht, frëngjisht, gjermanisht, anglisht, rusisht, greqisht ...) me nuanca të ndryshme kuptimore e kanë prejardhjen e tyre tek ky operator i lirë i Shqipes **SHT-**, ose ç'është njëlloj tek sanskritishtja **STH-**.

Ja disa prej tyre:

angl. *store* (depo) = shq. *shtirë*
angl. *stay* (qëndroj) = shq. *shti*
angl. *stare* (qëndroj, rri, nuk lëviz) = shq. *shtirë*

gjerm. *stark* (i fortë) = shq. *shtirë*

angl. *strong* (i fortë) = shq. *shtirë*

lat. *staticus* (që nuk lëviz, statik) = shq. *shtīt, **shtang***

it. *statuto* (statut) = shq. *shtī, **shtang***

it. *conSTITuire* (përbëj) = shq. *shtīt*[*]

rus. *stroj* (*строй*) (rend, strukturë) = shq. *shtirë*

rus. *strogij* (*строгий*) (i rreptë, rigjid) = shq. *shtirë* (krahaso me angl. *strong* dhe me gjerm. *stark*)

lat. *mysterium* (mister) = shq. *me shtirë*, e pra simb. ⊠ ose edhe më saktë ⊡

Mos harrojmë se **misteri** është ai që na *fshihet*, e pra simb. ○, simbol ky që është, siç dimë, ai i *Qëndrës* ($x = -x$), ai i *Zotit*, ai i të *Vërtetës Absolute* e kështu me radhë.

Mund të shkruajmë edhe se:

$$misteri = \boldsymbol{E}$$

me qënë se siç dimë:

$$\boldsymbol{F} = \boxed{E}$$

Gjithshka që i përket ***E***-së është për ne *mister*, është për ne e Panjohura e Madhe, *Bota tjetër*.

angl. *steady* (i vazhdueshëm, i pandërprerë, konstant, që nuk ndërpritet, që nuk ndryshon) = shq. *shtīt*

gjerm. *stets* (vazhdimisht, pa ndërprerje) = shq. *shtīt*

rus. *stavka* (*ставка*) (paret që shtihen në lojë) = shq. *shtī **bâ** ka*

shq. *shtyllë* = *shti yll*, e pra simb. ⊠, e pra ⊡ e përfundimisht $-\sim$ (*moslëvizje, patundshmëri, qëndrueshmëri*)

---

[*] Ndonjë sqarim këtu është i nevojshëm:

Ajo që e bën (e përbën) një gjë (entitet) është *përmbajtja*, ..., ***sub**stanca*, d.m.th. (edhe etimollogjikisht) ajo që qëndron *mbrënda* saj, *prapa* saj, *ndën* të (*sub stans*...). E pra edhe ajo që është e **shtit**ur, e fshehur në të.

Po të marrim fjalën it. **colonna** si një entitet që nuk tundet (shq. *shtyllë*), mund të shohim se edhe ajo është sajuar duke lidhur konceptin e *shtimjes* (kalljes) me atë të *palëvizshmërisë*, të *qëndresës*.

Kjo fjalë nuk është tjetër veçse shqipja:

kallumun (jam kall)

gr. *stereós* (*στερεός*) (i fortë, i qëndrueshëm) = shq. *shtirë*

gr. *stirigma* (*στήρίγμα*) (mbështetëse, themel) = shq. *shtirë*

Vëmë rè me këtë rast se edhe shqipja *mbëSHTET* sikundër edhe *SHTET* (siç pamë) duhet motivuar me shqipen *shtīt* (gjithmonë me konceptin e *shtimjes* = koncepti i *palëvizshmërisë*, i *qëndresës* !)

gr. *stereóno* (*στερεώνω*) (i forcoj, fortifikoj) = shq. *shtirë*

gr. *stégasi* (*στέγαση*) (STREhim) = shq. *shti*(j)

Vëmë rè se edhe tek shqipja *strehim* (strehoj, etj.) duhet të shohim rrënjën *shtir* (në kuptimin e hyrjes, futjes).

gr. *stasou !* (*στάσου* !) (dale !) = shq. *shti*

gr. *stathmós* (*σταθμός*) (etapë, qëndresë) = shq. *shtīt*

gr. *stamató* (*σταματώ*) (mbes, mbetem, ndal, ndaloj, pezulloj...) = shq. *shtim*

gr. *statherá* (*σταθερά*) (konstante) = shq. *shtitur*

it. *constante* = shq. *shtī* (sanskr. *Sthā-*)

gr. *statheropoiménos* (*σταθεροποϊμένος*) (i stabilizuar) = shq. *shtitur bëmun*

gr. *statheropoió* (*σταθεροποιώ*) (konsolidoj, stabilizoj) = shq. *shtitur bëj*

lat. *staticus* = shq. *shtīt*

angl. *still* = *ende, prap* ... (vazhdimësi) *shtī yll* $_{\text{shq.}}$ = ★ = ⊙ ~

Vërnë rè se ekuacionin ★ = ○ = *Qëndër*, e gjejmë tek Cirlot*

angl. *stop* (ndal) = shq. *shtī* (*bâ*)
shq. *stepem* = shq. *shtī*
angl. *stumble* (pengohem, ngec, ngel, ndal...) = shq. *shtī bâ yll*
rus. *stojats* (*стоять*) (qëndroj) = shq. *shtij*
rus. *staranje* (*старáние*) (kujdes, zell) = shq. *i shtirun*

Vërnë rè në shqip: "*i shtirun pas...*" = *i dhënë pas, që i kuSHTohet...*

rus. *stats* (*стать*) (me u bë (angl. *to become*, gjerm. *werden*, it. *divenire*)) = shq. *shtīt*

Le të japim ndonjë shpjegim. Ne dimë ekuacionin:

⊡ = ● ...(**F**)

simboli ● mund të interpretohet si ai i *materializimit* e pra i *bërjes*. Dhe ne shohim që të ndodhë kjo, duhet që parimi hyjnor, Fryma (lat. *spiritus*), të *hyjë mbrënda*, të *shtihet*, të *okultohet* (kallet). Ja pra përse koncepti i *bërjes* (ru. *stats*) (●), jepet në gjuhë (këtu nga gjuha ruse) nëpërmjet atij të *shtimjes* (⊡).

rus. *stanovitsa* (*становиться*) (bëhem, angl. *to become*) = shq. *shtin*
rus. *stavits* (*ставить*) (vë, vendos) = shq. *shti bët* (shti bërë...)
rus. *ustanovits* (*установить*) (vendos, instaloj) = shq. *shtin*
rus. *stupenj* (*ступень*) (shkallare; shkallë; etapë) = shq. *step* (ndaloj), *shti bënj* ...
angl. *stem* (rrjedh nga, vij nga...) = shq. *shtīm*
gjerm. *stammen* (rrjedh nga, vij nga...) = shq. *shtīm jamun*

---

* Cirlot, fq 310: "The "flaming star" is the symbol of the mystic Centre..." (Ylli "flakëronjës" është simboli i Qëndrës mistike...).

Ekacioni simbolik:

 ...(F)

tregon se simb. O është *i shtimi*, parimi hyjnor që nga rrjedh dhe *materializimi*, *bërja* e atyre gjërave që rrjedhin prej tij.

Kujtojmë këtu se gjuha emërton paradigmatikisht e pra "redukton"çdo prejardhje (angl. *stem*) tek prejardhja e parë e Botës, nga *hymja* e Hyut, nga mohimi i parimit hyjnor (miti i Sakrificës Kozmogonike) dhe, menjëherë pas asaj, *kalljes*, *shtimjes* të tij, do me thënë *oKULtimit* të Tij dhe të shndërrimit të tij në një *miSter*, fjalë që lidhet, siç shpjeguam më lartë, me shqipen *shtirë* (sanskr. *sthairya*).

E kështu me radhë, e kështu me radhë...

Do të mund të vazhdonim kështu për një kohë shumë të gjatë, por shpresojmë se edhe me kaq, pa rradhitur këtu shumë e shumë fjalë të tjera nga gjuhë të ndryshme të Botës që lidhen me këtë rrënjë të shqipes (sanskritishtes) dhe motivohen prej saj, fuqia motivuese e shqipes del në pah fare mirë. Lexuesi mund ta vazhdojë vetë këtë punë që pas informacionit dhe shëmbullave që u dhanë këtu, nuk duhet të jetë për të e vështirë.

hāni - f. *cessation, diminution, déclin; dommage, perte, déficit; non-être; infraction*
(*pushim, zvogëlim, perëndim; dëm, humbje, defekt; mos-qënie; thyerje* (*të ligjit*))

°**kara** - *qui lèse, qui désavantage; qui fait disparaître*
(*që cënon, që dëmton, që bën të zhduket*)

Është shqipja *hyn* nga folja HYJ, që është kaq produktive në shqip.

Algoritmi Simbolik na jep:

$$\text{Hyj} = x \boxed{\text{E}} = \circ \boxed{\text{E}} = \boxed{\odot} =$$
$$F = -\bigcirc = \oplus = \bullet = \female \qquad \text{...(F)}$$

○ është ndër të tjera, siç dimë, simboli i *Qëndrës*, e pra atëhere edhe ai i *Zotit*, e pra atëhere edhe ai i **QËNIES** (fr. *Être*, gjerm. *Sein*, angl. *Being*) "par excellence".

Duke qënë kështu, −○ do të jetë atëhere **mosqënie** (fr. *non-être*).

Sipas Mendimit mistik dhe sipas Fillosofive të lashta të Hindisë dhe në përgjithësi të mbarë Lindjes, kjo Botë është e rreme, *duket sikur është por nuk është*, është një *magji* (mahi) e Majas a ç'është njëlloj e Maras (shejtanit)*. Pra kjo Botë nuk ka *qënie* të vërtetë, ajo nuk paraqet Realitetin e vërtetë, Realitetin e mbramë që rri fshehur, si një *noumen*, ndën, prapa realitetit *fenomenal.*** Në këtë përfundim ka arritur sot edhe shkenca e fillosofisë moderne, përfundim me të cilin në Fizikën kuantike Einsteini nuk ka qënë dakord, duke deklaruar se *"unë nuk besoj në një fizikë fantazmash"* (angl. *spooky physics*).

Simboli ♀ mund të interpretohet ndër të tjera edhe si *rënie* (angl. *Fall*)*** dhe si *perëndim* (fr. *déclin*). Dhe është fjala për *Rënien e Frymës* (Qënies) me të cilën Bota filloi****.

$$\female \textit{ (perëndim i diellit)} = -\bigcirc = \boxed{\odot} = \bullet \qquad \text{...(F)}$$

jo diell — *Dielli futet brënda* — *Errësirë natë*

Bota ka filluar me një *kapje*, *burgosje* të Frymës, simb. ⊡*****, me një

---

* Shih edhe Maya

** Shih edhe Alg.Simb:

Noumeni = E **Fenomeni** = F

Dhe kemi siç dimë: $F = \boxed{E}$

*** Shih edhe "the fall".

**** Shih edhe faqe 302.

***** Shih edhe *Anfang* e *fangen*.

zvogëlim të saj*, me një *ndarje* të saj**, gjë që jepet saktë me simbolin ⏀. Dhe kemi:

$$\textit{Bota materiale} = \bullet = ⏀ < \bigcirc$$

Inekuacioni i fundit flet për një *zvogëlim* (fr. *diminution*). Një zvogëlim të kujt? Të Frymës, të Qënies, të Zotit.

Rikujtojmë këtu se ○ është ndër të tjera edhe simboli i Energjisë primordiale e cila për krijimin e Botës duhej të modifikohej, e pra të zvogëlohej*** (fr. *subir une* ***diminution*** (t'i nënshtrohej një *zvogëlimi*)).

Kuptimi i *dëmit* (fr. *dommage*) nuk është tjetër veçse një interpretim i simbolit ⏀:

$$\textit{dommage}_{\text{fr.}} < \textit{damun}_{\text{shq.}} (⏀)^{****}$$

që nga dhe:

$$\bullet = \textit{dam, e keqe}$$

Duke dalë disi nga tema, vëmë rè me këtë rast edhe sa vijon:

Fjala *dommage* lidhet mbrënda frëngjishtes, përmes shqipes *damun*, me fjalën *dëmi* (gjysmë), e pra ½, e pra ⏀. Ky *gjysmim* dhe krijoi Botën. Por simboli ⏀ duke u interpretuar si i *damuni*, e pra *Demoni*, na shtyn të mendojmë atëhere se *Demoni* (i Damuni) është edhe DEMIurgu. Pra, në këtë kuptim *Krijimi i Botës është një krijim i Demonit*. Këtë mendim ne e gjejmë të shprehur haptas në Fillosofinë e lashtë hindiane (Mara si Demiurg), ashtu edhe, tërthorazi, implicite, në të gjitha fetë e rëndësishme të Lindjes, duke përfshirë këtu edhe fenë e krishterë, gjersa për Krishtin kjo Botë është e keqe dhe gjersa "*Urdhëtari*"***** i kësaj Bote është sipas tij Shejtani, të cilit i janë dhënë në këtë botë të gjitha. Nga ana tjetër tërë Ungjilli përshkohet majë e fund nga fryma e

---

* Shih ndër të tjera edhe *commencer*.

** Shih edhe Paracelsus, si edhe shqipen *ndarje – ndyrje* (⏀ = ● = *bota materiale*).

*** Shih Cirlot, *Cosmogony*.

**** Këtu < do të thotë: *vjen nga*... Është pra një simbol *derivacioni*.

***** "Unë nuk do të flas më tepër me ju sepse po vjen Urdhëtari i kësaj Bote, dhe ai s'ka asgjë të përbashkët me mua..." (Ungjilli sipas Gjonit, 14:30).

mosdashjes së Botës dhe të asgjëje që ndodhet në të, si edhe me motivin e fundit të afërm të Botës, me motivin eskatollogjik.

Edhe gnostikët* janë të mendimit se Demoni dhe Demiurgu janë i njëjti "personazh".

Marrim tani kuptimin e *thyerjes të Ligjit* (fr. *infraction*).

Po t'i referohemi Biblës, lexojmë atje se paraardhësit tanë më të lashtë, Adami dhe Eva, ndodheshin në Parajsë**. Koncepti i Parajsës përputhet me ato të Qëndrës mistike***. Atyre u lejohej të hanin nga çdo pemë, me përjashtim nga pema e *dallimit* të të mirës nga e keqja. Por ata, duke rënë në ngasjen e djallit (në trajtën e gjarprit) hëngrën nga pema e ndaluar. Pra e *thyen* urdhërin hyjnor (fr. *Infraction = thyerje të urdhërit, të ligjit...*). Zoti u kishte thënë: "*Porsa që të hani nga ajo pemë, do të vdisni*". Vdekja jepet simbolikisht, siç e dimë, me ●, simbol ky që është edhe ai i *materies* dhe i *Botës materiale*.

Mund të shkruajmë:

$$Parajsa = Qëndra = Coincidentia\ oppositorum = (x = -x) = -(x \neq -x) = -(○ \neq ●) = jo\ dallim\ mes\ të\ mirë\ (○)\ dhe\ të\ keqes\ (●) = E = jo\ Botë\ materiale$$

Adami dhe Eva hëngrën nga pema e dallimit të të mirës nga e keqja. Kjo mund të shkruhet si:

$$(○ \neq ●) = (x \neq -x) = F = ♀ = ● \ldots = -E$$

---

* **Gnosticismi** është një term historik për të treguar një sërë ferash mistike si edhe disa shkolla diturie që kanë qënë aktive sidomos në shekujt e parë pas Krishtit. Sistemet gnostike predikonin *misticizmin* ose, siç e quanin ata, *dijen e veçantë*, "gnosis", si qëllimin themelor të jetës.

Gnostikët shohin tek Bota një betejë mithollogjike ndërmjet dy forcave kundërshtare, të *drítës* nga njëra anë dhe të *errësirës* nga ana tjetër, duke vendosur me këtë rast një ndarje të rreptë ndërmjet *Botës materiale*, që mendohej ndënë pushtetin e forcave të liga (siç është ajo e Demiurgut) dhe *Botës spirituale* e veçuar prej saj dhe që është ndën pushtetin e plotë të Zotit.

** Shih edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi, fq. 125.

*** Shih edhe *qëndra mistike*.

Ata pra atëhere *ranë* (♀) (miti kozmogonik i *Rënies*, angl. *Fall*) = ata *vdiqën* për jetën spirituale të Parajsës (–○) = ata nuk ishin të denjë për të qënë më atje, por njëkohësisht me *largimin* (ndjekjen) e tyre nga Parajsa, u krijua dhe Bota materiale (●).

Kështu pra bota materiale, sipas mitit biblik, është krijuar me një *thyerje* të Ligjit të Perëndisë (fr. *infraction*), me një *humbje* (fr. *perte*), me një mohim të Qënies (fr. *non-être*).

hāni kara - *qui lèse, qui désavantage; qui fait disparaître*
(që cënon, që dëmton, që bën të zhduket)

Është shqipja **hyn kry**, pra simb. [x], e pra edhe, me qënë se gjuha emërton paradigmatikisht, [o]. Dhe me qënë se ○ është *Qënja* (fr. *être*), simboli i mësipërm që është ekuivalent, siç dimë me –○ do të ketë kuptimin e – *être*, *e mosqënies* dhe simboli [o] atë të *zhdukjes* (mos pamjes me) të *Qënies* (Zotit, hyjnisë).

Rikujtojmë se në shqip: *Hyu është Ai që hyu...* dhe është fjala këtu, siç kemi shpjeguar edhe gjetiu për *Deus Immanens*[*].

Ne shpjeguam të gjitha kuptimet e fjalës sanskr. **hāni** që s'ka dyshim se lidhet si me motivuesen e saj, me operatorin e lirë të Shqipes **Hy** (*hyj, hyn, hymun, hyra* ...etj., etj).

Rrënjën e shqipes HY e gjejmë edhe në këto fjalë të tjera të sanskritishtes:

himsā - f. *dommage, fait de léser délit; Nuisance personnifiée*
(dëm, cënim, krim; Dëm i personifikuar)

Kutpimin e *dëmit*, të *cënimit* ... e kishim edhe me **hāni**, gjë që dëshmon për faktin se **him-** tek **himsā** është prapë operatori i lirë i shqipes **HY**, këtu si *hym* (pjesore e foljes *hyj*).

Kemi këtu një zbatim të formulës së njohur të Algoritmit Simbolik:

---

[*] Shih edhe 231, 233, 264, 298, 421...

$$-x = \boxed{\times} \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

Duke marrë këtu $x = \bigcirc$ dhe duke zëvendësuar do të kemi:

$$-\bigcirc = \boxed{\circ} = F = \oplus = \bullet = \ldots$$

D.m.th. nga *hymja* (sanskr. *him-*) e pra simb. $\boxed{\circ}$ dalin edhe të gjitha kuptimet që kjo fjalë ka.

himsita (HIMS-) - a.v. *endommagé, blessé, détruit;* nt. *dommage* (*i dëmtuar, i plagosur, i shkatërruar; dëm*)

Shih **himsā**.

himsana - *fait de léser, de blesser, de tuer* (*të cënuarit, të plagosurit, të vrarit*)

Shih më sipër.

Gjuha emërton paradigmatikisht. Pra është fjala këtu për qënien e parë të *cënuar*, të *vrarë*... Kjo qënie e parë është një qënie Hyjnore, vrasja e të cilit ishte e domosdoshme për krijimin e Botës*.

Prandaj pra:

$$-\bigcirc = \boxed{\circ} = \oplus = \bullet = \ldots \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

ku $-\bigcirc$ është *mohimi* i Hyjnisë, $\boxed{\circ}$ është *burgosja* e Tij dhe bërja e tij kësisoj e padukshme (rikujtojmë se kjo jepet në Gjuhë edhe me gjerm. *Anfang / fangen*, lat. *incipere / capere*, me shq. *zë / zë*, që përkthehen simbolikisht me:

$$-1 = -\bigcirc = \boxed{\circ} \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

---

* Shih *Mitet Kozmogonike* dhe *Sakrifica Kozmogonike*.

që bëjnë pjesë në vargun e ekuivalencave simbolike të mësipërme.

Edhe këtu, si kudo, është fjala për *krijim* (paradigmatikisht: të Botës), është fjala për *kalimin* (që është një *rënie* siç kemi parë), nga ***E*** (○) në ***F*** (●)*.

Ka mundësi që edhe fjala shqipe *gjysma*, në trajtën *gjymsa* të lidhet edhe ajo me sanskr. **himsā** edhe kjo për arsye se këto dy fjalë janë pothuajse homonime dhe kuptimet e tyre, duke qënë të përafërta, shpien që të dyja tek simboli ⏀.

Po ashtu edhe shqipja *hise* (*pjesë*). Dhe me qënë se *gjysa* ($^1/_2$, ⏀) është *his*-ja par excellence, paradigmatike (me të cilën Bota filloi...) mund të shkruajmë ekuacionin:

$$hise = gjysa = ⏀$$

a-kovida - a. *qui n'a pas l'expérience de ...* (*që s'ka përvojën e ...*)

Është shqipja:

– **ka bë dì**

e pra *që s'di*.

a-jāta - a.v. *non encore né, non encore existant*
(*që s'ka lindur edhe, që ende nuk ekziston*)

Është shqipja:

– **jetë** (që s'ka ende jetë)

Kujtojmë se në shqip *jetë* lidhet me foljen *jam* (do të *jetë*...).

a-cchidra - a. *indemne; ininterrompu; intact, parfait*
(*i padëmtuar; i pandërprerë; i paprekur, i përsosur*)

Është shqipja:

– **ki** (qi) **ka darë**

---

* Shih edhe fq. 81, 90, 157.

(*që nuk ka darë, që nuk është darë*), pra simb. $-\oplus$.

E pra atëhere, për ekuivalencë simbolike, edhe ○, simbol ky që mund të vështrohet, siç dimë, edhe si ai i të *Tërës* dhe pra i *përsosjes*.

Duke zgjeruar bisedën shtojmë:

Frëngjishtja **indemne** do zbërthyer si:

in demne

ku **in** $= -$, ndërsa pjesa tjetër është shqipja *damun*. Kështu e tërë kjo fjalë do të thotë atëhere:

i padamun

e pra edhe *i padamtue*, simb. $-\oplus$ dhe për ekuivalencë simbolike $-\bullet$ dhe ○, simbol ky i fundit që është ndër të tjera edhe ai i *të plotës, i përsosjes*.

Po:

$$\bigcirc = (x = -x) = \textit{Qëndra} = \textit{Zoti} =$$
$$-\oplus \ (\textit{i pa prekur, i paprekshëm... i pa dëmtuem}) =$$
$$-\bullet \ (\textit{jo material} \text{ e pra } \textit{spiritual}) = \bigcirc \ (\text{i } \textit{përsosur}) = \textit{1}$$

Mund të themi atëhere se:

"*Vetëm* (*1*) *Zoti* ($x = -x$) *është* (=) *i paprekshëm, i pacëneshëm* ($-\oplus$), *vetëm* (*1*) *Ai është plotësisht spiritual* ($-\bullet$), *vetëm* (*1*) *Ai është i përsosur* (○)"

Krishti në Ungjill:

"*Vetëm Zoti është i mirë...*"

anguṣṭha - m. *pouce, gros orteil* (*gishti i madh i dorës* a i *këmbës*)

Me qënë se Gjuha emërton paradigmatikisht, sipas më të *madhit*, sipas më të *lartit* etj., etj. kjo fjalë lidhet më shqipen *gisht* (gishti i madh si gishti par excellence).

sūnu - m. *fills, enfant* (*djal, fëmi*)

Është shqipja *çun* gjithë po në atë kuptim.
Në angl. *son*, në gjerm. *Sohn*.

Le të vëmë rè këtu se në sanskritisht:

sūrya - m. *soleil, dieu du soleil* (*diell, perëndia e diellit*)


Me qënë se *dielli* vështrohet mitikisht si *djali i Qiellit*, fjala **sūnu** dhe **sūrya** në sanskritisht janë të bashkërrënjëshme. Ato lidhen gjithashtu që të dyja me **sy**nin (e folmja e Veriut) dhe **syr**in (e folmja e Jugut), dhe kjo sepse *syni* a *syri*, siç kemi parë, përputhen mitikisht me konceptin e *diellit*.

a-ja - a. *non né, qui existe de tout temps*
(*që s'ka lindur, që ekziston në çdo kohë*)


Me shqipen:

– **jam**

Një sqarim këtu është ndoshta i nevojshëm.
Ekzistenca (fr. ***exi**stence*) lidhet me foljen ***exit*** që shpreh konceptin e *daljes*. Po *dalja* nga ana e saj lidhet me një *dallim*.
Simbolikisht:



Dallimi nga ana e tij lidhet me një *materializim*, materializim ky që është ai i të *ekzistuarit*, të qënurit në këtë botë, të *lindurit* (vëmë ré në shqip: *lindje* dhe *lëndë*...).
Simbolikisht:



Po dimë se:

$$\bullet = F = (t \neq 0) = -(t = 0) = \textit{jo jashtë kohës, jo i përjetshëm}$$

Kështu pra *gjithshka lind është e përkohshme*, kurse *çfarë nuk lind është e përjetshme, është e të gjitha kohërave.*

Shohim se si Algoritmi ynë Simbolik e shpjegon këtë situatë fare mirë, e pra edhe dy kuptimet e fjalës sanskr. **a-ja**, që shprehin, siç shohim, një nga postulatet më themelore të Budizmit.

a-janman - a. *non sujet à naître; béatitude finale*
(*që nuk është i detyruar* (më) *të lindi; lumturia supreme, e fundit*)

Është shqipja **-jan**, e pra simbolikisht, duke e treguar lindjen si një *lëndëzim* me ●, tërë kjo fjalë do të përkthehet simbolikisht si −● e pra ○, e pra ($x = -x$), e pra Qëndra, e pra Zoti, e pra përputhja me parimin suprem të Universit, e pra atëhere *lumturia supreme.*

Rikujtojmë nga Cirlot:

> "In all symbols expressive of the mystic Centre, the intention is to reveal to man the meaning of the primordial "*paradisal state*" and to teach him to identify himself with the *supreme principle* of the universe"*

-man në këtë fjalë sanskritisht është një prapashtesë me kuptimin e personit,

* Shih fq. 343.

e subjektit të cilit i mvishet atributi i përshkruar nga rrënja e fjalës, këtu *jan*, mbi të cilin bie edhe tërë theksi semantik. Ai lidhet, siç ka shumë mundësi me *man* në kuptimin e njeriut, **man**usha (*njeri*, në sanskritisht). Ky sufiks është tepër i përdorur me këtë kuptim (me atë të *njeriut*, etj.) në shumë gjuhë indoevropiane.

ghạrma - m. *chaleur; feu intérieur* (*ngrohtësi; zjarr i mbrëndshëm*)

Është shqipja **ngroh**.

Vëmë rè se në shqip:

ngroh dhe *ngrij*

formojnë një çift ekuivokal*, si një rast i zbatimit të rregullës ($x = -x$) a ç'është njëlloj, referencës tek Qëndra.

Kemi parë** se kjo ka qënë një shfaqje e zakonshme në gjuhë tepër të lashta***. Pra dhe pajisja e një fjale (në çdo sistem gjuhësor qoftë) me një partner antitetik, flet për një nivel të thellë arkaik të kësaj fjale. Sanskritishtja nuk ka një partner antitetik për fjalën *ghạrma*, kurse shqipja ka një të tillë për fjalën *ngrohem* (*ngrihem*) që këndej edhe përfundimi:

ghạrma $_{\text{sanskr.}}$ < **ngroh** $_{\text{shq.}}$

Edhe anglishtja *warm* këtu lidhet, me qënë se sanskritishtja (shqipja) **g** (k) nistore shpesh është shndërruar në **w** në anglisht.

Sigurisht këtu lidhet dhe rusishtja *grets* (*гремь*) = *ngroh*.

an-adāra - m. *absence d'égards; indifférence; mépris*
(*mungesë kujdesi, mospërfillje; indiferencë; përbuzje*)

Është shqipja:

---

* Shih edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi, fq. 307.

** Shih *Hyrjen*.

*** Shih edhe fq. 144, 145, 146.

– **â darë**

(në kuptimin që *nuk e ndan* veç nga të tjerët, që *nuk e nderon*)
Shih lidhur me këtë fjalë edhe fjalën sanskr. **vandura** (fq. 399)

Në hebraisht:

kavod (כבוד) - angl. *honor, respect* (*nder, respekt*)

Kjo fjalë zbërthehet në:

ka vod

dhe me shqipen:

ka bë **da**

pra edhe në hebraisht si në sanskritisht (*dāra*) dhe në shqip (*nderi* = *ndarë*), koncepti i të ***nderuarit*** lidhet ngushtë me atë të ***ndarjes*** veç nga të tjerët. Që këndej del, ndër të tjera, se Zoti duke qënë më i ***ndari*** veç nga të gjithë, është (ose të paktën duhet të jetë...) më i ***nderuari*** nga të gjithë, i ***adhuruari***.

Le ta zgjerojmë biseden rreth *pranisë të rrënjave të gjuhës hebraishte si në Shqip ashtu edhe në Sanskritisht* ose *anasjelltas*. Ne kemi folur shkarazi për afërsinë e Shqipes me Hebraishten* duke cituar edhe Fan Nolin që e studionte rëndshëm në pleqërinë e tij këtë gjuhë, siç dëshmon ndër të tjera dhe metoda anglisht sot e disponueshme për mësimin e Hebraishtes me shënimet e tij. E mirë pra, ai shihte (edhe sipas atyre që kam dëgjuar nga një burim gojor i sigurtë) tek Arbërit dhe tek Hebrejtë dy popuj vëllezër. Në kohë të tij edhe Bilotta, zotërues mjeshtëror i gjuhës hebraike (gjë që lidhej edhe me karrierën e tij kishtare) që mund të vështrohet bashkë me De Radën e shumë arbëreshë të tjerë të mëdhenj të harruar... si një rilindas, kishte vënë rè një afërsi të madhe mes gjuhërave të këtyre dy popujve tepër të lashtë. Studimi nga ana ime i gjuhës hebraishte rikonfermoi intuicionin e Fan Nolit dhe të Bilottës mbi afërsinë e gjuhës shqipe

* Shih edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi, fq. 96.

me hebraishten.

Me qënë se numri i konkordancave mes shqipes dhe hebraishtes është jashtëzakonisht i madh, kemi menduar t'i radhitim disa prej tyre mënjanë në një kapitull më vehte *po në këtë studim,* duke dalë jashtë kufijve të tij të mirëfillta.

Kjo është bërë, duke thyer rregullat e kompozicionit të veprës, për arsye se këto konkordanca flasin për dy gjëra me një rëndësi thelbësore:

1) Për një lashtësi të paktën po aq të madhe të Shqipes sa dhe ajo e Hebraishtes.

2) Për faktin shumë themelor se shqipja duke qënë gjenetikisht e afërt me të dy përfaqësueset më të lashta të të dy **degëve** (familjeve) më të mëdha gjuhësore, të asaj të *gjuhërave indoeuropiane* (sanskritishtja) dhe të asaj të *gjuhërave semitike* (hebraishtja), mund të mendohet se është në gjëndje të shërbejë si një **trung** bashkues mes tyre. Kjo do të justifikonte deri në një farë pike edhe përzgjatjen jashtë themës të këtij studimi, që përpiqet të rroki kështu tërë kapacitetin përfshirës të Gjuhës sonë, a e thënë ndryshe, **universalitetin** e saj, gjë për të cilën është folur, ndonëse në një mënyrë disi të vagullt, edhe në *Pjesën e parë* të këtij studimi.

Lista e konkordancave, me një koment herë herë të shkurtër, jepet në një nënkapitull të veçantë me titull: *Shqipja dhe Hebraishtja.* Fjalorët e shfrytëzuar janë dy: njëri me përkthim në anglisht dhe tjetri me përkthim në italisht. Vëmë në dukje gjithashtu këtu se që të dy këto fjalorë janë të gjuhës hebraishte të sotme, të folur. Kuptohet vetvetiu se nga një fjalor i hebraishtes biblike (siç është ai i Gessenius, i konsultuar nga autori) konkordancat do të ishin edhe më të mëdha në numër si edhe më revelatore në cilësi.

Shqipja dhe Hebraishtja

Një listë e shkurtër konkordancash

Fjalori me përkthim në anglisht dhe anasjelltas

(Hebrew Dictionary, Hayim Baltsam MacMillan-Usa ,1992)

khadar (קדר) - angl. *room of ...* (*dhomë e ...*)

Zbërthehet në:

kha dar

dhe me shqipen:

ka **darë**

e pra simb. ⓘ e pra dhe ⊡, e pra dhe ⊠.

khadal (חדל) - angl. *ceased; stopped* (*që ka pushuar, që ka ndaluar*)

Do ndarë në:

kha dal

dhe me shqipen:

ka (n)**dal**

e pra simbolikisht:

$_{-}\sim$

ni'dar (נצדר) - angl. adj. *missing; absent* (*që mungon*)

Është shqipja:

i,e **ndar**

banah (בנה) - angl. v. *built; constructed* (*ndërtuar*)

Lidhet me shqipen:

ban, **bana** (*banesa*, *banoj* ...)

doron (דורן) - angl. *gift; present* (*dhuratë*)

Krahaso me shqip:

dhuroj, **dhuron**, **dhuratë** ...

kavar (קבר) - angl. v. *buried* (*i varrosur*)

Është shqipja:

ka varrue (nga fjala *varr*)

krahaso edhe me shq. *qivur*.

kash (קש) - angl. *straw* (*kashtë*)

Është shqipja:

kashtë

kashit (קשית) - angl. *straw* (for sipping drinks)
(*kashtë* (kallam kashtë për të pirë))

Është shqipja:

kashtë

tsur (צור) (shqipto cur) - angl. *rock; fortress* (*gur, shkëmb: fortesë*)

Është shqipja:

curr, *curran, curril, ...*

në të folmen e Veriut që lidhen, sigurisht me *gur, i,e gurtë ...*

ledah (לידה) - angl. n.f. *birth* (*lindje*)

Është shqipja:

lindje

bara (ברא) - angl. v. *created* (*i krijuar*)

Është shqipja:

i bërë

folja *baj, bëj ... bëra ...*

nig'al (נגאל) - angl. *was redeemed, rescued, set free* (*u ngjall, u lirua*)

Është shqipja:

ngjall

halbashah (הלבשה) - angl. *clothing* (*veshje*)

Lidhet me shqipen:

vesh, veshje etj.

kala (קלע) - angl. *shot, hit* (*i,e shtirë, e qëlluar*)

Është shqipja:

qëlloj

jetomim (יתומים) - angl. *orphanage* (*jetimësi*)

Lidhet me shqipen:

jetim

(që ndoshta lidhet, si me prejardhjen e saj, brënda shqipes, me i *jetun* = *qi ka mbetë*...)

heshtakhah (השתקה) - angl. *silencing* (*që vë në heshtje*)

Lidhet me shqipen:

hesht, heshtje ...

khavash (חבש) - angl. *dressed* (*veshun*)

Është shqipja:

ka vesh

hiktan (הוקטן) - angl. *was reduced, was diminished*
(*u reduktua, u zvoglua*)

Është shqipja:

u ka dan

(është *ndarë*, që nga simb. ⌀ , e pra atëhere edhe < ○ që mund të interpretohet pikërisht si *zvoglim* (angl. *diminished*))

histir (הסתיר) - (pres. ***mastir***) angl. *concealed* (*i fshehur*)

Është shqipja:

i shtir

(folja me *shti, shtij* ... etj.) simb. ⊡, simbol ky që mund të interpretohet edhe si ai i *shtimjes*, edhe ai i *fshehjes*.

histater (הִסְתַּתֵּר) - angl. *hid* (*i fshehur*)

Është shqipja:

i shtitur

histara' (הִשְׁתָּרַע) - angl. *stretched out; extended; spread out* (*i shtrirë, përhapur...*)

Lidhet me shqipen:

shtrij, i shtrirë etj.

khatsah (חֲצָה) - angl. *divided in two* (*i ndarë në dy*)

Është shqipja:

ka ça

e pra simb. ⊕ = ◖ ◗.

kholef (חוֹלֵף) - angl. *passing; fleeting; temporary* (*që kalon, që ikën; i përkohshëm*)

Është shqipja:

kaloj, *kalimtar* ...

karam (קָרַם) - angl. *crusted; covered with crust* (*me kore; i mbuluar me kore*)

Lidhet me shqipen:

kore

yashan/yashanah (ישן) - angl. *old* (*i vjetër, plak*)

Theksi semantik bie tek **-shan** që lidhet mitikisht me shqipen **syni** (*syni* si *çuni i qiellit*, e pra *djali* si *dielli*, "the son like the sun, ..." dhe *dielli* lidhet siç dihet me *vitin* (turq. *sene*) që nuk është tjetër veçse një rrotullim i plotë i Tokës rreth diellit.

zirah (זירה) - angl. *arena* (*arena*)

Fjala *arena* lidhet siç dihet me shqipen **rana** (toskërisht *rëra*). Po ashtu edhe fjala hebraisht që po shqyrtojmë lidhet me shqipen:

zhur

jozem (יזם) - angl. *initiator; initiates* (*iniciator, nismëtar, inicion*)

Lidhet me shqipen:

me **zan** (me *fillue*), **za** (*filloj*), **zamje** (*zanje*)

kvurakhamor (קבורחמור) - angl. 1. *contemptible burial* (*varrim i "shpifur"* (qesharak)); 2. lit. *the burial of an ass* (fjalë për fjalë: *varrimi i një gomari*)

Është shqipja:

varrimi i gomarit

Vëmë rè se në shqip edhe **gamor**, si edhe **qivur**.
Pra edhe, me shqipen: *Kivuri gamorit.*

huf'al (הופצל) - angl. v. *was activated; was started* (*u aktivizua; u fillua*)

Është shqipja:

u **fillua**

Vërë rè se në shqip: u **fillua** dhe **fal** (*përëndoi, mbaroi*).
Kështu shqipja shtron në këtë mënyrë ekuacionin simbolik:

α = ω
u fillua **u fal** (*u falit*)

hukam (הוקם) - angl. v. *was established; set up, erected* (*u vendos, u ngrit, u ndërtua...*)

Lidhet me shqipen:

këmbë, kām (në të folmen e Veriut)

Pra, me shqipen:

u **kam**sue (u ngrit në këmbë)

kum (קום) - angl. *get up!* (*ngrihu në këmbë*)

Lidhet me shqipen:

kām (këmbë)

Në Ungjill, Krishti vajzës të cilin ai e ngjall nga vdekja:

"*Talitha kumi!*" (*Ungjilli sipas Markut, 5:41*)

Me shqipen:

"*Delthe, kam!*

Delthe (hebr. *talitha*), *delthe e vogël* në hebraisht figurativisht për *vajzë të vogël.*

Me këtë rrënjë janë krijuar edhe shumë fjalë në hebraisht, si:

bi-mekom (במקום) - angl. adv. *in the place of, instead of ...*
(*më këmbë të ..., në **kam** të...*)

Në shqip gjithashtu: *më**këm**bësoj, më**këm**bës ...*
Të gjitha fjalë këto që lidhen me rrënjën shqip **kam** (me hebraishten **kom**...)

hitkomem (התקומם) - angl. *rebelled, rose against*
(*u rebelua, **u ngrit në këmbë** kundër...*)

Dhe këtu kemi prap shqipen:

kam (këmbë)

E kështu me radhë...

skirah (סקירה) - angl. *review; survey; glance* (*kqyrje; shqyrtim; shikim*)

Lidhet me shqipen:

shkyrtoj

që nga ana e saj lidhet me foljen **kyr** (*shoh*).

be'er (באר) - angl. 1. *well* (*pus*); 2. *pit* (*vrimë*)

Është shqipja:

bira

'ukal (עוקל) - angl. *was seized* (*u kap*)

Është shqipja:

u kall

e pra simb. ⊡ e pra atëhere edhe, për ekuivalencë simbolike ☓. Dhe kemi kështu si kuptimin e *kapjes* (☓) ashtu edhe atë të *futjes brënda*, të *të burgosurit*...

hukhal (הוחל) - angl. *was begun; started* (*nisi, filloi*)

Është përsëri shqipja:

u kall

e pra simb. ⊡ .

Dimë që kemi:

⊡ = *–1* = *fillimi*

Vëmë rè këtu se edhe hebraishtja e lidh *fillimin* me *kapjen*, *burgosjen* (⊡) e *parimit hyjnor* (○) po ashtu si shqipja me **zë** (*kapje* dhe *fillim*), gjerm. me *fangen* (kap, zë) dhe *anfangen* (filloj); lat. me *capere* (kap) dhe *incipere* (filloj).

Është rasti këtu për të shpjeguar edhe diçka tjetër.

Folja në hebraisht klasifikohet duke u bazuar mbi bashtingëlloret (në përgjithësi me tre) që përbëjnë rrënjën e saj. Të gjitha trajtat e të njëjtës folje nxirren nga këto gërma të quajtura "rrënjësore", duke zbatuar vokalizime (zanore) të ndryshme dhe duke shtuar parashtesa e prapashtesa.

Folja në hebraisht paraqitet zakonisht, në fjalor, jo në paskajore por *në vehten e tretë mashkullore njënjës të së kaluarës;* kjo jep atë që ne e quajmë **rrënjën** e foljes (fjalës).

Kjo është pra arsyeja që foljet në këtë listë fjalësh janë dhënë pikërisht në këtë kohë e në këtë vehtë.

histajem (הסתיים) - angl. *ended* (*mbaroi, ka mbarue*)

Lidhet me shqipen:

shtij (a më saktë ***shti** jam*)

dhe kjo për arsye se, me qënë që edhe sipas vizionit mistik të Universit, edhe sipas asaj që vetë Realiteti na tregon, ndërsa *fillimi lidhet me një dalje, fundi lidhet me një rifutje që andej nga ka dalë.*

Nga ana tjetër Algoritmi Simbolik (artikullim llogjik i mendimit mitik mbi të cilin të gjitha gjuhët ngrihen) na jep:

⊕	=	⊡	...(**F**)
cak i mbramë		*rifutja mbrënda*	
fundi		*shtimja* shq.	

Ekuacioni i mësipërm mund të lexohet në dy kahje:

Nga e djathta në të majtë ai mund të interpretohet si *lindje, fillim*, kurse nga e majta në të djathtë ai mund të interpretohet si *vdekje*, si *fund.*

hitvada' (התוודע) - angl. *became acquainted* (*u bë i njohur, i ditur*)

Theksi semantik bie tek:

vada'

që është shqipja:

ba **dî**

Krahaso me **kavod** (כבוד).

Edhe këtë rrënjë (**di, da** ...) në kuptimin e DIjes, ashtu si edhe shumë rrënjë të tjera të Hebraishtes, e gjejmë edhe në Sanskritisht (siç lexuesi do të bindet vetë), *gjë kjo që flet për një largësi jo aq të madhe mes këtyre dy "familjeve" gjuhësore, gjuhëve **indoeuropiane*** (me Sanskritishten si "burim") *dhe gjuhëve **semitike*** (me Hebraishten si pikënisje).

Dhe ndoshta në një situatë të tillë *ndërgjuhësore* **Shqipja e pasur pa masë**

siç është me operatorë të lirë* *do të luante rolin e një* **rruge kalimi, të një ure** *mes këtyre dy familjeve të mëdha gjuhësore, të vështruara me pa të drejtë gjer më sot kaq të ndara e të ndryshme.*

Le të vëmë rè këtu edhe një gjë tjetër me rëndësi:

Konkordancat që po paraqesim shkurtimisht këtu mes Shqipes dhe Hebraishtes, ashtu si edhe në rastin e Shqipes me Sanskritishten, janë dy llojesh:

a) *Të drejtë për drejta* kur ato bien menjëherë në sy pa ndonjë veprim "zbërthimi";

b) *Të zhdrejta* (të tërthorta) kur operatorët e Shqipes janë të "brëndashkruar", janë të "inkapsulluar" në gllosën Hebraisht, e lypet një farë teknike për t'i nxjerrë ato që andej në gjëndje të pastër.

Fjalët e hebraishtes që kemi shqyrtuar gjer tani e do të shqyrtojmë më pas, perstohen për t'u futur si në njërën ashtu edhe në tjetrën kategori.

hitgarah (התגרה) - angl. v. *teased, challenged*
(*i ngarë, i ngacmuar, i sfiduar*)

Lidhet me shqipen:

ngaj, i ngarë, ... *ngasje*

hitgarut (התגרות) - angl. nf. *provocation* (*provokim*)

Është shqipja:

ngarje ... *ngasje*

hitgared (התגרד) - angl. v. *scratched oneself* (*u krrua*)

---

* Shih edhe 15, 125, 176.

Lidhet me shqipen:

me krru (angl. *scratch*)

hitgabrut (התגברות) - angl. *strengthening*
(*që forcon, duke forcuar*)

Lidhet me shqipen:

burrnoj (nga fjala *burrë*)

Ky operator i lirë i shqipes është i pranishëm, siç do të shohim, në shumë fjalë të përbëra (i inkapsulluar) të hebraishtes.

zefet (זפת) - angl. *tar; pitch* (*katran, zift*)

Lidhet me shqipen:

zift

zift (זיפת) - angl. 1. *no good;* 2. adv. *unhappy, unhappily*
(*i keq; palumturisht, fatkeqsisht...*)

Theksi semantik këtu bie tek:

zi

që nuk është tjetër veçse shqipja:

i zi, e zezë

e pra simb. ●.

hushtat (הושתת) - angl. *was founded; based* (*u themelua; bazuar*)

Lidhet me shqipen:

shtī, shtīt (*u shtīt*)

e pra simb. ⊡, gjë që jep për ekuivalencë simbolike ●, e pra *materializim, ndërtim.*

Krahaso dhe me të njëjtën rrënjë sanskritisht si edhe me shqipen ***shtet***, *mbë**shtet***, etj., etj.

nemanut (נאמנות) - angl. *loyalty, fidelity* (*ndershmëri, besnikëri*)

Theksi semantik bie tek:

man

që lidhet me shqipen:

man (**m**(b)**an**)

(*që nuk ndryshon, që nuk tradhëton ...*)

Këtë rrënjë e gjejmë edhe në fjalën **amen** (në ritualet fetare në kuptimin *i,e vërtetë, ashtu është*), me qënë se pandryshueshmëria vështrohet si një atribut themelor i të vërtetës dhe i Zotit.

mador (מדור) - angl. *section* (*seksion, e ndarë*)

Lidhet me shqipen:

dar (*i,e* (*n*)*darë*)

nga folja DAJ.

katsats (קצץ) - angl. *chopped; cut off*
(*i coptuar; i prerë, i ndarë*)

Është shqipja:

ka ça

e pra simb. ⊕ e pra edhe, për ekuivalencë simbolike ◖ ◗.

katsar(si edhe **katser**) (קצר) - angl. *short* (*i shkurtër*)

Është shqipja:

ka ça, **ka çarë** (folja *ÇAJ*)

Një sqarim këtu është i nevojshëm.

Në angl. **to share** (*ndaj*) dhe **short** (*i shkurtër*).
Në fr. **briser** (*thyej*) dhe **bref** (trajta e lashtë **brier**) (*i shkurtër*).

Me fjalë të tjera *koncepti i shkurtësisë lidhet me atë të një prerje*, të një *ndarjeje*, të një *shkurtimi*.

Jo vetëm, por duke e zgjeruar biseden, ne mund të themi se edhe koncepti i *mprehtësisë* lidhet me atë të *prerjes*.

Kështu p.sh. në shq. **pres** dhe i m**preh**të.
Në angl. **to share** dhe **sharp** (*i mprehtë*).
Në rus. **rezats** (*резать*) (*pres*) dhe **rezkij** (*резкий*) (*i mprehtë*).

Vërejmë shkarazi se edhe rusishtja *raz* (*раз*) lidhet brënda rusishtes me fjalën *rezats* (*резать*) - *me pre*, e pra simb. ⌀ .

Kështu rusishtja shtron ekuacionin e njohur simbolik:

$$\underset{rezats}{⌀} = \underset{raz}{-1} \qquad ...(\mathbf{F})$$

Vërejmë se në hebraisht **rishon** (ראשון) = *i pari*, dhe mund të vërtetohet se lidhet me rusishten **раз**.

Edhe fjala shqip **brisk** lidhet po këtu, d.m.th. mbrënda shqipes me foljen **pres** dhe jashtë shqipes me fr. **briser** (*pres, coptoj*).

Se si dhe pse *koncepti i mprehtësisë lidhet me atë të coptimit* kjo shpjegohet "algoritmikisht" kështu:

Nisja bëhet gjithmonë, siç dimë, nga Qëndra, e pra simboli ○ i cili, siç

shihet, nuk ka *cepa*, nuk është i *prerë* dhe pra si i tillë *nuk është as i mprehtë*. Shqipja me *copë* dhe *cep* na thotë se *cepat dalin nga një coptim i të tërës*, që jepet nga simboli ○. Figura e mëposhtme e tregon qartë këtë:



coptimi = *cepat* (*mprehtësia*)

Kjo situatë përshkruhet bukur nga aforizma e Shqipes:

"*Nga coptimi cepat*"

Duke e zgjeruar edhe më tej bisedën shtojmë se *coptimi* (dhe *cepat* që lindin prej tij) realizon kalimin nga ○ në ⦶ e pra nga kodi ***E*** në kodin ***F***, e pra nga kodi i *thellësisë* (***E***) në kodin e *cektësisë* a i *përciptësisë* (***F***). Atëhere kuptojmë përse në shqip kjo situatë jepët më së miri me:

copë, **cep**, **cip**(ë)

që lidhen që të gjitha me të njëjtën rrënjë me vokalizime të ndryshme (**o**, **e**, **i**).

Duke e zgjeruar akoma dhe më tej bisedën, shtojmë edhe sa vijon:

Figura simbolike ○ është në të njëjtën kohë ajo e *Qëndrës*, ajo e *Hiçit*, ajo e *Përsosjes*.

Mund të shkruajmë edhe, siç dimë:

$$\bigcirc = (x = -x) = -(x \neq -x) = \textit{Unbrocken Symmetry}$$

Pra mund të shkruajmë atëhere edhe:

$$\bigcirc = \textit{The Perfect, Unbrocken Symmetry of Nothingness}$$

Këtu *s'ka coptim*, këtu *s'ka cepa*. Po këtu *s'ka as Botë materiale*. Jemi para **Krijimit**.

Krijimi fillon, siç dimë, me ⦶ e pra me ***coptimin***, me ***cepat***, me *përcipshmërinë*. Këtu nuk ka më as *përsosje*, (⦶ = −○) as *Unbrocken symmetry* (⦶ = −○ = − [−(***x*** ≠ −***x***)]). Këtu kemi krijim të Botës materiale dhe mbajtje të saj (⦶ = ● = *Bota materiale*).

Kështu pra, nga sa më sipër del se *Bota materiale është e përciptë, është me copa, është me cepa ...*".

Fjalori me përkthim në italishte dhe anasjelltas
(Italiano-Ebraico, Ebraico-Italiano, Miriam Biasoli, Antonio Vallardi editore,2004)

em (אם) - it. *madre* (*nanë*)

Është shqipja:

i,e **ama**

buz (בּוּז) - it. *disprezzo* (*përbuzje*)

Është shqipja:

për**buz**

Në shqip gjithashtu, ... *i bëj buz diçkaje* = e *përbuz*.

biet (בִּית) - it. *addomesticare* (*zbut*)

Është shqipja:

zbut

si edhe **i but**, **zbutje**, etj., etj.

bajt (בִּית) - it. *casa* (*shtëpi*)

Është shqipja:

bujtinë

nga folja *me **bujt***.

bejt-kevarot (בית–קברות) - it. *cimitero* (*qimitir*)

Me shqipen:

bujtinë qivuresh

badal (בדל) - it. *separarsi* (*me u ndà*)

Me shqipen:

ba dallù

esh (אש) - it. *fuoco* (*zjarr*)

Krahaso me shqipen:

ashk, eshkë

Këtu lidhet dhe anglishtja **ash** = *hì* (it. *cenere*) si e kundërtë e zjarrit në bazë të regullës ($x = -x$).

ani (אני) - it. *io* (*unë*)

Është shqipja:

uni

histir (הסתיר) - it. *nascondere* (*me fsheh*)

Lidhet me shqipen (dhe sanskritishten):

me **u shtir**, *shtirem* (*shtihem, futem brënda* ...)

hi- në hebraisht është diateza e pjesores, kështu që rrënja e pastër është **shtir**.

mustar (מסתר) - it. *nascosto* (*i fshehur*)

Është përsëri shqipja:

shtir

Edhe fjala **mister** (it. *mistero*, angl. *mistery* ...) këtu lidhet, me hebraishten *mustar*, me shqipen *me shtir* si edhe me sanskritishten ku kjo rrënjë gjëndet në po këtë trajtë si edhe bash me kuptimin e *misterit*.

bad (בד) - it. *parte, porzione* (*pjesë, porcion* ...)

Është shqipja:

bë **dà**

e pra simb. ⌀.

ania (אניה) - it. *nave, battello* (*anija*)

Është shqipja:

ania

da'tanut (דעתנות) - it. *scienza, erudizione* (*shkencë, dituri*)

Është shqipja:

dituni

da'at (דעת) - it. *conoscenza* (*njohje, dije*)

Është shqipja:

dituni, **dijt**, ... (folja *di*)

adama (אדמה) - it. *terra, terreno* (*tokë, dhè*)

Është shqipja:

dhōm (në të folmen e Veriut)

gèver (גבר) - it. *maschio* (*mashkull*)

Lidhet me shqipen:

burr

Kujtojmë se shqipja *burr* ka dhënë latinishten **vir** në kuptimin e *burrit* e *virtutit* (lat. *virtus*), në kuptimin e *fuqisë*, *forcës* (*vir*), etj.

gavri (גברי) - it. *virile* (*burrëror*)

Lidhet me shqipen:

burr

gibor (גִּבּוֹר) - it. *eroe* (*herò*)

Lidhet përsëri me shqipen:

burr, *burrëri*, etj., etj.

zera' (זרע) - it. *seme* (*farë*)

Lidhet me shqipen:

zjarr

Sa do të shihen më poshtë do ta bëjnë më të besueshme këtë lidhje mes *farës* dhe *zjarrit*.

zarkhan (זרחן) - it. *fosforo* (*fosfor*)

Lidhet me shqipen:

zjarr

khan, kha... lidhet me foljen shqipe **ka** (*kam*), dhe parangjitet ose pasngjitet tek trupi (rrënja) e fjalës.

Vëmë rè se në rusisht: **zernò** (*зерно*) *farë* (it. *seme*) dhe në të njëjtën kohë **zarjà** (*заря*) *agim* (fjalë shqipe që lidhet me sanskr. *Agni - zjarr, dritë* dhe me rus. *ogonj* (*огонь*) *zjarr*).

Siç shihet me *zjerno* (*farë*) dhe *zarjà* (*agim*, e pra *zjarr*), rusishtja na flet qartë për lidhjen e *farës* me *zjarrin* (angl. *fire*). Vëmë rè shkarazi me këtë rast edhe lidhjen e shqipes **farë** (it. *seme*) me **furrë** (it. *forno*) që flet përsëri mbi lidhjen themelore të farës me zjarrin. Rikujtojmë gjithmonë se fara lidhet me *mashkullin* i cili lidhet mitikisht me *Diellin*, e pra me *zjarrin* "par excellence", ndërsa *femra*, përsëri mitikisht, me *Hënën* dhe rrjedhimisht me *ujin*.

zarakh (זרח) - it. *brillare* (*shkëlqej*)

Lidhet me shqipen:

zjarr

vadaj, -it (ודאי) - it. *certo* (*sigurisht*)

Është shqipja:

ba dij, ba **ditë**

Një gjë e sigurtë është, një gjë që dihet. Në shqip: ... *kjo dihet*... në kuptimin që për këtë s'ka ndonjë dyshim, se kjo është e sigurtë...

vadáiut (ודאיות) - it. *certezza* (*siguri*)

Është shqipja:

ba **dijt**

vida (ודה) - it. *confessare* (*bëj të ditur, konfesoj*)

Është shqipja:

ba **dì**

viduj (ודוי) - it. *confessione* (*konfesim, rrëfim*)

Është shqipja:

ba **dìj**, *ba me dijtë, ba me ditun* (folja **dij**)

kodem (קדם) - it. *prima* (*para, përpara*)

Është shqipja:

ka dām (që është ndarë)

e pra simb. ⏀, e pra atëhere:

$$⏀ = F = -1 = \text{një, i pari, ... përpara } (prima)_{\text{it.}}$$

Rikujtojmë me këtë rast sa vijon:

a) Bota ka filluar me një ndarje. (Paracelsus : *Die Separatio ist aller Geburt Anfang*).

b) Gjuha referon gjithmonë tek Qëndra dhe tek **ndarja e parë** në të, siç është **krijimi** i Botës, **fillimi** i saj.

c) Sipas mendimit mitik, mbi të cilin tërë Gjuha ngrihet, Bota ka filluar me një involucion, gjë që do të tregohet pra me -1 dhe jo me 1.

Kështu pra shqipja e shpie fjalën hebraishte **kodem** bash tek simboli që ajo duhet të përshkruaj.

Le të shtojmë këtu shkarazi se *Adam Kadmoni* mbahet si i pari i hebrejve. Ai ishte mbreti legjendar i fenikasve dhe themeluesi i Tebës. Legjendat thonë se

ai vdiq në Iliri, tek i biri Ylli. Kohët e fundit flitet se është gjetur varri (tuma) e tij këtu në vendin tonë, gjë që do të nxirrte të vërtetë legjendën mbi vdekjen e tij në Iliri. Kjo mund të flasi, nëse edhe shumë gjëra të tjera do ta rikonfermonin, për një farë "autoktoniciteti" të hebrejve në Shqipëri dhe jo vetëm si të ardhur këtu herë pas here, me rastin e përndjekjeve që u bëheshin atyre në vende të tjera të botës, e veçanërisht në Europë. Gjejmë gjurma të hebrejve kudo në vendin tonë, të quajtur shpesh herë *cudhènj* (deformim i emrit *judhè*), madje edhe në vende të tilla veriore e malore si në krahinën e Kurbinit, si në bjeshkët e Iballës, të Pukës e gjetkë ...

kadmon (קדמון) - it. *primitivo* (*primitiv, i hershëm*)

Është shqipja:

ka dāmun

e pra simbolikisht:

$$\text{⏀} = F = -1 \text{ (shih edhe më lartë)}$$

Duke u rikthyer tek Adam Kadmoni, me qënë se Adami, njeriu i parë, u krijua prej dheu, prej *dhomi*, (hebr. **adama**), emri i mbretit të parë legjendar fenikas "përkthehet" me shqipen si:

"*Â dhom ka damuni*"

Rikujtojmë se *i damuni* d.m.th. *i ndari* është *i nderuari*. Kështu në shqip, kështu në hebraisht (**kibed** (כבד) e pra me shq. *ka bë dà*), kështu në sanskritisht (**vandura** dhe me shq. *bâ ndarë*). Nga ana tjetër më i nderuari nga të gjithë është më i pari nga të gjithë, pra Zoti e pas tij Mbreti (Kadmon).

kadum (קדום) - it. *arcaico* (*arkaik, i lashtë*)

Lidhet me shqipen:

ka **dam**

Shih **kadmon**.

'avad (עבד) - it. *adorare* (*adhuroj*)

Lidhet me shqipen:

bâ **da** (*është ndarë, ndahet*)

Edhe latinishtja *adorare* (adhuroj) shpjegohet edhe ajo me shqipen *â darë* . I adhuruari pra *Zoti*, *Hyjnia* supozohet i *ndarë veç nga të tjerët.*

bikura (בכורה) - it. *primizia* (*gjë e hershme, e parë*)

Është shqipja:

bâ **kry** (bë kre-u)

leda (לדה) - it. *nascita* (*lindje*)

Lidhet me shqipen:

lind

higdir (הגדיר) - it. *definire* (*përcaktoj*)

Është shqipja:

ka darë

e pra simb. ⏀. Rikujtojmë se në shqip fjala ***përcaktim*** nënkupton vënien e një *caku*, e pra **ndar**jen.

gedal (גדל) - it. *confine* (*kufi*)

Do zbërthyer si:

ge dal

Theksi semantik bie mbi **dal** që lidhet me shqipen **dalloj** që rrjedh nga ana e saj nga një *dâ yll* dhe me qënë se *ylli* (i përdorur këtu si një nyje prapashtesë) lidhet me Qëndrën, mund të shkruajmë edhe:

$$\textbf{yll} = \bigstar = (x = -x) = \bigcirc$$

E pra atëhere:

gedal $_{\text{hebr.}}$ = **ke dallù** $_{\text{shq.}}$ = *ke dâ yll* = $\oplus$ = *kufiri* (si ndarje mes dy vendeve ...)

gadól, *gedóla* ... (גדול) - it. *grande* (*i madh*)

Do zbërthyer si:

ga dol

dhe me shqipen:

ka **dallù** (*ka dalluar*)

Le të shpjegojmë këtë motivim, me anë të shqipes, të kësaj fjale.
Simbolikisht:

$$\textit{ka dallù} = \oplus = F = -\bigcirc = -(x = -x) = -(x^2 + y^2 = 0) = (x^2 + y^2 = r^2)$$

Pra me anë të *ndarjes* (*dalloj* = $\oplus$) kalohet nga *pika* (*qëndra e rrethit*, $(x^2 + y^2 = 0)$) tek *periferia e rrethit* $(x^2 + y^2 = r^2)$, dhe ky është një *zmadhim*.

kara (קרה) - it. *capitare* (*me rastis*)

Është shqipja:

ka **rà**

ku theksi semantik bie tek **rà** që lidhet me foljen shqipe *me* **rà.**

Vëmë rè edhe se:

a) it. **caso** (*rast*), lidhet mbrënda italishtes në **cadere** (nga lat. *cado, cecidi, **casum**, cadere* ...).

b) shqipja **rast** (që nga *rastis*) duhet ndarë në **ra** (a)**sht**.

c) në gjuhë të tjera ne vëmë rè të nëjtën lidhje të konceptit të *rastit* me atë të *rënies*.

Kështu për shembull në gjerm. *fallen* (me rà), ndërsa *Falle* (*rast*).

bara (ברא) - it. *creare* (*krijoj*)

Është shqipja:

bërë (*bë, baj*...)

berja (בריה) - it. *creatura* (*krijesë*)

Është shqipja:

bërja

beria (בריאה) - it. *creazione* (*krijim*)

Është shqipja:

bërja (*të bërët*)

era' (ארצ) - it. *avvenire, accadere* (*me ndodh*)

Lidhet me foljen shqipe:

me **rà** (it. *cadere*)

Vëmë rè se edhe në italisht *accadere* (*me ndodh*) nga *cadere* (*me* **rà**).

havdala (הבדלת) - it. *distinzione* (*dallim*)

Është shqipja:

ba dallù

Simbolikisht:

$$\text{Ⓘ} = F = (x = x) = -(x = -x) = (x \neq -x) = dallim$$

hevdel (הבדל) - it. *differenza, diversità* (*ndryshim, larmi*)

Është përsëri shqipja:

bë dallù

Vëmë rè se edhe në shqip (ashtu si edhe në shumë e shumë gjuhë të tjera) koncepti i **ndry**shimit është lidhur me atë të **ndar**jes.

Rikujtojmë se Algoritmi Simbolik jep me këtë rast ekuacionin:

$$\underset{\substack{ndarë \\ sever_{\text{angl.}} \\ dividere_{\text{it.}}}}{\text{Ⓘ}} = \underset{\substack{ndryshëm \\ several_{\text{angl.}} \\ diverso_{\text{it.}}}}{\chi} \qquad ...(\mathbf{F})$$

hagdara (הגדרה) - it. *definizione* (*përcaktim*)

Shih **higdir** (הגדיר) Lidhen me shqipen:

bitur (בתור) - it. *taglio* (*prerje*)

Lidhet me shqipen:

bë therr

gader (גדר) - it. *recinto, siepe* (*garth, rrethim*)

Lidhen me shqipen:

ka dar

(krahaso me shqipen *gardh*)

Do të kemi:

$$\text{⦶} = F = (x = x) = -(x^2 + y^2 = 0) = (x^2 + y^2 = r^2) = rreth = rrethim, \odot$$

Le të vëmë rè me këtë rast edhe diçka me rëndësi: një pjesë e gllosave hebraisht që jepen këtu, duke qënë marrë nga një fjalor me përkthim italisht, transkriptimi i gërmës **dh** (ד) jepet si **d** (ד). Kjo për arsye se në italisht nuk ekziston tingulli "dh". Një gjë e tillë e zvoglon herë herë afërsinë e gllosës hebraisht me shqipen.

mida (מדה) - it. *misura* (*matje*)

Lidhet me shqipen:

me dà (folja *daj*)

E pra simb. ⦶. Dhe kjo për arësye se *matja* nënkupton një *ndarje*.

Le ta zgjerojmë pak bisedën rreth kësaj çështjeje. Algoritmi simbolik jep:

$$\text{⦶} = \bullet \qquad \ldots(\mathbf{F})$$

Pra një lidhje të *ndarjes* me *materien*. Por Fizika Kuantike na jep një lidhje mes *matjes* dhe *materies* gjë që, siç dimë, sanskritishtja e jep përmes bisemisë të fjalës **matra** që do të thotë në të njëjtën kohë edhe *matje* edhe *materie*.

Pra kemi:

ndarje = *materie* (ekuacioni simbolik i mësipërm)

matje = *materie* (Fizika Kuantike dhe sanskritishtja)

Që këndej del krejt natyrshëm që:

matja = ndarja

d.m.th. që *matja* nënkupton një *ndarje*.

Pra atëhere vërtetë hebraishtja:

mida = *matje*

mund të interpretohet (motivohet) me anë të shqipes si:

me dà

ketem (כתם) - it. *macchia* (*njollë*)

Simbolikisht:

● = **njollë** ...(F)

Algoritmi Simbolik nga ana tjetër na jep:

● = ⏀ ...(F)

Ekuacion që jepet nga Gjuha në shumë mënyra. P.sh. në shqip me *ndyrë* dhe *ndarë*, me *pis* dhe *pjesë* e kështu me radhë.

Pra hebraishtja **ketem** mund të motivohet atëhere me shqipen **ka dam** (ose ***ka thym***).

Shtojmë këtu se edhe fjala shqip më**kat** këtu lidhet:

kat = *ka* **dà** (***ka thy***) = ⏀ = ● ...(F)

Pra *mëkati* si një *ndarje*.

Nga kush? Nga Zoti.

Simbolikisht:

Zoti (○) dhe *ndarja nga Zoti* (⊕)

dafna (דפנה) - it. *alloro* (*dafinë*)

Është shqipja:

dafinë

gadum, geduma (גדום) - it. *mutilato* (*gjytym, i gjymtyruar*)

Është shqipja:

ka dam

e pra simbolikisht:

⊕ = ***F*** = −○ = *jo i plotë, jo i përsosur*

Këtu lidhet siç dimë, edhe fjala **dam** (it. *danno*) e shqipes, pra dhe shqipja *ka-**dam**-tue* që ngjan më tepër me hebraishten **gadum** ...

asar (אסר) - it. *legare* (*lidh*)

Në shqip:

zë, zuri

me kuptimin e *kapjes* e pra dhe të *lidhjes*.

asur, asir (אסיר, אסור) - it. *prigioniero* (*rob, i burgosur*)

Lidhet me shqipen:

zë, zuri

Mos harrojmë se *robi* (hebr. *asur*) është ai që *kapet*, që **ziret**... Kështu p.sh.

në lat. *capere* (*me kap*), *captivus* (*i zënë, i kapur rob...*). Në gjerm. *fangen* (*kap*); *Gefangene* (*robi, i burgosuri*).

dira (דירה) - it. *appartamento* (*apartament*)

Lidhet me shqipen:

i,e **darë,** i,e **ndarë** (folja *daj*)

e pra simbolikisht:

 ...(**F**)

biser (בשר) - it. *annunziare* (*lajmëroj, shpall ...*)

Është shqipja:

bë zëri (në shqip **bëzaj** = *bë zâ*)

hilul (הלול) - it. *lode* (*lëvdatë*)

Theksi semantik bie tek **lul**, e ka shumë mundësi të jetë shqipja *lule* (it. *fiore*, angl. *flower*). Dhe kjo për arsye se koncepti i *lules* lidhet me një cilësi të parë, me "*majën e gjërit*". Në shqip:

"*Lule djalë*", "*në lule të ballit*"

e kështu me radhë. Kështu koncepti i *lules* lidhet me atë të *lavdisë, të lëvatës.* Si përfundim edhe shprehja fetare "**Haleluja**" lidhet nëpërmjet hebraishtes ***hilul*** me shqipen ***lule***. Krahaso me gjuhë të tjera si për shëmbull në italisht në shprehjen:

"*il fior fiore della società...*" = *ajka e shoqërisë.*

bor (בור) - it. *fossa; buca* (*grop, varr; brimë*)

Lidhet me shqipen:

birë (*brimë*)

mana' (מנצ) - it. *evitare* (*evitoj, shmang*)

Lidhet me shqipen:

sh**man**g

sier (סיר) - it. *esplorare* (*eksploroj*)

Lidhet me shqipen:

syri

Vëmë rè se lat. *observare* lidhet edhe gjithashtu me shqipen *syri*. Kjo rrënjë shqipe është e pranishme edhe në shumë fjalë të sanskritishtes, në të cilën ajo lidhet gjithashtu, mitikisht, edhe me *diellin* (**sūrya**)*.

jara (ירה) - it. *sparare* (*shtie, qëlloj*)

Lidhet me rrënjën shqipe **rà**.
(Në shqip: me i rà = me e qëllue)

matara (מטרה) - it. *bersaglio* (*shënjestër*)

Lidhet me shqipen:

rà (me i rà; shënjestra pra vëndi, pika e **ram**jes, qëllimit)

levad (לבד) - it. *solo* (*vetëm*)

---

* Shih ndër të tjera për këtë fjalë edhe në indeks.

Është shqipja:

vetëm, vet (*vedi, veda* në të folmen e Veriut)

lo shakuf (לא שקוף) - it. *opaco*

(*opak, jo i tejdukshëm, që nuk të lë të* ***shik****osh përtej*)

lo rri për *jo, nuk* e pra simb. – *1.*

shakuf lidhet me shqipen **shikoj**.

mishkafajim (משקפים) - it. *occhiali* (*syza, gjyslyke*)

Lidhet me shqipen:

shikoj

naga' (נגע) - it. *toccare* (*ngaj, prek*)

Është shqipja:

ngaj, ngas

masor (מסור) - it. *sega* (*sharrë*)

Është shqipja:

sharrë

niser (נסר) - it. *segare* (*sharroj*)

Është shqipja:

sharroj

bakhir (בכיר) - it. *superiore* (*që ndodhet në krye; kryesor*)

Është shqipja:

bâ kre, bâ kry

tam (תם) - it. *finire* (*dam*)

Është shqipja:

dam

Një sqarim këtu është i nevojshëm:

Simboli tek i cili shpie shqipja *dam* është ⏀. Ky simbol tregon edhe *kufirin*, *cakun* gjer ku mund të arrihet në botën tonë reale, pandaj pra edhe në italisht p.sh. kemi **fine** (*fundi, mbarimi*) por njëkohësisht edhe *con***fine** (*kufiri*); në anglisht **end** (*fundi*), që, siç kemi parë, zbërthehet në **e nd**, dhe me shqipen **â nda**, simb. ⏀.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për gjermanishten **Ende** (*fundi*)

Vëmë rè më tej se:

⏀ = ● (*Bota materiale, **tërë** bota materiale gjer në **fund***).

Nga ana tjetër:

$$-damje = -⏀ = -Bota\ materiale = -● =$$
$$○ = Hiçi; Bota\ tjetër, Bota\ spirituale.$$

Pra, është pikërisht **damja** ajo që përcakton tërësinë e kësaj botës sonë materiale, e pra **fundin** e saj. Kështu shqipja **dam** motivon bindshëm kuptimin e fjalës hebraisht **tam** që do të thotë *mbaroj, përfundoj* (it. *finire*).

tamim (תמים) - it. *intero, completo* (*i tërë, i plotë*)

Është përsëri shqipja:

dam

Edhe këtu (shih më sipër), është fjala për *tërësinë, përplotësinë* e Botës materiale që është në të vërtetë vetëm *gjysma* e tërësisë së Botës të vërtetë që jepet simb. me ○, simbol ky i bashkëpërfshirjes të të dy botrave, *materiale* dhe *spirituale*, i **tërësisë**, i **gjithësisë**, i **mbarësisë të vërtetë**.

tsafa (צפה) - it. *guardare* (*shikoj*)

Është përsëri shqipja:

shof

tsefia (צפיה) - it. *osservazione* (*shikim, vrojtim*)

Lidhet me shqipen:

shof, shef etj.

tsole'a, -la'at (צולע– לעת) - it. *zoppo* (*i çalë, topall*)

Lidhet me shqipen:

i,e **çalë, çaloj**

tsakhak (צחק) - it. *ridere; scherzare* (*qesh, bëj shaka*)

Lidhet me shqipen:

shakà

Vërejmë këtu se edhe emri *Isak* (i biri i Abrahamit) lidhet me këtë rrënjë dhe kjo sepse *Sara*, gruaja plakë e Abrahamit, kur ëngjëjt i thanë se pas një viti do të lindte një djalë (Isakun) nuk besoi dhe pandehu se ëngjëjtë bënin shakà, pra dhe i vunë djalit, kur lindi pas një viti siç kishin profetizur ëngjëjt, emrin **Isak**.

tsofe (צופא) - it. *spettatore* (*spektator*)

Lidhet me shqipen:

shof

Shtojmë këtu se me këtë rrënjë të shqipes lidhet edhe greqishtja **sofia** (*σοφία*) = *dituri*. Edhe lat. **scientia** (*shkenca*) lidhet po me shqipen **shoh** (në lat. *scio* = *di*). Kemi folur për këtë lidhje edhe gjetiu.

netakh (נתח) - it. *pezzo* (*copë*)

Lidhet me shqipen:

nda ka (ka **ndà**)

e pra simb. 𐤃 e pra edhe:

𐤃 = *copë*


natan (נתן) - it. *dare* (*me dhanë*)

Lidhet me shqipen:

ndan

Edhe vetë shqipja *me dhanë* lidhet edhe ajo drejt për së drejti me shq. **dān**, operatori i *ndarjes*.

Simbolikisht:



Ai që *ban **dhanjen** ndan* diçka nga vehtja.

Këtu lidhet edhe fjala shqipe **dhuntì**, ajo që është **dhān**, **dhurata**.

Vëmë rè gjithshtu se **dhun**tì dhe **dhuratë** janë në shqip të bashkrrënjëshme; **n**-ja (dhu**n**ti) që shndërrohet në **r** është fenomeni i njohur i rotacizmit kur kalohet nga një fjalë në gegnishte në korrisponduesen e saj në toskërisht

(*nje**ni** - nje**ri**, gju**ni** - gju**ri***, etj.)

Dhe së fundi emri i personazhit të rëndësishëm biblik **Nathanael** që zbërthehet në hebraisht si **nathana el** e pra, gjithnjë në hebraisht "*i dhanuni nga Zoti*" mund të sillet tek shqipja si "*I dhanuni nga Ylli, dhuntia e Yllit*", ku:

$$Yll_{\text{shq.}} = El_{\text{hebr.}} = Zoti$$

Edhe emri Emmanuel (hebr. Immanuel) që ju vu Krishtit kur lindi (Ungjilli sipas Matheut 1:22) e që do të thotë hebraisht "*Zoti është me ne*" sillet në shqip si:

À me ne Ylli

d.m.th. *Zoti* (***Eli*** në hebraisht dhe ***Ylli*** në shqip) *është me ne*.

Dhe, duke përfituar nga ky rast, shtojmë se edhe shumë emra të rëndësishëm biblik mund të sillen edhe ato tek shqipja. Kështu, ndër të tjera, emri i Kryeëngjëllit *Gabriel* që në hebraisht do të thotë "*Fuqia e Zotit*" sillet përmes shqipes në:

Burrnia e Yllit

Dhe kjo sepse, siç kemi parë në këtë listë të shkurtër konkordancash hebraisht-shqip, në hebraisht **Gabor** (edhe *Gibor*) do të thotë *burrë i fortë*, *hero* (גִּבּוֹר) dhe kjo fjalë zbërthehet me shqip në ***ka burrë***. *Burri, burrnija* ... si simbol i fuqisë, i heroizmit, etj., etj.

natun (נתון) - it. *dato* (*i,e dhënë*)

Lidhet me shqipen:

dhan dhe **ndan**

Shtojmë këtu se edhe italishtja **dato** ... **dare** (*dhanë* ... me *dhanë*) lidhen edhe ato me shqipen **dāt** (pjesore arkaike e foljes *DAJ*) dhe **dar** (*me ndà*).

Po ashtu edhe fr. *donner* sillet në shqip si *damun ar* etj., etj.
Edhe po ashtu it. *perDONARE*, fr. *parDONNER* ... e kështu me radhë.

kal, kala (קל, קלה) - it. *facile* (*kollaj*)

Është shqipja:

kollaj

Vëmë rè me këtë rast se edhe it. *facile* duke u zbërthyer në *fa cile* dhe më tej në *ba cile* dhe së fundi në *bë koll*-aj sillet edhe ajo tek shqipja.

tsien (צין) - it. *notare, osservare* (*vë rè, vrojtoj*)

Zbërthehet në **t sien** dhe me shqipen *të syn*-oj (në kuptimin *të shoh*).
Vëmë rè me këtë rast edhe sa vijon:
1) gërma **t** u paravihet në hebraisht foljeve (si në **t sakhak**, ...) pikërisht si në shqipen **të** (*të* shikoj, *të* punoj ...) dhe si në anglishten **to** (*to* work, *to* laugh ...)

Vërejtje :
Kur pas **t**-së fjala (folja) fillon me gërmën **s** kemi:

$$\mathbf{t + s} = \mathbf{c} = \mathbf{ץ}_{\text{hebr.}}$$

2) Edhe tek it. *osservare*, nga latinishtja **ob ser vare**, theksi semantik bie tek **ser** që nuk është gjë tjetër veçse shqipja **syri**.

tefila (תפלה) - it. *preghiera* (*të falur, lutje*)

Është shqipja:

falje, *të falur* ... nga folja shqipe **falem**

Hete kadmon (חטא קדמון) - it. *peccato originale* (*mëkat zanafillor*)

Sillet në shqip si:

më KAT kadamun

ku:

ka damun = ⏀ = *F* = *–1* = *zanafilla, fillimi, origjina*

Vetë fjala **Hete** sillet në shqip si:

ka dà = ⏀ = *F* = ● = *mëkat*

Vëmë rè me këtë rast se edhe lat. *peccatum* me theksin semantik tek ...**cat**... sillet tek hebraishtja **Hete** dhe tek shqipja *mëKAT* dhe më tej në:

ka dà = ⏀ = *F* = ●

leda (לדה) - it. *parto* (*lindje*)

Lidhet me shqipen:

lind

Ka shumë mundësi që theksi semantik në hebraishten **leda** të bjerë mbi **dà**, ndërsa pjesa tjetër **le** (*la, li, l* ...) të jetë thjesht prostatike (kujtojme fjalën **levad**, që zbërthehej në **le vad** dhe sillej tek shqipja **ved**).

Në qoftë se është kështu (sikundër ka shumë mundësi) shqipja *lind* do ndarë në **li** ***nd*** ku theksi semantik bie mbi **nd** që lidhet brënda shqipes me foljen **ndaj**.

Kështu hebr. **leda** sillet tek **da**, ndërsa shq. *lind* sillet tek **nd**(a). Po:

da = **nda** = ⏀

Kështu që hebraishtja dhe shqipja thonë të njëjtën gjë, duke e shpjeguar lindjen si një *ndarje*, sikundër ajo është në esencë. Ne dimë se *lindja e Botës ka filluar*

me një ndarje (Die Separatio ist aller Geburt Anfang), pra ashtu edhe ajo e Njeriut.

Italishtja e jep pastër këtë me fjalën **parto** = *lindje* dhe **parte** = *pjesë* dhe s**part**ire = *ndaj*.

kata' (קטע) - it. *troncare* (*cungoj*)



trung, cung

Është shqipja:

ka dà

kav-gemar (קו–גמר) - it. *traguardo* (*finish*)

kav është shqipja *ka* **vijë**
gamar është shqipja *ka* **marù**

Pra kuptimi:

Vija e **m**(b)**arim**it

pagum (פגום) - it. *difettoso* (*me defekt, i metë*)

Do ndarë në **pa gum** dhe me shqipen:

bâ i gjymtuar

ose edhe

bâ gjymës

e pra simb.

e pra:

–○ = *jo i përsosur, i metë*

bar (בר) - it. *figlio* (*bir*)

Është shqipja:

bir

badak (בדק) - it. *analizzare* (*analizoj*)

Me shqipen:

bâ **dà** ka

e pra simb. ⏀.

bikur (בקור) - it. *visita* (*vizitë*)

Thesi semantik bie në **kur** që është shqipja **kyr** (*kqyr*): Vu re se edhe it. *visitare* lidhet brënda saj me foljen "*vedere*" (me pa), me pjesoren e kësaj folje në latinisht *visum*.

'avad (עבד) - it. *adorare* (*adhuroj*)

Është shqipja

à bâ **dà**

(ai që ndahet veç nga të tjerët, ai që ha bukë veç, ai që është i veçuar nga të tjerët, ai që është i veçantë dhe si i tillë **nder**ohet, a**dhur**ohet).

Edhe it. *adorare* lidhet me operatorin e lirë të shqipes **dar** (folja *DAJ*).

hodi'a (הודיע) - it. *avvertire* (*lajmëroj, baj me ditë*)

Theksi semantik bie tek **di** (folja shq. *dij*). Krahaso me shqipen pa*ditë*, ba me *ditë*, etj.

belo yod'in (בלא יודעין) - it. *incònscio* (*i pavetëdijshëm*)

belo, që zbërthehet në **be lo** ka vlerën në hebraisht të një mohimi (**lo** = –). Pjesa tjetër (**yod'in**) lidhet me shqipen **di** (folja *Dij*). Pra tërë fjala do të thotë:

jo dij, që **nuk din**, *jo i vetëdijshëm ...*

beltiadu'a (בלתידוע) - it. *ignoto* (*i panjohur, i paditur*)

belti $_{\text{hebr.}}$ = *– 1*

Dhe kjo fjalë lidhet me shqipen **di** (shih më sipër).

khakar (חקר) - it. *indagare* (*hetoj*)

Është shqipja

ka kyr (kqyr)

Le të vëmë rè se mund të shkruajmë:

kqyr $_{\text{shq.}}$ < **kkyr** $_{\text{shq.}}$ < **ka kyr** $_{\text{shq.}}$

Përfitojmë nga rasti për të treguar se edhe fjala it. *indagare* mund të sillet tek shqipja. Dhe ja se si:

inda $_{\text{it.}}$ = **â ndà** $_{\text{shq.}}$ = ⦶ = ⧈

gare $_{\text{it.}}$ = **kyr** $_{\text{shq.}}$ = 

Atëhere tërë fjala simbolikisht mund të paraqitej si:



kyr $_{\text{shq.}}$ **ande** $_{\text{shq.}}$ (*brënda*)

gare $_{\text{it}}$ **inde** $_{\text{it.}}$

miadi (מיידי) - it. *immediato* (*i pandërmjetshëm, i menjëhershëm*)

mi këtu mund të lozi rolin e një grimce privative (mohuese): –, pra kjo fjalë do sillej në:

a di

dhe me shqipen:

– â dà

e pra simbolikisht:

$$-\odot = -(|) = E = (t = 0)$$

e pra kemi kuptimin:

i pandërmjetshëm (*imediat*) = –(|) *ndërmjetësi*

si edhe kuptimin:

$$(t = 0) = \textit{i menjëhershëm}$$

Vëmë rè se fjala it. *immediato* zbërthehet në:

in medio

e pra:

– **medio** = –(|)

Shtojmë, mënë fund, se edhe vetë fjala lat. *medius* motivohet me shqipen *me dà* që e shpie atë tek simboli ⊙, e pra edhe (|) që ajo përshkruan.

raa (ראה) - it. *vedere* (*me pa*)

Kjo fjalë e ka burrimin tek fjala **Ra** e gjuhës egjiptiane të lashtë që është emri i perëndisë së *Diellit*.

Këtu lidhet në shqip edhe folja **vërej** që zbërthehet si:

vë rè

Shtojmë me këtë rast se angl. *beware* (gjerm. *bewaren* = *ru*-aj) *ru*-aju sillet në shqip si:

bë vë rè

Këtë rrënjë e gjejmë, ndër të tjera, edhe në shqipen **barì** që do ndarë në **ba rì** dhe më thellë (arkaike) **ba ruò** dhe **ba rù**, pra ai që *bën ruajtjen* (e bagëtisë).

Po këtu lidhet në shqip edhe fjala ***roje***.

reut (**ראות**) - it. *vista* (*të parë, pamje*)

Do zbërthyer në :

re ut

ku **-ut** është një prapashtesë në hebraisht për formimin e emrave abstraktë. P.sh. nga *bahir* = *i qartë*, *behir**ut*** = *qartë**si***; *shakhen* = *afër*, *shekhen**ut*** = *afër**si***).

Duke qënë kështu rigjejmë rrënjën **rè** (*vu rè*) të shqipes.

kadan (**כדן**) - it. *attaccare, legare* (*zë, kap, lidh*)

Do zbërthyer në:

ka dan

dhe është shqipja **ka da**(n) (*ka ndarë*), e pra simbolikisht ⌀ .

E pra atëhere edhe:

⌀ = ***F*** = ⋈

ku simboli i fundit është ndër të tjera edhe ai i *lidhjes*.

Rikujtojmë në angl. **bound** (*kufi*), e pra ⌀ dhe në të njëjtën kohë **bond** (*lidhje*), e pra ⋈.

Edhe këtu është shqipja që motivon me:

bë dà

Shëmbulla të tilla ka plot në këtë studim.

shilakh (שלח) - it. *licenziare* (*pushoj nga puna, lëshoj*)

Lidhet me shqipen:

shlù ka

e pra simb. –☓.

lakham (לחם) - it. *nutrirsi* (*ushqehem*)

la- është prostatike.

Theksi semantik bie mbi **-kham** ku duhet parë operatori i lirë i shqipes **ha** (folja *haj, me ngrënë*).

lakham (לחם) - it. *combattere* (*luftoj*)

Krahaso me shqipen *ha-hem* = *grindem*. Vëmë rè se si në hebraisht bash ashtu edhe në shqip operatori **ha** (me hanger) është përdorur në dy kuptime, në atë të të *ushqyerit* dhe në atë të *grindjes*, ta *hamjes* me njëri tjetrin, të *luftës*.

miten (מתן) - it. *moderare* (*e bëj diçka të matun*)

Lidhen me shqipen **mat** e pra simb. ⏀ , dhe pra edhe:

$$⏀ = F^{\cdot} = -○ = \textit{jo e tëra}$$

matun (מתון) - it. *moderato* (*i matun, i moderuar*)

Është shqipja:

i matun

madua (מדוע) - it. *perché* (*pse*)

Pra kjo fjalë tregon *arsyen*, *shkakun*. Pra mund të shkruajmë:

madua = ↔ ...(**F**)

Është shqipja **me dà**, e pra simb. ⌀ . Në hebraisht, siç kemi parë, **mida** (*matje*), e pra simb. ⌀ . Edhe kjo fjalë, nga ana tjetër, sillet tek shqipja **me dà**. Duke qënë kështu ne mund të themi se me **madua** dhe **mida** hebraishtja shtron ekuacionin e rëndësishëm simbolik:

⌀ = ↔ ...(**F**)
mida *madua*

Duke zgjeruar bisedën, vërejmë se po këtë ekuacion simbolik, shqipja p.sh. e shtron (ndër të tjera) me:

⌀ = ↔ ...(**F**)
ndaj **ndaj**
pjesë *pse*

e kështu me radhë. Gjermanishtja e shtron këtë ekuacion, siç kemi parë, me:

⌀ = ↔ ...(**F**)
halb *deshalb*
(*gjysëm*) (*prandaj*)

dhe po ashtu drejt a tërthor të gjitha gjuhët.

Me qënë se Gjuha referon, siç dimë, tek Qëndra e tek ngjarja më e

rëndësishme atje, siç është krijimi i Botës, simboli ↔ rri këtu për "shkak të krijimit të Botës". E pra ai (↔) na thotë se *shkaku i krijimit të Botës është Ndarja*. Dhe rigjejmë kështu, ndër të tjera, dhe të thënën e famshme, kaq herë të cituar në këtë studim, të Paracelsus: "Die Separatio ist aller Geburt Anfang".

mad (מד) - it. *misura* (*matje*)

Është shqipja:

matje

leut (לאות) - it. *stanchezza* (*lodhje*)

Është shqipja:

lodh, **loth**, *lodhje, lothje*

asar (אסר) - it. *vietare* (*ndaloj, nuk lejoj*)

Lidhet me shqipen:

zë, **zuri** ...

(Diçka që është e *zënë, e kapur*... diça që nuk është e lirë...)

dabar (דבר) - it. *capo* (*kryetar*)

Duhet ndarë si:

da bar

e pra me shqipen **bër DÀ** (folja *daj*).

E pra simb. ⏀, e pra edhe:

⏀ = ***F*** = ***−1*** = *i pari* (i kësaj bote...)

Rikujtojmë me këtë rast fjalë të tilla hebraisht (të cilat ne i kemi parë) si **kodem** (*më parë*), **kadmon** (*primitiv, i pari në kohë...*) të cilat silleshin në shqip si **ka dam** dhe **ka damun**, e pra që motivoheshin kështu përmes foljes shqipe **DAJ**.

Me qënë se Bota filloi me një *ndarje*, *ndarja* pra është gjëja e **parë**, është **kreu**, e pra kryetari (it. *capo*), etj.

bakhir (בכיר) - it. *superiore* (*eprori, kryetari ...*)

Sillet tek shqipja:

ba kry

dan (דן) - it. *ragionare* (*arsyetoj*)

Lidhet e foljen shqipe:

daj

Ne dimë se:

$$arsyeja = llogjika\ formale = (x = x) = F = \text{⏀} = (\mathbf{daj, ndan})_{shq.}$$

Kemi parë gjithashtu se si në sanskritisht:

$$Artha\ (arsye) = ardha\ (gjysma) = \text{⏀}$$

Po ashtu në shqip:

$$\mathbf{ndaj} = për\ këtë\ shkak, për\ këtë\ \mathbf{arsye} \ldots = \text{⏀}$$

Kështu pra arsyetimi lidhet me një *ndarje*, me një *analizë*, me *dallime*, etj., etj., gjë që justifikon etimollogjizimin e mësipërm të fjalës hebraishte **dan**.

nishba' (נשבע) - it. *giurare* (*betohem*)

Lidhet me shqipen:

bëj **bè**, **be**-tohem, **be**-t-im

mishpat (משפט) - it. *giudizio* (*gjykim*)

Theksi semantik bie tek **-pat** që duhet zbërthyer si *bâ dà* ose edhe *bâ thy* ... e pra, si në një rast, si në tjetrin, simb. ⏀. Edhe tek it. *giuDIzio* theksi semantik bie tek *DI* që lidhet me shq. **daj**.

Vëmë rè se rrënjën **pat** (sikundër edhe shumë e shumë rrënjë të tjera të hebraishtes e gjejmë edhe në sanskritisht, si p.sh. në **ava-Pat** që do të thotë *ndarje, coptim* dhe që ne e kemi sjellur tek shqipja si **â bâ Dà** e pra simb. ⏀.

shura (שורה) - it. *fila* (*rrjesht*)

Lidhet me shqipen:

sërë

Këtu lidhet edhe it. **serie** (serì).

❖ ❖ ❖

Këto janë vetëm disa pak konkordanca midis hebraishtes dhe shqipes sepse numri i tyre arrin shifra shumë më të mëdha. Kështu që afërsia e thellë dhe e gjithanshme (që prek jo vetëm gllosarin por edhe struktura të caktuara gramatikore) mes këtyre dy gjuhërave është jashtë çdo dyshimi.

Pasthënie

Pjesa e dytë e këtij studimi përpiqet të përmbushi ato zotime që autori mori në pjesën e parë, ndër të cilat janë:

1) Dhënia e një numri shumë më të madh gllosash të Sanskritishtes se sa në pjesën e parë që gjejnë motivimin e tyre në Shqip.

2) Vënia në dukje më mirë dhe më konkretisht të fuqisë shpjeguese, "gjithpranishmërinë" dhe efikasitetin e operatorëve të lirë të Shqipes në motivimin e fjalëve të huaja, këtu kryesisht të Sanskritishtes, por me raste edhe të ndonjë gjuhe tjetër.

3) Zgjerimi i shtratit fillosofik që lejon përqasje fjalësh me kuptime, në dukje, tepër të largëta dhe të pamvarura. Kjo problematikë shpresoj të jetë lëvruar mirë. Ka dalë fare qartë, mendoj, se si fjalët, të çfarëdo gjuhe qofshin, janë zhytur si në një lëng "amniotik" në mjegullnajën e një vizioni mbi Botën dhe mbi çdo gjë në të që e ka burimin në lashtësinë më të thellë të Njerëzimit. Me shëmbulla të shumta është treguar lidhja e Gjuhës me Mitin. Gjuha është shfrytëzuar jo më të rrallë, si një "place d'armes" për t'u hedhur në sulm kundër kështjellash Njohjeje të padorzueshme, me mjete të tjera, gjer më sot. Këtu përfshihen, ndër të tjera, inkursionet në fusha të ndryshme të Dijes (shkencë, fillosofi, theollogji ...) duke u katapultuar nga trampolini tashmë i sigurtë, i njohjes gjer në thellësinë e saj ekstreme të Fjalës.

4) Gjithshka hipotetike dhe çdo pohim disí "dogmatik" në pjesën e parë të këtij studimi, nuk janë më të tillë në pjesën e dytë. Janë sjellë dëshmira nga burime të ndryshme që rikonfermojnë faktin themelor se Gjuha (të gjitha gjuhët pa përjashtim) ngrihen mbi një vizion mitik të Universit, se thesari që fshihet në gjirin e gjuhës, pasi hapet me çelësin magjik të Algoritmit Simbolik, jep një informacion tërësor e tërëpërshkues dhe po aq aktual sot sa ka qënë edhe shekuj më parë, si një emanacion mbi krahët e gjuhës të "Qëndrës Spirituale" që, siç thotë René Guénon "...was established in the terrestrial world to conserve intact a treasure of non-human knowledge"*.

5) Në pjesën e parë flitej shkarazi edhe për hipotezën e Monogjenezës së gjuhëve, d.m.th. për prejardhjen e tyre nga një Gjuhë-mëmë e përbashkët, e cila por, sipas autorit, ishte një gjuhë simbolike dhe jo konceptuale.

Këtu shtojmë, mbi të gjitha ato sa u thanë edhe këto:

Me qënë se fjalët (të çfarëdo gjuhe qofshin) referojnë tek e mbramja ...*tek një simbol dhe jo tek një koncept* (siç mendonte gjuhësia klasike) dhe me qënë se simboli, nga ana e tij, lidhet me llogjikën e të Tretit të Përfshirë, e pra atëhere edhe me Qëndrën, del se të gjitha gjuhët referojnë me fjalët e tyre tek Qëndra që është *një* dhe *e vetme*. Kjo flet atëhere për lindjen e të gjitha gjuhërave nga Qëndra** e pra, në favor shkurt të Monogjenezës. Në këtë pjesë të dytë janë dhënë shumë shëmbuj rikonfermonjës tërthorazi të kësaj teze, ndonëse pa u thelluar aq sa duhej në të. Por sidoqoftë edhe vetëm *fakti i pranisë të Algoritmit Simbolik në të gjitha gjuhët*, si të vdekura ashtu edhe të gjalla, siç *tregohet qartë në mënyrë bindëse në këtë studim*, si edhe fakti, lidhur me këtë, se të gjitha gjuhët shtrojnë, me polisemantizmin dhe homonimitë e gjysëm homonimitë e gllosave të tyre, *të njëjtat ekuacione simbolike* e pra dhe *të njëjtat mite kozmogonike*, do të mjaftonte mbase për një rikonfermim të vërtetësisë të tezës të Monogjenezës.

Rilindasit tanë folën e shkruajtën pa fund dhe me baza shkencore për një lashtësi primordiale të gjuhës sonë. Por pjesa më e madhe e gjuhëtarëve shqiptarë jo vetëm që s'ia vunë veshin por dhe u tallën e vazhdojnë ende dhe sot

---

* Cirlot, fq. 42, (... u vendos në Botën Tokësore për të ruajtur të paprekur një thesar diturie jo njerëzore).

** Rikujtojmë se:

$$Qëndra = (x = -x) = 0 = 1 \text{ (e vetme, e përbashkët)}$$

të tallen me ta duke u ngjitur lloj lloj nofkash përbuzëse dhe asgjësuese, si "romantikë", si "shovinistë", si persona pa një pregatitje gjuhësore e shkencore të mjaftueshme, e kështu me radhë... Këto të gjitha janë tashmë një përsëritje gjërash të ditura... Por ajo që s'dihet mirë mbase nga askush është se sipas vizionit rilindas "një njohje e thellë e Shqipes do të sillte me vehte një *revolucion* në shkencën e Gjuhësisë". Ky ishte një pohim profetik dhe realizimin e kësaj profecie ne e shohim sot: duke u thelluar në studimin **vertikal** të Shqipes, autori i këtij studimi mbrrijti në përfundime origjinale dhe "tërëpërmbysëse" të konceptit të vjetër, klasik mbi Gjuhësinë. Ky vështrim i ri nuk e ndan më Fjalën nga Mendimi, ai nuk dekllaron se fjalët (emërtimet) janë si ca etiketa arbitrare dhe konvencionale që u ngjiten sendeve vetëm për t'i "dalluar", por i lidh ato me një përmbajtje të veten, të thellë botëkuptimore, fillosofike. Se si, e qysh, e tek... lexuesi e ka të qartë nga leximi i studimit. Sajohet, falë depërtimit në thesaret njohëse të Shqipes, krejt një vizion i ri, jo vetëm mbi Gjuhën por edhe mbi tërë Realitetin, gjë që sjell më vete revolucionin e profetizuar në gjuhësi nga rilindasit tanë.

Sot Shkenca dhe mendimi shkencor kanë ecur përpara. Bashkë me të edhe Gjuhësia. Pra dhe është e natyrshme që edhe në Gjuhësi të mirren parasysh arritjet e reja në këtë fushë. Në qoftë se nuk do të bëhej kjo ne nuk do të qemë kurrë në gjëndje të provonim në këtë studim një lashtësi më të madhe të Shqipes ndaj Sanskritishtes. Ne ia dolëm mbanë ta bëjmë këtë me një rigorozitet pothuajse mathematik edhe sepse, ndër të tjera, e pamë fjalën të pa shkëputur nga mendimi, sepse u nisëm, si nga një postulat (të cilin në një kohë të dytë e vërtetuam) se "fabrikimi" i fjalëve nuk është as arbitrar dhe as konvencional, por tej masës i thellë dhe fillosofik, tej masës i integruar në një vizion tërësor të Universit dhe të gjithshkaje ndodh në të ...

E, më në fund le të shtojmë edhe diçka mbi "Organizimin jo optimal të materialit...". Që në vitin 1997, idera të tjera, më të thella e të pjekura, më shtynë të bëja ndryshime në parashtrimin e lëndës për t'i bërë vënd gjërave të reja që kisha zbuluar ndërkaq. Ndërkallja e tyre solli, ndër të tjera, edhe *përsëritje* këtu atje, të cilat edhe i lash sepse: a) ato mund të ngulitnin më mirë në mëndjen e lexuesit ca pohime themelore, por krejt të reja dhe të padëgjuara për të; b) përsëritjet bëheshin në kontekste të ndryshme; c) së fundi, "repetitio mater studiorum". Ndaj pra edhe ato janë lënë qëllimisht, ndonëse "antiestetikisht" në tekst.

Do të mund të viheshin edhe shumë konkordanca të tjera, por qëllimi kryesor a, të paktën, një nga qëllimet kryesore të autorit të këtij studimi ishte ta bënte sa

më të qartë dhe të kapshme për një lexonjës të "pa iniciuar" mekanizmin gjer diku, në mos po edhe krejt të fshehtë e të panjohur gjer tani, të krijimit të fjalëve, misterin e madh të polisemisë që shpjegohet për herë të parë në këtë studim në të gjithë shtrirjen dhe paradoksalitetin e saj. Siç pamë, polisemia fshihte dhe zbulonte (a të paktën sinjalizonte) për ata që kishin sy për të parë, lidhje të fshehta, themelore, esenciale mes kuptimeve në dukje kaq të ndryshme dhe pa kurrfarë lidhje mes tyre të së njëjtës fjale. Këto lidhje qënë të një natyre mitike e pra si të tilla të përfshirshme mbrënda vizionit mbi Botën që mbretëronte sovran në kohën e krijimit të Gjuhës. Kjo është edhe arsyeja, siç është vënë në dukje, përse këto lidhje nuk janë mundur të kapeshin e të shpjegoheshin nga linguistë e fillosofë të gjuhës që njihnin vetëm vizionin shkencor, të ri, perëndimor të Realitetit.

Indeks

2 = -*1*: **78**, **80**, 100, 102, 120, 138, 140, 148, 208, 216, 222, 224, 234, 256, 258, 286, 290, 302, 310, 312, 314, 376, 378, 416.

Abel: 144, 145, 146.

Adam Kadmoni: **505**, **506**.

Adami dhe Eva: 158, 167, 347, 363, 475.

Akauzaliteti: 121, 184, 420.

Alienacion: 257, 331, 382, 436.

Algoritmi Simbolik si hologramë: 18, **98**.

Algoritmi simbolik: 18, 19, 21, 22, 23, 52, 64, 69, 71, 72, 73, 74, 76, 77, 78, 81, 83, 85, 89, 93, 94, 95, 96, 97, 99, 100, 101, 102, 106, 107, 108, 109, 113, 114, 115, 116, 117, 119, 123, 124, 134, 140, 141, 161, 167, 168, 172, 175, 176, 177, 178, 183, 189, 199, 204, 209, 211, 218, 220, 230, 231, 234, 241, 242, 243, 244, 246, 247, 248, 250, 251, 256, 257, 258, 264, 267, 270, 276, 277, 282, 290, 297, 302, 310, 314, 316, 320, 321, 325, 326, 329, 331, 335, 337, 341, 346, 349, 350, 355, 357, 359, 362, 363, 364, 366, 371, 372, 376, 378, 379, 380, 384, 390, 391, 392, 393, 395, 401, 402, 404, 406, 407, 409, 413, 415, 416, 420, 421, 425, 430, 432, 436, 437, 438, 441, 448, 450, 452, 456, 458, 460, 464, 472, 476, 481, 493, 509, 511, 512.

Amen: **496**.

Anallogjia: **74**, 75, 114.

ande: **134**, 135, 232, 306, 524.

Antillogjika: 27, **74**, 114, 121, 122.

Antinomitë e arsyes së pastër: 405, 406, 407.

Antiteza: 34, 81, 120, 257, 58, 264, 302, 304, 310, 382, 398, **405**, 406, 407, 408, 433, 436, 445, 452.

Ar: 151, 188, 189, 274, **275**, 279, 280, 313, 336, 337, 400, 401, 402, 403, 520.

ardha: **178**, 189, 190, 212, 274, 275, 400, 403, 404, 406, 421, 530.

Aristoteli: 26, 35, 43, 46, 48, 417.

arsyeja: 26, 55, 56, 57, 68, 108, 113, 114, 118, 120, 122, 147, 160, 183, 192, 213, 302, 338, 362, 383, 397, 403, 404, 405, 406, 413, 417, 422, 426, 427, 530.

artha: 178, 188, 189, 190, 191, 192, 212, 279, 401, 402, 403, 404, 406, 421, 426, 530.

Aufbruch: 152.

Ava-Pat: 13, 133, 432, 530.

Baudelaire: 76.

Berkley: 64, 172.

bërthama semantike: 207, 337.

Beth: 216, 287, 314, 337.

bhramārin: 15.

Big Bang: 64, 182, 347, 407.

Big Crunch: 64, 182, 347, 407.

Bilotta: 483.

Black-hole: 277, 347.

Bohm, David: 108, 109, 350.

Bohr Nils: 109, 410, 411.

boundary: 202, 457.

Broken Symmetry: 89, 90, 315.

Buddha: 428, 451.

Carnap, Rudolf: 88, 185.

Cassirer, Ernst: 23, 8, 93, 121.

Christian, James L.: 158, 420.

çiftet homonimike: 218, 346.

Cirlot, J.E.: 35, 36, 45, 46, 48, 51, 52, 53, 54, 55, 73, 80, 81, 82, 83, 85, 93, 94, 96, 101, 149, 151, 153, 157, 158, 159, 161, 163, 165, 174, 175, 199, 204, 207, 211, 220, 237, 317, 327, 343, 346, 360, 361, 362, 365, 371, 385, 389, 390, 391, 397, 412, 436, 471, 474, 481.

Coincidentia oppositorum: 24, 25, 30, 32, 36, 39, 46, 47, 85, 122, 124, 143, 150, 182, 213, 226, 229, 256, 321, 344, 347, 363, 371, 380, 385, 411, 438, 475.

Consensio linguarum: 125, 126, 190.

Çabej, E.: 273.

Demiurgu: 474, 475.

Demon: 131, 152, 431, 474, 475.

Deus Immanens: 231, 233, 264, 298, 402, 421, 452, 476.

Dialektika: 34, 203, 303, 304, 310, 354.

Dielli: 76, 152, 174, 175, 217, 260, 261, 275, 223, 276, 480, 490, 504, 514, 525.

Dimensionet e Realitetit: 116, 122.

Djali: 152, 174, 175, 480, 490, 517.

Djalli: 60, 61, 65, 131, 141, 152, 334, 431, 435, 439, 463, 475, 481.

doṣa: 362, 363.

down: 139, 140, 176.

Drejtëzat imagjinere: 37, 41, 42, 316.

E = Mc^2: 182, 392.

E Tëra: 36, 55, 58, 61, 85, 99, 100, 101, 102, 106, 142, 148, 213, 215, 219, 235, 268, 279, 341, 342, 371, 375, 381, 422, 437, 443.

Einstein: 23, 71, 78, 112, 113, 182, 185, 191, 419, 420, 473.

Ekuacionet simbolike: 51, 54, 61, 63, 68, 71, 72, 96, 100, 115, 124,

125, 136, 138, 139, 140, 149, 154, 162, 163, 164, 166, 172, 181, 184, 204, 205, 206, 214, 216, 217, 228, 229, 308, 311, 330, 344, 345, 346, 347, 348, 351, 355, 356, 359, 361, 370, 372, 387, 392, 402, 432, 433, 441, 443, 448, 450, 455, 457, 462, 472, 490, 498, 511.

Energjia primordiale: 83, 159, 160, 161, 298, 343, 360, 361, 391, 392, 474

Esse est percepi: 64, 172.

Euler: 38.

Explicate Order: 108, 109.

Fan Noli: 483.

Fillosofia Semantike: 123.

Fizika kuantike: 23, 63, 96, 103, 104, 105, 109, 110, 112, 113, 169, 171, 172, 179, 183, 184, 185, 190, 191, 192, 198, 199, 349, 408, 410, 412, 419, 420, 438, 442, 473, 511.

Fjalë-simbol: 18, 212, 219, 221, 305, 391.

Freud: 145, 238.

Fritjof Capra: 350.

Fryma: 23, 46, 58, 61, 77, 80, 114, 119, 142, 156, 157, 158, 179, 258, 275, 292, 293, 300, 301, 321, 322, 333, 334, 348, 385, 394, 406, 407, 408, 410, 421, 435, 442, 443, 450, 451, 452, 453, 471, 473, 474;
Fryma Absolute: 81, 120, 257, 301, 331, 382, 383, 436;
Fryma e Shënjtë: 117, 122;
Fryma Objektive: 257, 331, 382, 406
Fryma Subjektive: 257, 331, 382, 406.
Rënia e Frymës: 82, 264, 301, 473.

Gabriel: 519.

Gazulli: 134, 232.

Gnostikët: 475.

Goethe: 32, 86, 141, 435.

Gold: 189, 274, 365, 400.

Guénon: 274, 275, 389.

Hegel: 34, 81, 120, 257, 297, 302 303, 310, 331, 380, 382, 398, 405, 407, 408, 414, 433, 452.

Heidegger: 88, 89, 185, 414, 415, 417, 418, 440.

Heisenberg: 103, 109, 184, 192, 198, 349, 408, 410, 411, 420, 438, 442.

Hiçi: 18, 58, 80, 81, **85**, 86, 87, 88, 89, 90, 91, 100, 103, 117, 145, 153, 157, 186, 188, 315, 328, 351, 353, 410, 411, 412, 413, 414, 415, 416, 417, 499, 516.

Hieros Gamos: 71, 82, 115, 154, 159, 165, 167, 168, 264, 299, 351, 444, 448, 464.

Hipoteza e Machut: 71.

Holograma: 18, 98, 102, 103, 104, 105, 106, 107, 108, 109, 111, 112, 115, 168, 199.

Hyu: 250, 264, 298, 386, 421, 452, 472, 476.

imagjineri: 35, 36, 39, 41, 56 ,78, 85, 316, 317;
drejtëza imagjinere: 37, 41, **42**, 316;
njësi imagjinere: 30, 50.

Implicate Order: 108, 109, 110.

Infiniti: 36, 37, 38, 39, 40, 45, 46, 47, 49, 55, 58, 78, 83, 85, 115, 152, 161, 211, 255, 268, 279, 326, 327, 355, 363, 371, 391.

Inkapsullimet: 272, 375.

Inkoshienti: 11, 19, 103, 104, 146, 147, 199, 217.

Interdishiplinariteti: 104, 105, 179, 199.

Izomorfizmi: 104, 114, 115, 199.

Jing-jang: **203**, **204**, **237**, 238, 239.

Jisu Krishti: 70, 71, 72, 73, 79, 95, 96, 115, 119, 122, 158, 167, 258, **318**, 345, 347, 363, 370, 372, 380, 415, 443, 444, 450, 451, 474, 475, 479, 491, 519.

Jung: **104**, 105, 116, 179, 199, 274, 275.

Kant: 198, 213, 359, 394, 404, 405, 406, 407, 417, 419.

Kauzaliteti: 23, 24, 25, 26, 74, 103, 110, 112, 113, 191, 266, 405.

Konseguenca: 7, 76.

Korrispondenca: 57, 75, 76.

Koshienti: 64, 105, 146, 147, 381, 383, 412.

Kozmollogjia: 64, 65, 116, 153, 182, 276, 277, 315, 347, 348, 407, 416;
kozmollogjia moderne: 64, 65, 182, 348, 407, 276, 277, 315, 416.

Kozmogonia: 19, 71, 77, 81, 82, 83, 90, 94, 115, 153, 83, 155, 156, 157, 158, **159**, 160, 162, 163, 164, 165, 166, 167, 168, 169, 177, 181, 186, 241, 258, 264, 297, 298, 299, 301, 302, 303, 304, 308, 310, 321, 328, 351, 352, 360, 363, 379, 380, 384, 386, 391, 410, 411, 436, 464, 476, 472, 477.

Kryqi: 47, **316**, **317**.

Immobilis mobilis: 43.

Lacan: 57, **104**.

Leibnitz: **116**, 117, 118, **418**.

Levy-Brühl: 86.

ligji: 51, 65, 73, 76, 96, 103, 112, 113, 184, 190, 191, 238, 310, 325, 420, 444.

Llogjika formale: 26, 27, 56, 74, 113, 114, 120, 147, 148, 183, 192, 338, 383, 404, 417, 426, 530.

Mara: 65, 334, 473, 474.

materia: 44, 60, 62, 63, 64, 80, 82, 89, 108, 119, 126, 129, 141, 157, 162, 163, 165, 169, 171, 182, 191, 198, 547, 249, 257, 258, 259, 260, 277, 282, 300, 301, 308, 319, 326, 328, 331, 335, 347, 348, 349, 366, 382, 386, 392, 394, 408, 410, 411, 425, 426, 436, 441, 511.

matra: 126, 127, 129, 162, 169, 171, 172, 198, 348, 511.

Maya: 65, 334, 363, 473.

Mbretëria e Qiejve: 79, 112, 122, 322, 413.

Mefistofeli: 141, 142, 435.

Mendimi mistik: 19, 22, 23, 52, 54, 73, 75, 81, 87, 95, 108, 115, 116, 119, 125, 151, 154, 164, 198, 211, 250, 277, 309, 315, 321, 324, 334, 337, 343, 345, 349, 350, 352, 359, 361, 362, 363, 370, 378, 411, 412, 417, 418, 433, 436, 447, 448, 452, 473.

mendimi mitik: 18, 21, 22, 23, 24, 34, 52, 72, 86, 90, 93, 94, 95, 97, 101, 121, 123, 124, 140, 142, 145, 147, 149, 169, 172, 176, 189, 199, 204, 242, 255, 264, 297, 322, 331, 393, 411, 447, 460, 493, 505.

mendimi racional: 107, 108, 114, 115, 118, 417.

Metafizika: 89, 111, 116, 117, 185, 405, 406, 414, **417**, 418, **453**.

metafora: 112, 114.

Mircea Eliade: 57, 83, 155, 465.

misteri: 112, 117, 118, 122, 336, **367**, 398, **469**, 472, **502**.

Misticizmi: 11, 18, 19, 22, 23, 35, 46, 47, 52, 54, 73, 75, 79, 80, 81, 87, 95, 96, 108, 112, 115, 116, 119, 125, 149, 150, 151, 153, 154, 155, 158, 164, 198, 211, 241, 247, 250, 257, 277, 265, 309, 315, 321, 324, 334, 337, 343, 345, 349, 350, 352, 359, 361, 362, 363, 369, 370, 378, 385, 398, 406, 411, 412; 413, 417, 418, 422, 433, 436, 447, 448, 449, 452, 453, 462, 471, 473, 475.

mitet kozmogonike: 19, 83, 90, 94, 153, 156, 157, 159, 160, 162, 166, 168, 169, 181, 186, 258, 298, 301, 304, 321, 328, 360, 279, 380, 477.

Modification of primordial energy: 83.

mohimi: 308, 309, 310, 337, 380, 412, 414, 415, 416, 417, 436, 472, 476, 477, 523.

mohimi dialektik: 304.

Mystic Void: 87, 241, 247, 250, 350, 412.

Ndërtimi i Algoritmit nga Hiçi: 85.

neoplatonizmi: 60, 158.

Nothingness: 89, 103, 117, 315, 412, 413, 499.

Noumena: 95, 103, 117, 118, 322, 334, 335, 394, 412, 413, 417, 421, 427, 473.

operatori i lirë: 120, 203, 219, 268, 271, 288, 468, 495.

Ordo ideorum: 114, 427.

Otto Rank: 103, **145**.

Paracelsus: 64, 8, 153, 182, 257, 294, 97, 308, 331, 393, 505, 528.

Parajsa: 46, 96, 158, 167, 347, 475, 476;
parajsa e humbur: 96, 158;
gjëndje parajsore: 46, 159, 344.

Parimi i Papërcaktueshmërisë: 63, 103, 110, 184, 349, 419, 437, 442.

Parimi i Pandashmërisë: 110, 277

Parimi Suprem i Universit: 45, 46, 343, 344, 481.

Pauli: 104, 199, 423.

Peccatum Originalis: 347, 363, 380.

Penusiteti: 427.

The Perfect Symmetry of Nothingness: 89, 315, 499.

Periferia: 31, **34**, 46, 47, 48, 326, 327, 508.

përsëritja, përtëritja: 83.

Phenomena: 95, 237.

Philosophia Perennis: 116, 172, 418, 452, **453.**

Pi: 413.

Pika: **34**, **35**, 46, 46, 49, 59, 97, 94, 153, 240, 397, 413, 508.

Pilot science: 123, 1885.

Pinealiteti: 111, 119, **424**, **425**, **427**.

Poli: **35**.

polisemia: 124, 177, 178, 198, 302.

polisemantizmi: 124, 137, 156, 179, 188, 190, 463.

Pribram: 110, 111, 112, 113.

prime matter: 408, 411.

principle: 165, 237, 418
Principle of Causality: 420.
Principle of Indeterminism: 349.
Uncertainty Principle: 103, 349.
Inseparability Principle: 103, 109, 110, 277, 420.
Supreme Principle: 45, 343, 481.

Prostatizmi: 161, 291, 292, 329, 521, 527.

Psikopomp: 11.

primordial: 45, 46, 83, 153, 154, 159, 160, 161, 298, 343, 360, 361, 392, 452, 474.

Qëndra: 18, 19, **24**, 25, 26, **30**, 31, 32, 33, 34, **35**, **36**, 38, 39, **40**, 41, 43, 44, **45** ,**46**, 47, 48, **49**, 50, 51, 52, 54, 57, 58, 65, 73, 77, 78, 83, 85, 87, 90, 93, 94, 95, 96, 100, 101, 102, 104, 107, 117, 119, 121, 122, 124, 125, 142, 143, 144, 145, 147, 148, 149, 150, 151, 152, 153, 154, 155, 156, 158, 160, 161, 164, 165, 166, 181, 182, 188, 189, 204, 209, 213, 219, 239, 240, 241, 244, 250, 251, 253, 255, 258, 260, 262, 263, 265, 275, 278, 279, 284, 292, 307, 309, 314, 315, **316**, **317**, 321, 326, 327, 334, 337, 343, 344, 345, 346, 350, 355, 361, 363, 366, 367, 372, 385, 397, 400, 413, 425, 433, 435, 443, 445, 460, 471, 473, 475, 479, 481, 482, 498, 499, 505, 507, 508, 528.
qëndra mistike: 35.

Rilindasit: 483.

Roli Mesianik i Gjuhë Shqipe: 124, 197, 236, 457.

S/s: **203**, **204**, 205, 206, 238, 329, 388, 449.

Sakrifica kozmogonike: 83, 159, 164, 297, 298, 308, 352, 363, 386, 391, 411, 436, 472.

Sanskritishtja: 15, 16, 17, 18, 120, 122, 134, 143, 161, 162, 169, 171, 172, 173, 175, 179, 186, 190, 197, 198, 200, 201, 248, 250, 251, 253, 267, 273, 357, 361, 392, 393, 394, 403, 404, 407, 419, 421, 439, 443, 450, 452, 453, 468, 472, 476, 482, 483, 484, 494.

Saussure: **197**.

Schneider: 94, 95.

Semantika:
bërthama semantike: 335;
prefiks asemantik: 386;
rreze semantike: 59, 69, 116, 168, 169, 183;
spektri semantik: 58, 59, 66, 76, 77, 79, 81, 202, 211, 314, 341, 345, 362;
theksi semantik: 215, 282, 372, 482, 489, 494, 496, 507, 508, 513, 520, 521, 523, 527, 530.

Shën Pali: 73, 96, 122, 415, 424, 444.

Shkenca e Re e Etimollogjisë: 172, 173, 175.

Science des profondeurs: 122, 179, 186, 199.

Simboli: 11, 16, 17, 18, 23, 44, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 65, 66, 68, 72, 75, 77, 78, 85, 88, 89, 94, 112, 113, 117, 124, 141, 154, 159, 161, 163, 173, 176, 188, 189, 202, 204, 205, 211, 226, 229, 230, 231, 232, 234, 235, 238, 239, 241, 242, 243, 249, 250, 251, 258, 268, 269, 270, 271, 277, 279, 286, 297, 298, 299, 300, 305, 315, 316, 325, 330, 332, 333, 335, 336, 341, 344, 345, 347, 355, 357, 358, 362, 377, 382, 384, 385, 386, 291, 400, 402, 413, 431, 432, 437, 438, 441, 447, 451, 456, 471, 473, 474, 476, 478, 498, 505, 516, 525, 526, 528.

Simbolik:
identiteti simbolik: 115, 19, 378;
mendimi simbolik: 33, 57, 114, 343;
nivel simbolik: 168;
numri simbolik: 154, 165;
rend simbolik 57.

Simboli dhe koncepti: 57.

Spektri semantik i një simboli: 58.

Spinoza: 326, 427.

Spirit: 46, 51, 158, 260, 274, 385.

sterben: 18, 147.

Substanca: 117, 151, 242, 259, 260, 326, 327, 335, 384, 405, 408, **409**, 410, 411, 421, 452, 469.

superluminoziteti: 191.

syri: 173, 174, 200, 261, 422, 423, 424, 425, 426, 480, 514, 520.

Syri i Tretë i Shivës: **423**, **424**, **425**, **426**.

Tabula Smaragdina: 32, 33, 86, 94.

Takimet: **71**, 115, 315.

Teilhard de Chardin: 79, 96, 334, 421.

Theollogji Kristiane: 60, 122, 158, 167, 258, 347, 363, 380, 415, 451, 474.

Teoria e Relativitetit: 55, 65, 69, 70, 71, 78, 113, 115, **192**, 442.

Tertium Datur: **27**, 56, 75, 99, 103, 109, 148, 406, 425, 427.

Tertium non Datur: **26**.

The Fall: 77, 81, 82, 126, 127, 131, 132, 133, 139, 140, 154, 157, 158, 167, 177, 214, 238, 397, 473, 476.

Themeli: 26, 75, 91, 122, 124, 147, 148, 153, 160, 190, 265, 298, 308, 349, 363, 384, 385, 386, 391, 408, 411, 415, 442, 448, 453, 464, 468.

Tezë: 81, 120, 153, 172, 302, 309, 397, **405**, 406, 407, 408 414, 419, 420, 421, 436.

tomber: 177, 214, 432, 446.

Transhendenca: 57, 117, 119, 453.

Unbroken Symmetry: 89, 90, 315.

Ungjilli: 79, 95, 96, 343, 413, 444, 450, 474, 491, 519.

Urtësia e Gjuhës: 124, **181**.

Vacuumi: 44, 63, 89, 103, 110, 191, 349, 350, **410**, **411**.

Vetvrasja teorike e Einsteinit: 113, 420.

Zerua: 40, 58.

Zgjerime bisede: 18, 122 172, 173, 174, 197, 199, 319, 346.

Lista e fjalëve sanskritisht

a-cchidra: 478.
a-dāna: 269.
ā-dhāna: 390.
adhara: 214.
ā-dhāra: 383.
adhikya: 394.
a-dhmāna: 395.
a-dhruva: 335.
a-dhruva: 336.
ā-DṚ: 399.
a-dṛtya: 398.
ādya: 397.
a-gada: 337.
agra: 373.
agraya: 214.
agrya: 373.
a-ja: 480.
a-janman: 481.
a-jāta: 478.
a-kāṇḍa: 212.
a-kathita: 368.
a-khaṇḍa: 210.
a-khaṇḍa: 374.
a-khaṇḍita: 211.
a-khaṇḍita: 379.
a-kovida: 478.
a-kṛta-in: 369.
a-kṛtsna: 374.
a-kṛtsnavid: 374.
a-kṛtya: 373.
akṣigata: 378.
akṣi: 378.
a-mita: 436.
a-mythyā: 437.
a-mythyākṛ: 438.
aṃça: 369.
an-ābādha: 306.
an-abhibhāṣin: 254.
an-abhidhāna: 254.
an-abhra: 263.
an-abhyāsa: 263.
an-adāra: 482.
an-ādi: 257.
an-āhara: 292.
an-āmiṣa: 259.
an-anta, °**kara**: 256.
an-antarvāsas: 255.
an-apakārin: 256.
an-apalapa: 254.
an-apara: 253.
an-ārabhya: 296.
an-ārambha: 299.
an-ārata: 291.
an-ārūḍha: 305.

an-asthan: 260.
an-asūri: 260.
an-asūya: 261.
an-atidūre: 332.
an-avastha: 262.
an-avasthāna: 263.
an-avekṣā: 262.
an-avekṣaka: 262.
an-avekṣaṇa: 262.
anguṣṭha: 479.
a-nibandhana: 265.
a-niçam: 294.
a-niçcita -ta: 295.
a-nidāna: 264.
a-nimiṣ: 292.
a-nipāna: 267.
a-nipuṇa: 291.
a-nirbhinna: 293.
a-nirvedita: 293.
a-niṣna: 295.
an-iṣta: 296.
a-nivedana: 294.
anta: 230.
antar: 232.
antara: 233.
antarayati: 243.
anu-kathana: 296.
anu-rathyā: 296.
aṇḍa: 363.
aṇḍabhedana: 364.
aṇḍagata: 364.
apa: 244.
apa-BHAṢ: 251.
apa-ha: 248.
apa-HAN: 249.
apa-hantṛ: 251.
apa-haraṇa: 250.
apa-hartṛ: 249.
apa-hāsa: 253.
apa-hāsya: 253.
apa-hati: 248.
apa-HI: 270.
apa-kāra: 252.
apa-KṚ , °krta: 252.
apa-LAP: 245.
apa-lapa: 246.
apa-lapana: 245.
apa-latā-bhavana: 244.
a-pariccheda: 270.
apa-vāraka: 246.
apa-varga: 244.
apa-varjita: 248.
apa-vatsa: 253.
apa-vedha: 247.
apa-vidyā: 248.
apa-vṛtti: 247.
ardha: 400.
artha: 401.
ati-gahana: 367.
ati-gambhīra: 366.
ati-guru: 367.
ati-lobha: 276.
ati-lubdha: 276.
atīndriya: 333.
ati-nirdaya: 368.
ati-PĀ: 368.

ati-sakhi: 273.
ati-VAC: 273.
ati-vibinna: 272.
ati-vira: 272.
ati-virya: 273.
ati-vistara: 272.
ati-vistīrṇa: 272.
a-tula: 332.
aty-ādara: 274.
aty-anta: 276.
aty-ardha: 274.
aty-artha: 279.
aty-asita: 274.
ava-NIJ, °nikta: 433.
ava-PAT: 432.
ava-PAD: 432.
ava-PAṬ: 432.

BANDH: 446.
bandhana -ī: 454.
bandhu: 454.
bandhura: 456.
bandin: 457.
bheda: 325.
Bheda: 357.
bhedakara -ī, -°kṛt: 331.
bhedasaha: 331.
bhedi-n (bhedana, ...): 430.
bhedita: 332.
bhedya: 429.
BHID (...bhidya... bhinna...): 458.
bīja: 431.
bodhaka: 428.
bodhi: 428.
bodhita: 427.
bodhya: 428.

Da (Y) (-°dyati; -°tta -dāya): 218.
dabhara: 220.
dara: 218. **°çlatha**: 219.
doṣa: 362.
doṣa: 220.
duç-cyava: 222.
duḥkha: 207.
dur-adhīta: 225.
dur-ākṛti: 226.
dur-anta: 225.
dur-avabodha: 208.
dur-bhara: 224.
dur-bhida (-bheda, bhedya): 222.
dur-ghaṭa: 226.
dur-udaya: 226.
dur-vāṣas: 224.
dus° (dur°, duç, duh°... du°...): 220.
dūsa: 220.
duṣ-kara: 221.
duṣ-parīkṣya: 223.

gada: 350.
ghaṭā: 356.
ghṛarma: 482.

hāni °kara: 472.
hāni kara: 476.

himsā: 476.
himsana: 477.
himsita (**HIMS-**): 477.

KAD: 350.
kadana: 353.
kadru: 354.
kadvada: 353.
kaḍāra: 354.
kati: 355.
katipaya: 356.
khaṇḍa: 268.
khaṇḍana: 269.
KHYĀ - khyāti...: 267.

mā: 286.
mahābhara: 307.
mahāgiri: 307.
mahāhasa: 308.
mahāmedha: 308.
mahāmoha: 309.
mahāratha: 307.
mahāvela: 309.
mahāvira: 308.
Mā-mimīte ... māti...: 286.
māṃsabhūta: 287.
māṃsavikrayin ose
māṃsavikretṛ: 287.
maṃsa: 286.
mita (**MĀ**): 288.
mitabhāṣin: 288.
mitabhāṣitṛ: 288.
mitabhukta ose **mitabhuj**: 288.
mitāhāra: 289.
MITH-mithitvā: 290.

nir ṇikti: 281.
nir-āmiṣa: 281.
nir-antara: 227.
nir-apatrapa: 283.
nir-daya: 281.
nir-dhana: 281.
nir-doṣa: 280
nir-dravya: 282.
nir-ghāta: 282.
nir-hrīka: 283.
nir-ṇij: 281.
niṛ-pa: 285.
niṣ-phala: 285.
niṣ-tula: 285.

paktṛ: 285.
para: 371.
Para: 371.
pari-Bhram: 216.
pari-bhraṣṭa: 216.
pari-dhāraṇa: 285.
pari-galita: 311.
pari-ghātin: 309.
pari-GHAṬ: 309.
pari-nir-ṇij: 283.
pari-PĀ: 284.
pari-pāka: 284.
pātṛ: 286.
pātra: 286.
paṭa, °kuti, °veçman: 201.

paṭānta: 201.
paṭṭa: 203.

sam-agra: 215.
stambhita: 467.
sthairya: *466.*
sthairya: 466.
sthāpana: 459.
sthâpya: 467.
stheman: *466.*
stheman: 466.
stheya: 466.
sthīta (STHĀ) : 461.
sthīti: 460.
stimita: 467.
su: 203.
su-cetas: 210.
su-dāru: 208.
su-dayita: 206.
su-dhī: 207.
su-duḥkha: 206.
su-durmanas: 208.
su-durvida: 210.
su-duṣkara: 209.
su-duṣta: 209.
su-kathā: 206.
sūnu: 480.
sūrya: 261.
sūrya: *480.*

tamas: 280.
tulya: 270.

UṢ-oṣati; uṣyate: 445.
uṣna: 445.

vandāru: 312.
vedin: 445.
veditṛ: 446.
vi-manas: 291.
vi-manyu: 291.
vi-tamas: 311.
vi-varta: 314.
vi-vasana: 216.
vi-ViC: 312.
vraṇa: 215.

Lista e fjalëve hebraisht

(me përkthim në anglisht)

'ukal (עוקל): **492**.
banah (בנה): **486**.
bara (ברא): **487**.
be'er (באר): **492**.
bi-mekom (במקום): **491**.
doron (דורן): **486**
halbashah (הלבשה): **487**.
heshtakhah (השתקה): **488**.
hiktan (הוקטן): **488**.
histajem (הסתיים): **493**.
histara' (השתרע): **489**.
histater (הסתתר): **489**.
histir (הסתיר): **488**.
hitgabrut (התגברות): **495**.
hitgarah (התגרה): **495**.
hitgared (התגרד): **495**.
hitgarut (התגרות): **495**.
hitkomem (התקומם): **492**.
hitvada' (התוודע): **494**.
huf'al (הופצל): **490**.
hukam (הוקם): **491**.
hukhal (הוחל): **492**.
hushtat (הושתת): **496**.
jetomim (יתומים): **487**.
jozem (יוזם): **490**.
kala' (קלע): **487**.
karam (קרם): **489**.
kash (קש): **486**.
kashit (קשית): **486**.
katsar(si edhe **katser**) (קצר): **497**.
katsats (קצץ): **497**.
kavar (קבר): **486**.
kavod (כבוד): **483**.
khadal (חדל): **485**.
khadar (קדר): **485**.
khatsah (חצה): **489**.
khavash (חבש): **488**.
kholef (חולף): **489**.
kum (קום): **491**.
kvurakhamor (קבורחמור): **490**.
ledah (לידה): **487**.
mador (מדור): **497**.
nemanut (נאמנות): **496**.
ni'dar (נצדר): **485**.
nig'al (נגאל): **487**.
skirah (סקירה): **492**.
tsur (צור): **486**.
yashan/yashanah (ישן): **489**.
zefet (זפת): **495**.
zift (זיפת): **496**.

zirah (זירה): 490.

Lista e fjalëve hebraisht

(me përkthim në italisht)

'avad (עבד): 525.
'avad (עכד): 508.
adama (אדמה): 503.
ani (אני): 503.
ania (אניה): 502.
asar (אסר): 514.
asar (אסר): 531.
asur, asir (אסור, אסיר): 514.
bad (בד): 503.
badak (בדק): 525.
badal (בדל): 502.
bajt (בית): 501.
bakhir (בכיר): 517.
bakhir (בכיר): 532.
bar (בר): 524.
bara (ברא): 510.
bejt-kevarot (בית–קברות): 501.
belo yod'in (בלא יודעין): 525.
beltiadu'a (בלתידוע): 526.
beria (בריאה): 510.
berja (בריה): 510.
biet (בית): 501.
bikur (בקור): 525.
bikura (בכורה): 508.
biser (בשר): 515.
bitur (בתור): 511.
bor (בור): 515.
buz (בוז): *501.*
da'at (דעת): 503.
da'tanut (דעתנות): 503.
dabar (דבר): 531.
dafna (דפנה): 514.
dan (דן): 532.
dira (דירה): 515.
em (אם): 501.
era' (ארצ): 510.
esh (אש): 502.
gader (גדר): 512.
gadól, *gedóla* ... (גדול): 509.
gadum, geduma (גדום): 514.
gavri (גברי): 504.
gedal (גדל): 508.
gèver (גבר): 504.
gibor (גבור): 504.
hagdara (הגדרה): 511.
havdala (הבדלת): 511.
Hete kadmon (חטא קדמון): 523.
hevdel (הבדל): 511.
higdir (הגדיר): 508.
hilul (הלול): 515.
histir (הסתיר): 502.
hodi'a (הודיע): 525.
jara (ירה): 516.
kadan (כדן): 528.

kadmon (קדמון): 507.
kadum (קדום): 507.
kal, kala (קל, קלה): 522.
kara (קרה): 509.
kata' (קטע): 524.
kav-gemar (קו–גמר): 524.
ketem (כתם): 513.
khakar (חקר): 526.
kodem (קדם): 506.
lakham (לחם): 529.
lakham (לחם): 529.
leda (לדה): 523.
leda (לדה): 508.
leut (לאות): 529.
levad (לבד): 516.
lo shakuf (לא שקוף): 517.
mad (מד): 531.
madua (מדוע): 530.
mana' (מנצ): 516.
masor (מסור): 517.
matara (מטרה): 516.
matun (מתון): 529.
miadi (מיידי): 527.
mida (מדה): 512.
mishkafajim (משקפים): 517.
mishpat (משפט): 533.
miten (מתן): 529.
mustar (מסתר): 502.
naga' (נגע): 517.
natan (נתן): 520.
natun (נתון): 521.
netakh (נתח): 520.
niser (נסר): 517.
nishba' (נשבע): 532.
pagum (פגום): 524.
raa (ראה): 527.
reut (ראות): 528.
shilakh (שלח): 529.
shura (שורה): 533.
sier (סיר): 516.
tam (תם): 518.
tamim (תמים): 518.
tefila (תפלה): 522.
tsafa (צפה): 519.
tsakhak (צחק): 519.
tsefia (צפיה): 519.
tsien (ציין): 522.
tsofe (צופא): 519.
tsole'a, -la'at (צולע– לעת): 519.
vadáiut (ודאיות): 505.
vadaj, -it (ודאי): 505.
vida (ודה): 506.
viduj (ודוי): 506.
zarakh (זרח): 505.
zarkhan (זרחן): 504.
zera' (זרע): 504.

Bibliografi

Albert Einstein: *Relativity*

Benedict de Spinoza: *Ethics*

Berkley: *Three dialogues between Hylas and Philonous*

Bice Benvenuto, Roger Kennedy: *The Works of Jacques Lacan*

C.G. Jung, & M.-L. Franz: *Man and His Symbols*

C.G. Jung, & Wolfgang Pauli: *Atom and Archetype: The Pauli/Jung Letters*

C.G. Jung: *The Archetypes and The Collective Unconscious*

Carl Jaspers: *Metafisica*

Carlo Saviani: *L'Oriente di Heidegger*

Charles Baudelaire: *Les fleurs du Mal*

Charles Seife: *Alpha and Omega (The search for the **beginning** and **end** of the Universe)*

Charles Seife: *Zero*

D. Bohm: *The Implicate Order*

David Peat: *Synchronicity (The bridge between matter and mind)*

David Peat: *The philosopher's stone (Chaos, synchronicity and the Hidden Order of the World)*

Edward F. Edinger: *Ego and Archetype*

Ernst Casirer: *Language and Myth*

Ferdinand de Saussure: *Cours de linguistique générale*

Fritjof Capra: *Il punto di svolta*

Fritjof Capra: *The Tao of Physics*

Gary Zukav: *The dancing Wu Li Masters (An overview of the New Physics)*

George Ellis: *Before the beginning (Cosmology explained)*

Goethe: *Faust*

Heidegger and Asian thought, (edited by Graham Parkes)

Hermann Weyl: *Symmetry*

Immanuel Kant: *Critica della Ragion pura*

Jacques Lacan: *The Language of the Self (The Function of Language in Psychoanalysis)*

Jean Chevalier: *Dictionnaire des Symboles*

Marcus Borg: *Jesus the parallel Sayings & Buddha*

John Gribbin: *Unveiling the edge of time*

J.E. Cirlot: *A dictionary of symbols*

K.C. Cole: *The hole in the Universe*

Karl Pribram: *Languages of the Brain*

M. Hiriyanna: *Outlines of Indian Philosophy*

Martin Gardner: *Philosophical Foundations of Physics*

Micho Kaku: *Beyond Einstein*

Mircea Eliade: *Images and Symbols*

Mircea Eliade: *Le mythe de l'éternel retour*

Murry Hope: *Time, the ultimate energy*

Nick Herbert: *Quantum reality (Beyond the new physics)*

Nicolas de Cusa: *De la docte ignorance*

P.A. Schilpp: *The Philosophy of Rudolf Carnap*

Patrick Ravignant: *Oriente segreto (I folli di Dio)*

Paul Davies and **John Gribbin**: *The matter myth*

Paul Davies: *God & the new Physics*

Piergiorgio Odiffredi: *Il Vangelo secondo la Scienza*

Platone: *Parmenide*

Reinhard May: *Heidegger's Hidden Sources: East Asian Influences on his Work*

Rudolf Carnap: *Logic, Language, and the Structure of Scientific Theories, (edited by University of Pittsburgh Press)*

Sigmund Freud: *An outline of Psycho-Analysis*

Sigmund Freud: *Totem and taboo*

Sir James Jeans: *Physics and Philosophy*

Stephen Hawking: *Quest for a theory of everything*

The concise Oxford Dictionary of Linguistics

Ken Wilber: *The Holographic Paradigm*

The Holy Bible, King James version

Victor Stenger: *Timeless Reality*

Werner Heisenberg: *Across the frontiers*

William Barret: *Irrational Man (a study in Existential Philosophy)*

Pasqyra e lëndës

Dy fjalë lexuesit... ... ***11***

Hyrje ... ***13÷19, 124÷192***

Artikullimi llogjik i Mendimit Mitik nëpërmjet Algoritmit Simbolik... ***21÷123***

a. *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik* ... ***21***

b. *Ndërtimi i Algoritmit Simbolik duke u nisur nga Hiçi* ... ***85***

c. *Një ballafaqim i drejtë për drejtë i Algoritmit Simbolik me Mendimin Mitik* ... ***93***

d. *Algoritmi Simbolik si HOLOGRAMË* ... ***99***

Shkenca e rè e zgjeruar e Etimollogjisë ... ***171***

Urtësia e Gjuhës ... ***181***

Gllosar ... ***195÷533***

Një parathënie e shkurtër ... ***197***

Shqipja dhe Sanskritishtja ... ***201***

Shqipja dhe Hebraishtja ... ***485÷533***

Fjalori me përkthim nga anglishtja ... ***485***


Fjalori me përkthim nga italishtja ... ***501***

Pasthënie ... ***535***

Indeksi ***541***

Lista e fjalëve ***549***

Bibliografi ***557***



From the inside cover of Webster's 20 th Century Dictionary
World Publishing Company © 1956

Ndreqje gabimesh

Faqe	*Pozic. i rreshtit*	*Duhet lexuar*
32	i fundit	*Pjesën e parë* (fq. 160) si edhe *Pjesën e dytë* (fq. 86).
35	14 nga fundi	e manifestimit dhe të emanimit
73	2 nga fundi	Shih Cirlot, fq. 172.
77	8 nga fillimi	∞ = *i* = + = (*x* = ☒)
94	5 nga kreu	Simbolizmi i numrit *2*, ... *Pjesa e dytë* fq. 207
	8 nga kreu	Mitet kozmogonike, ... *Pjesa e dytë* fq. 83, 154, 157, 165.
111	12 nga fundi	(Shih lidhur me këtë çështje edhe faqet 119, 424)
112	13 nga kreu	Në faqen 107
126	-	**moto**
127	-	**matra, delats, rational**
128	-	**wake, pasi, denn, quindi, διο**
129	-	**ban, matra**
130	-	**hùn,** sch**mutz**ig
131	-	**bjes, vjes**
132	-	**fall, vjes**
133	-	**fall, ava-PAT, scendere**
135	7 nga fundi	**xi**
136	12 nga kreu	**zhè**
145	6 nga fundi	***quando***
186	i fundit	nëpërmjet bisemisë së italishtes **in**
189	6 nga kreu	në kuptimin e *ndarjes.*
190	7 nga kreu	të hiqet "1)"
204	i fundit	Hiqet shënimi i parë

211	10 nga fundi	dhe fjala **a-khaṇḍa**
214	2 nga kreu	Kuptimi *befas, papritur* del kështu: **a-kāṇḍa** dhe me shqipen, siç pamë – nda, e pra simb. – ⓘ, e pra atëhere, për ekuivalencë simbolike edhe ○, e pra ($x = -x$) = *Qëndra*, e pra (t = 0) (koha zero). Pra atëhere: *diçka që ndodh brenda një kohe zero*, në më nyrë të menjëhershme, të papritur ...
221	I fundit	Shto "E pra: *E vështirë* (⊗) *për t'u kryer* (*kry*)"
223	2 nga kreu	*vështirë* me **u dà**
232	14 nga fundi	është *brënda* (⊡).
250	12 nga kreu	sikundër
252	8 nga kreu	(*apa* = – *I* = ●)
264	i fundit	Po ajo që
287	5 nga kreu	**mā ṃsa vi kra yin**
289	10 nga fundi	(*b*)**huj**
389	10 nga fundi	Iris,
403	2 nga kreu	$-(x = -x) = (x \neq -x) = -(\leftarrow = \rightarrow) = (\leftarrow \neq \rightarrow) =$
445	4 nga kreu	për *antitezë*.
447	9 nga fundi	flet
455	12 nga kreu	Që kemi të bëjmë në të dy
473	12 nga kreu	shkenca e fillosofia moderne
473	2 nga fundi	Shih edhe faqe 303
482	3 nga fundi	Shih edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi, fq. 98, 160.
483	i fundit	Shih edhe *Pjesën e parë* të këtij studimi, fq. 90.
490	3 nga kreu	**jashan**/jashanah
502	3 nga fundi	diateza e pësores,
511	4 nga fundi	të prishet: "lidhet me shqipen:"
527	4 nga kreu	– **a di**
532	10 nga kreu	Lidhet me foljen